UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

BULETINI SHKENCOR "KËRKIME UNIVERSITARE"

Viti XXXIV i botimit (42)

2022/1

ISSN: 2226-082X

PUBLIKUAR NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

BULETINI SHKENCOR "KËRKIME UNIVERSITARE"

Botim periodik
Viti XXXIV, Nr. 42
2022/1

SCIENTIFIC JOURNAL "UNIVERSITY RESEARCH"

Periodical
Year XXXIV, Nr. 42
2022/1

PUBLISHED BY "EQREM ÇABEJ" UNIVERSITY
GJIROKASTËR

BOTUES
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
Lagjja "18 Shtatori", rruga "Studenti" 6001, Gjirokastër

Copyright © - Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet pa respektuar të drejtën e autorit.

ISSN: 2226-082X

EDITOR IN-CHIEF
Prof. dr. Bektash Mema
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
Rruga "Studenti" 6001, Gjirokastër
www.uogj.edu.al
Tel: +355 8426 3408

EDITORIAL BOARD
1. Prof. dr. Gëzim Sala
2. Prof. dr. Shyqyri Hysi
3. Prof. dr. Gëzim Rredhi
4. Prof. dr. Lavdi Hasani
5. Prof. asoc. Valbona Duri
6. Prof. asoc. Jaho Cana
7. Prof. asoc. Selfo Oruçi
8. Dr. Isidor Kokalari
9. Dr. Romeo Mano
10. Dr. Robert Çelo
11. Dr. Eduina Guga
12. Dr. Drita Luzo

Korektuesi në gjuhën shqipe
Prof. as. Spiridhulla Poçi

Korrektuesi në gjuhën anlgeze
Dr. Arben Gaba

Koordinator Administrativ
Dr. Lorenc Koçiu

PËRMBAJTJA

Fatos Tarifa
"Burnout"—një antidot i mirëqenies psikologjike të mësuesve. Si mund ta përballojmë atë? **7**

Arlinda Ymeri, Eranda Halluni Bilali
Psikologu shkollorë dhe lidhja e tij me mësuesin e arsimit fillor **15**

Romeo Mano, Mimoza Çarka
Hulumtim mbi përdorimin e strategjive mësimore dhe teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. (*Rast studimor: krahasimi i faktorëve strategjikë në mësimdhënie midis lektorëve të rinj dhe lektorëve me përvojë të gjatë në mësimdhënie)* **21**

Fiona Todhri, Sabina Belshaku, Juliana Cerekja
Zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësuesve **30**

Eris Dhamo, Anila Sulaj, Kristina Qypi
Administrimi i procesit të ri të mësimdhënies në distancë **36**

Zhuljeta Lilo
Edukimi i inteligjencës emocionale të mësuesit për krijimin e një klime pozitive në klasë dhe arritje shkollore **44**

Denada Quku
Ndikimi i eksodeve të brendshme rurale te perceptimet e të rinjve **51**

Shyqyri Hysi, Luiza Hysi
Presioni i shtetit komunist dhe krijimi i stresit psikologjik në sistemin arsimor fetar shqiptar, rasti i komunitetit mysliman 1945 – 1950 **60**

Darina Çoni (Kacollja), Fiona Todhri
Kriza në fushën e ndërtimit dhe pasojat sociale **66**

Marigona Bekteshi Ferati
Teatri edukativ si metodë e tejkalimit të pasojave për të mbijetuarat e dhunës gjatë luftës së Kosovës **76**

Fabiola Elezaj
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Durrës dhe Shijak **85**

Ingrida Behri Mustafa, Lira Spiro
Edukimi parandalon dhunën ndaj femrës **94**

Irena Telha, Denada Quku
Përcaktimi i shkallës së rëndësisë së rolit të psikologut shkollor në trajtimin e fëmijëve me prindër të divorcuar (Rasti i Shkollës jopublike "Turgut Ozal"Durrës) **103**

Elda Deliu
Shëndeti dhe mirëqenia psikologjike e mësuesve në ndikimin e COVID 19-n **112**

Blerina Hima Mërtiri
Mësuesi dhe psikologu,bashkëpunimi i tyre për lehtësimin e situatës psikologjike të nxënësve **117**

Jaho Cana, Jonida Bushi (Gjuzi)
Ndikimi i reformave në cilësinë e mësimdhënies në sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë **125**

Ermelinda Kashahu
Romancieri Petrit Palushi - produkt i kohës së re **130**

Ejona Isufaj
Sfondi historik i partive politike italiane **136**

Loreta Mamani, Eduina Guga
Rëndësia e njohjes nga mësuesit e çrregullimeve të vëmendjes dhe hiperaktivitetit te fëmijët e shkollave 9-vjeçare **145**

Marjeta Novaku
Zhvillimet social-ekonomike në prefekturën e Dibrës përgjatë krizës ekonomike në vend (1929-1935) **154**

Jonida Petro
Përftesat përkthimore dhe larmishmëria e tyre në përkthimin e Martin Iden nga Xhek London **167**

Vjollca Rrapai, Sashenka Kamberi
Shkallët e komikes në krijimtarinë letrare të Qamil Buxhelit **176**

Ejona Isufaj
Zanafilla e partive politike në Shqipëri **182**

Shpëtim Madani
Analizë e romanit "një jetë e re" sipas etikës deontologjike të Kantit **187**

Sashenka Kamberi, Vjollca Rrapai
Sinonimia fjalëformuese në fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe **195**

Elona Limaj
Përdorimi i emrave të përveçëm, të huaj në gjuhën shqipe **202**

Zeqir Zeqirllari, Hristina Mallanezo
Mësuesi, gjuha dhe letërsia në shkollë **209**

Merita Gjokutaj-Shehu
Elementet e krijimtarisë popullore në poetikën romantike të De Radës **217**

Mimoza Zekaj
Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e ndryshme të trevave shqiptare dhe në trevat shqipfolëse **224**

Spiridhulla Poçi
Aromanian in "gramaticā aromānā icā macedonovlahā" by Mihail g. Boiagi **231**

Kostando Ksera, Eljana Kokalari, Evanthia Baruta
Fjalorët e gjuhës greke me të folmen e arvanitasve **242**

Panajot Barka
Pema në organizimin e strukturës tradicionale shoqërore të shqipërisë së jugut, një komunikim diakronik me Orakullin e Dodonës **254**

Zeqir Zeqirllari, Hristina Mallanezo
Karakteristikat e një mësimdhënieje produktive **263**

Arjola Mitaj
Hapja tregtare dhe rritja ekonomike: analizë e serive kohore për Shqipërinë **271**

Dritan Rami, Arjan Harxhi, Pëllumb Pipero
Korelacion midis te dhënave epidemiologjike dhe klinike i rasteve me brucelozë në qarkun e Gjirokastrës gjatë periudhës 2017-2019. **280**

Igli Kokalari
Studim kliniko-statistikor i varikocelës, në spitalin "Omer Nishani" Gjirokastër, në periudhën 2009-2013 **288**

"BURNOUT"—NJË ANTIDOT I MIRËQENIES PSIKOLOGJIKE TË MËSUESVE

Si mund ta përballojmë atë?

Fatos Tarifa
Universiteti Europian i Tiranës
Departamenti i Shkencave Sociale
fatos.tarifa@usa.net

Kur në mesin e viteve 1970 Herbert Freydenberger (1974; 1975), një psikolog gjermano-amerikan, i njohur për studimet dhe punën e tij klinike lidhur me trajtimin e stresit, të lodhjes kronike dhe të abuzimeve me substancat psikoaktive, krijoi dhe përdori për herë të parë termin "burnout", për të përshkruar *lodhjen ekstreme mendore dhe fizike* të punonjësve në klinikën e tij, ai nuk mund ta kish imagjinuar se sa shpejt do të *popullarizohej* ky koncept dhe sa gjerësisht do të *përdorej* ai, kudo në botë, në studimet psikologjike e sociologjike mbi profesionet.

Christina Maslach (1976; 1978a; 1978b), një psikologe sociale e njohur në Universitetin e Kalifornisë në Berkli, ishte ndër të parat studiuese që e adoptoi me entuziazëm dhe e përdori këtë koncept të ri në kërkimet e saj empirike. Ajo konstatoi se dukuria "burnout" haset rëndom në një sërë profesionesh, që kanë të bëjnë me *shërbimet ndaj njerëzve* dhe erdhi në përfundimin se*kërkesat dhe përgjegjësitë* me të cilat ndeshen punonjësit në profesione të tillë jo vetëm e mundësojnë "burnout"-in, por edhe ndikojnë në pasojat me të cilat shfaqet kjo dukuri. Këto pasoja i përjetojnë jo vetëm *punonjësit e këtyre profesioneve*; ato ndikojnë edhe në vetë *cilësinë e shërbimeve që ata ofrojnë*, si dhe në institucionet e specializuar për t'i ofruar këto shërbime (Maslach 1976, 1978a).

Gjatë këtyre 3-4 dekada të fundit, dukuria "burnout" ka marrë vëmendje të gjerë, çka shprehet si në *interesimin publik* për të, ashtu dhe në *veprimtarinë kërkimore ndërdisiplinore*, në fusha të tilla si *psikologjia, sociologjia, puna sociale, mjekësia, arsimi, administrimi* dhe *menaxhimi*.

Studime të shumtë kanë eksploruar *marrëdhëniet me stresit në punë dhe "burnout"-it*. Prej tyre rezulton se "burnout" ka më shumë gjasa të zhvillohet *në ato situata, në të cilat prania dhe ndikimi i faktorëve stresues i tejkalojnë aftësitë e individit për t'i përballuar ata*. Duke u përballur me një varg *konfliktesh e kontradiktash që lidhen me rolet e tyre profesionalë* në institucionet dhe në organizatat ku punojnë, si dhe me *ndryshimet e shpejta në fushën e teknologjisë, pritshmëritë e shoqërisë në fushën e shërbimeve sociale, motivimi dhe aftësitë për punë me kalimin e kohës mund të bien, duke krijuar tension, lodhje emocionale, frustrim, demoralizim profesional, distancim mbrojtës, zhgënjim nga arritjet personale deri edhe depersonalizim*—të gjitha këto *simptoma* dhe *komponentë* të sindromit "burnout".

† † †

Studiues të ndryshëm kanë konstatuar se "burnout" është një *dukuri që mund të shfaqet në çdo profesion dhe, thuajse, te çdo individ* (Marrow 1981; Carroll & White 1982; Farber 1984a, 1984b). Shumica e studiuesve, sidoqoftë, bien dakord se sindromi "burnout" shfaqet *kryesisht—dhe në mënyrë më karakteristike*—tek ata individë që konsiderohen si "*helping professionals*", pra, që *punojnë me njerëzit, duke shpenzuar një pjesë të madhe të kohës duke u marrë nga afër me njerëz të tjerë në kushtet e një tensioni dhe stresi të vazhdueshëm, ose që kanë përgjegjësi për njerëz të tjerë*. Me fjalë të tjera, "burnout" shfaqet kryesisht si një *lodhje e madhe emocionale dhe fizike, që shkaktohet nga stresi që krijojnë marrëdhëniet ndërpersonale me njerëz të tjerë* (Maslach & Jackson 1979; Kahn 1978). Kjo veçori e dallon "burnout"-in nga *lodhja fizike që shkaktojnë monotonia dhe orët e zgjatura në punë fizike*.

"Burnout", si një dukuri, është studiuar gjerësisht në radhët e *punonjësve të shëndetit* (infermierëve, psikoterapistëve, dentistëve), te *punonjësit që kujdesen për fëmijët* (edukatoret, mësuesit, drejtuesit e shkollave, administratorët e bizneseve) etj.

Mësuesit përfaqësojnë një kategori të tillë profesionale, te të cilët dukuria "burnout" ndeshet më shpesh, me simptoma dhe *pasoja më të dukshme e më serioze*, arsye kjo për të cilën, gjatë këtyre më shumë se 40 viteve të fundit, *kjo dukuri është studiuar më gjerësisht në radhët e tyre* (Hendrickson 1979; Landsmann 1979; Weiskopf 1980; Jones & Emanuel 1981; Kirk & Walter 1981; Blase 1982, 1986; Cunningham 1983; Dworkin 1987; Pierce & Molloy 1990; Cherniss 1995; Whitaker 1996). Në Shtetet e Bashkuara, *mësuesia* renditet si *një ndër dhjetë profesionet më stresues*. Ky profesion është kaq stresues, sa Shoqata e Mësuesve të Kalifornisë ka krijuar, madje, një program që u ofron mësuesve një pushim (*retreat*) 5-ditor, me qëllim që ata të çlodhen.

Vetëm një mësues e di se sa stresues është puna që ai kryen, sado e bukur që mund të jetë ajo. Planifikimi i mësimit për të nesërmen dhe përgatitja e ditarit, takimet me mësues, takimet me prindërit, mbledhjet e komisioneve të lëndëve, testimi i nxënësve, korrigjimi i detyrave etj, etj.—të gjithë këta role krijojnë *predispozita për "burnout"*.

Mësuesve u kërkohet çdo ditë të mbajnë 50 kësula mbi kokë—të kryejnë pra, *50 detyra të ndryshme çdo ditë*, pa folur për *përgjegjësinë e madhe që ata kanë për formimin arsimor e kulturor të brezave të ardhshëm të shoqërisë*. Të mos harrojmë se, në vetëm pak orë, një mësuesi mund t'i duhet të kryejë edhe rolin e edukatorit, edhe atë të prindit, edhe atë të një infermieri, edhe rolin e një negociatori, edhe atë të një trajnuesi e me radhë. *Asnjë karrierë tjetër profesionale nuk kërkon të luash më shumë role sesa mësuesia*.

Duhet thënë, sidoqoftë, se, studimet në këtë fushë janë kryer, thuajse, të gjitha në Shtetet e Bashkuara ose në shoqëri të tjera të industrializuara, për shkak të perceptimit gjerësisht të përhapur—por të gabuar—se "burnout" është një "*sëmundje e jetës moderne*" (Maslach 1982: 29) dhe, për këtë arsye, është një dukuri relativisht e re.

† † †

Në literaturën sociologjike dhe psikologjike në Perëndim gjenden çuditërisht pak studime për profesionin e mësimdhënies në shoqëritë në zhvillim ose në ato shoqëri, që dikur kanë qenë shoqëri socialiste. Në Shqipëri, për të parën herë kjo dukuri u studiua në vitin 1991 dhe një artikull që autori i këtyre radhëve dhe një bashkëpunëtor i tij botuan në fund të viteve 1990 në revistën amerikane *Michigan Sociological Review* (Tarifa & Sokoli 1998), ishte i pari studim nga autorë shqiptarë mbi këtë subjekt. Ai artikull prezantonte dhe shpjegonte *gjetjet e një studimi eksplorues mbi shkallën e përhapjes dhe intensitetin e dukurisë "burnout" në radhët e mësuesve shqiptarë* të shkollave 8-vjeçare dhe atyre të mesme në vitin e parë të tranzicionit demokratik, duke i krahasuar ato me gjetjet e studimeve të kryera deri në atë kohë në vende të tillë, si Shtetet e Bashkuara, Suedia, Gjermania, Franca, Singapori etj..

Si i pari studim—dhe ndoshta i vetmi deri më sot—që është fokusuar në dukurinë "burnout" në radhët e arsimtarëve shqiptarë, është me interes të bëj të njohura, në vija të përgjithshme, mënyrën e realizimit dhe gjetjet e atij studimi.

Studimi në fjalë u krye në pranverën e vitit 1991, me një sample prej 349 mësuesish në 20 shkolla të vendit. Ky numër mësuesish përfaqësonte afërsisht 1 për qind të numrit të përgjithshëm të arsimtarëve në atë kohë, që ishte 38,400 (*Vjetari Statistikor i R.P.S. të Shqipërisë* 1991). Ata u zgjodhën në mënyrë rastësore në 8 nga 26 rrethet e vendit, nga Tropoja në Sarandë.

Pyetësori që u përdor për atë studim përmbante 112 pyetje, të formuluara për të matur disa komponentë, si kënaqësia në punë (*job satisfaction*), ngarkesa në punë (*workload*), mbështetja shoqërore (*social support*), (detyrat e papëlqyera (*aversive tasks*) dhe "*burnout*" (shih gjithashtu Kloep & Tarifa 1994).

Instrumentet matëse për dukuritë e mësipërme u ndërtuan nga autorit i këtyre radhëve, ndërsa ai për matjen e "burnout"-it u huazua nga një psikolog suedez (Hellerstedt 1989), që e kishte përdor atë për të studiuar "burnout"-in në radhët e mësuesve suedezë.

Për të matur "Burnout"-in, u formuluan 4 lloj pyetjesh:

- Pyetje që kishin të bënin me *arritjet personale* të mësuesve, të cilat sugjeronin alternativa përgjigjesh si këto: (i) Unë jam një mësues jo aq i mirë sa mësuesit e tjerë; (ii) Më duket vetja sikur jam një mësues i dështuar; (iii) E kam të vështirë të krijoj një mjedis të qetë pune në klasë; (iv) Nuk mendoj se unë bëj për mësues.

- Pyetje që kishin të bënin me *entuziazmin e mësuesve në punë*. Alternativat e sugjeruara si përgjigje për këtë pyetjeje ishin këto: (i) Unë kuptohem shumë mirë me nxënësit e mi; (ii) Unë jam shumë i efektshëm në punën që bëj; (iii) Ndihem plot energji për të kryer punën që bëj.

- Pyetjet që kishin të bënin me *lodhjen emocionale* përmbanin këto alternativa përgjigjesh: (i) Unë ndihem "burned-out" nga puna që bëj; (ii) Ndihem i lodhur ende pa filluar punë; (iii) ndihem emocionalisht bosh pas klasës së fundit çdo ditë.

- Pyetjet që kishin të bënin me *depersonalizimin* e mësuesve përmbanin këto alternativa përgjigjesh: (i) Ndonjëherë më duket se kam ndjenja negative ndaj

nxënësve të mi; (ii) Nuk bën kuptim të përpiqesh shumë me çdo nxënës të veçantë' (iii) Është e vështirë ta mbash afër një nxënës; (iv) Ndonjëherë i trajtoj nxënësit e mi si të ishin objekte pa shpirt.

Shkurtimisht, çfarë rezultoi nga ai studim i parë empirik lidhur me dukurinë "burnout" në radhët e mësuesve shqiptarë?

Ngarkesa në punë e mësuesve dhe *problemet disiplinore* u vu re se ishin ngushtësisht të lidhura me *lodhjen emocionale* të tyre. *Ngarkesa në punë shkaktonte stres*, por vetëm nëse—dhe vetëm atëherë—kur ajo shoqërohej nga faktorë të tjerë, si *ndërveprimet e papëlqyera me nxënësit* dhe *mungesën e mbështetjes nga kolegët e tjerë*.

Mbështetja nga ana e kolegëve, e cila konsiderohet se është *një ndër parakushtet më të rëndësishëm për të evituar "burnout"-in* duket se ishte e lidhur kryesisht me *entuziazmin e mësuesve për punën që kryenin*.

Nga ana tjetër, *ndjesia e fajit* dhe *problemet disiplinore* ishin të lidhura ngushtë me *depersonalizimin e mësuesve*.

Për habinë tonë, gjetjet e atij studimi, të kryer 30 vite më parë, dëshmuan një *shkallë shumë të ulët "burnout"*-i të raportuar nga vetë mësuesit, në krahasim me "burnout"-in që vihet re te mësuesit, pothuajse, në të gjithë vendet Perëndimore. Për t'i dhënë shpjegim kësaj gjetjeje, testuam *hipotezën e parashtruar nga dy studiues amerikanë*, Craig Cunningham (1983) dhe Barry Farber (1984a, 1984b), sipas së cilës, *shkalla e respektit që mësuesit gëzojnë në komunitetin e tyre, si edhe vlerësimi shoqëror për ta janë të lidhura ngushtësisht ose me praninë e "burnout"-it ose me mungesë e tij*.

Shumica dërrmuese e mësuesve pjesëmarrës në atë studim u shprehën se *ndiheshin shumë të respektuar dhe trajtoheshin në mënyrë dinjitoze për punën që bënin nga komuniteti i tyre*, shumë më tepër sesa mësuesit në vende të tjera më të zhvilluara, pavarësisht nivelit të shkollës në të cilën jepnin mësim—fillore, 8-vjeçare apo e mesme.

Analiza e të dhënave empirike të atij studimi na çoi në përfundimin se *respekti për mësuesit dhe statusi shoqëror i mësuesve në Shqipërinë e atyre viteve*—kur vendi ynë ruante ende shumë nga tiparet e shoqërisë socialiste nga kishim dalë—shpjegohej me disa faktorë, të tillë si:

- Pavarësisht se pjesa dërrmuesve e mësuesve (ashtu si dhe në vende të tjera ish-socialiste) vinin nga shtresa e ulët ose e mesme e shoqërisë, ndryshe nga ata që punonin në profesione elitare—mjekë, juristë, inxhinierë—*në Shqipëri mësuesia gëzonte një status profesional relativisht të lartë*.

- Pavarësisht nga roli dhe kontrolli i shtetit i cili ishte *i vetmi punëdhënës* për të gjithë mësuesit e shkollave, të të gjitha niveleve, *mjedisi institucional dhe politik e inkurajonin dhe e favorizonin mjaft mësimdhënien si një aktivitet profesional*.

- Lidhja e ngushtë mes mësimdhënies dhe synimeve të regjimit komunist për socializimin e brezit të ri do të thoshte se *mësuesit kishin mbështetjen e shtetit dhe të shoqërisë, dhe ipso facto, një rol dhe një pozitë të nderuar e të vlerësuar në*

shoqëri, si dhe një mirëqenie ekonomike e psikologjike relativisht më të mirë se masa dërrmuese e popullsisë.

- Përveç kësaj, në Shqipëri, si dhe në vendet e tjera ish-socialiste, *mësuesit konsideroheshin gjerësisht si pjesë e inteligjencies së vendit, çfarë nuk është e vërtetë në Perëndim.*

- Edhe pse mësuesit gëzonin një status shoqëror e profesional më të ulët në radhët e inteligjencës socialiste, *radhitja e tyre në një shtresë shoqërore me mjekët, juristët, inxhinierët, artistët, arkitektët etj., u jepte atyre një status dinjitoz në hierarkinë e strukturës së profesioneve në shoqërinë shqiptare*.

Këta faktorë, të marrë së bashku, kishin një ndikim shumë pozitiv në perceptimin nga ana e mësuesve të punës së tyre dhe, në një masë të konsiderueshme, shërbenin si një antidot kundër stresit dhe dukurisë "burnout" që e shoqëron atë.

† † †

Në ditët tona situata është krejt ndryshe. Shqipëria sot është "another land", një vend krejt tjetër nga çka qenë 30 vite më parë, në kohën kur u krye ai studim "pionier" mbi dukurinë "burnout" dhe mirëqenien psikologjike të mësuesve tanë.

Me përjashtim të *përmirësimit të dukshëm të infrastrukturës së shkollave në qytetet kryesore të vendit* (në zonat rurale ndryshimet në këtë aspekt kanë qenë shumë më të pakta, ndërsa numri i mësuesve ka rënë, kualifikimi profesional i tyre po ashtu dhe motivimi për punë është shumë më i ulët)—pra me përjashtim të përmirësimit të infrastrukturës, *thuajse, të gjithë treguesit që përcaktojnë shkallën e stresit në punë dhe praninë e dukurisë "burnout" në radhët e mësuesve janë përkeqësuar*.

- Sot*pasiguria dhe vështirësitë e jetës së përditshme* të cilat duket se janë shtuar, *i bëjnë më të vështiraarritjet personale të mësuesve* dhe, në një shkallë të konsiderueshme, *i demotivojnë ata për t'u kualifikuar më tej profesionalisht*, përveçse kur ky bëhet një kriter për të mbajtur vendin e punës.

- Te mësuesit e sotëm rrallë gjen sot të njëjtin *entuziazëm për punën* që kryejnë dhe *raportet e tyre mes njëri-tjetrin bëhen gjithnjë emë shumë raporte interesi sesa kolegjialiteti*.

- Energjia për punë që vihej re te mësuesit në të kaluarën sot ka rënë dhe, shpeshherë, gjen një farë *letargjie në punë* dhe një *mungesë interesi për punën*, të shprehura këto në qëndrimin ta "shtyjmë edhe këtë ditë". Kjo, në shumë raste, përçon një *mesazh negativ dhe demotivues edhe te nxënësit*. Këta të fundit, për shkak se, përveç teksteve dhe shpjegimit të mësuesit në klasë, sot marrin informacion nga shumë burime të tjerë, përmes Internetit, janë bërë jo vetëm *më pak të varur* nga—dhe, për këtë arsye, edhe *më pak të vëmendshëm*—ndaj mësuesve të tyre, por edhe *më të vështirë*.

- Një dukuri e tillë, në mjaft raste, krijon te mësuesit *ndjesinë e të qenit joefektivë*, e cila, në vetvete, është një faktor që krijon stres dhe stimulon "burnout".

- Mësuesit sot mund të *lodhen më pak fizikisht, por kjo nuk përkthehet në relaksim emocional*; përkundrazi, *lodhja emocionale* në një profesion i cili për ta

bëhet edhe më i vështirë, *e rrit stresin në punë* dhe i bën shumë prej tyre *të ndihen "burned-out" nga puna që bëjnë—të lodhur gjatë dhe pas punës* dhe *emocionalisht bosh në fund të një dite pune*.

- *E përsëritur në mënyrë të vazhdueshme,kjo gjendje emocionalisht stresuese* për ta mund të ndikojë edhe në marrëdhëniet me kolegët e tyre, te të cilët nuk gjejnë më *të njëjtën mbështetje* dhe *të njëjtin solidaritet profesional* që mësuesit u ofronin më parë njëri-tjetrit.

- Kjo *i demotivon* edhe më tej mësuesit në punën e përditshme që kryejnë, sidomos për t'u kushtuar *më shumë vëmendje nxënësve të dobët e problematikë*.

- Një faktor *sociologjik* që ndikon veçanërisht shumë në punën e arsimtarëve dhe në mirëqenien psikologjike të tyre është *ndryshimi demografik* thuajse rrënjësor *i mjedisit në të cilin ata jetojnë e punojnë*, i cili, për shkak të lirisë për të zgjedhur një vendbanim të ri, *ka humbur sot homogjenitetin e dikurshëm dhe është bërë një mjedis tepër heterogjen*. Fqinji sot nuk është më ai i dikurshmi, me të cilin hynim e dilnim dhe, po kështu, arsimtarët e tjerë të së njëjtës shkollë nuk janë më kolegët e tyre të dikurshëm. Ky faktor priret të ndikojë në dobësimin e *kohezionit social*, të *kolegjialitetit* dhe të *solidaritetit* njerëzor e profesional në punën e arsimtarëve.

† † †

Fatkeqësisht, te ne, në 30 vite, studimet në këtë fushë kanë munguar, thuajse, krejtësisht. Pak vëmendje i është kushtuar kësaj dukurie dhe, thuajse,*asnjë kërkim serioz nga studiues shqiptarë—sociologë, psikologë, ekspertë të çështjeve të edukimit ose të punës sociale, arsimtarë ose pedagogë—nuk është fokusuar në të.* Është koha të mendojmë seriozisht për mirëqenien sociale e psikologjike të mësuesve tanë, të cilët kanë një rol të pazëvendësueshëm në arsimimin dhe në edukimin e gjeneratave të reja të shqiptarëve.

Qoftë edhe vetëm për këtë arsye, kjo konferencë, e cila jo rastësisht mbahet në një qytet arsimdashës, si Gjirokastra—e njohur për traditat e çmuara të saj në zhvillimin e arsimit kombëtar—dhe në një universitet si ky, i cili mban emrin e njërit prej dijetarëve më të shquar të këtij kombi, Eqrem Çabej—si dhe pjesëmarrja e gjerë e arsimtarëve në të janë shumë domethënës dhe marrin një rëndësi të veçantë. Organizatorët e kësaj konference duhen vlerësuar e përgëzuar, siç duhen vlerësuar e përgëzuar edhe kontributet që sjellin në këtë konferencë pjesëmarrësit në të.

Këto fjalë marrin edhe më tepër kuptim në rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia Covid-19, të cilat e bëjnë më të vështirë jo vetëm mbajtjen e një konference si kjo dhe të çdo veprimtarie tjetër, siç jemi mësuar deri më sot, por *e bëjnë më të vështirë edhe profesionin e mësuesit, siç edhe e rëndojnë më tej ngarkesën e tij profesionale dhe emocionale*, duke krijuar terren për më shumë "burnout" në veprimtarinë profesionale dhe në jetën e përditshme të arsimtarëve tanë.

Referencat

Blase, J.J. 1982. “A Social-Psychological Grounded Theory of Teacher Stress and Burnout”. *Educational Administration Quarterly* 18(4): 93-113.

Blase, J.J. 1986. “A Qualitative Analysis of Sources of Teacher Stress: Consequences for Performance”. *American Educational Research Journal* 23(1):13-40.

Carroll, J.F., & W.L. White. 1982. “Theory Building”, ff. 41-60 në W.S. Paine (ed.), *Job Stress and Burnout*. Beverly Hills, CA: Sage.

Cherniss, C. 1995. *Beyond Burnout: Helping Teachers, Nurses, Therapists, and Lawyers Recover from Stress and Disillusionment*. New York: Routledge.

Cunningham, W.G. 1983, “Teacher Burnout - Solutions for the 1980s: A Review of the Literature”. *Urban Review* 15: 37-51.

Dworkin, A.G. 1987. *Teacher Burnout in the Public Schools: Structural Causes and Consequences for Children*. Albany, NY: State University of New York Press.

Farber, B.A. 1984a. “Teacher Burnout: Assumptions, Myths, and Issues”. *Teachers College Record* 86:321-338.

Farber, B.A. 1984b. “Stress and Burnout in Suburban Teachers”. *Educational Research* 77(6): 321-325.

Freudenberger. H.J. 1974. “Staff Burnout”. *Journal of Social Issues* 30(1): 159-165.

Freudenberger. H.J. 1975. “The Staff Burnout Syndrome in Alternative Institutions”. *Psychotherapy: Theory, Research and Practice* 12(1): 73-83.

Hellerstedt, H. 1989. *Hur mar magister*. Stockholm.

Hendrickson, B. 1979. “Teacher Burnout: How to Recognize it, What to do About it”. *Learning* (January), 7: 37-39.

Jones, M.A. & J. Emanuel. 1981. “Strategies and Recovery Steps of Teacher Burnout”. *Education Digest* 46: 9-11.

Kahn, R. 1978. “Job Burnout: Prevention and Remedies”. *Public Welfare* 36(2).

Kirk, W., & G. Walter. 1981. “Teacher Support Groups Serve to Minimize Teacher Burnout: Principles for Organizing”. *Education* 102(2): 147-150.

Kloep, M., & F. Tarifa. 1994. “Working Conditions, Work Style, and Job Satisfaction Among Albanian Teachers”. *International Review of Education* 40(2): 159-172.

Landsmann, L. 1979. “Teacher Burnout”. *Instructor* 88: 56-62.

Marrow, T. 1981. “The Burnout of Almost Everybody”. *Time* (September 21), 118: 84.

Maslach. C. 1976. “Burned-out”. *Human Behavior* (September), 5: 16-18.

Maslach. C. 1978a. “Client Role in Staff Burn-out”. *Journal of Social Issues* 34(4): 111-124.

Maslach. C. 1978b. “Job Burnout: How People Cope”. *Public Welfare* 36: 56-58.

Maslach. C. 1982. “Understanding Burnout: Definitional Issues in Analyzing a Complex Phenomenon”, ff. 29-40 në W. S. Paine (ed.), *Job Stress and Burnout: Research, Theory, and Intervention Perspectives*. Beverly Hills, CA: Sage.

Maslach, C., & S.E. Jackson, 1979. “Burned-out Cops and Their Families”. *Psychology Today* (May), 12: 58-62.

Pierce, C.M.B. & G.N. Molloy. 1990. “Psychological and Biographical Differences Between Secondary School Teachers Experiencing High and Low Levels of Burnout”. *British Journal of Educational Psychology* 60: 37-51.

Tarifa, F. & L. Sokoli, “Exploring Burnout and Its Correlates among Albanian Teachers”, *Michigan Sociological Review* 12: 95-116.

Vjetari Statistikor i R.P.S. të Shqipërisë (Statistical Yearbook of the P.S.R. of Albania). 1991. Komisioni i Planit të shtetit.

Weiskopf, P.E. 1980. “Burnout Among Teachers of Exceptional Children”. *Exceptional Children* 47(1): 18-23.

Whitaker, K.S. 1996. “Explaining Cases of Principal Burnout”. *Journal of Educational Administration* 34(1): 60-71.

PSIKOLOGU SHKOLLORË DHE LIDHJA E TIJ ME MËSUESIN E ARSIMIT FILLOR

Arlinda Ymeri[1], Eranda Halluni Bilali[2]
[1-2]University Of Shkodra " Luigj Gurakuqi", Albania
[1]arlindahallunovi@Live.com, [2]lerandabilali@yahoo.com

Abstrakt

Psikologjia shkollore është zbatimi i parimeve dhe teknikave psikologjike në edukimin e fëmijëve. Duke u mbështetur në bazën e njohurive të veta dhe atë të fushave përkatëse, përfshirë psikologjinë klinike dhe arsimore, psikologjia shkollore përqendrohet në studimin individual të të mësuarit dhe përshtatjes së fëmijëve kryesisht në mjediset arsimore. Psikologët e shkollës bëjnë partneritet me familjet, mësuesit, administratorët e shkollës dhe profesionistë të tjerë për të krijuar ambiente të sigurta, të shëndetshme dhe mbështetëse të të mësuarit që forcojnë lidhjet midis shtëpisë, shkollës dhe komunitetit. Si rezultat i punës së vazhdueshme të trajnimeve të edukimit në vazhdim të Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë për konsolidimin e këtij profesioni, diskutime dhe tavolina pune apo debati është pasqyruar dinamika e problematikave të punës së psikologut shkollor në raport me mësuesit e shkollave ku ato punojnë. Janë manifestuar vështirësitë e psikologëve për t'u pranuar nga mësuesit dhe për të formuar një marrëdhënie dhe klimë pune mes tyre. Duke u nisur ngadëshira që puna e psikologut në shkolla të jetë sa më e qetë dhe produktive kam ndërmarrë këtëstudim.

***Fjalët kyçe**: Psikolog shkollor, plan pune, aftësi problemzgjidhëse, plan ndërhyrjeje.*

Abstract

School psychology is the application of psychological principles and techniques in the education of children. Based on its oën knoëledge base and that of relevant fields, including clinical and educational psychology, school psychology focuses on the individual study of children's learning and adaptation mainly to educational environments. School psychologists partner with families, teachers, school administrators and other professionals to create safe, healthy and supportive learning environments that strengthen the bonds between home, school and community. As a result of the continuous work of the ongoing education training of the Order of Psychologist of Albania for the consolidation of this profession, discussions and work tables or dabates have reflected the dynamic of the work problems of the school psychologist in relation to the teachers of the school where they work. The difficulties of psychologists to be accepted by teachers and to form a relationship and working climate between them have been manifested.

Starting from the desire that the work of psychologist in schools to be as calm and productive as possible, I have undertaken this study.

Key words: *School psychologist, work plan, problem-solving skills, intervention plan.*

1. Hyrje

Çfarë është psikologu shkollor?

Psikologët shkollorë janë anëtarë të kualifikuar në mënyrë unike të ekipeve shkollore që mbështetin aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe aftësinë e mësuesve për të dhënë mësim. Ata ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të kenë sukses akademik dhe shoqëror. Si mund të kontaktoj një psikolog shkollor? Çdo shkollë ka qasje në shërbimet e një psikologu shkollor, megjithëse disa psikologë shkollorë shërbejnë në dy ose më shumë shkolla, kështu që mund të mos jenë në një shkollë të veçantë çdo ditë. Më shpesh, psikologët e shkollës mund të arrihen duke pyetur drejtpërdrejt në shkollë, zyrën qendrore të rrethit ose duke gjetur informacionin e kontaktit në faqen e internetit të shkollës ose rrethit.

Psikologjia shkollore filloi në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Origjina e saj është e lidhur ngushtë me ato të arsimit special, psikologjisë klinike dhe arsimore, ngritjes së shkencës psikologjike, zhvillimit të testeve psikoedukative dhe zbatimit të programeve të edukimit special në përgjigje të nevojave të fëmijëve atipikë që kërkohet të ndjekin shkollën nën detyrimin ligjor.

2. Metodologjia

Puna me ato ka konsistuar në takime 90 minutëshe dy herë në muaj në zyrën time nga periudha mars 2019-2020 dhe nga periudha mars 2020-2021 online, por për në një takim më të shkurtër prej 60 minutave. Fokusi i këtyre takimeve ishin problematikat që ato kanë hasur në punën e tyre përgjatë ditëve të punës dhe strategjinë e zgjidhjes së tyre e planin e masave të marra në shërbim të situatës.

Periudha e dytë mars 2020-2021ka sjellë një ridimensionim të këtyre marrëdhënieve psikolog shkollor- mësues i arsimit fillor. Të dhënat janë hedhur në një tabelë nga ku janë specifikuar skedarë të veçantë për problematikat e hasura më shpesh e me karakter të përafërt. Në përfundim të periudhës së vlerësimi është bërë një analizë cilësorë e të dhënave të cilat janë ndarë në tematika që janë përmendur më shpesh dhe plani i implementuar për zgjidhje, rezultatet apo edhe pamundësia e arritjes së një zgjidhjeje duke na shtruar detyrat për të hartuar një plan masash paraprake prevenuese.

Tërësia e të dhënave cilësore është analizuar nga ana ime në këtë studim duke i sintetizuar rastet në një kontekst më global në realitetin shqiptar. Kështu kam arritur të evidentoj disa përparësi dhe mangësi të marrëdhënieve

psikolog shkollor dhe mësues i arsimit fillor në qytetin e Shkodrës dhe rrethina. Për të arritur kështu në konkluzione në të mirë të të dy palëve psikolog shkollor-mësues i arsimit fillor.

Këto rekomandime i shkojnë në tërësi qëllimit për një mirëqenie psikologjike të mësuesit të arsimit fillor.

Kufizimet e punimit;

- Përfshirja e një numri të kufizuar të psikologëve shkollorë
- Kufizimi vetëm në qytetin e Shkodrës
- Mësuesit nuk kanë qenë pjesë e studimit
- Prindërit nuk ishin pjesë e studimit. Nuk janë marrë parasysh përjetimet e tyre në marrëdhënie me mësuesit që janë intensifikuar më së shumti gjatë implementimit të mësimit online.
- Neglizhimi i faktorëve alternativë që rritin shqetësimin e mësuesve, siç janë, p.sh., mësimi online, vështirësitë e përdorimit të platformave të mësimdhënies, vështirësitë teknologjike, klima e klasës online dhe mundësia e menaxhimit të saj në kushte të tjetërsuara etj.

Kampionimi:Duke treguar qëllimet e studimit tim grupit të psikologëve që janë pjesë e Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Shkodrës, ato janë bërë kampioni i këtij studimi. Kësaj ftese i janë përgjigjur 15 psikologë shkollorë që e ushtrojnë profesionin e tyre në qytetin e Shkodrës dhe rrethina duke mbuluar secili prej tyre minimalisht dy shkolla. Përzgjedhja ishte rastësore dhe kushti i vetëm ishte të ushtronin profesionin e psikologut shkollor.

Pyetjet kërkimore:

- A ka bashkëpunim ndërmjet psikologu shkollor dhe mësuesve të arsimit fillor?
- Nëse po, a ndikon puna e psikologut shkollor në mirëqenien psikologjike të mësuesit të arsimit fillor?
- A ndikon puna e tij në zgjidhjen e më shumë situatave në klasë?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve është mbajtur në konsideratë puna që psikologët shkollorë kanë bërë dhe marrëdhënien e krijuar me mësuesit e arsimit fillor.

3. Analiza e të dhënave

Psikologu i shkollës fillore duhet të përdorë katër mënyra të ndryshme (fillimi, sigurimi, receta dhe bashkëpunimi) gjatë kohëzgjatjes së saj, konsultimi me mësuesin, secila prej të cilave është dëshmi e një sërë kompetencash konsultimi që posedon psikologu i shkollës. Kur punohet së bashku, si këshilltari (konsulent) dhe mësuesi (i konsultuari) përcaktohen edhe qëllimet që tregon advokimi i tyre për nxënësin. Ata padyshim të angazhuar në një marrëdhënie bashkëpunimi me secilin dhe me të tjerët gjithashtu në mënyrë që të zbatohen programi i përgjegjshëm dhe i prekshëm i shkollës për mësuesit dhe nxënësit.

4. Përfundimet:

Rolet dhe funksionet kryesore të psikologëve praktikues të shkollës përfshijnë vlerësimin psikoedukativ, konsultimin, ndërhyrjet, hulumtimin dhe vlerësimin, edukimin në shërbim dhe administrimin.

Vlerësimi psikoedukativ. Psikologët shkollorë kalojnë të paktën 50% të kohës së tyre në administrimin e testeve psikologjike dhe edukative, kryerjen e vëzhgimeve, intervistave dhe mbledhjen e informacionit të duhur në vlerësimin e nxënësve që përjetojnë probleme të të mësuarit dhe rregullimit. Vlerësimi shpesh përfshin teste të aftësisë njohëse, arritjeve në shkollë, aftësive psikomotorike, sjelljes adaptive, aftësive sociale dhe përshtatjes personale-sociale. Vlerësime të tilla përfshijnë, gjithashtu, intervista me prindër dhe mësues, vëzhgime në shkollë dhe inspektim të të dhënave shkollore. Secili rast studimor përmblidhet në një raport me shkrim.

Ndërhyrjet. Praktikuesit kalojnë rreth 20 % të kohës së tyre në ndërhyrje direkte, përfshirë rehabilitimin dhe terapinë, që përfshin fëmijët e referuar. Të kryera individualisht ose në grupe, këto shërbime kanë për qëllim të lehtësojnë problemet akademike dhe të sjelljes.

Hulumtimi dhe vlerësimi. Rreth 3% e kohës së praktikuesit i kushtohet kërkimit dhe vlerësimit. Megjithëse ky është një rol i rëndësishëm për psikologët shkollorë, përparësitë e tjera përjashtojnë shumë përfshirje në hartimin e projekteve kërkimore dhe vlerësuese që mund të vlerësojnë më mirë efikasitetin e metodave të referimit, teknikat e vlerësimit, rezultatet terapeutike dhe vlerësimin e programeve.

Cilësimet e punësimit

Shumica e psikologëve shkollorë janë të punësuar në shkolla, kolegje dhe universitete ose praktikë private.Sondazhet kanë treguar vazhdimisht se të paktën 80 % psikologëve shkollorë janë të punësuar në mjediset e shkollës publike. Ndoshta një shtesë prej 5% shkollat private, qendrat e trajtimit rezidencial dhe shkollat me konvikt.

Disa psikologë shkollorë mund të caktohen në një shkollë specifike. Klienti kryesor i një psikologu shkollor është nxënësi. Sidoqoftë, për të ndihmuar në mënyrë efektive nxënësit psikologu i shkollës, gjithashtu, mund të punojë dorë për dore me mësuesit, administratorët e shkollës, prindërit dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

5. Rekomandimet për vijimësinë e punës së psikologut shkollor duhet të përfshijnë :

1)Realizimin e vlerësime psikologjike.

Psikologët shkollorë vlerësojnë nxënësit bazuar në referimet nga mësuesit dhe administratorët e shkollës. Kjo mund të bëhet për nxënësit që jetojnë në një zonë të caktuar si dhe për ata që janë të talentuar. Ata marrin një histori të plotë të historisë arsimore, sociale dhe mjekësore të një nxënësi, përveç testimit të tyre në fusha të shumta të funksionimit. Për të përmirësuar vlerësimet e tyre, psikologët e shkollës mund të intervistojnë nxënës dhe t'i

vëzhgojnë ata në mjedisin normal të shkollës. Psikologu i shkollës i mbledh këto të dhëna në një raport që përfshihet në të dhënat zyrtare të shkollës së nxënësit.

2) Të nxisin sjellje proshoqërore për nxënësit brenda mjedisit shkollor.

Psikologët e shkollës kanë njohuri të veçanta në lidhje me sjelljet adaptive që parashikojnë suksesin e nxënësve. Prandaj ata mësojnë dhe zbatojnë sjelljet prosociale që i ndihmojnë ata të bëjnë më të mirën. Ata mund ta bëjnë këtë duke përdorur përforcime pozitive, vendosje qëllimesh, modelim dhe sjellje të përshtatshme për të luajtur role.

3) Të këshillojë nxënësit individualisht ose në grupe.

Ata mund të takohen me nxënës një për një ose në grupe për të diskutuar çështje specifike akademike, sociale ose emocionale. Seancat e këshillimit zakonisht kërkojnë që psikologu të shkruajë një shënim në lidhje me përmbajtjen e sesionit dhe të zhvillojë ndërhyrje që adresojnë nevojat e nxënësve (të tilla si për ankthin ose problemet e vëmendjes).

4) Të zhvillojë ndërhyrje të reja për personelin mësimdhënës.

Psikologu i shkollës siguron që shkolla po ndjek protokollet e duhura në praktikat e saj të mësimdhënies, veprimet disiplinore dhe procedurat e tjera. Ata mund të monitorojnë efektivitetin e mësuesit, të ofrojnë komente dhe të ndjekin ndryshimet në performancën e nxënësit me kalimin e kohës.

5) Takimi me prindërit.

Për të siguruar informim të rregullt mbi përparimin e nxënësve, psikologët e shkollës duhet të takohen me prindërit përmes vizitave ballë për ballë ose konferencave telefonike. Ata gjithashtu mund t'u drejtohen prindërve për të diskutuar çështje që ndodhin në shtëpi (p.sh., divorci nga prindërit) që ndikojnë në sjelljen ose funksionimin emocional të nxënësve.

6) Trajnimet për prindërit dhe mësuesit. Në varësi të nevojave të shkollës, një psikolog shkollor mund të organizojë trajnime për të ndihmuar prindërit dhe mësuesit të trajtojnë çështje të zakonshme që prekin nxënësit.

7) Të veprojë si ndërlidhës me komunitetin.

Psikologu i shkollës shpesh është pika e referimit për anëtarët e tjerë të ekipit multidisiplinar - profesionistë që mund të punojnë në shkollë ose në komunitet. Psikologu i shkollës mund të kontaktojë pediatër, terapistë dhe punonjës socialë për t'i mbajtur ata të informuar mbi përparimin e nxënësit ose për të marrë informacion shtesë për vlerësime.

8)Të lehtësojë seancat e ndërmjetësimit nga kolegët.

Nëse dy ose më shumë nxënës prishin orën e mësimit ose përfshihen në konflikt, psikologu i shkollës punon me ta për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Ato i ndihmojnë nxënësit të mësojnë mënyra efektive për të trajtuar konfliktet dhe për të menaxhuar stresuesit në mjediset e shkollës.

9) Të ofrojë shërbime këshillimi në raste të veçanta

Në përgjigje të krizave ose tragjedive që prekin komunitetin shkollor, psikologu shkollor këshillon nxënësit dhe stafin sipas nevojës.

Studiuesi u kujdes që të ndante gjetjet e këtij studimi me mësuesit (i konsultuari). Një ndër qëllimet kryesore të këtij studimi fokusohet edhe te vetë mësuesit e arsimit fillor me qëllim që ata mund të evidentonin shqetësimet e tyre kryesore. Ndaj edhe gjetjet paraprake të punimit nënvizojnë nevojën për t'u bërë i dëgjueshëm, për të bashkëvepruar në mënyrë konstruktive, për të krijuar një klimë pozitive në klasë dhe për të përmirësuar gjendjen e tij psikoemocionale. Në referencë të sa më sipër vjen dhe rekomandimi me disa sugjerime për studime të mëtejshme të detajuara për të ndihmuar mësuesin e arsimit fillor të arrijë qëllimet në orën e mësimit (mënyra e recetës), si një ndihmesë konkrete për prezantimin e strategjive të zbatimit (mënyra e bashkëpunimit) të përbërë nga komponentë që ai do udhëzohet se si t'i implementojnë në punën e tij të përditshme.

Referenca:

Murati, Prof. Dr. Xheladin, 2002, Didaktika.

Murati, Prof. Dr. Xheladin, Shkup, 1998, Pedagogjia e përgjithshme,

http:.syri3.com/pdf_fajllat/ Mujo Haskoviq Psikologji, pdf

Đorđević, Dr. Jovan - Potkonjak, Dr. Nikola, Beograd, 1990, Pedagogjia.

Terry F. Pettijohn. Psikologjia, Një hyrje koncize. Botimi 2, 1996, Tiranë.

psikologe. https://www.scribd.com/doc/257247565/ Këshillimi, Psikologjik dhe shkolla.

http://detyrakursitmeporosi.blogspot.com/2014/02/studim-rasti-keshillim-i-nxenesit.htmlhttps://d4d-ks.org/editorial/sa-te-ndihmonte-procesin-mesimor-prezenca-e-psikologut-ne shkolla

Gëzim Dibra, Miriam Taipi, Eranda Halluni cikël leksionesh, Mësuesi dhe mësimdhënia.

HULUMTIM MBI PËRDORIMIN E STRATEGJIVE MËSIMORE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË MËSIMDHËNIE.

Rast studimor: krahasimi i faktorëve strategjikë në mësimdhënie midis lektorëve të rinj dhe lektorëve me përvojë të gjatë në mësimdhënie

Romeo Mano[1], Mimoza Çarka[2]

[1] Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, Universiteti "Eqrem Çabej"

rmano@uogj.edu.al

[2] Departamenti i Mësimdhënies, Universiteti "Eqrem Çabej"

mcarka@uogj.edu.al

Abstrakt

Ky hulumtim është bërë në kuadër të projektit TeComp: "Forcimi i Kompetencave Mësimore në Arsimin e Lartë në Shkencat Natyrore dhe Matematikore", i bashkëfinancuar nga Programi Erasmus plus dhe Bashkimi Evropian. Qëllimi kryesor është të përmirësohet cilësia e arsimit të lartë në fushën e shkencave natyrore dhe matematikore në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, në përputhje me praktikat e përparuara të BE-së, duke rritur krahasueshmërinë dhe konkurrencën e tyre në Evropë dhe më gjerë. Synimi kryesor do të arrihet duke plotësuar një numër objektivash specifike në fushat e studimit universitar që projekti mbulon:

Studimi i prezantuar në këtë punim mbështetet në identifikimin e nivelit të aplikimit të shtatë faktorëve strategjikë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me anë të metodave të statistikës deskriptive krahasuese: strategjitë mësimore që përfshijnë studentët; angazhimi intelektual dhe ndikimi në të nxënë; marrëdhënia lektor-student; bashkëpunimi midis studentëve në procesin e mësimnxënies; mësimdhënia me në qendër studentin; entuziazmi dhe mënyra e mësimdhënies; struktura e mësimdhënies.

Fjalë kyçe: *strategjitë mësimore, teknologji e informacionit, angazhim intelektual, entuziazmi në mësimdhënie, struktura emësimdhënies*

Abstract

This research was conducted in the framework of the TeComp project: "Strengthening Teaching Competencies in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences", co-funded by the Erasmus plus Program and the European Union. The main goal is to improve the quality of higher education in the field of natural sciences and mathematics in higher education institutions in Albania, in line with advanced EU practices, increasing their comparability and competitiveness in Europe and beyond.

The study presented in this paper relies on identifying the level of application of the seven strategic factors of teaching and learning, through comparative descriptive statistics methods: learning strategies involving students; intellectual engagement and impact on learning; lecturer-student relationship; cooperation between students in the learning process; student-centered teaching; enthusiasm and way of teaching; teaching structure.

Keywords: *learning strategies, information technology, intellectual engagement, enthusiasm in teaching, teaching structure*

1. Hyrje

Leksionet dhe demonstrimet tradicionale mund të bëhen përvoja të të mësuarit multimedial të bazuar në internet për nxënësit në distancë. Rrjeti mund të pasurojë burimet e të nxënit dhe institucionet të përqendrohen nga mësimdhënia në të mësuar, nga mësuesi te nxënësi. Mund të krijojë një mjedis mësimi në të gjithë botën nga komunitetet e të nxënit në rrjet. Rrjetet mund të krijojnë mjedise edukative të ngulitura në filozofinë demokratike të udhëzimit dhe duke i ndihmuar nxënësit të mësojnë. Karakteristikat e të cilave janë: (i)Respekt "respekt për personalitetin"; (ii)pjesëmarrja në vendimmarrje; (iii) liria e shprehjes dhe disponueshmëria e informacionit; dhe

(iv) përgjegjësia reciproke në përcaktimin e qëllimeve, planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e [procesit] "(Knowles 1980, p.85).

Për këtë arsye, qëllimi i këtij studimi është identifikimi i nivelit të aplikimit të shtatë faktorëve strategjikë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me anë të metodave të statistikës deskriptive krahasuese: strategjitë mësimore që përfshijnë studentët; angazhimi intelektual dhe ndikimi në të nxënë; marrëdhënia lektor-student; bashkëpunimi midis studentëve në procesin e mësimnxënies; mësimdhënia me në qendër studentin; entuziazmi dhe mënyra e mësimdhënies; struktura e mësimdhënies.

Për shkak të situatës që po kalojnë universitetet shqiptare dhe në përgjithësi sistemi universitar evropian dhe botëror, si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, mësimi online është bërë një nga metodat normale të zhvillimit të procesit mësimor. Kjo kërkon rritje të njohurive dhe aftësive të përdorimit të platformave elektronike dhe mundësive që ato ofrojnë.

Studentët janë në gjendje të punojnë në mjedise bashkëpunuese dhe interaktive të të mësuarit duke komunikuar në mënyrë efektive, duke shkëmbyer informacion dhe duke shkëmbyer ide dhe përvoja të të mësuarit me të gjithë në mjedis (Hussain&Safdar, p.46)

Studimi i ka paraprirë identifikimit të nivelit të njohurive dhe aftësive të stafeve akademike në përdorimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, si dhe nevojave për përmirësimin e tyre në funksion të rritjes së cilësisë së implementimit të shtatë faktorëve strategjikë të sipërpërmendur.

2. Studimi empirik i të dhënave

Sondazhi u plotësua nga 96 pedagogë të Universitetit "Eqrem Çabej" të Gjirokastrës dhe Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, 55.21% prej të cilëve ishin femra dhe 44.79% meshkuj. Kampioni përbëhej nga pedagogë të gjashtë fushave të ndryshme të mësimdhënies me një përfshirje si më poshtë: matematikë (27.08%), gjeografi (7.29%), shkenca kompjuterike (30.21%), fizikë (14.58%), kimi (5.21%), biologji (11.46%), ndërsa 4.17% nuk kanë deklaruar fushën e mësimdhënies. Sondazhi u realizua me anë të pyetësorëve, gjatë periudhës Prill -Maj 2019.

Për sa i përket përvojës mësimdhënëse në universitet, numri mesatar i viteve të përvojës në mësimdhënie është 11.21 vjet (me devijim standard: 7.68 vjet). Përvoja më e shkurtër e mësimdhënies në kampion është 1 vit, ndërsa përvoja më e gjatë e mësimdhënies është 37 vjet. Në studimin tonë, jemi mbështetur në krahasimin e rezultateve midis lektorëve të rinj dhe atyre me përvojë, duke konsideruar lektorë të rinj ata të cilët kanë një përvojë në mësimdhënie jo më të gjatë se 12 vjet, ndërsa lektorë me përvojë janë konsideruar ata të cilët kanë më shumë se 12 vjet në sistemin universitar të mësimdhënies. Për të ndërtuar bazën e të dhënave është përdorur shkalla e perceptimit sipas Likhert-it, nga 1-vlerësimi minimal, në 5-vlerësimi maksimal.

Fig.1 Vetëvlerësimi i njohurive dhe aftësive në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie

(III-1)	Niveli i njohurive dhe aftësive tuaja në zbatimin e paketave të Microsoft Office:	**SELF ASSESSMENTS OF ICT COMPETENCES**
(III-2)	Niveli i njohurive dhe aftësive tuaja në zbatimin e Open Source software:	
(III-3)	Niveli i aftësive tuaja në zbatimin e Web conferencing software:	
(III-4)	Niveli i njohurive dhe aftësive tuaja në zbatimin e Learning Management System (LMS):	
(III-5)	Niveli i njohurive dhe aftësive tuaja në zbatimin e online learning platform:	
(III-6)	Përdorni Ju materiale elektronike si materiale mësimore?	
(III-7)	Përdorni Ju libra elektronike si materiale mësimore?	
(III-8)	Përdorni animacione / filma si material mësimor?	
(III-9)	Përdorni forume dhe forma të tjera të komunikimit në internet në mësimdhënie dhe mësimnxënie?	
(III-10)	Përdorni kurse online si një material mësimor?	

(III-11)	Përdorni konferencat në internet si një material mësimor?	
(III-12)	Përdorni bazat të dhënash në mësimdhënie dhe mësimnxënie?	
(III-13)	Jeni të hapur për të komunikuar me studentët përmes rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, etj.)?	

Siç mund të shihet, vlerësimet e lektorëve të rinj dhe atyre me përvojë janë, pothuajse, në të njëjtat nivele. Të anketuarit vlerësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me paketën e Microsoft Office me rezultat shumë të lartë (4.44) si dhe përdorimin e materialeve elektronike (prezantime) si materiale mësimore (rezultati mesatar për III-6 është 3.90). Përdorimi i librave elektronikë / librave shkollorë si mësimdhënie materialeve (rezultati mesatar për III-7 është 3.85). Shumë rrallë lektorët përdorin konferencat në internet si një material mësimor (2.05) dhe po kaq përdorin kurse online si një material mësimor (mesatarisht 2.16). Vetëvlerësimi për një pjesë të konsiderueshme të pyetjeve është më pak se 3 ose shumë pak mbi 3, gjë që tregon se përmirësimi i njohurive dhe aftësive të TIK-ut në procesin e të mësuarit është më se i nevojshëm.

Fig.2 Përdorimi i strategjive mësimdhënëse që përfshijnë studentët

(P1)	Ju siguroni reagime për studentët në lidhje me zgjidhjet e testit, detyrat dhe punën e vazhdueshme.	**Teaching strategies involving students**
(P2)	Ju u ofroni studentëve një informacion të qartë se si të vlerësojnë kursin që ndjekin.	
(P3)	Ju u jepni studentëve udhëzime të qarta se si të përgatiten për orën tjetër.	
(P4)	Ju u jepni studentëve detyra shtëpie, detyra afatshkurtra, një detyrim për të lexuar diçka ose ndonjë formë tjetër të përgatitjes për kohën që vjen.	

Lidhur me strategjitë e mësimdhënies që përfshijnë studentët, perceptimi mesatar i lektorëve është midis vlerave që përfaqësojnë "Përgjithësisht të vërtetë" dhe "Plotësisht të vërtetë". Ata janë pothuajse plotësisht të sigurt për qartësinë e informacionit të përcjellë tek studentët (4.57) dhe përgjithësisht të sigurt për të siguruar reagime të shpejta dhe të hollësishme për testet, detyrat ose punët në vazhdim të studentëve (4.12).

Një krahasim i mesatares për faktorët s1-s4 tregon se për tre faktorët e parë, lektorët e rinj janë më optimistë sesa lektorët me përvojë, pavarësisht nga fakti se kjo diferencë nuk tejkalon njësinë e shkallës së perceptimit, ndërsa

lektorët me përvojë janë më optimistë se lektorët e rinj në lidhje me faktorin s4.

Fig.3 Angazhimi intelektual dhe ndikimi në të mësuar

(a1)	Ju i motivoni dhe inkurajoni studentët të zhvillojnë ide të reja dhe të gjejnë zgjidhje krijuese për problemet gjatë të mësuarit.	**Intellectual engagement and impact on learning**
(a2)	Ju i motivoni studentët të kërkojnë më shumë zgjidhje për të njëjtin problem dhe t'i krahasoni ato.	
(a3)	Zakonisht, ju filloni një diskutim me klasat, rreth zgjidhjes së problemeve komplekse.	
(a4)	Ju kërkoni që studentët të shpjegojnë idetë e tyre.	

Lidhur me angazhimin intelektual dhe ndikimin në të mësuar, perceptimi mesatar i lektorëve është midis vlerave që përfaqësojnë "Përgjithësisht të vërtetë" dhe "Plotësisht të vërtetë". Ata janë pothuajse plotësisht të sigurt për të motivuar dhe inkurajuar studentët të zhvillojnë ide të reja dhe të gjejnë zgjidhje kreative për problemet gjatë të nxënit (4.49) dhe përgjithësisht të sigurt në faktin se ata diskutojnë në auditor për zgjidhjen e problemeve komplekse (4.14).

Një krahasim i mesatareve për faktorët a1-a4 tregon se për tre faktorët e fundit, lektorët e rinj janë më optimistë sesa lektorët me përvojë, pavarësisht nga fakti se këto ndryshime nuk e kalojnë njësinë e shkallës së perceptimit, ndërsa për faktorin a1, të dy grupet kanë një perceptim i njëjtë mesatar.

Fig.4 Faktorët që përcaktojnë marrëdhëniet lektor-student

(P1)	Studentët me ju komunikojnë hapur dhe lirshëm.	**Relationship: teacher-student**
(P2)	Jeni të hapur ndaj formave të ndryshme të komunikimit elektronik përmes rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, etj.).	
(P3)	Marrëdhënia juaj me studentët është marrëdhënie respekti.	
(P4)	Ju komunikoni me studentët me buzëqeshje dhe ton të ngrohtë dhe miqësor.	

Sa i përket faktorëve që përcaktojnë marrëdhëniet mësues-student, vihet re se vetëm faktori o2 është nën nivelin e perceptimit "Përgjithësisht të vërtetë" (3.64). Kjo do të thotë që marrëdhëniet lektor-student nuk ndihmohen nga format e ndryshme të komunikimit elektronik, por ata janë pothuajse të sigurt (4.69) se ata i trajtojnë studentët e tyre me respekt.

Një krahasim i vlerave mesatare për faktorët o1-o4 tregon se perceptimet e lektorëve të rinj dhe atyre me përvojë, janë të njëjta.

Fig.5 Faktorët që përcaktojnë bashkëpunimin lektor-student

b1	Ju u jepni studentëve detyra në grupe që ata duhet të përfundojnë në klasë ose në shtëpi.	**Cooperation**
b2	Ju i motivoni studentët të ndajnë njohuritë e tyre dhe të ndihmojnë studentët e tjerë gjatë orëve të mësimit ose gjatë përgatitjes së provimit.	
b3	Përdorni softuer bashkëpunues në komunikimin me studentët (Google Docs, Wikis, etj.).	
b4	Ju prisni që studentët të përfshihen në diskutim dhe të shprehin mendimin e tyre.	

Rezultatet nga përgjigjet e lektorëve vunë në dukje se me përjashtim të faktorit b3, tre faktorët e tjerë janë pothuajse në nivelet maksimale të perceptimit të tyre (afërsisht 4.4). Faktori b3, i cili korrespondon me kërkesën për përdorimin e platformave elektronike në komunikimin me studentët, është afër nivelit mesatar të perceptimit të lektorëve (3.31). Kjo tregon që lektorët zakonisht nuk përdorin platforma online për të komunikuar me studentët e tyre.

Sa i përket krahasimit të mesatareve të përgjigjeve të lektorëve, lektorët e rinj kanë një nivel më të lartë të perceptimit të faktorëve b2, b3 dhe b4, pavarësisht se ndryshimet nuk janë shumë të ndjeshme, përveç faktorit b1 për të cilin niveli i perceptimit për të dy grupet është i njëjtë.

Fig.6 Faktorët që përcaktojnë mësimdhënien me në qendër studentin

(c1)	Ju jeni gati të bëni disa ndryshime në përmbajtjen e kursit tuaj, për t'ia përshtatur nevojave të studentëve.	**Student-centered teaching and learning**
(c2)	Ju respektoni përparësitë dhe dëshirat e studentëve duke u dhënë atyre detyra individuale.	
(c3)	Lidhni përmbajtjen e kurseve tuaja me njohuritë dhe përvojën e mëparshme të studentëve.	
(c4)	Juve ju interesojnë mendimet e studentëve.	

Lektorët vlerësojnë se ata janë të orientuar drejt mësimdhënies dhe të nxënit me në qendër studentin. Ata janë shumë të interesuar për mendimin e studentëve dhe kujdesen për dëshirat dhe përparësitë e studentëve për të përmirësuar procesin e mësimdhënies (mesatarja për të gjitha pretendimet është më e madhe se 4). Vlerësimet e studentëve për vërtetësinë e këtyre

pohimeve janë në nivelin më të ulët dhe do të ishte e dobishme të gjendeshin arsye më të thella për këtë mosmarrëveshje.

Një krahasim i mesatareve të faktorëve që përcaktojnë nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies me në qendër studentin midis lektorëve të rinj dhe atyre me përvojë tregon se në tre faktorët c1, c2 dhe c4, lektorët e rinj janë më optimistë sesa ata me përvojë, pavarësisht se ndryshimi midis tyre është me vlerë të vogël. Sa i përket faktorit c3, "Lidhni përmbajtjen e kurseve tuaja me njohuritë dhe përvojën e mëparshme të studentëve" lektorët me përvojë tregojnë për një vlerë mesatare më të lartë sesa mendimi i lektorëve të rinj.

Vlerësimet mesatare të faktorëve që përcaktojnë nivelin e entuziazmit (Tab.7) dhe stilit të mësimdhënies që lektorët kanë bërë, janë të orientuara drejt maksimizimit të perceptimeve të tyre për motivimin e studentëve për të kërkuar burime të reja mësimore përtej materialeve të kërkuara, si dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë e tyre (4.44). Vlera mesatare më e ulët arrihet nga faktori d2 (3.68), që tregon se përdorimi i librave elektronikë, prezantime elektronike, filma, etj., ka një tendencë drejt vlerave mesatare të nivelit të perceptimit të tyre.

Fig.7 Faktorët që përcaktojnë entuziazmin dhe stilin e mësimdhënies

(d1)	Ju ndryshoni metodat e mësimdhënies për të ruajtur interesin e studentëve.	**Enthusiasm and way of teaching**
(d2)	Ju përdorni libra elektronikë, prezantime, videoklipe, filma, etj. në leksionet tuaja.	
(d3)	Ju përdorni punën në çifte, punën në grupe, detyra dhe teknika të tjera për të përmirësuar ndërveprimin gjatë orëve të mësimit.	
(d4)	Ju i motivoni studentët të kërkojnë burime të reja mësimore përtej materialeve të kërkuara dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike besueshmërinë e tyre.	

Krahasimi i mesatareve të sondazhit për lektorët e rinj dhe ata me përvojë tregon se perceptimet e tyre për këta faktorë janë pothuajse në të njëjtin nivel. Përjashtimi i vetëm është faktori d4, i cili tregon se lektorët e rinj janë më të prirur të motivojnë studentët të kërkojnë materiale plotësuese dhe të vlerësojnë cilësinë e tyre.

Fig.8 Faktorët që përcaktojnë strukturën e procesit të mësimdhënies

(e1)	Gjatë mësimeve ju përmblidhni materialin dhe theksoni pjesët më të rëndësishme.	**Structure**
(e2)	Gjatë mësimeve ju rregulloni kohën e mësimit dhe menaxhoni mirë kohën e organizimit të klasave.	
(e3)	Organizimi dhe strukturimi i materialeve mësimore	

(e4)	Ju siguroheni që orët tuaja të jenë të organizuara mirë.	

Në lidhje me faktorët e zgjedhur nga vëzhguesit për të përcaktuar nivelin e strukturës së klasës, vërehet se vlerat mesatare të perceptimit priren drejt maksimumit të mundshëm të këtij perceptimi, me një ndryshim midis tyre që nuk është më shumë se 0,1 e njësisë së zgjedhur. Në krahasimin e përgjigjeve të dhëna nga lektorët e rinj dhe ata me përvojë, vihet re se vlerat e tyre mesatare janë për të dy grupet mbi 4.3 njësi, por në të gjitha rastet perceptimi mesatar për lektorët e rinj është më i lartë se perceptimi mesatar i lektorëve me përvojë.

3. Përfundime

Në përputhje me praktikat e përparuara të BE-së, për të rritur krahasueshmërinë dhe konkurrencën e tij në Evropë dhe më gjerë, procesi i mësimdhënies në universitetet tona kërkon rritjen dhe përforcimin e cilësisë së tij për t'i bërë ballë sfidave që situatat si kjo e pandemisë që po kalojmë dhe për t'i paraprirë çdo risie që teknologjia e informacionit mundëson në këtë proces. Duke marrë në konsideratë hulumtimet e shumta të bëra në fushën e implementimit të faktorëve strategjikë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, përdorimin gjithnjë e më shumë të teknologjisë së informacionit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe rezultatet e studimit statistikor, kemi konkluduar në përfundimet e mëposhtme:

- Është e domosdoshme përforcimi i njohurive dhe aftësive profesionale të stafit mësimdhënës përmes kurseve të trajnimit në qasjet, metodologjitë dhe teknologjitë arsimore bashkëkohore;
- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore si bazë për një integrim më të gjerë të parimeve pedagogjike dhe teknologjive moderne në mësimdhënie dhe mësimnxënie është një kërkesë imediate;
- Zhvillimi i kurseve trajnuese të reja në psikologji, pedagogji, metodologji mësimore dhe promovim të teknologjisë në IAL në përputhje me strategjitë moderne evropiane;
- Forcimi i infrastrukturës së personelit përmes futjes së zhvillimit të vazhdueshëm profesional në sistemin e arsimit të lartë;
- Zhvillimi i metodologjisë dhe platformave për integrimin më të gjerë të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

4. Referenca

Factors that Influence Learning Strategy Use among Senior High School Economics Students in Ghana: A Quantitative Approach, Anthony Akëesi Oëusu, Cosmas Cobbold, International Journal of Learning, Teaching and Educational Research Vol. 19, No. 5, pp. 167-185, May 2020.

Role of Information Technologies in Teaching Process, Irshad HUSSAIN, Muhammad SAFDAR, Turkish Online Journal of Distance Education-TOJDE, April 2008, ISSN 1302-6488 Volume: 9 Number.

Knoëles, M.S. (1980). The Growth and Development of Adult Education. In John M. Peter & Associates (eds.); Building an Effective Adult Education Enterprise, London; Jossey Bass Publishers. Marriam, S. B. & Cafarell.

Learning Strategies and Performance In a Technology Integrated Classroom, Kathleen Debevec, Mei-Yau Shih, Amherst Vishal Kashyap, Journal of Research on Technology in Education, Copyright © 2006, ISTE (International Society for Technology in Education), 1.800.336.5191 (U.S. & Canada) or 1.541.302.3777 (Int'l), iste@iste.org, www.iste.org.

Hussain, I. (2005). A Study of Emerging Technologies and their Impact on Teaching Learning Process. Un-published Ph.D thesis, Islamabad: Allama Iqbal Open University, Pakistan.

Learning Strategies and Learning styles, Ronald R. Schmeck, Southern Illinois University Carbondale, Springer Science+Business Media, LLC, New York, 1988.

Factors affecting students' learning strategies at school Aizan Yaacob, Aspalila bt. Shapii, Alobaisy Ayman Saad, Waleed Mugahed Al-Rahmi, Yahya M. Al-Dheleai, Nor-affandy Yahaya, Qusay Al-Maatouk, International Journal of Engineering & Technology, 7 (4) (2018) 3703-3709.

Social goals in the classroom: Findings on Student Motivation and Peer Relations. Shim, S. S., & Ryan, A. M., In M. H. Jones (Ed.), Social achievement goals (pp. 53–73). New York: Routledge. doi:10.4324/9780429468452-4, (2019)

ZHVILLIMI PROFESIONAL I VAZHDUESHËM I MËSUESVE

Fiona Todhri[1], Sabina Belshaku[2], Juliana Cerekja[3]
[1] Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
fiona.todhri@gmail.com
[2] Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan
sabina_belshaku@yahoo.com
[3] Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti A. Xhuvani" Elbasan
julicerekja@yahoo.com

Abstrakt

Në shkolla ka shumë mësues që nuk janë përfshirë në trajnime apo në seanca për ZhP- në; mungon baza e nevojshme e të dhënave në këtë fushë dhe nuk janë plotësisht funksionale rregulloret për akreditimin e programeve dhe të organizatave që ofrojnë trajnime për ZhP-në të mësuesve; ka vonesa ose dobësi në licensimin e mësuesve. Mbeten problemet me nivelin jo të përshtatshëm të pagave të mësuesve dhe me sistemin e gabuar dhe aspak motivues të kompensimit për punën e kryer. Përfshirja e pamjaftueshme e të gjithë mësuesve në programet e aftësimit, instrumentet e munguara për identifikimin dhe çmuarjen e nevojave për ZhP-në, larmia dhe thellësia e programeve trajnuese janë dobësi të tjera që kërkojnë trajtim urgjent nga ekspertët. Metoda e kërkimit është ajo cilësore. Çështjet në të cilat fokusohet me së shumti studimi cilësor lidhet kryesisht me nevojat e mësuesve për trajnim të vazhduar dhe mbështetje nga aktorë të tjerë. Disa nga gjetjet kryesore të artikullit kanë të bëjnë mëpërmirësimin e shprehive të mësimdhënies mbi aplikimin e teknikave dhe të mësuarit me në qendër fëmijën.

***Fjalë kyçe**: Zhvillim profesional, trajnim i vazhduar, mësues*

Abstract

There are many teachers in pre-graduate schools who are not involved in training or professional development sessions. The lack of data in the field of continuing teacher education, as well as the lack of accreditation of programs, affects the standardization and coordination of organizations providing teacher professional development training; all of these affect delays or weaknesses in teacher licensing. A problem that continues to remain in the ranks of teachers is the level of salaries inadequate to meet their needs with the demands that the market has for the quality of teaching. The research method used in this article is qualitative. The purpose and objectives on which the qualitative study is most focused are mainly related to the needs of continuing education teachers as well as their continuous

request to be supported by the community or other actors. Some of the main findings of the article relate to the current situation teachers have mainly with continuing qualification, as well as improving teaching skills or applying child-centered learning and techniques.

Keywords: *Professional development, continuing training, teachers*

1. Hyrje

Kurrikula kuptohet si një sistem i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që të lidhura mes tyre, mundësojnë të orientohet dhe të funksionojë sistemi arsimor nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimimi cilësor dhe i barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

Në morinë e ndryshimeve të shumta e të shpejta, sasiore e cilësore në të gjitha fushat e jetës, vendi ynë aktualisht po kristalizon edhe përmbajtjen e reformës kurrikulare, si një ndër drejtimet kryesore të kësaj reforme. Reforma jonë kurrikulare merr parasysh: *nevojat, zhvillimet e sotme dhe qëllimet e sistemit arsimor, të shpallura në dokumentet e ndryshme të politikave arsimore; traditën e sistemit tonë arsimor që është bazë për vazhdimin e reformës; nevojën për rritjen e cilësisë së arsimit dhe trajnimit; nevojën për të garantuar mundësi të barabarta për arsimim dhe trajnim cilësor për të gjithë; hapjen e sistemit arsimor ndaj botës.*

Sipas ekspertëve, një nga sfidat në implementimin e një reforme arsimore është efekti kohë. Në rastin e hartimit të kurrikulës së re, instrumentalizimin dhe instalimin e saj kërkon jo vetëm një periudhë të konsiderueshme për t'u absorbuar si nga stafi pedagogjik ashtu dhe nga nxënësit. Rezultatet e një reforme arsimore pritet që të përfitohen mesatarisht pas një dekade. Vështirësitë më të mëdha që hasen kur aplikon një kurrikul të re në sistemin parauniversitar janë kryesisht: ndryshimi i mendësisë mbi stilet e mësimdhënies, sidomos kalimi nga ai tradicional te teknikat bashkëkohore të cilat këto të fundit kërkojnë infrastrukturën didaktike, mjete mbështetëse si dhe trajnimin e vazhduar të mësuesve.

Referuar hendekut të lartë që vëmë re ndërmjet shkollave të zonave urbane, periurbane dhe atyre rurale, politikat arsimore dhe ato sociale mbështetëse janë një mundësi për të ndikuar në rezultatet e fëmijëve.

Një faktor mjaft i rëndësishëm dhe me impakt të lartë terezultatet e fëmijëve mbetet ai i rritjes së efektivitetit nëpërmjet mësimdhënies dhe trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve. Trajnimi i vazhduar i mësuesve ka qenë dhe mbete pjesë e strategjive arsimore në Shqipëri. Kjo strategji ndërhyrjeje jo gjithmonë ka rezultuar efikase.

Nëse i referohemi "Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020", raportohet se zhvillimi profesional nuk mundësoi zhvillimin e formave të trajnimit në bazë shkolle dhe / ose online, përcaktuar nga ligji nr.

69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". Po sipas kësaj strategjie përpjekjet nuk kanë munguar, por rezultatet nuk kanë qenë në pritshmëritë e duhura për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave.

Në shkolla ka shumë mësues që nuk janë përfshirë në trajnime apo në seanca për ZhP-në; mungon baza e nevojshme e të dhënave në këtë fushë dhe nuk janë plotësisht funksionale rregulloret për akreditimin e programeve dhe të organizatave që ofrojnë trajnime për ZhP-në e mësuesve; ka vonesa ose dobësi në licensimin e mësuesve. Mbeten problemet me nivelin jo të përshtatshëm të pagave të mësuesve dhe me sistemin e gabuar dhe aspak motivues të kompensimit për punën e kryer. Përfshirja e pamjaftueshme e të gjithë mësuesve në programet e aftësimit, instrumentet e munguara për identifikimin dhe çmuarjen e nevojave për ZhP-në, larmia dhe thellësia e programeve trajnuese janë dobësi të tjera që kërkojnë trajtim urgjent nga ekspertët, në kuadër të zbatimit të strategjisë.

Sipas literaturës është dokumentuar fakti se ***trajnimi i mësuesve*** është më efektiv kur fokusohet te nxënia, hartimi i strategjive të mësimdhënies, si të bashkëpunohet me kolegët e tyre, hartimi i praktikave efektive. Kur mësuesit e shkollës fillore kryen zhvillim profesional intensiv për shkencën, ata treguan përmirësim domethënës në performancën e nxënësve si dhe me bindjet e tyre, në përpjesëtim me numrin e orëve të trajnimit (afër 100 orë në vit).

Nga dokumentet strategjike, por edhe nga analiza e të dhënave cilësore, konstatojmë që ka mungesa në trajnime dhe mbi të gjitha nuk ka vazhdimësi të tyre, kjo vërehet më shumë në nivel lokal. Sipas specialistit *H. N. "Unë po e bëj trajnimin masiv, nuk është se s'e bëj, por arkitektura e sistemit është ndërtuar në mënyrë të tillë, që nëse drejtoritë arsimore që janë pjesëmarrëse në këtë trajnim, nuk bëjnë 'follow up', pra, nuk ndjekin kaskadën, trajnimi fillon e humbet".*

Nga intervistat me mësuesit kemi të tjera raportime, një pjesë e tyre shprehen se trajnimet që ofrohen nga agjencia nuk i përgjigjet nevojave të mësuesve. Gjithashtu, mungojnëteknikat e duhura ose përzgjedhja e metodave adekuate mbi aftësimin e mësuesve dhe shpeshherë i bën kualifikimet të papërshtatshme dhe painteres për mësuesit. Ja si shprehet dhe çfarë sugjeron një mësuese nga Dibra: Znj.*T. L: "E di çfarë është trajnim për mendimin tim? Është ky bashkëpunimi me një mësues profesionist, ose me një mësues që ka bërë disa vite pune, dhe t'i tregoj se ku qëndron problemi te një klasë dhe të më sugjerojë se çfarë mund të bëj unë ndryshe".*

Për të mbështetur argumentimet e mësipërme, dhe për ti dhënë përgjigje pse trajnimet e ofruara nuk janë të mjaftueshme dhe aspak efikase, për disa arsye: a)koha e shkurtër e trajnimeve të zhvilluara, kjo e bën të pamjaftueshme, b) Mësuesit jo gjithmonë gjejnë trajnimin e duhur në kohën e duhur.c) Mësuesi duhet ti paguaj vetë një pjesë të trajnimeve, dhe referuar kësaj të fundit, paga e mësuesit është e vogël për të përballuar vazhdimisht këtë kosto. Në këto kushte duhet liberalizim të tregut referuar këtyre kërkesave. Shkolla duhet të krijojë autonomi financiare për të përballuar

nevojat për trajnime të vazhdueshme të mësuesve. Duhet të licensohen dhe të favorizohen operatorë privat dhe autonom për të përmirësuar dhe përmbushur nevojat e mësuesve për zhvillim profesional të vazhduar.

Një fokus të veçantë duhet të ketë dhe trajnimi i mësuesve kur punojnë me grupe dhe kategori të popullsisë me probleme sociale, ekonomike ose me fëmijë më nevoja të veçanta. Nga të dhënat e deritanishme sipas analizave statistikore të dala nga data baze e PISA-s por edhe nga bisedat me specialistë të fushës, vërejmë se mosnjohja e nevojave që ka fëmija, por dhe mos plotësimit me njohuri të mësuesve, sesi të punojnë me këta fëmijë, e shton hendekun në përmirësimin e rezultateve arsimore për këto kategori. Karakteristikat që klasat kolektive kanë, ose zona të caktuara, referuar dhe kontekstit lokal në të cilën ata gjenden, d.m.th., si pozicioni gjeografik, shkalla e zhvillimit lokal, përbërja e popullsisë, etj, e bëjnë shpeshherë të vështirë punën për mësuesit. *Znj. T.L: "Unë ka 12 vite që punoj në arsim, ky është viti i 13. Dhe 12 vite kam dhënë mësim në një shkollë fshati, me klasa të bashkuara. Kam pasur edhe 3 klasa bashkë, dy-tre, jo me katër klasa. Në vitin e parë të punës, unë me klasa kolektive, me tre klasa. Sinqerisht ishte i vështirë fillimi, pjesa e ditarit kërkonte shumë kohë. Nuk është vetëm ajo pjesa që do japësh 6 orë, sepse punohej me sistem 6 orë, do me thënë në 2 pa një çerek ishe në shkollë çdo ditë. Do të bëje ditarë jo për një klasë por për tre klasë, llogarite sa i binte, 10-11 orë. Për klasën e parë, të tretë dhe të pestë, këto kam pasur unë në vitin e parë të punës.*

Specialistët si në fushën e psikologjisë dhe neurologjisë shprehen se mësuesit duhet të përfshihen dhe të njohin mirë psikologjinë e fëmijëve, zbërthimin e programit lëndor, integrimin lëndor, dhe gjetjen e metodave dhe teknikave efikase për një mësim kreativ që rrit nivelin e mësimnxënies. Ajo që del si kërkesë e domosdoshme është mbështetje e mësuesit në mënyrë të vazhdueshme nga shërbimi psikosocial në shkollë, që t'i bëjë të mundur mësuesit të njohë edhe botën e brendshme të fëmijës. Neuropediatria thekson se: "*Do të doja që ta shikonin fëmijën si një individ në zhvillim dhe mësuesit duhet të futen në psikologji, në konceptet e psikologjisë së zhvillimit të fëmijës në mënyrë që të hartohet një program i përshtatshëm për fëmijët, i përshtatshëm për individin. Domethënë, të jetë një program që të ketë kreativitetin që t'i përshtatet çdo lloj fëmijë pavarësisht asaj IQ-së së lindur, sepse me punë ne gjithmonë mund të bëjmë që fëmija për atë IQ-në natyrale që ka, të japë maksimumin e performancës së tij".*

Nga intervistat me politikëbërësit në vend shprehen se këto grupe shoqërore me vështirësi në mësimnxënie kanë qenë pikësynimi në hartimin e kurrikulave dhe programeve për të punuar në mënyrë të veçantë me këta nxënës. Sipas politikëbërëses znj. O.K *"Gjetëm goxha problematika, prandaj ndërtuam këtë planin. Agjencia që merret me hartimin e kurrikulave dhe me trajnimin, në bazë të këtij raporti, të këtyre vlerësimeve që iu bënë nxënësve, bëri një program. U bënë trajnime me mësuesit që punonin me këta nxënës, u shpërnda ky program dhe ata punuan në mënyrë specifike me*

këto. Tani duhet parë se çfarë ka ndodhur me nxënësit që punuan me këtë program, që të shohim se çfarë do të bëjmë".

Sipas specialistëve dhe interpretimit të të dhënave cilësore të marra nga intervistat e realizuar në terren, theksohet rëndësia e praktikave efektive të mësimdhënies, strategjive të të mësuarit nga nxënësit (pjesërisht produkt i praktikave të mësimdhënies) dhe ndikimin pozitiv, sidomos, kur ka një pjesë të madhe mësuesish të kualifikuar nëpër shkolla. Programet për zhvillim profesional të vazhduar të mësuesve kërkohet të përqendrohen më shumë te pajisja me mjete burimore dhe me teknika për të përmirësuar efektivitetin në klasë. Gjithashtu, sistemet e reagimit për mësuesit mund të bëjnë dallimin për përforcimin e teknikave të menaxhimit të klasës dhe për të promovuar teknikat përkatëse pedagogjike, kryesisht në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët e disavantazhuar.

2. Konkluzione

- Kualifikim i vazhdueshëm për mësuesit, duke ofruar trajnime për të përmirësuar teknikat e mësimdhënies, por duke vlerësuar dhe mbajtur parasysh nevojat e mësuesve, si dhe vënien në dispozicion të burimeve e mjete mësimore ndihmëse.
- Përmirësimi i shprehive të mësimdhënies mbi aplikimin e teknikave dhe të mësuarit me në qendër fëmijën.
- Avancim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kurrikulës parauniversitare.
- Konsultim me specialistë të shumë disiplinave, për ta bërë më praktike dhe të përshtatshme për të gjithë kategoritë e fëmijëve, si dhe me shumë materiale didaktike, mbështetëse për të.
- Nevojitet më shumë investime dhe mbështetje me burime njerëzore, mjete mësimore, libra, infrastrukturë për klasat kolektive në zonat rurale.
- Aplikimi dhe shtrirje më e gjerë e shkollave si qendër komunitare, sidomos, në zonat peri-urbane dhe rurale.
- Konsultim me specialistë të shumë disiplinave gjatë hartimit të kurrikulave parauniversitare, për ta bërë më praktike dhe të përshtatshme për të gjithë kategoritë e fëmijëve mësimnxënien, si dhe me shumë materiale didaktike, mbështetëse për të.

3. Referencat

Udhëzues për klasat kolektive-IZHA.

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020.

Intervistë me mësuese

Intervistë me politikëbërëse

Intervistë me specialistë të MASH-it.

Intervistë me neuropediatre

Korniza Kurrikulare E Arsimit Parauniversitar Të Republikës Së Shqipërisë, Tiranë 2014.

Qeverisja vendore në Shqipëri, Raport mbi situatën aktuale, Tiranë, 2019.

Standardet e shkollës si qendër komunitare, Tiranë, 2014.

Standardet e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç, IZHA, 2018.

Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë, Tiranë, 2019, ASCAP, MASH.

Strategjitë e të lexuarit dhe roli i tyre në fenomenin e analfabetizmit funksional te nxënësit e klasave të treta;Lika, M:, 2017.

ADMINISTRIMI I PROCESIT TË RI TË MËSIMDHËNIES NË DISTANCË

Eris Dhamo[1], Anila Sulaj[2], Kristina Qypi[3]
[1] Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
eris.dhamo@unitir.edu.al
[2] Departamenti i Menaxhimit Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës
asulaj@ubt.edu.al
[3]Prefektura e Elbasanit, Punonjëse sociale
qypikristina@gmail.com

Abstrakt

Ky është një studim eksplorues, me në qendër shqetësimin mbi qëndrimet e mësuesve mbi elementet e administrimit të procesit të mësimdhënies në distancë. Informacionet e shumta mediatike dhe deklaratat e zyrtarëve më të lartë të vendimmarrjes na kanë informuar në vijueshmëri mbi mënyrën se si do të realizohej mësimi në distancë dhe mjetet që do të përdoreshin. Sigurisht, që struktura ekzistuese rregullatore për mësimin në distancë do të ishte një udhëzues shumë i mirë i përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe, sigurisht, i rritjes së cilësisë së edukimit. Nën këtë kuadër kystudim vjen për të kuptuar se si teknologjia është vënë në përdorim nga vetë mësuesit për të organizuar dhe të realizuar mësimdhënien në distancë dhe pse jo dhe pritshmëritë që vetë mësuesit kanë nga përfshirja në këtë proces i atyre dhe inxënësve.Studimi është realizuar në32 shkolla të qytetit të Tiranës dhe në të kanë marrë pjesë 64nga 155 që ishin përzgjedhur në fillim..

Fjalë kyçe:*Mësues, administrim, mësim në distancë, efektiv.*

Abstract

This is an exploratory study, focusing on teachers' attitudes about the elements of distance learning process administration. Numerous media reports and statements by top decision-making officials have kept us informed on how distance learning would be accomplished and the tools that would be used, at the time where teachers were unprepared for the new situation. Certainly the existing regulatory structure for distance learning would be a very good guide to improving the quality of teaching and of course increasing the quality of education. Under this framework, this study comes (1) to understand how technology has been used by teachers themselves to organize and implement distance learning and (2) to explore the expectations that teachers themselves have from the involvement of them and students in this process.This research is a qualitative study, and researcher collected data through 32 schools in the city of Tirana (Albania

capital). The research involved 64 out of 155 teachers who were initially selected.

Keywords: *Teacher, administration, distance learning, effective, Tirana, Albania.*

1. Hyrje

Prej më shumë se një viti e gjithë shoqëriabotërore, jo vetëm ajo shqiptare jetonnënnjë rend të ri, të izolimit fizik dhe të masave të distancimit social (OBSH, 2020). Të gjitha qeveritë e vendevetë zhvilluara kanë organizuar dhe vënënë zbatim rregulla të reja të cilat cenojnë lëvizjen e lirë, organizimet dhe grumbullimet. Realiteti i ri i ditëve të sotme është shoqëruar me debate, të cilat fokusohen jo vetëm në krizën globale shëndetësore si kërcënimin më të madh të ekzistencës sonë, por edhe në rimodelimet sociale që kufizimet e vendosura prej saj sollën. Shoqëria jonë e sotme ka ndaluar të reflektojë mbi ri përcaktimin e vlerave, për të ndërtuar një "shoqëri të re", të tillë që të reflektojë elasticitet, reagueshmëri dhe aftësi për t'iu përshtatur sfidave me të cilat ajo përballet. Dhe sigurisht, që për të siguruar këtë reagueshmëri është e nevojshme që vetë sistemet arsimore të edukojnë shoqëri të tilla. Po nuk duhet lënë jashtë vëmendjes dhe fakti që nga Covid-19 dhe nga kufizimet e kësaj pandemie sistemi arsimor dhe ai profesional gjithashtu u cenua rëndë (OBSH, 2020) dhe, së pari, duhet të përshtatet vetë me rrezikun dhe strukturimin, por pa e reflektuar këtë te nxënësit që arsimon.

Pjesëmarrja e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në arsimin zyrtar është 84,4 përqind krahasuar me popullsinë e moshës shkollore.Të dhënat më të fundit(INSTAT, 02 Prill 2021) referojnë se, për vitin shkollor 2020-21, figurojnë të regjistruar në arsimin para universitar 460.819 nxënës dhe fëmijë, duke shënuar një ulje prej 4,4 %, krahasuar me vitin shkollor 2019-20. Në vitin shkollor 2020-21, numri i mësuesve në arsimin 9-vjeçar është 24.443, ndër të cilët 75,8 % janë gra. Raporti nxënës për një mësues në arsimin fillor publik është 16,6 dhe në atë privat është 13,9. Ndërsa në ciklin e lartë të arsimit 9- vjeçar, raporti nxënës për një mësues në publik është 8,9 dhe në atë privat 7,2. Numri i mësuesve në arsimin e mesëm është 8.584 prej të cilëve 68,4 % janë gra. Raporti nxënës për një mësues në arsimin e mesëm është 12,7 në arsimin publik dhe 8,9 në atë privat.

Vendimet e ardhura nga Komiteti teknik (2020), por edhe nga drejtuesit e vendit informuan jo vetëm ndërprerjen e studimeve në ambientet e shkollave, por edhe adoptimin e formave alternative të mësimit në distancë. Udhëzimet e MASR-së (2020) për adoptimin e teknologjisë në mësimdhënie u shoqëruan edhe me asistenca të ndryshme për nxënësit pa akses në teknologji, me orientime dhe asistencë në mësimdhënie nëpërmjet përdorimit të telefonit celular të mësuesve dhe programeve të ndryshme komunikative apo edhe nëpërmjet organizimit të programe televizive mbi mësimdhënien në të gjitha ciklet e arsimit (TVSH Shkolla). Referuar Instat-it (2021) numri i nxënësve të regjistruar në arsimin 9-vjeçar për vitin akademik 2020-

2021është 286.486, ndërsa numri gjithsej i nxënësve të regjistruarnë arsimin e mesëmështë 103.001.

Nxënësit, mësuesit dhe studentët përjetojnë çështje specifike teknike si lidhja e dobët e internetit, kompetenca të ulëta digjitale, mungesë të mbështetjes institucionale si dhe pajisje të vjetra, të cilat nuk suportojnë versionet e reja të programeve edukative ose janë të papajtueshme me platformat e zgjedhura për mësimdhënie (Qureshi, Khawaja, Zia, 2020).

Sigurisht, qëmësiminëdistancë edhe pse përsituatënnëtëcilën u përdor ishte me efektivi, por si çdo sistem edhe ai ka të metat e veta. Janë realizuar shumë studime mbi sistemin e mësimdhënies në distancë apo efektivitetin e këtij procesi online që prej më shumë se 20 vitesh, kur teknologjia ka mundësuar aplikimin e tij. Një numër studimesh (Husmann & Miller, 2001; McAlister, Rivera, & Hallam, 2001; Sherritt, 1996; Valentine, 2002) zbulojnë probleme ose sfida që lidhen me arsimin në distancë, nga përmbledhja e të cilave mund të renditen disa çështje, si:Mungesë e fokusit të "programit"; Rigoroziteti dhe metodat pedagogjike; Menaxhimi i klasës; Kostot e fshehura dhe keqpërdorimi i teknologjisë; si dhe mungesa e angazhimit të vërtetë.

Avantazhet e teknologjisë për mësimin në distancë u miratuan gjerësisht nga gjithë komuniteti i ekspertëve të edukimit (Milheim, 2001; Kinley's 2001), por pa u analizuar më parë mundësitë dhe aksesi në teknologji si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Ky studim nuk fokusohet në ketë aspekt, por nuk mund të diskutoj mbi administrimin e procesit të edukimit pa ndaluar më parë në evidentimin e mungesës së rregulloreve dhe normativave ligjore edukative të përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. As në edukimin përgjatë gjithë jetës nuk ka përcaktime mbi përdorimin e teknologjisë dhe integrimin e saj me aftësitë pedagogjike të të mësuarit të të rriturve, në diferencë nga gjetjet e shumë viteve më parë mbi zhvillimin e aftësitë e të mësuarit të të rriturve (He, 1998). Struktura rregullatore do të ishte një udhëzues shumë i mirë i përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe, sigurisht, të rritjes së cilësisë së edukimit. Nën këtë kuadër ky studim vjen për të kuptuar se si teknologjia është vënë në përdorim nga vetë mësuesit për të organizuar dhe të realizuar mësimdhënien në distancë dhe pse jo dhe pritshmëritë që vetë mësuesit kanë nga përfshirja në këtë proces i atyre dhe i nxënësve. Se si ky proces vlerësohet nga ata vetë.

2. Metodologjia

Qasja metodologjike e përdorur për këtë studim është ajo sasiore. Kjo qasje shpesh përdoret nga studiuesit që ndjekin paradigmën shkencore (Macdonald dhe etj., 2008) dhe kryesisht kërkon të përcaktojë sasinë e të dhënave dhe të përgjithësojë rezultatet nga një shembull i një popullate të synuar (Macdonald dhe tj., 2008). Ashtu siç dhe literatura referon, ky studim ndjek një proces të strukturuar të mbledhjes së të dhënave me daljen e të dhënave në formën e numrave. Kërkimi sasior, gjithashtu, vëzhgon analizën objektive duke përdorur mjete statistikore.

Pyetje kërkimore

Pyetjet e mëposhtme kërkimore u adresuan për të realizuar studimin:

1. Çfarë pritjesh dhe besimesh kanë mësuesit përmësimin në distancë?

2. A ka ndryshime të konsiderueshme midis pritshmërive dhe besimeve të mësuesve të mësimit në distancë bazuar në karakteristikat demografike (p.sh., mosha, gjinia, niveli arsimor, drejtimi, niveli i klasës, vitet e përfshirjes në mësimdhënie, tipologjia e shkollës)?

Popullsia

Popullsi për këtë studim, së pari, u identifikuan të ishin administratorët e mësimit në distancë dhe, meqë një terminologji e tillë nuk mund të evidentohet në sistemin tonë arsimor para universitar, pasi administratorët e vërtetë të procesit mësimor ishin vetë mësuesit, atëherë ata shërbyen dhe si popullsia e këtij studimi. Sipas INSTAT-it, 2021, numri i mësuesve në arsimin 9-vjeçar është 24.443 dhe në arsimin e mesëm është 8.584, me një total prej 33.027 mësuesish (INSTAT, 2021).

Ky studim është realizuar në Tiranë dhe nga vlerësimi paraprak i pyetësorëve të mbledhur është evidentuar se mësuesit janë përfaqësues të 32 shkolla, institucione arsimore parauniversitare.

3. Instrumenti i studimit

Për të hetuar perceptimet e administratorëve për cilësinë e arsimit në distancë, studiuesit krijuan një sondazh me 5 pikë në shkallë Likert: Nuk pajtohem plotësisht, nuk pajtohem, i pavendosur, dakord dhe plotësisht dakord. Pyetësori u zbatua në internet në mënyrë që administratorët të ishin në gjendje ta plotësonin atë me lehtësi. Pyetjet e sondazhit u përqendruan vetëm në kurse online. Pyetësori u nda në dy seksione kryesore. Seksioni i parë u përqendrua në qëndrimet dhe besimet e mësuesve në lidhje me klasat në internet dhe përfshiu fushat e kurrikulës, pedagogjisë, mjedisit të të mësuarit, nevojave të nxënësve, përmirësimit të procesit, mbështetja institucionale, etj. Seksioni tjetër u përqendrua në informacionin demografik të të anketuarve, të tilla si mosha, gjinia, niveli arsimor, vitet e punës si mësues. Një masë e besueshmërisë në nivelin Cronbach Alpha zbuloi një alfa prej 0,91 për instrumentin e sondazhit. (*Shihni Shtojcën për pyetësorin e sondazhit*.) Studimi u realizua në qytetin e Tiranës dhe ka nisur me rishikimin e literaturës për ndërtimin e pyetësorit në muajin dhjetor 2020 dhe ka përfunduar në muajin mars 2021. Sigurisht, që nuk është një studim kombëtar dhe ka një kohë të kufizuar në dispozicion për analizën e të dhënave, e cila është vetëm përshkruese.

Informacioni demografik

Mosha mesatare e administratorëve që u përgjigjën ishte 41.4 vjeç. Më i riu ishte 25 vjeç, ndërsa më i rrituri ishte 53 vjeç. Periudha mesatare e ushtrimit të profesionit (vetëm e të qenit mësues) ishte 14.8 vjet. Një përmbledhje e informacionit demografik mund të gjendet në Tabelën 1.

Tabela 1.Informacioni demografik i pjesëmarrësve.

Gjinia	
Mashkull	36.6%
Femër	63.4%
Niveli më i Lartë i Diplomës	
Arsim i Lartë	
Bchelor	26.8%
Master	65.9%
Doktoraturë	4.9%
Fusha e Diplomës (Disiplina Mësimdhënies)	
Edukim	48.8%
Shkenca Ekzakte	12.2%
Art& Shkenca Sociale	12.2%
Tjetër	26.8%
Niveli i Mësimdhënies	
Nëarsimin 9 vjeçar	**56. 3 %**
• Nëfillore	28.6%
• Nëciklin e lartëtëarsimitbazë	27.7%
Nëarsimin e mesëm	
• Gjimnazdhe Social-Kulturor	**43.7%**
• Profesional	31.4%
	12.3%

4. Gjetjet kryesore

Ashtu si dhe diskutuam në sesionin metodologji, të dhënat e siguruara nga ky studim nuk na mundësojnë të bëjmë përgjithësime si dhe nuk na mundëson të bëjmë analiza faktoriale, ndaj me gjetjet e studimit do jemi të rezervuar.

Referuar pyetjes së parë kërkimore të këtij studimi "*Çfarë pritjesh dhe besimesh kanë mësuesit për mësimin në distancë?*", nga analiza përshkruese e mesatares së rezultateve të tëdhënavetësiguruara(referuar shkallës Likert 4 = dakord; 5 = plotësisht dakord) janë identifikuar si më të rëndësishme këto aspekte:

Pesë pritshmëritë dhe besimet kryesore të mësuesve në lidhje me procesin e mësimdhënies në distancë referuar mesatares më të lartë të shkallës Likert janë:

- Nxitni ndërveprimin dhe bashkëpunimin e nxënësve(mesatarja 4.73)
- Jepni mundësi nxënësve për të bashkëvepruar me njëri- tjetrin (mesatarja 4.71)
- Jepni mundësi nxënësve për të bashkëvepruar me materialet e lëndës (mesatarja 4.64)
- Janë një mënyrë alternative e mësimdhënies dhe e të nxënit (mesatarja 4.56)
- Kanë një ndikim të rëndësishëm në arsimim (mesatarja 4.53)

Pesë pritshmëritë dhe besimet kryesore të identifikuara si më pak të përkrahura (1 = Aspak dakord; 2= jo dakord; 3 = Neutral) në lidhje me procesin e mësimdhënies në internet janë:

- Siguron mbështetje administrative për nxënësit (mesatarja 1.90)
- Keni një instruktor (mësues) kompetent në teknologji (mesatarja 1.95)
- Do të zëvendësojë programet tradicionale (mesatarja 2.32)
- Siguron fleksibilitet për mësuesit (mesatarja 2.39)
- Duhet të jetë më i përhapur (mesatarja 2.46)

Në këtë pjesë të gjetjeve të këtij studimi është me rëndësi të sqarohet një pyetje, ajo me numrin 37 "*Unë besoj te mësimi online*", me njëmesatare 3.01, duke mos arritur dot në konkluzion nëse vetë mësuesit besojnë në efektivitetin e procesit të mësimdhënies online dhe nëse administrimi i këtij procesi besohet të jetë i efektshëm.

Në vijim të analizës në pjesën në vijim jemi ndalur në pyetjen e dytë kërkimore "*A ka ndryshime të konsiderueshme midis pritshmërive dhe besimeve të mësuesve të mësimit në distancë bazuar në karakteristikat demografike*". Rezultatet e analizave statistikore tregojnë se nuk ka dallime të rëndësishme statistikore midis karakteristikave të procesit të administrimit të mësimit online dhe karakteristikave demografike si mosha, niveli arsimor, drejtimi, niveli i klasës, vitet e përfshirjes në mësimdhënie dhe tipologjia e shkollës. E vetmja e dhënë e rëndësishme mbi diferencat ndërmjet grupeve ishte ajo e gjinisë.

Rezultati i ***t-testi*** (Tabela 2) tregoi se kishte një ndryshim të rëndësishëm ($p < .05$) midis niveleve të pritshmërive dhe të besimeve të mësuesve mbi disa elemente të administrimit të procesit të mësimit në distancë bazuar në karakteristikat demografike të gjinisë meshkuj (mesatarja 4.02) dhe femrat (mesatarja 3.78).

Tabela 2. **Dallimet midis qëndrimeve të mësuesve meshkuj dhe femra.**

Levene's Test for Equality of Variances			**t-test for Equality of Means**						
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std.Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
								Lower	Upper
Equal variances	10.534	.002	2.264	39	.029	.2329	.10288	.02483	.4410
Assumed Equal variances not assumed			2.640	38.864	.012	.2329	.08821	.05447	.41137

5. Limitet e Studimit

Ky është një studim në një shkallë të vogël i realizuar nëpërmjet e-malit (38 përgjigjedhënës nëpërmjet postës elektronike) dhe shkalla e përgjigjedhënieve (edhe mungesa e kampionimit) nuk është konform standardeve statistikore duke ngritur debate mbi rezultatet e përfituara. Për të ulur gabueshmërinë dhe për të rritur cilësinë e studimit, studiuesja pas një kampionimi rastësor të shkollave të kryeqytetit realizoi vetë mbledhjen e të dhënave sipas kampionimit të listës emërore të mësuesve të këtyre shkollave, duke siguruar një shtesë ekstra prej 49 pjesëmarrësish në studim. Një element tjetër shumë i rëndësishëm i cili shoqëroi komentet e përgjigjedhënësve të kontaktuar personalisht nga studiuesja ishte mungesa e pyetjeve mbi sigurinë e sistemit të mësimdhënies dhe mjeteve teknologjike të përdorura për mësimdhënien në distancë. Ky ishte një element i cili qëllimisht nuk u përfshi në pyetësor pasi mbi vështirësitë e mësimdhënies në distancë ishte planifikuar të kryhej një studim tjetër.

Referenca

OECD (2020) The impact of COVID-19 on education - Insights from Education at a Glance 2020, OECD website, Aksesuar më 8.02.2021 https://www.oecd.org/education/the-impact-of-covid-19-on-education-insights-education-at-a-glance-2020.pdf

WHO (2020) Considerations for school-related public health measures in the context of COVID-19, WHO website, Aksesuar më 2.01.2021

https://www.who.int/publications/i/item/considerations-for-school-related-public-health-measures-in-the-context-of-covid-19

OECD (2020) Supporting the continuation of teaching and learning during the COVID-19 Pandemic, OECD website, Aksesuar më 4.12.2020 https://www.oecd.org/education/Supporting-the-continuation-of-teaching-and-learning-during-the-COVID-19-pandemic.pdf

OECD (2020) A framework to guide an education response to the COVID-19 Pandemic Aksesuar më 6.09.2020 https://www.aforges.org/wp-content/uploads/2020/04/framework.pdf

INSTAT (2020) Databaza Statistikore, INSTAT website, Aksesuar më 2.4.2020 http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/?rxid=a14c7666-af7b-4ad9-a3b6-5a5d03478851

Husmann, D. E. & Miller, M.T. (2001, Spring). Improving Distance Education: Perceptions of Program Administrators.Online Journal of Distance Learning Administration, 4(1).Marrëngahttp://www.westga.edu/~distance/ojdla/spring41/husmann41.htm

Expectations of online courses: The distance Education administrator's perspective. Marrënga: https://www.researchgate.net/publication/251892101_Expectations_of_online_courses_The_distance_Education_administrator's_perspective [Aksesuar më 10 Mars 2021].

Kearsley, G (2002). Is online learning for everybody? *Education Technology, 41(1),* 41-44.

McAlister, M. K., Rivera , J.C., &Hallam, S. F. (2001, Summer). Twelve important questions to answer before you offer a web based curriculum. Online Journal of Distance Learning Administration, 4(2).Marrënga:http://www.westga.edu/~distance/ojdla/summer42/mcalister42.html

Milheim, W. (2001).Faculty and administrative strategies for the effective implementation of distance education.British Journal of Educational Technology, 32(5).

Sherritt, C. (1996). A fundamental problem with distance programs in higher education. (ERIC Document Reproduction Service No. ED389906).

Macdonald, S., & Headlam, N. (2008). *Research Methods Handbook: Introductory Guide to Research Methods for Social Research*. Manchester, London: CLES.

Urdhër Nr.105, datë 24.02.2020, Për marrjen e masave higjeno.sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratorë akute përfshirë edhe Covid 19 në institucionet parashkollore, kopshte dhe çerdhe dhe institucione të tjera arsimore. http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Urdher-105-per-marrjen-masave-higjeno-sanitare-ne-inst-parashkollore-kopshtecerdhe-dhe-inst-aresimore.-u.105.pdf

Urdhër Nr.135, datë 09.03.2020, Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Aksesuar më 12.02.2021 në http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Urdher-135-Per-Mbylljen-e-Instit-Arsimore.pdf

EDUKIMI I INTELIGJENCËS EMOCIONALE TË MËSUESIT PËR KRIJIMIN E NJË KLIME POZITIVE NË KLASË DHE ARRITJE SHKOLLORE

Zhuljeta Lilo
Departamenti i Mësimdhënies, Universiteti 'Eqrem Çabej"
zpcinga@yahoo.com

Abstrakt
Mirëqenia psikologjike e mësuesit është një koncept sa i gjerë, aq dhe kompleks për t'u trajtuar, pasi lidhet më faktorë të ndryshëm personalë dhe profesionalë. Interesi studimor i këtij punimi qëndron në trajtimin e një koncepti psikologjik shumëdimensional për personalitetin dhe mirëqenien psikologjike te mësuesit, atë të inteligjencës emocionale.
*Ka mjaft të dhëna studimore si dhe përvoja profesionale e mësuesve, të cilat i mëshojnë Inteligjencës Emocionale **IE** si një faktor ringritës në suksesin profesional, madje, dhe me të fortë sesa Inteligjenca Konjitive. David MacClelland (1973) mbështeti pikëpamjen se aftësia akademike, gradat në shkollë ose performanca universitare, nuk mund të parashikojnë performancën profesionale. Në të kundërt, një tërësi aftësish, si: iniciativa, empatia dhe vetëdisiplinimi ishin ato që dalluan punonjësit e suksesshëm. Të dhënat studimore tregojnë se inteligjenca emocionale është e lidhur pozitivisht me suksesin profesional. Në veçanti, njerëzit me vetëbesim të lartë, me aftësi adaptuese, njerëzit me empati të lartë, kanë më shumë të ngjarë të jenë të suksesshëm në rrugën e karrierës së tyreprofesionale.*
Fjalët kyçe:*Mirëqenie psikologjike, inteligjencë emocionale, klimë pozitive, motivim, sukses shkollor.*

Abstract
The psychological well-being of the teacher is a concept as broad as it is complex to deal with, as it relates to various personal and professional factors. The research interest of this paper lies in the treatment of a multidimensional psychological concept of personality and psychological well-being of teachers, that of emotional intelligence. The study literature and the professional experience of teachers measure Emotional Intelligence IE as a revitalizing factor in professional success, even stronger than Cognitive Intelligence. David MacClelland (1973) supported the view that academic ability, school degrees, or university performance could not predict professional performance. In contrast, a set of skills, such as initiative, empathy, and self-discipline, were what distinguished successful employees. In particular, people with high self-esteem, adaptive skills, people with high empathy, are more likely to be successful in the path of their professional careers.
Keywords: *Psychological well-being, emotional intelligence, positive climate, motivation, school success.*

1. Hyrje.

Pas botimit të veprave të Goleman (1995-1998) vihet re një interes studimor në rritje rreth Inteligjencës emocionale, sidomos në fushat e mirërritjes së fëmijës, të arsimit dhe zbatimit në profesion. Ai hedh dritë në interpretimin e fenomeneve që deri më sot nuk janë shpjeguar plotësisht.

Me rëndësi është të kuptuarit e inteligjencës emocionale si një koncept shumëdimensional në tërësinë e komponentëve që e përcaktojnë atë dhe në zbatimin praktik shumëplanësh të marrëdhënieve shoqërore.

Inteligjenca e lartë emocionale mund të kontribuojë në një nxënës në procesin e të mësuarit, ndërsa nxënësit me inteligjencën emocionale të ulët mund të gjejnë dështimin, mosbesimin, gjë që dëmton suksesin e tyre akademik (Svetlana, 2007), pasi është konsideruar plotësues në procesin e të mësuarit.

2. Debati studimor rreth inteligjencës emocionale dhe suksesit profesional

Teoritë e interpretimit të inteligjencës emocionale ndahen ne tri kategori. Ato qe përshkruajnë atë si një koncept kompleks që përfshin dimensione të ndryshme të natyrës njerëzore: faktorin konjitiv, personalitetin, sjelljen njerëzore mbi bazën e aftësive emocionale.

- Teoritë e aftësive e konsiderojnë inteligjencës emocionale si një aftësi të trurit që ka ngjashmëri për nga strukturimi me llojet e tjera të inteligjencës, që i referohen kryesisht aftësive njohëse (Teoria e Mayer, Salovey, Caruso).
- Teoritë e fokusuara në personalitet e konceptojnë atë si një kombinim të aftësive përshtatëse të personalitetit (Bar-On).
- Teoritë e rezultatit. Mbështeten në rezultatin dhe efektivitetin në punë mbi bazën e organizimit të personalitetit të individit (Teoria Goleman). Golemane përshkruan si një strukturë që përfshin aftësitë emocionale të nxitjes për arritjen e objektivave dhe këmbënguljen përtej vështirësive, të kontrollit të impulseve dhe të ekuilibrimit të potencialeve të tij përtej vështirësive dhe emocioneve negative, duke i hapur udhë mendimit racional dhe empatisë. Modeli Goleman përbëhet nga 5 dimensione aftësishqë përfshijnë në tërësi 25 aftësi emocionale: 1) dija 2) menaxhimi i emocioneve c) motivimi i vetvetes 4)njohja e emocioneve të të tjerëve 5)administrimi i marrëdhënieve. Sipas modelit Goleman, Inteligjenca emocionale është një strukturë tërësore nga e cila buron kompetenca emocionale, d.m.th., mundësia e dikujt për efektivitet të lartë në veprimtari dhe në jetë.

Debati studimor rreth inteligjencës emocionale shtrohet në lidhje me çështjen nëse suksesi profesional dhe ai akademik i duhet atribuar kryesisht Inteligjencës së përgjithshme konjitive apo Inteligjencës emocionale. Disa studiues (Goleman, Daniel,1998), (Peter; Mayer, John; Caruso, David, 2004) i mëshojnë rëndësisë së edukimit të inteligjencës emocionale për rëndësinë e veçantë në rezultatin profesional dhe aftësi drejtuese. Sipas Goleman,

aftësitë që lidhen me IE-në përbëjnë 67 % të aftësive që konsiderohen të domosdoshme për rezultat prej lidershipi dhe se përbën një koncept të një rëndësie të dyfishtë krahasuar me inteligjencën e përgjithshme IQ.

Studiues të tjerë ndërkohë janë të mendimit se nuk ka të dhëna kërkimore të mjaftueshme rreth inteligjencës emocionale Cavazotte, Flavia; Moreno, Valter; Hickmann, Mateus (2012) dhe të tilla gjetje është e mundur t'i atribuohen më tepër inteligjencës së përgjithshme dhe karakteristikave konkrete të personalitetit sesa inteligjencës emocionale. Harms, P. D.; Credé, M. (2010). Hunt, James; Fitzgerald, Martin (2013).

Debati studimor rreth inteligjencës emocionale përbën një koncept me rëndësi të veçantë në fushën e studimit të Psikologjisë së Edukimit dhe kërkon studime të mëtejshme. Përveç kësaj, ajo që i jep dhe më shumë rëndësi studimore është fakti se të gjithë studiuesit, pavarësisht dilemave, bien dakord për faktin se IE-ja pasqyron aftësi që mund të përfshihen në Inteligjencën e përgjithshme, pasqyron, gjithashtu, empati dhe emocione që përforcojnë të menduarit dhe dinamikën e ndërveprimit social dhe orientojnë drejt suksesit

Në këtë shkrim studimor trajtohet ndikimi i inteligjencës emocionale në krijimin e një klime pozitive në klasë kur një mësues zotëron kompetencë emocionale. Për rrjedhojë, klima pozitive në klasë rrit vetëbesimin dhe nxit motivimin e nxënësit për arritje shkollore.

3. Inteligjenca emocionale e mësuesit, klima pozitive dhe suksesi shkollor

Sipas Goleman Boyatzis (2000), inteligjenca emocionale përbën një aftësi themelore në të ushtruarit e sjelljes drejtuese me efikasitet. Referuar Testit të Kompetencës Emocionale (ECI 360) (Bozatyis, Goleman, & Rhee, 2000), Inteligjenca emocionale për udhëheqje përfshin një sërë aftësish, ndër të cilat, më të rëndësishme janë kompetenca e komunikimit, vetënjohja, vetë-rregullimi, vetëkontrolli, empatia.

Kompetenca e komunikimit. Përbën mjetin kryesor për arritjen e rezultateve të dëshiruara në çdo fushë të veprimtarisë. Është pjesë e domosdoshme e aftësisë për udhëheqje, për të nxjerrë në pah dhe për të ushtruar të gjitha rolet udhëheqëse, për të përçuar mesazhet me sjelljen reaguese më të përshtatshme.

Vetënjohje. Do të thotë aftësi për të njohur vetveten, vlerat dhe parimet për të arritur objektivat në jetë. Është aftësia për të kuptuar dikush emocionet e tij, pozitive dhe negative, pikat e tij të forta dhe të dobëta. Është e rëndësishme për vetëpërmirësim dhe vetefikasitet në arritje. Aftësia udhëheqëse fillon me njohjen e mirë të vetvetes dhe përfundon me njohjen e tjetrit.

Empatia është aftësia për t'u vendosur në rolin e tjetrit dhe për të kuptuar emocionet e tjetrit, nevojat dhe karakteristikat e tjetrit dhe për t'i menaxhuar ato. Një udhëheqës që zotëron këto aftësi në planin tredimensional: punë, mirëqenie personale dhe mirëqenie e të tjerëve, plotëson kushtet e një

udhëheqësi ideal për të sfiduar pasiguritë në një epokë të ndryshimeve të vazhdueshme.

Stilet e drejtimit për një klimë pozitive

Sipas Evansit (1999), drejtuesit inovatorë që duan të drejtojnë veten drejt ndryshimit dhe nëpunësit e tyre drejt suksesit, duhet të jenë emocionalisht inteligjentë. Bennis (1989) beson se IE është përgjegjëse për gati 85% - 90% të suksesit të drejtuesve.

Sipas Goleman, një udhëheqës me kompetence të lartë emocionale duhet të zotërojë një gamë të gjerë aftësish për t'u orientuar drejt suksesit. Për këtë Goleman u referohet 6 stileve :Imponuesi (coercive), vizionari, humanisti (affiliative), demokrati, udhëheqësi (paesetting), dhe këshilluesi (coaching). Stilet e drejtimit lidhen me IE-në,

Mësuesit, drejtues të suksesshëm dhe karizmatik nuk përdorin vetëm njërin nga këto stile, por zotërojnë elasticitet dhe këmbejnë stilet në varësi të nevojave që lindin në klasë. Ata që zotërojnë 4 nga 6 stilet dhe kryesisht stilin oramatik, demokratik, human (Matsagouras, 2000) janë modeli i mësuesit ideal, i cili krijon një atmosferë dashurie, pranimi dhe siguriepër të gjithë nxënësit. Çdo nxënës ndihet i dashur dhe i pranuar kryesisht nga mësuesi dhe më tej nga shokët e tyre të klasës, i sigurt, pavarësisht një qëndrimi të mundshëm negativ i disave. Në këtë rast nxënësi nuk heziton të jetë prezent plotësisht në procesin mësimor, nuk sfidohet nga refuzimi për gabime të mundshme dhe dështime (Matsagouras, 2000). Ai respekton pikat e forta dhe të dobëta të shokëve të tij të klasës, pranon diversitetin dhe njeh personalitetin e tyre, merr pjesë dhe bashkëpunon me ta në një larmi situatash mësimore dhe aktivitetesh shkollore.

Inteligjenca emocionale kultivohet në një mjedis me një klimë pozitive, pasi ajo nuk varet vetëm nga karakteristikat e personalitetit të individit, por zhvillohet njëherazi edhe përmes përvojave pozitive të fituara nga mjedisi. (Wong & Law, 2002; Kunnanat, 2004).

Në një nga kërkimet studimore në Kaliforni, 2008, "Marrëdhëniet midis inteligjencës emocionale dhe arritjet akademike të nxënësve në shkollën fillore", Barbara A. Fatum sugjeroi se fëmijët që kanë aftësi të forta të zhvilluara të inteligjencës emocionale kanë më shumë mundësi që të përjetojnë jetën, kënaqësinë dhe lumturinë me miqtë dhe familjen (Fatum, 2008). Studim ky që pohoi se ambienti i shëndetshëm në klasë mund të motivojë fëmijët për të ndërtuar vetëdije emocionale dhe për të menaxhuar emocionet pozitive dhe negative.

Në një kërkim tjetër studimor (A.Metaj Maculaj), ku synohej identifikimi i raportit në mes të inteligjencës emocionale dhe dimensioneve të saj me ndërveprimin social si dhe përmasa e ndikimit të ndërveprimit social në inteligjencën emocionale, studim ky i realizuar me 525 studentë, u arrit në përfundimin se inteligjenca emocionale ka ndërlidhje me rrafshin social, edukimin personal dhe ndërpersonal (Metaj, 2017).

Studimet e kryera rreth inteligjencës emocionale në udhëheqje dhe në drejtimin e mësimdhënies tregojnë se edukimi dhe kultivimi i inteligjencës emocionale sjell ndryshime të rëndësishme në rezultatin e individit (Dulewicz & Higgs, 1999). Inteligjenca e lartë emocionale mund të kontribuojë në një nxënës në procesin e të mësuarit, ndërsa nxënësit me inteligjencën emocionale të ulët mund të gjejnë dështimin, mosbesimin, gjë që dëmton suksesin e tyre akademik (Svetlana, 2007), pasi është konsideruar plotësuese në procesin e të mësuarit.

4. Përfundime

Nga shqyrtimi i literaturës studimore vihet re një interes i dukshëm studimor rreth inteligjencës emocionale dhe rëndësisë së edukimit të saj për sukses në jetë dhe në profesion. Më të pakta janë studimet rreth inteligjencës emocionale të mësuesve dhe suksesit të tyre akademik.

Edhe pse Inteligjenca emocionale ende nuk e ka fituar statusin e saj si komponent shkencor i pavarur, sikundër personaliteti dhe Inteligjenca konjitive, studimet tregojnë rëndësinë e edukimit të saj në arritje profesionale, akademike dhe punën në grup.

Megjithëse pas botimit të veprës së Goleman ende nuk është zgjidhur debati i ndezur studimor rreth nivelit te ndikimit të inteligjencës emocionale përtej asaj konjitive, rezultatet kërkimore tregojnë se Inteligjenca emocionale është faktor tejet i rëndësishëm në arritjet, suksesin dhe zhvilliminenxënësve.

Sie tillëmeritontëvlerësohetdhenjëkohësishttëtrajtohetnëmënyrënmëtëmirëtëmundshme duke marrëpërbazërëndësinëdhendikimin e drejtpërdrejtënësuksesin e secilit (Dulewicz& Higgs, 1999).

Pavarësisht rasteve studimore të pakta rreth inteligjencës emocionale dhe suksesit akademik, është i dukshëm interesi studimor dhe rëndësia e edukimit të inteligjencës emocionale në shkollë. Sipas (Matsagouras, 2000), një mësues me inteligjencë emocionale në aftësi drejtuese zotëron kompetencën e krijimit të një klime pozitive mësimore, e cila më tej krijon dhe kultivon përvoja pozitive të edukimit emocional, social, ndërpersonal. (Wong & Law, 2002; Kunnanat, 2004), (Metaj 2017) dhe krijon premisat për të nxitur dhe motivuar suksesin akademik(Svetlana, 2007).

Studimet shkencore dhe kërkimore tregojnë se Inteligjenca konjitive është e rëndësishme për dijen, por kur kësaj të fundit i bashkëngjitet dhe inteligjenca emocionale, dyfishohetrëndësiadhendikiminë aftësi social-emocionale dhe arritja akademike fuqizohet.

Studiuesit i mëshojnë rëndësisë së edukimit të inteligjencës emocionale në shkollë jo vetëm të mësuesve, por edhe të nxënësve, si një pretendim me prioritet të lartë për mirëqenie psikologjike dhe social-emocionale.

5. Literatura

Ashkanasy, N.M. &Dasborough (2003).Emotional Awareness and emotionalintelligence in leadershipteaching. Journal of Education for Business

Boyatzis, R.E., Goleman, D & Rhee, K.S. (2000).Clustering competence in emotional intelligence.*The Handbook of Emotional Intelligence*.

Barchard, K.A. (2003) Does emotional entelligence assist in the prediction of academic success?Educational and Psychological Measurement.

Bennis, W. (1989). On becoming a leader , Addison-Wesley

Caruso, D.R.&Salovery, P (2004)The emotionally intelligent manager: how to develop and use the four key emotional skills of leadership.

Goleman, D. (1998) Goleman, D. (1998). Working With Emotional Intelligence. New York, NY. Bantum Books Goleman, D. (2000) Leadership that gets results. Harvard Business Review, March-April, 78-90

Goleman, Daniel (1998), *What Makes a Leader?*, Harvard Business Review

Goleman, D. (1998). Working With Emotional Intelligence. New York, NY. Bantum Books

Humpfrey, N., Curran, A., Morris ect. (2007) Emotion intelligence and education. A critical rewiew

Harms, P. D.; Credé, M. (2010). «Remaining Issues in Emotional Intelligence Research: Construct Overlap, Method Artifacts, and Lack of Incremental Validity». *Industrial and Organizational Psychology: Perspectives on Science and Practice* **3**(2): 154–158.

Hunt, James; Fitzgerald, Martin (2013). «The relationship between emotional intelligence and transformational leadership: An investigation and review of competing claims in the literature». *American International Journal of Social Science***2** (8): 30–38.

Salovey, Peter; Mayer, John; Caruso, David (2004), «Emotional Intelligence: Theory, Findings, and Implications», *Psychological Inquiry*: 197–215

Ματσαγγούρας, Η. (2003α). Η Σχολική Τάξη. Χώρος – Ομάδα – Πειθαρχία - Μέθοδος. Αθήνα: Γρηγόρης

Mazer, J.D. &Salovery, P. (1993). The intelligence of emotional intelligence.

Wong, C.S., Wong, P.M., & Law, S.K. (2002). The interaction effect of emotional intelligence and emotional labour on job satisfaction: A test of Holland's classification of occupations in Hong Kong. Paper presented at the third international conference on Emotions and Organizational Life. Gold Coast, Queensland, Australia

https://www.umib.net/wp-content/uploads/2020/01/kumrije-smajli.pdf

https://dione.lib.unipi.gr/xmlui/handle/unipi/4453
https://dione.lib.unipi.gr/xmlui/handle/unipi/4453
https://core.ac.uk/download/pdf/132805643.pdf

NDIKIMI I EKSODEVE TË BRENDSHME RURALE TE PERCEPTIMET E TË RINJVE

Denada Quku
Departamenti i Sociologjisë, Universiteti "Aleksandër Moisiu"
denada.quku@hotmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi synon të hulumtojë e të nxjerrë në pah disa elemente e faktorë të rëndësishëm, lidhur me një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, sikundër është fenomeni i migracionit i pas viteve '90 - të drejt zonave urbane brenda dhe jashtë shtetit. Kjo mbetet një lëvizje e pazakontë demografike në llojin e saj, për përmasat dhe gjithëpërfshirjen e të gjitha shtresave dhe grupmoshave të popullsisë, e cila, doemos, që pati dhe ndikime jo të pakta në marrëdhëniet tona shoqërore, të cilat e kaluan jo lehtë edhe këtë sprovë të vështirë, e cila, jo rrallëherë u shoqërua me fenomene e incidente joindiferente. Të dy grupet shoqërore, migruesit dhe vendasit, u përballën me një sërë sfidash e problematikash, të cilat ishin në njëfarë mënyre edhe pasqyrim i problematikave sa individuale, aq edhe që vinin si përplasje mentalitetesh e kulturash, të ndikuara nga ambienti ekonomik dhe diferencat etnokulturore që kishin. Lëvizja e njerëzve ka pasur tipare kaotike, duke funksionuar si e parregullt dhe e paregjistruar korrektësisht nga ana e organeve shtetërore përkatëse.Në përfundimet e veta, studimi synon të sjellë konkluzione e rekomandime rreth këtij realiteti të mprehtë që vjen i pranishëm deri në ditët e sotme.

Fjale kyçe: *Migrim, vend origjine, vend pritës, eksolokalizimit, ekonomi, politike, demografi*

Abstract

The purpose of this study is to investigate and highlight some important elements and factors, related to one of the most important events in the history of the Albanian nation, such as the phenomenon of migration after the '90s - to urban areas within and abroad. This remains an unusual demographic movement of its kind, for the size and inclusion of all social strata and age groups of the population, which influenced on our social relations. They passed this difficult test not easily, which frequently was accompanied by noticeable phenomena and incidents. Both social groups: migrants and locals, faced a series of challenges and problems, which were a sort of reflection of individual problems, as well as coming as a clash of mentalities and cultures, influenced by the economic environment and ethnocultural differences that they had. The movement of people had chaotic features, functioning as irregular and incorrectly registered by the

relevant state bodies. In this study were used descriptive methods, literature study and collection of facts from various sources. At the end, the study aims to bring conclusions and recommendations about this acute reality that is present to this day.

Keywords: *Migration, country of origin, host country, exocalization, economy, politics, demographics*

1. Vështrim i përgjithshëm

Eksodi rural përfaqëson faktin demografik dhe shoqëror më të rëndësishëm të periudhës së ribërjes së zonave rurale dhe urbane të Shqipërisë. Ai ka shumë përmasa dhe paraqet një shumësi formash të ndryshueshme nga një krahinë në tjetrën. Ai ka vënë në veprim dinamika shoqërore tepër domethënëse, pa të cilat është shumë e vështirë të kuptohet Shqipëria e sotme. Shumë pasoja shoqërore dhe kulturore kanë dalë në pah nga kjo zhvendosje masive e popullsisë në zona ku ajo nuk ka banuar më parë.

Faktorët kryesorë që kanë bërë të lindë dukuria e eksodit të përgjithshëm rural janë të lidhur me hapjen e Shqipërisë pas rënies së regjimit komunist.(Lika,2016)

Sipas analistit Hoti (2000) përgjatë periudhës socialiste ndodhi një proces i ngjashëm që solli zhvendosje, gjithashtu, masive të popullsisë fshatare drejt qyteteve. Kjo ndodhi kryesisht përgjatë viteve ’50 dhe ’60 të shekullit të kaluar. Më pas, ky proces vazhdoi në mënyrë shumë të dobët, sepse politika zyrtare kërkonte ta pengonte popullimin masiv të qyteteve dhe zbrazjen po ashtu masive të fshatrave. Kjo gjendje ndryshoi rrënjësisht pas hyrjes në fuqi të kuadrit ligjor demokratik, i cili parashikonte ndërmjet të tjerash, një tërësi të drejtash individuale për ta zgjedhur lirisht profesionin, vendin e punës dhe të banimit.(Hoti,2020)

Pikërisht ky kuadër i ri ligjor krijoi kushte për një ribërje demografike të qyteteve dhe fshatrave të Shqipërisë. Por nuk duhet harruar të theksojmë se prania e eksodit rural masiv në Shqipëri shpjegohet edhe me arsye të tjera, veç atyre që kanë të bëjnë me demokratizimin politik të vendit.

Për të kuptuar saktë dhe drejt eksodin rural shqiptar, i cili ka ndodhur: si pasojë e hapjes së brendshme (hapja administrative dhe shoqërore e fshatrave drejt qyteteve) dhe si pasojë e hapjes së jashtme (hapja ekonomike, shoqërore dhe politike e shoqërisë shqiptare drejt botës), duhet të sqarohet fillimisht dallimi midis dy koncepteve:

1.Konceptit të eksodit që paraqet prirjen e zhvendosjes të një pjese të madhe të popullsisë qytetare apo fshatare drejt zonave të reja të banimit apo të punësimit.

2.Konceptit të eksodit rural që shënon në mënyrë të spikatur zhvendosjen e një pjese të konsiderueshme të popullsisë fshatare drejt hapësirave të tjera të urbanizuara.

Këto dy prirje kanë të përbashkëta në shumë aspekte, por ato shprehin edhe dallime të rëndësishme midis tyre. Vlen të nënvizohet fakti se veçanërisht popullsia e zonave të mëdha urbane orientohet kryesisht drejt një emigrimi të jashtëm. Në të kundërt, eksodi rural orientohet njëherësh edhe jashtë vendit dhe drejt krahinave të tjera të Shqipërisë. Në këtë rast të fundit, popullsia zhvendoset kryesisht nga veriu drejt jugut, nga fshatrat drejt qyteteve, nga zonat malore drejt fushave, nga krahinat me një klimë më të ashpër dhe më të ftohtë drejt krahinave me kushte klimaterike më të pranueshme. Në këtë kuadër, mund të thuhet se ka zona rurale që po boshatisen krejt nga popullsia e tyre, por ka edhe krahina ku popullsia zëvendësohet me të sapoardhurit rishtas nga zona më të varfra dhe më të prapambetura.(Fuga,200)

2. Prezantimi i problemit

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka përjetuar një ndryshim të dukshëm të popullsisë. Jo vetëm që popullsia banuese ka pësuar rënie nga 3.182.417 në vitin 1989 në 2.800.138 në vitin 2011, por një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka lëvizur brenda Shqipërisë. Krahasuar me një dekadë më parë, 10 për qind e popullsisë jeton tashmë në një qytet apo fshat tjetër. Ashtu siç ndodh zakonisht me migracionin, disa grupe të shoqërisë kanë prirje më të madhe për të lëvizur duke dhënë një impakt me efekte që kanë shtrirje të gjerë në përbërjen e popullsisë në zona të ndryshme të Shqipërisë. Ashtu si në vende të tjera me të ardhura të mesme, migracioni i brendshëm në Shqipëri është më së shumti sinonim i urbanizimit. Pjesa më e madhe e njerëzve që kanë ndryshuar vendbanimin në dy dekadat e fundit kanë lëvizur në qendrat urbane, që në shumicën e rasteve, përfshin kryeqytetin, Tiranën ose zonat përreth.(INSTAT, 2014) Në periudhën 2001-2011, 228.952 individë që jetonin në Shqipëri kanë ndryshuar qarkun e vendbanimit të zakonshëm: këta migrantë përbëjnë 8 për qind të popullsisë banuese në vitin 2011. Lëvizjet në nivel qyteti dhe fshati, në të njëjtën periudhë shënojnë një shifër prej 280.863 individësh. Thuajse, gjysma e këtyre migrantëve të brendshëm janë rivendosur në qarkun e Tiranës, më saktë në Tiranën suburbane. Kështu, gjatë periudhës 2001-2011, mbi 112.000 individë janë vendosur në qarkun e Tiranës. (IBID)

3. Qëllimi

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë se si ndikon ky migrim te të rinjtë migrues në qytet, sfidat me të cilat ato përballen dhe këndvështrimet e tyre në lidhje me qytetin dhe jetën aty, sepse fenomeni i migracionit është një dukuri e krijuar prej disa rrethanash të natyrës ekonomike, sociale, psikologjike, kulturore dhe që njëkohësisht shoqërohet me një mori gjurmësh e ndikimesh që migranti lë apo fiton, si në vendin pritës, ashtu edhe në vendin e origjinës.

4. Objektivat

Objektivat e ngritura në këtë studim kanë për qëllim:

- Të përshkruaj vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë migrues në qytet në lidhje me kulturën, format e sjelljes, ndërveprimet me të tjerët.
- Të analizoj dallimet kulturore dhe vështirësitë fillestare të përshtatjes.
- Të krahasoj perceptimet e tyre dhe të vendasve në lidhje me kulturën, format e sjelljes, ndërveprimet me të tjerët.

5. Pyetjet kërkimore

- Cilat janë vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë migrues sot?
- Si ndikojnë dallimet kulturore përgjatë procesit të përshtatjes?
- Të krahasoj perceptimet e të rinjve vendas dhe migrues në lidhje me kulturën, sjelljen dhe ndërveprimet me njëri – tjetrin

6. Rëndësia e punimit

Qëllimi i këtij studimi synon të hulumtojë e të nxjerrë në pah disa elemente e faktorë të rëndësishëm, lidhur me një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, sikundër është fenomeni i migracionit i pas viteve ’90 - të drejt zonave urbane brenda dhe jashtë shtetit.

Të jetosh në fshat dhe të ushtrosh zanatin e bujkut apo të blegtorit quhet tashmë diçka krejt e papërshtatshme dhe që nuk përputhet asfare me dëshirat e të rinjve për një jetë qytetare. Fshati, zanatet rurale iu sjellin në kujtesë fjalën “fshatar”, që në sytë e një opinioni të caktuar meskin është sinonim i dikujt që bën një jetë të mbyllur brenda sinorëve të fshatit dhe jeton duke pasur statusin e një shtetasi të dorës së dytë. Për më tepër, informacionet televizive dhe kultura e marrë direkt nga ndjekja e emisioneve të radiove dhe stacioneve televizive të huaja apo shqiptare, të bazuara në përfytyrime fantaziste mbi shoqërinë e konsumit, i bën ata që ta kenë disi për turp të vazhdojnë të mbeten në kontakt të përditshëm dhe të drejtpërdrejtë me tokën, me kafshët e punës, me blegtorinë dhe të punojnë fizikisht në mënyrë të sforcuar.

Ky punim ka për qëllim të hedh dritë mbi rëndësinë e punëve, aktiviteteve dhe turizmit të ndryshëm që duhet ta shfrytëzojmë në zonat rurale dhe të tregojmë sesa e rëndësishme është të ruhen kultura, traditat, zakonet e këtyre zonave, si edhe të nxitet më tepër ruajtja e këtyre traditave.

7. Historik i shkurtër i eksodit rural shqiptar

Eksodi rural është i pranishëm në shoqërinë shqiptare prej një kohe të largët. Ai ka shoqëruar të gjithë historinë e vendit pas Shpalljes së Pavarësisë në vitin 1912. Dy periudha historike kryesore janë karakterizuar prej një eksodi rural shumë masiv dhe të shpejtë.

Gjatë gjithë historisë së tij, eksodi rural ka përbërë jo vetëm një dukuri të thjeshtë shoqërore dhe ekonomike, por ai ka luajtur një rol të veçantë në ribërjen e vazhdueshme të jetës politike shqiptare dhe në orientimin politik të vendit, duke ndjekur në përgjithësi ngjarjet dhe proceset e mëdha politike që e kanë transformuar rrënjësisht historinë e vendit, për mirë apo për keq

qofshin ato, por edhe pa menduar se është eksodi rural që i ka sjellë ndryshimet politike në historinë shqiptare. Migrimi paraqet një strategji diversifikimi dhe lëvizshmëria e banorëve rurale është shpjeguar shpesh si rezultat i faktorëve shtytës dhe i faktorëve tërheqës. Faktorët shtytës i referohen faktorëve të cilët nxisin dhe shkaktojnë dëshpërim dhe migrim të pavullnetshëm, për shembull, mungesa e tokës, ndërkohë që faktorët tërheqës i referohen atyre faktorëve që shkaktojnë migrimin e vullnetshëm, për shembull, pagat e larta në zonat urbane.(Biçoku,2018)

Ajo që mund të thuhet specifikisht lidhur me raportin eksod rural – politikë, është se në një farë mënyre, kjo popullsi rurale apo disi periferike në krahasim me zonat urbane kryesore merr në dorë çështjet politike dhe ekonomike të qyteteve, pra, të të gjithë kombit, ndërkohë që popullsia qytetare detyrohet të marrë një farë largësie prej jetës politike dhe shoqërore të bashkësisë politike kombëtare. Megjithatë, ajo vazhdon të ruajë në çdo rast dhe kurdoherë përparësitë arsimore dhe mbizotërimin e saj kulturor.

7.1. Periudha e parë

Periudha e parë e eksodit rural fillon me ardhjen e komunistëve në pushtet në vitin 1944, e cila vazhdon deri në vitet ’60. Gjatë kësaj kohe Shqipëria njohu reformën agrare të vitit 1946 dhe nisjen e procesit të industrializimit të zonës urbane të vendit. Në këtë kohë filloi të zhbëhej simbolika zyrtare e qytetit, si sundues në politikë dhe ekonomi. Për qëllimet e saj, politika zyrtare aktivizoi dhe përfshiu një popullsi rurale masive në jetën politike të vendit. Fshatarët që zbresin nëpër qytete menjëherë pas çlirimit të vendit nuk janë vetëm bartësit dhe përkrahësit e një lëvizjeje të re politike, por fillojnë të bëhen edhe aktorë të rëndësishëm të jetës së re ekonomike të vendit. Ata arrijnë në qytete si nëpunës të shtetit të ri, si ushtarakë, por edhe si krah pune i rëndësishëm që do të bënte të mundur procesin e industrializimit.

Për të paraqitur gjerësinë e këtij eksodi rural në kohën për të cilën po flasim, mund të jepen disa shifra. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1923, popullsia shqiptare përfaqësonte 676 000 vetë, ndërsa popullsia urbane përbëhej prej 128 000 vetash. Pra, afërsisht vetëm një ndër shtatë shqiptarë ishte qytetar. Ndërkohë, pas tridhjetë viteve transformimesh socialiste në Shqipëri, në 1974, situata kishte ndryshuar rrënjësisht. Në këtë kohë, popullsia shqiptare numëronte 1 456 000, ndërsa popullsia qytetare kishte kapur shifrën prej 680 000 vetash. Prandaj, mund të thuhet se në këtë kohë ishte arritur që afërsisht një ndër dy ose tre shqiptarë të ishte qytetar.

Kjo prurje masive e popullsisë rurale në qytete përfaqësonte në fakt një nga bazat shoqërore themelore të regjimit të ri politik komunist.

Fshatarët të transformuar papritmas në punëtorë të sektorit të industrisë kishin rroga të vogla. Kushtet e tyre të punës ishin të vështira. Të drejtat e tyre individuale ishin pothuajse të papërfillshme, krejt formale dhe jashtëzakonisht të kufizuara. Sidoqoftë, në mënyrë krejt paradoksale, mbështetja që ata i bënin regjimit ishte jo e pakët deri aty nga vitet ’70 të shekullit të kaluar.

Kjo mbështetje masive nga ana e popullsisë rurale të zhvendosura nëpër qytete e lejonte regjimin të zbatonte një politikë autoritare dhe izoluese, duke forcuar kontrollin e fuqishëm politik dhe administrativ të tij mbi të gjithë shoqërinë shqiptare. Radhët e nëpunësve të administratës shtetërore ishin mbushur e përmbytur me lloj – lloj nëpunësish të vegjël e të mesëm me origjinë fshatare, të cilët sillnin në mënyrën e funksionimit të shtetit mentalitetin e tyre tradicional të ushqyer paraprakisht nga një mjedis familjar patriarkal e autoritar dhe në kushtet e një jete rurale spartane.

Të sapoardhurit nëpër qytete nuk i trembeshin vështirësive të jetës, privimeve të ndryshme materiale dhe nuk kishin ndonjë pakënaqësi të shprehur thekshëm për shkallën e respektimit të të drejtave të tyre. Përkundrazi, nga pikëpamje shoqërore ata mund të ndjeheshin të lumtur. Ata tashmë jetonin në banesa qytetare të sapondërtuara pasi kishin braktisur shtëpitë e tyre të vogla të fshatit, shpeshherë të ndërtuara vetëm me qerpiç, me baltë dhe me kashtë. Rrjeti i zgjeruar i shërbimit mjekësor siguronte për ata të paktën një nivel fillestar përkujdesjeje, të cilin tradicionalisht nuk kishin pasur mundësi ta përfitonin në fshat. Ata punonin në mjedise të mbyllura, të mbrojtura nga pasojat e motit. Tani ata mund të mësonin zanate të reja që kurrë më parë nuk ishin njohur në trevat shqiptare as në qytete, as në fusha dhe as në malësi. Ata tashmë bënin një jetë profesionale kolektive dhe për herë të parë në jetën e tyre mund të punonin pranë e pranë gjatë orarit të punës me individë të seksit tjetër, burra e gra, krejt të huaj e të panjohur më parë. Zakonet e tyre morale kishin filluar të liberalizoheshin në mënyrë jashtëzakonisht të shpejtë.

Këto, pra, ishin pak a shumë rrethanat që shkaktuan eksodin rural midis viteve ’40 dhe ’60 në Shqipëri, të cilat kishin shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur këto arsye:

- Dëshira e fshatarëve për të thyer marrëdhëniet e vjetra midis fshatit dhe qytetit, ku fshatarët mbaheshin në një gjendje tepër inferiore.
- Dëshira e fshatarëve për zhvillim, mirëqenie, dinjitet, shkollim dhe kulturë.
- Ideja e pronës së përbashkët mbi mjetet e prodhimit, e barazisë ekonomike dhe shoqërore dhe e luftës kundër shfrytëzimit ekonomik të njeriut nga njeriu.(Fuga,2000)

7.2. Periudha e dytë

Periudha e dytë e eksodit rural fillon me lëvizjet demokratike të dhjetorit 1990 dhe vazhdon prej më shumë se një dekade, duke e transformuar Shqipërinë nga një vend komunist, në një shoqëri të themeluar mbi pronën private, ekonominë e tregut dhe demokracinë parlamentare. Duke filluar nga fillimi i viteve ’90, një tjetër eksod masiv fillon ta zhvendosë popullsinë fshatare drejt qyteteve. Sipas statistikave zyrtare të vitit 1996, popullsia e zonave rurale në Shqipëri ishte e përbërë prej 1,838,000 vetash, ndërkohë që në qytete jetonte një popullsi prej 1,445,000 vetash.(INSTAT,1997)

Gjatë viteve në vazhdim, këto shifra janë ekuilibruar akoma më shumë, saqë të bën të mendosh se aktualisht në Shqipërinë e sotme vetëm gjysma e popullsisë jeton në zonën rurale, kurse gjysma tjetër jeton nëpër qytete. Për të matur shkallën e lartë të kësaj ikjeje nga zonat rurale drejt atyre urbane, mjafton të thuhet se vetëm Tirana e ka zmadhuar mbi dy herë numrin e popullsisë së saj në krahasim me atë që ajo ka pasur në vitet '80. (Misja, V. Vejsiu, Y. & Bërxholi, A. 1987:5).

Një studim sociologjik i kryer aty nga vitet 1995 – 1997 në Shqipëri ka treguar rëndësinë dhe përmasat e gjëra të këtij eksodi rural. Po japim dy shembuj ilustrues:

- Komuna e Ndroqit, rreth 20 km larg Tiranës: përgjatë pesëdhjetë vjetëve të periudhës socialiste, afërsisht 200 familje ishin larguar nga kjo zonë për të shkuar me banim gjetiu, veçanërisht në Tiranë dhe në Durrës. Kurse, vetëm në periudhën 1991 – 1997, rreth 95 familje kishin braktisur fshatrat e kësaj komune për të shkuar drejt zonave urbane. Ndërkaq, në territorin e saj kanë mbërritur përgjatë së njëjtës periudhë afërsisht 90 familje të tjera, të cilat kanë zënë vendin e lënë bosh nga familjet e ikura.
- Komuna e Udenishtit, në bregun perëndimor të liqenit të Pogradecit: në kohën kur bëhej studimi në fjalë, ajo kishte 13,456 banorë (1997). Përgjatë periudhës socialiste, afërsisht 50 familje ishin larguar nga kjo zonë për të shkuar me banim në qytet. Kurse, vetëm në periudhën 1991 – 1997, rreth 178 familje kishin lënë komunën për të shkuar përfundimisht në qytet. Edhe këtu, sikurse në Ndroq, ka ndodhur dukuria e zëvendësimit demografik. Në territorin e saj kanë mbërritur brenda së njëjtës periudhë 368 familje të reja, të zbritura nga zonat malore të vendit.

Sondazhet dhe opinionet kanë treguar se eksodi rural mbahet gjallë kryesisht nga të rinjtë e zonave rurale, sepse ata dëshirojnë të ikin nga fshati për në qytete brenda ose jashtë vendit. Ky lloj eksodi rural zhvillohet brenda një strategjie të quajtur *eksolokalizim*.(Fuga, Dervishi, dhe Gjoka (1998).

8. Faktorët qe nxisin eksodin rural

Fenomene të tilla si eksodi i brendshëm rural (migrimi) i dekadës së fundit, lëvizja e brendshme e popullsisë, gjendja e tregut të punës, kanë një impakt të madh në jetën e grave dhe burrave, në problemet e pabarazisë dhe të situatës së nivelit të jetesës.

Veçanërisht për brezat e rinj, të jetosh në fshat dhe të ushtrosh zanatin e bujkut apo të blegtorit quhet tashmë diçka krejt e papërshtatshme dhe që nuk përputhet asfare me dëshirat e tyre për një jetë qytetare.

Fshati, zanatet rurale, iu sjellin në kujtesë fjalën "fshatar", që në sytë e një opinioni të caktuar meskin është sinonim i dikujt që bën një jetë të mbyllur brenda sinorëve të fshatit dhe jeton duke pasur statusin e një shtetasi të dorës së dytë. Për më tepër, informacionet televizive dhe kultura e marrë direkt nga ndjekja e emisioneve të radiove dhe stacioneve televizive të huaja apo shqiptare, të bazuara në përfytyrime fantaziste mbi shoqërinë e konsumit, i bën ata që ta kenë disi për turp të vazhdojnë të mbeten në kontakt të

përditshëm dhe të drejtpërdrejtë me tokën, me kafshët e punës, me blegtorinë dhe të punojnë fizikisht në mënyrë të sforcuar. Sipas Azizaj(2019) për më tepër, për ta, zanatet e bujkut dhe të blegtorit të ushtruara brenda gjirit të ekonomisë familjare nuk janë veprimtari të paguara me rrogë ose me të ardhura të tjera që shpërblejnë punën personale. Pra, të rinjtë me banim në fshatra, veten e tyre e quajnë të papunë dhe midis një papunësie në fshatin e tyre të lindjes dhe një papunësie në qytete, ata zgjedhin të dytën.(Azizaj,2029)

Porse ikja drejt qytetit ka vështirësitë e saj, të cilat brezat e popullsisë rurale me moshë midis 30 dhe 50 vjeçve janë gati përgjithësisht t'i përballojnë. Ata pranojnë çdo çmim: humbjen e traditave të tyre kulturore, jetën e vështirë në periferitë e pista dhe të varfra të qyteteve të mëdha, papunësinë, thuajse, të përhershme etj.

Më në fund, do të jetojnë larg baltës, larg izolimit rural, larg harresës dhe braktisjes nga ana e shtetit. Më në fund, fëmijët e tyre do të kenë mundësi të shkollohen në qytete dhe të përfitojnë nga shërbimet publike.

Ashtu sikurse komunizmi për brezat e popullsisë rurale përgjatë viteve '40 - '60 përfaqësonte realisht një mundësi vajtjeje në qytet, po ashtu demokracia për ta është në radhë të parë sinonim i një mundësie të re për të shkuar në qytet, duke menduar më shumë për fatin e fëmijëve të tyre, sepse, ajo që ka vlerë në fund të fundit, është se fëmijët e tyre do të jetojnë në qytet, ajo që në fakt i shqetëson më tepër është fati i fëmijëve, i së ardhmes së tyre.(Fuga,2000)

9. Gjetje dhe përfundime

Ky kërkim nxori në pah që veçanërisht për brezat e rinj, të jetosh në fshat dhe të ushtrosh zanatin e bujkut apo të blegtorit quhet tashmë diçka krejt e papërshtatshme dhe që nuk përputhet asfare me dëshirat e tyre për një jetë qytetare. Fshati, zanatet rurale, iu sjellin në kujtesë fjalën "fshatar", që në sytë e një opinioni të caktuar meskin është sinonim i dikujt që bën një jetë të mbyllur brenda sinorëve të fshatit dhe jeton duke pasur statusin e një shtetasi të dorës së dytë. Për më tepër, informacionet televizive dhe kultura e marrë direkt nga ndjekja e emisioneve të radiove dhe stacioneve televizive të huaja apo shqiptare, të bazuara në përfytyrime fantaziste mbi shoqërinë e konsumit, i bën ata që ta kenë disi për turp të vazhdojnë të mbeten në kontakt të përditshëm dhe të drejtpërdrejtë me tokën, me kafshët e punës, me blegtorinë dhe të punojnë fizikisht në mënyrë të sforcuar.

Të rinjtë e zonave rurale në momentin që vijnë në qytet përballen dhe me problematika të ndryshme,si: vështirësi ekonomike, përshtatje kulturore me vendasit, përballen, madje, dhe me nofka bullizuese të ndryshme. Të ikurit nga fshati sjell dhe problematika të ndryshme, si: ulje të prodhimeve vendase, zhvlerësim dhe humbje të ngadaltë të zakoneve kulturore dhe të larmishme që ka vendi ynë. Nga ana tjetër, kemi një ndërgjegjësim të të rinjve për të ndjekur arsimin e lartë, por duke projektuar një brez i cili

kontributin e tij dëshiron ta japë jashtë Shqipërisë, sepse e ka gati të pamundur ta gjejë veten e tij jo vetëm në fshat, po as edhe në qytet.

Trajtimi i kësaj teme ka rëndësi të veçantë për hartuesit e politikave dhe për hulumtues të disiplinave të ndryshme. Ato mund të përdoren për të kuptuar se si duhet të punohet për zbutjen e pabarazisë shoqërore, si mund të investohet në infrastrukturën e shërbimeve në zonat rurale të origjinës dhe në zonat urbane periferike ku vendosen të porsaardhurit, se si munden autoritetet lokale për të hartuar politika të veçanta punësimi për grupet në nevojë, si dhe për kategoritë e pakualifikuara. Duke qenë që ne jemi një vend bujqësor dhe blegtoral, t'u japin mundësi fshatarëve të zonave të ndryshme të zhvillojnë ekonominë e tyre, sepse ne jemi një vend që kemi 300 ditë me diell dhe kjo bën të mundur rritjen e shumë bimëve të ndryshme, kryesisht medicinale dhe relievi ynë është i përshtatshëm për turizëm të larmishëm.

Bibliografia

Azizaj.E (2029). "A reflection on the rural exodus in Albania".Marrë nga: https://idmalbania.org/reflection-on-rural-exodus-albania/?fbclid=IwAR02SpAU_IPN0NUtH7iZRTd5_jNIqMouqxwTQZ7ZQdWDAr8JH_MaVlh-1pw

Biçoku.J(2018).Migrimi Rural – Urban i Punës në Qarkun e Elbasanit. Marrë nga: http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/07/Jonida-Bicoku-Migrimi-Urban-rural-i-punes-ne-Qarkun-e-Elbasanit.pdf

Fuga, A(2000). *Shoqëria periferike,*Tirana, Ora.

Fuga. A, Dervishi Z, Gjoka R.(1998). Midis humbëtirës dhe gjallimit kulturor (Studim mbi gjendjen kulturore në zonat rurale të Shqipërisë), Tiranë.

Hoti.G (2020). "PERMBYSJA E KLASËS QYTETARE HISTORIKE SHQIPTARE DHE TRIUMFI I IDIOTIZMIT KRIMINAL FSHATAR!". Marrë nga: https://genckhoti.com/artikuj/117-permbysja-e-klases-qytetare-historike-shqiptare-dhe-triumfi-i-idiotizmit-kriminal-fshatar/

INSTAT.(1997), Shqipëria në shifra (Albania in figures), Tirana, Instituti i Statistikës.

INSTAT(2014) Migracioni në Shqipëri. Marrë nga: //www.instat.gov.al/media/3078/migracioni_ne_shqiperi.pdf

Lika.E(2016). NDIKIMI DEMOGRAFIK NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË SHQIPËRISË. Marrë nga: http://uet.edu.al/images/doktoratura/eduart_lika.pdf

Misja, Vladimir, Vejsiu, Ylli, Bërxholi, Arqile(1987). Popullsia e Shqipërisë, f. 70 – 304, Universiteti i Tiranës, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë,1987.

PRESIONI I SHTETIT KOMUNIST DHE KRIJIMI I STRESIT PSIKOLOGJIK NË SISTEMIN ARSIMOR FETAR SHQIPTAR, RASTI I KOMUNITETIT MYSLIMAN 1945 – 1950

Shyqyri Hysi[1], Luiza Hysi[2]

[1]Departamenti i Historisë-Gjeografisë, Universiteti "Eqrem Çabej"

shbhysi@yahoo.com

[2]Mësuese, Shkolla "Koto Hoxhi" Gjirokastër

luiza.hysi@yahoo.com

Abstrakt

Fundi i Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri përfshiu në një krizë psikologjike gjithë sistemin arsimor fetar shqiptar. Reformat komuniste të pasluftës prekën dukshëm jo vetëm brendinë e këtij arsimi, por edhe shtruan "de fakto" problemin e ekzistencës së tij. Në këtë kontekst ndikoi dukshëm veçanërisht Reforma Arsimore e vitit 1946. Në fakt, ishte Kushtetuta e marsit 1946 që me nenin e saj të 10-të e kishte distancuar besimin, kishën, xhaminë, teqenë nga zhvillimi i arsimit me cilësimin e shkollës si "laike dhe të ndarë ngakisha".Mësimi tradicional në shkollat e administruara prej Komunitetit Mysliman Islam në Shqipëri që ishin: mesxhidet, mejtepet dhe medresetë, u vu në provën e zjarrit. Nëpër shkollat publike ku zhvilloheshin edhe lëndë fetare prej mësuesve klerikë, mësimi i besimit u kufizua së tepërmi. U mbyllën shkollat fetare dhe u ndalua mësimi fetar. Në një sërë relacionesh nga Delvina, Shkodra, Korça, Gjirokastra etj., vihet re stresi që shteti komunist kishte krijuar te bashkësia e mësuesve të besimit dhe trupat pedagogjike në shkollat fetare myslimane të kohës. Përballë tyre qëndronte si shteti, PKSH (PPSH), ashtu edhe organizatat e masave, veçanërisht rinia dhe Fronti Demokratik.

Fjalë kyçe: *Arsim, stres, psikologji, komunitet, fetar.*

Abstract

The end of World War II in Albania was followed by a psychological crisis in the schooling and the religious system. The reforms of the communist party in Albania, more accurately the legislation amendmend of 1946, disassociated schooling from all the religious ideology of the time considering it as "atheist and separated from the church".The traditional way of teaching in Islamic comunity administrated schools (called medrese, mesxhide, mejtepe) was also hit by the policies of the communist party. Both religious, public schools and gradually the whole population were obligated to entirely forsake their faith and believe in god. The religious men serving in mosques and churches were faced with the harsh choice between the Marxist ideology of the time, or being considered traitors of the nation. The state, the communist party and the mass organizations such as the youth of

the country and the Democratic Front, made religious schools and buildings to shut down all around the country.

Key words: *Schooling, religious community, psychological stress*

Tema që ne kemi marrë në studim lidhet me mësimin fetar në Shqipëri, e specifikuar për shkollat që administroheshin nga Komuniteti Mysliman Shqiptar gjatë viteve 1945 – 1950. Arsimi fetar Islam në Shqipëri tradicionalisht ushtrohej në mesxhide, imarete, mejtepe, ruzhdije, medrese, kurset e ngritura pranë institucioneve fetare islame dhe idadijet.

Edukimi fetar dhe shkollat islame, si pjesë e rëndësishme e tij në vendin tonë, ka karakter historik. Ato startojnë menjëherë me pushtimin osman të Shqipërisë, pas epokës së Skënderbeut dhe kryengritjeve të fundshek. XV, pra, në fillim të shek. XVI. Sikurse dihet edukimi fetar dhe arsimimi ishin ekskluziviteti She Ul Islamit me qendër në Stamboll. Gjuha e përdorur në edukim dhe arsimin fetar ishte osmanisht e arabisht dhe mësuesit fillimisht erdhën nga territoret e Perandorisë Osmane. Ky mësim ka kaluar në katër periudha:

a. nga shek. XVI – XIX,

b. nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në vitin 1912, e cila etiketohet "*periudha e modernizimit të shkollave*", sepse përveç lëndëve me karakter fetar u futën edhe ato të shkencave shoqërore e natyrore.

c. zhvillimi i arsimit fetar në shtetin shqiptar 1912 – 1967,

d. ndërprerja e gjithë jetës dhe veprimtarisë së edukimit fetar 1967 – 1990,

e. riciklimi i edukimit dhe arsimit fetar 1990 e në vazhdim.

Nga shkollat e spektrit fetar(jo vetëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar) kanë dalë personalitete e figura kombëtare shqiptare sikurse janë: Engjëllorët, Pjetër Bogdani e Pjetër Buda, At Gjeçovi, vëllezërit Frashëri, Hasan Tahsini(Hoxha Tahsini), At. Gjergj Fishta, Lui Bumçi, Luigj Gurakuqi, Hoxhë Kadriu, Hafiz Ali Korça, Vehbi Dibra, Bajo Topulli, Hasan Prishtina, Mehmet Pash Dërralla, Avdi Bej Toptani, Faik Konica, Rauf Fico, Baba Rexhepi, Zef Pëllumbi etj.

Pas themelimit të shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912 dhe zhvillimit të arsimit kombëtar shqiptar shkollat fetare dhe rëndësia e tyre filluan të zbehen. Ministri i parë i arsimit, atdhetari Luigj Gurakuqi, e vuri theksin te "*…shkollat me karakter kombëtar*".

Në vitet njëzet kleri fetar bëri presion për të pasur rol në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve krahas shtetit dhe familjes. Në një shkrim të revistës "*Hylli i Dritës*" 1922, lexojmë: *"... gjurmë për gjurmë me shtetin dhe familjen do të përcjellim shoqërinë në prodhimin e kulturës*".

- Në vitin 1921 nga 400 shkolla publike vetëm në 27 shkolla nuk zhvillohej mësimi i besimit fetar.

- Në mars 1924 Ministria e Arsimit ndërpreu fondet e pagave të mësueseve të fesë në shkolla.
- Pas dy kongreseve arsimore: gusht 1920 dhe 22 korrik 1922 sistemi arsimor shqiptar u unifikuan. Por, njëkohësisht, u zhvillua një polemikë midis shtypit dhe klerikëve fetar nga njëra anë dhe mësueseve atdhetar nga ana tjetër. Flamurin e mbrojtjes së mësimit të besimit e mbajti revista "*Hylli i Dritës*" dhe e ndihmuar me ndonjë artikull nga organet e tjera si: "*Ora e maleve*", "*Lajmëtari i zëmrës*", "*Zani i Shan Andout*", "*Republika*" etj. Në vitin 1938 Shqipëria kishte 80% të popullsisë analfabete. Sipas statistikave 1938 Shqipëria kishte 643 shkolla. Në 30 shtator të vitit 1945 Shqipëria kishte 1 122 440 banorë, prej të cilëve 911 410 banorë figurojnë në listën e analfabetëve, e barabartë kjo me 81.22% të popullsisë.

Në vitin 1930 Hil Mosi theksonte: " *Të drejtën dhe detyrën e edukimit, mbas etikës së tija, shteti nuk duhet t'ia lëjë askuj*". Në këtë linjë veproi edhe Mirash Ivanaj(1891 – 1953), kur u propozua në detyrën e ministrit të Arsimit në dhjetor 1932(u dekretua, më 11 janar 1933). Ivanaj realizoi një reformë arsimore homogjenizuese me theks kombëtar. Studiuesi Dritan Spahiu shkruan: "*Ai dëshironte që të realizonte një arsim kombëtar e laik, me vizion perëndimor, që shkolla shqiptare të shkëputej nga kleri fetar dhe ndikimi i tij*".

Shkollat fetare janë konsideruar nga disa atdhetar si shkolla që u shërbenin politikave asimiluese të të huajve në Shqipëri. Mësuesi Sinan Beqir Hoxha shkruan: "*Xhamia e kisha luftuan shkollën kombëtare e laike, luftuan për shkollën profesionale a me karakter fetar, luftuan për të mbajtur në shkollë mësimin e besimit të kontrolluar prej tyre*". Madje, atdhetari vlonjat Jani Minga duke folur për shkollat e klerit ortodoks shprehej: "*…ato shkolla ishin veçse me ushtarë aktivë pa uniform të ideologjisë grekomane….*" Reforma u miratua njëzëri në Parlament më 11 prill 1933, ndërsa Mbreti Zog I e dekretoi më 22 prill. Zbatimi i saj ishte i menjëhershëm. Nga kjo reformë u mbyllën(26 prill 1933) gjithsej 85 shkolla të huaja. Sipas kategorive të tyre rezultojnë: "*21 shkolla private jo fetare, 14 shkolla të klerit mysliman shqiptar, 17 shkolla të klerit katolik, 4 shkolla të klerit ortodoks, 10 shkolla private në minoritetin grek, 19 shkolla të huaja që vepronin në Shqipëri*". Në këtë kontekst kujtojmë se në vitin 1921 vetëm në prefekturën e Gjirokastrës kishte 50 shkolla greke. Atdhetarët shqiptar e shtruan qysh në vitet njëzet problemin e mësimit të dogmës fetare në shkolla. Ata e konsideronin mësimin fetar në shkolla si mundësi "*...për me i dhen shkak përçarjes së ndjenjave kombëtare dhe me ndalue bashkimin e elementëve të ndryshëm të shtetit*".

Gjatë luftës shkolla dhe institucionet fetare pësuan dëme të konsiderueshme. Ndaj kleri islam synoi vënien në efikasitet të të gjithë infrastrukturës arsimore ekzistuese. Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore,Shqipëria u afirmua si një shtet laik. Në mars 1946 u miratua kushtetuta e cila ligjëroi lirinë e besimit. Në vitet e para të qeverisjes, regjimi i dalë nga lufta, për të realizuar strategjinë dhe taktikën e vet politike nuk u konfliktua me

komunitetet fetare. Ai u përpoq të jepte idenë se do të respektonte dhe zbatonte standardet demokratike në fushën e besimit fetar dhe të lirisë së ndërgjegjes. Shteti miratoi disa dokumente juridike, sikurse janë:

- Deklaratën e të drejtave të njeriut dhe të qytetarëve, e cila u miratua në mbledhjen e dytë të KANÇ –it, Berat 20 tetor 1944.
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 14 mars 1946. Historiani Ajet Shahu shkruan: "*Kushtetuta e vitit 1946 ligjëroi lirinë e besimit, ndarjen e shtetit nga feja*".
- Reformën arsimore 17 gushtit 1946, e cila pati si pikënisje vendimet e Plenumit V të KQ të PKSH –së shkurt 1946. Shteti përveç modeleve jugosllave(deri në vitin 1948) e ruse (1948 – 1960) i dha shkollës karakter politik(socialist). Reforma e dytë e plotësimit të këtij karakteri u krye në vitin 1963 dhe zeniti arrihet me reformën e vitit 1969, e cila u titullua: "*Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës*", synimi i së cilës ishte: "*Krijimi i njeriut të ri*". Në fushatën antifetare u përfshi edhe shtypi. Gazeta "Bashkimi" si zëdhënëse e organeve zyrtare theksonte: "*… feja e ka përçarë popullin dhe në shumë element pengon përparimin. ... feja ka penguar edhe bashkimin nacional të popullit në revolucionin e madh*".
- Ligjin "*Mbi Komunitetet Fetare*" nr. 743, datë 26 nëntor 1949. Këtij ligji në vitin 1963 iu bë një shtesë(amendament), "*Mbi ndryshimet mbi ligjin mbi komunitetet fetare*", si edhe miratimi i statuteve të komuniteteve fetare 1945 dhe gjatë periudhës 13 shkurt - 20 maj 1950.
- Më 23 mars 1946 Ministria e Arsimit u dha urdhër zyrave të arsimit në qarqe: "*...të ndërpritet dhënia e mësimit fetar në shkolla*".
- Shteti krijoi një presion edhe me rregullat për funksionimin e shkollave fetare. Kështu, që Medresetë të funksiononin, ato duhej të hartonin një rregullore. Kjo rregullore duhej miratuar nga Ministria e Drejtësisë. "*Mësimi nuk mund të fillojë pa marrë më parë pëlqimin e rregullores nga Ministria e Drejtësisë*".

Dy dokumentet e para kryesia e Komitetit Mysliman shqiptar në vitin 1946 i konsideronte: *"... bazamentin e plotë juridik që garantonin lirinë e ndërgjegjes dhe të ushtrimit të veprimeve fetare*". Mirëpo, megjithëse shteti nuk e deklaroi aspiratën e vet ateiste, ai ndërmori menjëherë disa reforma që prekën drejtpërdrejt komunitetet fetare dhe e vendosi edukimin dhe arsimin në shinat e rrugës ateiste.

Pas Luftë së Dytë Botërore Komuniteti Mysliman Shqiptar u vu në pozitat e presionit politik në të gjitha fushat. Besimi fetar dhe feja ishin të huaja për ideologjinë komuniste e filozofinë m-l nga e cila udhëhiqej ajo. Ishte kjo arsyeja që komunitetet fetare u konsideruan ente private dhe iu nënshtruan si të tilla, të gjitha reformave komuniste që u ndërmorën gjatë viteve 1945 – 1950. Edukimi dhe arsimi konsideroheshin fushat ku do të përgatitej njeriu i ri socialist. Kreu i partisë dhe shtetit E. Hoxha "*Arsimi të mos jetë një armë në dorën e borgjezisë, por në dorë të punëtorëve dhe fshatarëve*".

E për ta realizuar atë duheshin "*çrrënjosur besimet dhe paragjykimet ideologjike të së shkuarës*". Në këtë shënjestër ishte edhe edukimi e arsimi fetar. Reforma arsimore e 17 gushtit 1946 e vërtetoi më së miri luftën që PKSH-ja(PPP) i shpalli edukimit dhe arsimit fetar. Për realizimin e kësaj aspirate PKSH-ja punoi në disa fronte:

- Në fushën ekonomike, duke i përfshirë institucionet fetare në reformat e shtetëzimeve, reformën ekonomike, financiare, agrare, në vorbullën e sekuestrimeve etj.
- Në presionin e dhunës fizike mbi klerikët duke kryer arrestime klerikësh e studentësh të medreseve me motivacione të ndryshme. Me këtë rast përmendim arrestimet e bujshëm në Medresenë e Tiranës 19 maj 1947. "*Në një telegram të 19 majit të vitit 1947, që drejtori i Medresesë i dërgonte Kryesisë së Komunitetit, theksohet se forcat e sigurimit kishin arrestuar profesorët e Institutit Arsimor islam: Hafiz Ibrahim Dalliun Hasan Tahsimn, dhe drejtorin e brendshëm të saj, Januz Buljen*". Ndërsa nga Burreli Myftynia njoftonte se "ishin arrestuar klerikët Mustafa Stefhasani e Ali Bajdami". Ndërsa në Myftininë e Korçës ishte arrestuar për borxhe shtetërore Hafiz Xhafer Aliu.
- Në aspektin juridik dhe VKM-të që kufizonin nga dita në ditë veprimtarinë e enteve fetare.
- Në organizimin e fushatave kundër besimit, institucioneve fetare dhe klerikëve. Ato drejtoheshin nga organizatat bazë të PKSH-së dhe levat e saj si: Organizata e Rinisë, Bashkimi i Grave shqiptare, Bashkimet Profesionale etj.. Orientimi politik i udhëheqjes së PKSH –së ishte: *"...janë krijuar kondita për një veprimtari të gjerë politike e kulturoro – arsimore të gjerë..., por puna është se këto duhen orientuar e drejtuar nga partia*".
- Në përfshirjen e klerikëve dhe studentëve të medreseve në listën e rekrutimeve ushtarake.
- Në uzurpimin e objekteve të institucioneve fetare për nevojat e shtetit.
- Injektimi apo shartimi i dogmës fetare me dogmën politike të partisë dhe filozofinë m- l.
- Zëvendësimi në mënyrë graduale i ceremonive fetare me ceremonitë shtetërore e politike. Tregues ishte kufizimi i festave fetare zyrtare.
- Pengesat për pajisjen me klasa, kuadër dhe orare për zhvillimin e mësimit fetar.
- Mosfinancimi nga shteti i shkollës, konvikteve, teksteve të shkollave fetare dhe bursave të nxënësve për shkollat fetare.
- Krijimi i një propagande mbytëse për komunitetet fetare, veprimtarinë e tyre edukative dhe arsimore.

Për të nxjerr nga kolapsi sistemin e edukimit dhe arsimit fetar islam, Këshilli i Përkohshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë më 7 prill 1945 me vendim nr. 45 urdhëroi: "… *në çdo prefekturë të hapen kurse për përgatitjen*

e personelit fetar". Në fakt këto ishin shkolla të mirëfillta me sistem 5-vjeçarë dhe një praktikë fetare. Prej studiuesve ato konsiderohen në nivelet e shkollave të mesme të kohës, sikurse edhe medresetë. Ky veprim shkaktoi konfuzion në radhët e strukturave të shtetit, të cilat krijuan një sërë pengesash që këto kurse të mos funksionimin. I ndodhur në pozita të vështira, KMSH-ja në maj 1945 iu drejtua Ministrisë së Arsimit me një letër, në të cilën theksonte gjendjen e arsimit dhe pengesat që nxirrnin autoritetet lokale. Mirëpo qeveria shqiptare në maj 1945 nxori urdhrin, sipas të cilit mësimi fetar do të zhvillohej vetëm në shkollat fillore. "*Çdo lloj mësimi dhe ai fetar qoft …do të jepet vetëm në shkollat shtetërore*". Në të njëjtën kohë Ministria e Arsimit dha udhëzimin se: si tekst bazë do të përdorej "… *teksti Edukata fetare e morale*", i cili ishte përgatitur nga KMSH-ja në vitin 1942. Shqetësim i KMSH-së në 20 nëntor 1945 ishte: "*autoritet e pushtetit lokal po i sillnin pengesa mësimit të besimit në shkollat shtetërore. Ato propagandonin se ky mësim ishte i panevojshëm*".

Me gjithë përpjekjet e KMSH-së, mësuesve, prindërve, nxënësve, personaliteteve të kohës dhe autoriteteve drejtuese të KMSH-së, mësimi i besimit erdhi duke u mbyllur. Dalja e ligjit "Mbi Komunitetet Fetare" nr. 743, datë 1949, i dha goditjen përfundimtare mësimit të besimit fetar.

KRIZA NË FUSHËN E NDËRTIMIT DHE PASOJAT SOCIALE

Darina Çoni (Kacollja)[1], Fiona Todhri[2]
[1]Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit
darina.coni@uniel.edu.al
[2]Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
fiona.todhri@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimet në shoqërinë shqiptare, veçanërisht gjatë shekullit XX, janë realizuar në rrethana mjaft të ndërlikuara, rrethana në të cilat ndërthureshin dukuri e procese të shumëllojshme. Ky studim cilësor hulumton në këndvështrime të ndryshme krizën aktuale në sektorin e ndërtimit dhe pasojat sociale që ka sjellë kjo krizë në mbarë shoqërinë. Mbas shqyrtimit të literaturës dhe të dhënave statistikore të kohës, u realizuan edhe intervistat me 36 persona të cilët ishin punonjës si dhe sipërmarrës në këtë sektor. Analiza tematike e të intervistuarve mundohet të paraqesë fillimin e krizës në sektorinendërtimit,sidhethelliminesaj,dukeushoqëruaredhemepasojatsociale. Sipërmarrës që kishin marrë kredi nga bankat dhe nuk i shlyenin dot, punonjës që mbeteshin pa punë, dhe që ishin të vetmit që siguronin të ardhurat minimale të jetesës së përditshme . Një ndër faktorët esencial negativë në këtë kohë ishte edhe tërmeti që ra në Shqipëri më datën 26 Nëntor 2019. Pasojat e tmerrshme të këtij tërmeti ishin jo vetëm në humbjen e jetës së njerëzve, por edhe në dëmet e mëdha që shkaktoi, sidomos në ndërtimet e bëra mbas vitit 1991, të cilat konceptoheshin edhe më të sigurta.

Fjalët kyçe: *Ndërtim, krizë, papunësi, varfëri, pasojë sociale .*

Abstract

The developments in albanian society, especially during the 20th Century are realized in complicated circumstances, conditions in which interlink different processes and occurrences. This qualitative study , explores the actual crisis in different viewpoints in the construction sector and the social consequences that this crisis has brought in the entire society. After the literature review and the statistical data of the time, were also done interviews with 36 people which where workers and managers in this sector. The tematic analysis of the interviewee tries to show the start of the crisis in the construction sector ,also its deepening, by being accompanied with social consequences. Managers, who have received loans from the bank and cannot repay them, workers who became jobless and were the only that secure minimal incomes of the daily life. In that time one of the essential negative factors was the earthquake that hit Albanian on November 26, 2019. The terrible consenquences of this earthquake were not only the loss

of people's lives , but also the damages it caused , especially in the construction made after 1991, thought to be more safe.

Key Words: *Construction, crisis, jobless, poverty, social consequences*

1. Prezantimi

Studimi cilësor ka për qëllim të hulumtojë krizën në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe pasojat sociale të tij. Mbas vitit 1998, vit në të cilën filloi dhe ndërtimi i menjëhershëm i ndërtimeve, ky sektor u zhvillua shumë dhe u emërtua dhe si lokomotiva e zhvillimit të vendit. Te ky zhvillim ndikuan disa faktorë të rëndësishëm që morën hov të madh dhe, pothuajse, të pakontrolluar. Gjatë viteve të komunizmit shqiptarët vuanin për strehim. Kishte shumë familje që jetonin disa kurora në një apartament 2+1 për shumë vjet. Kështu në vitit 1979 në Shqipëri kishte 247 për qind të familjeve me dy kurora dhe 3,9 për qind e familjeve me tre kurora e lart.

(Misja & Vejsiu, 1984. f.154). Shtëpia dhe strehimi në atë kohë ishte ëndërr jo vetëm për qytetarët në zonat urbane, por dhe për banorët e zonave rurale.

Jetesa në këto hapësira të ngushta me shumë kurora në atë kohë filloi të sillte dhe konflikte sociale të shpeshta brenda familjes së madhe ku ato jetonin.

Konflikte këto të natyrës së përditshme, por njëkohësisht edhe konflikte që ndikonin drejtpërsëdrejti në lidhjen e martesës së çifteve dhe vazhdimësinë e saj.

" Megjithatë është fakt që në një familje me dy kurora, pikërisht dy gra, nusja me vjehrrën mund të mos merreshin vesh, mund të përfliteshin, mund të ziheshin e të mos komunikonin, madje, mund të krijonin atmosferë të rëndë në të gjithë jetën e familjes e në ndonjë rast, të çonin në njërin krah, në braktisjen e prindërve nga djali, kurse në rastin tjetër në mosmarrëveshje të thella midis çiftit të martuar, të cilat mund të shkonin gjer në divorcim"(Beqja, 1983, f.122). Përgjithësisht, për këto familje ishte ëndërr një banesë më vete, ku ata ishin të lirë të ndërtonin jetën e tyre .

Por problem madhor në atë periudhë mbeteshin edhe familjet e mëdha në numër, me fëmijë të rritur në moshë, në të cilën hapësirat e ofruara nga instancat e asaj kohe ishin të pamjaftueshme, për të mos thënë fare të pamjaftueshme.

Pra, pas viteve 90' shqiptarët ishin të etur për shtëpi, por kishin probleme financiare e nuk arrinin dot t'i ndërtonin ato. Emigrimi e zbuti përkohësisht fenomenin e disa kurorave në një apartament, sepse shumë familje emigruan jashtë vendit. Gjatë viteve 1993-1996 lulëzuan firmat piramidale dhe shumë familje shqiptare u tërhoqën nga fitimi i madh dhe i shpejtë i tyre. Për këtë arsye shumë prej tyre mbyllën kursimet e tyre të shumë viteve në emigrim në këto firma ndërsa të tjerët shitën dhe shtëpitë dhe mbyllën lekët në firma piramidale .

Por me rënien e firmave piramidale filluan tensione të shumta në familje dhe shoqëri , tensione të cilat çuan deri në konflikte e, madje, në shumë raste dhune fizike familjare. Njerëzit të tmerruar panë se si iu humbën kursimet e gjithë këtyre viteve sidomos e atyre që punuan në emigrim. Shumë shqiptarë kishin lënë familjen dhe kishin ikur në emigrim edhe në mënyrë klandestine, për të punuar një periudhë kohe e për ty rikthyer sërish pranë saj.

Për të fituar sa më shumë dhe duke parë dhe përhapjen që mori në Shqipëri ky lloj "biznesi", shqiptarët filluan t'i mbyllnin kursimet në këto firma piramidale. Por kur i humbën, humbi dhe shpresa për t'u kthyer pranë familjes dhe kjo ndodhi sidomos tek ata që shitën apartamentet dhe lekët i mbyllën në këto firma.

Kjo krizë ekonomike familjare u shoqërua me shumë pasoja sociale në shoqërinë e asaj kohe, duke sjellë edhe probleme sociale në familjet shqiptare, siç ishin dhuna në familje apo divorcet.

Mbas viteve 1996-1997 të gjithë ishin të zhgënjyer nga firmat piramidale që panë se si iu zhdukën kursimet e tyre të gjithë këtyre viteve. Ëndrra për shtëpi në vend të ishte zbutur gjatë këtyre 6 viteve u theksua më shumë. Në atë kohë sistemi financiar përfaqësohej nga firmat piramidale, banka e kursimeve që ishte, kishte vështirësi në likuiditete, rënia e sistemit financiar i bëri njerëzit të mos besonin më te ky sistem, por t'i ktheheshin së kaluarës kur njerëzit blinin prona të paluajtshme.

Duke parë këtë kërkesë të menjëhershme dhe fitimin e sigurt filluan të lindnin shumë shoqëri ndërtimore, pjesa më e madhe tyre pa kapitalin e nevojshëm për investime. Shitjet ishin të sigurta sepse klientët blinin apartamentin që sa hapej themeli i pallatit dhe kur kishte mbaruar karabinaja, ishte shitur gjysma e pallatit.

Por shoqëritë e ndërtimit filluan të ndërtonin disa pallate në të njëjtën kohë, pa pasur kapitalin e duhur, për këtë shkak iu drejtuan bankave të cilat filluan t'i kreditonin. Kjo rriti kostot e ndërtimit, se shoqëritë e ndërtimit, kur filluan të shisnin apartamentet, bënin llogari dhe përqindjen e interesit bankar që duhet të paguanin. Megjithatë bankat nuk mund të kreditonin pafundësisht, kështu shoqëritë kishin probleme përsëri likuiditetet. Ato filluan të përdornin sistemin e kliringut nëse sillje një mall si hekur, beton, tulla ose nëse bëje një punim në pallat shtroje pllaka, bëje punime elektrike e hidraulike etj., nuk merrje më lekë për mallin e sjellë ose për punën e kryer, por apartamente.

Por punëtorët të cilët merreshin drejtpërdrejt me këtë sektor, nuk kishin mundësi të përballonin këtë sistem e kështu në lojë hyjnë individë të veçantë që formuan shoqëri më të vogla dhe të specializuara vetëm në një fushë si: ndërtimin e murit, suvatime dhe ndërtim konstruksioni etj.. Por dhe këto shoqëri të vogla filluan të kenë probleme financiare ku shkaku kryesor ishte mungesa e shitjeve të apartamenteve.

Gjithë këto shoqëri ndërtimi në treg sollën dhe kërkesë të madhe për troje ndërtimi. Pronarët e këtyre trojeve duke parë këtë kërkesë të rritur shtuan përqindjen e fitimit, ku nga 20 për qind arriti në 33 për qind. Kjo rritje e kërkesës dhe përqindjes së tokës ku do ndërtoje u shoqërua në vitet e fundit dhe me një ulje të lejeve të ndërtimit, kjo për shkak edhe të lejeve që ishin dhënë për shumë vite pa një kriter demografik të përcaktuar.

"Sepse këtu është krijuar edhe një iluzion që nuk është vetëm shqiptar, por nga i cili vuan e gjithë bota e qytetëruar. Duhet mbajtur në vëmendje se çmimi i çdo malli në treg nuk ka të bëjë fare me atë që quhet gabimisht "Vlera e vërtetë" e tij. Vlerë të vërtetë nuk ka. Çdo mall sikurse edhe sipërfaqet e banuara kanë një çmim, por kjo nuk do të thotë se ato realisht, në mënyrë të përjetshme, si materie, si sende, vlejnë realisht aq. Çmimi i tyre është vendosur në një kohë kur ta zëmë popullsia kishte fuqi blerëse të madhe, kur interesi psikologjik dhe motivues për atë mall ishte i madh, kur ai ishte në modë etj., kurse më pas, me të rënë nga "vakti" këta faktorë edhe vlera e atij malli bie krejtësisht" (Fuga.A.,pa vit botimi). Por në horizont nuk dukej perspektivë pozitive, kriza e fuqishme evropiane e, sidomos ajo greke dhe italiane, filloi të prekë dhe Shqipërinë. Kriza e ndërtimit nuk erdhi si një rrufe në qiell të pastër, por erdhi gradualisht, nuk donim ta besonim se mund të na prekte kriza. "Fenomeni i globalizimit na ka vendosur ne të njëjtën anije ku turbulenca prek një vend do kemi efektin domino" (Civici, 2009, p.). Në fillimet e krizës amerikane dhe më pas ajo evropiane u ndien pak në Shqipëri sidomos në ndërtim. Kjo sepse kriza amerikane u shfaq me falimentime bankash dhe nuk u përqendruan analizat e hollësishme përse erdhi kjo krizë. Për këtë arsye shumë shqiptarë filluan të kishin frikë nga bankat, sepse kriza amerikane u krijonte idenë e firmave piramidale. "Në fund të vitit 2009 depozitat u shtuan vetëm me 7 për qind krahasuar me vitin e mëparshëm, duke reflektuar stepjen dhe trembjen e konsumatorëve, e krijuar pas krizës globale që filloi në shtator 2008, me falimentimin e bankës amerikane " Lehman Brothers" (Monitor, 2011).

Gjatë kësaj kohe shqiptarët në mëdyshje midis frikës së bankës dhe krizës filluan përsëri të blejnë apartamente, por me sipërfaqe të vogla, nuk preferonin më apartamentet e bollshme 3+1, por apartamente sa më funksionale e me sipërfaqe sa më të vogël. Kështu, në Shqipëri, për vitin 2008 ishin dhënë 910 leje ndërtimi për apartamente banimi dhe në vitin 2009 ishin 1021 leje ndërtimi. Vlera e ndërtimit në vitin 2009 ishte 71136 milionë lekë. (INSTAT Shqipëria në shifra 2010). Ndërtimi i rezistoi fluksit të parë të krizës, por me kalimin e kohës u pa se shkak për krizën amerikane dhe falimentimin e bankave ishte fusha e ndërtimit, kjo u theksua më shumë në krizën spanjolle që shumë banka ishin në prag të falimentimit për shkak të kredive të këqija në fushën e ndërtimit.

Rënia e besimit te ndërtimi u shoqërua dhe me krizën greke dhe atë italiane që në bazë nuk kishin ndërtimin, por borxhin e lartë shtetëror. Kjo krizë preku në radhë të parë emigrantët dhe remitancat filluan të bien çdo vit.

Kur kriza greke dhe italiane arriti kulmin në vitet 2011-2012, nga emigrantët nuk flitej më për të dërguar të ardhura në Shqipëri, por shumë prej tyre ngelën pa punë dhe po mendonin të ktheheshin në atdhe. Kriza italiane dhe, sidomos ajo greke, frikësuan tregjet ndërkombëtare në përgjithësi, sepse deri atëherë ishte parë që në kohë krizash, rruga më e shpejtë për të dalë ishte investimet e mëdha nga shteti për punë publike si në autostrada, metro etj., duke marrë kredi dhe duke rritur borxhin. Por ky sistem ra me krizën greke dhe asnjë bankë nuk blinte më borxhe shtetërore dhe kur i blinte, ato ishin me përqindje të lartë.

Kjo solli që investimet publike, sidomos ndërtimi i rrugëve të reja të frenoheshin dhe në disa segmente rruge të lihej fare pa punuar. Bankat, gjithashtu, filluan të shtrëngonin procedurat e dhënies me kredi për ndërtim dhe për blerje apartamentesh. Kjo krizë u shoqërua dhe me futjen në fuqi të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit"(fletore zyrtare nr. 56, 2009), i cili hynte tërësisht në fuqi në janar të vitin 2011. Sipas këtij ligji, lejet jepen vetëm mbas miratimeve të planeve rregulluese të qyteteve. Për këtë shkak u caktuan 2 vjet kohë për të hyrë në fuqi ligji, por për shumë faktorë këto plane nuk u miratuan dhe me hyrjen në fuqi të ligjit u vështirësua dhe dhënia e lejeve të ndërtimit.

Duke i dhënë një panoramë të përgjithshme lejeve të ndërtimit mund të themi se në vitin 2011 janë dhënë 1059 leje ndërtimi për banim, kurse në vitin 2012 janë dhënë 101 leje për banim, ndërsa në vitin 2013 janë dhënë 203 leje(Instat, 2013). Gjithashtu, krahas tyre, kemi dhe një ngadalësim të migrimit të brendshëm.

Gjithashtu, trendi në Evropë ishte të jetoje larg qyteteve të zhurmshme dhe zonave urbane, kjo për shkak të ajrit të ndotur dhe njëkohësisht për të shmangur trafikun e jashtëzakonshëm.

Kështu në Itali, në vitit 1981-1991 kemi një ulje të popullsisë në zonat urbane dhe një rritje të tyre në zonat rurale (Martinelli & Guidicini, 1993, f. 141). Ky trend po vihet re dhe vitet e fundit në klasën politike shqiptare ku një pjesë preferon të jetojë larg Tiranës dhe larg zhurmës së saj .

Gjithashtu, qëllimi kryesor i vajtjes në zonat urbane është njëkohësisht edhe të gjeturit punë. Dhe kjo gjë ndodhi në Shqipëri pas viteve 90". Me falimentimin e kombinateve të mëdha vendin e zunë punishtet e vogla dhe ndërtimet të cilat nuk siguronin punë afatgjatë. Nga frika se mund të ngeleshin pa punë njerëzit nga zonat rurale ndiheshin më të sigurt në zonat e tyre, sepse të paktën mund të punonin tokën dhe mund të mbijetonin. Të gjitha këto probleme thelbësore si kriza ekonomike, ligjore dhe ndryshimi i trendit të të jetuarit në qytet e futi sistemin në krizë dhe nxori mijëra veta të papunë.

Përgjithësisht, industria e ndërtimit ishte ajo e cila mbante peshën kryesore të punësimit të njerëzve. Kështu, duke u nisur nga statistikat në rang kombëtar, punësimi direkt në ndërtim zinte 9.9 për qind të të gjithë të punësuarve(INSTAT,Shqipëria në shifra 2010, f. 14). Kjo përqindje është

më e larët, nëse do të llogarisim edhe të punësuarit në industrinë metalurgjike, në fabrikat e çimentos, fabrikat e duralit, fabrikat e tullave. Fabrikat e tullave dhe e polisterolit patën të njëjtat probleme, ato filluan për të mbijetuar, të hynin në lojë në sistemin e kliringut, pra, kur shisnin mall nuk merrnin likuiditete financiare, por apartamente.

Në momentin që sektori i ndërtimit nuk kishte më ato ritme, këto fabrika filluan të përgjysmojnë prodhimin dhe të shkurtojnë punëtorët. "Të dhënat e fundit nga përfaqësuesit e kompanive të prodhimit dhe të tregtimit të tullave konfirmojmë se në muajt e fundit shitjet kishin rënë edhe më shumë. Në shumicën e rasteve ishin më të pakta kompanitë që ndërtonin në këto kohë dhe, si rrjedhojë, edhe më i ulët numri i materialeve të ndërtimit që prodhohej nga fabrikat shqiptare"(Monitor nr. 5 dt. 07 shkurt 2011, f. 18).

Shtimi demografik i qyteteve gjatë këtyre 30 viteve nuk u shoqërua me shtim normal sipas kërkesës për punësim. Por më shumë për t'u larguar nga kushtet e vështira në fshat. Qytetet ishin kthyer në qendra të mëdha shërbimi dhe, nga mungesa e madhe e papunësisë, zgjidhje e vetme për një pjesë të tyre ishte hapja e dyqaneve për shërbime.

Sipas Instatit, në 2010 ishin 60.1 për qind aktivitete ekonomike në fushën e tregtisë dhe hotelerisë, kafe dhe restorante (2012). "Në qytet sot, sikurse thotë miku im Filip Harenger, nuk ka njerëz, se ka punë, por ka punë, sepse ka njerëz. Ata i shërbejnë njeri- tjetrit. Ti më qeth, unë të mësoj fëmijët, unë të mësoj fëmijët, ti më hekuros rrobat, ti më hekuros rrobat, unë shkruaj libra që t'i lexosh pas darke e kështu pa fund i bëjmë shërbime njeri- tjetrit. Të gjithë jemi bërë tregtarë, të gjithë jemi bërë klientë. Kioska pa fund nëpër lagje. Unë vij blej te kioska jote, ti vjen blen te kioska ime. Të dy palët kemi iluzionin se po fitojmë. Ti fiton paratë e mia, kurse unë fitoj paratë e tua. Absurd komplet" (Fuga, A; pa vit botimi).

2. Bazat teorike

Efikasiteti i funksionimit të industrisë së ndërtimit varet nga ndikimi kompleks i faktorëve të ndryshueshëm të nivelit makro, siç janë niveli ekonomik, politik dhe kulturor i zhvillimit. Industria e ndërtimit ndikohet nga dokumentet rregullues, siçjanë : tregu, sistemi i taksimit, mundësitë dhe kushtet e tërheqjes, inflacioni, burimet lokale etj. (Simona, Kaklauskas, et al. 2011). Kjo tregon që kjo industri varet nga shumë faktorë në zhvillimin e saj. Disa nga faktorët që ndikuan sidomos në vendet në zhvillim janë edhe dokumentet rregullues ose leja e ndërtimit, lejet e kolaudimit dhe në fund hipotekimi i tyre, të cilat janë edhe hallkat që janë të lidhura me institucionet shtetërore. Këto institucione në funksionimin e tyre, sidomos, në Shqipëri kanë shumë probleme.

Në fillim kriza preku veçanërisht vendet e zhvilluara. Më vonë ky rrezik nga këto vende u transmetua me shpejtësi në vendet në zhvillim. Kriza ekonomike globale e cila ishte shfaqur në tregun e hipotekave në SHBA, në vjeshtën e vitit 2008, u përhap me shpejtësi në sektorin real dhe ekonomitë e vendeve të tjera në botë. (Ozdemir & Kiliç, 2008)

“Kjo krizë tregoi që sektori i pasurive të paluajtshme dhe sektorët e ndërtimit janë të lidhura ngushtë, së bashku, ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të PBB-së kombëtare, nga mbikëqyrja e projektimit, ndërtimit, administrimit, shitjen dhe marrjen me qira të banesave, ndërtesave të zyrave, parqeve industriale, qendrave tregtare, spitaleve dhe hotele ndër ndërtime të tjera. Tradicionalisht, ato prona të paluajtshme u financuan përmes investimeve të kompanive aksionarët, përmes kredive të jashtme bankare, ose duke emetuar borxhe ose në disa raste, kapitalë në tregjet e aksioneve” (Rocha Chiu, Poo Rubio, etj, 2020)

Kjo krizë u transmetua ndjeshëm edhe në sektorin bankar për shkak të kredive që kishin marrë këto shoqëri. Gjithashtu, kjo krizë preku edhe shumë familje që kishin prenotuar dhe kishin paguar lekët për apartamente që sapo kishin nisur të ndërtoheshin. Prandaj, krijimi i vlerës është një term që po bëhet më i rëndësishëm në sektorin e pasurive të paluajtshme; prandaj, dëshmohet se është me interes të madh për aksionarët të njohin përfitimin e kompanisë para se të bëjë një investim (León-Gómez, Becerra-Vicario, etj, 2020)

Kriza në këtë sektor ka bërë që kushtet e punës të jenë më të vështira për punëtorët. Protestat e fundit të punëtorëve në ndërtimin e Aeroportit të ri të Stambollit zbuloi pakënaqësinë e përhapur me kushtet e punës në këtë sektor (Yilmaz, 2018). Edhe pse kriza botërore në sektorin e ndërtimit ia la vendin krizës për shkak të Covid 19, përsëri këtyre krizave do t’ iu vijë fundi. Duhet që në sektorin e ndërtimit të vendosen rregulla të qarta. Ndërsa dalim nga recesioni global, ne duhet të shqetësohemi, për perspektivat për të ardhmen, në mungesë të një shtyse të re për ndryshim (Wolstenholme, 2009).

3. Metodologjia

Në këtë studim u përdor metoda cilësore duke intervistuar 36 persona, që ishin sipërmarrës, punonjës, blerës, pra, që ishin të lidhur drejtpërdrejt me këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë. Numri i të intervistuarve u realizua duke u bazuar te shih(Nick , Emmel, 2013). Në fillim u formua një strukturë kryesore e punimit se ku do zhvilloheshin intervistat dhe brenda kësaj strukturë të intervistuarit u pyetën në mënyrë rastësore. Pyetjet ishin të hapura që t’iu jepej mundësia të intervistuarve të përshkruanin përvojën e tyre. Këto biseda zgjatën rreth 30 minuta. Pas përfundimit të intervistave, u realizua kodimi manual hap pas hapi.

Pyetjet që u ngritën para studimit ishin:

Sa e shtrirë është kriza në sektorin e ndërtimit ?

Cilat janë pasojat sociale të kësaj krize?

4. Rezultatet

Të dhënat tregojnë shtrirjen e krizës në sektorin e ndërtimit dhe pasojat e saj. Nga të dhënat e 36 të intervistuarve tregohet qartë se mungesa e shitjeve të apartamenteve, solli dhe nisjen e kësaj krize. Shohim më poshtë opinionet dhe mendimet reale të të intervistuarve:

“Sinani një sipërmarrës rreth të gjashtëdhjetave ndër të tjera thekson: Në fillim kishim shumë shitje apartamentesh pa përfunduar pallatin, dhe kishim mundësi të paguanim nënkontraktuesit që na bënin punimet. Me uljen e shitjeve sidomos mbas krizës që përfshiu Evropën në vitin 2008, filluam që nënkontraktuesve, për shkak të mungesës së likuiditeteve dhe për arsye ekonomike, t’iu jepnim apartamente. Për punën e kryer ata do të merrnin apartamente me vlerën e kësaj pune. Ata mund ta shisnin ose ta mbanin sipas dëshirës.

“Krenari, një nënkontraktues tjetër ndër të tjera thekson: “Puna na ecte në fillim mirë. Në momentin që nuk na jepnin lekë për punën e kryer por na afronin apartamente, aty filloi për ne kriza. Apartamentet mezi shiteshin dhe ne nuk kishim mundësi të paguanim punëtorët. Për këtë arsye filluam të jepnim çmim më të lartë kur puna ishte me kliring(shkëmbimi i punës së kryer me apartamente)

Si del edhe nga të dhënat e intervistove mungesa e shitjeve të apartamenteve filloi të shfaqte edhe fillimin e krizës në sektorin e ndërtimit, gjë e cila u reflektua ndjeshëm në ekonominë familjare të këtyre familjeve .

“Përparimi rreth 40 vjeç, një specialist që punonte në këtë sektor theksonte:” Mirë që puna ishte e vështirë, por edhe koha e punës ishte me shkëputje. Kishte periudha disa mujore që punonim, por kishte edhe muaj të tërë ku rrinim në shtëpi, pa punuar dhe pa u paguar”

“Dëfrimi specialist në këtë sektor, rreth 55 vjeç thekson:” Puna nuk është e rregullt, kishim periudha që punonim por edhe periudha që nuk punonim dhe ne paguheshim me ditë pune. Jam bërë disa herë gati ta lija këtë punë por nuk dija ku të veja. Sepse të vetmen gjë që di të bëjë është ndërtimi. Familja kishte kërkesat e saj dhe fëmijët duhej të ushqeheshin” Përvoja e këtyre të intervistuarve tregonte se ky proces kompleks ndikoi drejtpërsëdrejti në rritjen e shkallës së papunësisë, rritjen e konflikteve të shumta sociale qoftë kjo në familje apo dhe në shoqëri

Shkëlqimi një sipërmarrës deklaron se me mos shitjen e apartamente edhe përfundimi i pallatit ishte i vështirë dhe detyroheshim ta vononim ndonjëherë edhe një vit nga ajo që kishim në kontratë. Kjo solli edhe kontradikta me personat që kishin blerë apartamente.

Muharremi një blerës apartamenti deklaron: edhe pse i kisha paguar të gjithë vlerën e apartamentit, shoqëria ndërtimore nuk e përfundoi dorëzimin brenda 6- muajve dhe u detyrova që këto 6- muaj të paguaja qira.

Mungesa e shitjeve bëri që apartamentet të mos përfundonin në kohë, dhe shumë blerës rrinin me ankthin nëse do përfundonte ose jo apartamenti i tyre dhe më në fund dhe të mbaronte një herë e mirë kalvari i vuajtjeve të shumta .

5. Diskutime

Siç del edhe nga studimi, kriza në sektorin e ndërtimit u thellua më shumë në momentin që kriza ekonomike përfshiu Evropën. Kjo për shkak edhe se shumë të ardhura për blerjen e këtyre apartamenteve vinin nga emigrantët.

Në momentin që ata ngelen pa punë nuk kishin mundësi jo vetëm të blinin apartamente ose të ndihmonin familjet në Shqipëri. Kriza në këtë sektor u ndie shumë edhe për shkak se shumë shoqëri ndërtimore nuk kishin mundësi financiare ta përfundonin pallatin deri në fund. Ata kishin një pjesë të vogël të financimit dhe pjesën tjetër e përfitonin nga shitja e apartamenteve.

6. Konkluzione

Për ta shmangur përsëritjen e një krize të tillë duhet që shoqëritë ndërtimore para se të marrin një leje ndërtimi duhet të kenë mundësi financiare gjithashtu duhet që lejet e ndërtimit të thjeshtohen dhe të jepen me lehtësi. Në mënyrë që ky sektor të gjallërohet përsëri dhe sigurisht të mos ketë pasoja negative në familje ashtu edhe në shoqëri.

Literatura:

Ana León-Gómez1.,, Rafael Becerra-Vicario2., & Daniel Ruiz-Palomo2 "Analysis of Value Creation in Real Estate" American Journal of Humanities and Social Sciences Research (AJHSSR) Volume-5, Issue-1, pp-463-472

Andreëw Wolstenholme., S Austin., M Bairstoë., & A Blumentha., "Never Waste a Good Crisis A Review of Progress since Rethinking Construction and Thoughts for Our Future" 2009 - repository.lboro.ac.uk.

Beqja, H., Rreth edukatës qytetare, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1983.

Civici, A(2009). Globalizimi, Shtëpia Botuese "UET", Tiranë.

Erkan, O., Serkan, K., (2008) Global Economic Crisis And The Construction Sector: A Field Research From Marketing Perspective, (https://ideas.repec.org/a/and/journl/v11y2011i2p43-68.html).

Emmel, N., (2013). Sampling and choosing cases in qualitative research: A realist approach. London, SAGE Publications Ltd doi: 10.4135/9781473913882

Fletore zyrtare Nr 56, 8 Maj 2009.

Fuga, A. Rënia e Qyteteve, Shtëpia Botuese "Papirus", Tiranë pa vit botimi.

Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë(INSTAT): Treguesi si pas qarqeve 2007-2008, fq71.

Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë(INSTAT): Shqipëria në shifra 2010 fq 14.

Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë(INSTAT): Shqipëria në shifra 2013.

Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë(INSTAT): Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike jo bujqësore. 2012

Luis Rocha Chiu1 , Aurora Poo Rubio1, Víctor Jiménez Argüelles1 , Víctor Lara Poó " The Impact of COVID-19 on the Price Performance of Real Estate

Investment Trusts (REITs) in Mexico" International Journal of Real Estate Studies. (https://www.utm.my/intrest/files/2021/01/7_Final_MS_CRES-Covid-028_Latest.pdf).

Martinelli,F., Guidicini,P.,(1993) "Le nuove forme di urbanità"

Misja, V., Vejsiu, Y.,(1984).Shndërrimet demografike të familjes në RPSSH, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë .

Revista "Monitor" nr. 37 dt 27 shtator 2010 fq.27

Revista "Monitor" nr. 5 dt 07 shkurt 2011 fq.18.

Revista "Monitor" nr. 9 dt 7 mars 2011 fq. 28.

Revista "Monitor" nr. 11 dt. 22.03.2011, fq. 10.

ttps://www.tandfonline.com/author/Kildien%C4%97%2C+Simona"& Kaklauskas, Arturas., 92011)."COPRAS based Comparative Analysis of the European Country Management Capabilities within the Construction Sector in the Time of Crisis" Journal of business economics and management, volume 12, (https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.3846)

Volkan, Y.,(2018). Unequal Turkey Under Construction, , Https:// www. Researchgate, net/profile/Volkan-Yilmaz 3/ publication.

TEATRI EDUKATIV SI METODË E TEJKALIMIT TË PASOJAVE PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS GJATË LUFTËS SË KOSOVËS

Marigona Bekteshi Ferati
Drejtor i "Mitrix Culture", Kosovë
marigonabekteshi3@gmail.com

Abstrakti

Ky studim hulumton pasojat afatgjata të dhunës seksuale dhe tejkalimin e traumës te të mbijetuarat e dhunës seksuale përmes teatrit edukativ.Pjesëmarrëse në këtë hulumtim kanë qenë 30 gra te mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë dhe janë intervistuar 4 gra, të cilat kanë rrëfyer në detaje ngjarjen e dhunimit seksual dhe jetën e tyre pas luftës.Për pjesën kuantitative janë përdorur tre pyetësor vetëraportues, pjesa kualitative është realizuar përmes një interviste gjysmë të strukturuar, ndërsa rrëfimet e të mbijetuarave janë transkriptuar, pastaj janë përdorur në shfaqjen teatrale "MBRETRESHAT PA KURORË", e cila ishte pjesë e këtij studimi.Hipoteza e parë e cila lidhet direkt përjetimin e dhunës seksuale dhe me pranimin social nuk rezultoi sinjifikante, megjithatë, nga intervistat janë nxjerrë rezultate që konfirmojnë ndikimin e dhunës seksuale në pranimin social të të mbijetuarave në rrethin etyre. Hipoteza e dytë doli të jetë e konfirmuar pasi që sipas rezultateve të nxjerra viktimat e dhunës seksuale kanë nivel të lartë të stresit posttraumatik, ndërsa të dhënat gjithashtu vërtetojnë edhe hipotezën e tretë që për shkak të stigmatizimit, të mbijetuarat jenë të përjashtuara dhe vet përjashtuara nga aktivitetet kulturore.

Fjalët kyçe: *Dhuna seksuale gjatë luftës, teatri edukativ, pranimi social, tejkalimi i traumës.*

Abstract

This study investigates the long-term consequences of sexual violence and overcoming trauma at survivors of sexual violence through educational theater.Participants in this research were 30 women survivors of sexual violence during the war in Kosovo and 4 women were interviewed, who recounted in details the event of sexual violence and their lives after the war.

For the quantitative part, three self-report questionnaires were utilized, the qualitative part was realized through a semi-structured interview, whereas the survivors' stories were transcribed, then used in the theatrical play "QUEENS WITHOUT CROWNS" which was part of this study.The first hypothesis, which is directly related to the experience of sexual violence and social acceptance, was not resulted as significant, however, from interviews were obtained results that confirm the impact of sexual violence on the social acceptance of survivors in their walks of life.The second hypothesis

turned out to be confirmed because according to the results obtained victims of sexual violence have a high level of post-traumatic stress, whereas the data also confirm and third hypothesis that due to stigmatization, survivors are excluded and self-excluded from cultural activities.

***Key words**: sexual violence during the war, educational theater, social acceptance, overcoming of trauma.*

1. Hyrje

Kanë kaluar më se njëzet vjet nga lufta mes Kosovës dhe Serbisë, prapëseprapë dhuna seksuale që u ushtrua ndaj kosovareve shqiptare gjatë asaj lufte ka mbetur temë e ndjeshme për gjithë shoqërinë në vendin tonë. Numri i konsiderueshëm i viktimave të dhunës gjatë luftës kushtëzon rëndësinë e ndërmarrjes së një projekti shkencor dhe një pune kërkimore që do ta mundësonte që rrëfimet nga dora e parë nga viktimat të viheshin në skenën dramatike. Qëllimi i këtij aktiviteti është ndryshimi i perceptimit të shoqërisë kosovare për të mbijetuarat e dhunës dhe ta fuqizojë atë shoqëri për t' iu dhënë mbështetjen e duhur sociale ashtu që më lehtë t'i përballojnë traumat.

Numër i konsiderueshëm i kosovareve rënë pre e dhunës seksuale gjatë luftës. Arritja e shfaqjes dramatike bazuar në fatin e tyre në Kosovë zbulon perspektivë të qartë mbi pasojat e atyre ngjarjeve te viktimat dhe ka pasur atë potencial që ofrojë ambient përkujdesjeje dhe mbështetje përmes teatrit edukativ. Njëri nga faktorët kryesorë për ta përballuar traumën është pranimi shoqëror i viktimave dhe në këtë kontekst si hulumtimi aktual ashtu edhe vetë shfaqja teatrale kanë ofruar qasje inovative në vendin tonë, mënyrë e cila u ka mundësuar atyre të flasin dhe t'i rrëfejnë tregimet e tyre ashtu që t'u dëgjohet zëri.

2. Aktualiteti dhe rëndësia e temës

Dhuna seksuale e njohur si armë ushtarake është shfrytëzuar me të madhe gjatë luftës mes Kosovës dhe Serbisë në periudhën 1998-1999. Nuk ka të dhëna statistikore të sakta për numrin e grave të dhunuara në Kosovë, prapëseprapë numri i përgjithshëm i viktimave të dhunës seksuale dhe keqtrajtimit nga forcat serbe në Kosovë sipas burimeve të ndryshme mund të arrijë në 20 mijë. Të mbijetuarat përballen me pasoja afatgjata dhe dëmtime në mirëqenien e tyre psikologjike, marrëdhëniet ndërpersonale dhe aktivitetet shoqërore, sepse izoloheshin nga familja dhe rrethi shoqëror ashtu që mbeteshin larg përgjegjësisë së institucioneve. Për ta tejkaluar traumën dhe ta vazhdonin jetën normale, ato kanë pasur nevojë që të përfshiheshin në aktivitete shoqërore dhe kulturore. Rrëfimet nga përjetimet që u kanë shkaktuar trauma edhe pse paraqitnin sfidë shumë të madhe për viktimën , sepse duhet të kthehej në atë kohë, t'i përkujtojë ato ngjarje dhe ta rrëfejë tregimin e saj. Rëndësi kulmore në vetëdijesimin e shoqërisë kosovare për të drejtën e tyre të natyrshme për pjesëmarrje aktive në komunitet dhe për rimëkëmbjen e mëtejmë të secilës veç e veç.

3. Teatri Edukativ

Sesioni i parë merr qasje edukative ndaj temës. Përkufizimet e shprehjes "edukativ" janë shtjelluar në pjesën e parë. "Edukimi përmes artit" ceket si shprehja kryesore sa i përket fokusimit në disertacion në pjesën e dytë. Ai përqendrohet në të kuptuarit se edukimi përmes artit është mjet zhvillimi i ndjeshmërisë, inteligjencës emocionale, aftësisë për analizim krahasues dhe pranimit të larushisë kulturore te njerëzit, që mundëson ruajtjen e baraspeshës pas efektit negativ të globalizimit përmes homogjenizimit të tij kulturor nga krijuesit edukativë me ndjenjën e vet të identitetit. Pjesa e tretë shtjellon dokumentet kryesore të UNESCO-s mbi edukimin përmes artit dhe sfidat në zbatimit të tyre në legjislacionin përkatës kombëtar. Korniza teorike ngushtohet më tej edhe me shprehjen "teatri edukativ". Është e rëndësishme të theksohet të kuptuarit e ndryshëm të shprehjes nga njerëz të ndryshëm dhe rreziku që të interpretohet gabimisht në aspektin gjuhësor dhe kulturor. Kjo temë mbështetet në të kuptuarit se shfaqje skenike e teatrit edukativ përçon porosi që mundësojnë të bëjnë ndryshim të fuqishëm në besimet dhe bindjet e spektatorëve për çështje dhe ngjarje të caktuara shoqërore. Ky lloj i shfaqjes është pika qendrore e punës kërkimore.

Rëndësi të madhe gjatë punës në shfaqjen "Mbretëreshat pa kurora" në krijimin e ndjenjës së saktësisë dhe vërtetësisë, pasi që skenari i shfaqjes ishte i punuar i tëri sipas tregimeve të vërteta, të rrëfyera nga të mbijetuarat e dhunës gjatë luftës së Kosovës. Ishte skajshmërisht sfiduese për aktorët që t'u bënin përshtypje spektatorëve me gjithë vërtetësinë e ngjarjeve, sepse ato interpretoni episodet më tronditëse jetësore, të cilat kurrë nuk e kishin përjetuar personalisht.

Shtylla e dytë e rëndësishme teorike që është vërejtur në procesin praktik të drejtimit të shfaqjes lidhet me atë që Stanislavski e quan "kujtime emocionale" Është shumë e rëndësishme që spektatori të di se keni aktruar në botën tënde dhe çfarë keni ndier. Në rastin e veçantë tonin, iu drejtuam asaj që aktorët mund të nxjerrin nga jeta e tyre private dhe informatave që kishin marrë për realitetin jo aq të largët historik në vend, si dhe njohurive të përditshme që përdoren për kontakte dhe miqësi. Përfshirja e psikologes klinike ishte gjë me vlerë në këtë segment pune. Procesi ishte mjaft intensiv dhe psikologja zhvilloi strategji të strukturuar profesionale veçanërisht për këtë shfaqje.

4. **Augusto Boal dhe "Teatri i të shtypurve"**

Augusto Boal (1931-2009) është autori teatral i vetëm botëror që arriti t'i zhvillojë disa forma të reja dhe të ndryshme teatrale. Teatri i të shtypurve është metodë e çlirimit të ndjenjave të shtypura dhe pozicioneve shtypëse. Është art skenik që merret me probleme sociale, politike dhe ekonomike, siç janë racizmi, varfëria, të pastrehët, dhuna gjinore, konfliktet fetare dhe etnike dhe rreziqet mjedisore.

5. Dhuna dhe teatri - ndikimet

Paraqitja i fenomeneve të ndryshme të rëndësishme për jetën njerëzore në media ka dështuar se ka ndikim mbi perceptimin e tyre shoqëror. Revistat, faqet e internetit, emisionet televizive dhe shfaqjet teatrale ndikojnë në shoqëri përmes jehonës së fortë dhe turpit shoqëror të sjelljeve të caktuara fajësuese. Në momentin kur një sjellje ose vepër antisociale fiton publicitet në media të ndryshme, fillojnë të marrin reagime nga publiku. E njëjta gjë vlen edhe për shfaqjet artistike që synohen dhe paraqiten në skenë para spektatorëve. Shoqëria kosovare reagon menjëherë në sërë temash që kanë të bëjnë me dhunën dhe reagimet kanë natyrë të ndryshme e nganjëherë edhe kontroversë. Qëllimi final për rikrijimin e akteve të dhunës në skenë është ndërgjegjësimi i publikut që reagon në anën negative të dhunës. Përmes teatrit edukativ, arti luan rol direkt dhe shumë funksional në parandalimin dhe zvogëlimin e rasteve kur shkelen të drejtat e njeriut. Madje, kjo metodë mund t'i ndalojë sjelljet e rrezikshme përmes krijimit të modeleve të reja të roleve, të materializuara në vepra artistike të zhanreve të ndryshme.

Pjesa e dytë ndalet në kornizën teorike të "teorisë së stigmatizimit", që direkt lidhet me temën e këtij punimi shkencor. Shprehja "stigmë" i referohet krejtësisht një cilësie diskredituese që duhet trajtuar në gjuhën e marrëdhënieve e jo në atë të cilësive.

Stigma mund të ndahet në tri kategori. Lloji i parë është stigma ndaj deformimeve të ndryshme fizike të trupit. Lloji i dytë ka të bëjë me pasionin e turpshëm dhe të panatyrshëm që konsiderohet dobësi; paturpësinë që buron nga çrregullimi mendor, alkoolizmi, homoseksualitetit, papunësia, tentimet e vetëvrasjes dhe sjellja radikale politike. Lloji i tretë bazohet në stigmën gjenetike ose racore, stigmën etnike që mund të bartet përgjatë tërë brezave dhe prek të gjithë anëtarët e familjes. Me fjalë të tjera stigma e bazuar në përkatësi racore ose etnike ose farefis është objekt i psikologjisë sociale që nga kohërat e lashta. Manifestimet përçmuese mund të jenë të dukshme - margjinalizimi shoqëror ose përndryshe mund të jetë rast i vetëstigmatizimit, largimit social etj. Stigma ka funksione të ndryshme përfshirë shfaqjen e forcës për mbajtjen e pabarazisë sociale dhe shtypjes.

Pjesa e tretë thekson pasojat afatgjata të ngjarjeve traumatike siç është dhunimi gjatë luftës. Përveç simptomave psikologjike viktimat shfaqin edhe pasoja fizike- dhimbje kronike të muskujve, presion të lartë të gjakut, mbipeshë, parregullsi në sistemin kardiovaskular. Është cituar edhe një shembull nga Bosnja fqinje. Studimi në fjalë ka arritur në përfundim se 21 vjet pas luftës në Bosnjë, 57% e të keqtrajtuarave seksuale ende vuajnë nga simptomat e PTSD-së.

Kjo prapaskenë thekson rëndësinë e statistikave nga lufta në Kosovë (1998-1999), të cilat shtjellohen në pjesën e katërt. Pavarësisht numrit të vogël të hulumtimeve të të dhënave statistikore për pasojat e luftës në Kosovë, punimet e botuara zyrtarisht zbulojnë para gjithë botës se çfarë ka ndodhur gjatë luftës mes Kosovës dhe Serbisë në periudhën 1998-1999. Raporti i "Amnesty International" thotë se intervistat me të mbijetuarat e dhunës gjatë luftës, të realizuara nga një përfaqësues kompetent kosovar nën mbikëqyrjen

e EULEX-it, rezultuan me këto të dala: Në periudhën deri në fund të luftës në qershor të vitit 1999, rreth 12 mijë qytetarë kosovarë u vranë, rreth 3 mijë ende janë të zhdukur dhe deri 20 mijë femra u dhunuan. Sipas këtij raporti, viktimat e dhunimit janë të moshës 7 deri 66 vjeç. Dhunimet e meshkujve përmenden, por pa ndonjë numër. Rreth 100 viktima mbetën shtatzënë nga këto dhunime dhe lindën foshnje, 50% të tyre ishin të infektuara me sëmundja ngjitëse seksuale ndërsa 20 gra vdiqën nga dhuna seksuale.

Pranimi shoqëror fillon nga familjarët, komuniteti dhe vetëm atëherë vazhdon në nivelin shtetëror dhe dëshmohet në aktivitetet sociale, punësimin etj. Kosovaret kanë përvoja të ndryshme me të afërmit e tyre. Disa prej tyre reagojnë me mirëkuptim dhe mbështetje, por shumica e tyre janë braktisur nga bashkëshortët ose familja e tyre e gjerë. Do të kishte gra në Kosovë që do të guxonin të flisnin dhe të kërkonin drejtësi, por u penguan nga familjet e tyre për shkak të fajit dhe turpit. Ato duhej të heshtnin dhe të përkeqësonin edhe më tepër stigmën dhe dhimbjen e tyre. Ky fakt demonstron mosgatishmërinë e familjarëve për të pranuar viktimën (motrën, gruan, nënën). Në shumë raste, fëmijët fillojnë ta shohin nënën e tyre si të ndyrë dhe të njollosur për shkak të paragjykimeve dominuese në rrethin e tyre. Madje besojnë se ajo më mirë do të ishte të vritej sesa të dhunohej. Kjo është pasojë e mendësisë patriarkale dhe normave morale në vend. Kosova nuk është shembull i vetëm kësi lloj qëndrimi. Është dëshmuar në shumë vende të shkatërruara nga lufta dhe konfliktet, se fati i viktimave të dhunës ka qenë i ngjashëm me të mbijetuarat e vendit tonë. Duhet kërkuar lidhshmëri mes aktit seksual dhe standardeve morale. Prapëseprapë duhet përmendur edhe atë që bashkëshorti e ka mbështetur gruan e tij të dhunuar në shumë raste në Kosovë si dhe e ka ruajtur familjen pavarësisht ngjarjeve të rënda.

Fatkeqësisht, gjëja më e keqe për të mbijetuarat e dhunimit gjatë luftës nuk ishte vetëm episodi mizor në vete. Shoqëria jonë shfaqë dhunë dytësore mbi ato viktima duke i privuar nga politikat qeveritare dhe qasja në rehabilitim. Shteti nuk i njeh si viktima të krimeve të luftës, kështu që dhunimi në mënyrë paradoksale mbetet fyerje brenda shtëpisë. Kjo është arsyeja pse viktimat kanë zgjedhur heshtjen si të vetmen përgjigje të duhur shoqërore ndaj së kaluarës. Shumica e studimeve të bëra te viktimat e dhunës seksuale të luftës dëshmojnë se stigmatizmi është fenomen mjaft i vërtetuar që ndikon në përjetimin e viktimave dhe ndikon në jetën e tyre. 100 foshnje kanë lindur dhe janë braktisur në Kosovë në janar të vitit 2000. Fiset familjare janë betuar të heshtin për këtë gjë e nënat e tyre kurrë nuk e kthyen kokën prapa të shohin se çfarë ka ndodhur me jetët e pafajshme të cilat paguan çmimin e luftës.

Është nxjerrë si përfundim se teatri edukativ luan rol të rëndësishëm në parandalimin e sulmit seksual dhe ndryshimin e normave shoqërore që ndërlidhen me seksualitetin. Teatri edukativ mund të jetë jashtëzakonisht i dobishëm aty ku ngjarje traumatike dhe emocionale veçse kanë ndodhur në shoqëri. Duhet marrë parasysh se shfaqjet teatrore edukative janë transformuese dhe mund t'i ndryshojnë perceptimet për dhunën seksuale si

dhe aftësinë e spektatorit për të pranuar dhe mbështetur çdo viktimë të këtyre akteve, pavarësisht rrethanave.

6. Objektivi Studimor:

Objektivi kryesor i temës së studimit është që të tërhiqet vëmendja për një metodë inovative në Kosovë për ta tejkaluar traumën te të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës që mund të jetësohet me sigurimin e efekteve terapeutike dhe ftesën për pranim shoqëror të viktimave në komunitet përmes ngritjes së ndërgjegjes së spektatorëve.

7.Objektivat e punës kërkimore :

Ky studim për herë të parë në Kosovë paraqet një punë kërkimore praktike për mundësinë e tejkalimit të traumave nga viktimat e dhunës seksuale përmes teatrit edukativ.

Studimi jep kontribut në zbutjen e stigmës te viktimat dhe ndihmon me të madhe në integrimin e tyre në shoqëri dhe në rrethin në të cilin ato jetojnë dhe punojnë.

Puna kërkimore synon që të përfshihet në procesin terapeutik të përballimit me traumë të të dhunuarave gjatë të luftës në Kosovë.

8. Metodat

Studimi është një kombinim i metodave kualitative dhe kuantitative. Për variablin e PTSD-së është përdorur pyetësori i standardizuar Harvard Trauma Questionnaire, i cili është i standardizuar në gjuhën shqipe dhe është përdorur edhe në studime të tjera për të matur PTSD në Kosovë. Pranimi social dhe shëndeti mendor është matur përmes pyetësorëve të hartuar enkas për këtë studim (shih shtojcën e punimit).Në anën tjetër, për marrjen e informacioneve për strategjitë ballafaquese dhe traumën, janë realizuar intervista klinike gjysmë të strukturuara, me kohëzgjatje 15-30 minuta.

8.1 Pjesëmarrësit/et

Pjesëmarrëse në këtë studim janë te mbijetuarat e dhunës civile të cilat marrin shërbime në qendrën *'Zyra qendrore LIVCLK- shoqata lidhja e invalidëve dhe viktimave civile të luftës në Kosove'* në Drenas. Pjesëmarrëse në këtë hulumtim janë gjithsej 30 gra, të cilat janë ndarë në tri grupe të fokusuara. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të identifikimit se në këtë komunë, është ekzaminuar ky numër minimal si viktima të dhunës civile dhe pjesëmarrja është bërë në baza vullnetare. Të gjitha gratë pjesëmarrëse i takojnë nacionalitetit Kosovarë dhe aktualisht jetojnë në qytete të ndryshme të Kosovës.

8.2 Procedura

Duke u nisur nga ndjeshmëria e temës që ky hulumtim e ka trajtuar realizimi i tij është ndarë në dy faza. Në fazën e parë pjesëmarrësit kanë plotësuar tre pyetësorët e lartpërmendur, qëllimi i të cilëve është ofrimi i të dhënave statistikore për trivariablet që e kanë udhëhequr hulumtimin: pranimi social, stresi postraumatik dhe shëndeti. Nga të dhënat që kanë dalë nga këta pyetësorë ato janë shqyrtuar, analizuar dhe janë nxjerrë rezultatet përmes

paketës SPSS- programit për analizë statistikore të të dhënave për hulumtime .Në fazën e dytë pas të dhënave dhe rezultateve që kanë dalë nga faza e parë është ndërtuar një intervistë gjysmë e strukturuar, nëkëtë interviste janëdhënërrëfimet ekskluzivisht përkëtë studim shkencor, intervistapërmbanrrëfimine detajuar se si ka ndodhur dhunimi dhe detajet e tjera përcjellëse (këtorrëfime me vone janëshfrytëzuarpërrealizimin e shfaqjes teatrale),janë intervistuar 5 (pesë) gra të po së njëjtës mostër. Intervistat janë incizuar me lejen e pjesëmarrësve dhe janë transkriptuar.

9. Konsideratat etike

Si**ç** është cekur edhe në seksionet e tjera të këtij hulumtimi, pjesëmarrësit dhe organizata janë informuar për procedurën e administrimit të pyetësorit si dhe për procesin e intervistimit. Njëkohësisht, ato janë informuar që **q**asje në të dhënat të cilat do të dalin nga studimi, do të ketë edhe mentori udhëheqës i hulumtimit si dhe janë informuar për anonimitetin e gjithë procesit. Gjithashtu, është marrë edhe pëlqimi i tyre për pjesëmarrje në baza vullnetare.

10. Hipotezat e punës kërkimore

Viktimat e dhunës seksuale në Kosovë janë përjashtuara nga rrethi i tyre shoqëror.

Shfaqja teatrale do të ndikojë dhe transformojë qasjen e spektatorëve ndaj viktimave të dhunës gjatë luftës.

10.1 Testimi i hipotezave

Hipoteza e parë, e cila lidhet drejtpërdrejt me përvojën e dhunës seksuale dhe pranimit shoqëror nuk rezultoi si domethënëse bazuar në analizën statistikore të pyetësorëve, megjithatë, nga intervistat e marra rezultate që konfirmojnë ndikimin e rëndë të dhunës seksuale në pranimin shoqëror të mbijetuarve në rrugët e tyre të jetës. Sipas rezultateve të marra nga pyetësorët megjithatë viktimat e dhunës seksuale kanë një nivel të lartë të stresit posttraumatike, ndërsa fragmentet nga intervistat tregojnë se për shkak të stigmatizimit, të mbijetuarit janë përjashtuar dhe vetëpërjashtuar nga aktivitetet kulturore. Intervista është intervista e drejtpërdrejtë që dha shumë ushqim për të menduar në lidhje me fatin e vështirë të grave pas ngjarjeve mizore.

Shfaqja teatrore do të ndikojë dhe transformojë qasjen e spektatorëve ndaj viktimave të përdhunimit gjatë luftës.

Spektatorët që morën pjesë në dramën "Mbretëreshat pa Kurora" tregojnë se shfaqja në mënyrë instiktive ndryshon mendimin e tyre për gratë e dhunuara dhe kjo fetë e rëndë e hollë i bëri ata të shihnin jetën ndryshe dhe të formulonin qëllime të reja për veten e tyre

Viktimat e abuzimit seksual do të ndiejnë dhe do të përjetojnë mbështetje emocionale nga publiku pasi drama e tyre njerëzore vizualizohet në performancën në skenë

Viktimat e përdhunimit gjatë luftës konfirmuan personalisht këtë hipotezë: "Unë po qaja gjatë gjithë shfaqjes, por gjithashtu mund të vëreja se njerëzit përreth meje nuk kursyen lot, ata përjetuan prerë me aktorët atë që kishim kaluar ..."

Familjet e viktimave në Kosovë do të rishikojnë perceptimin e tyre në lidhje me ngjarjen traumatike të dhunës seksuale të pësuar nga të afërmit e tyre më të ngushtë.

Një anëtar i familjes së një gruaje të dhunuar gjatë luftës ndan përshtypjet e tij:

M.H: “E dija që kishin vuajtur dhe ishin torturuar, por nuk e imagjinoja se ishte kaq e keqe dhe e keqe !!! Nuk mund ta besoja atë që gratë tona kishin vuajtur (në një tronditje).

Një i afërm tjetër që ndoqi shfaqjen ishte vetë kritik:

FL: "Si nuk i kuptuam ... si nuk u dhamë atyre një dorë ndihme .. sa shpesh i kemi fyer ato gra të varfra ... ato nuk e meritojnë qëndrimin tonë të gabuar, ata nuk donin që të u ndodhi atyre ... ishte e qartë se çfarë ata u bënë atyre.

11. Përfundime

Ky studim ofron për herë të parë në Kosovë një hulumtim praktik mbi potencialin për kapërcimin e traumave nga viktimat e dhunës seksuale përmes teatrit edukativ në një shfaqje të bazuar në historitë autentike të të mbijetuarve.

Studimi kontribuon në zbutjen e stigmës mbi viktimat dhe është i favorshëm për integrimin e tyre shoqëror në mjedisin shoqëror ku ata jetojnë dhe punojnë.

Metoda empirike e zbatuar nga hetimi aktual ofron të dhëna të rëndësishme statistikore për analiza të mëtejshme të temës në fjalë.

Ky hulumtim lejon që spektatorët, institucionet, media, OJQ-të, Zbatimi i Ligjit, për Shoqërinë Civile dhe për njerëzit me formim të ndryshëm profesional të dëgjojnë historitë e viktimave të treguara në vetën e parë dhe të shikojnë ato të vizualizuara në teatrin e qytetit të Mitrovicës.

Ky projekt promovon të drejtat e grave, vetë respektin e tyre dhe shëndetin mendor përmes mbështetjes emocionale të ofruar nga teatri arsimor.

Projekti i tanishëm shkencor, i cili do të vijoj edhe më tej, me synimin e një teme doktorature në Bullgari, publikon në Ballkan dhe më tej mbi këtë problem të madh humanitar të grave që u bënë viktima të përdhunimit gjatë kësaj lufte absurde në zemër të Evropës në prag të shekullit XXI.

Referencat

Artikulli i Amnesty International. Kompensimi për të mbijetuarit e përdhunimit gjatë luftës, por ende nuk ka drejtësi. Kosovë, 2017

Dimitrova, Blaga. Ballkaniada. Prishtinë, 2000. Përktheu Agim Vinca

Burns, M. Teatri Interaktiv dhe Improvizues: Drama dhe Performanca e Zbatuar. Janar 2007

Gardner, Lynn. The Guardian. 4 shtator 2013.

Goffman, E. Stigma. Simon & Schuste. New York.1986.

Husic, S., Siljak, I., Osmanovic, E., Dekic, & Heremic, L. Ne jemi akoma gjallë. Studim mbi pasojat afatgjata të përdhunimit të luftës dhe strategjitë e përballimit të të mbijetuarve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Medica Zenica & Medica Modiale. Zenica, Bosnjë dhe Hercegovinë. Shkrim EseKonkurrenca. 2015

Islamaj, Shefkije. Islamaj, Shefkije. Ne mi kazvaj ce me sanuvash. Në: Literary Balkans, Nr. 4, Sofia, 2005. Ed. R. Beyleri. Përkthyesi: Ralitza Mladenova

Owens, C. Pse dhe si mund të ndikojë teatri improvizues në mjediset e konfliktit dhe ndërtimin e paqes? Ankara 2014.

Radio Televizioni i Kosovës RTK. Dokumentar - Ulërime në heshtje. Kosovë, 2016.

Foshnjat e viktimave të përdhunimit Smith H. paguajnë çmimin e luftës. Kujdestar. 2000.

Snook B.H. dhe R. Buck. Politikat dhe praktikat brenda arsimit artistik. Në: Kërkime në Edukimin e Vallëzimit, f. 222. Universiteti i Auckland, Auckland, Zelanda e Re, 2014.

Stanislavski, K. Sistemi. Prishtinë: Rilindja, 1984. f. 61.

Wareham, R. Nuk ka vend të sigurt: Një Vlerësim i Dhunës ndaj Grave në Kosovë. Zhvillimi i Kombit të Bashkuar i Gjetur për Gratë (UNIFEM). Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID). Prishtinë, 2000.

Yohani S. dhe Hagen K. Gratë refugjate që mbijetuan nga dhuna seksuale e lidhur me luftën: një kornizë multikulturore për ofrimin e shërbimeve në vendet e zhvendosjes. Fondacioni i Traumës së Luftës. 2021.

PUNËSIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË DURRËS DHE SHIJAK

Fabiola Elezaj
Mësuese, Shkolla 9-vjeçare "Rilindja", Durrës
fabiola.elezaj@gmail.com

Abstrakt

Punësimi është një element kyç për jetesën normale të një personi, por kjo gjë nuk është e lehtë të arrihet nga personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara në qytetin e Durrësit dhe të Shijakut nuk po arrijnë të integrohen lehtësisht në shoqëri, por përkundrazi ndeshen çdo ditë me fjalë diskriminuese për ta, gjë që e bën akoma edhe më të vështirë procesin e punësimit. Politikat sociale në shtetin tonë ekzistojnë, por zbatimi i tyre nuk po shihet në asnjë institucion apo biznes, gjë që ndikon edhe në humbjen e besimit ndaj vetes tek këta persona. Ky studim ka synim të nxjerrë në pah arsyet e mos punësimit të personave me aftësi të kufizuara si edhe të japë disa rekomandime për të lehtësuar sadopak procesin e integrimit të tyre. Në shtetin shqiptar ka ende shumë punë për të bërë në lidhje me këta individë, duke filluar me pagesat e asistencës dhe duke përfunduar më qendrat e formimit profesionalapo qendrat e informimit për këto grupe individësh të cilët në dy qytetet e përfshira në studim nuk janë të pakta në numër.

Fjalë Kyçe: *Aftësi e kufizuar, punësim, politika sociale, diskriminim, përshtatje e arsyeshme, formim profesional*

Abstract

Occupation is a key element to living a normal person, but this is not easily achieved by people with disabilities. People with disabilities in the city of Durrës and Shijak not appear to easily integrate into society, but rather face every day with discriminatory words which makes it even more difficult process of employment. Social policies in our country exist but their implementation is not seen in any institution or business, which also affects the loss of confidence in yourself to these people. This study aims to highlight the reasons for not hiring persons with disabilities and to provide recommendations to ease the process of their integration. In Albanian state still has more ëork to do in relation to these individuals, starting with payments ending with assistance and vocational training centers or information centers for these groups of individuals who in two cities involved in the study are not outnumbered.

Key Words: *Disability, employment, social policy, discrimination, reasonable adjustments, vocational training.*

1. Hyrje

Studimi me temë " Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në Durrës & Shijak" është një temë e përzgjedhur e nxitur nga vëzhgimet e herëpashershme në dy qytetet Durrës dhe Shijak. Kjo temë është përzgjedhur me qëllimin e tillë për të dhënë vlerësimin e realizimit të së drejtës për punësim për persona me aftësi të kufizuara. Vlerësimi synon të japë informacion mbi numrin e gjendjen e kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara në këto qytete, mbi numrin e personave me aftësi të kufizuara të regjistruar si punëkërkues të papunë, aksesin që ata kanë në shërbimet aktuale publike dhe private të punësimit, te hedhë dritë mbi : tendencën për punësim nga vetë personat me aftësi të kufizuara; mbi vështirësitë dhe pengesat me të cilat ata ndeshen në realizimin e kësaj të drejte, si dhe të ofrojë informacion mbi mundësitë dhe faktin se sa i hapur është tregu aktuali punës për të akomoduar PAK.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë hapat e marrë dhe rezultatet e deritanishme të zbatimit të ligjeve nga institucionet; të zbulojë reagimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky studim është i nevojshëm për disa arsye: nxjerr në pah arsyet më madhore të papunësisë së personave me aftësi të kufizuara si edhe nxjerr shkaqet e ndryshme të diskriminimit të tyre në shoqërinë shqiptare. Ky studim synon të nxjerrë në pah arsyen se përse PAK nuk integrohen në shoqëri duke u bazuar në arsyet e ndryshme personale apo familjare të tyre, si edhe të shfaqë disa nga rrugët që personat me aftësi të kufizuara ti ndjekin për t'u integruar në shoqëri.

2. Të dhëna për PAK në Shqipëri

Të dhënat për PAK në Shqipëri janë të paplota, por bazuar në statistika zyrtare numri i tyre sa vjen e rritet.

Tabela 1. Numri i PAK në Shqipëri në vite të ndryshme.

Vitet	Numri i PAK
2003	75.044
2004	77.248
2008	105.972
2009	122.360
2010	133.000 3.7% 3 popullsisë

Personat me aftësi të kufizuara ndahen edhe sipas grupeve të ndryshme të vështirësisë pasi në bazë të ndarjes së tyre ata përfitojnë pagesat nga shteti për paaftësitë e tyre. Kjo ndarje është bërë nga KMCAP . Në Shqipëri është një ndarje e tillë si mëposhtë:

Tabela 2.Ndarjet e paaftësive në grupe dhe numri i tyre për çdo grup.

Ndarjet e personave	Gjithsej të vlerësuar nga KMCAP	Grupi i parë	Grupi i dytë
Individë me AK	61.975	16.794	46.181

Invalid punë	54.966	38.486	9.390
Totali	116.941	55.280	55.571

Nga Tabela.2 rezulton se në total është rreth 3.4% e popullsisë të vlerësuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Punës janë vlerësuar si të paaftë për punë. Ky total është në rang republike dhe vetëm 15.746 persona nga 116.941 marrin pagesë kujdestarie.

Duke filluar që prej vitit 2007, të dhënat statistikore për PAK janë të ndara sipas gjinisë, duke krijuar kështu mundësitë e analizës si dhe përfshirjen më të mirë të perspektivës gjinore në formulimin dhe zbatimin e politikave.

2.1 Të dhëna që lidhen me punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Statistikat zyrtare tregojnë se 47% e PAK janë bërë të tillë për shkaqe që lidhen me punësimin. Brenda kësaj skeme vetëm 2275 prej 9533 personave me aftësi të kufizuara të vlerësuar si pjesërisht të aftë për punë rezultonin të punësuar; tek ta pjesa më e madhe e punëve nuk kërkonte kualifikim. Sipas statistikave më të fundit zyrtare rreth 64% (nr. 75.348) e PAK raportohen të jenë në moshë pune.

Raporti i progresit i KE-së i vitit 2009 për Shqipërinë vë në dukje se aksesi për PAK mbetet ende problem. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2010 rezultojnë të regjistruar si punëkërkues të papunë 2112 PAK, prej të cilëve vetëm 2 janë punësuar; 15 persona me aftësi të kufizuara janë ndërmjetësuar për të ndjekur kurset në Qendrat e Formimit Profesional.

3. Vështrim në literaturë

3.1 Legjislacioni ndërkombëtar për aftësinë e kufizuar

Në mbarë botën është një numër prej1 miliardë persona të cilët kanë një aftësi të kufizuar; vlerësim ky i dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Aftësia e kufizuar mund të përfshijë dëmtim fizik, dëmtim ndijor, dëmtim njohës apo intelektuale, çrregullim mendor (e njohur edhe si aftësi të kufizuara psikiatrike ose psikosociale) ose llojet e ndryshme të sëmundjeve kronike. Një paaftësi mund të ndodhë gjatë jetës së një personi ose mund të jetë i pranishëm që nga lindja.

Në dekadat e fundit aftësia e kufizuar është bërë një çështje e nxehtë dhe e debatueshme, së pari, në arenën politike e, së dyti, në debatet akademike. Ndërhyrjet politike janë fokusuar në legjislacionin antidiskriminues, edukimit e transportit, rritjes së autonomisë, duke lëvizur nga skemat tradicionale të ofrimit të shërbimeve mjekësore dhe përkujdesit social. Në të gjitha nivelet lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, qeveritë kanë lidhje me qytetarët. Lidhja e qeverisë me qytetarët është e drejtpërdrejtë apo përmes organizatave të shoqërisë civile (OEDC, 2001).

Giddens (1993, cituar në Beckett 2006a), i definon lëvizjet sociale si "një grupim njerëzish që janë përfshirë në kërkim të realizimit apo bllokimit të një procesi ndryshimi social". Ka një interes në rritje në ditët e sotme për lëvizjet sociale mes individëve, anëtarëve të një shoqërie dhe institucioneve (Beckett, 2006a, fq.131). Scott (1990) e cilësoi lëvizjen sociale si një lëvizje

të nisur nga individi, të cilët kanë interesa të përbashkëta, specifika sociale dhe identitet të njëjtë (cituar nga Shakespeare, 2006). Oliver (1990, fq.113) argumentoi që lëvizja e aftësisë së kufizuar është një lëvizje sociale, e cila karakterizohet së pari nga përjashtimi nga politikat tradicionale; nga lidhjet personale me një politikë të caktuar; vlerësimi kritik i shoqërisë dhe post-materializmi.

Lëvizja e aftësisë së kufizuar është quajtur "lëvizje e re", bën pjesë në lëvizjet e iniciuara nga grupe të përjashtuara dhe përbën bazën sociale për politika e praktika transferuese. Është një lëvizje inovative, pjesë e betejës për demokraci përfaqësuese, drejtësi e barazi sociale. Mobilizimi rreth aftësisë së kufizuar si një lëvizje sociale, është i rëndësishëm për vetë njerëzit me aftësi të kufizuar dhe jo vetëm kaq, pasi ndikon në perceptimin dhe krijimin e koncepteve të aftësisë së kufizuar dhe jo vetëm kaq, pasi ndikon në perceptimin dhe krijimin e koncepteve të aftësisë së kufizuar në shoqëri (Shakespeare, 2006).

3.2 Direktiva Evropiane mbi Punësimin

Direktiva Evropiane mbi Punësimin 200/78 vendosi mbi shtetet e BE detyrime të shumta në lidhje me rishikimin e Legjislacioneve Kombëtare me qëllim ndalimin dhe luftimin e diskriminimit sipas qëllimit të parashikuar në direktivë. Kjo direktivë në fushën e punësimit për shkak të fesë apo besimit, orientimit seksual, moshës dhe aftësisë së kufizuar, parashikon ndalimin e diskriminimit, prurja më e re e kësaj direktive, përsa i përket AK është koncepti i përshtatjes së arsyeshme. Kjo kërkesë ishte dhe është komplekse.

3.3 Aftësia e kufizuar në legjislacionin shqiptar

Kjo pjesë e studimit do të paraqesë dhe analizojë ligjet shqiptare në lidhje me aftësinë e kufizuar duke filluar me përkufizimin e aftësisë së kufizuar.

"Person me aftësi të kufizuar janë ata persona te të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore".

Është konstatuar se vitet e fundit qeveria shqiptare i ka kushtuar vëmendje çështjes së aftësisë së kufizuar, veçanërisht në hartimin e politikave dhe të legjislacionit. Një nga fushat e cila mbetet problematike dhe ende s'ka gjetur rregullimin e duhur në kuadrin ligjor dhe në programe dhe praktika konkrete, lidhet me trajnimin profesional dhe punësimin e PAK.

4. Metodologjia

4.1. Hipotezat, kampioni, përgatitja e pyetësorëve

Në punim janë përdorur disa metoda për të nxjerrë të dhëna sasiore e cilësore. Metodologjia që u përdor për realizimin e studimit është e tipit deskriptive për dy qytetet e marra në studim Durrës dhe Shijak. Në këtë studim janë shënuar referencat bibliografike, pasi është shfrytëzuar jo vetëm një literaturë e gjerë me libra, artikuj të ndryshëm nga autorë të huaj dhe shqiptarë, por edhe informacione nga faqe zyrtare në internet në lidhje me

punësimin e PAK, legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar si edhe strategjitë për integrimin e këtyre personave në Shqipëri.

4.2. Hipoteza

Për të çuar më tej studimin tim dhe për ta bërë atë të vlefshëm kanë shërbyer hipotezat e mëposhtme të cilat vazhdimi i studimit do t'i vërtetojë ose do t'i hedhë poshtë ata për të nxjerrë, kështu, hipoteza dhe rezultate të reja.

Hipoteza1. Zbatimi i ligjit nuk aplikohet në pothuajse 98% të institucioneve shtetërore apo private (për të dy qytetet) si edhe nuk njihet nga shumica e pronarëve apo menaxherëve të këtyre institucioneve.

Hipoteza2. PAK nuk integrohen në jetën sociale, nuk ofrohen në qendrat shtetërore për punësim apo trajnim për arsye se: nuk kanë mbështetjen e familjarëve duke nisur kështu me bazat e diskriminimit; dhe nuk kanë besim në njohuritë dhe aftësitë e tyre (sidomos PAK të arsimuar) duke menduar kështu se i shmangen diskriminimit. Kjo vlen për rreth 95% të personave me aftësi të kufizuara në qytetet e studiuara.

4.3. Kampioni

Për studimin e gjendjes së punësimit të PAK në qytetet Durrës-Shijak, u përfshinë 33 pjesëmarrës PAK dhe 48 familjarë të tyre. Në studim morën pjesë edhe 8 drejtorë të institucioneve publike dhe 10 drejtorë të institucioneve private. Gjithashtu edhe14 pronarë/menaxherë biznesesh të cilat janë intervistuar me pyetje të mbyllura, por edhe janë intervistuar në mënyrë indirekte për arsyet e përmendura më lart.

U bë kujdes që pjesë e studimit të ishin të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar: në lëvizje, sëmundje mendore, sëmundje kronike dhe problem në shikim. Pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre janë përzgjedhur përmes bashkëpunimit me Zyrën e Punës Durrës, por në qytetin e Shijakut përzgjedhja është bërë nga njohje personale vetë personave dhe familjarëve. Drejtorët e institucioneve që u përfshinë në studim u zgjodhën me vështirësi pasi përzgjedhja e bërë paraprakisht nuk mundi të zbatohej me gjithë institucionet për arsye se nuk lejonin futjen e një personi jo të stafit në ambientet e biznesit apo institucionit duke ruajtur konfidencialitetin. Pas shumë përpjekjeve për të bërë negociata me ta u arrit që nga 10 institucione dhe 5 biznese të bëra në plan në listën fillestare u arrit të anketoheshin e intervistoheshin vetëm 3 institucione dhe 10 biznese; ndërkohë u bë një tjetër listë ku u shtuan 8 institucione dhe 10 biznese të cilat pranuan të plotësonin anketën.

4.4. Përgatitja e pyetësorëve

Të dhënat për realizimin e studimit u mblodhën përmes dy llojeve të pyetësorëve. Intervistat me pyetje të hapura dhe intervistat me pyetje të mbyllura të cilat janë ndërthurur me njëri tjetrin. Çdo pyetje është ndërtuar me synim nxjerrjen jo vetëm të informacionit parësor , por edhe të reagimit të çdo të intervistuari në çastin e plotësimit të intervistës. Çdo pyetje është hartuar në mënyrë të tillë që të kuptohet lehtë nga përgjigjedhënësit.

4.4.1 Intervista me drejtorët e institucioneve publike dhe private

Intervista me institucionet rajonale shtetërore u zhvilluan me 10 drejtorë të institucioneve publike, me drejtorë shkollash, drejtorë të zyrave të punës në Durrës dhe Shijak, me Drejtorinë Rajonale të Inspektoratit të Punës.

4.4.2 Intervista me komunitetin e biznesit

Me komunitetin e biznesit u krijua një pyetësor me pyetje kryesisht të mbyllura dhe me dy pyetje të hapura. Intervistat u realizuan me 14 biznese të ndryshme në të dyja qytetet e marra në studim. Pyetjet synonin të nxirrnin në dukje se sa akses kishin PAK në këto biznese, sa pronarë biznesesh i njihnin dhe e zbatonin ligjin në fuqi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, sat ë ndërgjegjësuar dhe përgjegjshmëri sociale kishin këta pronarë biznesesh në këtë drejtim si edhe të zbulonte pengesat me punësimin e kësaj kategorie, gjithashtu edhe mundësitë për eliminimin e tyre.

4.4.3 Intervista me fokus grupe me personat me aftësi të kufizuara dhe prindër të tyre

Në intervistim u përfshinë 10 fokus grupe me 81 pjesëmarrës, prej të cilëve 33 ishin persona me aftësi të kufizuara që u përkasin, kryesisht, grupit të invalidëve të punës (n=9), të verbër (n=7), para-tetraplegjik (n=10), me problem të ndryshme fizike (n=7), si edhe 48 prindër të tyre në dy qytetet ku u shtri studimi.

5. Rezultatet e studimit

5.1. Të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara në qytetet Durrës & Shijak

Qyteti i Durrësit -- kanjë popullsi prej mbi 206.470 banorë, ndërkohë që në vitin 2012 ishin vetëm 204.478 banorë.. nga një popullsi kaq e madhe rezultojnë rreth 5223 persona me aftësi të kufizuara, prej të cilëve vetëm 423 përfitojnë pagesë kujdestarie dhe 3037 prej tyre janë persona me aftësi të kufizuara në moshë pune. Prej tyre në moshë pune janë vetëm 58% (n=3037).Përsa i përket nivelit të arsimit apo të punësimit të tyre nuk ka të dhëna të sakta. Në qytetin e Durrësit shërbimet e vetme që ekzistojnë për personat me aftësi të kufizuara janë Shkolla Speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore me 111 fëmijë dhe Qendra Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim me 33 persona. Një institucion i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punësimit dhe formimit profesional të personave me aftësi të kufizuara është Qendra e Formimit Profesional e cila funksionon duke ofruar kurse të ndryshme për personat të cilët shprehin interes dhe dëshirë për të përfituar këto trajnime. Numri i personave që merrnin trajnim në këtë qendër gjatë vitit 2010 ishte 870 kursantë në total ku 5 janë persona me aftësi të kufizuara, ndërsa për vitin 2013 rezultojnë të regjistruar 6 persona me aftësi të kufizuara.

Qyteti i Shijakut – ka një popullsi prej 13.380 banorë, ndërkohë që në vitin 2012 ishin 13.288 banorë. Nga ky numër i popullsisë rezultojnë 305invalidë pune; janë 191 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 150 persona me aftësi të kufizuar, në total shkojnë 456 persona me aftësi të kufizuar. Nga 456 persona me aftësi të kufizuar rezultojnë plot 50% (n=228) persona

të tillë në moshë dhe aftësi pune. Prej këtyre personave rezultojnë vetëm 15 persona të arsimuar në shkollën e mesme të qytetit. Në këtë qytet nuk ka asnjë QFP apo shkollë speciale, gjë që sjell një vështirësi më të madhe për këta individë pasi të ardhurat e ulëta të familjes nuk arrijnë të bëjnë të mundur lëvizjen e shpeshtë të tyre në qendrën që ndodhet në Durrës, meqenëse është edhe qyteti më i afërt. Nuk ka as edhe një organizatë që të merret me këta persona përveç organizatave të cilat vijnë në qytet vetëm në ditët e shënuara si p.sh.: data 3 Dhjetor e cila është edhe dita ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara, si edhe për fushatat elektorale duke premtuar kushte më të mira dhe asistencë më të lartë për këta persona, premtime që nuk mbahen…

6. Diskutime, konkluzione dhe rekomandime

Në shtetin shqiptar ka barriera të shumta në lidhje me realizimin e procesit të punësimit dhe formimit profesional. Janë pikërisht personat me aftësi të kufizuara, familjarë të tyre si edhe institucionet përgjegjëse të cilët bëhen shkak i këtyre barrierave. Ka institucione shtetërore të cilët nuk janë ndërgjegjësuar dhe nuk e perceptojnë dot se edhe këta persona kanë aftësi dhe kapacitete për të punuar në fusha të ndryshme nëse u ofrohen disa lehtësime dhe përshtatshmëri për vendin dhe mjetet e punës.

Studimi tregoi se qasja e përfshirjes në formim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, është më tepër e nxitur dhe e modeluar nga organizatat e shoqërisë civile se sa është një objektiv strategjik i Qeverisë shqiptare. Mungesa e planifikimeve për këtë çështje, si strategjike ashtu edhe financiare e tregojnë këtë. Përshtatshmëria fizike e qendrave të formimit profesional por edhe e bizneseve apo institucioneve të ndryshme lë për të dëshiruar. Personat me aftësi të kufizuar gjenden në udhëkryqin midis opinionit dhe diskriminimit në çastin e frekuentimit të një pune apo të një qendre profesionale, por gjithashtu edhe duhet të përballen me kushte jot ë përshtatshme për ta apo edhe me një rrogë të ulët në rastin e punësimit. Si parakusht i domosdoshëm për të vlerësuar alternativat për punësim dhe formim profesional që tregu i punës ofron, personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre u nevojitet informacion. Ky informacion është detyrim ligjor të gjenerohet nga strukturat shtetërore përgjegjëse për punësim dhe formim profesional në nivel lokal. Gjithashtu të gjithë subjektet private që kanë në fokus trajnimin profesional duhet të informojnë komunitetin për shërbimet që ofrojnë. Mungesa e informacionit që PAK kanë për të drejtat e tyre për punësim dhe formim profesional bazuar në ligj, vjen, shpeshherë, edhe si pasojë e mungesës së mjeteve dhe formave të përshtatshmërisë të komunikimit, të domosdoshme për të garantuar aksesin në këtë informacion.

Subjektet private dhe ato publike megjithëse e kanë detyrim ligjor të punësojnë persona me aftësi të kufizuara, jo vetëm që nuk e bëjnë këtë siç duhet, por nuk sigurojnë as infrastrukturën e nevojshme për t'i paraprirë këtij procesi. Koncepti i gjithëpërfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në programe të ofruara për grupe të tjera në nevojë është ende i panjohur për qendra që ofrojnë shërbime punësimi e formimi profesional. Ka vend për

organizatat e aftësisë së kufizuar të rivlerësojnë punën e tyre në drejtim të organizimit, fuqizimit dhe përgatitjes së mëtejshme në aspekte që lidhen me avokatinë dhe lobimin për të njohur, për të rivlerësuar në mënyrë periodike dhe për të adresuar si duhet problematikat e anëtarëve të tyre. Disa nga rekomandimet e lartpërmendura kanë filluar të krijohen në qytetin e Durrësit, por ka ende shumë punë për të bërë të mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund të integrohen në shoqëri. Ndonëse në qytetin e Durrësit po fillojnë të ndjehen hapat e para të lëvizjeve, sado të vogla që janë ato, por në Shijak nuk ka asnjë lëvizje për këta persona. Duhet ende shumë punë për të arritur që edhe personat me aftësi të kufizuara të mund të integrohen në shoqëri pa u ndjerë të veçuar dhe të diskriminuar nga pjesa tjetër e shoqërisë. Nëse hapat e lartpërmendur fillojnë të shihen me seriozitet për zbatimin e tyre atëherë do të mund të kemi integritet të plotë në shoqërinë tonë.

Bibliografia

Beckett, A. (2006). Citizenship and vulnerability; dissability and issues of social and political engagement (Shtetësia dhe cënueshmëritë; kufizimet dhe çështjet e angazhimit shoqëror dhe politik). Neë York.:Palgrave Macmillan.

FSHDPAK. (Nëntor 2011). *Për një jetë dinjitoze përmes punës, Raport Vëzhgimi.* Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2006). *Respektimi i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore*: *Raport Vëzhgimi*, Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2008). *Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë vitit 2007: Raport monitorimi*, Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2010a). *Për një jetë dinjitoze përmes punës: Vëzhgim mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara në pesë rajone të Shqipërisë*. Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2010b). *Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Tiranë. FSHDPAK.

FSHDPAK. (2011). *Zbatimi i planit të veprimit të strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, Raport monitorimi.* Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2008) *Përgjegjësia Sociale e Komunitetit të Biznesit dhe Grupet në Nevojë, Raport Vëzhgimi.* Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (2011). *Punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri, Raport Studimi.* Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (Dhjetor 2006). *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Opsional.*New York.

FSHDPAK. (Shkurt 2010). *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.* Tiranë: FSHDPAK.

FSHDPAK. (Janar 2011*). Guidë Udhëzuese mbi Ligjin NR.10221, Datë 14/02/2010. Për Mbrojtjen nga Diskriminimi.* Tiranë: FSHDPAK.

Komisioni i Komunitetit Evropian. (2009). *Raporti i Progresit për Shqipërinë, Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillimin.* Bruksel.

MPÇSSHB. (2010a), *Strategjia lokale për personat me aftësi të kufizuara: Për një jetë më cilësore për personat me aftësi të kufizuara e familjet e tyre në qytetin e Durrësit,* Tiranë: MPÇSSHB.

MPÇSSHB. (2010b), *Manual i zbatimit të standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara*, Tiranë: MPÇSSHB.

OECD (2001), *Citizens as partners;handbook on information, consultation and public participation in policy making*, (parë më 10 Mars 2014,) http://oecd.org/home/0,2987,en_2649_201185-1-1-1-1-,00 html

Oliver, M. (1990), *The Politics of disablement*, The Macmillan Press, London.

Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të kufizuara. (2006). Tiranë.

EDUKIMI PARANDALON DHUNËN NDAJ FEMRËS

Ingrida Behri Mustafa[1], Lira Spiro[2]
[1]International Public Law, University "Aleksander Moisiu", Durrës
ingridaemustafa@gmail.com
[2]Departament of Justice, University "Pavarësia", Vlorë
liraspiro@yahoo.com

Abstrakt

Shoqëria njerëzore, edhe sot në shekullin XXI të ekzistencës së saj, vazhdon të ketë krimin bashkudhëtar të saj. Krimi shfaqet në të gjithë dimensionet shoqërore dhe ndaj kujtdo, qoftë grua, mashkull, i rritur apo i mitur. Në këtë punim, jemi ndalur në një temë që ndoshta për dikë mund të tingëllojë shumë e trajtuar, siç është dhuna ndaj grave, por në vizionin tonë për sa kohë ka gra të dhunuara, për sa kohë ka gra që vriten përditë, duhet të mos heshtim, duhet të flasim në çdo moment. Duke biseduar, trajtuar këtë temë, zëri ynë shkon përtej çdo dere shtëpie, shkon dhe te dera më e largët ku gjendet një grua e dhunuar dhe që nuk di si të veprojë.Konsiderojmë shumë të rëndësishme edukimin. Edukimi i cilitdo person, qoftë vajzë, qoftë mashkull. Shkolla ka rëndësi primare, ndoshta prindërit në shtëpi janë të zhytur në punë, ndoshta e mendojnë si një çështje që s'mund t'i prekë, por jo! Dhuna nuk parashikohet, dhuna nuk diferencon! Prek këdo! Ndaj të gjithë duhet të mobilizohemi dhe të edukojmë sa më shumë të gjithë shoqërinë për këtë fushë.

Abstract

Human society, even today in the XXI century of its existence, continues to have its fellow traveler crime. Crime manifests itself in all social dimensions and against anyone, whether a woman, male, adult or juvenile. In this paper, we dwell on a topic that may sound very treated, such as violence against women, but in our vision as long as there are raped women, as long as there are women who are killed every day, we should not stay silent, we must speak at every moment. By talking, addressing this topic, our voice goes beyond every home, goes to the farthest home where there is a raped woman, who does not know how to act. We consider education very important. Education of any person, whether girl or male. School is of primary importance, if the parents at home are busy at work, they may think of it as something they can not touch, but no! Violence is not predicted, violence does not differentiate! It affects everyone! Therefore, we must all mobilize and educate the whole society in this field as much as possible.

Keywords: *violence, women, protection, women's rights*

1. Metodologjia

Me qëllim që të identifikohen qartë problematikat dhe masat ndërhyrëse në të gjitha nivelet, është përzgjedhur metoda e kërkimit, metoda cilësore dhe sasiore, si dhe metoda e krahasimit të të dhënave statistikore. Kërkimi shkencor është bazuar mbi identifikimin e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, zhvillimet ligjore dhe akademike në lidhje me ndryshimet, që i janë bërë akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me mbrojtjen dhe dhunën ndaj grave. Është bërë një kërkim i raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me standardet, problematikat e konstatuara ndaj dhunës së çdo forme si dhe mbrojtjes së grave që hasin këtë ngjarje. Janë monitoruar faqet zyrtare të Organizatave Jofitimprurëse, të medias dhe shtypit online etj.

2. Një vështrim mbi dhunën ndaj grave

Çdo ditë, kudo në botë, edhe në vendet më të zhvilluara dhe me qasjen më të lartë kundrejt të drejtave të njeriut konstatohet dhunimi i femrave në forma nga më të ndryshme. Dhuna ndaj grave dëshmon, së pari, për cenimin, shkeljen e mosrespektimin e të drejtave të njeriut dhe së dyti për dhunimin e të drejtave të femrave.

Dhuna ndaj femrës shkel, dëmton dhe nuk lejon gëzimin nga gratë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Në të gjitha shoqëritë, në një shkallë më të madhe ose më të vogël, gratë dhe vajzat u janë nënshtruar abuzimit fizik, seksual dhe psikologjik. Dhuna ndaj grave gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit mes grave dhe burrave. Ajo është përjetësuar nga praktikat tradicionale dhe zakonore që përputhen me statusin më të ulët që kanë femrat në familje, vendin e punës, komunitet dhe shoqëri, dhe kjo gjendje është përkeqësuar nga presionet sociale.

Dhuna ndaj femrës është përkufizuar nga OKB-ja si: "*çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton në, ose ka të ngjarë të rezultojë në, dëm fizik, seksual ose psikologjik apo vuajtje për gratë, duke përfshirë kërcënime të akteve të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, të zhvilluara në publik ose në jetën private.*"

Bazuar në këtë përkufizim dallojmë format në cilat shprehet dhuna ndaj femrës janë:

Abuzimi emocional

Abuzimi emocional përfshin një sërë sjelljesh që synojnë të prekin karakterin e gruas dhe të shkatërrojnë ndjenjën e tyre të vetëvlerësimit dhe të vetëbesimit. Në fillim, një grua e dhunuar mund të reagojë ndaj kritikave dhe injorimit duke u përpjekur të ndryshojë veten ose për sjelljet abuzive të bashkëshortit/partnerit të saj, ajo mund t'ia hedhë fajin faktit që ai konsumon alkool. Megjithatë, me kalimin e kohës

shumë gra kuptojnë se asgjë që ato bëjnë nuk sjell ndonjë ndryshim dhe ndjenja e tyre për sigurinë në marrëdhënie minimizohet.

Abuzimi psikologjik

Abuzimi psikologjik ndryshon nga abuzimi emocional, duke përfshirë një gamë sjelljesh që kanë si synim të trembin dhe të shkaktojnë frikë te gratë, t'i kontrollojnë dhe t'i izolojnë ato nga familja dhe miqtë, dhe t'u mohojnë atyre mundësinë për të punuar jashtë shtëpisë ose nëse ato punojnë jashtë shtëpisë, për t'u marrë dhe për të kontrolluar pagën e tyre. Gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh jetojnë në frikë, përjetojnë ankth dhe vështirësi në përqendrim, kanë performancë të dobët në punë, paraqesin probleme shëndetësore fizike dhe rrezikojnë seriozisht të kalojnë në depresion dhe gjithashtu janë të rrezikuara nga mendimet dhe përpjekjet për vetëvrasje.

Dhuna fizike

Kur njerëzit bisedojnë rreth dhunës në familje, shpesh i referohen abuzimit fizik të një bashkëshorti ose partneri intim. Abuzim fizik është përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që e lëndon ose e rrezikon atë person. Abuzimi fizik në situatat e dhunës në familje përfshin një gamë të gjerë sjelljesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në goditje, rrahje, rrëmbime, shkelmim, mbytje, shkulje të flokëve dhe sulm me armë. Sulmi fizik ose rrahja e një partneri ose e një anëtari të familjes konsiderohet krim qoftë kur ndodh brenda shtëpisë, qoftë kur ndodh jashtë saj.

Dhuna fizike përbën akte që synojnë të dëmtojnë viktimën dhe përfshijnë, por nuk kufizohen në to,:

- Të shtyra; Rrëmbim; Përdredhje krahu; Shkulje flokësh; Shuplaka; Shkelmim; Kafshim; Përpjekje për të mbytur; Të djegurit; Goditja me armë; Goditja me thikë etj.

Dhuna seksuale

Dhuna seksuale përfshin çdo situatë në të cilën një grua detyrohet të marrë pjesë në një aktivitet seksual të degraduar, të padëshiruar ose të pasigurt (kjo përfshin seksin e detyruar nga ana e bashkëshortit/partnerit me të cilin gruaja kryen gjithashtu seks me pëlqimin e saj).

Këto përbëjnë format e shprehjes së dhunës, të cilat mund të shprehen të veçuara ose të kombinuara me njëra tjetrën. Një formë tjetër e dhunimit të femrës por që kalon përmasat e vetëm dhunës ndaj femrës është trafikimi femrave, që e prek rëndë dinjitetin dhe të drejtat e liritë themelore të femrës. Sot trafikimi përbën një problem tepër serioz jo vetëm në nivelin kombëtar por gjithnjë e më shumë po merr vëmendje e trajnim nga niveli ndërkombëtarë përsa kohë trafikimi shoqërohet me kalim kufijsh dhe prek më shumë se një shtet.

Trafikimi femrave është pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore, që përben një sfidë të kohës që kërkon marrjen e masave adekuate për t'u luftuar. Trafikimi i qenieve njerëzore është një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut që në vitet e fundit ka shkaktuar zemërim publik dhe politik dhe ka çuar në hartimin dhe zbatimin e traktateve ndërkombëtare dhe veprim të konsiderueshëm kombëtar në plan për të luftuar këtë fenomen çnjerëzor.

Trafikimi i qenieve njerëzore, veçanërisht të miturve dhe grave të reja, për qëllime të shfrytëzimit seksual është bërë një çështje që shkakton shqetësimit të madh në nivel global për shkak të rritjes së shpejtë të saj në vitet e fundit. Fenomeni është bërë më trans nacional në këtë drejtim. Një tipar i rëndësishëm i rritjes në trafikimin e qenieve njerëzore ka qenë përfshirja e organizatave kriminale që shfrytëzojnë kërkesën e njerëzve për mërgim që vijnë nga vendet e varfra.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një nga shkeljet më të rënda të drejtave të njeriut të përhapura sot. Shkeljet e të drejtave të njeriut janë si një shkak dhe një pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore. Trafikimi është një shkaktar i shkeljeve të të drejtave të njeriut, Të drejtat e njeriut e të personave që trafikohen të cilët trajtohen si mallra janë shkelur për shkak se ata janë shfrytëzuar si punëtorët, janë të privuar nga liria e tyre të lëvizjes, shpesh u mohohet qasja në kujdesin shëndetësor dhe, në rastin më të keq, janë të privuar nga e drejta e tyre për jetën. Trafikimi është gjithashtu një pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, si persona të trafikuar, veçanërisht gratë, kanë përjetuar shpesh shkeljen e të drejtave të tyre, duke i ekspozuar ato më shumë ndaj rrezikut të shfrytëzimit dhe abuzimit.

Një formë tjetër e dhunimit të drejtave të grave konstatohet në fushën e politikës. Dhuna ndaj femrave në politikë është dhuna që ndodh në sferën politike, por që në mënyrë specifike prek gratë. Dhuna ndaj femrës në politikë është përdorur për të përforcuar strukturat tradicionale shoqërore dhe politike duke synuar që të rritet numri i grave liderë, gjë kjo që sfidon patriarkatin dhe pritjet mbizotëruese shoqërore. Studime të ndryshme konfirmojnë se femrat në politikë, janë pre e dhunës të llojeve dhe dimensioneve të shumta dhe në të gjitha nivelet. Femrat përballen me faktin se atyre nuk u lejohet të marrin vendime; ato janë zakonisht të rreshtuara brenda partive politike, perceptohen të jenë më pak të afta për të fituar vende politike dhe si pasojë nuk ju është dhënë mundësia për të kundërshtuar zgjedhjet. Femrat gjithashtu përjetojnë izolimin politik për shkak të mos ndjekjes së linjave partiake që janë udhëhequr nga anëtarët e partisë meshkuj. Ato gjithashtu nganjëherë përballen me poshtërimin që u bëhet nga përdorimi i simboleve të papërshtatshme gjatë zgjedhjeve. Femrat gjithashtu rrezikojnë të përjetojnë dhunë fizike dhe ngacmime dhe ka raste të panumërta të grave politikane (dhe

parlamentarëve) që përjetojnë dhunë gjatë fushatave zgjedhore dhe vizitave të tjera në zonat e tyre.

3. Arsyet e dhunës ndaj femrës

Zhvillimi programeve dhe ndërmarrja e masave për të luftuar dhunën ndaj femrës kërkojnë zbulimin e shkaqeve të dhunës ndaj femrave. Është shumë e rëndësishme të kuptohen shkaqet e dhunës së femrës në mënyrë që duke zgjidhur dhe duke punuar mbi këto shkaqe mund të arrihet me sukses dhënia fund apo minimizimi i dhunës ndaj femrës.

Janë zhvilluar hulumtime të shumta për zbulimin e arsyeve se pse femrat janë viktimë e dhunës qoftë nga partneri intim apo kushdo tjetër. Disa arsye se përse partneri intim apo anëtarë të ndryshëm të shoqërisë kryejnë dhunë ndaj femrës dhe kjo e fundit shndërrohet në viktimë krimi janë: Niveli i ulët i arsimit; Qenia dëshmitarë të dhunës në familje; Çrregullime të personalitetit; Përdorimi i alkoolit; Xhelozia; Niveli i ulët ekonomik; E kaluar e dhunshme; Mosmarrëveshje martesore dhe pakënaqësi; Vështirësi në komunikimin në mes të partnerëve.

4. Dhuna ndaj gruas në EU

Sistemi evropian përkrah zhvillimit të masave e legjislacionit në mbrojtje të të drejtave të njeriut ka ndërmarrë nisma në luftën kundër dhunës ndaj femrës.

Ndikimi i dhunës ndaj grave shtrihet përtej atyre femrave që kanë qenë viktima e kjo pasi dhuna ndaj femrës prek familjet, miqtë dhe shoqërinë si një e tërë. Dhuna ndaj femrës bën thirrje për një vështrim kritik në mënyrën se si shoqëria dhe shteti duhet të përgjigjen për këtë dhunim. Ndaj janë mëse të nevojshme masat për të luftuar dhe parandaluar dhunën ndaj grave qoftë në nivelin e Bashkimin Evropian, qoftë në nivelin kombëtar.

Masat në nivel evropian që mund të shërbejnë për të luftuar dhunën ndaj femrës përfshijnë Direktivën e Viktimave të BE-së (2012/29/EU) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

- Direktiva e Viktimave të BE-së, e miratuar në vitin 2012, përcakton standardet minimale mbi të drejtat, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të krimit në BE, dhe bën në mënyrë specifike referencë për viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e dhunës seksuale dhe viktimat e dhunës në një marrëdhënie të ngushtë.

- Konventa e Stambollit, të cilin Këshilli i Evropës e miratoi në vitin 2011, është instrumenti i parë ligjor detyrues rajonal në Evropë që trajton tërësisht format e ndryshme të dhunës ndaj femrës, të tilla si dhuna psikologjike, dhunën fizike, dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual. Konventa ka hyrë në fuqi pas 10 ratifikimeve. Rekomandimi

5 (2002) i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi mbrojtjen e grave nga dhuna;

- Rekomandimi 17 (2007) i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore;
- Raporti Final i Aktivitetit të Fushatës së Këshillit të Evropës "*Stop Dhunës në Familje ndaj Grav*e", 2006-2008.

Konventa e Stambollit synon të parandalojë të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën ndaj vajzave, nga aktet e dhunës që kanë ndodhur deri në masat parandaluese, si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse që gjithashtu kërkon mbrojtjen e viktimave, ndjekjen penale të kryerësve dhe zhvillimin e politikave të integruara.

Dëshmitë nga hulumtime të gjera të kryera në BE për dhunën ndaj femrave tregojnë se shumica e femrave që janë viktima të dhunës nuk i raportojnë përvojat e tyre qoftë në organet e policisë apo në ndonjë organizatë në mbështetje të viktimave. Si rezultat, shumica e femrave që janë viktima të dhunës nuk vijnë në kontakt me sistemin e drejtësisë dhe shërbime të tjera. Pra është e qartë se nevojat dhe të drejtat e shumë grave në BE aktualisht nuk zbatohen në praktikë.

Komisioni Evropian është duke zbatuar veprime konkrete për të eliminuar dhunën ndaj femrave. Grat dhe vajza, viktima të dhunës kanë nevojë për mbështetjen dhe mbrojtjen e duhur, e cila është e përforcuar nga ligjet në fuqi. Rregullat e legjislacionit të krijuar nga BE përcaktojnë disa të drejta minimum për të gjitha viktimat, që sigurojnë:

- Trajtim me respekt nga oficerët e policisë të trajnuar mirë, prokurorët dhe gjyqtarët dhe mundësinë për të marrë informacion të kuptueshëm për të drejtat e tyre;
- Përkrahje të specializuar në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian;
- Pjesëmarrje në procedurat e drejtësisë dhe të kenë të drejta të caktuara (të tilla si të drejtën për t'u dëgjuar, e drejta për ndihmë ligjore, e drejta për interpretim të ligjit, të përkthimit, të drejtën për të rishikuar një vendim, për të mos u ndjekur penalisht etj.);
- Mbrojtje nga viktimizimi sekondar dhe të përsëritur, nga frikësimi dhe nga hakmarrja gjatë hetimeve të policisë dhe të procedurave gjyqësore (p.sh. duke kufizuar numrin e intervistave dhe ekzaminimet mjekësore në minimum, duke siguruar masa të veçanta për të shmangur kontaktet vizual me kryerësit gjatë procedurës gjyqësore etj).

5. Dhuna ndaj grave në Shqipëri

Vitet e fundit, në media janë raportuar shumë raste të dhunës ndaj femrës, disa prej tyre kanë qene ekstreme, duke i marrë jetën femrës, në këtë mënyrë dhuna ndaj femrës është shtrirë në përmasat e një

fenomeni mjaft shqetësues në Shqipëri. Një fenomen që në fakt i ka gjurmët në historinë e traditat e vendit, pra nuk përbën risi.

Shoqëria shqiptare ka një histori të gjatë të dominimit mashkullor nën të cilën femrat janë mësuar tu binden burrave të tyre dhe të pranojnë rolin e tyre nënshtruar, një reflektim i traditave të forta patriarkale të Ballkanit. Para Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte një vend kryesisht rural me një kulturë të fortë fshatare. Kjo do të thotë se vlerat tradicionale patriarkale kanë dominuar pjesën më të madhe të shoqërisë, përcaktimin e roleve gjinore dhe marrëdhëniet që vazhduan edhe gjatë epokës komuniste dhe, në një masë të konsiderueshme edhe në të tashmen. Familja rurale patriarkale kultivon idealin e një gruaje të nënshtruar dhe pasive, të bindur fillimisht ndaj të atit, dhe më vonë ndaj bashkëshortit. Superioriteti i burrit është pjesë e brendshme e kësaj tradite. Rrënjët e keqtrajtimit të grave shqiptare nga burrat datojnë në shekullin e 15-të dhe janë të lidhura me kodin tradicional të ligjeve zakonore të njohur si Kanun. Sipas rregullave të Kanunit, një burrë ka të drejtë të rrahë dhe të poshtërojë publikisht bashkëshorten e tij, nëse ajo nuk i bindet atij. Burri lejohet t'i presë flokët e gruas së tij, ta dëbojë atë nga shtëpia me një kamxhik në mes të fshatit. Kanuni përcakton se një burrë mund ta vrasë gruan e tij për dy arsye: pabesi dhe tradhti. Kanuni i ndalon gratë nga të folurit me mysafirët që vizitojnë shtëpinë apo të hyjnë në dhomën e burrave pa u kërkuar nga burri i saj. Shumë burra, sidomos ata nga zona verilindore e vendit, ende u përmbahen këtij kodi tradicional, në të cilat gratë konsiderohen si plaçkë dhe mund të trajtohen si i tilla. Në disa zona të verilindje, ajo është ende e pranueshme rrëmbimi i grave të reja për martesë. Shumë gra ende e shohin pozitën e tyre sociale në kuadër të ligjeve zakonore. Kanuni është vetëm një nga faktorët që ndikon në pozitën inferiore të grave në shoqërinë shqiptare. Faktorë të tjerë përfshijnë niveli shumë të ulët të zhvillimit socio-ekonomik, niveli i lartë i varfërisë, niveli i ulët i arsimimit dhe mungesa e kulturës demokratike. Fakti që burrat vazhdojnë të dominojnë gratë deri në mesin e shekullit të njëzetë e vendos Shqipërinë në një kategori të veçantë në mesin e vendeve evropiane. Viktimat e dhunës me bazë gjinore janë gra dhe vajza të të gjitha moshave, grupeve sociale dhe arsimore apo profesioneve të ndryshme. Megjithatë, grupet më vulnerabël mbeten gratë e varfra, gratë kryefamiljare dhe vajzat, veçanërisht ato në komunitetet migratore të brendshme të ardhura nga zonat e ndryshme në rrethinat e Tiranës e Durrësit, studentet, gratë në veri të vendit ku tradita patriarkale është akoma e fortë dhe gratë në zonat rurale. Në shumicën e rasteve dhunuesit janë burra, të cilët njihen nga viktima: anëtarë të familjes, të afërm, fqinj dhe kolegë. Situata e rëndë e viteve të fundit është gjithashtu rezultat edhe i përpjekjeve të pamjaftueshme nga institucionet publike, të shoqërisë civile dhe të sektorit privat për të parandaluar dhunën mbi baza gjinore dhe për të mbrojtur e përkrahur viktimat e saj.

Në kuadër të mbrojtjes së femrës nga dhuna nga ana e shtetit Shqiptar janë ndërmarrë disa hapa në fushën e legjislacionit, le të përmendim:

- Shqipëria është anëtare e OKB-së që në vitin 1995 dhe ka ratifikuar Konventën "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas", me ligjin nr. 7767 datë 09.11.1993, si dhe protokollin shtesë të kësaj Konvente.
- Në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA), nenet 77 dhe 99 përcaktojnë detyrimet e Shqipërisë lidhur me ofrimin e mundësive të barabarta në punësim, në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë. Në kuadrin e bashkëpunimit social synohet përshtatja e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* përsa i përket mundësive të barabarta për gratë.

6. Përfundime

Ajo çfarë vërehet gjerësisht gjatë këtij studimi është se mbyllja e njerëzve në shtëpi, mbyll dhe disa mundësi të grave të dhunuara për të denoncuar dhunën që përjetojnë. Vlerat tradicionale i shtyjnë shumë gra që ta kuptojnë martesën si qëllimin më të rëndësishëm të jetesës së tyre. Gratë presin që nëpërmjet martesës të arrijnë kushtet e dëshirueshme sociale, e shohin atë si element kyç për identitetin e vetes. Disa e justifikojnë dhunën duke fajësuar veten se kanë dështuar në rolin e tyre si bashkëshorte, rast ky që i çon gratë të heshtin dhe të shpresojnë se sa më shumë kohë të kalonin bashkëshortët e tyre jashtë shtëpisë, aq më të mbrojtura ishin ato, mit ky që ra gjatë periudhës së pandemisë sepse tashmë dhuna nuk vinte as nga abuzimi me alkoolin, as nga gjendja ekonomike e as nga xhelozia, dhuna vjen nga mendësia kriminale e tyre.

7. Rekomandime

Kriminaliteti femëror kërkon ndërmarrjen e masave të koordinuara për të ulur qoftë masën e dhunës ndaj femrës dhe masën e përfshirjes së femrës në krim.

Ndaj po paraqes këto rekomandime për situatën e kriminalitetit femëror në Shqipëri:

- Zhvillimi dhe realizimi i programeve, projekteve ndërgjegjësimin e femrave për të drejtat e tyre dhe për denoncimin e dhunës së ushtruar ndaj tyre;
- Zhvillimi nga ana e organeve shtetërore dhe organizatave të ndryshme të shërbimeve psikologjike, për këshillimin dhe përkrahjen e femrave të dhunuara;
- Zhvillimi i trajnimeve për stafin e organeve që kanë në detyrë trajtimin e kriminalitetit femëror si të strukturave të policisë, në paraburgim dhe në vendet e ekzekutimit të vendimeve penale.

- Qëndrimi pranë femrave të dhunuara, përkrahja e tyre maksimale dhe zhvillimi i mundësive për përfshirjen e tyre në programe të caktuara edukuese e për t'i dhënë një arsimim profesional.
- Programe për përkrahjen e mbështetjen e fëmijëve të femrave të dhunuara në mënyrë që të minimizohen në maksimum pasojat e rënda që krijohen tefëmijët nga dhuna në familje.
- Zhvillimi i programeve të caktuara në institucionet e vuajtjes së dënimit penal në fokus aktivizimin e femrës, edukimin dhe arsimimin e vazhdueshëm të tyre.
- Ndërmarrja e masave rehabilituese për femrën në mënyrë që pas daljes nga institucionet e vuajtjes së dënimit penal të jetë më e përkrahur për zhvillimin e jetesës sa më normale.

Legjislacion

1.Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

2.Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë.

3.Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*".

PËRCAKTIMI I SHKALLËS SË RËNDËSISË SË ROLIT TË PSIKOLOGUT SHKOLLOR NË TRAJTIMIN E FËMIJËVE ME PRINDËR TË DIVORCUAR

(Rasti i Shkollës jopublike "Turgut Ozal"Durrës)

Irena Telha[1], Denada Quku[2]

[1]Psikologe, Shkolla "Eftali Koci", Durrës

telhairena@gmail.com

[2]Departamenti i Sociologjisë, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

denada.quku@hotmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të tregojë rëndësinë e rolit të psikologut në shkollë, marrëdhënies prindër-mësues-psikolog në mbarëvajtjen fizike, emocionale dhe rritjen akademike të nxënësve, veçanërisht të fëmijëve me probleme familjare (të divorcuar ose në prag divorci), pasi përtej të qenit një çështje e brendshme e çiftit, kriza bashkëshortore bart rrezikun e ndikimeve të pafavorshme për marrëdhëniet në familje, për mirëqenien momentale psikologjike, si dhe për të ardhmen e pjesëtarëve të familjes në tërësi. Në këtë studim janë përdorur metodat cilësore: intervistë gjysmë të strukturuar të thelluar. Intervista konsiston në 11 pyetje të hapura lidhur me rëndësinë e rolit të psikologut në shkollë duke marrë në studim një psikolog, përkatësisht të shkollës jo-publike "Turgut Ozal" Durrës.

Nga të dhënat e mbledhura dolëm në përfundim se roli i psikologut është shumë i rëndësishëm në identifikimin e problemeve që në fazën fillestare të fëmijëve me prindër të divorcuar dhe në ndërhyrjen e menjëhershme duke përdorur Hartën Sociale dhe planifikimin e Planit Individual, duke u konsultuar me të gjithë aktorët e interesuar, si edhe pjesëmarrja në trajnime psikologjike është shumë me vlerë nga ana e psikologëve.

Fjalë kyçe: *Divorc, psikolog, marrëdhënie familjare, terapi, këshillim.*

Abstract

The purpose of this study is to show the importance of the role of the school psychologist, the parent-teacher-psychologist relationship in the physical, emotional well-being and academic growth of students, especially children with family problems (divorced or on the verge of divorce), as beyond being an internal affair of the couple, the marital crisis carries the risk of adverse effects on family relationships, on the current psychological well-being, and on the future of family members as a whole. Qualitative methods were used in this study: semi-structured in-depth interview. The interview consists of 11 open-ended questions regarding the importance of the role of the school psychologist taking into study a psychologist, respectively of the non-public

school "Turgut Ozal" Durrës. From the collected data we concluded that the role of the psychologist is very important in identifying problems from the initial stage of children with divorced parents and in the immediate intervention using the Social Map and Individual Plan planning, consulting with all stakeholders, as well as participation in psychological training is very valuable on the part of psychologists.

Key words: *Divorc, psychologist, family relationships, therapy, counseling*

1. Hyrje

Shërbimi psikologjik në institucionet arsimore para universitare përbën një risi për arsimin tonë kombëtar, çka hedh edhe një hap tjetër në përqasjen e sistemit tonë arsimor me sistemet bashkëkohore evropiane e botërore. Implementimi i tij fillon në vitin mësimor 2004-2005. Shërbimi psikologjik në shkolla do të kryhet nga një specialistë. Specialisti i shërbimit psikologjik duhet të ketë përfunduar studimet universitare në degën e psikologjisë apo të jetë mësues me specializim pasuniversitar në këto fusha. Specialisti i shërbimit psikologjik i shkollës, është një person kyç në mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore edukative të institucionit arsimor. Veprimtaria e tij zhvillohet në lidhje dhe bashkëpunim të ngushtë me stafin pedagogjik dhe drejtues të shkollës, me prindërit dhe komunitetin, ku ndodhet shkolla. Qëllimi kryesor i punës së specialistit të shërbimit psikologjik në shkollë fokusohet në promovimin dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve si dhe në ndihmesën dhe mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësim nxënies dhe mësimdhënies.

Psikologët shkollor janë persona kyç që ndikojnë në përmirësimin veprimtarisë mësimore, edukative në shkolla. Këta profesionist njohin dhe kuptojnë saktësisht politikat dhe çështjet e edukimit dhe arsimit të cilat dalin nga puna edukative në shkollat ku punojnë. Ata janë të pajisur me mjetet profesionale dhe kanë trajnimin e duhur të kryer në vlerësimin e nxënësit dhe stileve njohëse, të mësuarit duke pasur qëllim planifikimin edukativ mësimor. Marrëdhëniet e rregullta të drejtpërdrejta me nxënësit, mësimdhënësit dhe komunitetin për të siguruar kushte më të mira të krijimit të shëndetit mendor të nxënësve në institucionet shkollore. Por çfarë mund të sjelli roli i psikologut në shkollë? Ndihmon çdo mësimdhënësi të sigurojë kushte të nevojshme për mësimdhënie dhe nxënësit për mësim nxënie. Mundëson çdo mësimdhënës që të identifikojnë sa më herët tek nxënësi përparësitë dhe mangësitë e tyre. Ndihmon mësimdhënësve në përpilimin e programit të punës edukative që u dedikohet nxënësve në harmoni me nevojat aktuale të bashkësisë së klasave. Ndihmon mësimdhënësve që t'ia krijojnë mundësin çdo nxënësi për të marrë pjesë në punën e pavarur mësimore, motivimin, zgjidhjen e problemeve, në marrjen e vendimeve. Motivon çdo mësimdhënës që të bashkëpunojë me punën e shërbimit profesional në shkollë. Mundëson dhe motivon çdo mësimdhënës që të koordinojë bashkëpunimin e shkollës me komunitetin. Ofrim këshillimi për individët si: nxënësit, prindërit, mësimdhënësit. Mbështetjen e ndryshimit, nxitjen dhe motivimin për ndryshim në fushën mësimore, akademike, të

marrëdhënieve sociale dhe funksionimit personal. Shërbimi i psikologut ua lehtëson punën nxënësve, ndihmon ta njohin, kuptojnë dhe pranojnë vetën, dinjitetin e tyre, duke i orientuar në shfrytëzimin e mundësive të tyre për përparimin e vazhdueshëm në shkollë, duke pasur nxënësit një mundësi të flasin me psikologun ti drejtohen për problemet, sfidat dhe vështirësitë në mësim nxënie si dhe problemet e tjera emocionale, sociale, familjare. (Sherifi, 2016)

2. Prezantimi i problemit

"Derisa vdekja të na ndajë".

Duket se shqiptarët nuk po i qëndrojnë besnikë kësaj shprehje në vitet e fundit. Mjafton t'u hedhim një sy shifrave të përllogaritura nga INSTAT, 31 divorce në 100 martesa në vitin 2016. Po pse po ndodh kjo? Arsyet kryesore, që japin ekspertët ligjorë dhe ata të fushës psikologjike, lidhen fort me shoqërinë shqiptare ndër vite: dhuna, varfëria, emigracioni, mblesëritë. Studiues të shumtë kanë arritur në përfundimin se divorci i prindërve ndikon në sjelljen e mëvonshme të fëmijës, ndikon në shfaqjen e simptomave emocionale, mungesës së vëmendjes ose hiperaktivitetit, sjelljeve jo sociale, problem në sjellje, rritjen e nivelit të stresit. Kështu e pare në këtë këndvështrim komunikimi midis prindërve dhe pas divorcit ka një ndikim shumë të madh në sjelljen e fëmijëve. (Grubeska,2003)

Divorci është një proces i gjatë, i lodhshëm, i kushtueshëm dhe shpeshherë me pasoja të rënda shoqërore.(Hyka, 2017)

3. Qëllimi i punimit

Të kuptuarit të rëndësisë së rolit të psikologut në shkollë me përballimin dhe trajtimin e fëmijëve që hasen me divorcin ose krizat e divorcit të prindërve.

3.1 Objektivat

- Të kuptojë sesa i vështirë është kapërcimi i pasojave të ndarjes së prindërve për fëmijët?
- Të analizojë masat dhe sjelljet që duhet të bëjnë prindërit në mënyrë që fëmijët e tyre të mos vihen përballë shpërthimeve emocionale që mund të lënë gjurmë në rritjen e tyre?
- Të kuptojmë sesi mund të ndërhyjë psikologu në raste të tilla?

3.2 Rëndësia e punimit

Të tregojë rëndësinë e punës së Psikologut Shkollor në identifikimin e sjelljeve jo të përshtatshme të nxënësve që shfaqin kur kanë prindër të divorcuar ose janë në krizë divorci dhe të ndërmarrë hapat e duhur në trajtimin e tyre individual, dhe këshillim familjar.

3.3 Kufizimet

Studimi u mbështet në përdorimin e intervistave gjysmë të strukturuara të thelluara me 1 psikologe shkollore. Një kufizim tjetër ka qenë marrja në studim e vetëm 1 psikologe shkollor, dhe kjo e bën të vështirë daljen në përgjithësime. Koha e shkurtër në dispozicion, nr. i kufizuar i psikologëve.

3.4 Çështjet etike

Studimi u zhvillua, duke respektuar çështjet etike, si me subjektet dhe me procesin e mbledhjes së të dhënave. U respektua anonimati i psikologes, si dhe konfidencialiteti i saj te faza e intervistimit. Subjektit të studimit iu kërkua të shënonte vetëm inicialet e emrit, duke i mundësuar kështu një lirshmëri në të shprehur. Subjektet u informuan për qëllimin e studimit, llojin e pyetjeve dhe mënyrën sesi do të përpunoheshin, analizoheshin dhe paraqiteshin rezultatet e marra. Asaj iu bë e qartë, se ishte e lirë të mos i përgjigjej pyetjeve, të cilat cenonin në një farë mënyre privatësinë. Si dhe iu bë e qartë, se mund të tërhiqej nga procesi i intervistimit në momentin kur ajo ndihej nën presion apo kishin mungesë interesi. Për më tepër, u diskutuan edhe çështjet e etikës (ruajtja e konfidencialitetit, pasqyrimi i përpiktë i përgjigjeve të dhëna). Ata u informuan se çdo përgjigje e dhënë, do të përdorej për qëllime studimore.

4. Shqyrtim literature

Sipas Konventës së të drejtave të fëmijëve neni 5 Kujdesi prindëror, i cili përfshin disa nënnene, si më poshtë:

- Sipas Konventës së të drejtave të fëmijëve: "Prindërit, në mënyre të përbashkët, përgjigjen për arsimimin, zhvillimin fizik e mendor, për shëndetin dhe detyrimin për ushqim të fëmijëve të tyre (neni 78 – Kodi i Familjes).
- Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të këqija të fëmijëve dhe mbi masat për edukimin e tyre", ndryshuar me Dekretin Nr. 7441, date 1.12.1990, parashikohet dënimi i prindërve për sjellje të këqija dhe për rrugaçëri të fëmijëve të tyre të mitur, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç. Prindërit, në mënyrë të përbashkët, përgjigjen për arsimimin, zhvillimin fizik e mendor, për shëndetin dhe detyrimin për ushqim të fëmijëve të tyre (neni 78 – Kodi i Familjes).
- Në të njëjtën kohë projekti i ligjit parashikon kuptimin e përgjegjësive prindërore, ku përfshihen te drejtat dhe detyrat qe kane për qellim te sigurojnë mirëqenien morale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte personale me ta, duke i siguruar fëmijëve edukimin, rritjen, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e të mirave të tij.
- Po në kuadrin e përgjegjësive prindërore, një rol të madh luan shkolla, e cila ka një bashkëpunim të gjerë me komunitetin, veçanërisht me prindërit e fëmijëve.

Fëmijët, pavarësisht nga mosha apo seksi, e përjetojnë keq ndarjen e prindërve. Kjo ndikon në sjelljen dhe gjendjen psikologjike të tyre, gjë që në një mënyrë ose në një tjetër lë gjurmë dhe ndikon në formimin e personalitetit të tyre. Ndarja e vë në pozita të pabarabarta njërin nga prindërit në lidhje me fëmijët. Prindi (nëna ose babai) që fiton të drejtën e kujdestarisë është në kontakt të vazhdueshëm me ta, kurse tjetri është më larg, për të mos thënë që edhe i shkëput fare kontaktet me fëmijët. Ndryshimet në marrëdhëniet me fëmijët mes dy prindërve, mund të varen nga ligji, kultura,

morali, psikologjia etj. Sidoqoftë, ato lënë shenja tek fëmijët, prandaj mendimi shkencor sugjeron: përfshirjen afatgjatë të të dy prindërve në përkujdesjen ndaj fëmijëve.(Ibid)

Psikologjia në klinikën e neurologjisë në QKUK, Mr. Sci Donika Tahirsylaj-Alidemi thotë se divorci i prindërve ka impakt në sjelljen e fëmijëve me një diferencë të moderuar që më tepër shfaqet tek djemtë sesa tek vajzat, mirëpo agresiviteti, pasiguria dhe shfaqja e pa lumturisë janë vetëm disa nga shenjat që ndarja e prindërve ndikon tek të vegjlit e tyre. Sipas saj, divorci ka një impakt më të madh në sjelljen e fëmijëve për grup moshën 6-10 vjeç sesa grup moshat 11-14 vjeç dhe 15-18 vjeç. Ajo shtoi se fëmijët shfaqin kryesisht sjellje agresive, bëhen të pashoqërueshëm, krijojnë varësi, nuk afrohen lehtë në rrethin social ku bëjnë pjesë, por mbyllen në vetvete. Këto sjellje, sipas Tahirsylaj-Alidemi, janë të theksuara më shumë vitet e para të divorcit të prindërve dhe zbehen me kalimin e kohës. Sipas psikologes, studime të shumta kanë treguar se fëmijët që jetojnë bashkë me prindërit e tyre biologjikë janë 20-35% më të shëndetshëm psikologjikisht sesa fëmijët me prindër të divorcuar, dhe se fëmijët që kanë konflikte familjare para dhe pas divorcit shfaqin një pafundësi problemesh të sjelljes së tyre (Ibishi, 2017). Më tej psikologjia, Donika Tahirsylaj- Alidemi ka thënë se kur prindërit divorcohen, fëmijët zakonisht bëhen më indiferent sepse nuk duan që rrethi shoqëror ta kuptojnë që prindërit e tyre janë ndarë.

5. Metodologjia

Përdorimi i metodave cilësore në këtë studim synoi përshkrimin, shpjegimin dhe kuptimin e rolit të Psikologut në shkollë, ku janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuara, të thelluar me 1 psikologe shkolle, përkatësisht të shkollës Jo-Publike" Turgut Ozal".

Lloji i intervistës së përdorur me psikologen është ajo gjysmë e strukturuar, e thelluar e cila i jep asaj më shumë mundësi për tu shprehur dhe për të dhënë opinionet e saj (Paçukaj, 2011) në lidhje me punën e tyre, përgjegjësitë, funksionet që kanë dhe me problematikat e ndryshme që ato hasen.

Intervista është ndërtuar lidhur dhe me rëndësinë e rolit të psikologut në shkollë, marrëdhënies prindër-mësues-psikolog, në mbarëvajtjen fizike, emocionale dhe rritjen akademike të nxënësve, veçanërisht të fëmijëve me probleme familjare (të divorcuar ose në prag divorci), pasi përtej të qenit një çështje e brendshme e çiftit, krizat bashkëshortore bart rrezikun e ndikimeve të pafavorshme për marrëdhëniet në familje, për mirëqenien momentale psikologjike, si dhe për të ardhmen e pjesëtarëve të familjes në tërësi. Intervistat janë zhvilluar në një interval kohor prej mesatarisht 4 orë me ndërprerje. Para intervistimit psikologia u informua rreth qëllimit të studimit, si dhe llojit të pyetjeve që do t'u drejtoheshin.

Periudha kohore

Studimi u shtri në një periudhë kohore 1 - mujore Dhjetor 2018 – Janar 2019, ku fillimisht u kryen intervistat me psikologen. Kurse koha e

përpunimit të të dhënave zgjati 1 javë, së bashku me analizën dhe konkluzionin.

6. Gjetjet dhe diskutimet

Nga intervista me psikologen e shkollës e cila ka 740 nxënës dhe ajo punonte me 500 nxënës përfshirë këtu kopshtin, filloren dhe 9-vjeçaren, shprehet se që në fillim të çdo viti shkollor ne u paraqitim prindërve për të plotësuar një formular që titullohet "Harta Sociale"e cila duhet të plotësohet nga prindi dhe një kopje të tij e marrim ne dhe një kopje mësuesi kujdestar" që konsiston në 13 pyetje. Problematikat (.....) dhe Aftësi e kufizuar (.....), ka raste kur referohen nga mësues ose edukatorë sjellje jo të përshtatshme të fëmijëve, por që nuk janë konstatuar se prindërit janë të ndarë. Në këtë shkollë ka 6 raste të tilla fëmijësh që i përkasin relativisht moshave nga 8-15 vjeç me problematika në sjellje si rezultat i divorcit te prindërve që ndikon në sjelljen e mëvonshme të fëmijës, në shfaqjen e simptomave emocionale, mungesës së vëmendjes ose hiperaktivitetit, problem në sjellje, rritjen e nivelit të stresit, rënie nga mësimet ,mbyllje në vetvete(Ballafaqim me literaturën.(Grubeska, 2003) si edhe përdorim të theksuar të celularit kur është në shtëpi. Hartimi një Plan Individual për fëmijën bëhet në bashkëpunim me mësuesen kujdestare, prindin mësuesin ndihmës drejtorin dhe me psikologun e shkollës. Ky plan zhvillohej çdo muaj për të parë dhe për të kuptuar arritjet e nxënësit dhe për vendosjen e objektivave të reja." Ndërsa në rastin kur prindërit nuk prononcohen për deklarimin e divorcit kërkonte takim me mësuesin referues, për të parë intensitetin e sjelljes, dhe me pas prindin. Për ta informuar për sjelljen problematike që shfaq.'

Në lidhje me trajnimet që zhvillohen për trajtimin e fëmijëve me prindër të divorcuar ose në krizë divorci, ajo e sheh si një domosdoshmëri dhe shumë të vlefshëm në këto situata kritike madje dhe për vetë prindërit sepse i japin një ndihmesë të madhe fëmijës të kalojë shpërthimet emocionale, sepse fëmija gjithmonë ka nevojë për mbështetjen dhe dashurinë e të dy prindërve edhe pse të ndarë nuk duhet të harrojë që t'i qëndrojë pranë fëmijës sa herë që ai ka nevojë. Nuk duhet të shtyjë në asnjë mënyrë kohën e vendosur për të kaluar së bashku me fëmijën. Prindërit e ndarë nuk duhet t'u flasin keq fëmijëve për njëri-tjetrin, ose ti etiketojnë me emra të ndryshëm fyes ose tallës. Fëmija duhet të lajmërohet për çdo ndryshim që mund të ndodhë pas divorcit. Duhet të përballohen të gjitha nevojat e fëmijës për edukim, mirëqenie etj. Duhet të lejohet takimi i fëmijës me prindin tjetër me të cilin jetojnë të ndarë. Gjatë procesit të divorcit, prindërit duhet të jenë të sinqertë me fëmijën." Nuk duhet të gënjejnë asnjëherë.(Ballafaqim me literaturën Kola, 2013)'. Gjatë periudhës së divorcit prindërit, pavarësisht problemeve të tyre duhet t'i përkushtohen dhe fëmijëve sepse ata kanë nevojë më shume se kurrë për vëmendjen dhe interesin e tyre. Prindërit të dy duhet të interesohen në shkollë për ecurinë e fëmijës në mësime, në këtë mënyrë dhe fëmija do të ndihet më mirë në sy të bashkëmoshatarëve që i kanë prindërit bashkë. Ato nuk duhet t'u flasin keq fëmijëve për babain ose nënën e tyre. Fëmija duhet të paralajmërohet për ndryshimet që do të përballet, si p. sh.,

Ndryshimi i shtëpisë, shkollës, vendit etj. Fëmijëve duhet t'i mundësohet takimi me prindin tjetër që jetojnë të ndarë dhe mos t'i mohohet kjo e drejtë. Nëse prindërit pas divorcit mund të komunikojnë në mënyrë konstruktive në lidhje me problemet rreth fëmijës do ishte që element pozitiv i cili do të ndryshonte, jo vetëm sjelljen, por edhe gjendjen emocionale të fëmijëve të tyre që vuajnë në një mënyrë të padrejtë këtë gjendje.."(Ballafaqim me literaturën. Hodaj 2015) sepse fëmijët e moshave të ndryshme e përjetojnë emocionalisht ndryshe ndarjen e prindërve, si p.sh., mosha 0-2 vjeç, në këtë moshë u nevojitet një mbështetje dhe ngrohtësi e qëndrueshme, përgjatë gjithë ditës në këtë periudhe. Ndarja e prindërve ne këtë periudhë mund të nxisë te fëmijët e kësaj moshe mungesë interesi ndaj lojërave të ndryshme apo edhe në mungesë afeksioni ndaj njerëzve të dashur që i qëndrojnë pranë, pra, në një farë mënyre mund t'i shkaktojë një izolim social.

2-4 vjeç

Fëmijët në këtë periudhë kanë nevojë për një kujdes të qëndrueshëm. Fëmijët e kësaj moshe e manifestojnë ndarjen e prindërve me shqetësime të vazhdueshme që shpeshherë identifikohen me stres, kufizojnë aktivitetet e tyre sociale të mëparshme , çrregullime të gjumit, të qara pa shkak, mungesë vëmendje për fëmijët qe janë ne kopshte.

6 – 8 vjeç

Fëmijët e kësaj moshe, kanë nevojë për të kaluar kohë me secilin prind, që të ndjehen të sigurt që ata i duan. Në këtë moshë fëmijët interesohen të dinë se kush është fajtori për një akt të tillë. Fëmija edhe pse është prezent i një fakti të tillë, pra ndarjes së prindërve, përsëri shpreson që të dy prindërit së bashku do të ribashkohen për t'u impenjuar me të. Ajo që prindërit duhet të bëjnë, është të bindin fëmijën për prezencën e secilit prej tyre në aktivitetet dhe jetën e fëmijës edhe pse do qëndrojnë të ndarë me njëri tjetrin. Fëmija e manifeston stresin e divorcit të prindërve me anë të zemërimit, agresionit apo trishtimit të thellë, probleme me shokët, rezultate jo të mira në shkollë.

12 – 15 vjeç

Fëmijët në këtë moshë kanë nevojë për mbështetje të qëndrueshme nga të dy prindërit. Ata mund të mishërojnë fajin për divorc në njërin ose në të dy prindërit dhe mund të kundërshtojnë faktin e të qëndruarit një herë në njërën apo tjetrën banesë të prindërve. Këtë shqetësim dhe mosaprovim të situatës ata e shprehin me anë të rezultateve të dobëta në mësime, hiperaktivitet, ngacmon tëtjerët, ankth... Pavarësisht faktit që këto shqetësime e kanë zanafillën në divorcin e prindërve këto raste kanë nevoje për asistence të specializuar si dhe mbështetje sociale dhe familjare.

15 -18 vjeç

Adoleshentët në këtë moshë fokusohen tek pavarësia e tyre dhe në aktivitetet sociale dhe shkollore. Dhe padashur ata bëhen intolerant ndaj problemeve të prindërve të tyre. Edhe pse adoleshentët në këtë moshë fokusohen në pavarësinë e tyre ata përsëri preokupohen për problemet e prindërve të tyre. Megjithatë adoleshentët që e përjetojnë keq këtë fakt e manifestojnë atë me

performancë të ulët në shkollë, probleme me drejtësinë, drogën e alkoolin, aktivitete seksuale si dhe arratisje nga shtëpia.(Ballafaqim me literaturën Kola, 2013)

Fëmijët me prindër të divorcuar ose në krizë divorci kanë nevojë për mbikëqyrje dhe këshillim të posaçëm. Duke qenë se mësuesit kanë kontakt të përditshëm me nxënësit e kanë më të lehtë të identifikojnë reagimet e tyre e më pas ata të venë në dijeni Psikologun Shkollor.

7. Përfundime

Roli i Psikologut Shkollor është shumë i rëndësishëm në këtë institucion, pasi identifikimi i fëmijëve që hasen me problematika të tilla si divorci, ose prindër në krizë divorci do ti ndihmojë ata sesi ti përballojnë sa më mirë këto situata delikate, duke përdorur këshillimin individual dhe familjar në mënyrë që fëmija të arrijë të rritet i shëndetshëm dhe pa sjellje problematike në të ardhmen.. Fëmija gjithmonë ka nevojë për mbështetjen dhe dashurinë e prindit. Çifti i ndarë, edhe pse i tillë, nuk duhet të harrojë që t'i qëndrojë pranë fëmijës sa herë ka nevojë. Nuk duhet të shtyjë në asnjë mënyrë kohën e vendosur për të kaluar së bashku me fëmijën. Prindërit e ndarë nuk duhet t'u flasin keq fëmijëve për njëri-tjetrin. Fëmija duhet të lajmërohet për çdo ndryshim që mund të ndodhë pas divorcit. Duhet të mënjanohen ndikimet negative të menjëhershme mbi fëmijën si p.sh., ndryshim qyteti, shkolle, shoqërie etj. Duhet të përballohen të gjitha nevojat e fëmijës për edukim, mirëqenie etj. Duhet të lejohet takimi i fëmijës me prindin tjetër me të cilin jetojnë të ndarë.

8. Sugjerime

Për vetë faktin se në shkolla po rritet gjithmonë e më tepër numri i nxënësve është e nevojshme që të shtohet numri i psikologëve, të rritet niveli profesional i tyre duke i angazhuar në trajnime të ndryshëm e të përshtatshme me problematikat e reja që haset shoqëria sot, siç është numri i divorceve të shtuara kohët e fundit. Si edhe të respektohet me dinjitet figura e Psikologut shkollorë janë normalisht persona kyç që ndikojnë në përmirësimin e veprimtarisë mësimore edukative në shkolla. Njohin dhe kuptojnë saktësisht politikat dhe çështjet e edukimit dhe arsimit, të cilat dalin nga puna edukative në shkollat ku punojnë. Ata janë të pajisur me mjete profesionale, dhe kanë trajnimin e duhur për të kryer vlerësim të nxënësit, dhe stileve konjitive të të nxënit duka pasur qëllim planifikimin edukativ mësimor. Kanë trajnimin e duhur për të njohur dhe diagnostikuar një sërë çrregullimesh fëminore të sjelljes dhe të të nxënit. Mbajnë kontakte e marrëdhënie të rregullta dhe të drejtpërdrejta me nxënësit, mësuesit dhe komunitetin.

Bibliografia

Çako. M (2016)."Dëshiron divorcin? Mendo për fëmijët". *Ballkanweb.* Μαρρë μë 20 Janar 2019 nga:*https://balkanweb.com/deshiron-divorcin-mendo-per-femijet/*

Dawson, W. R. M. (1991). The How and Why of What Went Where in Apparent Motion: Modeling Solutions to the Motion Correspondence Problem. Psychological Review Vol. 98, No. 4, 569-603
wexler.free.fr/.../dawson%20(1991)%20the%20how%20and%20why%2...

Grubeska. G (2003).“PSYCHIATRIC LEGAL DECISION-MAKING: THE CHILD AND THE DIVORCE”. Marrë më 17 Janar 2019 nga: file:///C:/Users/Gazeta%204/Downloads/di6_04_08vuksic.pdf

Hodaj. K (2015). “Divorci, psikologët: Ja çfarë prindërit duhet të shmangin përballë fëmijës”. *Γαζετα ΙΔΕΑ.* Μαρρë με 28 Ξαναρ 2019 νγα:¨*http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1210/Divorci-psikologet-Ja-cfare-prinde*

Hyka. D (2017). “Divorcet, arsyet se pse po rriten dhe pasojat ekonomike.” Revista Monitor. Marrë më 25 Janar 2019 nga: http://www.monitor.al/divorcet-arsyet-pse-po-rriten-dhe-pasojat-ekonomike/

Ibishi. B (2017).“Si ndikon divorci i prindërve te fëmijët, pasojat i tregon psikologjia”.*Telegrafi.Com.*Marrë më 8 Dhjetor 2018 nga:https://telegrafi.com/si-ndikon-divorci-prindërve-te-fëmijët-pasojat-tregon-psikologjia/

Likmeta. S (2014). “Divorci i prindërve, si përgjigjen fëmijët në gjykatë”. Shekulli.Online. Marrë më 27 Janar 2019 nga: http://shekulli.com.al/48672/

SHËNDETI DHE MIRËQENIA PSIKOLOGJIKE E MËSUESVE NË NDIKIMIN E COVID 19-N

Elda Deliu
eldadeliu17@gmail.com

Abstrakt

Viti që lamë pas rezultoi një periudhë tepër intensive për të gjithë ne. e mbushur plot sfida të pazakonta të cilat shkaktuan ngarkesë të tepërt emocionale si dhe gjendje të rënduar psikologjike për këdo. Ndër më të prekurit nga kjo situatë ishin mësuesit dhe arsimtarët e cikleve të ndryshme arsimore duke filluar nga parashkollori deri në arsimin e mesëm. Ky kërkim shkencor ka për qëllim të evidentojë nivelin e stresit të mësuesve përgjatë kësaj periudhe, faktorët që kanë ndikuar më tepër si dhe mënyrën me të cilën ato e kanë përballuar këtë situatë.Në përputhje me masat anticovid, pyetësorët janë zhvilluar online përmes platformës "Google Form". Në total morën pjesë 173 mësues të shkollave dhe kopshteve të ndryshme në qytetin e Durrësit, përfshirë arsimin publik dhe privat. Nga ky studim u konstatua se një përqindje relativisht e lartë i kanë përjetuar në mënyrë jo pozitive të gjitha ndryshimet e ndodhura në arsim kohët e fundit.

Fjalët kyçe: *mirëqenie psikologjike, mësues, bashkëpunim.*

Abstract

The year we left behind turned out to be a very intense period for all of us, full of unusual challenges which caused excessive emotional load as well as aggravated psychological condition for everyone. The most affected by this situation were teachers and educators of various education cycles, starting from preschool to high education. This scientific research aims to identify the level of stress of teachers during this period, the factors that have influenced the most and the way in which they have coped with this situation. In accordance with the anti-covid measures, the questionnaires were developed online through the google form platform. A total of 173 teachers from various schools and kindergartens in the city of Durres participated, including public and private education. From this study it was found that there is relatively a high number of teachers that have experienced in a non-positive way, all the changes that have occurred in education recently. Stress has been present in every moment and this is due to various factors among which we can mention: online learning, quarantine, excessive documentation, etc., this has affected the personal aspect of teachers and consequently is reflected inadvertently and in their work.

Key words: *psychological well-being, teacher, collaboration.*

1. Hyrje

Mësuesit u kthyen në klasë për vitin e ri shkollor 2020-2021 dhe u përballën me mjedise të reja dhe sfiduese, qasje udhëzuese dhe role si edukatorë. Tashmë mësuesit kishin lënë pas një vit plot vështirësi, ngarkesë të papërballueshme emocionale dhe vinin nga një situatë e rënduar psikologjike.

Pandemia COVID-19 i gjeti të gjithë të papërgatitur dhe mënyra më e mirë për ta përballuar atë ishte ruajtja e qetësisë dhe zbatimi i masave mbrojtëse.

Ndër personat më të prekur nga kjo situatë ishin edhe mësuesit të cilët u përballen me një formë te re të mësimdhënies, totalisht ndryshe nga ajo tradicionalja e cila ishte mësimdhënia online.

2. Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij studimi lidhet ngushtë me gjendjen psikologjike të mësuesve në institucionet arsimore si në situata të zakonshme ashtu edhe në ato të jashtëzakonshme. Ky punim tregon qartë realitetin e gjendjes së arsimtarëve duke vënë në pah problematikat personale dhe profesionale , gjë e cila ndikon në shëndetin e tyre mendor.

3. Rishikimi i literaturës

Sfidat e mësimdhënies personalisht ose në internet i kanë shtrirë arsimtarët në kufijtë e tyre. Pas gati një viti të plotë ata kanë vënë në rrezik veten e tyre gjatë mësimdhënies në klasë dhe kanë luftuar për të arritur nxënësit në distancë. Të dhënat e fundit të botuara nga instituti i statistikave të UNESCO-s, Task forca ndërkombëtare si dhe raporti global i monitorimit të arsimit tregojnë se 81% e mësuesve fillorë dhe 86% e mësuesve të arsimit të mesëm kanë kualifikimet minimale të kërkuara çka i lë mësuesit të papërgatitur për të trajtuar sfidat me të cilat përballen. Një sondazh i përbashkët i zhvilluar nga UNESCO, UNICEF dhe Banka Botërore mbi përgjigjet ndaj Covid-19, zbuloi se vetëm gjysma e vendeve të anketuara ofrojnë trajnim shtesë për arsimin në distancë për mësuesit dhe më pak se 1/3 ofrojnë mbështetje psikosociale për t'i ndihmuar ato të kalojnë kriza. Ndërkohe në një deklaratë të dhënë nga drejtoresha e përgjithshme e UNESCO-s për mbrojtjen e financimit të arsimit u theksua se për të ndërtuar një fuqi punëtore elastike të mësuesve në kohë krize, të gjithë mësuesit duhet të jenë të pajisur me aftësi digjitale dhe pedagogjike për të dhënë mësim në distancë, në internet dhe përmes mësimit të përzier, qoftë në mjedise të teknologjisë së lartë, të ulët ose pa teknologji. Kjo deklaratë e cila njeh ndikimin e krizës së Covid-19, ka prekur 63 milionë mësues ndërkohë theksoi dobësitë e vazhdueshme në shumë sisteme arsimore dhe përkeqësoi pabarazitë.

Nga e gjithë kjo situatë, personat të cilët e kanë ndjerë barrën më të madhe se sa e ka ndryshuar botën kjo pandemi, janë mësuesit (Colin Sharkey, drejtori ekzekutiv i shoqatës së edukatorëve amerikanë).

4. Metodologjia

Ky është studim kërkimor cilësor i realizuar mbi bazën e platformës "Google Form". Përmes kësaj platforme mësuesit u dhanë përgjigje pyetjeve lidhur me situatën në të cilën gjenden në ambientin e tyre të punës. Në këtë studim morën pjesë 173 mësues të shkollave dhe kopshteve të ndryshme publike dhe private në qytetin e Durrësit. Pyetjet e formuluara kishin në thelbin e tyre të evidentonin stresin dhe ngarkesën e mësuesve lidhur me profesionin e tyre. Gjithashtu studimi lidhet dhe me situatën e pandemisë në të cilën u gjendëm kohët e fundit.

5. Mbledhja e të dhënave

Mënyra e mbledhjes së të dhënave në këtë studim u realizua në mënyrë online për shkak të situatës në të cilën ndodhemi. Mësuesve të qytetit të Durrësit, të ciklit të ulët, 9-vjeçar dhe të mesëm, i është paraqitur një pyetësor në Google Form në të cilin do të japin përgjigje lidhur me situatën në të cilën janë gjendur dhe problematikat apo vështirësitë që ata kanë hasur gjatë kësaj kohe në punën e tyre. Pyetjet u formuluan duke menduar çdo problematikë që mësuesit mund të kenë pasur gjatë karrierës së tyre pedagogjike, përfshirë këtu edhe situatën e pazakontë të pandemisë.

6.Rezultate

Nga ky studim është vënë re se 86.7 % e mësuesve të qytetit të Durrësit janë të punësuar në sektorin publik nga ku pjesa më e madhe ofrojnë mësim në arsimin 9-vjeçar. Mësuesve u janë drejtuar një sërë pyetjesh të hapura të cilat lidheshin me praninë e stresit në vendin e tyre të punës, raportin mësues-prind-nxënës apo drejtues-mësues. Bashkangjitur gjithashtu edhe faktin se si ka ndikuar periudha e izolimit në aspektin personal dhe profesional. Konkretisht, nga një total prej 173 mësuesish, vetëm 9 prej tyre pohuan se nuk ndihen të stresuar. Ndërkohë 163 pohuan të kundërtën duke shprehur dhe arsyet të cilat e çojnë mësuesin në përjetimin e stresit para, gjatë ose pas pandemisë. Arsyeja kryesore janë prindërit dhe nxënësit e papërgjegjshëm. Nxënës të cilët nuk zbatojnë detyrimet kryesore që kanë dhe shpeshherë tejkalojnë edhe të drejtat e tyre duke shkelur ato të të tjerëve. Nga ana tjetër edhe mungesa e kontrollit te vazhdueshëm të prindërve kundrejt fëmijëve duke i lënë liri të tepërt. Ndërkohë dhe bashkëpunimi në nivele të ulëta është arsyeja që çon edhe në produktivitet të ulët dhe në mosplotësimin e objektivave. Përdorimi pa kriter i teknologjisë nga nxënësit është gjithashtu faktor stresi në vendin e punës së mësuesve. Nxënësit krijojnë varësi dhe duke i kthyer në pasivë gjatë procesit mësimor e cila ka pasoja negative në rezultatet e nxënësve. Gjithashtu si pasojë e tërmetit, pak kohë para pandemisë, mësuesit dhe nxënësit u zhvendosën në shkolla e reja ku për shkak të ngarkesës së madhe ishte e nevojshme zhvillimi i mësimit në dy grupe, njëkohësisht me orë më të shkurtuara. Pas tërmetit u përballën me një tjetër situatë, pandemia e cila solli ndryshime në procesin mësimor dhe jo vetëm.

Mësimi online ishte një nga pikat më të prekura nga gjithë mësuesit. Përballja me një situatë të tillë erdhi shumë e papritur dhe arsimtarët u gjendën të papërgatitur. Platforma e re e mësimit online, pajisjet

teknologjike dhe dokumentacioni i zgjeruar për t'u plotësuar ishte e re për të gjithë dhe një pjesë e madhe e mësuesve nuk ishin të azhurnuar me të rejat e mësimdhënies. Koha për të zhvilluar mësim ishte e pamjaftueshme, mësim nuk kryhej me ritme normale si në klasë, kishte mbingarkesë dhe njëkohësisht mungesë të theksuar mjetesh mësimore. Pandemia përveç problemeve në mësimdhënie, pati ndikim të madh edhe në psikologjinë e mësuesve. Të gjithë ndiheshin të rrezikuar të ktheheshin në ambientet e shkollës, masat anticovid dhe kushtet higjieno-sanitare ishin stres më vete.

Ndikim të madh në psikologjinë e mësuesve kanë edhe drejtuesit. Drejtues të emëruar sipas bindjeve politike dhe jo sipas kritereve bazë të përcaktuara, ndikonin tek mësuesit pasi ekzistonte mungesa e bashkëpunimit mes tyre.

Por si ka qenë raporti mësues-drejtues apo mësues-prind-nxënës?

Sa i përket këtij raporti, një përqindje relativisht e lartë kryesisht 95%, çoi në përfundimin se kjo marrëdhënie ishte kryesisht pozitive, tolerante, mirëkuptuese dhe bashkëpunuese. Drejtuesit janë munduar t'i vijnë në ndihmë kolegëve të tyre brenda mundësive, çka vlen për t'u theksuar.

Ndërkohë përgjigje pozitive janë marrë edhe për raportin mësues-prind-nxënës. Bashkëpunues, korrekt, mbështetës, i suksesshëm, komunikim i vazhdueshëm ishin termat e përdorur nga mësuesit për të përshkruar situatën. Të pakët në numër ishin ato të cilët vunë në dukje se ky raport ka qenë tepër i vështirë, i dobët dhe i ndërlikuar. Kjo për arsye të distancës apo mungesës së mjeteve teknologjike. Në përmbyllje të këtij sondazhi u shtrua pyetja lidhur me ndikimin e pandemisë në aspektin personal dhe profesional. Ajo çka bie në sy është fakti që një pjesë e mirë e mësuesve e kanë marrë me sportivitet këtë gjë. Kjo ndikon pozitivisht në psikologjinë e tyre dhe në uljen e nivelit të stresit.

Por për pjesën tjetër nuk është i njëjti rezultat. Mësues të ndryshëm e kanë pasur tepër të vështirë këtë pjesë. Kjo lidhet me faktorë të ndryshëm si p.sh.: vështirësitë ekonomike, ngarkesë e rënduar psikologjike, plane të parealizuara etj.

Ndërsa në aspektin profesional theksohet vështirësia në mësimdhënien online dhe mungesa e mjeteve të duhura.

7. Diskutime

Bazuar në literaturën e shqyrtuar dhe sondazhin e zhvilluar në terren, janë evidentuar 2 pika të përbashkëta të cilat janë: mungesa e trajnimeve të posaçme për zhvillimin e mësimit online jo vetëm në kohë pandemie si dhe mungesa e mbështetjes psikosociale për mësuesit.

Siç u theksua edhe më sipër, jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera të botës, mënyra më e mirë që mësuesit të arrijnë rezultatet e dëshiruara në punën e tyre janë specializimi i tyre për të dhënë mësim në mënyra të ndryshme dhe për të përballuar situata të ndryshme në te cilat mund të gjenden në të ardhmen.

Por gjithashtu duhet veçuar fakti se ndihmesë të madhe në këtë rast jep edhe mbështetja psikologjike e mësuesve e cila motivon dhe çon në produktivitet

më të lartë, gjë e cila mungon në shkollat tona si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit.

Ajo çfarë rekomandohet në raste të tilla është mundësia e trajnimeve specifike për mësuesit lidhur me menaxhimin e situatave të ndryshme e cila çon në rritjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies. Organizimi i mbledhjeve më të shpeshta me prindërit duke evidentuar problematikat dhe ecurinë e nxënësve si dhe mënyrën e përmirësimit të tyre.

8. Konkluzione

Një vit nën ndikimin e COVID-19, vëmendja e politikëbërësve është përqendruar gjithnjë e më shumë në përpjekjet për të rihapur në mënyrë të sigurt shkollat si dhe për të rikuperuar kohën e humbur mësimore për nxënësit.

Pandemia ka ndikuar mjaftueshëm tek arsimtarët në shumë aspekte.

Ende është e pranishme frika nga infektimi si pasojë e moszbatimit me përpikëri të masave anticovid apo dhe mungesa e higjienës, mësimdhënia në distancë apo mungesa e mjeteve e cila ka penguar deri diku procesin e mësimdhënies. Mungesa e interesit nga ana e nxënësve apo mosinteresimi nga ana e prindërve rezultoi një ndër faktorët më stresues tek mësuesit.

Përdorimi i teknologjisë nga mësuesit "e vjetër" të cilët kanë hasur vështirësi gjatë përdorimit të platformave të ndryshme dhe si rrjedhojë pengon zhvillimin normal të procesit mësimor.

Pavarësisht problemeve profesionale, ajo çka ndikon në mirëqenien psikologjike të mësuesve janë dhe problemet personale te gjithsecilit prej tyre të cilat ato përpiqen mos t'i transmetojnë në ambientin e tyre të punës për t'i ardhur në ndihmë mbarëvajtjes mësimore duke dhënë maksimumin e tyre për kushtet në të cilat gjendemi.

Mirëpo për të rregulluar problematikat që mësuesit kanë në ambientin e tyre të punës duhet ende punë e mbi të gjitha bashkëpunim mes mësuesve, drejtuesve dhe nxënësve gjithashtu.

MËSUESI DHE PSIKOLOGU,BASHKËPUNIMI I TYRE PËR LEHTËSIMIN E SITUATËS PSIKOLOGJIKE TË NXËNËSVE

Blerina Hima Mërtiri
Mësuese, Shkolla 9-vjeçare "Andon Xoxa", Fier
blerinamertiri@yahoo.com

Abstrakt

Mësuesi dhe psikologu shkollor vërtet kanë funksione të ndryshme, në shkollë, por synojnë një qëllim të përbashkët plotësues dhe bashkëpunues në ndihmën psikologjike dhe edukimin qytetar të gjithë fëmijëve të shkollës në çdo lloj situate.Pra, për të realizuar sa më mirë funksionimin e detyrës se tyre, mësues dhe psikologë shkollore duhet të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë, të shkëmbejnë informacione, të ndërtojnë strategji, të ofrojnë shërbime mbështetëse dhe cilësi në shërbimet që iu ofrojnë nxënësve, në mënyrë që periudha shkollore e tyre të kalojë me sa më pak probleme dhe ngarkesa psikologjike për nxënësit dhe familjet etyre.

Fjalë kyçe: *Psikolog shkollor, mësues, bashkëpunim, prindër, identifikim, rezultat, analizë e sjelljes.*

Abstract

The teacher and the school psychologist do have different functions in the school, but they aim at a common complementary and cooperative goal in the psychological assistance and civic education of all school children in any kind of situation. This responsibility is increasing from year to year as students grow, and this process should be followed carefully as it affects their formation with civic education and to increase their progress during the learning process. The main object of the work of the school psychologist has been and is related to recognizing the psychological problems of students, recognizing their intellectual development, identifying talented students, identifying students' physical disabilities.

Keywords*: school psychologist, teacher, cooperation, identification, result, analysis of the child's behavior.*

1. Hyrje

Arsimi gjithëpërfshirës është çështje e gjithë shoqërisë, jo vetëm e sistemit arsimor. Ai është një hap i parë drejt përfshirjes sociale, e cila vërtet has në vështirësi të shumta, por po bëhet realitet edhe si koncept edhe si praktikë. Këtu nënkuptojmë nxënës të ndryshëm dhe të veçantë që mësojnë së bashku në të njëjtën shkollë dhe klasë.

Pjesë e këtij arsimi është dhe psikologjia shkollore e cila ka të bëjë me fëmijët, të rinjtë, familjet dhe procesin e shkollimit. Psikologët e shkollës janë të përgatitur të zhvillojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë programe për të

siguruar mjedise pozitive për nxënësit me prejardhje të ndryshme, dhe shërbime efektive arsimore dhe psikologjike që promovojnë zhvillimin e shëndetit, ndërhyrjes, parandalimit, dhe zhvillimit të programit. Përpjekjet e tyre përgjithësisht bazohen ne gjetjet shkencore për të lehtësuar problemet njohëse, të sjelljes, sociale dhe emocionale, gjithashtu të kenë dhe njohuri ligjore, të statuteve dhe rregulloreve shtetërore për shkollat dhe shërbimet psikologjike.

Shkolla është ambienti ku formohet personaliteti i nxënësit, ku merren dije, gjithashtu është vendi ku mund të korrigjohen disa prej gabimeve që prindërit mund të kenë bërë në edukimin e fëmijëve të tyre.

Në gusht të vitit 2013, u ngrit për herë të parë Njësia e Shërbimit Psikosocial për sistemin arsimor parauniversitar. Psikologët u bënë pjesë e shkollave shqiptare dhe që prej asaj kohe ata kanë qenë pjesë e debatit publik nëse numri i tyre është i mjaftueshëm dhe nëse roli i tyre është funksional dhe efektiv.

Sipas statistikave në institucionet e arsimit konfirmohen se në të gjitha shkollat e vendit shërbejnë dhjetëra psikologë dhe punonjës socialë të cilët mbulojnë disa shkolla. Psikologët vetë por edhe shoqatat që mbrojnë të drejtat e tyre thonë se ata kanë ngarkesë të madhe.

Sipas psikologjisë shkollore nxënësit duhet të trajtohen të gjithë njësoj, pa dallime, bazuar në vështirësitë që ata hasin. Ata duhet të marrin pjesë në çdo aktivitet shkollor, të ndjehen të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre, dhe duhet të regjistrohen në shkollë pavarësisht aftësive të tyre fizike. Të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, pavarësisht ndryshimeve dhe sfidave të tyre. Ata duhet te ndjekin dhe mirëpriten nga shkollat e tyre të

përshtatura sipas moshës, me klasa të rregullta dhe mbështeten për të mësuar, kontribuar dhe marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës shkollore.

Që e gjithë kjo të funksionojë ka të bëjë me mënyrën se si ne i zhvillojmë dhe projektojmë shkollat, klasat, programet dhe aktivitetet tona në mënyrë që të gjithë nxënësit të mësojnë dhe të marrin pjesë së bashku. Këtu përfshihen jo vetëm orët e mësimdhënies dhe veprimtaritë në klasë, por edhe gjatë veprimtarive jashtëshkollore duke biseduar rreth eksperiencave të tyre.

Mësuesi luan një rol kyç dhe psikologu si vëzhgues i sjelljes se tyre luan një rol bashkëpunues dhe korrekt.

Gjatë dekadës së fundit janë bërë një sërë përpjekjesh për të promovuar dhe mundësuar këtë bashkëpunim, por gjithashtu është e rëndësishme që të gjurmojmë dhe trajtojmë shkaqet dhe mangësitë.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i këtij studimi është që të evidentoj paqartësitë për sa i përkasin njohurive që kanë mësuesit dhe prindërit mbi rëndësinë e punës së psikologut shkollor. Të identifikohen gjithashtu probleme në të njëjtën kohë dhe përparësi që shfaqen në lidhje me këtë problem. Duke dëgjuar herë pas here mësues ose prindër qe veprime jonormale të nxënësve i justifikojnë si të moshës ose papjekuri dhe vazhdojnë ti shohin për vite me radhë në këtë

stad, lind nevoja e ndërhyrjes së psikologut me një fushatë ndërgjegjësimi për të bindur prindërit dhe një pjesë mësuesish që nuk e kërkojnë këtë mbështetje.

Cili është qëllimi i bashkëpunimit që ofrojnë psikologët e shkollës?

Psikologët e shkollës ofrojnë mbështetje dhe ndërhyrje të drejtpërdrejtë për nxënësit, mësuesit, familjet e nxënësve dhe profesionistë të tjerë të shëndetit mendor të punësuar në shkollë (p.sh. Këshilltarë shkollorë ose punonjës socialë të shkollës). Ndërhyrja e tij në shkollë përfshin: vlerësim, mbështetje psikologjike, këshillim, informim/ndërgjegjësim dhe orientim. Për të përmirësuar strategjitë e mbështetjes, ata punojnë me administratorët e shkollës për të përmirësuar praktikat në të gjithë shkollën dhe bashkëpunojnë me ofruesit e komunitetit për të koordinuar shërbimet e nevojshme. Njohja nga mësuesit dhe psikologët për ndihmën dhe

pozicionin e secilit ndihmon në forcimin e këtij bashkëpunimi.

Psikologët ndihmojnë shkollat dhe mësuesit ne arritjen e disa objektivave bazë:

--Për kryerjen e vlerësimeve psikologjike te nxënësve.

--Menaxhimin e sjelljes së nxënësve dhe klasës.

--Monitorimi e progresit të nxënësit.

--Për të përmirësuar aftësitë komunikuese dhe shoqërore.

--Vlerësojnë nevojat emocionale dhe të sjelljes së nxënësve.

--Sigurojnë këshillim individual dhe në grup.

--Promovojnë zgjidhjen e problemeve, menaxhimin e zemërimit dhe zgjidhjen e konflikteve.

--Modifikimin dhe përshtatjen e kurrikulave dhe udhëzimeve sipas situatave të paraqitura.

--Monitorimin dhe komunikimin në mënyrë efektive me prindërit për progresin e nxënësit.

--Ndihmojnë parandalimin dhe ngacmimin si dhe format e tjera të dhunës dhe bullizmit.

Judith Contreras Landess,(School psychologist, Chicago university) ka theksuar në pjesën më të madhe të studimeve të tij mbi sjelljen dhe performancën akademike, konsultimin dhe bashkëpunimin, nevojat e sjelljes, shoqërore, emocionale dhe njohëse dhe vlerësimin e arritjeve që vjen si rezultat i bashkëpunimit mësues—psikolog.

Psikologët ndihmojnë gjithashtu dhe prindërit në disa drejtime:

--Në informimin, mbështetjen psikologjike dhe zgjidhjen e konflikteve mes brezave.

--Mundëson zhvillimin e komunikimit në mes të shkollës dhe prindërve, për t'i bërë prindërit pjesëmarrës dhe ndikues në edukimin efektiv të fëmijëve të tyre.

--Ndihmon prindërit për të njohur nevojat e veçanta të fëmijëve të tyre dhe u ndihmon nxënësve në përmbushjen e suksesshme të tyre.

-- Forcon partneritetin familje-shkollë.

--Ofron programe edukimi për prindërit .

--Bashkëpunon me organe të tjera në rast nevoje për referim apo ndihmë.

NASP (National Assosiation of school psychologist), vlerëson larminë e profesionit duke theksuar se: "Psikologët shkollorë kanë një rol kritik në komunikimin e rëndësisë së standardeve kombëtare në përmirësimin e rezultateve për nxënësit, studentët, familjet dhe shkollat dhe në punën për adoptimin e tyre. Miratimi i vazhdueshëm i këtyre standardeve nëpër rrethe shkollore dhe shtete ndihmon në promovimin e një konsistence të praktikës duke siguruar publikun që nxënësit dhe studentët të kenë qasje në shërbimet e nevojshme kudo që jetojnë.

3. Objekti i punës së psikologut është të ndihmojë:

- Nxënësit e shkurajuar, me vështirësi në të nxënë, probleme të përqendrimit, melankoli, probleme të sjelljes dhe të personalitetit.
- Mësuesit që kanë vështirësi me klasën apo individë të veçantë, në konflikt të hapur , të shkurajuar.
- Integrimin e nxënësve nga ambiente të tjera social-kulturore.
- Në zgjidhjen e konflikteve me nxënësit.
- Vështirësi për të vendosur marrëdhënie sociale.
- Çrregullime të sjelljes (hiperaktivitet, bullizëm, etj).

Shërbimet që një psikolog shkollor ofron janë:
Këshillim psikologjik Vlerësim psikodiagnostik
Psikoterapi e shkurtër Mbështetje psikoedukative si rrjedhojë e bashkëpunimit mësues-psikolog Takime ndërgjegjësuese, parandaluese me prindër, mësues dhe psikologë(në rastet që është e nevojshme).

4. Metodologjia

Për trajtimin e objektivave të studimit u përdor një qasje e metodave cilësore. Një studim shumëpalësh përfshin konsultimin me mësuesit, prindërit, psikologe, anëtarë të komunitetit, mbikëqyrjen e shërbimeve psikologjike, vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e sfidave .

Në përgjithësi, mësuesit mbajnë qëndrime pozitive dhe përqafojnë vlerat pozitive të psikologut.

Robert dhe Barbara Sommer (Oxford University ,USA) vënë në dukje se pothuaj të gjitha profesionet kanë interes për informacionin që ka të bëjë me sjelljen njerëzore, por profesioni i mësuesit është ai që ka më shumë interesim në këtë drejtim.

Metodat më të rëndësishme të kërkimit shkencor që përdoren në shumicën e degëve të psikologjisë janë: vëzhgimi natyror, intervistimi, metoda kërkimore--analitike, testimi, studimi i rastit.

Metodat e kërkimit të përdorura për mbledhjen e të dhënave për këtë studim ishin:

Ndërthurja e metodës së vëzhgimit me ato kërkimore dhe analitike, duke përfshirë përdorimin e pyetësorëve, intervistave me mësues, nxënës, prindër dhe psikologë.Pyetësorët të realizuar pas mbarimit të procesit mësimor, zgjatën rreth 25 minuta për nxënësit dhe 15 minuta për prindërit, përfshinë pyetje rreth nevojave psikologjike të nxënësve duke mundësuar një vëzhgim më të detajuar të kërkesave që kanë nxënësit në këtë drejtim.

Me mësuesit dhe psikologët u zhvilluan diskutime në formë intervistash rreth rasteve e bashkëpunimit me psikologun shkollor të cilat janë realizuar gjatë viteve eksperience të punës së tyre.

Në këtë studim kanë marrë pjesë rreth 100 të anketuar, të cilët janë përzgjedhur rastësisht në ambientet e shkollave 9-vjeçare "Edith Durham", Tiranë ,klasa e 3-të, , "Andon Xoxa",Fier, klasa e 4–t dhe "Naun Doko",Marinës, Fier,klasa e 6-të.

Anketimi në shkolla të ndryshme ka vështirësitë e veta.Por u menaxhua realizimi në këto shkolla dhe klasa qëllimisht për të bërë krahasimin midis shkollës së kryeqytetit,qytetit dhe të fshatit.Në shkollat e qytetit prindërit ishin të interesuar dhe të informuar rreth detyrave të psikologut dhe një pjesë e tyre kishin pasur raste bashkëpunimi për zgjidhje konfliktesh nëpërmjet trinomit prind—mësues—psikolog.

Si rezultat i saj doli se 70 % e të anketuarve ne shkollat e qytetit kishin informacion mbi rëndësinë e bashkëpunimit mësues- psikologë.

Shkollat e qytetit



Shkollat e fshatit

Në shkollat e zonave rurale kjo përqindje ishte akoma më e ulët. Mësuesit dhe prindërit e nxënësve në zonat rurale përballen me më shume vështirësi në zgjidhjen dhe diskutimin e problemeve që hasen si dhe në marrjen e këtyre informacioneve.Në zonat rurale vihet redhe një neglizhencë e prindërve për marrje informacionesh të ndryshme rreth funksionit të psikologut dhe bëri që kjo përqindje të jetë më e ulët.Ndoshta puna e institucioneve arsimore duhet të jetë më korrekte në shpërndarjen e informacioneve te prindërit dhe mësuesit.Gjithashtu, numri i psikologëve nëpër shkolla është më i paktë, si rrjedhojë dhe ndihma e psikologut dhe bashkëpunimi i tij me mësuesit lë akoma për të dëshiruar.

Psikologët kanë zgjedhur dhe shfrytëzojnë shumë vëzhgimin natyror i cili është si gjithmonë teknika bazë në nxjerrjen e konkluzioneve.Vëzhgimi natyror i organizuar nga mësuesja përkatëse e nxënësve dhe psikologu shkollor në mjediset e përditshme shkollore si dhe në bashkëpunim me prindërit në ambiente dhe aktivitete jashtëshkollore,pas procesit mësimor,përfshin regjistrimin e informacionit në këto mjedise.

Robert Puçik (psikolog, Florida,US) ka theksuar dhe duke e rekomanduar se një përshkrim i saktë i vëzhgimit natyror, është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse na jep një pamje të vërtetë të jetës.Metoda e Intervistimit përfshin subjektin duke bashkëvepruar me psikologun dhe duke iu përgjigjur pyetjeve verbale. Intervistimit kërkon shumë kohë, megjithatë, përmes tij, një intervistues psikolog i aftë vjel një informacion të gjerë.

Metoda e anketimit ndihmon shumë herë psikologët që kanë nevojë të vjelin informacion më të gjerë në një kohë relativisht të shkurtër, në rastin konkret nga nxënësit dhe prindërit.

Testi i inteligjencës i përdorur për të matur IQ janë teste të nivelit maksimal dhe zakonisht kanë një përgjigje të saktë pasi pretendojnë të dinë nivelin e aftësisë së personit të vlerësuar. Termi "inteligjencë" është bërë pjesë e të folurit tonë të përditshëm.

DinieGolemin (psikolog kalifornian internacional i njohur), na parashtron faktorët të cilët bëjnë që një person me IQ të lartë të mos arrijë ndonjë gjë të madhe në jetë, ndërkohë që një me IQ mesatare t'i kapë majat e suksesit. Këta faktorë në të cilët përfshihet vetë njohja, vetëpërmbajtja dhe eupatia, i japin një kuptim tjetër të qenit "i mençur". Edhe pse bazat e saj ndërtohen nga përvojat e fëmijërisë, inteligjenca mund të ushqehet nga përvojat e fëmijërisë por edhe në moshë të pjekur.

5. Rezultate

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se në pjesën më të madhe,mësuesit dhe psikologët po përdornin praktika ekipi bashkëpunimi për nxënësit.Kur disa disiplina punojnë së bashku, praktikat bashkëpunuese konsiderohen jetësore për të përmbushur rezultatet e qëllimit përkatës. Pas realizimit të pyetësorëve ,mbledhjes së të dhënave te tyre,si dhe pas bashkëbisedimeve arrijmë në disa rezultate dhe detyra.Marrëdhënia mësues -psikologë duhet të fuqizohet, por më e rëndësishmja është ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e këtij bashkëpunimi.Bashkëveprim më i mirë midis tyre jep më shumë siguri, më shumë kulturë dhe shumë rezultate.

Ky studim tregon që përpjekjet e mëtejshme kërkimore mund të nxisin akoma më shumë bashkëpunimin midis mësuesve dhe psikologëve shkollorë.

Rritja e fushatës së ndërgjegjësimit si të prindërve ashtu dhe të mësuesve është bazike.

“Bashkëpunimi midis aktorëve mësues, psikolog dhe prind, kërkon një harmoni, e cila arrihet me vullnetin e mirë dhe mbështetjen e sistemit të edukimit që aderon një shoqëri më të mirë, dhe jo të mbuluar prej “egoizmit

për mbijetesë” që po karakterizon gjithnjë e më tepër shoqërinë tonë” (DendaToça, psikologe dhe analiste).Roli i psikologut duhet marrë më seriozisht teksa dukuritë negative në shkolla janë në rritje dhe nevoja për qasje direket është e menjëhershme.

Ne e dimë se nuk ka fëmijë të këqij, të paedukuar, të zhurmshëm, të ndrojtur, të dobët, apo të paaftë, etj. . Thjesht, ka fëmijët të cilët janë të ndryshëm dhe unik. Një mësues dhe psikolog i drejtë, human dhe profesionist, kryen një punë direket dhe indirekte për t’i zhdukur këto dallime dhe për t’i njësuar me kërkesat e kohës.

6. Përfundime

Shumica e psikologëve janë të angazhuar në disa shkolla përnjëherësh dhe potenciali për të mbuluar një numër kaq të gjerë të shkollave është mjaft i vogël, prandaj puna e psikologut nuk mund të jetë efektive kur ai mbulon një numër të madh nxënësish. Duhet që në çdo shkollë të kishte psikolog rezident e jo në lëvizje, që të njihen me problematikat e çdo nxënësi. Ai ngelet një profesion që ka akoma shumë punë për t’u konkretizuar.

Vërtet raporti i madh i nxënësve me numrin e vogël të psikologëve konfirmon mangësitë e një shërbimi kaq të rëndësishëm që duhet të izolojë që në krye dukuritë negative gjatë rrugës së shkollimit të nxënësve, por kjo ka bërë që psikologët të njohin nevojën për të krijuar një marrëdhënie më të ngushtë me mësuesit.

Shumica e mësuesve ishin fleksibël dhe akomoduan psikologun,duke rivendosur një orar ose përcaktim të orareve në mënyrë që nxënësi të mund të marrë pjesë në terapi. Megjithatë kishte disa mësues që ishin të rreptë në lidhje me kohën e mësimdhënies dhe nuk ishin të gatshëm t'i lejonin nxënësit të merrnin pjesë në terapi vëzhgimi gjatë kohës së klasës. Rekomandohet që terapistët e punës duhet të advokojnë rolin e tyre dhe krijimin e një vetëdijeje më të madhe për profesionin e tyre, në radhë të parë, brenda mjedisit shkollor. Të dy mësuesit dhe psikologët duhet të krijojnë mundësi për komunikim dhe ato kanë nevojë gjithashtu të krijohen metoda alternative për të përmirësuar komunikimin.Komunikimi mund të përmirësohet duke përdorur sa vijon sugjerime:

- Caktimi i orareve specifike që profesionistët të takohen dhe diskutojnë në mënyrë që të gjithë nxënësit në nevojë të marrin ndërhyrjen e duhur.
- Bashkëpunimi përmes raporteve të progresit.
- Mësuesit që japin mësim në këto klasa duhet të përfshijnë në mësimdhënie lojëra, këngë, dramatizime që t’i japin mundësi nxënësve në vëzhgim për t’u shfaqur.
- Prindërit duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e psikologut shkollor, në mënyrë që të mund të ndihmojnë fëmijët e tyre.

Referencat

- Robert Plutcik(psikolog Florida,USA).

-Case-Smith's,Terapia e punës për fëmijë dhe adoleshentë.

-Daniel Goleman (Titulli në origjinal “Inteligjenca emocionale”).

-Robert dhe Barbara Sommer (Universiteti i Oksfordit, USA).

-Judith Contreras Landess, (Doktor i Edukimit në Psikologjinë e Shkollës dhe Psikolog Shkollor i Certifikuar Kombëtarisht).

-Denada Toce(psikologe,analiste).

-NASP (Shoqata kombëtare e psikologjise shkollore).

NDIKIMI I REFORMAVE NË CILËSINË E MËSIMDHËNIES NË SISTEMIN PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Jaho Cana[1], Jonida Bushi (Gjuzi)[2]

[1]Universiteti "E. Çabej", Departamenti i Historisë-Gjeografisë,Gjirokastër

jaho.cana@yahoo.com

[2]Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjermanishtes

jonidagjuzi@yahoo.de

Abstrakt

Mbas përmbysjes së regjimit komunist në Shqipëri, e gjithë jeta shoqërore, ekonomike e politike, përjetoi ndryshime thelbësore dhe, në disa fusha, edhe radikale. Në këtë kuadër edhe në fushën e arsimit u bënë ndryshime të shumta, të cilat, ashtu sikurse dhe në fushat e tjera të jetës, u përmblodhën në një term, reforma, të cilat mbas viteve 90' dhe në vazhdim ishin të shpeshta dhe gati të vrullshme. Por a sollën ato në realitet përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në sistemin parauniversitar në hapësirën territoriale të vendit tonë? Dhe a ishin apo janë ato produktive dhe a e kanë përmirësuar gjendjen në sistemin arsimor parauniversitar?

Në thelb, mjaft prej këtyre reformave rezultuan të suksesshme dhe, madje, ishin të domosdoshme, por mjaft prej tyre, në vend që ta përmirësonin situatën, e përkeqësuan cilësinë e mësimdhënies. Prandaj është e domosdoshme që disa nga ato, të ashtuquajtura reforma, nuk duhej që të aplikoheshin në vendin tonë. Sepse këto reforma u morën në mënyrë shabllone nga vende të tjera dhe filluan të zbatoheshin pa marrë parasysh realitetin në sistemin arsimor shqiptar.

***Fjalë kyçe**: arsim, reformë, cilësi, para universitar, përmirësim.*

Abstract

The demise of communist regime in Albania inextricably led to the ensuing social, economic and political rapid changes. There were cases of certain fields experiencing radical ones. In this context, Albanian educational system, as well, underwent considerable changes which later on were designated as "after 90' reforms". These changes, in the coming years were, were frequent and impetuous. What perturbs us today is the frequently raised question: Did they bring about a qualitative or ameliorated teaching to the Albanian pre-University system? Were the reforms on Albanian educational system productive and progress-focused?

Basically there were some successful and necessary reforms, but there were others that have a counterproductive effect resulting in the teaching quality deterioration. That is why we have to emphasize here the fact that some of

the so-called reforms should not have been applied to the Albanian educational context for the mere fact that they represented an exact copy borrowed from other countries without undergoing the adaptation process. They were immediately applied overlooking the educational reality of Albania.

***Key words**: education, reform, quality, pre-university education, progress.*

Sistemin arsimor shqiptar viti 1990 e gjeti në një situatë të tillë ku reformimi i tij paraqitej një domosdoshmëri jo vetëm në aspektin e formës, por mbi të gjitha në përmbajtjen e tij. Tashmë dihet prej të gjithëve se sistemi arsimor shqiptar i para viteve 1990 ishte një sistem arsimor i cili bazohej kryesisht te pedagogjia ruse. Një sistem i cili në thelb pavarësisht se paraqiste një sërë avantazhesh dhe deri diku ishte i suksesshëm për kohën që u aplikua, duhet thënë se me ndryshimet që ndodhën në aspektin e sistemit politik dhe ekonomik, ky sistem kërkonte me patjetër që të ndryshohej, sepse ishte tejet i politizuar dhe ishte vënë tërësisht në shërbim të partisë-shtet. Madje, në sistemin arsimor të kohës, vendin kryesor e zinin lëndët që kishin të bënin me ideologjinë komuniste dhe filozofinë marksiste-leniniste. Lëndët kryesore të këtij sistemi ishin lëndët që bënin fjalë për historinë e PPSH-së dhe lëndët e filozofisë marksiste. Këto lëndë ishin edhe lëndët bazë. Sistemi arsimor i kohës i kishte kthyer ato në lëndë kryesore, duke spostuar në një farë mënyre shkencat bazë, si ato natyrore dhe ato shoqërore. Aq rëndësi kishin këto lëndë saqë rezultatet e tyre ishin dhe kriteri kryesor për të fituar të drejtën për të vazhduar arsimin e lartë.

Po kështu, sistemi arsimor bazohej tek i ashtuquajturi trekëndëshi revolucionar, i cili përcaktohej në këtë formë: Mësim, punë prodhuese dhe kalitje fiziko-ushtarake. Pra, duke i bërë vetëm një rishikim sipërfaqësor këtij sistemi shihet mjaft qartë se sa e domosdoshme ishte reformimi i këtij sistemi mbas viteve 1990.

Mirëpo, ky rishikim apo reformim paraqiste vështirësi të mëdha në të gjitha aspektet. Sfida kryesore për këtë qëllim mbetej sidomos depolitizimi. Në fakt, pavarësisht këtij politizimi të tejskajshëm të sistemit arsimor nuk kemi të drejtë të shtrembërojmë apo ta hedhim tërësisht poshtë arritjet në fushën e arsimit. Përkundrazi, gjatë 40 viteve të diktaturës komuniste pati arritje shumë të rëndësishme në fushën e arsimit si në infrastrukturë, ashtu edhe në formë e përmbajtje. Dhe, mbi të gjitha, në sistemin parauniversitar të kohës kishte potenciale të mëdha intelektuale që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në arsimimin e popullsisë shqiptare.

Në procesin e depoltizimit të shkollës reformat e pas viteve 1990, pa frikë, do t'i quaja të suksesshme. Sepse, në radhë të parë, u çlirua sistemi nga politizimi i tepërt dhe, mbi të gjitha, iu la hapësira e nevojshme lëndëve bazë si matematika, fizika, kimia, biologjia, historia, gjeografia dhe, madje, duke u futur edhe lëndë të reja të panjohura më parë, sidomos, në fushën e shkencave shoqërore, shkenca këto që kontribuojnë ndjeshëm në formimin

social të brezit të ri dhe, madje, duke hedhur baza të qëndrueshme për formimin e kuadrove të ardhshme për të përballuar sfidat e kohës dhe të realitetit të ri.

Po kështu ishin edhe mjaft reformat të tjera. Sidomos, të suksesshme ishin përpjekjet për rishikimin e teksteve mësimore. Tekstet, tashëm,filluan të hartoheshin në mënyrë më praktike duke i pastruar ato nga ujërat e tepërta. Mendoj se deri në fund të shekullit që lamë pas reformimi i këtyre teksteve u realizua me sukses. Dhe në këtë proces morën pjesë një numër i konsiderueshëm profesorësh e mësuesish të cilët ishin mjaft të përgatitur si në aspektin teorik dhe shkencor, ashtu edhe në aspektin psikopedagogjik.

Këto tekste, tashëm, kanë një ngarkesë mësimore të tillë që u përshtateshin grupmoshave që iu drejtoheshin dhe merrnin në konsideratë veçoritë psikologjike të nxënësve, duke mos i ngarkuar me shprehi e koncepte abstrakte dhe të pakuptueshme për moshën e tyre. Por mbi të gjitha këto tekste u pajisën me një aparat pedagogjik më të detajuar. Aparat ky, i cili i linte më shumë hapësirë mendimit krijues të nxënësve dhe nxitjes së të mësuarit krijues dhe larg të të mësuarit thjesht teorik dhe përmendësh.

Po kështu, nxënësit, tashmë, po sipas këtyre teksteve duhet të merren më shumë me aktivitete praktike, aktivitete këto të cilat do t'u lehtësonin punën nxënësve për përvetësimin e njohurive teorike në mënyrën sa më të shpejtë.

E suksesshme paraqitet edhe reforma për dokumentacionin shkollor. Por mbi të gjitha e suksesshme ishte mënyra e organizimit dhe administrimit të shkollave. Këto reforma i kthyen këto shkolla në qendra komunitare, që i vë ato teorikisht por edhe pjesërisht jo vetëm në shërbim të nxënësve, por edhe në shërbim të të gjithë komunitetit. Tashme, këto shkolla kanë një mënyrë dhe qasje krejt tjetër për në procesin e drejtimit të tyre dhe të vendimmarrjes. Dhe, mandej, këto reforma vunë në qendër të punës nxënësin duke respektuar në tërësi të drejtat e fëmijëve dhe duke ruajtur sidomos dinjitetin e tyre. Një vëmendje e rëndësishme në këto reforma i është kushtuar sidomos heqjes së dhunës në shkolla. Para viteve 1990, një nga defektet më të mëdha në sistemin arsimor ishte puna autoritare e mësuesit dhe dhuna që ushtrohej ndaj tyre, duke ndrydhur në këtë mënyrë iniciativën e nxënësve. Kjo mënyrë të vepruari në fakt ishte gati e qëllimshme me qëllim që shkolla të prodhonte njerëz dhe kuadro të formatuar larg iniciativës dhe vetëveprimit

Pra në thelb mjaft prej këtyre reformave rezultuan të suksesshme dhe madje ishin të domosdoshme, por mjaft prej tyre në vend që ta përmirësonin situatën, ato e përkeqësuan cilësinë e mësimdhënies. Prandaj është e domosdoshme që disa nga ato të ashtuquajtura reforma nuk duhej që të aplikoheshin në vendin tonë. Sepse këto reforma u morën në mënyrë shabllone nga vende të tjera dhe filluan të zbatoheshin pa marrë parasysh realitetin në sistemin arsimor shqiptar.

Në vazhdim të kësaj ideje duhet shtruar pyetja: A kanë ndikuar pozitivisht të gjitha këto reforma në procesin e mësimdhënies në sistemin parauniversitar

dhe a është produktiv ky sistem në krahasim me sistemin arsimor të mëparshëm?

Me keqardhje unë do të konstatoja se, në fakt, në disa raste, ato kanë ndikuar negativisht në këtë aspekt. Për ta konkretizuar idenë po marrim problemin e teksteve. Në shumë raste mënyra e përzgjedhjes së tyre nuk më duket se i përshtatet realitetit, madje, në ndonjë rast ato përzgjidhen edhe në mënyrë abuzive. Dhe në këtë mënyrë nxënësve iu afrohen tekste që paraqesin mjaft gabime, në radhë të parë, shkencore dhe kjo është më e pafalshmja. Pse ndodh ky fenomen? Kjo ndodh sepse në hartimin e këtyre teksteve autorët shpesh -herë përdorin një gjuhë tepër teorike, abstrakte dhe të pakuptueshme për nxënësin. Në disa tekste autorët përdorin edhe një terminologji që bazohet në gjuhët e huaja dhe jo në gjuhën shqipe. Prandaj unë mendoj që për të përmirësuar punën për hartimin e teksteve, përveç përfshirjes së intelektualëve nga bota akademike, në këtë proces duhen përshirë edhe mësues të cilët kanë një përvojë shumë të madhe në procesin mësimor. Dhe, në këtë sistem, në vendin tonë ka një armatë të madhe mësuesish të cilët janë jo vetëm të përkushtuar në punën që bëjnë, por janë dhe intelektual mjaft të zotë, të cilët me kontributin e tyre do të ndikojnë në përmirësimin e hartimit të teksteve mësimore dhe, rrjedhimisht, edhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Nga ana tjetër në procesin e cilësisë së mësimdhënies po ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë, të cilët në dukje janë të vogla, por që lenë pasoja të mëdha në këtë proces. Këtu dua të përmend faktin që sistemi arsimor në vend që të lehtësohet nga ana dokumentare, ai po rëndohet gjithmonë e më shumë, duke e kthyer mësuesin në një burokrat dhe jo në një mësimdhënës. Dhe kështu, sot mësuesit i kërkohet plotësimi i evidencave, formularëve, raporteve etj. Duke harruar dhe anashkaluar ata çka është më kryesorja, mësimdhënia.

Edhe mënyra e plotësimit të regjistrave na duket një mënyrë joefikase, sepse mënyra se si po punohet aktualisht me regjistrin, sipas vëzhgimeve të mia personale është i papërshtatshëm dhe shumica e mësuesve nuk e pranojnë këtë praktikë pune.

Nga ana tjetër, në cilësinë e mësimdhënies po luan negativisht rol edhe infrastruktura në shkolla dhe, sidomos, pajisja me laboratorë. Në shumicën e rasteve, në shkolla gjen rëndom disa libra, ndonjë hartë apo ndonjë mikroskop, disa kompjuter, të cilët në shumicën e tyre rezultojnë të prishur apo disa sende tëvjetruara dhe të dala jashtë përdorimit që në thelb nuk u përgjigjen kërkesave të kohës.

Si konkluzion, unë mendoj se marrja e masave për riparimin e këtyre problemeve dhe sidomos rritja e kontrollit në shkolla nga institucionet përkatëse do ta vendoste procesin e mësimdhënies në nivele të reja dhe do ta bënte procesin mësimor me zbavitës, më të kuptueshëm dhe më rezultativ.

Literatura

- AEDP, "*Metoda të mësimdhënies*", Toena, Tiranë, 1999.

- "*Arsimi nëpër botë"*, përmbledhje artikujsh, nr. 1-2, Tiranë, 1997.
- "*Arsimi nëpër botë*", Përmbledhje artikujsh. Revistë periodike,(koleksion).
- Caushi Lira, "*Metodologjia e historisë*", shblu, Tiranë, 2003.
- Dërguti Mendur, "*Metodika e historisë, për shkollën 8-vjeçare, klasa I-IV*",
- Filo Llambro, "*Libri i mësuesit dhe i nxënësit, historia 2*", Tiranë, 1999.
- Kraja Musa, "*Vizjone pedagogjike rurale*", Tiranë, 2003.
- *Metodat e mësimdhënies*, AEDP, Tiranë, 1999.
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, "*Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar"*, Tiranë, 2003.

ROMANCIERI PETRIT PALUSHI
PRODUKT I KOHËS SË RE

Ermelinda Kashahu
Departamenti i Letërsisë, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
ekashahu@gmail.com

Abstrakt

Produkti i kohës në veprat që sjell shkrimtari, përpunon teoritë e strukturimit të shoqërisë njerëzore, si epoka e modernitetit të lartë.Ky produkt është rrjedhojë i kohëve të orëve që është e detyrueshme, e kalendarit universal dhe e entiteteve të zbrazëta sociale, e sintezës së thellë dhe e teorisë bashkëkohore. Autori dallon në këndvështrimin interdisiplinar të tij interpretimet e reja dhe origjinale, duke shprehur një shqetësim intelektual, edhe kur pesha dramatike e zhvillimeve funksionale apo strukturore, ishte e madhe. Koha e leximit është dhe koha e shkrimtarëve si Petrit Palushi. Ky është produkti më i mirë në shërbimet profesionale, produkti i traditës me të cilën është edukuar letrarisht, ku në ballafaqimin e një vepre me një vepër tjetër shpjegon dhe funksionin me të cilën i ka përdorur shkrimtari në veprën e tij. Kjo justifikon bindshëm vëmendjen e opinionit letrar, ku në dritën e studimeve të reja të lexuesit, lexohet ndryshëm nga studiuesit. Mënyra sesi perceptohet realiteti dhe sesi realiteti është bërë i dukshëm te lexuesi, është dhe merita kryesore e autorit.

Abstract

The product of time in the works that the author brings, elaborates the theories of the structuring of human society, as the era of high modernization. This product is a consequence of the times of the hours which is obligatory, of the universal calendar and empty social entities, of the deep synthesis and contemporary theory. The author stands out in his interdisciplinary point of view new and genuine interpretations, expressing an intellectual concern, even when the dramatic weight of functional or structural developments was great. Reading time is also the time of writers like Petrit Palushi. This is the best product in professional services, the product of the tradition with which he was literary educated, where in the confrontation of one work with another he explains the function with which the writer has used them in his work. This convincingly justifies the attention of literary opinion, where in the light of new studies of the reader, is differently read by the scholars. The way reality is perceived and how reality has become visible to the reader is the main merit of the author.

Keywords*: time, writer, reality, Petrit Palushi*

Shkrimtari Petrit Palushi hyri në letërsi fal shkollës së tij dhe produktit frytdhënës së kësaj shkolle, si një vlerë e madhe për lexuesin shqiptar, po të kemi parasysh periudhën e regjimit diktatorial.Hyri siç hyn një studiues me rrëfime madhështore të ideve. Hyri me tema që hasen shpesh, si ajo e artit të bukur, për të mbërritur drejt një pjekurie problematike dhe të kuptueshme, drejt një humanizmi të ri që konsiston në pranimin e vetëdijshëm të jetës.

Kur kam lexuar mbi shkollimin e këtij shkrimtari, mu kujtua jeta e rëndomtë dhe censura e lirisë te shumë shkrimtarë, që sa e sa kanë vuajtur, e sa e sa vepra të tyre u janë censuruar dhe i ka mbuluar pluhuri shekullor. Ndaj, dhe unë, kur lexova mbi këtë shkrimtar, rroka me përpikmëri gjithë rrugëtimin e jetës dhe veprës së tij, njësoj si ata studiues që në një përpjekje fatlume mes historianit dhe shkrimtarit, mes hulumtimit dhe erudicionit, etikës së shkrimit dhe historisë, atyre historive të heshtura, rishkruajnë histori të reja. Një jetë e bukurshkruar dhe e përulur plot modesti, plot hijeshi, ndaj së vërtetës së artit, rezulton se ke ç'shkruan për të ku dhe unë si lexues i parë, gjej pamje, ngjarje, emra, që pulsojnë në dejet e jetës së këtij shkrimtari.

Një shkrimtar me edukatë dhe formim qytetar është dhe shkrimtari me ndjesi të mprehta estetike, ku referimet ndaj dukurive të papëlqyeshme për realitetin janë të dukshme dhe me pasivitetin e tyre i hapin rrugë çdo ideologjie.Moderniteti te ky shkrimtar, në mënyrë metaforike paraqitet me imazhin e një supermakine të fuqishme, ku për të pasur në bibliotekën e punës jo vetëm njerëzit e botës akademike, por dhe të gjithë ata që janë të interesuar ta kuptojnë botën e sotme, duhet të lexojnë në mënyrë sa më intelektuale këtë produkt cilësor që sjellin këta shkrimtar. Sjellin stilin e vet të këndshëm, të shoqëruar me një erudicion unikal si rivitalizim i teorisë sociale. Produkti i kohës në veprat që sjell shkrimtari, përpunon teoritë e strukturimit të shoqërisë njerëzore, si epoka e modernitetit të lartë.Ky produkt është rrjedhojë i kohëve të orëve që është e detyrueshme, e kalendarit universal dhe e entiteteve të zbrazëta sociale, e sintezës së thellë dhe e teorisë bashkëkohore. Autori dallon në këndvështrimin interdisiplinar të tij interpretimet e reja dhe origjinale, duke shprehur një shqetësim intelektual, edhe kur pesha dramatike e zhvillimeve funksionale apo strukturore, ishte e madhe.

Shkrimtari prek konceptin e tij për kohën, të tashmen historike ose të tashmen e amshueshme, e cila qëndron aty ku priten boshti i kohës dhe i hapësirës reale me boshtin e kohës dhe hapësirës irreale. Koha në veprën e autorit nuk është vetëm gjykim vlerëmatës, edhe pse vetë zgjedhja e temave dhe e autorëve përmban në vetvete parapëlqim dhe nevojën e domosdoshme të gjetjes së vendndodhjes në strukturën e sistemit tonë letrar.

Koha e leximit është dhe koha e shkrimtarëve si Petrit Palushi. Ky është produkti më i mirë në shërbimet profesionale, produkti i traditës me të cilën është edukuar letrarisht ku në ballafaqimin e një vepre me një vepër tjetër shpjegon dhe funksionin me të cilën i ka përdorur shkrimtari në veprën e tij. Kjo justifikon bindshëm vëmendjen e opinionit letrar, ku në dritën e studimeve të reja të lexuesit, lexohet ndryshëm nga studiuesit. Mënyra sesi

perceptohet realiteti dhe sesi realiteti është bërë i dukshëm te lexuesi, është dhe merita kryesore e autorit.

Në lidhje me këtë që thashë pak më lart, më kujtohet këtu dhe proza e Mitrush Kutelit, ku huazonte terma nga krijimtaria gojore. Edhe shkrimtarit tonë për krijimin e një realiteti fantastik i është dashur të njohë thellë botën dhe psikologjinë e shkrimtarit, njohje që e kanë brumosur me të tillë shije letrare, ndikuar thellë dhe në formimin e tij si shkrimtar.

Ajo që më pëlqen, është fakti që shkrimtari nuk shkruan mbi bazën e një teorie letrare, por mbi bazën e një tensioni emocional, që ka domethënie të vetën në planin ëndërror, ndjenjësor dhe ekzistencial.Parimi themeltar këtu nuk është më historiku, por koha me pjesëtimet e veta. Kjo është dhe vlera thelbësore e asaj çka ai ka trajtuar, e të qenit pikërisht me kohen. Në kushtet e një shoqërie të sotme, çdo gjë e re që sjell shkrimtari është tregues qytetërimi. Organizimi kolosal dhe letrar i shtrirë, është dhe krijimi letrar i një shkrimtari elitar, i cili që të jetë demokratik, duhet të bëjë të mundur që nëpërmjet një edukimi të eleminojë injorancën. Kjo mendjekthjelltësi është e ngjashme me krijimin letrar, duke bërë që letërsia të jetë zbavitëse dhe për të qenë e kapshme i shërben krijimit të demokracisë. Tejdukshmëria përtej misterit që në pamje të parë duket si një paqartësi, jep dhe ndezjen e paimagjinueshme të personazheve të kohës, që aq bukur i ka reflektuar shkrimtari. Kjo tregon dhe për shtrirjen e kuptimit të tekstit në përgjithësi. Koha në optikën e dashurisë realizon një mrekulli, mohon shkëputjen e një teksti (në rastin tonë të romaneve),duke shfaqur operacionin e bukur dhe emocionues, mbi një nga shkrimet kapitale të gjuhës sonë, siç është shkrimi i Petrit Palushit ku teksti bashkohet me tekstin, dhe teksti shndërrohet në një tekst tjetër.Nuk ka sesi një shkrimtar i tillë të mos jetë produkt i shkollës ku jeton dhe krijon, kur dihet fare qartë,që vepra e tij përbën një kontribut të jashtëzakonshëm në revolucionin e përhershëm të romanit bashkëkohor. Metaforat e qeta, të matura dhe tepër elegante,shpjegojnë raportin midis dasive dhe universalizmit, që nuk ka qenë as i lehtë, as i vazhdueshëm, por me ndërprerje kontraste, lëvizje të befasishme dhe shpërthyese. Ndoshta, kjo metaforë na bën të kuptojmë atë që duhet quajtur tragjedia e shpirtit evropian.Stuhia e mendimeve të shkrimtarit është një agim, një grumbull resh, një grumbull mendimesh dhe shpirti i shkrimtarit nuk është një realitet i përhershëm dhe nuk merr trajta të qeta dhe zbukuruese, por është shpërthyes, dramatik dhe uragan, është një trevë e ngopur që do të vdiste nga steriliteti.

Ashtu siç më ka tërhequr një piktor i vibracionit, që në pak ngjyra përcjell ngjyrën emocionale, edhe shkrimtari Petrit Palushi tërheq vëmendjen e lexuesit me jetëshkrimin e tij. E kam fjalën për veprat e tij që në mënyrë të drejtpërdrejtë i drejtojnë lexuesit mesazhe kuptimplota. Biografia e tij është ftesë e mirë për të njohur një jetë njerëzore. Për autorin, arti i fjalëve është dhe gjendje shpirti. Komunikimi shpirtëror dhe intelektual është padyshim komunikimi më i bukur i një njeriu, qoftë dhe kur jeta është e trazuar.

Rrjedha e njëkahshme e kohës kur shkroi autori, e bën më të kthjellët përsosjen e modelit të shkrimtarit, i cili na dhuron me bujari çdo të veçantë.

Nuk do të nguroj të flas për kuptimin konkret të veprave të tij, sepse më bën përshtypje që gjatë leximit të veprave nga fillimi e deri në fund, nuk sheh një lloj shterimi apo shushatje, duke bërë që shkrimtari të zërë një përqindje të lartë të letërsisë më të mirë artistike në këto vitet e fundit. I pëlqeva romanet e shkrimtarit, sepse aty ai nuk ka ku fshihet. Aty llafazanëria nuk të bën derman dhe sapo mbërrin në faqen e fundit, kupton sesi lexues i reziston impulsit historik, krahasuar këtu me shumë romane bashkëkohore që i bëjnë të ndihen në arrati. Kujtojmë këtu përshkrimin që shkrimtari bën për botën e rinisë, mënyrat e veta të dala nga moda, mënyra sesi shkrimtari gjykon zgjedhjet moderne.

Shkrimtari mbijeton në tërësinë e vet edhe si një person i pavarur.

Këtu përmendim rolin e tij si autor reflektiv ku bota e tij e brendshme dhe mbingarkea emocionale, shfaq zërin më të rëndësishëm të kohës.Edhe aty ku ndonjë roman nëpërmjet personazheve të tij denonconte regjimin komunist, librat e tij kanë një të vërtetë të madhe që karakterizohet nga liria ekonomike, iniciativa e lirë, individualizmi dhe egoizmi "racional". Prandaj, realiteti i jashtëm ekziston si një realitet objektiv dhe ky objektivizëm depërton në botën shpirtërore të lexuesit. Si arsye për të zbuluar mjetin e vetëm, për të zbuluar realitetin dhe si udhëheqje e veprimeve tona, është i pari shkrimtar që e vë theksin mbi mendimin e pavarur dhe iniciativën e lirë si një vokacion që mund të shfrytëzojë të gjitha aftësitë e shpirtit njerëzor. Si sintezë e thellë e teorisë bashkëkohore duke shqyrtuar impaktin e modernitetit mbi jetën personale dhe atë shoqërore të njerëzve, sa në diakroninë dhe sinkroninë e historisë së njerëzimit, duke shprehur në veprat e tij shqetësimin intelektual me peshë dramatike të zhvillimeve,shpesh veprat e tij përballen me tema universale. Këto marrëdhënie tejet të ndërlikuara për autorin, i trajton në thellësi duke e projektuar në brendësinë personale të tij.Në libra gjejmë misticizëm, qetësi, atmosferë krejt të ndryshme, herë stil të qartë dhe herë të zhdërvjellët, herë të spikatur dhe herë shpotitës. Kjo është dhe dilema që shkrimtari kërkon të kthjellojë në këtë rrugëtim, ku nocioni i kohës është konkret, ciklik dhe ndonjëherë i vazhdueshëm.

Kujtojmë këtu emrat interesant të personazheve të romaneve, ku në korpusin e pashkelur, ndonëse gjithnjë i pranishëm, shkrimtari përpiqet t'i marrë në strehë edhe personazhet e tjerë.Ndjenjat estetike rizgjojnë dhe shpirtin e personazheve drejt një rruge pa kthim. Pa dyshim një rrëfim i tillë, por me një vlerë të madhe për lexuesin shqiptar, është dhe rrëfimi madhështori i ideve.

Veprat e shkrimtarit janë të përfunduara artistikisht dhe vëmë re që duke u nisur nga e sotmja, problematizohet një jetë me të shkuarën, jepet një projektim i saj utopik në të ardhmen.Po të vështrohet materiali në relacion me realitetin, vlen të theksohet dhe koha objektive, ku shtresa aktuale e veprës i përgjigjet një të tashmeje në roman. Kërshëria e vërtetë dhe ajo moderne e ka zanafillën në veprën e vet si përqendrim më i mirë i dijes poetike dhe epokës së tij. Ky është shembulli i profesionalizmit të thellë, ku

eleganca plot shembuj erudicioni, hijshmërie poetike dhe përcaktimi konceptual apo këshillimet e vyera letrare, janë karakteristikë e rëndësishme e këtij shkrimtari. Vlen për t'u theksuar rrëfimi mbi koshiencën dhe subkoshiencën e personazheve, hijshmërie poetike, përcaktime konceptuale dhe këshillime të vyera letrare. Shembull tjetër i rëndësishëm dhe i çmuar i profesionalizmit të thellë që karakterizon punën e shkrimtarit dhe të ndershmërisë së tij shkencore, edhe pse në distancë, është loja gjuhësore në vetvete, që do të thotë shprehje e ndjenjës dhe e vërtetësisë.

Bukuria e këtij libri nuk qëndron në subjektin e romaneve,por në aftësinë për të zbërthyer psikologjikisht metamorfozën e trishtimit,dhimbjes, vetmisë, ku lakonizmi dhe gjuha metaforike është tipari i një proze të shkurtër, e cila ngjesh kuptime dhe asociacione dhe ku mesazhet e kuptueshme i drejtohen lexuesit duke i thirrur vetëdijes së humbur dhe ku konceptet kulturore nuk kthehen në rrëfim filozofik. Duket sikur ndonjëherë shkretia shpirtërore lidhet me mungesën e çështjeve për të cilat kuptimësohet jeta në planin shoqëror dhe ku dhimbja si vuajtje e brendshme, për pasojë të ndjeshmërisë, nuk është ndjesi e lënë pas dore në letërsinë moderne. Nga pikëpamja e kodit shkrimor, mbizotëron ai deskriptiv, i cili për shkak të qartësisë së përshkrimit, bën të mundur që në mënyrë të qëllimshme, të lirohet shkrimi nga figurat ligjërimore dhe në imagjinatën e krijuesit të mbizotërojnë faktet jetësore.Edhe përdorimi i monologut të brendshëm, gati mbizotërues në pjesën e parë, si instrument i rëndësishëm për të kuptuar çfarë ndodh, të bën të njohësh teknikat moderne të rrëfimit, se libri që sapo lexove sjell një shije të prozës moderne dhe postmoderne.Të mos harrojmë se letërsia shqipe rrallëherë e ka njohur neutralitetin si përvojë jete e shkrimit. Kjo bën që ndërthurja e dy stilemave ligjëruese: publicistike dhe letrare, sido që do të shoqërohej me një shkujdesje në punë të poetikës dhe formës, nuk ka qenë pengesë që në letërsinë e këtij shkrimtari të ketë shkëndija të tilla. Asnjë lexues, as unë, as dikush tjetër nuk nxjerr kot konkluzione se pse një shkrimtar është prozator i mirë. Edhe kjo e ka njëfarë shpjegimi:

Kur pohohet aksioma themeltare e letërsisë, cilado qoftë arsyeja, fragmentarizmi i kohës apo shpërbërja e jetës sonë bashkëkohore është vërtet imponuese. Momentet që ky shkrimtar ndjek, janë momente të një aksioni vendimtar, të pakthyeshëm dhe dramatik. Kujtojmë këtu librin "Reshpjen që s'e kuptuam kurrë".Kjo do të thotë se leximi i këtij shkrimtari mua më fut në një gjendje reflektimi të qetë, ashtu si lexuesi, i cili në momente të caktuara me statusin e misionarit, rinis të krijojë personalitetin e vet shpirtëror dhe kulturor në botën shqiptare

Latinët thoshin: Historia është mësuesi i jetës

Në këtë vështrim, shkrimtari në fjalë është fenomeni letrar i kohës së tij pasi përshkruan një standard të lartë moral, me jetë e me vepër, duke e quajtur kështu detyrën e tij si një objektivizëm, që do të thotë filozofi e bazuar në realitetin objektiv.Kjo tregon se mendja njerëzore e shkrimtarit Petrit Palushi, përmes arsyetimit është mjeti që njeriu ka për ta njohur atë, kur dihet se arsyeja është udhëheqësja dhe gjykimi i pavarur i mendjes së vet.

Optika krejt origjinale, kulturologjike, historike dhe filozofike është ajo që komunikon drejtpërdrejt me lexuesin, ku përmes kthjelltësisë së trajtimit të argumentit, të qëndrimit kritik dhe të pakompromis të fenomenit, në simbiozë me diturinë dhe elegancën e stilit, model ky që mungon në këto përmasa në mjedisin shoqëror.Pra, përmes këtij zhanri delikat, autori ka ditur të sjellë përballjen me kujtimet dhe sfidat dëshmuese historike.Kështu, lexuesi fiton bujarisht ato që përjeton dhe shijon estetikisht preciozitetin e kujtimeve të një jete unike. I vetëdijshëm dhe i kujdesshëm që lidhja mes jetës reale dhe letërsisë (artit në përgjithësi), të mbetet e një lloji të veçantë duke bërë që realiteti edhe pse ka qenë i vështirë dhe i ashpër për shkrimtarin, të ketë vlerën e dëshmisë dhe jo të interpretimit.

Përfundime:

Pavarësisht nga qëndrimi i ideve të shkrimtarit, strategjia e përforcuar nga faktori letrar është më i dobishmi dhe më i favorshmi për lexuesit dhe të tjerët në të njëjtën kohë.

Në fushën e pastërtisë së gjuhës shqipe, ai e ndjek me këmbëngulje parimin e drejtë të rilindësve, të përdorimit të fjalës shqipe në vend të fjalës së huaj, duke aktivizuar dhe duke vënë në qarkullim shpeshherë edhe fjalë të tjera, krejt burimore ose të krijuara prej tij.

Nëpërmjet këtyre praktikave, shkrimtari jep Shqipërinë në rrymë të kohërave e në mënyrë të veçantë në këtë gjysmëshekull të fundit.

Literatura:

VATH KORESHI: Roman i shkruar mjeshtërisht. Nga parathënia e romanit "Përroi i Andrrës" (2004).

HALIL HAXHOSAJ: "Vështrim në prozën romanore të Petrit Palushit", botim i OMBRA GVG, Tiranë, 2011.

Ibrahim Kadriu: Profil i Petrit Palushit "Buzëqeshje miqsh", 4 (Reflekse biografish), SHB "LIBRI SHKOLLOR", Prishtinë, 2015, fq.179.

FATMIR MINGULI: Paralelizmi ekzistencial "Vështrim kritik për romanin "Shtrati 13" të Petrit Palushit, 1 tetor, 2016.

Abdullah Zymberi: Fjalësi te veprat e shkrimtarit tonë Petrit Palushi

Kumtesat (Shkencat gjuhësore 1), fq. 211- 215, Prishtinë 2013.

Granit Zela: "Fjala", 12 shtator, 2004.

SFONDI HISTORIK I PARTIVE POLITIKE ITALIANE

Ejona Isufaj
Këshilltare e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
isufaje@gmail.com

Abstrakt
Ky punim tregon në mënyrë të përmbledhur dhe krahasuese fondin historik të krijimit të partive politike italiane në sistemin shumë partiak të demokracisë liberale. Analiza krahasuese tregon dallimet dhe ngjashmëritë duke pasur në konsideratë ambientin ekonomik, social dhe ideologjik ku lëvruan dhe drejtuan këto parti në vende të ndryshme Evropiane. Italia e periudhës para Luftës së Dytë Botërore është fokusi kryesor i këtij punimi.
Fjalët kyç: *parti, partitë politike italiane, Lufta e Dytë Botërore.*

Abstract
This paper summarizes and compares the historical background of the creation of Italian political parties in the multi-party system of liberal democracy. Comparative analysis shows the differences and similarities taking into account the economic, social and ideological background where these parties delivered and led in different European countries. Pre-World War II Italy is the main focus of this paper.
Key words*: parties, Italian political parties, Pre-World War II.*

Sistemi partiak i Republikës së Parë italiane (1946-1992) është përkufizuar si "sistem shumëpartiak me mbizotërimin e një partie". Partia Demokristiane ka qenë pjesëtare në të gjitha qeveritë e koalicionit të kësaj republike (mbi 50 qeveri koalicioni).

Ky sistem dallonte nga sistemet partiake të demokracive të tjera perëndimore, të cilat sillnin karakteristikat e mëposhtme:

- **sistemi dy partiak**, karakteristikë për vendet anglofone, me dy parti politike të mëdha që alternohen në pushtet dhe drejtohen me qeveri një - partiake;
- **sistemi partiak dy plus një**, karakteristike për Gjermaninë, ku asnjë nga partitë e mëdha, si: Partia Kristiandemokrate, Partia Socialdemokrate nuk kanë mundur të krijojnë qeverinë njëpartiake, ndaj kanë formuar qeveri në aleancë me një parti të tretë, të vogël nga pesha elektorale, siç ka qenë Partia Liberaldemokratike, pjesëmarrëse si në qeverinë e formuar nga Partia Kristiandemokrate, por edhe kur qeveria ka qenë e formuar nga Partia Socialdemokrate.

- **sistemi shumëpartiak** në të cilin mbizotëron një parti, si në Francë gjatë Republikës së Katërt (1946-1957)[1].

Ç'mund të themi për përcaktimin e modelit të sistemit politik të demokracisë liberale të Italisë, në lidhje me kushtëzimin e faktorëve ekonomikë, socialë, kulturorë që, siç i trajtuam më sipër, janë me efekte të drejtpërdrejta në jetësimin e njërit apo tjetrit model, pra, të "modelit mazhoritar, të garës e konkurrencës" apo të "modelit Konsensus i bashkërendimit e pajtimit". Mund të pranojmë se Italisë për vetë kontekstin e faktorëve, me pikënisje traditën historike, diferencimet ekonomike, sociale, rajonale si dhe të nënkulturave **i shkonte për shtat *modeli konsensus i bashkërendimit*.**

Hedhja e bazave të modelit të sistemit politik nisën në procesin **e bashkimit kombëtar të Italisë,** që ndodhi në gjysmën e dytë të shekullit XIX, pra, shumë më vonë se komb-shtetet e tjera të Evropës Perëndimore, gjë që tregonte edhe për "vonesa" në zgjidhjen e "krizave të mëdha" që i bashkëngjiten zhvillimit të komb-shteteve moderne, si "kriza e identitetit", "kriza e depërtimit", "kriza e legjitimitetit". Në mesin e shekullit XIX Italia vazhdonte të ishte ndarë në shtete dhe principata monarkike të pavarura nga njëra – tjetra. Territore të Italisë së Veriut si Lombardia, Venediku, Toskana ishin nën kontrollin e Austrisë. Italia e Jugut ishte nën sundimin e një dinastie mbretërore të huaj. Në Italinë Qendrore krahas principatave ishte shteti Papal.

E vërteta ishte se edhe pse ekzistonin dallime në aspektin ekonomik, politik, ekzistonin tiparet karakteristike të kombit, të komponentit psikologjiko-kulturor të tij si gjuha e njëjtë, besimi fetar – katolik (*Italia i kishte rezistuar reformacionit protestant*) dhe shfaqje kulturore të përbashkëta.

Përjashtim, përsa i përket formës së qeverisjes dhe zhvillimit ekonomik e social bënte mbretëria e njohur zyrtarisht si **Mbretëria e Sardenjës**, ku ndryshe nga shtetet e tjera të Italisë, ishte sanksionuar monarkia parlamentare dhe ishte hapur rruga e zhvillimit të sipërmarrjes së lirë kapitaliste. Ajo shquhej për rritjen e prodhimit përmes investimeve në industri, bujqësi e infrastrukturë. Në Sardenjë ekzistonte një elitë politike e përkushtuar ndaj modernizimit të gjithanshëm ekonomik, shoqëror e kulturor. Mes saj veçohej kryeministri Kamiljo de Kavur (1810-1861). Ishte, pikërisht, Mbretëria e Sardenjës që u bë nismëtare për bashkimin e Italisë: ajo,siç shprehej Kavuri, përbënte shembull për modernizimin e gjithë Italisë dhe që popullsia e shteteve dhe principatave do të bindeshin se do të përfitonin shumë nga bashkimi me Mbretërinë e Sardenjës, si nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, social, kulturor ashtu edhe për rritjen e shkallës së jetesës. Kështu do të mundësohej bashkimi paqësor, me pëlqimin dhe miratimin e popullsisë, që në fakt u shpreh përmes organizimit të plebishitëve. Meritë e Kavurit ishte dhe sigurimi i aleatëve nga shtetet evropiane, që nënkuptonte mbështetjen për çlirimin e territoreve të Italisë

[1]Filo. LLambro, Sistemi Politik Bashkëkohor-Europa, Ideart, 2010, fq. 192.

nga pushtimi i huaj, ashtu edhe për njohjen në arenën ndërkombëtare si komb-shtet i pavarur i rreshtuar krahas komb- shteteve të tjera.

Ndërsa u realizua bashkimi i Italisë (zhvillimi i plebishiteve në principatat në të cilët u dha pëlqimi për bashkimin e vendit; lufta e armatosur kundër pushtuesve të territoreve të Italisë së Veriut; lufta e udhëhequr nga Xhuzepe Garibaldi në Jugun e Italisë; thirrja më 17 mars 1861 i parlamentit me përfaqësues të zgjedhur i cili shpalli zyrtarisht bashkimin e Italisë me mbretin Viktor Emanueli II (1849-1978) e Roma si kryeqytet i Italisë së bashkuar) u bë **çështje e mprehtë organizimi institucional e funksional e shtetit të ri.**

Ndërkaq ekziston një lidhje rekursive mes sistemit politik të demokracisë liberale dhe kulturës civile e politike me përmbajtje liberale e demokratike. Vetë sistemi politik i demokracisë liberale nuk mund të jetë i qëndrueshëm pa mbështetjen sociale të qytetarëve të formësuar me idealet e vlerat liberale e demokratike.

E vërteta ishte se në Itali **kishte *vonesa* në përhapjen e ideve** të platformës së liberalizimit, konservatorizmit modern dhe të nacionalizmit modern aq të domosdoshëm në mbështetjen e sistemit të ri politik. Për dhjetë vjeçar të tërë ishin bërë mbizotëruese idetë e nacionalizmit romantik e emocional të përfaqësuar nga Xhuzepe Mazin. Prandaj ekzistonte një e ***çare*** e madhe midis asaj çfarë ishte arritur me bashkimin e Italisë (si arritje në zgjidhjen e 'krizave' të para të mëdha, 'kriza e identitetit', 'kriza e depërtimit' 'kriza e legjitimitetit') dhe premisave të domosdoshme për sanksionimin e sistemit të qeverisjes moderne e mbështetur me zgjidhjen e krizës së pjesëmarrjes dhe krizës së shpërndarjes.

U përhap shprehja **Italinë e bëmë, tani të bëjmë italianët –** shprehja që përmbante nevojën për ndërrmarjen e shndërrimeve të reja në të mirë të faktorit kontekstual që lidhet me formësimin e kulturës politike liberale e demokratike të elitës politike e të masës së popullsisë.

Në këtë proces studiuesit veçojnë rolin e Kamilio Kavurit. Platform e Kavurit me **argument edhe për organizimin politik të Italisë** shprehte dhe një lloj reaksioni' ndaj sistemit qeverisës në shtetet që kishin copëtuar Italinë dhe po aq ndaj prirjeve kulturaliste, individualiste të elitave të këtyre shteteve që ishin të **natyrave statike, autoritare e konservatore.**

Kavuri pati meritë të madhe për **hedhjen e bazave të parlamentarizmit,** që mund të themi se i shkonte në lidhje me modelin e ardhshëm të sistemit politik të Italisë së bashkuar.

Sipas Kavurit,**parlamenti duhej të ishte qendër e shprehjes dhe përpunimit të opinionit publik,** por i realizuar nga një grupim i caktuar, ai që gëzonte të drejtën e votës. Në funksion të shprehjes së opinionit publik, Kavuri i kushtonte rëndësi të madhe **zhvillimit të debateve parlamentare**. Debatin ai e shihte si një mjet i pazëvendësueshëm në shqyrtimin dhe formulimin e politikave dhe të rritjes së përgjegjshmërisë në qeverisje.

Në vazhdim të përcaktim të rolit të parlamentit, Kavuri veçonte si debatin më të rëndësishëm e më me peshë atë për **buxhetin e shtetit.** Miratimin e buxhetit e mbështeste në argumentin e liberalëve të hershëm për funksionimin e parlamentit i cili ishte institucioni që bashkëlidhte: *Përfaqësimin* në qeverisje të të qeverisurve, demokracia përfaqësuese: përfaqësuesit e zgjedhur me votën e të qeverisurve, me *pëlqimin* që janë përfaqësuesit e zgjedhur nga të qeverisurit që shprehin vullnetin e tyre dhe të cilët japin pëlqimin për politikat qeveritare, ku veçohet ***pëlqimi për taksa***. Kjo shprehet me sloganin"**taksa me përfaqësim e pëlqim**", si të vetmet që fitojnë legjitimitet. Parlamenti, nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit, rrit përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e qeverive. Kështu krijonte pengesa ligjore që ndalin qeveritë që të ndërmarrin veprime arbitrare dhe abuzive.

Më tej në konceptimin e Kavurit për parlamentin si **organ i shqyrtimit ishte dhe përcaktimi si organ kontrolli mbi aparatin e ministrave (qeveria).** Madje, ai veçonte përgjegjshmërinë e drejtpërdrejtë të parlamentit në menaxhimin e burimeve natyrore, njerëzore e kapitale, që, siç dihet, kanë si tipar karakteristik të tyre *pamjaftueshmërinë*, ndërkohë që kërkesat për të mirat materiale (vlerat materialiste) nga ana e të qeverisurve janë të pafundme. Kjo ndodh edhe kur të qeverisurit gëzojnë standard jetese, të shprehur përmes të ardhurave, sigurimeve shoqërore, mirëqenies të kënaqshme.

Xhovani Sartori, një studiues tjetër i madh i demokracisë e konceptonte **rolin e parlamentit të pazgjidhshëm me buxhetin e shtetit.** Ai shkruan: "*Pushteti i parlamenteve është pikërisht "pushteti mbi qesen", pushteti që synon një marrëveshje për taksat si një nga burimet e të ardhurave dhe njëkohësisht, frenim të shpenzimeve, qeveria mund të shpenzojë vetëm me miratimin e parlamentit dhe parlamenti është realisht një gardian me shumë sy dhe dorështrënguar, sepse përfaqësonte ata që paguanin"*. Sartori nënvizon rrezikun që krijohet për dobësimin e pushtetit mbi qesen, kur përfaqësuesit e zgjedhur në parlament, të ndodhur nën trysninë e zgjedhësve, të tregoheshin të shpenguar në premtimet gjatë fushatave elektorale dhe miratonin lloj-lloj shpenzimesh e të rritjes së tyre pa pasur parasysh gjendjen e të ardhurave- çka i hapte rrugën krijimit të deficiteve buxhetore dhe rritjes së borxhit publik. Këto pasoja që çojnë në krijimin e deficiteve buxhetore, Sartori i lidh me demokracinë në deficit që nuk arrin të kontrollojë shpenzimet dhe që mbërthehet në rrethin vicioz borxh – inflacion dhe që është, patjetër, një demokraci e prekur nga politika e keqe[2].

Kavuri këmbëngulte që jeta parlamentare të mos ishte e mbyllur. Për këtë arsye ai i kushton rëndësi masmedias, si njëri nga kanalet e rëndësishme të lidhjes me të qeverisurit.

Predispozitës së Kavurit për rolin e veçantë mbizotërues të parlamentit në qeverisje i shtohej ajo e deqendërsimit në qeverisje. Sipas Kavurit, *një komb*

[2]Satori Govani, Ç'është Demokracia, Dituria, 1998, fq. 248.

*i madh dhe i fortë*duhet të ketë hapësirë për autonomi krahinore, rajonale me të drejta për të miratuar **ligje vendore në përshtatje me dallimet dhe strukturat ekonomike e shoqërore.** Ai theksonte se zhvillimi harmonik mund të realizohej me një administrim të mirë, me moralizëm e paqëtimin e vendit dhe jo me shtetrrethime (që filluan të praktikohen rëndom në Italinë Jugore të prapambetur) dhe as me ligje të jashtëzakonshme[3].

Në argumentet e Kavurit për vendin e rolin e parlamentit vihen re parashtrime që lidhen me tipare të modelit konsensus e të bashkërendimit, të sistemit politik të demokracisë liberale. Mendohet se modeli konsensus e i bashkërendimit do të ishte më i përshtatshëm për Italinë. Konsiderata mbështet në:

1. Karakterin e secilit prej modeleve të sistemit politik të demokracisë liberale; modeli mazhoritar; modeli i garës e konkurrencës; modeli i përzier;

2. Kushtëzimet e modeleve nga konteksti i faktorëve (faktorët kontekstualë) që janë me efekt të drejtpërdrejtë në konturimin e modelit të sistemit politik, si: përvoja (e parë dhe si traditë) historike dhe evoluimet me sistemin e qeverisjes; shkalla e zhvillimit ekonomik e social; kultura civile e politike e masës, popullsisë dhe të elitave. Në të gjithë këta faktorë, siç analizon studiuesi Jackon J.Spievogel, Italia shprehte karakteristika të veçanta[4].

Kështu:

a. Edhe pse u realizua bashkimi i Italisë, asaj i **mungonte tradita e qeverisjes së unifikuar e të qendërsuar.** Besatimi (që mishërohet në legjitimitetin e qeverisjes) ishte me nuanca të theksuara të natyrës lokale, provinciale dhe, për shumicën e italianëve, ishin të një rëndësie shumë të madhe. Te mbizotërimi i ndjesive provinciale e kishin bazën prania e rivaliteteve lokale.

b. Tek italianët kishte mungesa në zhvillimin e ndjesive apo të **sensit të komunitetit,** për arsye të diferencimeve të thella seksionale dhe kulturore. Ndryshe nga veriu i Italisë që po bëhej më i industrializuar, i urbanizuar e më i pasur, Jugu i Italisë ishte rajoni ku mbizotëronte prapambetja ekonomike dhe varfëria. Ai ishte i populluar nga pronarët e mëdhenj dhe nga numri i konsiderueshëm i fshatarëve pa tokë, të cilët i konsideronin italianët e Veriut si të huaj.

c. Edhe pas bashkimit të vendit, **pozicionimi i Kishës Katolike,** ishte i tillë që ndikonte në ruajtjen e dallimeve e të ndarjeve brenda komb-shtetit të ri. Për këtë kishin ndikuar pikëpamjet e Papës Piu IX (1846-1878). Ai nuk ishte pajtuar me humbjen e pushtetit të tij territorial në shtetin Papal dhe e deklaronte veten si"*i burgosuri në Vatikan"*. Prandaj bënte thirrje që katolikët që përbënin shumicën e popullsisë të mos merrnin pjesë në zgjedhjet elektorale kombëtare dhe në organet e qeverisjes së re. Megjithëse

[3]Filo Llambro, Marku Juljana, Luku Esilda. Historia e civilizimit bashkëkohor, Ideart, 2012, fq. 104-105.

[4] Spievogel J. Jackon, Western Civilization, Compreheusive, Volume, 1991, fq. 841-848.

pretendimet e qëndrimet e Papës ishin injoruar nga shume italianë**, pozicioni opozitar i Kishës Katolike** ishte një burim kundërshtie dhe revolta ndaj qeverisjes së re.

Qëndrimet e Papës Piu IX ishin shprehje e **katolicizmit të pareformuar,**i cili ,ndryshe, nga protestantizmi nuk pranonte pajtimin midis katolicizmit dhe kapitalizmit dhe po aq pajtimin e katolicizmit me demokracinë. Siç dihet, protestantizmi me *etiketën protestante,* që u bë *etika e sipërmarrjes kapitaliste* ofroi një mbështetje të madhe në modernizimin ekonomik, social e politik të komb-shteteve perëndimore. U desh që të kalonin vite që Kisha Katolike të ndryshonte qëndrimet e saj për **pajtimin e katolicizmit me kapitalizmin dhe demokracinë.** Kjo u afirmua publikisht në vitin 1892 nga Papa Leoni XIII, në enciklikën e parë sociale "Rerum Novarum".

Problemet ekonomike të Italisë së bashkuar ishin po aq të mprehta. Edhe pse Veriu kishte arritje të konsiderueshme në rrugën e modernizimit ekonomik e social përmes industrializimit dhe urbanizimit, Italia në përgjithësi karakterizohej nga pamjaftueshmëria, me mungesa në burimet natyrore të konsiderueshme që pengonin zhvillimin e harmonizuar në shkallë kombëtare.

Pengesa e madhe në rrugën e modernizimit ekonomik e social dhe në konsolidimin e sistemit të ri të qeverisjes së demokracisë liberale ishte **shkalla tepër e lartë e analfabetizmit.**

Faktorët që u trajtuan më sipër **kishin cenuar zgjidhjen e plotë të të tri krizave të para të mëdha:** të krizës së identitetit; të krizës së depërtimit; të krizës së legjitimitetit.

Kjo ishte arsyeja që në Itali të **shfaqen mangësi dhe vonesa në zgjidhjen e krizës së radhës: të krizës së pjesëmarrjes.** Kjo krizë, siç u analizua më sipër, konsiderohet se ka marrë zgjidhje me:

1. Përafrimi i së drejtës së përgjithshme elektorale, që nënkupton demokratizimin e votës (demokracia elektorale), si dhe formën elementare të pjesëmarrjes në qeverisje (kuptimi minimal i demokracisë). Shtetasit me të drejtën e votës ndihen pjesëmarrës në qeverisje (zgjedhin dhe zgjidhen në organet e qeverisjes), të integruar në sistemin e qeverisjes së demokracisë liberale si "*guverment of the people, by for the people*". Ata që gëzojnë të drejtën e votës u krijohet mundësia që të japin pëlqimin dhe miratimin se kush do të qeverisë, e po ashtu ta bënin qeverinë të përgjegjshme dhe llogaridhënëse për zgjidhjen dhe plotësimin e interesave të mbarë shoqërisë.

2. Njëherësh me afirmimin e së drejtës së përgjithshme elektorale, afirmohen edhe **partitë politike elektorale e të masës.** Janë partitë politike që realizojnë demokracinë përfaqësuese, që është në thelbin e sistemit politik të demokracisë liberale dhe që dallohet nga demokracia klasike, si demokraci e drejtpërdrejtë.

Qeveritë perëndimore u përballën me **trysninë e socializmit shkencor** (i simbolizuar me marksizmin), i përfaqësuar nga të ashtuquajturit ideologë të klasës punëtore, Karl Marks e Frederik Engels. Ata synonin në kanalizimin e

mobilizimit social e politik të punonjësve, jashtë institucioneve ekzistuese në zhvillimin e revolucionit proletar të armatosur, përmbysjen e institucioneve ekzistuese dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, që, me likuidimin e pronës private, do të shënonte edhe përmbysen e sistemit ekonomik kapitalist.

Në këtë mjedis të mobilizimit social e politik të punonjësve dhe të trysnisë së Marksizmit, në vendet perëndimore u arrit **kompromisi i madh** ndërmjet **kapitalizmit** dhe **demokracisë.** U arrit nga elita qeverisëse liberale, përfaqësues edhe të sistemit ekonomik kapitalist që trysnia që mbarte në vetvete mobilizimi social e politik i punonjësve për sigurimin e pjesëmarrjes në qeverisje, ta kanalizojë në rrugë institucionale**,** me garantin ligjor të së drejtës së votës për masën e gjerë të popullsisë, e konceptuar si **e drejta e përgjithshme elektorale.** Kjo nënkuptonte demokratizimin e votës, e njohur edhe si demokraci elektorale, pararendëse dhe integrale e demokracisë përfaqësuese që është në thelbin e sistemit politik të demokracisë liberale. Kjo i shërbeu drejtpërdrejtë performancës së demokracisë, e shprehur përmes qëndrueshmërisë dhe stabilitetit.

Partitë politike italiane e ruajtën gjatë tipin e partisë elitë parlamentare. Ato vazhduan të jenë **grupime të vogla me mbështetje shoqërore tepër të kufizuar.** Si të tilla drejtuesit e tyre ishin shumë të dhënë pas sigurimit të posteve në qeveritë e formuara e të përfitimeve prej tyre, sesa për zgjidhjen e interesave të mbarë shoqërisë. Kjo ishte dhe arsyeja që parlamenti të mbizotërohej nga realitetet mes grupimeve politike për sigurimin e posteve, të atyre që dukeshin se i afronin më shumë përfitime nga mbajtja e tyre, gjë që i hapi rrugë ryshfeteve dhe korrupsionit.

Transformimi bëri që qeveritë të mos karakterizoheshin nga konkurrenca partiake, mbi bazën e alternativave dhe objektivave politike që do të realizonin. Prandaj qeveritë e koalicionit ishin të paqëndrueshme, ato zëvendësonin njëra-tjetrën. Megjithatë, u arrit në një stabilitet të qeverive kur ato u drejtuan nga Xh. Xholit.

Ai shërbeu si kryeministër gjatë periudhës midis viteve 1903 - 1914. Stabiliteti i qeverisë i shërbeu që t'i jepej fund dukurisë së transformimit, që kishte karakterizuar veprimtarinë e partive politike në parlament gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit XIX. Por me Xholitin filloi të zërë vend një dukuri tjetër që do t'i bashkëngjitej partive politike italiane, mbizotërimi i partisë **nga figura e udhëheqësit lider,** si një figurë politike e pazëvendësueshme në parti e në pushtet. Kjo nënkuptonte që udhëheqësi partiak të përdorte lloj-lloj mjetesh e mënyrash për të qenë në pushtet, duke shërbyer në perspektivë për ta bërë qeverisjen italiane, edhe shumë më të korruptuar[5]. Partitë politike në vendet e tjera të Evropës Perëndimore që ishin shndërruar në parti elektorale të masës, u bënë nismëtare të zgjidhjes së krizës tjetër të madhe, ajo *e shpërndarjes.* Është fjala për ndërmarrjen e politikave publike për shpërndarjen autoritative të vlerave materialiste për

[5] Spievogel. J. vepër e cituar, fq. 842.

shoqërinë. Kjo nënkuptonte marrjen e përgjegjësive nga qeveritë partiake në zgjidhjen e problemeve ekonomike e sociale, pra, edhe **shkëputjen nga "laissez- faire",** që ishte kundër ndërhyrjes së qeverisë në jetën ekonomike e sociale.

Me zgjidhjen e krizës së pjesëmarrjes, u hodhën bazat për shtetin e mirëqenies sociale, *shteti që kujdeset për jetesën e përshtatshme e mirëqenien e shtetasve*. Që kujdeset për: garantimin e të ardhurave për punonjësit (sanksionimi me ligji i pagës minimale); krijimin e legjislacionit të sigurimeve shoqërore me përfitimet si për të papunët, të paaftët, të moshuarit, të fëmijëve; mirëqenien e shprehur në rritjen e shkallës së jetesës, strehimit komod; arsimimit; shëndetit publik; kalimin e kohës së lirë; mjedisit të pastër[6] etj.

Zgjidhja e krizës së shpërndarjes, u integrua në funksionin e partive politike të **përmasave horizontale** (integrimi politik i shoqërisë) me synimin e arritjes së kohezionit social, përmes harmonizimit të sa më shumë interesave të klasave e të shtresave sociale e shmangien e dallimeve apo pabarazive të thella ekonomike.

I pari ishte parlamenti gjerman që me nismën e kancelarit Van Bismark (i konsideruar si pionieri i shtetit të mirëqenies sociale) që pas vitit 1880, miratoi serinë e ligjeve, pjesë të legjislacionit social me të cilat punonjësit u bënë përfitues të sigurimeve shoqërore të disa tipave.

Në Britani ku në qeverisje ishte Partia Liberale u avancua edhe më tej. Krahas miratimit të ligjeve për ofrimin e sigurimeve shoqërore me përfitim për punonjësit filloi të zbatohej taksa progresive mbi të ardhurat, çka shënoi edhe rishpërndarjen e të ardhurave në funksion të kohezionit social.

Ndërsa në Itali, partitë politike që ruanin tiparet e partive elitë parlamentare, bënë pjesë të veprimtarisë së tyre realizimin e pretendimeve imperialiste[7]. Ata u zotuan fort që Italia të gëzonte statusin e Fuqisë së Madhe ashtu si të shteteve të tjera perëndimore. Për këtë punuan që të krijohej një ushtri e madhe dhe flotë e fuqishme. Një zotim i tillë i partive politike italiane nuk qe i rastit. Të gjithë faktorët e trajtuar më sipër, lidhur me: dallimet e mëdha ekonomike, sociale, kulturore, rajonale; vonesat në institucionalizimin e mobilizimit social e politik të punonjësve nëpërmjet afirmimit të së drejtës së përgjithshme elektorale; predispozitat e partive politike italiane si *parti elitë parlamentare* me veprimtarinë kryesisht në parlament; dukuria e *transformuar* me shfaqje të rivalitetit, për të zënë postet në qeveri, që ndryshojnë në vazhdimësi, i bënin ato të paqëndrueshme. Dukuria e liderit partiak të pazëvendësueshëm (në shembullin e Xholitit), kishte krijuar pengesa serioze për **integrimin kombëtar të popullsisë**, kultivimin e **ndërgjegjes kombëtare** lidhur kjo me realizimin e legjitimitetit të sistemit qeverisës, i parë si identifikimi i popullsisë në sistemin politik të qeverisjes e të besimit ndaj tij. Me fjalë të tjera shtetasit duhet të motivohen **nga ndjesia**

---

[6]Filo, Llambro, Historia për Shtetin e Mirëqenies Sociale, Extra, 2002.
[7]Spievogel, J. Vepër e cituar, fq. 842.

e përkatësisë në sistemin politik të demokracisë, të simpatisë për të dhe të pasurit interes në mbarëvajtjen e sistemit, ku të gjithë (pavarësisht nga dallimet sociale e ekonomike) janë përfshirë në termin **NE**.

Ndjesia e përkatësisë ndaj sistemit politik i tejkalon ndjesitë për qeveritë e ditës (që vinë në pushtet nga zgjedhjetelektorale të rregullta e periodike), të cilat, për politikat që ndjekin, mund të mos pëlqehen nga të gjithë shtetasit.

Në vitin 1912 në Itali, shumë më vonë se në vendet e tjera të **Evropës Perëndimore** u afirmua **e drejta e përgjithshme elektorale për burrat,** por ajo nuk i shërbeu institucionalizimit të mobilizimit social e politik të punonjësve. Vazhduan aksionet edhe trazirat jashtë institucioneve. Jo të gjithë punëtorët votonin për partinë socialiste që pretendonte se shprehte të drejtat e klasës punëtore.

Veprimtaria e partive politike pushoi me vendosjen e regjimit fashist.

RËNDËSIA E NJOHJES NGA MËSUESIT E ÇRREGULLIMEVE TË VËMENDJES DHE HIPERAKTIVITETIT TE FËMIJËT E SHKOLLAVE 9-VJEÇARE

Loreta Mamani[1], Eduina Guga[2]

[1] Departamenti i Mësimdhënies, Universiteti "Eqrem Çabej"

loretamamani@hotmail.com

[2] Departamenti Kontabilitet financës, Universiteti "Eqrem Çabej"

eduina.guga@hotmail.com

Abstrakt

Çrregullimet neurozhvillimore shfaqen herët në jetën e fëmijës. Ato marrin trajtën e mangësive në një ose disa aspekte të zhvillimit: atij social, konjitiv, gjuhësor apo të sjelljes. Prania e çrregullimeve të të nxënit është befasuese për prindërit dhe edukatorët. Studimet dhe përvoja tregojnë se mosofrimi në kohë i shërbimeve në shkollë sjell dëmtime të paripërueshme në cilësinë e jetës së nxënësve. Mësuesit duhet të kenë njohuritë e duhura për të gjetur format më të drejta të trajtimit dhe rrugët më të mira të ofrimit në kohë të programeve profesionale për këtë kategori nxënësish. Ky punim trajton çrregullimet e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit (ADHD) të fëmijëve të shkollave 9-vjeçare. Shkak i studimit u bë puna ime personale në bashkëpunim me kolegët e mi nga kontakti me një fëmijë që vuan nga ky lloj çrregullimi.Qëllimi kryesor i studimit është të informojë mësuesit e prindërit për të gjitha llojet e çrregullimeve dhe simptomat që karakterizojnë nxënësit si dhe mënyrën e menaxhimit të sjelljeve të këtyre fëmijëve.

Fjalët kyçe: *Çrregullimet e vëmendjes dhe hiperaktivitetit, terapi, menaxhim rasti, simptoma*

Abstract

Neuro-developmental disorders appear early in a child's life. They take the form of deficiencies in one or more aspects of development: social, cognitive, linguistic or behavioral. The presence of learning disabilities is surprising for parents and educators. Studies and experience show that failure to provide school services on time leads to irreparable damage to the quality of life of students. Teachers should have the necessary knowledge to find the best forms of treatment and the best ways of timely delivery of professional programs for this category of students. This paper addresses Attention Deficit Hyperactivity Disorder (ADHD) in primary school children. My personal work with a child suffering from this type of disorder prompted me to do this study.

The main purpose of the study is to inform teachers and parents about all types of disorders and symptoms that characterize students and how to manage the behaviors of these children.

Key words: *Attention Deficit Hyperactivity Disorder, therapy, case management, symptoms.*

1.Hyrje

Në ditët e sotme prindërit dhe edukatorët përballen me sjellje të ndryshme që shfaqin fëmijët e tyre. Edhe pse ndaj tyre ndërhyhet me metoda të ndryshme nga mësuesi e prindi, ndryshimi te sjellja e tyre nuk funksionon. Te disa fëmijë çrregullimet shfaqen që në lindje dhe prindërit e kujdesshëm i dallojnë ato dhe kërkojnë ndihmë. Por në shumicën e rasteve këto çrregullime barten ndër vite duke mos u kuptuar ose mos u pranuar nga prindërit. Ato shfaqen në zhvillimin social, konjitiv, gjuhësor apo të sjelljes. Këta fëmijë karakterizohen nga vështirësia në të nxënë dhe prindërit çuditen e befasohen me rezultatet e tyre, sepse ata kanë qenë në kopsht shumë aktiv. Këto sjellje kategorizohen te çrregullimet e zhvillimit neurologjik ku fëmijët mund të përjetojnë vështirësi me gjuhën dhe të folurit, aftësitë motorike, sjelljen, kujtesën. Mbas diagnostikimit fillon trajtimi i këtyre çrregullimeve me një kombinim të terapive profesionale, farmaceutike dhe programe në shtëpi dhe shkollë. Çrregullimet neurozhvillimore në klasifikimin e ri të DSM-V[1], përfshijnë:



Figura 1. Klasifikimi i çrregullimeve neurozhvillimore

Në periudhën 2006–2008, bazuar në përgjigjet e prindërve në pyetjet e një sondazhi, afërsisht 15% e fëmijëve të moshës 3 deri në 7 vjeç, në Shtetet e Bashkuara, u prekën nga këto çrregullime neurozhvillimore: ADHD-ja, paaftësi në të mësuar, paaftësi intelektuale, paralizë cerebrale, autizëm,

[1] *Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders* (*DSM–5*)

kriza, belbëzim, humbja e dëgjimit mesatare dhe e thellë, verbëri dhe vonesa të tjera të zhvillimit (Barkley, RA, ed, Cali ID, Cohen Rl, Harriston SI, e Coll).U vu re se, ADHD-ja dhe aftësia e kufizuar dominonin më shumë te nxënësit. Shumë fëmijë të prekur nga çrregullime të neurozhvillimit kanë më shumë se një çrregullim, për shembull, rreth 4% e fëmijëve në SHBA i kanë të dy ADHD-ët dhe paaftësinë në të mësuar (Foley, M.2010).Disa studiues kanë deklaruar se mbizotërimi i disa çrregullimeve neurozhvillimore, pikërisht, autizmi dhe ADHD-ja, janë rritur gjatë katër dekadave të fundit (Ghanizadeh & Haghighi, 2010).Një nga faktorët që ndikon në përhapjen e çrregullimeve është gjenetika e njeriut.

Çrregullimet e inhibimit shfaqen si pamundësi e përqendrimit të mjaftueshëm të vëmendjes si dhe prani e shtuar e impulsivitetit dhe hiperaktivitetit. Karakteristikat tipike të fëmijëve me çrregullime të inhibimit përfshijnë mungesën e shprehive të organizimit të vëmendjes, shprehive të organizimit dhe planifikimit në kohë dhe/ose pamundësinë për të qëndruar në detyrë. Në varësi të karakteristikave, çrregullimet e inhibimit klasifikohen (DSM-V) si:



Figura 2. Klasifikimi i çrregullimeve të inhibimit

2. Çrregullimi i mungesës së vëmendjes i kombinuar me hiperaktivitet (ADHD).

Çrregullimi i deficitit të vëmendjes / hiperaktivitetit (ADHD) është çrregullimi më i zakonshëm neurobehavioral (neurosjelljes) i fëmijërisë dhe mund të ndikojë thellësisht në arritjet akademike, mirëqenien dhe ndërveprimet shoqërore të fëmijëve (American Academy of Pediatrics. ADHD). Prindërit, mësuesit dhe komuniteti fillojnë të shqetësohen, sepse ata nuk mësojnë, nuk nxënë si fëmijët e tjerë, sjellin shqetësime në shkollë dhe komunitet. Këta fëmijë janë përherë të stresuar dhe të nervozuar. Hiperaktiviteti, i quajtur ndryshe *keqfunksionim minimal i trurit* i kombinuar me çrregullime të tjera karakterizohet me veprime të tjera si "Vjedhje", "shkatërrim prone", "dhunë ndaj më të dobëtve", "vënie të zjarreve", "vështirësi në përqendrim" , etj. Për ta fillon shqetësohet mësuesi, prindi, komuniteti, policia si dhe shokët e tyre. Ky çrregullim shfaqet më shumë te

meshkujt sesa te femrat, sepse meshkujt janë gjenetikisht më të predispozuar ndaj sëmundjeve të sistemit nervor (Barkley). Ky çrregullim shfaqet te fëmijët në moshën 2-11 vjeç, por kulmin e arrin në moshën 7-8 vjeç.

Çrregullimi i mungesës së vëmendjes i kombinuar me hiperaktivitet (ADHD) është identifikuar qysh herët dhe studiues të ndryshëm kanë hedhur hipoteza të ndryshme. Ai është përshkruar:

- ✓ Për herë të parë qysh në shek.XIX ku disa e quajtën "sëmundje e impulsivitetit".
- ✓ Në vitin 1902 (Still) përshkruan kriteret e diagnostikimit.
- ✓ Në vitin 1940 u zhvillua teoria e "Dëmit minimal cerebral".
- ✓ Më vonë Strauss hodhi hipotezën për shkaqet organike të ÇVH-së.
- ✓ Në vitet ´80 u bë veçimi i çrregullimit të vëmendjes e disfrazisë në bazë të simptomave.

Ky çrregullim te fëmijët kalon në disa faza (Dhamo, M., (2016):

1. Foshnjëria, ku çrregullimi vërehet nga nëna.
2. Fëmijëria e hershme, ku hiperaktiviteti lajmërohet, por nuk diagnostikohet.
3. Fëmijëria e vonë, ku vërehen qartë në shkollë nga veprimet e tyre.
4. Në pubertet ku ndihen dukshëm sjelljet asociale

3. Mësuesi dhe prindi përballë çrregullimit ADHD

Mësuesi e raporton konstatimin te psikologu i shkollës, i cili efillon vlerësimin formal të fëmijës për praninë e çrregullimeve neurozhvillimore vetëm me miratimin e prindit. Raporti i matjeve dhe analizës së bërë ndahet me mësuesit, prindërit dhe specialistin përkatës në drejtorinë arsimore. Me pranimin e tyre, psikologu harton Planin Edukativ Individual (PEI) dhe, nëse është e nevojshme, edhe Planin e Modifikimit të Sjelljes (PMS). Njëkohësisht, NJMF në bashki harton Planin Koordinues të Mbështetjes Sociale (PKMS) si dhe Planin Individual të Mbrojtjes (PIM) për fëmijën dhe familjen. Të gjithë së bashku (mësuesi, prindërit, psikologu, punonjësi social, mësuesi i arsimit special, drejtuesi i shkollës, mjekë dhe terapistë të fëmijës, i ngarkuari i arsimin special në DAR/ZA, psikologu në shkollë a bashki dhe punonjësi i sigurimeve shoqërore) përbëjnë ekipin e trajtimit të fëmijës dhe Grupin Multidisiplinar. Ata mblidhen së bashku në varësi të problematikave.

Këshilla për prindërit që kanë fëmijë me ADHD

1. Hartimi i një plani të përditshëm ku të shkruajë sa herë zgjasin sjelljet e pavëmendshmërisë dhe minutat e tyre me qëllim që të arrijë të zvogëlojë minutat e zgjatjes dhe pak nga pak duke i eliminuar sa më shumë ato.
2. Mos e shpërqendro fëmijën me muzikë të lartë, televizor, lojëra të zhurshme, sepse nuk përqendrohet te detyra kryesore.
3. Sa herë fëmija reagon, ju duhet të mbani shënim formën e reagimit.

4. Kur fëmija sillet mirë duhet ta shpërbleni si me: puthjet, përqafime, duartrokitje, diçka që i pëlqen shumë, si aktiviteti fizik etj.

5. Shpenzoni kohë në natyrë me fëmijën të paktën 30 min në ditë.

4. Studim Rasti

Rasti që do të paraqitet më poshtë është i një nxënësi në një shkollë në qytetin e Gjirokastrës. Nxënësi është i gjinisë mashkull, në klasën e gjashtë. Gjatë trajtimit janë përdorur intervista të strukturuara dhe gjysmë të strukturuara si dhe vëzhgimet. Intervistat janë zhvilluar me të miturin, nënën e tij, rrethin familjar, mësues e drejtues shkolle, psikologë si dhe specialistë të NJMF-së në bashki. Ky është një rast problematik i cili është vlerësuar nga specialisti në Tiranë me ÇPVH dhe, pikërisht, me çrregullim të vëmendjes / hiperaktivitetit ADHD. Te ky rast do të japim një tablo të karakteristikave të simptomave që shfaq ky fëmijë, ecurinë dhe përmirësimin që ka pasur nga terapia intensive.

Historia e rastit

Rasti është një djalë 14 vjeçar, E. XH, i cili frekuenton ciklin 9-vjeçar në një nga shkollat e qytetit të Gjirokastrës. Ai është diagnostikuar me "Çrregullimin e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit" dhe merr trajtim nga një psikolog i specializuar. Vjen nga një familje me prindër të divorcuar. Babai kontribuon vetëm për pjesën financiare dhe jo për edukimin e tij. Përveç shkollës, në edukimin e tij marrin pjesë nëna dhe dy gjyshërit nga ana e nënës. I mituri ka ardhur në jetë nga një lindje normale. Ai ka dhe një vëlla tjetër më të vogël që nuk paraqet asnjë lloj problematike. Në fëmijërinë e hershme mësohet se babai ka ushtruar dhunë fizike ndaj tij. Nga anamneza u konstatua se ka të afërm me probleme të shëndetit mendor në rrethin familjar të nënës dhe babait. Që pa shkuar në shkollë nëna ka vërejtur se ka qenë shumë i lëvizur. Pas divorcit familja shpërngulet te gjyshërit, nga ku fëmija ndërron mjedisin familjar dhe shkollor. Në këtë moment kur ai ka qenë në klasën e katërt fillore kanë filluar dhe problematikat. Shenjat e çrregullimit u vunë re jo vetëm nga nëna, por dhe nga mësuesja kujdestare.

Pasi ka përfunduar disa herë në polici, kjo e referon rastin në NJMF, Bashki. Ngrihet grupi Multidisiplinar me përfaqësues policie, psikologë, mësues, drejtues dhe prindi. Hartohet një plan pune ku u vendos një psikologe të cilën e dëshironte vetë ai dhe fillon puna me trajtimin e tij dhe të nënës për mënyrën e edukimit.

Më vonë me ndihmen e një shoqate u çua në Tiranë ku u ridiagnostikua dhe filloi një terapi me një psikolog tjetër më të specializuar, mashkull. Për arsye mungesash nuk e kalon klasën.

Para terapisë, shenjat që u shfaqën,me tendencë shtimi ishin:

- ✓ Nuk futej në orën e mësimit, por e kalonte kohën në oborr.
- ✓ Marrëdhënie problematike me shokët.
- ✓ Kryente vjedhje të vogla në dyqanin e lagjes.
- ✓ Shumë i lëvizshëm.
- ✓ Aftësi të pakta dëgjuese.
- ✓ Nuk përfundon dot detyrat që i jepen.
- ✓ Obez.

- ✓ I pëlqejnë ushqimet e thata.
- ✓ Vendos zjarre.
- ✓ Fjalor i keq.
- ✓ Kur kërkon të kryejë një detyrë që e ka për qejf, e lë në mes.
- ✓ Kërkon të shoqërohet me persona më të mëdhenj se vetja.
- ✓ Ngacmon e ofendon njerëzit ku ai mendon se dominon mbi ta.
- ✓ Vjedhje në disa nga banesat e lagjes ku banon.
- ✓ Vjedhje të turistëve të qytetit
- ✓ Ka filluar të përdorë cigare, por edhe lëndë narkotike.
- ✓ Nuk të kthen përgjigje kur i flet.
- ✓ Problematik në polici, me një nr. dosjesh, por që deri në 14 vjeç nuk e kap ligji.

➢ **Objektivat e vendosura nga psikologu:**

1. Autonomia:

- Të aftësohet në përqendrimin e vëmendjes gjatë orës së mësimit.
- Të jetë i rregullt dhe i organizuar në sendet personale.

2. Zhvillimi konjitiv:

- Të mësohet të flasë me fjali dhe rrjedhshëm.
- Të mësohet të kryejë veprimet matematikore.
- Të përqendrohet, kur të japë përgjigje.

3. Komunikimi:

- Të flasë bukur, qartë dhe mos ofendojë të tjerët.
- Të jetë më pak impulsiv në dhënien e përgjigjeve të menjëhershme.

4. Marrëdhëniet sociale:

- Të respektojë shokët në klasë dhe lojë.
- Të respektojë prindërit të afërmit dhe më të mëdhenjtë.
- Të ndjekë udhëzimet e më të mëdhenjve.
- Të evitojë sjelljet agresive ndaj të tjerëve.

➢ **Terapitë me të cilat trajtohet i mituri:**

1. Trajtim me anë të medikamenteve.

2. Psikoterapia: U zhvillua nga psikologë. Bisedat për shqetësimet që ka i mituri janë në qendër të vëmendjes, ndjenjat e tij si dhe mendimet e ndryshme janë pjesë e bisedave. Qëllimi është që fëmija të ketë kontroll mbi sjelljen dhe ta përmirësojë atë.

3. Terapia konjitive-sjellore: Kontrollohet sjellja e fëmijës duke përdorur systemin ndëshkim-shpërblim

➢ **Përmirësime që ka pasur fëmija në sajë të trajtimit:**

- **Aspekti konjitiv**: kupton atë që i thuhet, flet me fjali të rregullta, merr pjesë në mësim.
- **Komunikimi**: arrin të komunikojë me qetësi, të kthen përgjigje, fillon të përdorë fjalët magjike.
- **Aspekti social**: ka momente që është i qetë, ka krijuar marrëdhënie me shokë. Është më pak agresiv me shokët dhe të tjerët.

5. Përfundime:

- Simptomat e para në "Çrregullimin e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit" shfaqen te fëmijët në fëmijërinë e hershme.
- Ka një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në shfaqien e këtij çrregullimi: faktorë gjenetikë, komplikacone të nënës gjatë shtatzanisë, probleme familjare, morfologjiko-cerebrale, etj.
- Prindërit nuk e pranojnë faktin që fëmija i tyre vuan nga ky lloj çrregullimi
- Fëmijët me çrregullimin ADHD duhet të trajtohen nga profesionistë.
- Ky lloj çrregullimi është më i shfaqur te djemtë.
- Aplikimi i terapive ndikon pozitivisht në menaxhimin e sjelljeve të fëmijëve.
- Mësuesit e psikologu shkollor luan rol të rëndësishëm në arritjen e sjelljeve pozitive.
- Prindërit luajnë rol mbështetës në trajtimin e fëmijëve.

6. Rekomandime:

- Të zhvillohen trajnime për mësuesit për të njohur më shumë rreth këtij çrregullimi.
- Psikologu i shkollës të trajtojë rastin, por duhet të kryejë seanca edhe me mësues, shokët, familjen e të miturit me ADHD.
- Referimi i rastit të NJMF-së, kur ai paraqet rrezikshmëri për veten dhe të tjerët.
- Mbledhja e GTM-së për menaxhim rasti, ku marrin pjesë gjithë aktorët që kanë lidhje me rastin.
- Përfshirja e prindit në seanca të prindërimit pozitiv.
- Angazhimi i të miturve në aktivitete social-kulturore.
- Vlerësimi i nevojave të familjes dhe ndërhyrja.

Referenca

Barkley, RA, ed, Cali ID, Cohen Rl, Harriston SI, e Coll. "Attention Deficit Hyperactivity Disorder" A handbook for diagnosis and treatment.

Foley, M. (2010), "A comparison of family adversity and family dysfunction in families of children ëith attention deficit hyperactivity disorder (ADHD) and

families of children ëithout ADHD9", Journal for Specialists in Pediatric Nursing, USA.

Ghanizadeh & Haghighi, (2010), "Child and Adolescent Psychiatry and Mental Health".

American Academy of Pediatrics. ADHD: Clinical Practice Guideline for the Diagnosis, Evaluation, and Treatment of Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder in Children and Adolescents. Pediatrrics. 2011; 128:1–16.

Kadri, H & Olumchev, N & Saveska, M & Sushevska, L. (2011), "Analysis of subtypes and other associated conditions of attention deficit and hyperactivity disorder (ADHD) in School; Population from 6 to 12 years of age", Scientific Journal of the Faculty of Medicine in Nië, Macedonia.

Kotoëycz, N & Crampton, S & Steele, M. (2005), "Canadian Journal of Rural Medicine".

Kulla. Florian, "ADHD-ja dhe ndihmesa që duhet të japim për fëmijët.

Nano. Virgjil, "Në mbështetje të proceseve gjithëpërfshirëse".

Dhamo, M (2016), "*Çrregullimet e të nxënit dhe të sjelljes/lista kontrolli mbi diagnostikimin e nxënësve në ciklin fillor"* Save the Children, "*Instrumentet e diagnostikimit të çrregullimeve neuro-zhvillimore të fëmijëve"*, Tiranë, pp. 5-6.

Internet

Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (DSM–5) https//www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK519712/table/ch3.t3

Literatura

Journal of Safety Research. 2007; 38:113–128. [PubMed: 17303170] Barkley RA,

Fischer M, Smallish L, Fletcher K. Young adult follow-up of hyperactive children: Antisocial activities and drug use. Journal of Child Psychology and Psychiatry. 2004; 45:195–211. [PubMed: 14982236]

Biederman J, Monuteaux MC, Mick E, Spencer T, Wilens TE, Silva JM, Faraone SV. Young adult outcome of attention deficit hyperactivity disorder: a controlled 10-year follow-up study. Psychol Med. 2006; 36:167–179. [PubMed: 16420713]

Bird HR, Gould MS, Staghezza B. Aggregating data from multiple informants in child psychiatry epidemiological research. Journal of the American Academy of Child & Adolescent Psychiatry. 1992; 31:78–85. [PubMed: 1537785]

Bufferd SJ, Dougherty LR, Carlson GA, Rose S, Klein DN. Psychiatric disorders in preschoolers: Continuity from ages 3 to 6. American Journal of Psychiatry. 2012; 169:1157–1164. [PubMed: 23128922]

Pelham WE, Gnagy EM, Greenslade KE, Milich R. Teacher ratings of DSM-III-Rsymptoms of the disruptive behavior disorders. Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry. 1992; 31:210–218. [PubMed: 1564021]

Piacentini JC, Cohen P, Cohen J. Combining discrepant diagnostic information from multiple sources: Are complex algorithms better than simple ones? Journal of Abnormal Child Psychology. 1992; 20:51–62. [PubMed: 1548394]

Riddle MA, Yershova K, Lazzaretto D, Paykina N, Yenokyan G, Greenhill L, Posner

K. The Preschool Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder Treatment Study (PATS) 6-year follow-up. Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry. 2013; 52:264–278. [PubMed: 23452683]

Sellke T, Bayarri MJ, Berger JO. Calibration of p values for testing precise null hypotheses. American Statistician. 2001; 55:62–71.

Shaffer, D.; Fisher, P.; Piacentini, J.; Schwab-Stone, M.; Wicks, J. Diagnostic Interview Schedule for Children. New York: Columbia University; 1993.

Sibley MH, Pelham WE Jr, Molina BSG, Gnagy EM, Waschbusch DA, Garefino AC,

Karch KM. Diagnosing ADHD in adolescence. Journal of Consulting and Clinical Psychology. 2012; 80:139– 150. [PubMed: 22148878]

Sibley MH, Pelham WE, Molina BSG, Coxe S, Kipp H, Gnagy EM, Lahey BB. The role of early childhood ADHD and subsequent CD in the initiation and escalation of adolescent cigarette, alcohol, and marijuana use. Journal of Abnormal Psychology. 2014; 123:362–374. [PubMed: 24886010]

Thompson AL, Molina BSG, Pelham W, Gnagy EM. Risky driving in adolescents and young adults with childhood ADHD. Journal of Pediatric Psychology. 2007; 32:745–759. [PubMed: 17442694]

ZHVILLIMET SOCIAL-EKONOMIKE NË PREFEKTURËN E DIBRËS PËRGJATË KRIZËS EKONOMIKE NË VEND (1929-1935)

Marjeta Novaku
Zyra Arsimore Dibër
mnovaku@gmail.com

Abstrakt

Kriza ekonomike botërore e viteve 1929-1933 e gjeti Shqipërinë, pothuajse, të falimentuar ekonomikisht dhe financiarisht duke qenë edhe një vend bujqësor i pazhvilluar. Prefektura e Dibrës, si një vend gjeografikisht malor, me një ekonomi të varfër të trashëguar me kohë në përgjithësi, e ndjeu thellë krizën ekonomike, pavarësisht disa masave të ndërmarra nga qeveria. Në këtë periudhë, buxheti financiar për Dibrën nuk arriti të plotësonte kërkesat e popullsisë. Kjo çoi që rrogat e nëpunësve mos paguheshin për muaj të tërë etj.. Në kuadrin e zbatimit të Reformës Agrare nga Ahmet Zogu, në maj të vitit 1930, të dhënat statistikore për këtë prefekturë mungojnë, por vërehet qartë që paria vendase preferoi të lidhej pas sistemit të pronës çifligare, pra, nuk e mirëpriti atë. Në këtë artikull janë pasqyruar, gjithashtu, në mënyrë të detajuar treguesit ekonomikë të zonës, duke analizuar pasqyrat buxhetore të disa komunave, ku me gjithë rënien ekonomike, pati një mbledhje të rregullt të taksave, që rëndoi më tej fshatarët. Në kushtet e varfërisë së madhe, në artikull jepen të dhëna për ndihmat ushqimore nga ana e qeverisë, por që nuk ishin të mjaftueshme.

Në aspektin social, edhe pse një jetë e varfër kulturore, në artikull janë evidentuar zhvillimet arsimore të prefekturës , si dhe veprimtaria e degëve të shoqërisë në rang kombëtar "Gruaja Shqiptare", në vitin 1929 në Burrel dhe në Peshkopi. Gjithashtu, dalja e Kodit Civil, më vitin 1929, favorizoi gratë në fushën e divorcit, megjithëse hasi vështirësi, ndikoi pozitivisht dhe në këtë qark.

Fjalët kyçe: *Dibër, ekonomia, reformat, social, A.Zogu.*

Abstract

The world economic crisis of 1929-1933 found Albania almost economically and financially bankrupt, being an underdeveloped agricultural country. Dibra prefecture, a region with a mountainous terrain, and with a poor economy inherited over time, in general, felt the economic crisis deeply, despite some measures taken by the government. In this period, the budget for Dibra failed to meet the demands of the population. This led to the employees' salaries not being paid for months, etc.. In the context of the implementation of the Agrarian Reform by Ahmet Zogu, in May 1930,

statistical data for this prefecture are missing, but it is clearly observed that the local chieftains preferred to hold on to the manorial system, therefore, did not welcome it. In this article, the economic indicators of the area are also reflected in detail, analyzing the budget statements of some municipalities, where despite the economic decline, there was a regular collection of taxes, which further burdened the villagers. In conditions of great poverty, the article provides data on food aid from the government, but that was not enough.

As regards the social aspect, although a poor cultural life, the article highlights the educational developments of the prefecture, as well as the activity of the branches of the association at the national level "Albanian Woman", in 1929 in Burrel and Peshkopi. Also, the release of the Civil Code, in 1929, favored women in the field of divorce, although it encountered difficulties, it had a positive effect in this region as well.

Key words: *Dibra, economy, reforms, social, A. Zogu.*

Kriza ekonomike botërore e viteve 1929-1933 preku rëndë edhe Shqipërinë, e cila duke qenë një vend bujqësor i pazhvilluar, varej nga tregu i jashtëm. Edhe këtu si në vendet e tjera ajo u shfaq me pakësimin e prodhimit industrial, me rrënimin e prodhuesve të vegjël, fshatarë e zejtarë, dhe me shtimin e papunësisë, me rënien e çmimeve, me uljen e madhe të tregtisë së jashtme dhe sidomos me rënien e theksuar të bujqësisë. Kriza përfshiu dhe sistemin monetar e të kreditit.

Shenjat e para të krizës u ndien në Shqipëri që nga fundi i vitit 1929. Vetë A.Zogu në mesazhin mbretëror para parlamentit, në tetor 1930, deklaroi se vendin e kërcënonte një krizë e madhe ekonomike-financiare, e shkaktuar sipas tij, pjesërisht për arsye "klimaterike" dhe pjesërisht nga pasojat e krizës botërore.[1]

Por përpjesëtimet e mëdha që mori kriza ekonomike në Shqipëri dhe sidomos vazhdimi i saj për një kohë më të gjatë se vendet e tjera (deri më vitin 1935), pati edhe shkaqe të brendshme, të cilat duheshin kërkuar në pleksjen e ekonomisë kapitaliste të tregut me mbeturinat e theksuara feudale. Për shkak të prapambetjes dhe rendimenteve të ulëta të prodhimeve të saj, bujqësia shqiptare, që përpara krizës, ishte në një gjendje të keqe dhe e paaftë të përballonte konkurrencën e bujqësisë kapitaliste evropiane.

Shqipëria i ndjeu më shumë efektet e krizës ekonomike dhe për arsye të tjera. Kështu strukturat e reja ekonomike po depërtonin me vështirësi në vend. Italia, Gjermania, Anglia, Austria, Jugosllavia eksportonin miliona franga ar mallra industriale në Shqipëri, kurse prodhimet bujqësore të saj, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të qeverisë shqiptare nuk gjenin asnjë lehtësi shitjeje. Nga ana tjetër, rritja e vogël e prodhimit në vend, kur huaja

[1] *Historia e Popullit Shqiptar,* vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, Toena, 2007, fq. 293.

financiare e SVEA-s, prej 50 milionë frangash ari u përdor për ndërtime rrugësh, urash publike etj. e jo për vepra prodhuese, e rëndoi më tepër gjendjen ekonomike.[2]

Ndonëse u bënë hapa përpara, sidomos, në fushën e legjislacionit ku, ndër të tjerash, spikaste dhe Kodi Tregtar i vitit 1932, i bazuar në përvojën evropiane, me rëndësi të madhe në rregullimin e marrëdhënieve e të konflikteve tregtare, duke i dhënë dorë zhvillimit kapitalist të vendit, duhej ende kohë, mjete financiare si dhe kuadro të afta për të pasur sukses. Shqipëria ballafaqohej ndërkohë me një labirint vështirësish.

Burimet e të ardhurave qeveritare kishin ndryshuar shumë pak dhe akoma ekzistonte sistemi arkaik i taksave dhe i tarifave doganore. Më tepër se 28% e të ardhurave shtetërore sigurohej vetëm prej segmentit fshatar të shoqërisë shqiptare. Këto taksa ishin konceptuar sipas sistemit fiskal turk dhe konsistonin, kryesisht, në taksën mbi kafshët bujqësore dhe të sistemit të së dhjetës, i cili kërkonte prej fshatarëve të magazinonin prodhimin e tyre dhe të prisnin deri sa të vinin tagrambledhësit e qeverisë për të marrë pjesën e tyre.[3] Vetë sistemi tatimor ishte në krizë të rëndë e në rënie, si një sistem i tejkaluar, që nuk i përshtatej kushteve të ekonomisë së tregut.

Mbi ekonominë e vendit vijonte të rëndonte politika buxhetore e qeverisë, shpenzimet joproduktive për ushtrinë e xhandarmërinë dhe për aparatin burokratik. Nga buxheti financiar, 45-50%, shkonte për mbajtjen e ushtrisë dhe të xhandarmërisë. Shpenzimet kryesore të vitit 1929-1930 ishin shpërndarë si vijon: Ushtria 45,5%, Ministria e Brendshme 7,3%, Ministria e Financave 7,3%, Ministria e Ekonomisë Kombëtare 5,7%, Ministria e Drejtësisë 3,9%, Drejtoria e Postave dhe Telegrafit 3,7% dhe Ministria e Punëve Botërore 3,5%.[4]

Në këtë kontekst, edhe në prefekturën e Dibrës, buxheti financiar nuk mund t'i plotësonte tërësisht shërbimet e popullsisë, edhe pse ishte parashikuar një lloj barazimi i të ardhurave me shpenzimet. Por një gjë e tillë nuk mund të ishte reale me situatën, pasi kërkesat e popullsisë ishin më të mëdha, por dhe të domosdoshme në kushtet që jetonin. Madje, qeveria për të përballuar deficitin buxhetor mori masa të rrepta për vjeljen e taksave, duke kërkuar dhe të prapambeturat. Kështu, buxheti i komunës Maqellarë për vitin 1930, i miratuar nga këshilli administrativ i prefekturës Dibër, më 15 shkurt 1930 parashikonte 7360 franga ari të ardhura, që vinin nga gjobat, nga taksa e bagëtive, taksave ndaj dyqaneve e ndërtesave të tjera tregtare, taksat e peshimit e të matjeve etj. Shpenzimet ndërkohë ishin 7360 fr.ari, ku përfshiheshin rrogë personeli për kryetarin e sekretarin e komunës e nëpunës të tjerë, për qira, për pastrim, për ndriçim, për ndërtime e meremetime shkollash, të veprave publike, shpenzime për borxhet dhe për paditë që i

---

[2]Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e Mbretit Zog I*, (Tiranë: 1995), fq. 227-228.
[3]Bernd .J.Ficsher, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, Çabej, 2004, fq.178.
[4]*Po aty*, fq.179.

bëheshin komunës etj.. Ndërsa në komunën "Zerqan", të nënprefekturës "Zerqan", buxheti i vitit 1930, i miratuar më 15 mars 1930 nga këshilli administrativ i nënprefekturës, ishte 8770 franga ari, kur të ardhurat dhe shpenzimet ishin po aq sa buxheti (8770 franga ari).[5] Përveç taksave shtetërore te të ardhurat e buxhetit përfshiheshin edhe mbledhja e të prapambeturave, ku në rrethin e Zerqanit ato mblidheshin rregullisht duke e detyruar popullsinë të shiste edhe produktet për ushqimin familjar.[6]

Mirëpo kjo pasqyrë buxhetore e këtyre komunave, duke u mbështetur dhe në çështjet e lartpërmendura, kur rrogat e nëpunësve me muaj nuk paguheshin, tregon që hyrjet (të ardhurat) dhe shpenzimet mund të ishin relative. Abuzimet që bëheshin nga nëpunësit flisnin për një anë tjetër të kësaj pasqyre, ku jo të gjitha të ardhurat ishin në shërbim të popullsisë. Të ardhurat e buxhetit që ishin kryesisht nga tatimet e taksat e popullsisë, nuk i mbulonin nevojat e shpenzimeve në rritje të aparatit burokratik. Një situatë e tillë financiare pasqyrohet në njoftimin e datës 12 nëntor 1930 të prefekturës së Dibrës, dërguar MP-së së Brendshme, sipas së cilës, për shkak se të ardhurat mujore në nënprefekturën e Matit ishin 10 000 franga ari në muaj dhe shpenzimet ishin 25 000 franga ari, nuk mund të paguheshin rrogat e nëpunësve të njësive të ndryshme të administratës. Prefektura në fjalë i kërkonte kësaj ministrie që nga thesari i shtetit t'i dërgoheshin 10 000 franga ari në muaj, me qëllim që të bëheshin në mënyrë të rregullt pagesat, të paktën të xhandarmërisë.[7] MP-ja e Brendshme kishte urdhëruar Ministrinë e Financave që kërkesa të merrej në konsideratë.[8]

Por plaga më e rëndë e vendit në këtë periudhë ishte gjendja e keqe e bujqësisë, e cila sa vinte e përkeqësohej për shkak të marrëdhënieve ekzistuese. Prodhimi bujqësor ishte gjithnjë i ulët dhe Shqipëria vijonte të importonte sasi të mëdha drithi, kjo, edhe si rrjedhojë e kushteve klimaterike, kryesisht thatësirës së gjatë.

Kishte ardhur koha e ndërmarrjes së një reforme agrare. Me nxjerrjen e Kodit Civil në vitin 1929, që përcaktoi parimet kapitaliste të pronësisë, u bë e mundur hartimi i projektligjit mbi reformën bujqësore, ku për këtë qëllim në prill 1929 u ngarkua një komision i drejtuar nga ministri i Drejtësisë, Hiqmet Delvina, me pjesëmarrjen e profesor Giovani Lorenzoni. Parlamenti e miratoi ligjin më 13 prill 1930 dhe u shpall më 3 maj 1930.[9] Ai parashikonte marrjen e tepricave të tokave të çifligarëve (që kishin më tepër se 100 ha) dhe shitjen e tokës fshatarëve të patokë, ose atyre me pak tokë (deri në pesë ha për familje). Ligji që kishte 100 nene parashikonte një mori

---

[5]*Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH),* Fondi (më tej F.228), Viti (më tej: V.1930), Dosja (më tej: D.)100, fq. 1, 7.
[6]*AQSH*, fq.152/13, V.1930, D.73/a, fq.342.
[7]*AQSH*, fq.152/13, V.1930, D.752, fl.14.
[8]*Po aty*, fq.15.
[9]Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Tiranë: 55, 2006, fq.311-312.

përjashtimesh nga rregullat e përgjithshme të konfiskimit. Nuk mund të merreshin as vreshtat, as ullishtet, as kopshtet, as kullotat e as pyjet.[10]

Sipas profesor Kristo Frashërit, në qarkun e Dibrës, në kuadrin e zbatimit të reformës agrare, një pjesë e pakët e tokave të pronarëve me mbi 100 ha, ra në duart e fshatarëve të vegjël, të cilët u kthyen në fshatarë të mesëm ose të bujqve çifçinj, të cilët me sakrifica u kthyen në fshatarë të vegjël. Edhe pse nuk ka të dhëna statistikore për këtë qark, duke u mbështetur në rezultatet që pati ky proces në shkallë kombëtare, mund të thuhet se në fund të regjimit monarkist edhe në këtë trevë numri i fshatarëve pronarë të vegjël, që u zhveshën tërësisht ose pjesërisht nga tokat e tyre, ishte më i madh se ai i bujqve (fshatarëve pa tokë), të cilët u pajisën tërësisht apo pjesërisht me tokën e nevojshme. Lakmia për të blerë tokë pushtoi parinë dibrane, e cila e shtyrë nga karakteri i saj konservator, preferoi të lidhej pas sistemit çifligar dhe jo pas qeverisjes kapitaliste moderne. Pothuajse, të gjithë elementët e parisë ose e shtuan sipërfaqen e mëparshme të çifligjeve, ose u bënë pronarë të rinj çifligarë. Megjithatë, prona çifligare që ata krijuan qe e kufizuar. Ndër këta ishin C. Elezi, F. Dine, D. Dema me vëllezërit e tij, M.Kaloshi, D. Hoxha, A.Maliqi, S.Kaloshi, S.Shehu, S.Jegeni.[11] Shteti e ndihmoi parinë jo vetëm të rriste pronën tokësore, por edhe të pasurohej nëpërmjet veprimtarive të tjera, siç ishte mbledhja e të dhjetave shtetërore, spekulimi në tregtinë e drithit etj. Kështu, dhe me anën e blerjes së tokave shtetërore me çmime të lira, u pasuruan favoritët e mbretit. Reforma agrare ngeli vetëm në letër. Fshatarët shqiptarë gjatë krizës ekonomike në vend dhe atë botërore, vuajtën shumë, pasi çmimet e produkteve bujqësore e blegtorale që eksportonte Shqipëria, ranë.[12]

Sigurisht, që pre e kësaj situate ishte edhe prefektura e Dibrës, madje, dhe më e rënduar, duke pasur parasysh dhe terrenin gjeografik, por dhe ekzistenca e një ekonomie të varfër e trashëguar me kohë. Edhe raporti i muajve prill-maj-qershor 1932 i Komandës së Qarkut të Xhandarmërisë në Peshkopi e paraqiste ekonominë në prefekturën e Dibrës në vështirësi, për shkak të mungesës së komunikacionit, të gjakmarrjes, kur dhe tregtia e mishit, e leshit dhe e bulmetit ishte e kufizuar.[13] Në këtë prefekturë produktet bujqësore dhe blegtorale që kultivoheshin dhe sasia e tyre në vitin 1932, ishin: në grurë (338 000 kg), elb (80 000 kg), tërshërë (22 000 kg) thekër (75 000 kg), misër (6.400.000 kg ose 6400 t)), fasule (105 000 kg), qepë (65 000 kg), patate (20 000 kg), gështenja (28 000 kg), rrush (95 000 kg), duhan

---

[10] G.Ll.Arsh, I.G.Senkeviç, N.D Smirnova, *Histori e shkurtër e Shqipërisë,* (Prishtinë: Rilindja, 1967), fq. 227.

[11]Kristo Frashëri, *Historia e Dibrës (Që nga lashtësia deri në mars 1939),* Tiranë, M&B, 2012, fq. 408-410.

[12] Senkievic G.I.&Smirnova D.N. - *Histori e shkurtër e Shqipërisë,* Prishtinë, Rilindja, 1967, fq.228.

[13]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.46, fl.24.

(11 000 kg), bulmet, gjalpë edhe djathë (93 200 kg), lesh (67 000 kg), lëkurë (16 500 copë).[14]

Shqipëria nuk ishte në gjendje të siguronte nevojat e veta nga prodhimet bujqësore dhe, si rrjedhojë, ajo ishte e detyruar t'i importonte ato, ku misri dhe gruri që më parë prodhoheshin më shumë në vend, tani në vitet e krizës, por dhe më vonë, do të ishin në listën e vazhdueshme të mallrave që importoheshin në Shqipëri.

Mjerimin që kishte pllakosur zonat malore të Veriut, e vërtetonin dhe autoritetet qeveritare në krahina, në relacionet që i dërgonin MP-së së Brendshme. "Numri i njerëzve që vuajnë nga uria në qarkun e prefekturës së Dibrës dita-ditës shtohet e, sidomos, në malësinë si Reç, Dardhë e gjetkë ku gjendja pasqyrohet e tmerrshme". Edhe në rrethin e Matit të kësaj prefekture, nënvizohej në njoftimin e prefektit të Dibrës, Z.Prodanit, më 15 mars 1932 "duhen të merren masa të menjëhershme për sigurimin e ushqimit të pjesës së varfër, e cila përbën 70% të popullsisë".[15] Në këtë prefekturë ishin 26 000 veta që kishin nevojë të domosdoshme për mallra ushqimi dhe nga kjo sasi, 17 000 veta ishin nga nënprefektura e Matit.[16]

Si rezultat i kësaj gjendjeje, Ministria e Ekonomisë Kombëtare, në mars 1932, e autorizoi prefekturën e Dibrës për blerjen e 1000 kv misër, krahas sasisë prej 500 kv, që kishte qenë autorizuar më parë .[17]

Gjithashtu, prefektura e Dibrës kishte vënë në dijeni, në mars 1932, MP të Brendshme, se për shkak të dimrit të ashpër, popullsia e rretheve Peshkopi e Zerqan në prefekturën e Dibrës ishte detyruar të hiqte bukën e gojës, për t'ua dhënë bagëtive që të mos ngordhnin nga uria. Si rrjedhojë, krahas të varfërve që ishin shënuar në listën e përpiluar në bazë të rregullores përkatëse, ishte dhe një numër i konsiderueshëm i banorëve, që kishte nevojë për ndihmë. Me 10 kg misër për frymë në muaj që caktonte rregullorja për ndihmë sociale, për çdo person, problemi nuk zgjidhej, prandaj sipas kësaj prefekture ishte e domosdoshme që përveç 1000 kv misër që do t'i sillte nga Jugosllavia një sipërmarrës brenda një muaji, të bliheshin edhe 600 kv misër të tjerë.[18] MP të Brendshme urdhëroi Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare që të autorizonte prefekturën e Dibrës, që të blinte dhe 600 kv misër të tjerë nga dhjetarët, përveç sasisë që ishte autorizuar më parë.[19]

Mirëpo MP të Brendshme në maj 1932, autorizoi prefekturën e lartpërmendur, që sasia prej 500 kv misër dërguar për rrethin e Matit dhe sasitë e tjera që do të dërgoheshin t'u shpërndaheshin të varfërve, përkundrejt punës së përditshme që ata duhej të bënin (d.m.th. të bëhej punë botore çdo ditë, atëherë dhe misri të shpërndahej çdo ditë), sepse sipas asaj

---

[14]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.374/2, fl. 85.
[15]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.45, fl. 49.
[16]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.374/2, fl. 3.
[17]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.374/2, fl.12, 22.
[18]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.45, fl. 49-50.
[19]*Po aty*, 60.

deri më tani i ishte dhënë popullsisë mësim i dembelizmit në sigurimin e ushqimit.[20] Megjithatë, rregullorja për shpërndarjen e misrit kundrejt punës, ishte për të gjithë prefekturat e nënprefekturat e Shqipërisë.[21]

Kriza ekonomike, që përfshiu edhe Shqipërinë, e thelloi papunësinë, rrënimin ekonomik të fshatarëve e të zejtarëve, zinë e bukës, e cila mori përpjesëtime të mëdha më 1935, dhe keqësoi më tej gjendjen e nëpunësve e të intelektualëve. Si rrjedhojë, në Tiranë u organizuan manifestime nga 500 punëtorë që punonin në ndërtimin e rrugëve të vendit dhe të ardhur nga anë të ndryshme të Shqipërisë kundër papunësisë dhe vështirësive të jetesës. Krahas lëvizjes kundër papunësisë u zhvillua dhe ajo kundër zisë së bukës. Popullsia e krahinës së Hasit, të Skraparit, të Kurveleshit e të krahinave të tjera që në vitin 1931 protestuan kundër zisë së bukës dhe e kërkonin atë nga organet qeveritare. Gjithashtu, pati përplasje të ashpra midis fshatarësisë dhe çifligarëve që ua kishin marrë tokat fshatarëve. Konflikti më i madh që pati jehonë kombëtare ishte ai i fshatarëve të Gorricës (Korçë) me pronarin Maliq Frashëri. Lëvizja fshatare drejtohej kryesisht kundër politikës tatimore të qeverisë.[22] Krahas lëvizjes fshatare u zhvillua dhe ajo punëtore. Kështu, punëtorët e pushuar nga puna në kantierin për ndërtimin e rrugës Krujë-Burrelmanifestuan më 26 gusht 1930 gjithë ditën nëpër rrugët e Krujës dhe kërkuan mëditjet e papaguara.[23]

Edhe prefektura e Dibrës ishte e përfshirë nga kjo gjendje e vështirë ekonomike, ndoshta dhe më rëndë se pjesët e tjera të vendit. Por, konkretisht, të dhëna për lëvizje të tilla në këtë krahinë nuk ka. Sipas mendimit tonë, popullsia e atjeshme ishte e revoltuar shpirtërisht nga një situatë e tillë ekonomike, ku varfëria ishte e tejskajshme dhe masat qeveritare ishin jo në shkallën e duhur, në raport me gjendjen aktuale. Influenca e parisë mbi popullsinë dhe kredibiliteti i saj tek organet shtetërore e mbante atë nën mbikëqyrje për çdo lëvizje, siç është parashtruar dhe në çështjet e mësipërme. Popullsia e këtyre krahinave jetonte nën hijen e parisë vendase, në një marrëdhënie të veçantë specifike, popullsi- pari-institucione shtetërore, që e karakterizonte këtë krahinë. Nga ana tjetër, ishin faktorët e brendshëm të kësaj krahine, si problemi i gjakmarrjes, gjë që shfrytëzohej nga njerëzit në momente të përshtatshme. Një shembull të tillë parashtronte prefektura e Dibrës përpara MP-së së Brendshme në korrik 1930. Sipas saj, banorët e fshatrave Reç dhe Dardhë nuk kishin kryer punime në rrugë që prej 9 vjetësh dhe, nga varfëria e madhe, edhe në këtë kohë nuk ishin në gjendje të punonin. Mirëpo, zyra e Punëve Botërore insistonte në nxjerrjen e tyre në ndërtimin e rrugëve. Po sipas kësaj prefekture, thuhej se "krahas varfërisë së kësaj popullsie të këtyre fshatrave, nxjerrja e tyre për të punuar në ndërtim rruge mund të provokojë dhe të papritura për arsye se kanë armiqësi të vjetra në tërë popullsinë e qarkut Dibër". Prandaj, ky dikaster i lutej ministrisë së

[20]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.374/2, fl.56.
[21]*AQSH*, F.152/15, V.1932, D.374, fl.95.
[22]*Historia e Popullit Shqiptar…,* vëll.III, 316.
[23]*Po aty*, fq. 317.

lartpërmendur, që të ndërhynte aty ku mundej, për përjashtimin e popullsisë nga detyrimi i rrugës, duke i lënë vetëm në ndërtimin e urës Reç, që ishte mbi lumin Drin, pasi ishte i nevojshëm për komunikacionin e atyre vendeve.[24]

Meqenëse prefektura e Dibrës ishte zonë kufitare, ajo duhej të përballej dhe me probleme të tjera ekonomike. Për shkak të afërsisë së kufirit dhe ndonjëherë dhe të pakujdesisë së barinjve, shumë bagëti të banorëve të fshatrave të kësaj zone kalonin në tokën jugosllave. Procedura që ishte ndjekur zakonisht për kthimin e tyre, ishte e gjatë, më e pakta zgjaste 1-3 muaj. Prandaj për të mënjanuar procedurat dhe për arsye që shtetasit shqiptarë e jugosllavë të mos pësonin më dëme në raste të tilla, ministri fuqiplotë Rauf Fico (legata e Mbretërisë së Shqipërisë në Beograd), pas bisedimeve me funksionarin kompetent të MP-së së Jashtme të Jugosllavisë, hartuan një projektmarrëveshje shqiptaro-jugosllave. Ajo caktonte një procedurë më të shpejtë për dorëzimin e bagëtive që kalonin nga toka shqiptare në atë jugosllave dhe anasjelltas dhe që duhej të zbatohej nga ana e autoriteteve kufitare të shteteve respektive. Por, njëkohësisht, duhej të aprovohej nga qeveria shqiptare, gjë që theksohej në njoftimin e legatës së Mbretërisë së Shqipërisë në Beograd, dërguar në fillim të muajit maj 1933, ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Xh.Vila.[25]

Konkretisht, kjo projektmarrëveshje, e cila në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.394, datë 26 maj 1933, në dakordësi me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, që hyri në veprim që nga kjo datë, përmbante: "1) Në rast se bagëtia kalonte gabimisht nga toka e një shteti në tokën e tjetrit, autoritetet kufitare të këtij të fundit ishin të detyruar të njoftonin, brenda një kohe të shkurtër, autoritetet kufitare të shtetit tjetër dhe të dorëzonin bagëtinë në postën më të afërt të vendit ku kalonte kufirin bagëtia; 2) Me rastin e dorëzimit të bagëtisë do të bëhej një procesverbal, në të cilin do të shkruhej: a) emri dhe posti (detyra) i autoritetit kompetent që dorëzon bagëtinë; b) emri dhe posti i autoritetit kompetent që merr në dorëzim bagëtinë; c) sasia dhe lloji i bagëtisë; d) nënshkrimet e autoriteteve kompetente të të dy shteteve që përmbushin këto formalitete (dorëzuesi dhe marrësi); e) dëmet e shkaktuara eventualisht nga bagëtia kur kalon kufirin gjithashtu të përmenden në procesverbal dhe janë në ngarkim të pronarit të bagëtisë. Dëmet duhen të rregullohen ndërmjet autoriteteve që bëjnë këto formalitete përpara se të dorëzohet bagëtia".[26] Një projektmarrëveshje e tillë sigurisht që ishte në favor të dy shteteve, pasi ishte një mjet sigurie në zonën kufitare për mosshkaktimin e konflikteve, të cilat në disa raste ndikonin dhe në marrëdhëniet e të dy mbretërive.

Në kushtet e zhvillimit të krizës ekonomike botërore dhe asaj të brendshme, qeveria e Pandeli Vangjelit caktoi kohën e zhvillimit të zgjedhjeve

---

[24]*AQSH*, F.228, V.1930, D.102, fl.1.
[25]*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, V.1933, D.42, fl.133-135.
[26]*AMPJ*, V.1933, D.42, fl.136.

parlamentare më 16-31 gusht 1932 (për zgjedhësit e parë) si dhe më 11 nëntor 1932, për zgjedhësit e dytë. Në zgjedhjet e vitit 1932 nga prefektura e Dibrës dolën këta deputetë: Abdurrahman Dibra, Abdurrahman Sali Mati, Fiqri Rusi, Hafëz Xhemali, Nush Bushati, Jashar Erebara.[27] Në prani të familjes mbretërore dhe trupit diplomatik, parlamenti shqiptar i hapi punimet e tij më 21 nëntor 1932. Në fillim mbreti mbajti fjalën e hapjes dhe, duke folur për gjendjen e përgjithshme, vlerësoi normalitetin e administratës shtetërore, reformat komunale, zhvillimin e drejtësisë, të shëndetësisë, arsimit kombëtar, por për të problemi më i madh në vend ishte ai i zhvillimit ekonomik, pasi vendi ishte prekur nga kriza ekonomike botërore.[28]

Në fjalën e tij të inaugurimit gjatë mbledhjes së parë të parlamentit në periudhën e monarkisë, A.Zogu me qëllim që të lehtësonte procesin e qytetërimit të vendit, premtoi se do të merrte një reformë të gjerë sociale, duke argumentuar, se në të kaluarën forcat e shumta të pushtimit i kishin imponuar shqiptarëve zakone të papërshtatshme. Mbreti shprehte vendosmërinë për t'i çrrënjosur të gjitha ato zakone që ai i vlerësonte moralisht dhe materialisht të dëmshme për Shqipërinë.[29]

Vitet e para të monarkisë dëshmuan futjen në gjirin e shoqërisë shqiptare të një sërë reformash tepër të nevojshme. Dalja e Kodit Civil, më 1929, i cili rregullonte marrëdhëniet pronësore, martesore, të së drejtës familjare, të trashëgimisë e të tjera dhe që ishte huazuar nga kodi francez Napoleonian, ishte një nga reformat legjislative më me rëndësi që ndikonte drejtpërsëdrejti në çështjet ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në fakt, vështirësitë e përshtatjes së mentalitetit shqiptar me këtë kod perëndimor ishin të dukshme pasi në zonat veriore institucioni i martesës e disa institucione të tjera të së drejtës familjare, vijonin ende të rregulloheshin pjesërisht.

Në dispozitat për të drejtën familjare, gruaja shqiptare u njësua me burrin në të drejtën për të dhënë pëlqimin për martesë, në atë të divorcit, të trashëgimisë, duke u vënë ligjërisht në pozita të barabarta me të. Në fakt, ai nuk u zbatua menjëherë, sepse tradita e vjetër u bëri qëndresë normave të reja ligjore. Pjesa më e madhe e grave nuk kishte arsim dhe si të tilla nuk mund t'i njihnin e t'i kuptonin ato. Njohja dhe zbatimi i Kodit të ri Civil ishte tepër e vështirë në kushtet, kur në vetë ndërgjegjen e gruas shqiptare, kishin zënë vend zakone e mendësi të vjetra, të cilat ishin më të forta se ligjet.[30] Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Kodit Civil, më 1 prill 1929 dhe me masat e marra nga autoritetet administrative lokale të prefekturës së Dibrës, në malësitë e saj ishin në zbehje e sipër disa zakone të vjetra, të trashëguara prej kohësh, siç ishin martesat me anën e shitblerjes së vajzës, që e vinin në

---

[27] "Përfundimet definitive të zgjedhjeve parlamentare", nr.400, *Besa*, Tiranë, 12 nëntor 1932, 1.

[28] "Hapja madhështore e legjislaturës së dytë në praninë e N.M. T. Mbretit", nr.407, *Besa*, Tiranë, 21 nëntor 1932, 1, 4.

[29] B.J.Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri…,* 182.

[30] Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri 1912-1939*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 2002), 295.

vartësi të plotë të burrit dhe e bënin atë thjesht një zbatuese të urdhrave të tij.[31]

Në intervistën që A.Zogu i kishte dhënë gazetës "Daily Telegraph", në tetor 1928, ai vinte në dukje se: "Ne jemi shekuj të tërë mbrapa pjesës tjetër të Europës së qytetëruar. Njerëzit nuk janë në gjendje as të shkruajnë as të lexojnë, ata u binden pak ligjeve të shkruara, gjakmarrja vazhdon të jetë e përhapur në shumë krahina të vendit. Unë jam i vendosur ta civilizoj popullin tim dhe ta fus atë sa më shumë në rrugën e mësimit të zakoneve dhe mënyrës së jetesës perëndimore".[32]

Ahmet Zogu po përpiqej që të krijonte një shtet modern e të qytetëruar. Një hap tjetër i rëndësishëm në fushën sociale ishte dhe krijimi në Tiranë i shoqërisë "Gruaja shqiptare" në dhjetor të vitit 1928 nën kujdesin e Nënës Mbretëreshë. Në qarkoren drejtuar gjithë prefekturave u shtrohej detyrë që të formonin në çdo qark degë të kësaj shoqërie, që do të funksiononin në bazë të statutit të saj, i cili iu shpërnda të gjitha prefekturave e nënprefekturave. Në paragrafin e dytë të tij përcaktohej qëllimi i shoqërisë, e cila do të merrej me vepra edukative, higjienike e aktivitete të tjera bamirësie, që do të lartësonin femrën shqiptare. Gjithashtu, shoqëria do të mbronte e përkrahte industrinë dhe artet e vendit dhe në të rol do të luante gruaja shqiptare. Në kohë lufte ose raste mjerimi, shoqëria do të bashkëpunonte me Kryqin e Kuq.[33] Këshilli drejtues i shoqërisë që ishte organi më i lartë i saj dhe që drejtonte të gjithë aktivitetin e shoqërisë brenda dhe jashtë vendit ishte i përbërë prej 7 anëtarësh. Kryetare ishte Sanije Zogu (motra e A.Zogut), nënkryetare Emine Toptani dhe sekretare Parashqevi Qiriazi.[34]

Me mbështetjen e organeve të pushtetit lokal, nëpër qarqe filluan të ngrihen njëra pas tjetrës degët e shoqërisë "Gruaja shqiptare", ku krahas qyteteve të Shqipërisë së Mesme e të Jugut, u formuan degë të saj edhe në qytetet veriore dhe verilindore të vendit. Në qershor të vitit 1929 u formua dega e Burrelit të prefekturës së Dibrës, me kryetare Nazlije Abaz Balin dhe arkëtare Ballkine Metrën.[35] Në shtator të atij viti u formua dega e Peshkopisë së prefekturës së Dibrës dhe ajo e Kukësit.[36]

Drejtim tjetër, në të cilën e përqendroi vëmendjen shoqëria, ishte të inkurajonte anëtarët e simpatizantet e saj në tërë vendin për zhvillimin e industrisë artizanale shtëpiake, për prodhimin e pëlhurave, sixhadeve e qilimave. Për këtë arsye shoqëria një herë në vit shpallte javën ekonomike. Gjatë kësaj jave me gratë e vajzat e shoqërisë zhvilloheshin konferenca dhe mësime të veçanta për veprimtarinë shtëpiake. Gjithashtu gjatë javës

---

[31] Zoi Xoxa, *10 vjet mbretëri 1928-1938*, Tiranë: 1938, f. 258.
[32]B.J.Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri…,* 182.
[33]F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri…,* 277-278.
[34]F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri…,* 280.
[35] F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri...,* 281; *Gazeta e Re*, nr.172, qershor 1929, 1.
[36]F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri…,*280-281.

organizoheshin edhe panaire me prodhime të ndryshme të punuara me gratë e vajzat në çdo qytetet.[37]

Me gjithë riorganizimin e këshillit drejtues dhe përpjekjet e figurave të shquara të lëvizjes femërore shqiptare si Parashqevi Qiriazi, Urani Rumbo etj., për të mbajtur në veprim degët e shoqërisë, ato nuk patën rezultatet e duhura. Degët e saj në qytetet e Shqipërisë Veriore dhe Verilindore nuk u aktivizuan, pothuajse, aspak në krahasim me ato të qyteteve të tjera të vendit. Aktiviteti i shoqërisë në qendër dhe në rrethe erdhi gjithnjë duke rënë. Madje, një pjesë e degëve ekzistonin vetëm fiktivisht.[38] Sipas nënkryetares së shoqërisë "Gruaja shqiptare" E.Toptani, shkak kryesor për pushimin e aktivitetit të shoqërisë ishte kriza ekonomike që kishte përfshirë tërë vendin.[39]

A. Zogu, gjithashtu, shprehu vendosmërinë të përqendronte vëmendjen në ndërtimin e një sistemi arsimor të efektshëm si bazë mbështetëse drejt një qytetërimi perëndimor të popullsisë. Lufta kundër analfabetizmit ishte një plagë e rëndë për shoqërinë shqiptare në përgjithësi dhe për femrën në veçanti. Prandaj, në ligjin për reformën arsimore 1934, këtij problemi iu kushtua neni 244, në të cilin parashikohej çelja e kurseve kundër analfabetizmit për të rriturit dhe në veçanti për gratë dhe vajzat.[40]

Në komunën e Maqellarës (rrethi Peshkopi), sipas burimeve arkivore, mësuesi i fshatit Allabegi kishte hapur kurs nate dhe kishte filluar mësimin që në muajin shkurt 1934, ku merrnin pjesë 15 veta.[41]

Fushës së arsimit qeveria shqiptare i kushtoi rëndësi, për shkak se popullsia e vendit ishte analfabete dhe kjo pengonte zhvillimin e vendit në përgjithësi. Si rrjedhojë, u ndërmor një program ambicioz reformash, që kishte si objektiv ngritjen e një rrjeti të tërë shkollash fillore në të gjithë vendin, të ndërtuara mbi bazën e sistemit me konvikt, për të gjithë ata fëmijë që banonin në zona të largëta dhe nuk mund të përshkonin çdo ditë rrugën për të ndjekur mësimet.[42] Sipas ligjit për reformën arsimore që u dekretua në shtator 1934 dhe hyri në zbatim për vitin shkollor 1934-1935, shkollat fillore mbeteshin me 5 klasa.[43]

Edhe në krahinën e Dibrës, numri i shkollave fillore dhe i sasisë së nxënësve të regjistruar u rrit. Në vitin shkollor 1934-1935 në qarkun e Dibrës situata ishte si më poshtë:

Shkolla fillore mashkullore e internatit "Dibra" në Kastriot me 204 nxënës; shkolla fillore mashkullore Peshkopi me 121 nxënës; shkolla fillore femërore Peshkopi me 66 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Bellovë" me

---

[37]*Po aty*, 282-283.
[38]F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri…,* 284-285.
[39]*Po aty*, 286.
[40]F.Musaj, *Gruaja në Shqipëri…,* 246.
[41]*AQSH*, F.152/17, V.1934, D.527, fl.1.
[42]B.J.Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri…,*183.
[43]*Shqipëria më 1937,* vëll.I, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, f. 168.

47 nxënës; shkolla fillore e përzier (djem dhe vajza) në fshatin "Brezhdan" me 40 nxënës, prej të cilëve 34 djem dhe 6 vajza; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Grevë" me 38 nxënës; shkolla fillore e përzier në fshatin "Herbel" me 50 nxënës prej të cilëve 48 ishin djem dhe 2 vajza; shkolla fillore e përzier në fshatin "Maqellarë" me 65 nxënës, prej të cilëve 46 meshkuj dhe 19 femra; shkolla fillore e përzier në fshatin "Allajbegi" me 101 nxënës, prej të cilëve 80 djem e 21 vajza; shkolla fillore e përzier në fshatin "Kërçisht" me 59 nxënës, prej të cilëve 55 djem dhe 4 vajza; shkolla fillore e përzier në fshatin "Zerqan" me 151 nxënës prej të cilëve 126 djem dhe 25 vajza; shkolla fillore mashkullore e fshatit "Zogaj" me 40 nxënës; shkolla fillore e përzier e fshatit "Homesh" me 81 nxënës, prej të cilëve 59 djem dhe 22 vajza; shkolla fillore e përzier e fshatit "Gjoricë" me 77 nxënës, prej të cilëve 70 djem dhe 7 vajza; shkolla fillore mashkullore e fshatit "Ostren i Madh" me 40 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Ostren i Vogël" me 34 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Lejçan" me 41 nxënës; shkolla fillore mashkullore "Lladomericë" me 30 nxënës; shkolla fillore e përzier në fshatin "Radovesh" me 22 nxënës, prej të cilëve 17 djem dhe 5 vajza; shkolla fillore e përzier në fshatin "Vernicë" me 24 nxënës, prej të cilëve 12 djem dhe 12 vajza; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Trebisht" me 85 nxënës, ndërsa ajo femërore me 35 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Gjinovec" me 37 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Klenjë" me 51 nxënës; shkolla fillore mashkullore në fshatin "Steblevë" me 55 nxënës.[44]

Pasqyra e të dhënave të mësipërme tregon një pjesëmarrje më të gjerë të nxënësve të të dy gjinive në shkollë, në krahasim me periudhën e mëparshme. Në nënprefekturën e Zerqanit, komuna e Gollobordës paraqiste problem madhor në çështjet arsimore, sepse kishte popullsi bullgarofone dhe gjuha kombëtare nuk flitej fare në jetën e përditshme të tyre, por dhe nuk dinin shqip. Prandaj, shihej e domosdoshme dhe ndjekja e mësimit në gjuhën shqipe në mënyrë të rregullt nga ana e nxënësve, jo vetëm nga djemtë, por edhe nga vajzat.

Fshatrat me popullsi bullgarofone në prefekturën e Dibrës ishin: Vernik, Trebisht, Klenjë, Gjinovec, Steblevë, Ostren i Madh, Ostren i Vogël, Tuçep, Lladomericë, Radovesh, Lejçan, Smollik, Herbel dhe Kërçisht i Epërm.[45] Sipas Kryeinspektorisë së Oborrit Mbretëror në këtë krahinë, në interes të zhvillimit të arsimit e të gjuhës shqipe, duhej që Ministria e Arsimit të angazhohej në hapjen e shkollave fillore për vajza në ato fshatra ku nuk kishte shkolla të tilla, si dhe të një internati femëror në një nga fshatrat më të përshtatshme të zonës.[46]

Sipas raportit të muajit korrik 1935 të Inspektorisë së Arsimit, Elbasan në qarkun e Dibrës edhe pse zhvillimi i mësimit për vitin shkollor 1934-1935,

---

[44]*AQSH*, F.228, V.1934, D.215, fl.1-13.
[45]*AMPJ*, V.1932, D. 149, fl.11.
[46]*AQSH*, F.150, V.1932, D.250, fl.8.

kishte qenë deri diku i kënaqshëm, por mungesa e orendive shkollore (banka, dërrasa), mungesa e mjeteve shkollore (si harta etj., në të gjitha shkollat), mungesa e godinave, mosvazhdimi i rregullt i nxënësve ishin pengesë për pritmëritë e duhura në këtë fushë. Komisionet shkollore sipas reformës së re arsimore 1934, në arsimin fillor për sa i përket ecurisë së mësimit kishte qenë disi i mirë, por kujdesi i tyre për të marrë masa shtrënguese ndaj prindërve për dërgimin e vajzave në shkollë të linte për të dëshiruar.[47]

Sigurisht, që krijimi i një rrjeti sa më të gjerë shkollash mashkullore, por, sidomos, femërore nuk ishte i lehtë për shumë faktorë. Problemi i arsimimit të femrës nuk u trajtua vetëm si faktor që do të ndikonte në çlirimin shoqëror të saj, por u pa, lidhur ngushtë edhe me fatet e kombit e të përparimit të tij. Gjithashtu, shkolla nuk u konsiderua vetëm si vatër diturie që do t'i jepte mundësi femrës të kuptonte nivelin e ulët shoqëror ku ndodhej në krahasim me ato të grave të popujve të zhvilluar, por ajo shërbente dhe si një mjet i efektshëm për të luftuar zakonin e mbrapshtë të së kaluarës, të jetës së mbyllur të vajzës.

Reformat që ndërmori Zogu në planin ekonomik dhe shoqëror ndonëse hasën në vështirësi për t'u asimiluar nga popullsia e prefekturës së Dibrës, por dhe në përgjithësi nga populli shqiptar, ishin të rëndësishme për emancipimin e saj, duke pasur parasysh botëkuptimin dhe bashkëjetesën e gjatë të këtij populli nën sundimin osman. Edhe koha në të cilën u zbatuan këto reforma nuk ishte favorizuese, siç ishte kriza ekonomike botërore, por dhe pozita ekonomike e prapambetur e kësaj zone në krahasim me pjesët e tjera të Shqipërisë.

[47]*AQSH*, F.228, V.1934, D. 215, fl.16.

PËRFTESAT PËRKTHIMORE DHE LARMISHMËRIA E TYRE NË PËRKTHIMIN E MARTIN IDEN NGA XHEK LONDON

Jonida Petro
Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze
janasline2@yahoo.co.uk

Abstrakt

Ky artikull, në dritën e Studimeve Përkthimore, i jep vëmendje përftesave dhe taktikave përkthimore të përzgjedhura nga përkthyesi në përcjelljen sa më pranë origjinalit, gjatë përkthimit të romanit "Martin Iden", vepër e shkrimtarit të veçantë amerikan Xhek London, e cila është sjellë në shqip prej përkthyesit dhe themeluesit të shkollës përkthimore shqiptare, prof. Shaban Demiraj. Në këtë punim analizohen metodat e përkthimit dhe përftesat përkthimore të tilla si transpozimi dhe barazvlefshmëria, modulimi, zgjerimi, të cilat shfrytëzohen në funksion të sjelljes së një efekti sa më pranëtekstit burimor për nga aspektet kuptimore, stilistikore dhe estetike. Punimi paraqet shembuj të shumtë paralelisht në të dy gjuhët dhe i krahason ato për të parë më qartë alternativat e përzgjedhura nga përkthyesi dhe komenton së fundmi lidhur me vlerën e shtuar ose të munguar, sipas rasteve të ndryshme, bën një kritikë të shkurtër përkthimore dhe nxjerr konkluzione lidhur me mundësinë e ripërkthimit.

Fjalë kyçe: *gjuha, përkthimi, proces, përftesat përkthimore, përkthyesi, shqip, anglisht.*

Abstract

This article, in the light of translation studies, is focused on the rendition and translation procedures selected by the translator of "Martin Eden" novel, a work of the American exceptional writer Jack London, presented in Albanian by the translator and founder of the translation Albanian school Prof. Shaban Demiraj. This paper analyses the translation methods and renditions such as transposition, equivalence, modulation and explicitation, *which are employed in the function of producing an effect close to the source text in the semantic, stylistic and esthetic aspect. This study introduces various examples in both languages and accordingly, makes relevant comparisons in order to clearly define the alternatives selected by the translator and eventually makes comments on the losses and gains according to different cases. Further, this paper makes a short translation criticism and comes up with conclusions concerning the possibility of retranslation.*

Key words: *language, translation, process, translation renditions, translator, Albanian, English.*

1. Hyrje

Përkthyesi përballet gjithmonë e me më shumë zgjedhje dhe problematika gjatë përkthimit të një teksti të caktuar, me synim për të arritur përputhjen e strukturave gjuhësore duke krijuar të njëjtën atmosferë dhe përcjell mesazhin e synuar nga autori, por edhe duke ruajtur stilin individual të tij.

Sipas Newmark (1988:5), "përkthimi është përcjellja e kuptimit të një teksti në një gjuhë tjetër në mënyrën që autori ka synuar atë tekst"[1]

Dyzimi midis të qëndruarit besnik ndaj gjuhës së autorit apo gjuhës së përkthimit është shoqëruesi i përhershëm i punës së përkthyesit përgjatë përkthimit të veprës letrare. Përzgjedhjet e tij për të sjellë në gjuhën shqipe sa më natyrshëm tekstin origjinal në përpjekje për të krijuar të njëjtin efekt me atë të gjuhës burimore dalin në pah gjatë analizës së përcjelljes së strukturave gramatikore dhe mënyrës së organizimit të frazave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Strukturat gjuhësore nga njëra gjuhë në tjetrën, këtu nga gjuha angleze në atë shqipe, përcillen, duke marrë parasysh kryesisht situatën ligjërimore, personazhet dhe veçoritë e tyre, bashkëbiseduesit dhe statusin e tyre social, që justifikojnë përzgjedhjen e procedurave të caktuara të përkthimit. Gjatë analizës krahasuese të tekstit origjinal me atë të përkthyer vihen në dukje përftesat përkthimore, veçanërisht, një sërë transpozimesh të përdorura për ta risjellë në shqip punën e Londonit po me atë forcë shprehëse e gjuhë të gjallë e të larmishme, të cilën autori shpesh e zhvendos nga gjuha letrare në gjuhën e stilit bisedor të shkujdesur. Përkthyesi ka përcjellë në shqip edhe përdorimin e zhargoneve, sociolekteve dhe idiolekteve për ta portretizuar me të gjithë mjetet e mundshme që ofron stilistika e gjuhës angleze. Përveç transpozimeve të tipeve të ndryshme, përkthyesi përdor mjeshtërisht edhe mikrostrategji të tjera, si p.sh., përkthimin e barazvlefshëm, natyrshmërinë, sinoniminë, shënimet sqaruese, zgjerimin ose reduktimin e frazave, përftesat grafike etj. .

Metodologjia: Në këtë punim prezantohen përftesa të ndryshme përkthimore që kanë ndikuar përcjelljen në shqip të romanit 'Martin Iden' të realizuara nga përkthyesi Shaban Demiraj për të sjellë te lexuesi të njëjtat kontekste, efekte dhe mesazhe si në veprën origjinale.

Gjatë analizës krahasuese midis veprës origjinale dhe asaj të përkthyer vihet re se përkthyesi ka përdorur disa mikrostrategji të cilat janë paraqitur në vijim.Bëhet një vlerësim lidhur me zgjedhjet që ka ndërmarrë përkthyesi Shaban Demiraj në funksion të arritjes së ekuivalencës me tekstin burimor si dhe të efektit që i është krijuar lexuesve shqiptarë që kanë pasur në dorë këtë roman.

---

[1] Newmark, P. (1988a). *A Textbook of Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall, pg.5.

U analizuan strategjitë e përdorura nga përkthyesi si transpozimi, modulimi, kondensimi, parafrazimet etj. .

1.1 Zhvendosjet ose Transpozimet

E.Tupja e përkufizon zhvendosjen kështu: "zhvendosja qëndron në zëvendësimin e një pjese të ligjëratës në tekstin origjinal me një pjesë të ndryshme të ligjëratës në tekstin e përkthyer dhe realizohet në rrafshin morfo-sintaksor.[2]

Ndërsa nga Vinay & Daberlnet [3], kjo mikrostrategji ose procedurë përkufizohet si procedurë përkthimi që përdor një strukturë gramatikore të ndryshme nga ajoe gjuhës burimore në ato raste kur përcjellja e kësaj strukture është e mundur dhe e pranishme në gjuhën e përkthimit. Gjithashtu, transpozimet ilustrojnë një tension të vazhdueshëm mes gramatikës dhe theksit logjik.

Transpozimi është e vetmja procedurë që ka të bëjë me strukturën gramatikore e sintaksore dhe shpeshherë përkthyesit e përdorin atë me intuitë. Megjithatë, studimet krahasuese gjuhësore dhe analiza e korpusit të tekstit dhe përkthimeve të tyre do të nxirrnin në pah transpozime të tipave të ndryshëm për çdo tekst origjinal të përkthyer në gjuhë të ndryshme, por edhe në të njëjtën gjuhë nga përkthyes të ndryshëm. Në veprën e analizuar vihen re këto transpozime:

1.1.a. Ndryshimi nga njëjësi në shumës

as if the level floors were tilting up and sinking down to the heave and lunge of the sea. (M.E, p.7)	Sikur dyshemeja të ngrihej dhe të ulej nga dallgët e detit. (M.I, K.I, fq.13)
Joe was a dozen of demons for work. (M.E, p.76)	Ai ishte djalli vetë për punë. (M.I, f.159)

1.1.b. Ndryshimi i rendit të mbiemrit i cili është edhe transpozim automatik dhe nuk lë rrugëzgjedhje në strukturën analitike të shqipes. Rendi mbiemër + emër, i njëjtë me atë të gjuhës angleze, përdoret ose përcillet si i tillë në ato raste kur përkthyesi mendon t'i japë vlerë më të madhe emocionale frazës ose kur e shënjon atë stilistikisht.

I babble like a little child. It is a great task..." …"Just think how you have improved in the short time I have known you. …… ….. a noted public speaker (M.E, p.64)	Kur flas belbëzoj si një fëmijë i vogël. Është e vështirë ta shprehish….. –Mendoni vetëm se sa keni përparuar brënda kësaj kohe të shkurtër, që ju kam njohur unë. …..është i njohur si orator i mirë. …. " (M.I, f.134)

[2]E. Tupja,*Këshillanjëpërkthyesitëri*, Onufri, 2000.

[3] Vinay, J.-P. and J. Darbelnet (1977): *Stylistiquecomparée du français et de l'anglais*, Paris, Didier.

1.1.c. Tjetër tip transpozimi është i nevojshëm kur struktura gramatikore e gjuhës burimore nuk ekziston në gjuhën e përkthimit, p.sh.,*gerundi i anglishtes* **i cili** nga përkthyesi është përcjellë në shqip si më poshtë:

he said, attempting to mask his anxiety (M.E, CH.I, p.7)	tha duke u orvatur ta fshihte shqetësimin (M.I,K.I, fq.14)	Gerundi i anglishtes është përkthyer me strukturën duke +formësi folje që shpreh një veprim që shoqëron veprimin e parë (ndryshe, forma e pashtjelluar foljore përcjellore)[4]

1.2. Modulimi

Ky term përdoret për të përkufizuar një variacion që ndodh nga ndryshimi i pikëpamjes dhe shpesh i kategorisë së mendimit. Përkthyesit përdorin modulime të lira në ato raste kur gjuha e përkthimit nuk lejon përkthimin e fjalëpërfjalshëm dhe kjo, sipas kritereve të Vinay & Darbelnet[5], ndodh, pothuajse, gjithmonë.

Konkretisht, Munday, teksa citon Vinay dhe Darbelnet, pohon se modulimi ndodh zakonisht në nivel mesazhi. Ndërsa ndryshimet në nivel gramatikor njihen si transpozime.Në nivel mesazhi, modulimi ndahet më tej në kategori të tjera, si psh.: konkrete për abstrakte, shkak – pasojë, një pjesë për një tjetër etj.

Një nga procedurat e modulimit më të përdorura dhe më të hasura në përkthimin që kemi marrë për rast studimor, është përdorimi i formës veprore për formën joveprore dhe, në raste kur joveprorja nuk ekziston, kjo procedurë bëhet e detyrueshme dhe e këshillueshme qëvetvetorja preferohet kundrejt joveprores.

Veprorenpërjoveproren

She <u>might well be sung</u> by that chap, Swinburne. (M.E,ch.1. p.8-9)	Asaj mund t'i thurte vargje fare bukur Suinbërni. (M.I, f.16)
yet it would not sell. (M.E,ch.xxiii, p.103)	...po megjithatë shkrimet e tij as i blinte kush.

1.3. Kondensimi

Kondensimi është strategjia nëpërmjet së cilës teksti burimor tkurret pa i hequr asnjë shtresë kuptimore tekstit në përkthim dhe duke sjellë një tekst

[4]Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave, 2002, fq. 285-287.

[5] Vinay, J.-P. and J. Darbelnet (1977): *Stylistiquecomparée du français et de l'anglais*, Paris, Didier.

burimor më ekonomik nga ana gjuhësore[6].Sugjerohet që kjo mikrostrategji të përdoret në masë të kufizuar nga përkthyesi, sepse, në të kundërt, do kishim të bënim me përkthim të lirë ose rikrijim të veprës origjinale. Në këtë rast kemi të bëjmë me tkurrje ose pakësim të elementeve leksikore e kuptimore, zakonisht të atyre elementeve që nuk përmbajnë peshë të qenësishme për përcjelljen e mesazhit dhe kuptimin e kontekstit:

She was a pale, ethereal creature, with wide, spiritual blue eyes and a wealth of golden hair. (M.E,ch.1. p.8-9)	Ajo ishte një krijesë e zbehtë si prej eteri, me sy të kaltër të mëdhenj dhe tërë gjallëri e me flokë ngjyrë ari. (M.I, f.16)
She wanted to cry out at the recklessness of the thought, and in vain she appraised her own cleanness and culture and balanced all that she was against what he was not. (M.E, p.16)	Atë çast desh bërtiti nga ky mendim i prapë dhe më kot u mundua të çmonte pastërtinë dhe kulturën e saj duke e krahasuar veten me të. (M.I, f.33)

1.4 Parafrazimi ose përkthimi i lirë

Perifrazimi ka të bëjë me rikrijimin e të njëjtit mesazh e efekt me anë të elementeve e strukturave të ndryshme nga ato të tekstit origjinal me qëllimin që ta sjellë sa më të kuptueshëm atë për lexuesin e tekstit të përkthyer. Disa raste ku përkthyesi ka përdorur këtë mikrostrategji janë paraqitur më poshtë:

He was keyed up to concert pitch, and there was never a moment in the long day when he was not fighting for moments. (M.E, p.76)	Çdo lëvizje e mendonte dhe e llogariste mire dhe vazhdimisht përpiqej të fitonte kohë. (M.I, f.159)
He set the alarm clock at six, and measured back five hours to one o'clock. (M.E, p. 76)	Zilen e sahatit e vuri për në orën gjashtë dhe, duke menduar të flinte vetëm pesë orë, vendosi të qëndronte zgjuar gjer në orën një pas mesnate. (M.I, f.159)

1.5 Përkthimi i barazvlefshëm ose ekuivalenca

Vinay dhe Darbelnet[7] me këtë term i referohen vëmendjes, alternativave të njohura, frazave dhe idiomave, e thënë ndryshe, mënyravetë paraqitjes së klisheve dhe aspekteve standardetë pandryshueshme të gjuhës si rasti i njësive frazeologjike.

That's the way it landed on me, but I guess I ain't up much on poetry, miss." (M.E, CH.I, p.9)	Këtë përshtypje më kanë bërë; po unë kujtoj, zonjushë, se nga poezia nuk marr erë shumë. (M.I, K.I, fq.22)

[6]Malone, J. *The Science of Linguistics inn the art of translation*, Taylor C.CUP, 1998, pp. 47-64

[7] Vinay, J.-P. and J. Darbelnet (1977): *Stylistiquecomparée du français et de l'anglais*, Paris, Didier.

It was as if he had seen the sun fall out of the sky, ... (M.E, p.53)	Ky zbulimi është për atë njësoj si të kish parë diellin duke u rrokullisur nga kupa e qiellit, … (M.I, f.111)

1.6 Përkthimi direkt ose përcjellja

Përkthimi i fjalëpërfjalshëm i shprehjeve, emërtimeve ose përbërësve të fjalëve të përbëra dhe frazave njihet me termin përkthim i huazuar ose direkt ose ndryshe përcjellja. Shembujt më të qartë të përkthimit të huazuar janë përkthimet e disa fjalëve karakteristike për kulturën e veprës origjinale.

His mind seemed to turn, on the instant, into a vast camera obscura, and he saw arrayed around his consciousness endless pictures from his life, (M.E, CH.I, p.8)	Dhe menjëherë në mendje zunë t'i pasqyroheshin si në një film piktura nga jeta e tij – (M.I,K.I, fq.16)
"A trick picture," (M.E, CH.I, p.8)	'Do të jetë ndonjë pikture për të mashtruar' (M.I,K.I, fq.15)

1.6 Përkthimi i dobët (Mistranslation)

Studiuesit e përkthimit kanë zhvilluar dhe zhvillojnë gjithmonë debatin e vazhduar që nga konceptimi i parë i praktikës së tij (përkthimit) deri më sot, lidhur me faktin se sa identike duhet të jetë një vepër e përkthyer me origjinalin.Bisedat dhe debatet rreth ekuivalencës nuk kanë arritur të na tregojnë se sa i njëjtë duhet të jetë një tekst me origjinalin për ta cilësuar versionin e përkthyer si besnik ndaj tij.

Me gjithë kujdesin e madh që mund t'i kushtohet transferimit të tekstit burimor në gjuhën e përkthimit mund të bëhet e pashmangshme, për një arsye ose një tjetër, që të kemi devijime nga teksti origjinal në një pikë ose tjetër të tekstit të përkthyer.

Përkthimi i dobët ka të bëjë me shmangien e përkthimit nga origjinali dhe tregon dështim të përpjekjes që bën përkthyesi gjatë procesit të përkthimit për të transferuar sa më besnikërisht tekstin original dhe të krijojë barazvlerësin e tij. Ky keqinterpretim ndodh për shumë arsye, shpeshherë për shkak të kuptuarit tjetër për tjetër të fjalës, frazës, ose të një fjalie të origjinalit. Ndonjëherë kjondodh për shkak të ndryshimeve ndërmjet dy kulturave ose për shkak të përdorimit teknik të fjalëve[8]. Jemi përqendruar këtu kryesisht në keqinterpretimet lidhur me njësitë leksikore që kanë ardhur për shkak të të kuptuarit të gabuar të tekstit origjinal ose për shkak të zgjedhjes së fjalëve e shprehjeve të papërshtatëshme për përçimin e saktë të mesazhit të origjinalit. Probleme të tjera të ngjashme janë edhe paqëndruehmëria/inkonsistenca, shtesat dhe heqjet ose reduktimet në tekstin

[8]https://www.ajol.info/index.php/og/issue/view/19237

e përkthyer.Përkthyesi i rastit tonë studimor na përball me pesëmbëdhjetë raste keqpërkthimi.

The book was closed on his forefinger, and before he turned he was thrilling to the first new impression, which was not of the girl, but of her brother's words. (M.E, CH.I, p.8)	E mbylli menjëherë librin duke e mbajtur gishtin në të; aq shumë u prek nga fjalët e Arthurit dhe nga bukuria e vajzës. (M.I,K.I, fq.16)
"Something no laundry ever does, except this one. (M.E,p77)	-Këtës'egjen në asnjë pastërti tjetër. (M.I, f.161)
Look at that!"He held a cuff aloft (M.E, p 77)	Ja shikoje! – e në atë çast i tregoi një jakë këmishe. (M.I, p161)

1.7. Shtesa

Newmark shprehet se *shtesat* janë informacioni saktë që ishtohet normalisht përkthimit përçështje kulturore (pra, duke mbuluar ndryshimet kulturore mes GjB dhe GjP), mund të jenë me karakter teknik (sipas çështjes që trajtohet) ose me karakter gjuhësor (që shpjegojnë në mënyrë direkte përdorimin e fjalëve).[9]

Pikërisht, për këto arsye, përkthyesi Demiraj në përputhje me stilin e Xhek London, zgjedh shtesat, si strategji përkthimore për të tërhequr lexuesit e tij që t'i shikojnë disa hollësi nga shumë afër, po pa emocionalitet, pa stil të shtjelluar e komente. Ka disa shembuj ku përkthyesi është përpjekur të ndërhyjë në rrjedhën e rrëfimit ose e bën tonin e përkthimit të tij më emocional se sa vetë origjinali. Disa shembuj të tillë janë:

It's hopeless," Weedon Scott confessed. He sat on the step of his cabin and stared at the dog-musher, who responded with a shrug that was equally hopeless. (W.F, p.183)	Nga pragu i kasolles prej druri, pranë Dausonit, Skotti dhe Metti vështronin Dhëmbin e Bardhë. -S'ka shpresë të zbutet- tha Uindon Skotti. Ai zbriti një shkallë dhe i hodhi një vështrim Mettit, që mblodhi dhe ai supet me dëshpërim. (Dh.B, fq.152)
And in her zeal, when she had finished with her own, she attacked the belongings of her men and went through them like a tornado. (C.WW, p.38)	Dhe me hovin që kish marrë, pasi mbaroi punë me thesin e vet, iu sul plaçka vetë të dy burrave e bëri kërdinë, si një tufan që pllakos viset e Gjirit të Meksisë. (K.P, fq.67)

[9]Newmark, P. (1988a). *A Textbook of Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall.

Përfundime

Të gjithë profesionistët apo joprofesionistët e përkthimit të cilët merren me përkthime letrare ballafaqohen me çështjen e cilësisë së përkthimit.[10] Që në qasje të parë, vlerësimi i përkthimit nuk duket se është i lehtë. Vlerësimi i parë vjen në formën e fjalëve "mirë" ose "keq" dhe "saktë ose "gabim", të cilat janë polet e vlerësimit, por në të njëjtën kohë termat më të paqarta të përkthimit.[11]

Por ky lloj vlerësimi mund të jetë zanafilla me anë të së cilës gjykohet puna e përkthyesve dhe vlerësime të tilla nuk duhet të anashkalohen. Reagimi "tingëllon gabim" mund të krahasohet me atë të një adhuruesi të muzikës.[12] Dëgjimi i një simfonie të regjistruar dhe komenti "i çakorduar"; ai ose ajo nuk mund të identifikojnë instrumentin, por në veshin e tyre ndihet që diku në orkestër një muzikant ka krijuar një tingull të gabuar.[13] Nëse një person që bën vlerësimin e përkthimit është në gjendje si fillim të "dëgjojë një tingull në simfoninë e përkthimit", atëherë, mendojmë se ka mundësi të bëjë një analizë të hollësishme.

Një model i mirënjohur i vlerësimit të përkthimit është ai nga P. Newmark. Në planin e tij, ai përmend pesë faza që një përkthyes duhet të kalojë për të kritikuar një përkthim, përkatësisht:

1. Analizën e tekstit në GjB duke theksuar qëllimin dhe aspektet e tij funksionale;
2. Interpetimin e qëllimittëtekstittëGjB;
3. Bërjen e një krahasimi të hollësishëm me origjinalin;
4. Vlerësimin e përkthimit; në terma përkthimore dhe në terma kritike;
5. Vlerësimin e përkthimit në gjuhën dhe kulturën ose disiplinën e synuar.[14]

Në përkthimin e veprës nga përkthyesi Shaban Demiraj, janë përdorur strategji përkthimore të larmishme që kanë mundësuar që përkthyesi të përcjellë dhe të ruajë me sa më shumë besnikëri tekstin original duke ruajtur vlerat gjuhësore dhe ato estetike më së miri në përcjelljen e mesazhit të autorit.

Ndërsa lexon përkthimin e "Martin Iden", sipas edhe shembujve që ilustrojnë secilën përftesë përkthimore të përzgjedhur, shihet se sjellja në shqip e "Martin Iden" i ngjan vërtet një simfonie shumëngjyrëshe që mbahet në këmbë nga përzgjedhjet e përkthyesit dhe strategjive për përkthimin e figurshëm. Shembujt, siç edhe i pamë për secilën përftesë, shpesh ndiqen nga komentet përkatëse që qartësojnë e justifikojnë përcjelljen në shqip të tekstit burimor.

---

[10]House, J., *Translation quality assessment*, Gunter Narr Verlag, 1997, f. 101-119.
[11]Po aty.
[12] Berman, A., *Pour une critique des traductions:*John Donne, Gallimard 1995, f.1-5.
[13]Po aty.
[14]Newmark, P., *A Texbook on Translation,* Prentice Hall 1988, f. 184-192.

Fakti se sipas kampionimit manual të përftesave përkthimore, proces i cili kërkon kohë dhe mund, janë përdorur gjerësisht transpozimet në forma të ndryshme për t'iu qasur stilit të autorit të veprave, modulimet për të shmangur përkthimin e fjalëpërfjalshëm për të ofruar një përkthim sa më të natyrshëm, kondensimin dhe zgjerimin për të përcjellë mesazhe sa më pranë origjinalit ose kur janë përballur me mospërputhje leksikore mes dy gjuhëve, parafrazimin për ta bërë sa më të kuptueshëm origjinalin për lexuesit, përkthimin e barazvlefshëm për të përcjellë me orientim nga kultura marrëse njësitë kuptimore, përkthimin e drejtpërdrejtë sa herë ka qenë e nevojshme, shënimet për të sqaruar fjalë që nuk ekzistojnë ose që janë të panjohura për lexuesit, transferimin direkt të njësive matëse, paçka se do të kishte qenë më e qartë dhe e kuptueshme përcjellja e tyre në shqip. Kemi pasur raste të shohim edhe përkthim të dobët për shumë arsye, shpeshherë për shkak të të kuptuarit tjetër për tjetër të fjalës, frazës ose të një fjalie të origjinalit. Ndonjëherë ndodh për shkak të ndryshimeve ndërmjet dy kulturave ose për shkak të përdorimit teknik të fjalëve. Probleme të tjera të ngjashme janë edhe paqëndrueshmëria/inkonsistenca, shtesat dhe heqjet ose reduktimet në tekstin e përkthyer. Sidoqoftë, mund të thuhet me bindje të plotë se përkthyesi në fjalë ka bërë përpjekje të suksesshme në sjelljen në shqip dhe se deri më sotnuk identifikohet nevoja për ripërkthim.

Literatura:

Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave, 2002, fq. 285-287.

Berman, A., Pour une critique des traductions: John Donne, Gallimard 1995, f. 1-5.

House, J., *Translation quality assessment*, Gunter Narr Verlag, 1997, f. 101-119.

Munday, Jeremy. *Introducing Translation Studies: Theories and Applications*. Second Edition, London: Routledge, 2008.

Newmark, P. (1988a). A Textbook of Translation. Hertfordshire: Prentice Hall, pg.5.

Newmark, P. (1988a). *A Textbook of Translation*. Hertfordshire: Prentice Hall. Pg.91.

Tupja,E., *Kë*shillanjë *p*ërkthyesi *t*ëri, Onufri 2000.

Vinay, J.-P. and J. Darbelnet (1977): *Stylistiquecomparée du français et de l'anglais*, Paris, Didier.

https://www.ajol.info/index.php/og/issue/view/19237

SHKALLËT E KOMIKES NË KRIJIMTARINË LETRARE TË QAMIL BUXHELIT

Vjollca Rrapai[1], Sashenka Kamberi[2]
[1]Departamenti i Letërsisë, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër
vjollcarapai@yahoo.com
[2] Departamenti i Gjuhës Shqipe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër
sashakamberi@yahoo.com

***Abstrakt**:*
Në këtë artikull synohet të realizohet një pasqyrim i përdorimit të figurave letrare më të spikatura në krijimtarinë letrare satirike të Qamil Buxhelit. Ne do të ndalemi në evidentimin e shkallëve të komikes të aplikuara prej tij si, zmadhimi, ironia, karikatura, satira, grotesku etj. Dukuritë komike që i nënshtrohen satirës nuk janë të njëllojta dhe shkalla e negativitetit të tyre është e ndryshme. Në përputhje me thelbin e vet negativ të dukurisë ndryshon edhe ngjyrimi i demaskimit satirik ndaj një tipi komik, bartës i zakoneve të vjetra ose ndaj një njeriu të rrezikshëm që shfaqet me fraza parimore. Qamil Buxheli është një ndër shkrimtarët e paktë shqiptarë që jetën dhe veprimtarinë krijuese ia kushtoi gjinisë së humorit. Nga bashkëkohësit e tij Buxheli dallohej për ndjenjën e fortë të humorit, mprehtësinë dhe mjeshtërinë e të shkruarit letërsi satirike. Përmes artit të fjalës ai synonte përsosmërinë e shoqërisë.

***Fjalët çelës**: veprat humoristike, ironia, grotesku, satira, zmadhimi*

Abstract
This aim of this article is to present the use of the most prominent literary tropes in Qamil Buxheli's satirical work. We will try to highlight the satirical techniques used by him, such as, exaggeration, irony, caricature, satire, grotesque etc. Vices, follies, abuses, and shortcomings that are subject to satire are not the same and their degree of negativity is different. In accordance with the negative essence of the phenomenon changes also the tincture of the satirical unmasking of a comical fellow with old and outdated ideas or of a dangerous man who is outwardly a principled man. Qamil Buxheli is one of the few Albanian writers who devoted his life and work to the genre of humour. Buxheli distinguished himself from his contemporaries for his strong sense of humour, sharpness and mastery of writing satirical novels. Through the art of the written word he aimed at the perfection of society.

***Key words**: satirical novels, irony, grotesque, satire, exaggeration*

Humori dhe satira në të njëjtën vepër artistike mund të gërshetohen me njëra – tjetrën si dy lloje të qëndrimit ideoemocional ndaj dukurisë komike. Edhe në veprat artistike ndodh që personazhet, të cilat karakterizohen nga virtyte të larta, të qortohen edhe me mjetet e humorit, pasi edhe ata mund të ndodhen në situata komike. Kështu, me ngjyra të humorit janë vizatuar shumë personazhe të virtytshme të komedive të mëdha botërore. Në të gjitha veprat satirike ku demaskohen cilësitë negative të personazheve zakonisht shfrytëzohen mjetet e humorit dhe herë–herë edhe ato të ironisë therëse. Disa studiues klasifikimin e trajtave të humorit e bëjnë duke u nisur nga format më të thjeshta, më elementare dhe pastaj shkallë – shkallë arrijnë drejt skajit ku përfundon fusha e veprimit të humorit dhe nis satira. Në veprat humoristike ku paraqiten dukuri shoqërore të përgjithshme personazhet karakterizohen nga virtyte "të mira", por kanë edhe të meta të pjesshme, kritikohen për veset e personazheve, kryesisht, për anët negative që shkaktojnë të qeshurën te lexuesi. Viktimë e dobësive të veta bëhet edhe personazhi i tjetërsuar nga faktorët shoqërorë, prandaj shpeshherë ndaj tij përdoret humori. Ky lloj personazhi letrar i lidhur me një tip tjetër komik mund të vihet në pozitë qesharake, sepse ndikohet nga veset dhe anët negative të personazhit që satirizohet. Kujtojmë lidhjen e famshme të Sanços me Don Kishotin, të Demkës me Zylon dhe çifteve të tjera në letërsinë botërore. Tek ai përqeshen dobësi të tilla si paaftësia për të dalë nga gjendja qesharake dhe për të shkëputur marrëdhëniet me tipa të ulët e të paaftë, siç ndodh me Demkën apo me shumë personazhe në përmbledhjen me tregime të Q. Buxhelit "Dostojevsk nuk kemi, idiotë sa të duash".

Ironia: Ironia është një mënyrë e të thënit të gjërave në mënyrë të tërthortë, ajo është një metodë për të kuptuar më mirë absurditetin e gjërave që na rrethojnë. Ironia shfaqet me anë të kontradiktave midis fjalëve dhe kuptimit të tyre, midis aksioneve dhe rezultateve të tyre, midis aparencës dhe realitetit duke u bërë kështu një element shumë i rëndësishëm midis absurdit dhe paradoksit. Në të folurin e zakonshëm përdoret më së shumti si shprehje ironike, e cila kuptohet si të tilla nga intonacioni ose konteksti. Në veprat letrare ironia përdoret si një mjet i fuqishëm për të shprehur zemërim, urrejtje, pakënaqësi dhe përbuzje. Qamil Buxheli në krijimtarinë e tij letrare shfrytëzon dy lloje të ironisë, ironinë verbale dhe ironinë e situatave, të dy këto lloje zënë një vend të gjerë në veprat e tij. Ironia verbale ka të bëjë kryesisht me keqkuptimet që krijon veshja fonetike e fjalës me kuptimin e saj, ajo mbart në vetvete, shpeshherë, edhe hiperbolën. Ndërsa ironinë e situatave Buxheli e përdor dendur kur vëren se si njerëzit e ndodhur në rrethana të pafavorshme tentojnë t'i bëjnë ato edhe më të pafavorshme.

Kritiku Hasan Hasani në një artikull kushtuar romanit satirik "Kariera e zotit Maksut" të Qamil Buxhelit shprehet se Zotin Maksut, Qamil Buxheli e vë në pozita të ndryshme dhe qesharake duke mos kursyer asnjëherë ironinë e cila arrin në sarkazëm. [...] Buxheli për të treguar se kush është ky dhe në çfarë vendi punon dhe se a ka mundësi që prej këtij vendi, prej kësaj komune, në qoshen e së cilës fëmijët dhe njerëzit e rritur kryenin nevojën e urinës, nën

dritaren e zotit Maksut, sepse kjo është një komunë pa nevojtore publike - ironizon shkrimtari, këput njëherë e përgjithmonë të gjitha shpresat, që një njeri i tillë, siç është zoti Maksut, vërtetë nuk ka vend askund.[1] Ironia e Buxhelit ka shumë funksione, ajo është një instrument herë i hapët e herë i fshehtë për të zbuluar të vërtetën, përveç kësaj ajo kryen edhe funksione stilistike duke rafinuar dhe pasuruar ligjërimin satirik. Buxheli e përdor ironinë si një mjet origjinal për të shprehur qëndrimet e tij ndaj realitetit të kohës, duke e vënë në dukje përmes ligjërimeve të ndërlikuara të personazheve të tij.

Zmadhimi: Zmadhimi është dukuria komike që satirizohet, afrohet shumë me të ulëtën dhe disa herë edhe me të shëmtuarën. Këto dukuri afrohen me njëra – tjetrën për shkak të natyrës dhe rolit që ato luajnë në veprën letrare. Zmadhimi ose hiperbolizimi është një figurë letrare me anë të së cilës njerëzit, kafshët, sendet ose fenomenet e ndryshme paraqiten jashtë mase të zmadhuara. Në letërsinë shqipe hiperbolën e gjejmë shpesh edhe në krijimtarinë popullore, në këngët legjendare dhe rapsoditë.

Qamil Buxheli është një ndër shkrimtarët e paktë shqiptarë që jetën dhe veprimtarinë krijuese ia kushtoi gjinisë së humorit. Përmes artit të fjalës ai synonte përsosmërinë e shoqërisë. Krijimtaria e tij letrare zë një vend të rëndësishëm në letrat shqipe, kryesisht në gjininë e satirës dhe humorit. Zmadhimin ky autor e përdor për të rrëfyer raportet e brendshme dhe të jashtme të tipave apo karaktereve të caktuara. Buxheli zotëronte në mënyrë të jashtëzakonshme ndjenjën e humorit dhe mekanizmin e sofistikuar për të zbuluar komiken në situata të ndryshme. Ky shkrimtar në tregimet, skicat dhe fejtonet humoristike trajton me kujdes problemet e shoqërisë së kohës dhe kuptohet se çdo frazë përmban një brendi komike duke iu referuar ngjarjeve konkrete.

Shkrimtari i mirënjohur dhe bashkëkohësi i Q. Buxhelit, Dritëro Agolli thekson në mënyrë të veçantë këmbënguljen e këtij autori për të qenë vazhdimisht në oponencë ose opozitë konstruktive, duke mos kursyer as veten e as krijimtarinë e tij letrare: "Duke fokusuar te "Seriozia" qesharaken dhe te "qesharakja" seriozen, arrin të përqeshë në politikë, në kulturë, në letërsi dhe në arte, në fe e kudo edhe gjërat në dukje "më të shenjta". Nuk harrohet satira buxheljane në kohë të diktaturës, kur shaka të tilla qenë me zarar, shprehja e tij "Proletarë të të gjitha vendeve, veresie s'ka", ashtu siç nuk harrohet "rraketa" satirike "Qentë lehin dhe karvani u shkon pas" e hedhur prej tij në kulmin e një fushate elektorale të viteve të fundit, kur votuesit, duke shkuar pas berihajt, duke u grindur me kundërshtarin politik votonin, duke thirrur "Po, po, po" ose "Jo, jo, jo" pa njohur fare as emblemën e partisë, as programin, e as vetë kandidatin".[2]

---

[1]Shih: Hasani, Hasan, Romani "Kariera e zotit Maksut" i Qamil Buxhelit: "Fjala", Prishtinë, Nr. 9, shtator 1972, f. 7.

[2] Agolli, Dritëro, "Një personalitet i shquar i kulturës dhe letërsisë së re shqiptare" (shkrimtari Qamil Buxheli), "Zëri i popullit", 30 maj 204, f. 3.

Figurën e zmadhimit e hasim shpesh në veprimet e personazhit kryesor të romanit "Kariera e zotit Maksut" të Qamil Buxhelit, Maksut Ramo është një figurë komike që i nënshtrohet demaskimit satirik. Në veprat e Qamil Buxhelit komike janë edhe figurat e provincialëve, konservatorëve, burokratëve dhe gjithë atyre që frenojnë zhvillimin dhe përpjekjet e shoqërisë për demokratizimin e vendit, vetëm e vetëm për përfitime personale, ndërsa në fjalimet e tyre shfaqen si të emancipuar, ashtu siç shtirej edhe zoti Maksut në shumë biseda. Të gjitha këto dukuri të vjetra dhe të dëmshme që paraqiten si të reja dhe përparimtare kanë edhe një tharm komik.

Satira: Në veprat letrare satira shfaqet në forma të ndryshme, me anë të saj kritikohenvesetnjerëzoreapoindividuale, abuzimet me pushtetin ose mangësitë e personazheve të ndryshmedemonstrohenme anë tëtalljes, përqeshjes, ironisë dhe metodave të tjera, ndonjëherëedhe meqëllim përtë ndikuar në përmirësimin e karakterit të vetë personazhit.

Në letërsinë shqipe satira është përdorur me mjeshtëri nga Çajupi, Noli, Migjeni, Musaraj etj. Qamil Buxheli është një ndër shkrimtarët më të njohur në përdorimin e satirës, ai fillimisht korri sukses të madh me vëllimin me tregime "Faraonë dhe firaunë". Përveç tregimeve të shumta satirike, ai shkroi edhe tri romane të suksesshëm: "Kur qesh tërë qyteti", "Kariera e zotit Maksut", "Maratona e vdekjes" si edhe në novelën "Abeli, unë dhe Paganini". Përmes veprimeve dhe sjelljeve të personazheve të tij autori shfrytëzon më së miri satirën dhe groteskun duke e bërë "lojën" e tyre edhe më tërheqëse për lexuesin.

Në këto vepra ndryshon deri diku forma e paraqitjes së ngjarjeve në krahasim me situatat jetësore dhe reale, kjo gjë ndodh në mënyrë të veçantë në veprat humoristike dhe satirike. Në disa nga veprat satirike – humoristike duket sikur ngjarje të tilla ndodhin rrallë në jetë, por ajo që bie në sy është pasuria e figurave fantastike. Qamil Buxheli në vëllimin e tij me satirë dhe humor "Dostojevsk nuk kemi, idiotë sa të duash" situatat fantastike i shpalos përmes humorit dhe tonit kritik, i cili në disa raste shkon deri në satirë. Nëpërmjet artit të satirës Qamil Buxheli analizon, eksploron dhe evidenton të keqen apo të shëmtuarën dhe në të njëjtën kohë ai përpiqet të ndërgjegjësojë lexuesin për këto fenomene të shëmtuara. Satira është arma me të cilën autori shpreh hapur gjykimet dhe pakënaqësitë për këto fenomene dhe individët e veshur me pushtet. Satira e tij ka për detyrë të mbrojë idealet e së vërtetës, të moralit dhe natyrisht denoncimin e së keqes. Autori nuk përshkruan gjatë një dukuri të dëmshme, por nis shigjetat drejt natyrës së fenomenit dhe lexuesi është në gjendje të kuptojë disa ngjarje dhe veprime reale.

Përmes satirës ai pozicionohet moralisht dhe vë në dukje dukuri negative duke shprehur hapur gjykimet e tij. Buxheli e realizon qëllimin e tij në dy mënyra kryesore: së pari, me anën e një strukture teorike – letrare të përpunuar; së dyti, duke u dhënë objekteve dhe subjekteve të tij formën më të egër dhe qesharake duke ndërtuar groteskun.

Grotesku: Grotesku është një nga mënyrat e zmadhimit dhe deformimit satirik, ku përmasat e dukurive ose cilësive të tyre rriten në mënyrë të jashtëzakonshme. Grotesku shpeshherë bashkon realen me fantastiken dhe jo rrallë herë shfaqet në forma të çuditshme. Me përmasa groteske janë krijuar disa prej tipave më të goditur në gjininë e humorit dhe satirës në letërsinë botërore. Ai paraqet në mënyrë të theksuar komike ose qesharake aspekte të ndryshme të realitetit duke shfrytëzuar hiperbolën dhe mjete të tjera të satirës. Grotesku shfrytëzohet në mënyrë të veçantë kur paraqet të zmadhuara në mënyrë kolosale përmasat fizike të një dukurie ose disa cilësi të saj. Figurat groteske në pamjen e parë duken të çuditshme dhe absurde.

Në krijimtarinë artistike të Qamil Buxhelit grotesku zë një vend të rëndësishëm. Përmes penës së tij ky autor paraqet disa tipare qesharake dhe negative të shoqërisë sonë. Në disa raste ai paraqet në mënyrë të pjesshme tipare të veçanta duke individualizuar në këtë mënyrë karaktere të ndryshme, por edhe duke bërë përgjithësime estetike. Ka raste kur grotesku i tij nuk vjen i argumentuar ose vjen me përmasa të mëdha hiperbolike dhe në këtë mënyrë zbehet vërtetësia e tij. Situata të tilla gjejmë në romanin "Kariera e zotit Maksut" njëra prej tyre është minimi i hotel "Kontinentalit":

Buxheli, në krijimtarinë e tij, groteskun e shpreh përmes konkretizimit dhe me tipare të zmadhuara në romanin "Kur qesh tërë qyteti", ku tipizon burokratët dhe shpalos disa dukuri të marrëdhënieve shoqërore. Në këtë roman personazhet komike në shumicën e veprimeve të tyre paraqiten përmes groteskut, ndërsa karakteret e tjera paraqiten në forma reale. Veprat letrare të ndërtuara mbi bazën e groteskut paraqesin një subjekt letrar ku përfshihen një numër personazhesh, por prapa marrëdhënieve të tyre nënkuptohen dukuri të tjera. Si në veprën alegorike, ashtu edhe në veprën ku shfrytëzohet grotesku ka dy rrafshe, njëri është ai që përshkruhet në veprën artistike i drejtpërdrejtë, ndërsa tjetri duhet nënkuptuar në bazë të përqasjeve dhe përfytyrimeve të lexuesit. Një shembull të tillë Buxheli e sjell me shumë mjeshtëri në fund të romanit "Kariera e zotit Maksut".

Përdorimi i groteskut në veprat e Buxhelit ruan realitetin e marrëdhënieve njerëzore, duke dhënë anët komike të domosdoshme dhe komiken bindëse. Ndërsa në veprat ku personazhet marrin trajta fantastike dhe ngjarjet zhvillohen sipas një logjike të veçantë dhe sipas karakterit të vetë personazheve të krijuara, autori i veprës satirike i transferon dukuritë për të zbuluar më mirë komizmin e tyre, por në disa raste realiteti përmban trajta të tilla për të hiperbolizuar këto dukuri.

Karikatura: Karikatura është një tjetër element i rëndësishëm që bie në sy, pothuajse, në të gjithë veprimtarinë letrare të Qamil Buxhelit. Karikatura është paraqitja e deformuar e një personi me qëllim në një vepër letrare, deformimi i një sendi apo i një ngjarjeje duke theksuar disa anë negative dhe qesharake. Në veprat letrare karikaturat janë një armë e fuqishme për të demaskuar të meta dhe dobësi, ato janë të lidhura me vizatimin e portreteve të karaktereve të vëna në lojë prej autorit duke ekzagjeruar në sensin qesharak me tiparet fizike të personazheve dhe karakteristikat e tyre.

Mjetet e karikaturizmit i shfrytëzon Buxheli edhe kur paraqet portretet e personazheve satirike në përmbledhjet me novela dhe tregime humoristike: "Abeli, unë dhe Paganini", "Një ndodhi në plazh", "Faraonë dhe firaunë" dhe, pothuajse, në të gjitha veprat e tjera. Ka disa raste kur autori e përdor karikaturën në funksion të humorit dhe shakasë. Në letërsinë tonë përdorimi i karikaturës mori zhvillim të madh në veprat e shkruara gjatë Luftës Nacionalçlirimtare në skicat dhe botimet e shtypit ilegal, më pas edhe në shumë krijime me temë politike e në mënyrë të veçantë në revistën humoristike "Hosteni", ku Buxheli ka qenë mjaft aktiv me shkrimet e tij. Karikatura e asaj periudhe trajtoi luftën kundër së vjetrës duke satirizuar gjithçka që binte ndesh me zhvillimin dhe ecjen përpara të shoqërisë. Mjetet e karikaturës në portretizimin e tipit satirik në letërsi shërbejnë edhe për të vënë në dukje kundërshtitë komike të tij. Ajo është pjesë përbërëse e kategorisë së satirës edhe pse ka rolin e saj të veçantë në procedurat e vizatimit të personazheve të vëna në tallje duke ekzagjeruar me sensin qesharak tiparet dhe karakteristikat e personazheve.

Përfundime:

Qamil Buxheli personazhet e tij i vë në pozita qesharake duke mos kursyer asnjëherë ironinë e cila shkon deri në sarkazëm. Tehu i kritikës së tij drejtohet kundër politikës dhe fenomeneve negative, ai nuk ndalet në shpjegimin e vërtetësisë së ndodhisë, por e përdor atë si mjet për organizimin e materialit dhe dhënies së idesë, ai kërkon të bëjë të njohur fenomenin dhe jo ngjarje konkrete. Qamil Buxheli në disa tregime të tij paraqet një situatë fantastike që në fillim, ndërsa në raste të tjera subjekti afron me një përshkrim realist dhe shkallë – shkallë e në mënyrë të papritur kalon në një situatë fantastike.

Bibliografi

Buxheli, Qamil,"Kur qesh tërë qyteti" (Roman humoristik), "Naim Frashëri", Tiranë, 1970.

Buxheli, Qamil, "Kariera e zotit Maksut" (Roman satirik), "Naim Frashëri", Tiranë, 1971.

Buxheli, Qamil, "Maratona e vdekjes" (Roman satirik), "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1991

Buxheli, Qamil, "Dostojevsk nuk kemi, idiotë sa të duash" (Satirë dhe humor), "Marlin Barleti", Tiranë, 1997.

Αριστοτελι, "Ποετικα", "Ναιμ Φρασηёρι Τιρανё,", 1961.

Gramshi, Antonio, "Shkrime për kulturën dhe letërsinë", "Naim Frashëri", Tiranë, 1981.

Agolli, Dritëro, "Një personalitet i shquar i kulturës dhe letërsisë së re shqiptare" (shkrimtari Qamil Buxheli), "Zëri i popullit", 30 maj, 2004.

Hasani, Hasan, Romani "Karriera e zotit Maksut" i Qamil Buxhelit: "Fjala", Prishtinë, Nr. 9, shtator, 1972.

ZANAFILLA E PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI

Ejona Isufaj
Këshilltare e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
isufaje@gmail.com

Abstrakt

Ne fillim të shekullit XX Shqipëria vuante nga vonesat në zgjidhjen e krizave të mëdha të krizës së identitetit; kriza e depërtimit; kriza e legjitimitetit që ishin me efekte për ***vonesa në krijimin e partive politike.*** *Ky punim analizon krijimin e partive politike në Shqipëri, si dhe sfondin historik ku ato krijohen. Ka një analizë të detajuar jo vetëm të krijimit, por edhe të konsolidimit në shoqërinë shqiptare.*

Fjalët çelës: *Shqipëri, parti politike, shekulli XX, shoqëria shqiptare.*

Abstract

At the beginning of the XX century, Albania suffered from delays in resolving major identity crisis crises; penetration crisis; the crisis of legitimacy that had effects on delays in the formation of political parties.This paper analyzes the creation of political parties in Albania, as well as the historical background where they are created. There is a detailed analysis not only of the creation but also of the consolidation in the Albanian society.

Key words*: Albania, political parties, XX century, Albanian society.*

Edhe në fillim të shekullit XX Shqipëria "vuante" nga vonesat në zgjidhjen e "krizave të mëdha" të "krizës së identitetit"; "kriza e depërtimit"; "kriza e legjitimitetit" që ishin me efekte për **vonesa në krijimin e partive politike.**

Shpallja e Pavarësisë Kombëtare më 28 nëntor 1912 është kurorëzimi i lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, ku veçohen arritjet e Lidhjes së Prizrenit, me të cilën u hodhën hapat e para drejt pavarësisë së Shqipërisë të organizimit konstitucionalist e institucional i shprehur përmes organeve të posaçme, të atij legjislativ (Këshilli i Përgjithshëm), ekzekutiv (Komisioni për Punët e Brendshme, Komisioni për Çështjet Financiare, Komisioni i Punëve të Jashtme) e në vazhdim me Lidhjen Shqiptare të Pejës. Qeveria e përkohshme e Vlorës ishte një **qeveri elitare** me politikanë që kishin bërë emër, por pa qenë të zgjedhur nga të qeverisurit.

Zhvillimet në Qeverinë e Vlorës**, në aspektin krahasues,** siç shkruan A. Krasniqi, ishin shumë larg nga modelet e zhvillimeve politike në vendet e

tjera të Evropës, madje, edhe të Ballkanit. Në atë kohë, pothuajse, në të gjitha vendet fqinje ishin krijuar parti politike, institucione politike dhe mekanizma të debatit politik[1].

Qeveria e Vlorës, nuk arriti të realizojë zhvillime që diskutoheshin nga zgjidhja e "krizës së identitetit" të saj " të depërtimit", "të legjitimitetit" e "të pjesëmarrjes". Autoriteti i saj nuk u shtri në të gjithë tërësinë territoriale në përputhje me identitetin kombëtar, si zgjidhje të "krizës së identitetit" e të "krizës së depërtimit". Ajo nuk arriti të afirmojë legjitimitetin si "qeveri e vetme". Veprimtaria e saj u ndërpre me fillimin e Luftës së Parë Botërore.

U deshën të kalonin disa vite që më 1920 të mundësohej thirrja e **Kongresit të Lushnjës** me delegatë të krahinave të zgjedhur pa votim, por me mandate përfaqësues. Kuvendi i Lushnjës sanksionoi institucionet e qeverisjes. U formua Këshilli Kombëtar, Senati, Qeveria.

Krijimi i **Këshillit Kombëtar** përbënte përvojën e parë drejt një **demokracie parlamentare**, megjithëse zgjedhja e deputetëve nuk u mbështet në praktikat parlamentare[2]. Ndërkohë u shënua një hap përpara me vendimin për hartimin e Ligjit Elektoral dhe organizimin e zgjedhjeve për në Asamblenë Kushtetuese. Zanafilla e partive politike u shpreh në formimin e partive politike të përkufizuara si **parti elitare parlamentare. Arsyeja është fakti që ishin** të karakterizuara nga anëtarësia partiake tepër e kufizuar dhe se veprimtaria e tyre ishe e kufizuar kryesisht në parlament.

Emërtimi "parti elitë" u plotësua me atë, parlamentare, kur më 10 tetor 1920 një grup deputetësh të Këshillit Kombëtar shpallën programin politik me emrin e **Partisë Popullore Kombëtare** dhe vendimin për të konkurruar në zgjedhjet e reja elektorale. Në të bënin pjesë personalitete si Fan Noli, Ahmet Zogu, Eshref Frashri, Luigj Gurakuqi, Stavri Vinjau..etj.

Në nëntor të po atij viti (1920) deputetë të tjerë shpallën krijimin e **Partisë Përparimtare (Demokratike) Shqiptare.** Drejtues të saj ishin Hoxhë Kadriu, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Shefqet Verlaci[3].

Këto parti, parë në këndvështrimin tim, kishin **karakterin e partive elitë parlamentare** për disa arsye:

1. **U mungonte struktura organizative partiake,** në sekretariat, komitete partiake, organizata bazë të partisë që vepronin në shkallë vendi. **Anëtarësia** në to ishte mjaft e kufizuar. Po ashtu veprimtaria e tyre ishte e kufizuar vetëm në parlament.

2. Ato ishin larg të qenit **si parti klasore,** siç ishin në fillimet e tyre partitë politike në vendet e zhvilluar. Kjo reflektonte shkallën e pluralizmit ekonomik e social të Shqipërisë në vitet 1920. Mbizotëronte bujqësia, artizanati e zejtaria dhe struktura sociale me diferencime ndërmjet pronarëve të mëdhenj të tokave dhe masës dërrmuese të fshatarëve më me pak tokë dhe

[1]Krasniqi, A. Partitë....e cituar, fq.38.
[2]Krasniqi, A. Po aty, fq.47.
[3]Duka, Valentina, Historia e Popullit Shqiptar.

pa tokë; të pak sipërmarrësve të disa punishteve me një numër të vogël të punëtorëve të punësuar në to; të zejtarëve; artizanëve si dhe profesionistëve me një numër të kufizuar.

3. Kishte vështirësi në përcaktimin e tyre në **spektrin partiak,** me parti të kahut të Majtë, të Qendrës e të Djathtë. Atyre iu mungonin alternativa të mbështetura në bazë të platformave ideore, si të liberalizimit, konservatorizmit, social demokracisë. Kjo ishte arsyeja e pranisë të përqasjeve në programet e tyre.

Sidoqoftë, është për t'u shënuar zotimi i tyre në funksion të sigurimit të pavarësisë e të sovranitetit kombëtar, mbi të gjitha territorit shqiptar si edhe nëpër ndërmarrje serioze për zhvillimin dhe modernizimin e shtetit[4].

Për të gjitha këto arsye realizimi i cilësisë së konkurrencës e të konsensusit, që i atribuohet partive politike në demokraci nuk ishte mbi bazën e alternativave ideore, por të një **konkurrence për pushtet.** Kështu, në periudhën qershor- dhjetor të vitit 1923 parlamenti (jo mbi bazën e zgjedhjeve elektorale) u përfshi në **ndryshimin e pesë qeverive.**

Të dy partitë politike të krijuara u karakterizuan nga **prania e fraksioneve,** e, për rrjedhojë, ndodhi përçarja në gjirin e tyre, që u shoqërua me **organizime të reja e po ashtu me emërtime të reja.** Ndodhi shpërbërja në Partinë Popullore Kombëtare. Zogu krijoi një parti me emrin **Parti Popullore** që u njoh më shumë si Partia Qeveritare ose Shoqëria Konservatore "Klika", ndërsa Fan Noli dhe përkrahësit e tij krijuan **Partinë Demokratike**.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 1920, **mbeti vetëm si supozim shndërrimi i këtyre partive në parti elektorale të masës.**

E vërteta ishte se sistemi elektoral i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Asamblesë Kombëtare afirmonte të drejtën e votës atyre që kishin mbushur moshën 18 vjeç dhe zgjedhjen e një deputeti për çdo 8 mijë banorë. Por ishin disa arsye që pjesëmarrja si në zgjedhjet e vitit 1921 dhe të vitit 1923 të mos arrinte në më shumë se 20%. Ato kishin të bënin me prapambetjen e madhe ekonomike e sociale të vendit. Vetëm 13% e popullsisë jetonte në qytet. Mbizotëronte një shkallë e lartë e analfabetizmit[5].

Si rezultat i zgjedhjeve, në fillim të vitit 1924, parlamenti përbëhej nga tri grupime: Partia Qeveritare (konservatore); Partia Popullore; Partia Demokratike dhe grupi i deputetëve të pavarur. Të tria grupimet nuk kishin ndryshime thelbësore në përmbajtjen ideore, alternativave të programeve të tyre politike. Ato u përfshinë në **Konkurrencë për të zënë poste në qeverisje.** Për rrjedhojë pati ndryshime të shpeshta të kabineteve qeveritare.

Ecurisë drejt afrimit të partive elektorale të masës i dhanë një **goditje të madhe ngjarjet e qershorit të vitit 1924.** Ato u paraprinë nga organizimi

---

[4]Krasniqi, A. Partitë....e cituar, fq.50.

[5]Duka, Valentina, Historia cituar.

dhe veprime jashtinstitucionale, si protesta masive në Vlorë, zgjedhja e një Komuniteti politik të njohur edhe si "Mbledhja Kombëtare" me në krye Fan Nolin dhe në veri të vendit filluan veprimtari ushtarake nën drejtimin e Bajram Currit.

Me 10 qershor 1924 me rënien e qeverisë ekzistuese u krijua një Qeveri e Përkohshme me kryeministër Fan Nolin. Për herë të parë u dëshmua për formimin e një qeverie me një program të**mbështetur në platformën liberale e demokratike,** me të cilën argumentoheshin kryerja e reformave ekonomike e sociale dhe të modernizimit ekonomik.

Si këto zhvillime ndikuan në sistemin partiak e në formësimin e partive elektorale të masës?

Sistemi politik i demokracisë liberale ndryshe nga sistemet e tjera e mbështet **legjitimitetin e tij,** të përkufizuar procedural, ligjor e racional **në pëlqimin dhe miratimin e elektoratit masiv** i dhënë përmes zgjedhjeve elektorale të rregullta e periodike. Kështu realizohet edhe sovraniteti popullor në kuptimin e ri si qeverisje e shumicës me respektin e pakicës. Po kështu, sistemi i demokracisë liberale e shpreh epërsinë e tij përmes **qarkullimit të elitave qeverisëse**, është elektorati që me zgjedhjet e radhës penalizon qeverinë të cilën e ka votuar për arsye të paefektshmërisë në qeverisje me realizimin e premtimeve të bëra elektoratit.

Siç shkruan A. Krasniqi, "*gabimi më i madh i qeverisë së drejtuar nga Noli ishte **refuzimi për të legjitimuar qeverisjen e tij përmes zgjedhjeve.** Në kundërshtim me kërkesat e Perëndimit dhe zërat liberal për organizimin e zgjedhjeve të reja, të cilat mund ta ndihmonin qeverinë në rrugën e saj të reformave, Noli dhe përkrahësit e tij refuzuan zgjedhjet*"[6]

Ndryshe veproi Ahmet Zogu, i cili hyri me ushtrinë e tij në Tiranë më 13 dhjetor 1924 dhe mori drejtimin e vendit. Kthimin e tij ai e shpalli kthim të Legalitetit, duke nënkuptuar **kthimin e parlamentit dhe të qeverisë** së dalë nga zgjedhjet e vitit 1923 dhe që ishte përmbysur në qershor të vitit 1924.

Me 31 janar 1925, Asambleja Kombëtare shpalli **Republikën Shqiptare** me president Ahmet Zogun me mandat 7-vjeçar. Republika kishte tipare të një republike presidenciale. Zogu, "***i dha fund demokracisë së brishtë parlamentare** dhe vuri politikën nën kontrollin e tij të plotë*"[7].

Kalimi në **monarki**, përkoi me ekzistencën e regjimeve monarkike e autoritare në Ballkan e në vendet e Evropës Qendrore, si dhe regjimeve totalitare fashiste në Itali, ardhja më pas në pushtet i nazistëve në Gjermani.

*Parlamenti në monarkinë shqiptare funksionoi nën kontrollin e plotë të mbretit dhe me gjithë lirinë e mendimit të shprehur përmes mediave të shumta, **pluralizmi partiak u suprimua**[8]**.***

---

[6]Krasniqi, A. Partitë....e cituar, fq.69.

[7]Krasniqi, A. Partitë....e cituar, fq.71.

[8]Krasniqi, A. Partitë....e cituar, fq.88.

Periudha e Luftës së dytë Botërore solli zhvillime të reja, si:

- Krijimi i **Partisë Fashiste Shqiptare** e zotuar në përhapjen e ideve fashiste dhe si një alibi e mbështetjes shqiptare për pushtimin, por që shpërndarja e saj u bë menjëherë pas kapitullimit të Italisë, në vjeshtën e vitit 1943.

- Krijimi **i Partisë Komuniste** më 8 nëntor 1941, nga bashkimi i grupeve komuniste, e cila, siç shkruan H. Hibbert, në mars të vitit 1943 ishte bërë përfundimisht një parti plotësisht e organizuar, me shtrirje të gjerë[9] e që në vazhdim me përvetësimin e ideologjisë komuniste e të rolit në LANÇ-it, do të pretendonte si e vetmja forcë politike që i takonte të merrte pushtetin e vendosjen e pushtetit popullore "diktatura e proletariatit".

- Krijimi i **Ballit Kombëtar** si kundërpeshë e Partisë Komuniste, por që fati i tij u përcaktua me mbarimin e luftës.

- **Legaliteti,** si parti mbretërore me synimin e rikthimit të regjimit monarkik, pati të njëjtin "fat" si Balli Kombëtar.

Gjithçka do të ndryshonte pas Luftës së Dytë Botërore, nën udhëheqjen e partisë - shtet deri në rënien e murit të Berlinit dhe krijimin e sistemit shumë partiak të pas viteve 90.

[9] Hibbert, H.: Fitorja e Hidhur –LNÇSH, Tiranë, 1993.

ANALIZË E ROMANIT "NJË JETË E RE" SIPAS ETIKËS DEONTOLOGJIKE TË KANTIT

Shpëtim Madani
Akademia e Forcave të Armatosura, Tiranë
madanishpetim@gmail.com

Abstrakt: *Ky artikull analizon romanin "Një Jetë e Re" të shkrimtarit hebreo-amerikan Bernard Malamud (1914-1986) nga këndvështrimi i etikës deontologjike të Kantit. Studimi hedh dritë mbi pikëpamjet kryesore të Kantit për moralin duke parashtruar konceptet e ndërlidhura të detyrës, vullnetit të lirë dhe tri formulimet e imperativit kategorik, të cilat përbëjnë bazën e filozofisë morale të Kantit. Analiza fillon me një hyrje të shkurtër në teorinë morale të Kantit, për të vazhduar me zbatimin e saj në veprën letrare në fjalë.*

Fjalët kyçe: *Detyrë, vullnet i lirë, etikë, imperativ kategorik*

Abstract

This article analyzes the novel "A New Life" by Jewish-American writer Bernard Malamud (1914-1986) from the perspective of Kant's deontological ethics. The study sheds light on Kant's major views about morality by putting forward the interrelated concepts of duty, free will, and the three formulations of the categorical imperative, which constitute the basis of Kant's moral philosophy. The analysis begins with a short introduction into Kant's moral theory, to proceed with its application in the literary work in question.

Key words: *Duty, free will, ethics, categorical imperative*

1. Hyrje

Etika deontologjike (nga greqishtja: '*deon'* që do të thotë *'detyrë'* ose *'detyrim'*) është teoria etike që vë theksin te cilësimi i një veprimi si i drejtë ose i gabuar, pavarësisht nga përfundimi apo pasojat e tij. Ajo shihet në antitezë me etikën teleologjike, e cila e përcakton një veprim të drejtë apo të gabuar në varësi të rezultatit apo pasojave të tij. Imanuel Kanti i përket etikës deontologjike. Si ndër përfaqësuesit kryesor të Iluminizmit, ai aplikoi një qasje racionale "*a priori"*, për sa i përket ekzistencës dhe krijimit të një sistemi të qëndrueshëm vlerash morale, duke besuar se veprime të caktuara janë të drejta ose të gabuara, pavarësisht nga ndjesitë tona dhe pavarësisht nga rezultati i këtyre veprimeve. Për shembull, Kanti shprehej se në çdo lloj rasti apo rrethane ishte moralisht e gabuar të gënjeje.

Morali për Kantin është koncept racional që i dallon njerëzit nga kafshët. Meqenëse këto të fundit kryejnë veprime të nxitura nga dëshirat dhe

instinktet – e jo nga arsyeja - veprimet e tyre nuk mund të quhen morale. Ndryshe ndodh me njerëzit, të cilët e kanë kapacitetin për të reflektuar dhe për të realizuar zgjedhje dhe veprime racionale, të pandikuara nga rrethanat, besimi apo doktrinat fetare.

Në veprën e tij kryesore,*Baza e Metafizikës së Moraleve* (1785), Kanti thekson se ajo çka e bën një njeri të quhet i mirë është zotërimi i vullnetit të mirë, i cili udhëhiqet nga ligji moral. Koncepti i vullnetit të mirë i referohet vendosmërisë së individit për të marrë vetëm ato vendime që kanë vlerë morale dhe sjelljes së tij që bazohet në këto konsiderata morale. Kjo natyrë apo karakter i tillë, sipas Kantit, do të vlerësohej shumë nga të gjithë ne. Ky vullnet i mirë, sipas Kantit, është i tillë pa kufizim. "Është e pamundur të mendosh ndonjë gjë në botë apo dhe jashtë saj, që mund të shihet si e mirë pa kufizim, përveç vullnetit të mirë" (B, 1997, f.7). Kjo do të thotë se vullneti i mirë është plotësisht i tillë dhe nuk zbehet ose cenohet nga asgjë e keqe apoe dëmshme që e rrethon. Ndryshe ndodh me veti të tjera të së mirës, si: lumturia, guximi, pushteti etj., të cilat transformohen në mënyrë negative, kur ndikohen nga faktorë të jashtëm destruktivë apo karakterizohen nga një vullnet jo i mirë. Për shembull, kënaqësia që *përftohet* nga goditja e një kafshe të pafajshme apo pushteti që shfrytëzohet për interesa personale, nuk sjellin asnjë të mirë, por vetëm sa u japin forcë regresive veprimeve në fjalë.

Sipas Kantit, një vullnet i mirë është i tillë, pavarësisht nga efekti i tij. "Një vullnet i mirë është i mirë jo për ndikimin apo arritjen që sjell; është i mirë vetëm falë forcës së vet të vullnetit, d.m.th, i mirë në vetvete" (B, f.8). Kjo do të thotë që edhe nëse vullneti i mirë nuk arrin qëllimin e mirë të synuar, edhe nëse dështimi është rezultati i tij final, "ai ndriçon si gur i çmuar për veten, si diçka që ka vlerë të plotë në vetvete"(B, f.8). *Forca e vullnetit,* e cila karakterizon vullnetin e mirë, "nuk është thjesht një dëshirë, por bashkim i të gjithave mjeteve të mundshme që kemi nën kontroll" (B, f.8). Ajo nënkupton vendosmërinë dhe zgjedhjet e duhura drejt një qëllimi.

Ndonëse në fillim te*Baza e Metafizikës së Moraleve* Kanti i jep atribute absolute vullnetit të mirë, parimi i moralitetit fillon, para së gjithash, nga koncepti i detyrës (apo veprimit nga detyrimi moral) i cili , për Kantin, nuk ndërkëmbehet me atë të vullnetit të mirë. Ai sqaron se detyra është vullneti i mirë që operon sipas "disa rezervave dhe pengesave subjektive, të cilat, sidoqoftë, jo vetëm që nuk e fshehin apo bëjnë atë të padallueshëm, por përkundrazi e lartësojnë dhe e lënë atë të ndriçojë gjithnjë e më fort" (G.10). Me fjalë të tjera, Kanti bën dallimin ndërmjet veprimit *për hir të* detyrës dhe veprimit *në përputhje me* detyrën. Në rastin e parë, vullneti i mirë vepron nga detyra e, si rrjedhojë, ka vlerë morale. Ndërsa, në rastin e dytë, vullneti i mirë nuk vepron nga detyra, kështu që veprimi nuk ka vlerë morale, sepse nuk përfshihet asnjë shtrëngim i brendshëm moral në kryerjen e veprimit dhe individi është ndikuar nga nxitës të caktuar (si p.sh. interesi vetjak) që nuk kanë lidhje me detyrën. Kanti sjell rastin e një shitësi që ka interes të ruajë reputacionin e biznesit, kështu që tregohet i ndershëm me të gjithë blerësit.

Meqenëse interesi personal është arsyeja kryesore për sjelljen e tij korrekte, nuk përfshihet asnjë rezervë e brendshme, kështu që ai nuk vepron nga detyra. Pra, veprimi i nxitur nga dëshirat apo gjendja emocionale nuk kanë vlerë morale. Kanti paraqet, gjithashtu, rastin e dy filantropëve, ku njëri, nga keqardhja, ka dëshirë të madhe t'i gëzojë njerëzit në nevojë, ndërsa tjetri që ndihmon jo nga dëshira, por për hir të detyrës:

Supozoni, atëherë, që mendja e këtij filantropi ishte e kapluar nga dhimbja e tij, gjë që i kishte shuar çdo keqardhje për fatin e të tjerëve dhe, ndërsa i kishte ende mundësitë për t'u dhuruar të tjerëve në nevojë, hallet e tyre nuk e prekën atë, sepse i mjaftonin të vetat. Dhe supozoni tani që, megjithëse nuk ka asnjë predispozim për një gjë të tillë, ai prapëseprapë, kundër pandjeshmërisë së tij të tmerrshme, e bën veprimin pa dëshirë, thjesht nga detyra; atëherë veprimi ka vërtet vlerë morale" (G.12).

Duke i dhënë përparësi të dukshme veprimit të nxitur nga detyra dhe jo nga ndjenjat apo emocionet, veprimi i filantropit të dytë është, për Kantin, në respekt të ligjit moral.

Këtë ligj moral, nga i cili rrjedhin të gjitha detyrat dhe detyrimet tona, Kanti e quan *imperativi kategorik*, ku parashtron tri formulime të tij:

IK-1: *Vepro vetëm në mënyrë të tillë që vullneti ta vlerësojë veten njësoj sikur po arrin nëpërmjet maksimës së tij ligjin universal* (B, p.31). Ky formulim quhet ndryshe dhe Formula e Ligjit të Natyrës apo Parimi i Universalizimit. Një gjë e tillë do të thotë që me veprimet tona nuk duhet të dëmtojmë apo lëndojmë të tjerët duke aplikuar sjellje me dy standarde, por çdo veprim duhet të konceptohet dhe realizohet si pjesë e ligjit universal. Për shembull, kemi rastin e një individi që bën një premtim të rremë për të siguruar një hua, nga njëra anë, dhe huadhënësin që ka investuar besimin e tij te huamarrësi, nga ana tjetër. Nëse do të konsiderohej normale të gënjyerit, sa herë të lindte nevoja, atëherë nuk do të ekzistonte besimi dhe, si rrjedhojë, as premtimi. Meqenëse nuk do të universalizohej maksima, atëherë premtimi i rremë do të ishte moralisht i palejueshëm.

IK-2: *Vepro në mënyrë të tillë që të tregosh humanizëm, si ndaj vetes, ashtu edhe të tjerëve, gjithmonë si qëllim, kurrë thjesht si mjet* (B, p.38). Ky parashtrim quhet ndryshe dhe formula e respektit për veten dhe njëri-tjetrin, ideja themelore e dinjitetit njerëzor.

IK-3: *Vepro në mënyrë të tillë që përmes maksimës tënde të bëhesh gjithmonë ligjvënës në mbretërinë universale të qëllimeve* (B, p.41). Ky parashtrim është një kombinim i dy formulimeve të mësipërme dhe i referohet parimit të autonomisë, i cili është dhe thelbi i teorisë morale të Kantit.

Kur e ndjekim këtë parim, ne e konsiderojmë veten si qytetarë ligjvënës në mbretërinë e qëllimeve. Mbretëria e qëllimeve mund të konceptohet ose si një lloj republike demokratike, 'një bashkim sistematik i qenieve racionale përmes ligjeve të përbashkëta' që qytetarët i bëjnë vetë; ose si një sistem i të gjitha qëllimeve të mira 'një tërësi qeniesh racionale si qëllim në vetvete dhe

përcaktimi si qëllim që secili bën për veten.' Ligjet e mbretërisë janë ligje të lirisë, sepse ajo është tregues i qytetarëve të lirë për të krijuar ligjet e veta dhe sepse përmbajtja e atyre ligjeve na drejton për të respektuar lirinë e përdorimit të arsyes të çdo qytetari. Një gjë e tillë është burimi i dinjitetit që i atribuojmë qenies njerëzore (G.41).

Është pikërisht koncepti i këtij dinjiteti njerëzor që konsiderohet si shprehje e vlerës së pakushtëzuar të vullnetit të mirë. Si dhe, nga ana tjetër, theksohet ideja e lirisë politike si autonomi. Me fjalë të tjera, një shtet është i lirë kur autoriteti legjitim i ligjeve të tij përfaqëson vullnetin e qytetarëve të vet, të cilët janë të lidhur nga këto ligje. Përmes sjelljes së tij racionale, secili individ është kontribues dhe përgjegjës për zbatimin e tyre.

Sipas Kantit, *imperativi kategorik* nënkupton komanda apo rregulla morale absolute dhe universale, të udhëhequra vetëm nga arsyeja, të cilat duhen zbatuar pavarësisht nga rrethanat apo dëshirat e individit. Për shembull, kemi: Mos gënje asnjëherë. Studio shumë etj.. Nga ana tjetër, imperativi hipotetik, ku zbatimi i një komande apo rregulli moral varet nga dëshirat e individit për arritjen e një qëllimi të caktuar dhe nuk konsiderohet universale apo absolute. Ato paraqiten në formën e fjalive kushtore apo hipotetike. Për shembull, kemi: Mos gënje, nëse nuk është e domosdoshme. Studio shumë, nëse dëshiron të gjesh një punë të mirë.

2. Etika Deontologjike e Kantit në roman

Fabula e romanit *Një Jetë e Re* (A New Life [1961]) ka në qendër heroin Seimor Levini, një mësues i ri anglishteje që vjen nga Nju Jorku në Kolegjin e Kaskadias në Perëndim, për të dhënë mësim në departamentin e anglishtes, ku ngrihet kundër kolegëve pseudointelektualë dhe krijon lidhje intime me gruan e shefit, gjë që i shkakton pushimin nga puna.

Ajo çfarë bie menjëherë në sy, është se asnjë nga personazhet nuk vepron për hir të detyrës, por të nisur nga motive personale. Ferçajldi, shefi i departamentit, mburret me librin e tij të vjetruar të gramatikës, duke e mbajtur me çdo kusht pjesë të programit, ndërkohë që mbyt çdo frymë liberale te vartësit. Po ashtu, Xhilli, eprori i tij direkt, si dhe kolegu tjetër i paaftë, Fabrikanti, kërkojnë që secili ta shfrytëzojë Levinin, me qëllim që të zgjidhen në krye të departamentit. Nga ana tjetër, Polina, gruaja e Xhillit, e lënë në harresë nga i shoqi, e sheh Levinin si një rast ideal për përmbushjen e nevojave të saj seksuale. Ndërkohë, fillimisht, as Levini nuk kryen veprime me vlerë morale, por udhëhiqet nga dëshirat personale, duke i trajtuar të tjerët si mjet për të arritur qëllimin. Duke qenë viktimë e dobësisë së tij sensuale, ai karakterizohet nga një epsh i theksuar për gratë. Tri aventurat e tij të para të pasuksesshme seksuale me kamerieren Laverne, kolegen Avis Flis dhe studenten Nadalinë, e paraqesin atë si një endacak që nuk e lidh moralin me seksin. Edhe takimet me Polinën nuk i konsideron përtej aventurës.

Megjithatë, forca e tij e vullnetit për të kryer veprime morale sipas imperativit kategorik është ende e dobët, sepse Levini në planin personal

vjen nga një e kaluar e errët me varësi alkooli dhe mendime për vetëvrasje. Që në faqet e para, ai e deklaron këtë gjë: "Jeta ime...ka qenë pa ndonjë qëllim të qartë në vetvete. Disa ia vënë fajin kohëve, ndërsa unë vetes...Në të kaluarën, kam mashtruar veten dhe shkatërruar zgjedhjet e mia" (f.14). Duket qartë se mungesa e respektit për veten e pengon atë të respektojë të tjerët. Në librin e tij "*Metafizika e Moraleve"* (1797) , Kanti shprehet se e kemi për detyrë të njohim dhe tregojmë vlerësim ndaj vetes, përndryshe nuk mund të shfaqim vlerësim për dinjitetin e askujt. Detyrimi fillestar është për veten, domethënë, për humanizmin në personin tonë (MM, 1996, f.209). Një individ duhet të jetë plotësisht human për t'i trajtuar të tjerët po me të njëjtën shkallë humanizmi. Në këtë drejtim, studiuesi Roger J. Sullivan, në librin e tij "*Një Hyrje në Etikën e Kantit"* (1996) thekson:

Pyetja kryesore duhet të jetë: çfarë lloj personi po bëhet vetja ime? Dhe përgjigja që duhet të japim është se po bëjmë çdo gjë që është e mundur për të kultivuar vetërespekt. Më shumë se gjithçka tjetër, një gjë e tillë do të na motivojë të bëhemi ai lloj individi që duhet të jemi dhe të jetojmë jetën që duhet (f.154).

Në këtë prizëm, Levini ende luan me dy standarde, në shkelje të plotë me formulimin e parë të imperativit kategorik: nga njëra ruan lidhjen e fshehtë me gruan e eprorit direkt - ndonëse e kupton se: "Duhet ta kontrolloj veten. Duhet të di gjithmonë se ku jam" (f.191) - nga ana tjetër, kritikon tekstin e Ferçajlldit apo kolegë të tjerë. Sidoqoftë, Levini nuk është njeri që nuk reflekton apo nuk përpiqet t'i japë jetës një drejtim racional dhe moral. Që në fillim, ai i rrëfen Polinës, fill pas mbërritjes në shtëpinë e tyre: "Unë udhëhiqem nga disa ideale...Ato i japin vlerë njeriut, nëse ai u del për zot" (f.14). Pikërisht, këtu qëndron sfida më e madhe e tij: kontrolli i dëshirave personale dhe përkushtimi ndaj së mirës së përbashkët.

Levini i njeh përparësitë e tij që në fillim. Vjen në Kolegjin e Kaskadias si një njeri i reformuar, i cili shpreson se do të materializojë idealet e tij humaniste në një mjedis të ri. Ndryshe nga kolegët e tij, mban një qëndrim liberal, sepse, sipas tij, "Liberali i vërtetë, me entuziazmin e vet moral, mbante gjallë idealin vizionar...dhe luftonte me çdo forcë për ta shndërruar në një jetë më të mirë për njerëzit..."(f.201). Në këtë mënyrë, Levini, humanisti liberal, mendon se njeriu mund t'i mbijetojë padijes dhe mizorisë vetëm duke u bërë mirë të tjerëve: "Ata që e kishin zbuluar guximin e tyre moral, apo e kishin gjetur atë, duhet t'u bashkohen të tjerëve që janë të moralshëm; këta duhet të udhëheqin, pa fanatizëm. Çdo vepër mirësie është zvogëlim i së keqes në botë" (f.227).

Levini vjen në Perëndim për të vënë në jetë identitetin e ri, në përputhje me idealet e tij të reja. Qëllimi i tij është "të ndihmojë njerëzimin, pavarësisht nga rreziku i përgjithshëm, ankthi, cenimi i vazhdueshëm i lirisë dhe shtypja e njeriut" (f.203). Ndërsa jep mësim në kolegj, Levini parashtron idenë e përfshirjes së arteve liberale në kurrikulën e Fakultetit të Arteve, me qëllim që t'i ndihmonte studentët e tij të rriteshin shpirtërisht, duke u mësuar atyre se "çfarë të shkruajnë", përveç "si të shkruajnë" (f.101). Aspiratat e Levinit

burojnë nga idealet e tij humaniste dhe ai ngrihet me forcë kundër qëndrimeve të mbrapshta të kolegëve të tij. Ai lufton në mënyrë të pandërprerë për idealet e tij të lirisë, dashurisë dhe vëllazërimit. Levini udhëhiqet nga ideja se:

Në parim, ai nuk duhet të ketë frikë. "Ajo pak gjë që bën mund të nxitë personin tjetër të bëjë më shumë. Nuk është i nevojshëm një revolucion i dhunshëm për të ndryshuar një vijë veprimi apo institucion. Gjithçka që duhet është një ide e mirë dhe një njeri me guxim. Dikush që e di se idetë historikisht të suksesshme të Amerikës kanë qenë liberale dhe radikale, duke vazhduar revoltën për çështjen e lirisë. 'Fatkeqësia ndodh nëse një vend braktis përfundimisht të kaluarën e tij radikale' – R.Çejs. Mos ki frikë nga të ligjtë. Mos harro se njeriu që përbuz idealistin përbuz imazhin e fshehtë të tij." [Blloku i Levinit: "Ndriçime"] Mos ki frikë nga emrat. Qëllimi yt si njeri i përmirësuar vetë është ta ndihmosh njerëzimin, pavarësisht nga rreziku i përgjithshëm, ankthi, tradhtia e vazhdueshme e lirisë dhe shtypja e njeriut. Si pedagog, ai do të bënte gjithçka të mundur për t'i nxjerrë përpara ata pak individë të talentuar që do të bënin më shumë sesa u kishin mësuar pedagogët e tyre, në emër të demokracisë dhe humanizmit (f.203).

Ai nis fushatën kundër qëndrimit të pafavorshëm të autoriteteve ndaj arteve liberale, qëndrim që tradhton antipatinë e tyre për rritjen e shpirtit të njeriut dhe mosrespektin për dinjitetin njerëzor.

Levini është i zhgënjyer me mësimdhënien e tij. "Shqetësohem se nuk po jap mësim si të ruaj qytetërimin nga vetëshkatërrimi" (f.101). Ai dëshiron t'u përcjellë studentëve të tij perceptimin e vet për jetën përmes arteve liberale.

Pra, përveç drejtuesve mendjengushtë dhe të vetëkënaqur, Levini ndihet i zhgënjyer edhe nga ambiciet e vetë studentëve. Këta të fundit nuk duken të shqetësuar se, që të ruajnë jetën e tyre të patrazuar, ata jo vetëm që kanë hequr dorë nga përgjegjësia ndaj vetes, duke mos i vënë gjërat në pikëpyetje apo hulumtuar, por edhe ndaj shoqërisë që ekziston jashtë kufijve të utopisë së tyre. Studentët nuk duan t'ia dinë për idetë apo të respektojnë intelektin: të menduarit në mënyrë kritike mund t'i cenojë mjediset e Arkadias. Ata mbivlerësojnë dobinë e pragmatizmit, jo rastësisht, meqenëse një arsimim "praktik" siguron mbijetesën e komunitetit të tyre agrar. Jeta e mirë, sipas tyre, lidhet me vënien në funksion të standardeve të efikasitetit të mësuara nga teknologjia. Ata kanë frikë nga inovacioni dhe ndryshimi. Ajo çka duan kushtëzohet nga sipërfaqësorja, thuajse, kërkesa foshnjarake që janë pjesë e kësaj parajse të veçantë: zanate të mira, skuadra fituese, si dhe gjetja e rrugës më të lehtë. Levini mendon se studentët duhet të mësojnë të shkruajnë për jetën, si dhe për idealet e dashurisë dhe lirisë së përbashkët, duke pasur si qëllim përmirësimin e fatit të njeriut në një botë të padrejtë. Megjithatë, Levini vazhdon të japë mësim, duke u ngritur mbi zhgënjimin e tij dhe ndjenjën e dështimit, sepse studentët e tij "ishin qenie njerëzore dhe me mundësi" (f.241). Ai citon filozofin Xhon Milli: "Njerëzit janë njerëz, përpara se të jenë juristë, mjekë apo fabrikantë..."(f.242).

U theksua më lart se parimi themelor i imperativit kategorik është vullnetit autonom, i cili e bën individin ligjvënës në mbretërinë e qëllimeve. Kanti dallon autonominë nga heteronomia, e cila është "burimi i të gjitha parimeve joautentike në lidhje me moralin. Nëse vullneti kërkon ligjin, atëherë e drejton atë kudo tjetër, përveçse në favor të maksimës së tij për ligjin universal...Kjo sjell gjithmonë *heteronominë*" (G.47). Pra, një vullnet heteronom është i influencuar nga individë të tjerë apo dëshira të caktuara. Në këtë mënyrë, për një kohë të konsiderueshme, Levini karakterizohet nga një vullnet heteronom. Megjithatë, qëndrimi i tij racional dhe moral bëhet real, kur ai ndalon së mbështeturi Fabrikantin kundër Xhillit në zgjedhjet për shef departamenti, në momentin që zbulon se ai [Fabrikanti] është oportunist, konformist dhe njeri pa dinjitet. Po ashtu, i kundërvihet dhe Xhillit, i cili kërkon të bëhet shef dhe të ruajë statuskuonë.

Duke e parë nivelin e ulët të të dyve, Levini vendos ta hedhë vetë kandidaturën. Si kandidat ai i sugjeron dekanit mundësinë e futjes së programit të Librave të Mëdhenj, duke synuar hapjen e bashkësisë së mbyllur të fakultetit, përmes shkëmbimit të qëndrimeve, mendimeve dhe përshtypjeve të reja – si kritikë e nëndheshme e modeleve të vjetruara. Ndërkohë, në momentin që fillon fushatën, ai shkëputet plotësisht nga Polina, por një lidhje e tillë është zbuluar tashmë nga Xhilli. Kjo gjë i shkakton Levinit humbjen e zgjedhjeve dhe vendit të punës. Megjithatë, Levini largohet nga Kolegji me dijen se ka mundësuar disa ndryshime tashmë: libri i gramatikës së Ferçajlldit është hequr pas tridhjetë vitesh. Po ashtu, Xhilli po merr parasysh t'u ofrojë orë letërsie disa pedagogëve që merren me studentë pasuniversitarë. Ndërkohë, dekani ka kërkuar edhe futjen e programit të Librave të Mëdhenj. Vullneti i tij i mirë që shkon përtej çdo interesi personal, ka vlerë të plotë praktike dhe morale.

Në planin personal, me vullnetin e tij tashmë tërësisht të lirë, ai vendos të martohet me Polinën dhe të kërkojë kujdestarinë e të dy fëmijëve të saj. Ndonëse ndjenjat e tij nuk janë të forta si më parë, ai ndien përgjegjësi për ta dashuruar atë. I habitur për këtë vendim, Xhilli e pyet se çfarë ka ndërmend të bëjë me një grua jo të besueshme dhe më të madhe në moshë, me dy fëmijë të adoptuar, si dhe pa perspektivë pune. "Pse ta marrësh atë barrë mbi vete?" Ndërkohë, Levini ia kthen prerë: "Sepse mundem, bir bushtre" (319). Përmes kësaj shprehjeje të shkurtër dhe të fuqishme, Levini vërteton se, sipas etikës kantiane, ka kurorëzuar veprimin për hir të detyrës, pavarësisht nga pengesat e brendshme. Një veprim i tillë ka vlerë të mirëfilltë morale dhe është tregues i përmbushjes së imperativit kategorik.

3. Përfundime

Thelbi i etikës deontologjike të Kantit është veprimi për hir të detyrës, paravarësisht nga qëllimet, dëshirat apo rrethanat e individit. Detyra, për Kantin, është shprehje e vullnetit të lirë të individit që, me gjithë rezervat e brendshme, merr vendime me vlerë morale, në respekt të ligjit moral suprem – imperativit kategorik. Ky imperativ i drejtohet qenies njerëzore racionale, e cila e ka detyrim moral respektin ndaj vetes dhe tjetrit, duke mos

e trajtuar asnjëherë as veten dhe as të tjerët si mjet, por gjithmonë si qëllim. Me sjelljen dhe veprimet e tij, çdo njeri duhet të udhëhiqet nga parimet e ligjit universal që krijon bazat e një shoqërie të mirë dhe të lirë, ku individi racional konsiderohet si ligjvënës. Siç thekson dhe Christine Korsgaard, në hyrjen e saj për *Bazën e Metafizikës së Moralit*: "Morali, sipas Kantit, është një lloj metafizike në praktikë. Jemi vetë ne që imponojmë ligjet e arsyes mbi veprimet tona, dhe përmes veprimeve tona pastaj në botë, kur veprojmë në mënyrë morale" (G.xxiv).

Etikadeontologjike e Kantit gjen zbatim të dukshëm edhe në romanin "Një Jetë e Re". Heroi i veprës, Levini, arrin në fund të zbatojë plotësisht parimet e imperativit kategorik, në sajë të aftësisë së tij për të kontrolluar instinktet dhe dëshirat personale, me qëllim kryerjen e veprimeve racionale me vlerë morale, si në planin personal ashtu edhe atë profesional. Aktet e tij të guximshme dhe racionale, drejt fundit të romanit, evidentojnë evoluimin e qenies së tij, aplikimin e rregullave morale në interesin e përbashkët për një shoqëri më të mirë dhe të lirë.

Referenca:

Borges, Maria (2019). *Emotion, Reason, and Action in Kant*. London: Bloomsbury Academic.

Kant, I. (1997). *Groundwork of the Metaphysics of Morals*. Cambridge University Press.

Kant, I. (1996). *Practical Philosophy*. Cambridge University Press.

Kant, I. (1996). *The Metaphysics of Morals*, Cambridge Texts in the History of Philosophy, Cambridge. New York: Cambridge University Press.

Malamud, Bernard (1980). *A New Life*. New York: Avon Books.

Sullivan, J. Roger (1994) . *An Introduction to Kant's Ethics.*Cambridge; New York: Cambridge University Press.

SINONIMIA FJALËFORMUESE NË FJALORIN SINONIMIK TË GJUHËS SHQIPE(2004).

Sashenka Kamberi[1], Vjollca Rrapai[2]

[1] Departamenti i Gjuhës Shqipe,Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër

sashakamberi@yahoo.com

[2] Departamenti i Letërsisë,Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër

vjollcarapai@yahoo.com

Abstrakt

Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe *i hartuar nga Jani Thomai, Miço Samara, Hajri Shehu dhe Thanas Feka e pa dritën e botimit në vitin 2004. Ky fjalor kryen funksionin e vet parësor, për të pasqyruar pasurinë sinonimike fjalësore të shqipes apo funksione të tjera, si ai për të rritur kopentencën leksikore e për të ndikuar në pasurimin e zhdërvjellësinë e përdoruesve të shqipes. Ndër të tjera, ai shërben dhe si një vepër që të ndihmon për të parë sinoniminë nga pika e rrafshe të ndryshme për arsye studimi.Në këtë punim iu referuam "Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe" (2004), për të vëzhguar dallimet sinonimike mes fjalëve jo të parme apo sinoniminë e përftuar gjatë fjalëformimit. Në fillim jemi ndalur në dukurinë e sinonimisë dhe dallimin mes* ***sinonimisë leksikore, sinonimisë gramatikore*** *dhe* ***sinonimisë fjalëformuese.*** *Më tej kemi vendosur theksin në sinoniminë fjalëformuese, konkretisht, në dallimet semantike dhe veçoritë stilistikore të sinonimeve të përftuara nga fjalëformimi. Shembujt e vjelë nga* ***"****Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe" (2004), shërbejnë për të konkretizuar e shpjeguar dukurinë e sinonimisë gjatë fjalëformimit.*

Fjalët kyç: *sinonimi leksikore, sinonimi fjalëformues, dallime semantike, dallime stilistikore etj..*

Abstract

The Synonyms Dictionary of the Albanian language compiled by Jani Thomai, Miço Samara, Hajri Shehu and Thanas Feka was firstly published in 2004. This dictionary performs either its primary function to reflect the synonymic and vocabulary treasure of the Albanian language , or other functions , such as the one to increase the lexical competence in order to influence the enrichment and dexterity of Albanian language users. Among other things, it serves as a work that helps consider synonymy from various viewpoints and planes for study reasons.

In this paper we referred to the Synonyms Dictionary of the Albanian language (2004), to observe synonymous pairs differences in the context of derived and compound words, or synonymy obtained in word formation. Firstly, we focused on the phenomenon of synonymy and the difference among lexical synonymy, grammatical synonymy and word-formation synonymy. Next, we put emphasis on word-formation synonymy, specifically

in the semantic differences and stylistic features of synonyms that are derived from word formation. Examples taken from the Synonyms Dictionary of the Albanian language (2004) serve to concretize and explain the phenomenon of synonymy in word formation.

***Keywords**: lexical synonymy, word-formation synonymy, semantic differences, stylistic differences etc.*

1. Hyrje

"Fjalori Sinonimik i Gjuhës Shqipe" (2004), botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i hartuar nga J. Thomai, M. Samara, H. Shehu dhe Th. Feka shërben si burim i jashtëzakonshëm për të trajtuar probleme e dukuri të ndryshme të rrafshit leksikor dhe semantik. Ndër të tjera ky fjalor shërben dhe si burim i frytshëm për të trajtuar tema që lidhen me sinoniminë fjalëformuese. Por, për të trajtuar dhe për të interpretuar saktë dukurinë e sinonimisë fjalëformuese, duhet të ndalemi në dallimin mes tri llojeve të sinonimisë: **sinonimisë leksikore; sinonimisë gramatikore; sinonimisë fjalëformuese.**

Sinonimia ka të bëjë me lidhjet e pakushtëzuara kuptimore dhe është trajtuar nga shumë autorë. Prof. Jani Thomai pranon se sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë a të afërt, duke pasur dy-tre a më shumë fjalë që shënojnë të njëjtin send, të njëjtin tipar, të njëjtin veprim a të njëjtën dukuri.[1] Me sa duket sinonimia paraqet probleme te dysia *fjalë me kuptim të njëjtë/ fjalë me kuptim të përafërt.*

Studiuesi Miço Samara pohon se: "Gjuhësia e sotme shqiptare e ka bërë dallimin ndërmjet **sinonimisë leksikore** (ku përfshihet dhe sinonimia frazeologjike me gjithë dallimet që ato kanë) dhe asaj **gramatikore.** Përmendet edhe **sinonimia fjalëformuese**, por deri tani nuk është sqaruar mirë lidhja që ajo ka me dy llojet e para të sinonimisë, sepse sinonimia fjalëformuese zë një vend të ndërmjetëm midis të parave. Termat që shënojnë këto tri lloje të sinonimisë thellojnë e saktësojnë më mirë identitetin e saj, si dhe shkallën ose përmasat e lidhjeve sinonimike ndërmjet njësive gjuhësore. Kështu, **sinonimia leksikore ka si pikënisje kuptimin e fjalës**, pavarësisht nga treguesit morfologjikë e kategoria gramatikore e saj, ndërsa **sinonimia fjalëformuese niset nga struktura formale e fjalës dhe nga gjedha e formimit, me ose pa ndajshtesa dhe nga funksionet e tyre.** P.sh., ndërmjet foljeve **çel – hap** kemi sinonimi leksikore, ndërmjet **i fisshëm – i fisëm** mund të thuhet se kemi sinonimi fjalëformuese, kurse ndërmjet shumësave **nipërit – nipat** kemi sinonimi gramatikore." [2]

Në këtë punim në pamundësi që të jemi shterues, jemi ndalur vetëm në ***dallimet semantike dhe veçoritë stilistikore të sinonimeve fjalëformuese.***

---

[1] J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f.138.

[2] M. Samara, *Probleme të sinonimisë dhe "Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*", SF, 1-2, 1999, f.167-168.

2. Dallimet semantike

Studiuesja kosovare, Shefkie Islamaj, është marrë mirëfilli me sinoniminë, ndër të tjera, pohon se *sinonimet janë fjalë që kanë një kuptim leksikor dhe ndryshojnë në nuancat e kuptimit, në ngjyrën shprehëse dhe se i takojnë kësaj apo asaj shtrese stilistikore të gjuhës.* [3]

Sinonimet në gjuhën shqipe i kemi të plota dhe të pjesshme. Sinonime të plota nuk kemi ose shfaqen shumë rrallë, sepse që të kemi të tilla, duhet :

a. Të zëvendësohen në të gjitha kontekstet;

b. Të ruhet vlera e tyre njohëse dhe afektive.

Por kjo studiuese nuk përcakton qartë kufijtë e sinonimisë gramatikore duke pranuar si sinonimi gramatikore atë që e quajmë sinonimi fjalëformuese. Ajo pohon se ***sinonimet gramatikore*** mbështeten në variantet morfologjike, që do të thotë se janë "fjalë me rrënjë të njëjtë e kuptim të afërt apo edhe të njëjtë dhe ndryshojnë vetëm në bazë të parashtesave, të prapashtesave apo dhe të fleksionit (eptimit), si *barkalec – barkaliq, barkiç, barkanoz, barkosh; dëmtues – dëmtar; zbardh- zbardhoj; kuq-skuq; fantazi-fantazira* etj[4].Pra, siç shihet, brenda një pohimi ngatërrohet sinonimia leksikore, sinonimia fjalëformuese dhe sinonimia gramatikore.

Sh. Islamaj pranon se gjuha jonë ka mundësi të mëdha për të përdorur shumë fjalë me kuptim të përafërt, por me një ngjyrim të fortë emocional. Edhe pse të gjitha fjalët e shqipes nuk marrin ngjyrim emocional, përsëri kjo është një rrugë mjaft e përshtatshme për shfaqen e sinonimisë në gjuhë. Efektet stilistike janë parakusht për ekzistencën e **varianteve sinonimike.**

Variantet sinonimike janë karakteristike si në *morfostilistikë* dhe në *morfonostilistikë* . [5]

Më tej Sh. Islamaj pohon se " po të marrim grupin e varianteve *dërdëlisje, kakarisje, xërlisje, turtulisje, xhaunisje, llomotitje* apo grupin tjetër *ha, gëlltis, kapërdij, përpij, gllabëroj, kullufis, sklup* etj., do të shohim se kemi mundësi të zgjedhim fjalën e përshtatshme që na përgjigjet." [6]

Gjuhëtari R. Memushaj i sheh në një rrafsh më diferencues e më të saktë variantet sinonimike, duke dalluar **variante semantike** (mahnitem – çuditem), **variantet afektive** (fytyrë – surrat), **variantet stilistike** (shqiptar – arbëror), **variantet sintagmatike** (përbuz – përçmoj) etj.[7]

Sinonimia krijohet nga fjalë të shqipes që mund të jenë: fjalë të gjuhës standarde – fjalë e gjuhës standarde, fjalë e gjuhës standarde – fjalë dialektore, fjalë e shqipes – fjalë fjalë e huazuar etj.. Kur sinonimia shihet si fjalë dialektore – fjalë dialektore, fjalë e shqipes – fjalë e huazuar lehtësisht mund të krijohet sinonimi e plotë. Nëse ne ndalemi në sinoniminë që krijohet

---

[3] Sh.Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 363.
[4] Sh.Islamaj, *Roli sinonimisë në pasurimin e gjuhës*, Prishtinë, f.362.
[5] Sh.Islamaj, *Roli sinonimisë në pasurimin e gjuhës*, Prishtinë, f.365.
[6] Sh.Islamaj, *Roli sinonimisë në pasurimin e gjuhës*, Prishtinë, f.365.
[7] R.Memushaj, *Hyrje në gjuhësi, Tiranë*, 2006, f.179-180.

me fjalë dialektore – fjalë dialektore, shumë shpesh mund të vërejmë *sinoniminë fjalëformuese*, e cila mund të shpërfaqet si grupe emërtimesh që nuk sjellin nuanca kuptimore a stilistikore, por më shumë tregojnë shumësinë e mjeteve fjalëformuese të shqipes që në këtë rast dalin me funksion sinonimik a të njëjtë.

Prof. J. Thomai pranon se në leksikun dialektor ne mund të dallojmë tre tipa gjuhësorë formimesh të sinonimisë.[8]

a. tipin leksikor, si *pëllumbe, çile* etj.

b. tipin fjalëformues, si *bardhë, bardhe, bardhoshe, bardhane* (dhi); *bardho, bardhel, bardhyl, bardhush, bardhan* (ka) etj.

c. tipin fonetik, ku përfshihen variante fonetike, të cilat nuk i kemi marrë si leksema të mëvetësishme, si *kuçeshë , kuçoj* (kuqeshë, kuqoj), *sjape, sjapole, sjapore* (cjape,…) ; *pështjerrë* (mështjerrë); tablore, tamlore (tamblore) ; thtujak (ftujak), thtujë (ftujë) etj.

Kështu, në shqipe gjejmë prapashtesa njëfunksionshe – (**ë)m(ë)** /**-me**, **- (ë)r**, **- t(ë),** që mund të ndërtojnë vargje (grupe) sinonimesh fjalëformuese, si *balmë (i) / balme (e) = balët (i, e) = balër (i, e)*; *mushkemë (i)/ mushkeme (e); mushkët (i,e), mushkër(i,e)* etj.

Por, nëse kërkojmë në **Fjalorin sinonimik të gjuhës shqipe (2004),** njësi të tilla nuk i gjejmë. Kjo do të thotë se njësitë sinonimike që ndërtojnë me mijëra vargje, janë, së pari, sinonime leksikore, të cilat shihen nga R. Memushi si variante semantike, apo si shprehet J. Thomai, dallohen nga nuanca kuptimore.[9]

Kështu, edhe ***sinonimet fjalëformuese*** që ne analizojmë, edhe pse shënojnë të njëjtin nocion a koncept, ato patjetër duhet të dallohen nga një tipar.

Për të parë më konkretisht këtë dukuri i referohemi grupit paradigmatik të sinonimeve fjalëformuese që lidhen me fjalën **belbër (i)**, të marrë nga Fjalori Sinonimik i Gjuhës Shqipe (2004) dhe të fjalëve sinonime të kësaj fjale, të marra nga Fjalori i Gjuhës Shqipe (2006).

BELBËR (I)*mb*., dhe si *em.* Që i mbahet goja; që nuk i shqipton mirë fjalët . **Belbët (i).Belban** shar . **Belbacak** (belbacuk). *Gjini ishte shumë belbacuk e kishte vështirësi të madhe me u përgjegjë, sidomos kur ndeshte ndonjë femër*. (Folk.). **Belbaq** shar . Belbaraq shar. **Gojaç** keq. Reporterit … i vinte e përpjetë tani që kish të bënte me një njeri kaq gojaç e të mpitë (Let. art. përkth.). **Gagaç. Gojëmbajtur**.- Që kur i ra skela e posit në kokë, Llaqit u bë e mbeti gojëmbajtur. (Ligj. fol.). **Gjuhëndalur. Gojëzënë . Gjuhëzënë. Gojëmarraq. Gjuhëmbajtur**.

Këtu dallojmë disa vargje sinonimesh fjalëformuese:

1. Vargu i parë i sinonimeve fjalëformuese është i ndërtuar me prapashtesa dhe nuk ka si tipar dallues nuancat kuptimore. Nëse do të krahasonim

---

[8]J.Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2001, f.58.
[9] J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f.139.

strukturat e tyre kuptimore, kuptohet që këtu do të kishim vetëm një strukturë të tillë, çka duket nga shpjegimi i kuptimit të mbiemrit **i belbër** dhe referimet e të gjithë mbiemrave të tjerë te ky mbiemër (struktura e tij kuptimore).

Dallimi këtu shfaqet se në cilin ligjërim a në cilin stil përdoren njëri a tjetri mbiemër. Elementet plotësuese në shpjegim për secilën njësi bëhen tregues i këtij dallimi dhe i diferencimit leksematik: *i belbër* dhe *belban* janë asnjanës, kurse *belbacak*, e dhe *belbacuk, (e)* markohen nga elementi mospërf., që na çon në ligjërimin konotativ.

belbacak ,-e*mb*. edhe si em., *mospërf.* i belbër.

belbacuk , -e mb., edhe si em., *mospërf.* i belbër.

belban , -e *mb*., edhe si em., i belbër.

belbër (i, e) [belbët (i,e)]*mb.*, edhe si em., që i mbahet goja ose që nuk i shqipton fjalët qartë.

Fjala **gagaç, -e** (i belbër.) nuk formon varg fjalëformues me njësi tjetër, por dihet qartë se ka ngarkesë të fuqishme negative, ajo është formuar nga tingullimi **ga- ga**, që më shumë vjen nga bota e shpendëve sesa nga bota njerëzore. Pra dallimi është se *i belbër* dhe *gagaç* nuk kanë sferë të njëjtë përdorimi.

2. Nëse do të pranonim se **gojaç,-e** dhe **gojac, -e** formojnë një varg sinonimesh fjalëformuese, shihet qartë se struktura e tyre kuptimore është më e gjerë sesa ajo e mbiemrit i belbër, d.m.th. dallimi këtu eshtë kuptimor dhe njësitë sinonimike dalin si variante semantike.

gojaç, - e (gojac, e) mb., edhe si em., keq. 1. Me gojë të madhe a të shtrembër. 2. Belbacak, gagaç . 3. keq . që merr të tjerët nëpër gojë; llafazan.

3. Nëse do të shohim vargun fjalëformues që lidhet me **gojë** do të shohim se *Gojëzënë* ka strukturë më të gjerë kuptimore sesa mbiemri **i belbër**, pra kemi dallim semantik. *Gojëmarraq,-e* edhe pse në Fjalori (2006) nuk është shënuar, kuptohet lehtë nga prapashtesa me kuptim keqësues që nuk është asnjanëse në ligjërim, por e ngarkuar konotativisht.

Gojëmarraq ,-e *mb.* , edhe si *em.* , *i belbër*

Gojëmbajtur*mb*. i belbër .

Gojëzënë *mb*. 1. edhe si *em*., i belbër ; që nuk flet dot, që i është zënë goja; / si *mallk*. që iu zëntë goja ! 2. fig . që nuk mund të flasë a të shprehet, sepse e pengon një shkak i fortë.

4. Nëse shohim vargun e katërt që lidhet me temën fjalëformuese **gjuhë**, edhe pse nuk markohet me elemente plotësuese, kuptohet shumë lehtë se është varg i përbërë nga njësi të cilat përdoren që të gjitha në stilin e ngritur a në letërsinë e shkruar, duke sendërtuar me vlerë të fuqishme artistike.

gjuhëmbajtur mb. i belbër.

gjuhëndalur mb. i belbër; gjuhëmbajtur.

gjuhëzënë mb. gjuhëmbajtur.

Dallimet semantike te sinonimet fjalëformuese mund të ndiqen lehtësisht dhe drejtpërdrejt edhe te klasa leksiko-gramatikore e emrave.

Po marrim për të shtjelluar dhe për të ilustruar mendimin tonë tek emrat **Shtrëngim,shtrëngesë**, si edhe **shtrëngicë** (që është në Fjalorin 2004-ës). Krahasimi mekanik i strukturave të këtyre tri njësive që janë sinonime fjalëformuese bëhet tregues, se pse ekziston sinonimia në gjuhë dhe pse gjuha nuk mban në përdorim gjëra të tepërta.

SHTRËNGES/Ë,-A*f.* 1. bised.→ **Shtrëngim,-i**. *m.* 2. Të qenët në shtrëngim a në nevojë ekonomike etj. **Shtrëngim. Nevojë. Ngushticë** (ekonomike). **Shrëngicë. Ngërmesë**. **Shtrëngatë. Rricë. Hall**. 3.→Nënbarkëz,-a *f.*

SHTRËNGES/Ë,-A*f.* 1. → **Shtrënges/ë,a** f. 2.→**Zgrip,i***m.*

SHTRËNGIM,I *m. Veprimi dhe gjendja sipas* **Shtrëngoj, Shtrëngohem. 1. Kapje. Zënie. Rrokje. Shtrëngesë. 2→Ngjeshj/e,-a** *f.* 3. **Tkurrje. Mbledhje** (e muskulit). **Dhembje** (nga shtrëngimi). 4. **Shtërzimi** (i mëmës). 5. **Detyrim**. 6.→**Zor,-i.***m.* 7.→**Frenim,-i.***m.* 8.→**Shtrënges/ë,-a**. *f.* 9. *drejt.*→ **Dhunë/ë, a** f. 10. *drejt.*→**Nxitim,-i**. *m.*

3. Veçoritë stilistikore dhe ligjërimore

Studiuesi Gj. Shkurtaj thotë se « shumë fjalë, përveç kuptimit sendor, logjik, nocionor për arsye të prejardhjes ose të pasurimit të tyre ose për shkak të ndonjë rrethane që lidhet me faktorëjashtë gjuhësor, me kohë fitojnë edhe disa veti të tjera që quhen ngjyrime stilistike ose ngarkesa shprehëse ».[10]

Fjalori i sinonimeve bëhet kështu për përdoruesit e shqipes dhe për cilindo tjetër që kërkon ta mësojë dhe ta zotërojë atë si një bazë e fuqishme për të zgjedhur lëndë leksikore e semantike. Me të drejtë studiuesi Shkurtaj pohon se « Sinonimia stilistike është vetia më e çmuar e gjuhës ».[11]

Ne po sjellim dy njësi që lehtësisht mund të shihen se kanë shumë vargje fjalëformuese në përbërje të tyre dhe elementet plotësues na çojnë te dallimet që shfaqin njësitë pjesëmarrëse në këto vargje, pa qenë e nevojshme t'i drejtohemi një fjalori shpjegues të shqipes.

FATKEQ,-E*mb..*, edhe si *em.* 1. Që ka fat të keq, që e ndjekin fatkeqësitë. **Fatlig. Fathumbur. Fatgremisur. Fatpërmbysur. Pafat (i). Bjerrafat. Palumtur (i). Lumëmadh. Gjëmëmadh. Orëkeq** *bised.* **Orëlig** *bised.***Orëprapë***bised.* **Orësharë***bised.* **Orëfjetur** *bised.***Taksiratmadh***bised.* 2. Që vjen me diçka të keqe, që sjell fatkeqësi. **Fatlig. Fatmjerë. Pafat(i). Palumtur(i). Ogurkeq.** 3. Që përfundon keq. **Fatlig. Pafat (i). Palumtur (i).**

FAT/ZI- ZEZË *mb.*,edhe si *em.*1. Që ka fat shumë të keq, që nuk i ecën fare; që i ka ndodhur një fatkeqësi e madhe; si *mallk.*që iu nxiftë fati.

---

[10] Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, Tiranë, 2006, f.236.
[11] Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, Tiranë, 2006, f.236.

Fatmjerë. Fatkob. Mjerë(i). Fatshkretë. Fatgremisur. Fatpërmbysur. Jetëzi. Jetënxirë. Gullmëzi. Ditëzi. Diterrët. Lumëzi. Buzëzi *fig.* **Rrezikzi. Derëzi. Shkronjëzi. Punëzi. Vulëzi. Nxirak.** *Plaç të preftë,more nxirak, me gjithë ato shajtime*! *Na çave kokën*. (Let.art.). **Mynxyrosur (i).** Orëprerë. **Orëzi***bised*. **Orëshuar***bised*. **Orëvrarë***bised*. **Orëvdekur***bised*. **Yllshuar***bised.* **Gjumëzi.Rrezikzi***bised*. **Hakzi**. **Zi (i).Nxirë (i). Shuar (i). Nafakëkëputur***bised.***Nafakëprerë***bised*. **Nafakësosur***bised*. **Lumosur (i)**. **Valëmadh***fig.* që ka parë shumë vdekje dhe fatkeqësi. **Shkretë (i). Katran** si *mb. fig. bised*. **Vitorezi***vjet*. **Baftzi***vjet.* 2. Që vjen me diçka shumë të keqe, që sjell fatkeqësi të madhe. **Fatmjerë. Fatkob. Mjerë (i). Ogurzi** *bised.***Nxirak.Gjëmëzi. Gjëmëmadh. Zi (i).** 3. Që përfundon shumë keq. **Fatmjerë. Nxirak**. Qe një martesë nxirake, e pahirtë, po fëmijët u rritën e u bënë të mirë. (let. art). **Nxirë (i)***fig.***Mynxyrosur (i).**

Vlera e lidhjeve sinonimike në Fjalorin e sinonimeve të gjuhës shqipe, 2004, është parë "në përqasje të standardit me gjuhën shpipenë përgjithësi, si edhe sipas funksioneve në ligjërime e në stile të ndryshme".[12] Aty ka një hapësirë të madhe nga janë përzgjedhur fjalët që janë pasqyruar dhe njëkohësisht krijojnë edhe normën leksikore dhe atë sinonimike në shqipe.

Në Fjalor gjejmë edhe huazime që formojnë zakonisht jo vargje, por çiftë sinonimike. Nga autorët është bërë një punë e madhe shkencor dhe me vlera kombëtare për t'i dhënë përparësi sinonimit shqip apo janë përpjekje për të mënjanuar huazimin e panevojshëm nga përdorimi.

Si përfundim ne mund të themi se sinonimia fjalëformuese merr përparësi, qoftë për të mënjanuar dubletet leksikore, qoftë për të bërë zëvendësimin e fjalës së huaj më të ashtuquajturat kuazihomonime (fjalë jo të parme që kanë temën fjalëformuese të huazuar nga një gjuhë, zakonisht i.e., kurse ndajshtesat fjalëformuese janë të shqipes), (shënimi ynë S.K). Kështu vlera e drejtpërdrejtë e sinonimisë fjalëformuese në këtë fushë do të dukej te thellimi dhe te zgjerimi i procesit për të bërë normë fjalën që është bërë më shqipe sesa huazimi.

Bibliografia

Fjalori Sinonimik i Gjuhës Shqipe, (2004).

Gj. Shkurtaj, *Kultura e gjuhës*, Tiranë, 2006.

J.Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2001.

J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

M. Samara, *Probleme të sinonimisë dhe "Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*", SF, 1-2, 1999.

Sh.Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985.

Sh.Islamaj, *Roli i sinonimisë në pasurimin e gjuhës*, Prishtinë, f.362.

R.Memushaj, *Hyrje në gjuhësi, Tiranë*, 2006.

[12] J.Thomi…, *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f.9-10.

PËRDORIMI I EMRAVE TË PËRVEÇËM, TË HUAJ NË GJUHËN SHQIPE

Elona Limaj
Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Albanian University
e_limaj@yahoo.com

Abstrakt

Në kuadër të hapjes me vendet e botës dhe kontakteve të shumta ekonomike, politike, sociale në vitet e fundit, shqiptarët janë bombarduar me një numër të madh emrash të përveçëm, të huaj, të cilët si shkruhen e shqiptohen diku nuk shkruhen e shqiptohen diku tjetër. Kjo dukuri nuk përfshin vetëm emrat e shfaqur rishtas, por edhe emrat e përdorur më hershëm në gjuhën shqipe. Shihet një praktikë e re e të shkruarit dhe shqiptuarit të këtyre emrave që është në kundërshtim të plotë me parimin fonetik të të shkruarit të gjuhës standarde, vendosur nga Kongresi i Drejtshkrimit. Ky punim është realizuar duke u bazuar në shembujt e marrë në median shqiptare të shkruar dhe audiovizive, portalet e ndryshme dhe libra të përkthyer në gjuhën shqipe. Është përdorur metoda krahasuese për të kryer një analizë të plotë të dy qasjeve të përmendura në këtë punim në lidhje me emrat e përveçëm: përdorimin si në origjinal ose përkthimin e tyre. Në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe, përgjithësisht, ekzistojnë dy qasje, të cilat analizohen në këtë punim.

***Fjalët çelës**: gjuha shqipe, drejtshkrimi, emra të përveçëm të huaj, origjinal, përkthim*

Abstract

In the framework of openness to the world and numerous economic, political and social contacts faced in the last years, Albanians have come across to a significant quantity of foreign proper names, who are registering different ways of writing in various cases. This phenomena does not only include the recently appearing names, but also the proper names that has appeared earlier in the Albanian language. There is a new practice in the writing and pronunciation of these names, which runs counter to the phonetical principle of the Standard Language writing, determined by the Orthography Congress.This work has been realized based on examples extracted from the Albanian printed and visual media, various portals and novels translated into the Albanian language. It is used the comparative method to carry out a complete analysis of two approaches: their usage as in the original and their translation. This work analysis two approaches used in the Albanian language about the writing and reading of foreign proper names.

***Key words :** Albanian language, writing, foreign proper names, original, translation*

1. Hyrje

Që në krye të herës duhet të pranojmë se ritmet e globalizmit e kanë turbulluar keqazi regjimin e gjuhës shqipe. Në këtë epokë globalizmi të pashmangshëm të hapjes fatlume të qarkullimit, me të mira e me të këqija, është e vërtetë që shqipja po jeton të njëjtat ethe si edhe vetë folësit e saj në përballjen me kulturat, qytetërimet, zakonet e gjuhët e tjera. Nga njëra anë, kjo tregon se gjuha shqipe, fort e izoluar për disa dekada ashtu sikurse dhe aparati i mendimit njerëzor shqiptar, nuk ishte në gjendje të përballonte dyndjen, shpeshherë pa rend e pa kronologji të koncepteve, të ideve, të teknologjive.

Duhet të rikujtojmë që emrat në gjuhën shqipe ndahen në të përveçëm dhe të përgjithshëm. Emra të përgjithshëm quhen emrat që tregojnë qenie ose sende të të njëjtit lloj. Emra të përveçëm quhen emrat që tregojnë një qenie ose një send të vetëm, të dalluar nga të gjithë të tjerët. (AKSH 2002, 82) Drejtshkrimi i këtyre të fundit ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës.

Dikush e shkruan emrin e huaj siç shqiptohet, dikush tjetër, siç është në origjinal. Madje, në të njëjtin botim ose lajm në media mund të hasim në dy standarde të drejtshkrimit të emrave të përveçëm. Ndodh, që emri e një personi të shkruhet sipas rregullave të shqipes, ndërkohë që mbiemri mbetet si në origjinal. Ky fenomen po zhvillohet nën shurdhmemecërinë e gjuhëtarëve dhe kësisoj nuk gjen asnjë bazim shkencor në këtë rrugëtim.

Duket se është krijuar pak rrëmujë në këtë pikë dhe nuk ka një tendencë të vetme të qartë për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqip, gjë që sjell edhe çoroditje te njerëzit, pasi gjuha ka lindur dhe ekziston si mjet komunikimi i lirshëm dhe gjuha e shkruar, po nuk u kuptua nga lexuesi, atëherë nuk e luan dot rolin e saj.

2. Materiale dhe Metoda

Ky punim është realizuar duke u bazuar në shembujt e marrë në median shqiptare të shkruar dhe audiovizive, portalet e ndryshme dhe libra të përkthyer në gjuhën shqipe.

Është përdorur metoda krahasuese për të kryer një analizë të plotë të dy qasjeve të përmendura në këtë punim në lidhje me emrat e përveçëm: përdorimin si në origjinal ose përkthimin e tyre.

Në nëntor 1973 u mblodh Kongresi i Drejtshkrimit, i cili gjithë vëmendjen ia kushtoi njehsimit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Kongresi vendosi që në rregullat e drejtshkrimit të gërshetohej parimi fonetik me atë morfologjik dhe historik (AKSH 1973, 36).

Kongresi i vitit 1973 vendosi që "*Shkrimi i emrave të përveçëm, të huaj mbështet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes",* (AKSH 1973, 35)si edhe jepet, gjithashtu, varianti që mund të shënohet në kllapa në gjuhën origjinale.

Ndërkohë, Shqipëria e viteve ´90 pësoi ndryshime rrënjësore në sistemin politik, ekonomik, social e kulturor, duke u përballur me fenomenin e globalizimit. Pas viteve ´90 kemi një vërshim të fjalëve të huaja, përfshirë emrave të përveçëm në shkrimet politike, letrare, ekonomike nga gazetat, televizionet, radiot, konferencat, ku vihet re një shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, kryesisht, në drejtshkrimin e drejtshqiptimin e këtyre emrave të përveçëm.

Disa e justifikojnë këtë praktikë me numrin e madh të emrave të përveçëm, të huaj që hyjnë në gjuhën shqipe, të cilët janë të vështirë për t´u shqiptuar. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe, sidomos, pas Kongresit të Drejtshkrimit u përcaktuan dhe u përdorën kritere të njehsuara edhe për shkrimin e fjalëve të huaja: "Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar" (AKSH 1973, 90-105). Mbi këtë parim dhe rregullat e dala prej tij u shkrua për vite me radhë. Por, as ky kriter nuk respektohet, prandaj edhe konfuzioniështë më shqetësues. Brenda një numri gazete ose reviste, madje, brenda një shkrimi, autorët shkruajnë Clinton edhe Klinton, Clinton-it edhe Clintonit; edhe "rrugët e Londrës dhe të New-York-ut". Një shembull ku mund të gjejmë edhe lënien si në origjinal ashtu edhe përkthimin e emrave të përveçëm në një fjali është fjalia: "Presidenti amerikan në largim Barack Obama është në qytetin e Çikagos ku do të mbajë fjalimin e lamtumirës."

Gjuha është sistem dhe, si i tillë, nuk mund të luhet me të sipas tekave të njërit ose tjetrit. Nëse norma që kemi, për këtë ose atë kategori fjalësh, ose për këtë ose atë fushë të përdorimit të gjuhës, është e ngushtë, e tejkaluar ose jointegruese, atëherë, gjuhëtarët duhet të vendosin norma e kritere të reja, që duhet të zbatohen nga të gjithë ata që shkruajnë shqip.

Meqenëse në shqip emrat shquhen me mbaresë dhe lakohen, ndryshe nga shumë gjuhë të tjera të botës, atëherë emrat e huaj s'kanë si përjashtohen nga natyra e shqipes, prandaj duhet të shquhen e të lakohen, përndryshe do të kemi një shpërfytyrim të ligjërimit të gjuhës shqipe.

Pyetja që ngrihet në këtë kuadër: Si ka mundësi që rregulli i Kongresit të Drejtshkrimit po shkelet në të gjitha rastet e mundshme?

3. Analiza

Ekzistojnë disa qëndrime lidhur me këtë çështje dhe në këtë punim do mundohemi të paraqesim të gjithë problematikën dhe pikëpamjet mbi këtë dukuri. Kështu, në drejtshkrimin e emrave të përveçëm, të huaj në gjuhën shqipe ekzistojnë dy qëndrime:

1. Emra të përveçëm, të huaj si në origjinal

Ky qëndrim konsiston në shkrimin sipas grafisë në gjuhën dhënëse, emrat e përveçëm, të huaj në gjuhën shqipe i lëmë si në origjinal.

Në shumë vepra letrare të përkthyera para Luftës së Dytë Botërore, emri i autorit shkruhej si në origjinal, si për shembull, Shakespeare. Ndryshe veprohej me emrat e personazheve. Ato ose mund të shkruheshin si në

origjinal, ose mund të shkruheshin fonetikisht, si për shembull, Oliver Tuistin ose Oliver Twist-in.

Ndërkohë, këto vitet e fundit është vënë re kthimi i tendencës së periudhës para Luftës së Dytë Botërore ku po mbizotëron shkrimi i emrave të huaj të përveçëm si në origjinal. (Alystad & Assis Rosa 2015, 3-24) Por nuk është çudi fare që të marrim në dorë një vepër të përkthyer të një autori të huaj ku të gjithë emrat e përveçëm janë si në origjinal dhe një vepër tjetër të po të njëjtit autor, por të përkthyer nga një përkthyes tjetër ku emrat e përveçëm janë shkruar fonetikisht.

Vitet e fundit në shqipen e shkruar po theksohet me të madhe prirja për t'i shkruar emrat e huaj ashtu siç shkruhen në origjinal. Për shembull: Trump, Versailles, Charles De Gaulle, Pierre-Auguste Renoir, Dwight Eisenhower (Shkurtaj 2008, 245).

Shumë nga mbështetësit e të shkruarit të emrave të përveçëm si në origjinal duhet të kenë parasysh se kontakti i gjuhës shqipe me kulturën e botës nuk është pas viteve 1990. Pasi do të na duhej të rishkruanim një numër të madh emrash të përveçëm që tashmë kanë zënë vend në regjistrin e gjuhës dhe do të ishte absurde t'i ndryshonim. (Koskinen &Palopski 2019, 23-44) Kështu, do të duhej të shkruanim Newton e jo Njuton, Chopin e jo Shopen, Rutherford e jo Radhërford, Picasso e jo Pikaso, Goethe e jo Gëte, Byron e jo Bajron, Chateaubriand e jo Shatobrian, Heine e jo Hajne etj. Po të shkonim më tej, do të na duhet të shkruajmë në shqip edhe emrat e vendeve, ashtu siç shkruhen në gjuhët e tyre origjinale. Për shembull, London në vend të Londër, New York, në vend të Nju Jork, Sevilla në vend të Seviljes (dhe në këtë rast do thoshim Berberi i Sevilla-s!), Bordeaux në vend të Bordo (dhe do thoshim ,p.sh, verë e Bordeaux-it!) Shembulli tipik është mbiemri i Presidentit Trump, i cili sheh një numër të ndryshëm drejtshkrimesh : Trump, Tramp, Trump-it. Pastaj nuk duhet të harrojmë se jo të gjithë shqiptarët dinë gjuhë të huaja e mund t'i lexojnë ashtu siç duhet emrat e huaj të shkruara në shqip si në origjinal. Ndaj e gjithë kjo ndërmarrje është një kuturisje e kotë. Gjuha shqipe bazohet mbi parimin që lexohet siç shkruhet, bazuar në rregullat e drejtshkrimit.

Me të drejtë gjuhëtarja Jorgaqi shprehet: "… të lexosh një vepër ku, nga fillimi në fund, nuk percepton veçse personazhe me emra që u bien ndesh shprehive elementare të gjuhës sate, nuk është thjesht dhe vetëm mungesë "rendimenti" gjuhësor për lexuesin. Është edhe çështje "perceptimi" emotiv, pasi prania e tyre, në njëfarë mënyre, sikur e pengon krijimin e asaj ndjesie "njësimi" që provon shpesh lexuesi karshi personazheve…". (Jorgaqi 2000, 90)

2. Emra të huaj të përshtatur në shqip

Qëndrimi i dytë i përket atyre që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhet të shkruhen sipas traditës vendase duke zbatuar drejtshkrimin e shqipes, sipas shqiptimit që kanë emrat e huaj në gjuhën prej nga merren.

Gjatë periudhës së komunizmit u vu re një ndryshim i plotë në këtë drejtim. Dominoi në mënyrë të plotë shkrimi fonetik i emrave të përveçëm, ku Shakespeare njihej si Shekspiri (Pipa 1989, 25). Kjo ka bërë që emri i Shekspirit dhe autorëve të tjerë të njohur botërorë të jetë mjaft i përhapur dhe i përdorur në formën e tij fonetike në masën e gjerë të lexuesve.

Emrat e përveçëm të njerëzve dhe të vendeve të huaja shkruhen sipas shqiptimit që kanë në gjuhën prej nga janë marrë: Shekspir, Bethoven, Klinton, Sharl dë Gol, Shiler, Nju-Jork, Kajro, Algjeri, Palestinë, Versajë etj. Po të shohim fillimet e shqipes së shkruar do të vinim re se autorët e hershëm shqiptarë, si Pjetër Budi, e shkruajnë emrin e birit të Zotit, Krisht e jo Christ. Më pas, Noli shkruan Shekspir e jo Shakespeare dhe Don Kishot e jo Don Quixote apo Don Quichotte.

Emrat e përveçëm i shkruajmë si shqiptohen dhe ata u nënshtrohen rregullave drejtshkrimore e gramatikore të shqipes, dmth, shkruhen ashtu siç dëgjohen dhe lakohen si të gjithë emrat e tjerë. Gjithsesi, mund të vendosim në kllapa emrin në origjinal. Kështu, themi Kondoliza Rajs (Condoleezza Rice), De Gol (Gaulles), Xhon Uidhers (John Withers), Zyrih (Zürich).

Disa emra të përveçëm me prejardhje të huaj të emrave të qyteteve shkruhen sipas traditës së ngulitur prej kohësh në gjuhën shqipe: Bruksel, Korfuz, Moskë, Paris, Selanik, Stamboll, Suedi, Vjenë, Zvicër etj.

Dëgjojmë, për shembull, spikerët e TV-ve dhe të radiove si edhe gazetarët e medias së shkruar të thonë apo të shkruajnë pa të keq: “Deklarata e Trump” dhe jo “Deklarata e Trampit”; Këngëtarja britanike tërhiqet nga ceremonia e Trump; “Takimi i Ramës me Kim” dhe jo “Kim-n”; Sipas Kuschner dhe jo “Kuschner-it” etj.

Nuk është mirë të themi “Putin do takohet me Obama”, por “Putini do takohet me Obamën" pasi është e njëjta gjë sikur të thuash “Skënder do takohet me Kujtim”.

Sipas përkthyesit të shquar Shvarc, “Nuk duhet harruar parimi fonetik i shqiptimit të emrave dhe duhet respektuar lakimi i emrave të përveçëm në rasa”. (Shvarc 2002, 8)

Një e metë tjetër e cila haset shumë shpesh në medie është edhe përdorimi i trajtës së pashquar në vend të së shquarës, edhe pse dihet se edhe shqipja, ashtu sikurse gjuhët e tjera të mëdha e të vjetra, ka shquarësinë dhe pashquarësinë e emrave, si dhe lakimin e tyre sipas të dy këtyre trajtave. Vizita e Klinton fuqizon shtetin (duhet: Vizita e Klintonit fuqizon shtetin), Fjalimi i Bush i mbajtur... (duhet: Fjalimi i Bushit i mbajtur...), Xhenifer Lopez i kërkohet bashkëpunim shtesë.… (duhet:Xhenifer Lopezit i kërkohet bashkëpunim shtesë).

“Bllokohet kalimi i Lewandowskit te Bayern, shkruan një gazetë, ndërkohë që mund t’i shohim emrat e shqipëruar: bllokohet kalimi i Levandovskit te Bajern.

Një fenomen shqetësues, përsa i përket gjuhës shqipe, është edhe dëshira e prindërve për t’i vendosur fëmijëve emra të huaj. Në shumicën e rasteve,

emrat e huaj regjistrohen jo mbi bazën e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, po mbi ato të gjuhës së huaj nga është huazuar emri i fëmijës, të tilla si Chloe, Bryan, Wendy, Aaron, Alessio etj. Vihen re edhe emra që mund të përdoren në të dy gjinitë dhe është e vështirë të përcaktosh përkatësinë gjinore vetëm nga emri i zgjedhur, si Joel, Ariel etj.

Ky fenomen shkakton vështirësi në lakimin e këtyre emrave, pasi format e tyre të huaja i përshtaten me vështirësi rregullave të shqipes. Por çdo gjuhë ka sistemin e saj fonologjik dhe grafematik, që nuk përkon me sistemet përkatëse gjuhësore me të cilat bashkëvepron. (3) Për këtë, ekzistojnë dy mundësi për të përshtatur emrat e huaj në gjuhën shqipe - transkriptimi dhe transliterimi.

Transkriptimi praktik gërsheton elemente të transkriptimit (pasqyrim shkrimor të fonemave) me elemente të transliterimit (dhënia e shkronjave të një alfabeti me shkronja të një alfabeti tjetër)

Parimi i transliterimit është më i përshtatshëm, ndërsa parimi i transkriptimit është i pavolitshëm në shumicën e rasteve. Parimi i transliterimit nënkupton transkriptimin fonetik që zakonisht zbatohet si transkriptim praktik. (Ymeri 2015, 135)

4. Përfundime

Pas këtyre reflektimeve, mund të nënvizohet se në publicistikë dhe në letërsinë artistike është mirë që emrat e huaj të shkruhen siç shqiptohen.

1. Në shkrimet me karakter shkencor dhe zyrtar ose dhe kur shihet e nevojshme në një stil të posaçëm ose në kushte të caktuara, të shkruhen në gjuhën përkatëse, duke përdorur kllapat. Simone de Beauvoir (Simon dë Bovuar).

2. Një rrugëdalje për këtë problem mund të jetë përdorimi i vizave mes çdo emri të huaj dhe mbaresave shqipe, p.sh.: Trump-it, megjithëse, një grafi e tillë është lodhëse, jopraktike dhe të krijon përshtypjen e diçkaje artificiale, por e domosdoshme kur nuk përdoret kriteri fonetik.

Në këtë mënyrë do të mund të ndreqen edhe shqiptime të gabuara të disa emrave të huaj që, dosido, kanë hyrë në të folurit tonë. Arsyeja është e thjeshtë: se në Kongresin e Drejtshkrimit është vënë ky rregull, i cili nuk mund të thyhet derisa të mbahet një kongres tjetër dhe të vendoset e kundërta e saj.Fjala është për përcaktimin e një rregulli bazuar në karakteristikat e gjuhës shqipe për futjen e emrave të huaj apo fjalëve të reja.

5. Referenca

Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1973) *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, (2011),*Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Toena, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002) *Gramatika e Gjuhës Shqipe*,Tiranë.

Arshi Pipa (1989) Politics of Language in Socialist Albania. New York; Columbia University Press;

Cecilia Alvstad and Alexandra Assis Rosa (2015), *Voice in Retranslation. An overview and some trends.* Target, vol. 27, no.1.

Eshref Ymeri, (2015)*Përkthimi, një histori pasioni*, Tiranë, Toena.

Gjovalin Shkurtaj, (2004) *Trysnia e huaj dhe qëndresa e shqipes.* Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde 29 prill 2004, Vol II; Nr. 1.

Gjovalin Shkurtaj, (2008) *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, Toena.

Gjovalin Shkurtaj, (2000) D*rejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folme*, Tiranë.

Kristina Jorgaqi, (2000) *Leksione xhepi për gjuhën.* Tiranë, Dituria.

Koska Koskinen and Outi Paloposki (2019b) New Directions for retranslation research: Lesson Learned from the archaeology of retranslations in the Finnish Literary System, Cad Trad Florianopolis, vol. 39, no. 1

Rexhep Qosja (2003) *Kongresi i drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas, shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë.

Robert Shvarc (2002) "*Pasurimi i gjuhës shqipe në media*", Gazeta "Shekulli"; 8, Tiranë.

Emil Lafe, (1990) *Sistemet e transkriptimit nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe*. Gjuha Jonë,10/4.

MËSUESI, GJUHA DHE LETËRSIA NË SHKOLLË

Zeqir Zeqirllari[1], Hristina Mallanezo[2]
[1]Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës
zeqirzeqirllari18@gmail.com
[2]Departamenti Gjuhëve të Huaja, Universiteti "Eqrem Çabej"
hristinamallanezo@gmail.com

Abstrakt

Gjuha dhe letërsia shqipe zënë një vend me rëndësi në plan-programet e shkollës sonë. Si lëndë e veçantë ajo mësohet që nga klasa e parë e shkollës fillore e deri në klasat e fundit të arsimit të mesëm, si dhe në shumë shkolla të larta e fakultete, që përgatitin kuadro të profilit arsimor. Në bazë të kurrikulës bërthamë, në ciklin 9-vjeçar gjuha dhe letërsia mësohen të integruara së bashku. Përballja me një klasë me nxënës është përballje me një heterogjenitet problematikash e situatash, me një larmi karakteresh njerëzore e tipa të ndryshëm psikologjikë, që të thuash të vërtetën, për t'ia dalë mbanë këtij misioni, nuk ekziston një "recetë" standarde. Pasja e një diplome universitare asnjëherë nuk është garanci se një mësues do të jetë i aftë, i sukseshëm. Që një mësues të jetë i suksesshëm, nuk mjafton vetëm zotërimi i mirë teorik i lëndës, por duhet të dijë si të transmetojë këto njohuri te nxënësit e tij, ndaj dhe pikërisht për këtë përdoret shprehja mësimdhënia është art. Me pak fjalë, mësues i suksesshëm quhet ai që është në gjendje të realizojë qëllimet dhe objektivat e programit. Përmasat kryesore të mësimdhënies së suksesshme janë synimi dhe rezultati. Pa synime rezultatet e nxënësit bëhen të rastësishme dhe pa kriter, ndërsa rezultatet e planifikuara, arritja e tyre, vërteton aftësitë e një mësuesi të suksesshëm.

***Fjalët kyç**: gjuha shqipe, letërsia shqipe, cikli 9-vjeçar, mësues*

Abstract:

Albanian Language and Literature hold an important place in the school curriculum. As an essential subject, it is taught from the first grade of primary school to the last grades of secondary education, as well as in many colleges and faculties, which prepare educational staff. Based on the core curriculum, in the 9-year cycle, language and literature are integrated and taught together. Facing a class of students means to deal with heterogeneous problems and situations, with a variety of human characters and different psychological types, truth be told, there is no standard "recipe" to accomplish this mission. Having a university degree, is no guarantee that a teacher will be competent and successful. In order for a teacher to be successful, it is not enough to only have a good theoretical knowledge of the subject, but s/he must know how to transfer this knowledge to his/her students, this is precisely why the expression "Teaching is an Art" is used.

In a few words, a successful teacher is one who is able to serve the purpose and objectives of the program. The main dimensions of successful teaching are goal and result. Without goals, the student's results are random and without criteria, while achieving the planned results proves the skills of a qualified teacher.
Key words: *Albanian language, Albanianliterature, 9-year cycle, teacher*

1. Objektivat pedagogjike

Mësimdhënia është një proces i organizuar. Si e tillë, ajo është e orintuar drejt një qëllimi apo disa qëllimeve të caktuara. Fjalët "synime", "qëllime" dhe "objektiva" përdoren ne vend të njëra-tjetrës në mënyrë të shpeshtë në kuptime të ndryshme.

Synimet janë shprehje të përgjithshme të vlerave që orientojnë drejtimin tonë.

Qëllimet janë të shprehura dhe të orientuara drejt atij që nxë, mëson dhe përcakton se çfarë do të mësojnë nxënësit si rezultat i mësimdhënies.

Gjithashtu kemi dhe objektivat mësimore të cilat përcaktojnë se cila sjellje e veçantë do të arrihet, në cilat kushte do të demonstrohet kjo sjellje e caktuar dhe në çfarë niveli të kryerjes do të përmbushet ajo.

Objektivat i kemi të përgjithshme dhe të veçanta.

Objektivat e përgjithshme janë pohime të gjera të asaj që duhet të jetë në gjendje nxënësi të bëjë me shembuj ose ilustrime të veçanta. Ata janë më të dobishëm kur shprehitë që duhen mësuar janë relativisht të ndërlikuara dhe më pak të strukturuara.

Objektivat e veçanta janë pohime mbi atë se çfarë do të jetë në gjendje të bëjë nxënësi në kushte të caktuara dhe në një shkollë të caktuar. Ata janë të dobishëm kur shprehitë që duhen mësuar janë relativisht të thjeshta dhe mjaft të strukturuara. Lënda e matematikës, arsimi profesional, edukimi fizik etj., përdorin shpesh objektiva të veçantë të arritjes, por ato mund të gjenden dhe në shumë fusha të tjera.

Në punimin tonë, sikundër është dhe objekti kryesor i tij, konkretisht, kemi marrë për analizë metodiko-pedagogjike librin e gjuhës shqipe dhe letërsisë së klasës 8-të.

Dhe për këtë, duke qenë se jemi në nivelin e kurrikulës për shkollat e ciklit 9-vjeçar, më poshtë do donim të evidentonim disa objektiva pedagogjike vetëm në aspektin e gjuhës si lëndë.

Si më kryesorin nga objektivat pedagogjikë të gjuhës në nivelin e AMU-së, mund të renditim disa, ku nxënësi duhet:

- të komunikojnë qartë dhe saktë (me gojë dhe me shkrim) në varësi të qëllimit dhe të situatës;
- të shprehin opinionet e tyre, në mënyrë korrekte nga ana gjuhësore, gjatë diskutimeve dhe gjatë punëve në grup;
- dëgjojnë, lexojnë dhe kuptojnë lloje të ndryshme tekstesh, nxjerrin përfundime dhe i vlerësojnë këto tekste (me gojë ose me shkrim);
- të gjejnë informacion në media dhe në internet, e gjykojnë në mënyrë kritike këtë informacion dhe e përdorin atë në mënyrën e duhur;

- të njohin llojet e ndryshme të teksteve dhe përdorimet e tyre, si dhe hartojnë e prezantojnë tekste të ndryshme;
- të lexojnë tekste letrare të gjinive të ndryshme dhe zhvillojnë botën emocionale përmes tyre;
- të kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë tekste letrare si një burim për të njohur histori të ndryshme, marrëdhëniet njerëzore, ndjenjat, vlerat etj.;
- të përdorin gjuhën standarde në shkollë dhe jashtë saj, si dhe zbatojnë rregullat gramatikore themelore;
- të vlerësojnë letërsinë si pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare dhe botërore;
- të vlerësojnë rëndësinë e gjuhës shqipe si vlerë e kulturës kombëtare.

Nga gjithë këto objektiva të renditura më lart mund të kalojmë në një ndarje më specifike të objektivave të veçanta, duke pasur parasysh të nxënit sipas kompetencave të fushës.

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
Nxënësi:
- interpreton tekstin dhe nëntekstin, si dhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;
- diskuton, zgjeron dhe gjykon idetë e dëgjuara, si dhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon rreth temave të fushave të ndryshme.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
Nxënësi:
- flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale;
- përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuara me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim;
- krijon tekste mediatike për qëllime dhe audienca të ndryshme duke përdorur format dhe teknikat e përshtatshme;

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
Nxënësi:
- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili i autorit ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;
- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit. Duke i klasifikuar tekstet në letrarë ose joletrarë veçojmë:

a) tekstet letrare:
-vlerëson gjuhën dhe idetë që përcillen në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës a subjektit;
- bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimtarit;
- krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme

b) tekste joletrare:
- përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme;

- dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasoja;
- veçon tiparet karakteristike të fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme.

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
Nxënësi:
- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;
- përdor forma të efektshme për qëllime dhe audienca të caktuara;
- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idetë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.

Përdorimi i drejtë i gjuhës.
Nxënësi:
- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore;
- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta;
- përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit;
- zotëron nocionet themelore fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore dhe fjalëformuese.

2. Gjuha dhe letërsia në shkollë

Gjuha dhe letërsia shqipe zënë një vend me rëndësi në plan-programet e shkollës sonë. Si lëndë e veçantë ajo mësohet që nga klasa e parë e shkollës fillore e deri në klasat e fundit të arsimit të mesëm, si dhe në shumë shkolla të larta e fakultete, që përgatitin kuadro të profilit arsimor. Në bazë të kurrikulës bërthamë, në ciklin 9-vjeçar gjuha dhe letërsia mësohen të integruara së bashku.
Përballja me një klasë me nxënës është përballje me një heterogjenitet problematikash e situatash, me një larmi karakteresh njerëzore e tipa të ndryshëm psikologjikë, që të thuash të vërtetën, për t'ia dalë mbanë këtij misioni, nuk ekziston një "recetë" standarde. Pasja e një diplome universitare, asnjëherë nuk është garanci se një mësues do të jetë i aftë, i suksesshëm.
Që një mësues te jetë i suksesshëm, nuk mjafton vetëm zotërimi i mirë teorik i lëndës, por duhet të dijë si të transmetojë këto njohuri te nxënësit e tij, ndaj dhe pikërisht për këtë përdoret shprehja mësimdhënia është art.
Puna e një mësuesi të mirë ka të bëjë me faktin se sa mundet ai që dhe një nxënës i nivelit mesatar ose dhe më i ulët, pasi të ketë mbaruar shkollën, të ketë një mendim a koncept të qartë se ç'është gjuha dhe letersia.
Me pak fjalë, mësues i suksesshëm quhet ai që është në gjendje të realizojë qëllimet dhe objektivat e programit. Përmasat kryesore të mësimdhënies së suksesshme janë *synimi* dhe *rezultati.* Pa *synime* rezultatet e nxënësit bëhen

të rastësishme dhe pa kriter, ndërsa *rezultatet* e planifikuara, arritja e tyre, vërteton aftësitë e një mësuesi të suksesshëm.
Konkretisht, për lëndën e gjuhës dhe letërsisë në shkollë, një mësues i mirë duhet të ketë disa pika orientuese bazë dhe të punojë vazhdimisht, orë për orë, në funksion të të nxënit të këtyre bazave themelore të kësaj disipline nga nxënësit.

• *Gjuha në shkollë.*
Zotërimi i gjuhës standarde në shkollë është një kërkesë e rëndësishme dhe përbën një ndër synimet kryesore të çdo lënde mësimore. Për këtë shfrytëzohen të gjitha mjetet dhe mundësitë, në radhë të parë vetë lënda e gjuhës shqipe në shkollë si dhe ajo e letërsisë si bashkërendëse e saj.
Siç dihet, gjuha ndryshon në varësi të qëllimit dhe situatës komunikuese. Për rezultate të mira mësuesi duhet të vërë në përdorim një tërësi komponentësh të mësimdhënies dhe të të nxënit të lëndës, duke nisur që nga teoritë e organizimit të procesit mësimor të kësaj lënde. Ky objektiv përfshin përsosjen e vazhdueshme të mësimdhënies dhe të përvetësimit të gjuhës shqipe në shkollë, kuptimin e detajuar nga ana e mësuesit të përmbajtjes kurrikulare, standardet dhe format e larmishme të vlerësimit.
Mësuesi duhet të jetë tepër i vetëdijshëm për vështirësitë e të nxënit. Gjithashtu, duhet të jetë shumë i qartë për materilet didaktike thelbësore dhe suplementare si dhe për ndikimin që kanë ato gjatë mësimdhënies.
Për kohën që jetojmë, format e reja të mësimdhënies dhe të të nxënit përmes rrugëve dhe mjeteve të teknologjive të reja të informacionit janë një mundësi më tepër për të rendur drejt metodave sa më të arrira të mësimdhënies.
Mësuesi duhet të krijojë gradualisht bindjen te nxënësit e tij se mësimi i gjuhës shqipe duhet parë jo si qëllim në vetvete për mësimin e një displine shkollore, por si një proces që mundëson të nxënit në të gjitha lëndët shkollore dhe përtej tyre. Këtu duhet kuptuar thellësisht nga mësuesi lidhjet që krijohen përmes kësaj lënde me lëndët e tjera, duke nisur nga lëndët me karakter të theksuar shkencor e deri tek ato lëndë me karakter aplikativ.

- *Letërsia në shkollë.*

Letërsia është një veprimtari njerëzore që unifikon si asnjë tjetër në një mendjen dhe zemrën e njeriut, arsyen dhe ndjenjën, përkatësisht letërsia përbën atë që mund të quhet plotësia e botës njerëzore. Nëpërmjet saj pasurohet mendja, por fisnikërohet edhe shpirti i njeriut.
Të mësuarit e letërsisë gjatë viteve të fundit shihet si një përpjekje për të çliruar fuqinë madhore të kësaj disipline në njohjen e nxënësve me vetë jetën e tyre dhe me botën përreth, si dhe një mjet për të zhvilluar aftësitë e tyre kritike e krijuese.
Mësimdhënia e letërsisë duhet të jetë e lidhur me përvoja dhe përmbajtje që e bëjnë nxënësin të gatshëm dhe të aftë të mësojë. Mësimdhënia e letërsisë duhet të jetë e strukturuar në mënyrë që nxënësi të kuptojë dhe të zbatojë lehtë njohuritë që ai merr në këtë disiplinë. Metodika e kësaj

lënde duhet skicuar dhe parapërgatitur mirë për të lehtësuar të nxënët. Letërsia në vetvete të krijon mundësinë për zgjidhjen e konflikteve sociale duke kultivuar tolerancën dhe mirëkuptimin.
Kështu, një mësues i mirë duhet të orientojë mjeshtërisht që në një klasë të mbushur me "lexues", t'u ofrojë nxënësve mundësinë që të dallojnë ndryshimet në përgjigjet e tyre, të kuptojnë interpretimet e njerëzve të ndryshëm për të njëjtin tekst. Për këtë arsye, thuhet që një vepër letrare ka po aq interpretime sa më tepër njerëz ta kenë lexuar atë.
Një vepër letrare është objekt gjykimi i lexuesit, nxënësit në rastin konkret, por edhe i studiuesit ose kritikut. Ndaj mësuesi duhet të ketë qartë dallimin që ndryshimi ndërmjet gjykimit të secilit qëndron në faktin se lexuesi shprehet për veprën nisur nga emocioni i çastit dhe përvoja estetike vetjake, kurse studiuesi dhe kritiku e mbështetin gjykimin e tyre jo vetëm në përvojën vetjake, por edhe në njohuri teorike. Qëndrimi i kritikut synon të jetë objektiv, ndërsa i lexuesit subjektiv. Mësuesi duhet të jetë ai që do të realizojë hallkën lidhëse midis këtyre gjykimeve. Kështu, mësuesi duhet të synojë që nxënësi duhet të arrijë në nivel të kënaqshëm disa objektiva nga kjo disiplinë. Të jetë i qartë dhe i saktë në komunikimin me gojë dhe me shkrim; të lexojë një shumëllojshmëri tekstesh dhe të reagojë ndaj tyre në mënyrën e duhur; të demonstrojë se i ka kuptuar qartë të gjitha rregullat e gjuhës së shkruar, duke përfshirë këtu gramatikën, drejtshkrimin dhe pikësimin; të veprojë në një shumëllojshmëri kontekstesh brenda dhe jashtë klasës; të marrë vendime të përshtatshme mbi mënyrën e komunikimit.

3. Zhvillimi i shprehive të të shkruarit, të lexuarit dhe të folurit në orën e gjuhës dhe letërsisë

Kuptimi mbi të shkruarit

Të shkruarit është një shprehi e rëndësishme komunikative, e cila ka lindur qysh në lashtësi, si një nevojë e njerëzimit për të komunikuar dhe për të përcjellë mesazhe në një mënyrë tjetër. Të shkruarit realizon komunikimin e njerëzve në kohë dhe hapësirë. Përmes të shkruarit shoqëria njerëzore në shekuj ka ruajtur dhe transmetuar trashëgiminë e saj më të rëndësishme; shpikjet, ngjarjet, kulturën etj.
Megjithëse të shkruarit vlerësohet si një proces dhe shprehi vetjake, ai i ka shërbyer shoqërisë si mjet i rëndësishëm për realizimin e lidhjeve humane shumëshekullore. Duke filluar nga bibliotekat më të vjetra në botë, nga papiruset e lashta e duke arritur deri në ditët tona te përdorimi i internetit, dëshmohet më së miri për rolin dhe shërbimet që i ka bërë shkrimi njerëzimit.
Disa prej përparësive të të shkruarit në formimin e nxënësit me këtë proces, në kuadër të zhvillimit edhe të shprehive të tjera, si një ansambël i të tre këtyre elementeve, mund të përmendim shtyrjen e të rinjve në mendime më të thella nëse ata do të donin të shkruanin thjesht përvojat e tyre, në mënyrë të tillë që të mund të gjejnë veten në to. Gjithashtu, ky proces,

ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e kuriozitetit, duke i bërë ata më të gjallë e më vëzhgues.
Të shkruarit zgjeron ndërgjegjësimin e të rinjve në lidhje me përvojën dhe sfidat e shokëve. Nëpërmjet të shkruarit zhvillohet fryma e bashkëpunimit mes tyre si dhe përmirësohet ndjeshëm aftësia lexuese dhe shkruese e të rinjve.
Nxënësit lexojnë si shkrues dhe shkruajnë si lexues. Të shkruarit e përmirëson të mësuarit e thelluar të nxënësve.

Kuptimi mbi të lexuarit

Të lexuarit është një proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Shkolla, si institucioni përmes të cilit përcillen dhe përvetësohen dije, e sheh të lexuarin si çelësin e sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij.
Formimi gjuhësor, letrar psikologjik, estetik, artistik që fiton nxënësi gjatë leximit të një vepre letrare, i ndihmuar edhe nga puna e mësuesit në anën metodike, ka ndikim edhe në ndjeshmërinë e formimin e tyre intelektual.
Gjendja emocionale e shpirtërore që krijohet gjatë leximit të veprës letrare ka një rol të pazëvendësueshëm, i cili shërben edhe si nxitje për lexime të reja, duke realizuar kështu edhe një ndër funksionet kryesore të letërsisë, atë estetik, d.m.th. nxitjen e ndjenjës të së bukurës në përgjithësi, në motivimin e nxënësve në nxitjen e leximit të veprave letrare dhe në krijimin e një kulture të qëndrueshme letrare.
Në shoqërinë e sotme ku ndryshimet janë të shpejta, ku njohuritë grumbullohen e shtohen brenda nje kohe të shkurtër, arritjet shkollore kanë kuptim vetëm nëse vlejnë për jetën dhe për të nxënit gjatë gjithë jetës. Shoqëria e sotme ka nevojë për individë të cilët përballojnë sfidat, madje, gjenerojnë vetë mendime e ide kreative.
Të lexuarit është një proces që të çon drejt të kërkuarit të diçkaje, por edhe një nevojë dhe dëshirë emocionale e individit. Ai është një shenjë e jetës së njeriut dhe një proces që përmbush qëllime të përcaktuara vetjake e shoqërore.
Disa nga këto motive dhe qëllime në lidhje me të lexuarit përcaktojnë dhe llojet e tij që janë të lexuarit për ndjenjë; të lexuarit e kuptimshëm; eksplorues; në lloje dhe gjini letrare; të lexuarit për përvetësimin e informacionit të shkruar; të lexuarit krijues dhe ai zbatues.
Koncepti i aftësisë për të lexuar ka të bëjë me një grup strukturash që nga aftësitë, shprehitë dhe njohuritë individuale te praktikat shoqërore deri te vlerat ideologjike dhe synime të tjera më strategjike.
Sipas përkufizimeve që vijnë nga studiues të ndryshëm dhe në kohë të ndryshme, këto përkufizime i lidh fakti se qëllimi i zhvillimit të aftësisë për të lexuar është t'i aftësojë nxënësit për t'u bërë lexues aktiv gjatë gjithë jetës së tyre, të aftë për t'u angazhuar në mënyrë të pavarur në veprimtari lexuese.

Të shprehurit ose të folurit

Nivelin e zhvillimit të përgjithshëm gjuhësor të nxënësve si dhe natyra e këtij zhvillimi, nxënësit e shfaqin me anë të mjeteve të ndryshme shprehëse, prej të cilave të folurit zë një vend të rëndësishëm. Me anë të tij jo vetëm objektivizohet procesi i të menduarit, por njëkohësisht edhe formohet.

Të gjithë nxënësit flasin në mënyre efektive për audienca, qëllime, situata dhe kontekste të ndryshme. Nga ana tjetër, nxënësit duhet të zotërojnë aftësitë e duhura për të marrë role të ndryshme në një diskutim.

Ata duhet të arrijnë të mbajnë një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup; të luajnë role të ndryshme në një diskutim: rolin e moderatorit, rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.; të mbështesin një pozicion në diskutime që realizohen në grupe të vogla ose të mëdha. Për këtë nxënësi duhet të modifikojë një pozicion në diskutime që realizohen në këto grup, madje, edhe të kundërshtojë një pozicion në këto diskutime.

Gjithashtu, mësuesi duhet të arrijë që ata të marrin role drejtuese në diskutime, projekte dhe forume, të jenë në gjendje të përmbledhin përfundimet e një diskutimi, të vlerësojnë përfundimet e tij.

Duhet synuar që nxënësi të aftësohet të përdorë përmbajtje të përshtatshme për shumë drejtime ose qëllime, si nëpër audienca, situata dhe kontekste të ndryshme dhe të shfrytëzojë pasurinë leksikore e semantike të shqipes, për të shprehur saktë mendimet e tij në diskutimet e ndryshme në grup.

Referenca

Musai, Bardhyl, *Metodologji e mësimdhënies*, T., Pegi, 2003, f. 34

Myrtaj, L., Pema, E., *Gjuha shqipe: libër për mësuesin*, T., Pegi, 2017

Musai, Bardhyl, *Metodologji e mësimdhënies*, T., Pegi, 2003, f. 36

Gjokutaj, Mimoza, *Didaktika e gjuhës shqipe*, T., SHBLU, 2009, f. 165

Gjokutaj, Mimoza, *Didaktika e gjuhës shqipe*, T., SHBLU, 2009, f. 201

ELEMENTET E KRIJIMTARISË POPULLORE NË POETIKËN ROMANTIKE TË DE RADËS

Merita Gjokutaj-Shehu
Universiteti "Eqrem Çabej", Departamenti i Letërsisë
merigjokutaj@yahoo.com

Abstrakt

Poetët arbëreshë, ashtu si gjithë poetët e Rilindjes Kombëtare, me artin e tyre, dallohen, së pari, për mbështetjen krijuese në folklor, realizuar në mënyrë mjeshtërore, pa cenuar aspak individualitetin e tyre si artistë. Ata shpesh nuk donin ta dallonin veten e tyre nga këngëtari popullor, poezinë e tyre nga poezia e popullit, e, megjithatë, në folklorizantë nuk u kthyen. Në krijimtarinë e tyre ata shkrinë e bënë një thelbin e poezisë popullore me vokacionin e tyre poetik, me personalitetin e tyre artistik. De Rada është poeti i parë shqiptar, që është në gjendje të kuptojë në thelb rëndësinë e letërsisë popullore, të çmojë domethënien e saj historike, të çmojë bukurinë e saj artistike dhe ta popullarizojë në përpjestime pak a shumë evropiane. I dha përmbledhjes së vet folklorike titullin e bujshëm "Rapsodi e një poeme shqiptare", duke pasur idenë se këto këngë janë fragmente të një poeme të madhe kombëtare e duke shprehur një bindje të përgjithshme të romantikëve shqiptarë, se prej këtyre këngëve mund të rindërtohen qartë natyra, mentaliteti, doket dhe historia shpirtërore e shqiptarëve në të kaluarën e tyre.

Abstract

Arbëresh poets, like all poets of the National Renaissance, with their art, are firstly distinguished for the creative support in folklore, realized in a masterful way, without compromising at all their individuality as artists. They often did not want to distinguish themselves from the popular singer, their poetry from the poetry of the people, and yet they did not turn to folklorists. In their creativity they merged the essence of folk poetry with their poetic vocation and their artistic personality. De Rada is the first Albanian poet who is able to understand the essence of popular literature, to appreciate its historical significance and its artistic beauty as well as to popularize it in more or less European proportions. He gave his folklore collection the sensational title "Rhapsody of an Albanian poem", having the idea that these songs are fragments of a great national poem, and expressing a general conviction of Albanian romantics. From these songs the nature, the mentality, the customs and the spiritual history of Albanians in their past can be reconstructed clearly.

Poetët arbëreshë, ashtu si gjithë poetët e Rilindjes Kombëtare, me artin e tyre, dallohen, së pari, për mbështetjen krijuese në folklor, realizuar në mënyrë mjeshtërore, pa cenuar aspak individualitetin e tyre si artistë. Ata shpesh nuk donin ta dallonin veten e tyre nga këngëtari popullor, poezinë e tyre nga poezia e popullit, e, megjithatë, në folklorizantë nuk u kthyen. Në krijimtarinë e tyre ata shkrinë e bënë një thelbin e poezisë popullore me vokacionin e tyre poetik, me personalitetin e tyre artistik.[1]

Prof. Çabej, argumentimin e rolit dhënës të letërsisë gojore në raport me letërsinë e shkruar, qoftë në kuadrin nacional, qoftë në atë ballkanik, e lidh me një varg faktorësh të jetës së popujve e në mënyrë të veçantë me disa cilësi të letërsisë gojore, e cila, duke qenë më e vjetër dhe me një traditë më të madhe ekzistimi dhe transmetimi, ka pasur ndikim më të dukshëm në letërsinë e shkruar. Ai thotë: *"Është një influencë e madhe e poezisë popullore mbi shkrimtarin. Kjo shpjegohet me lidhjen e ngushtë që ka poezia popullore me jetën shpirtërore të këtyre popujve. Poezia popullore është ndër këta e gjallë e produktive, prandaj komponentja e këngës popullore është kudo e dukshme. Kjo influencë shprehet në lëndë, në formën e përbrendshme, në ritëm, metrikë si dhe në veçanti.*

Nuk ekziston këtu një poezi me të vërtetë krijuese, e cila të mos bazohet shpirtërisht te populli. Jo se s'ka poetë që të kenë ecur në rravat e artit të huaj, dhe, pa pasur asnjë lidhje organike, të kenë mbetur formë e zbrazët. Por përgjithësisht këtu poetët kanë dalë prej tokës së natyrshme të poezisë popullore."[2]

E konkretisht, De Rada, më së pari shfaqet si evidentues i kulturës popullore shqiptare, realizuar në veprën "*Rapsodi e një poeme shqiptare"* që është përmbledhja e parë e rëndësishme e poezisë sonë popullore dhe e para në të cilën gjen përmbushjen e plotë koncepti romantik mbi letërsinë popullore, mbi mënyrën e mbledhjes dhe të paraqitjes së saj.

De Rada krijoi në një periudhë kur letërsia shqipe duhej të dilte prej guackës së vjetër fetare. Që të ndodhte kështu, De Radën e ndihmoi për nga forma kënga popullore arbëreshe, kurse për nga përmbajtja tematika historike. Me të drejtë Çabej për De Radën thekson: *"...tek ai kemi notën e subjektivizmit dhe shënimet autobiografike, pastaj kthimin në mesjetë, zmadhimin e së kaluarës së popullit të vet, dashurinë ndaj ngjarjeve të mëdha historike....Romantizmit i përgjigjet lidhja me poezinë popullore, sidomos naiviteti dhe magjepsja nga e kaluara".*[3]

De Rada është poeti i parë shqiptar, që është në gjendje të kuptojë në thelb rëndësinë e letërsisë popullore, të çmojë domethënien e saj historike, të çmojë bukurinë e saj artistike dhe ta popullarizojë në përpjesëtime pak a

---

[1] Xhiku, A:*Disa tipare të stilit në poezinë arbëreshe,* Romantizmi arbëresh,. Tiranë, 1980, fq. 150.

[2] Çabej E:*Për gjenezën e literaturës shqipe,* Studime gjuhësore, V, Prishtinë,1975, fq.133.

[3] Çabej, E:*Studime gjuhësore,* V, Prishtinë, 1975. fq. 335.

shumë evropiane. I dha përmbledhjes së vet folklorike titullin e bujshëm *"Rapsodi e një poeme shqiptare"*, duke pasur idenë se këto këngë janë fragmente të një poeme të madhe kombëtare, e duke shprehur një bindje të përgjithshme të romantikëve shqiptarë, se prej këtyre këngëve mund të rindërtohen qartë natyra, mentaliteti, doket dhe historia shpirtërore e shqiptarëve në të kaluarën e tyre.

Duke vepruar kështu, ai donte të arrinte disa qëllime:

- së pari, të propagandonte idenë se dhe shqiptarët, ashtu si popujt e tjerë me individualitet të theksuar etnik, kishin pasur eposin e tyre mesjetar, që u thërrmua nga koha.
- së dyti, pavarësisht nëse pranohej apo s'pranohej ekzistenca e eposit kombëtar, kjo ndërmarrje duhej të tërhiqte vëmendjen ndaj vlerave autentike të folklorit arbëresh, vlera që romantiku De Radë i vë mbi ato të letërsisë së kohës dhe i konsideron si *"shembull i gjallë për artin poetik evropian"*[4]
- së treti, ndërmarrja e De Radës, duke u paraqitur si e papërfunduar, fragmentare, me mungesë pjesësh të tëra, me një renditje hipotetike etj., synonte t'i nxiste bashkatdhetarët të interesoheshin për gjurmimin e vlerave të ngjashme në popull, më shumë se ç'do ta bënte këtë ngrehina e një eposi imagjinar e plotësuar dhe e përfunduar plotësisht.

Në vitin që u botua ***"Rapsodi e një poemi arbëresh"*** shtypi italian i kohës do të ekzaltohej: *"Është një frymë e shenjtë, një aromë hyjnore e poezisë lindore e të re…këto janë pjesë të një poemi të mrekullueshëm".* [5] Kurse më 1884 shtypi parizian do të shkruante për variantin e ri të *Rapsodive* që qe botuar në *"Flamuri i Arbërit": "Një origjinalitet mahnitës, një fuqi shprehjeje (që nuk ekziston më veçse te popujt që kanë një jetë epike ose që, së paku, për traditë të poezisë së tyre u shërben eposi) kanë gdhendur te këto këngë një tipar origjinal dhe u kanë dhënë një ngjyrë e një shijë të veçantë*[6]

Këngët e mbledhura u bënë për De Radën burim admirimi: *"Gjithmonë,* - kujton më pas ai, - *mbetesha i mahnitur nga idetë e thjeshta dhe forma e këngëve arbëreshe".* [7] Por poeti nuk mbeti thjesht tek admirimi; sipas dëshmisë së tij me mbledhjen e këngëve zuri fill studimi i gjuhës amtare dhe përpjekja për të vjershëruar në shqip.

Duke qenë se poezia e romantizmit shqiptar krijohej krahas me mbledhjen dhe publikimin e letërsisë popullore, ishte e pamundur, që një krijues, i cili e mblidhte letërsinë popullore, të mos nxitej prej saj. Këtë e dëshmon roli i strukturës folklorike në strukturën e poezisë romantike.

---

[4] Biblioteca Albanese, Publikim i "Flamurit të Arbërit", fq. 3.

[5] Stratico, A:*Manuale di litteratura Albanese,*Del prof. Albert Stratico, Ulrico Hopel,Editore-libraio della real caso, Milano, 1896. fq.62.

[6] Po aty. De Rada, G:Autobiologia, Primo Periodo, Cosenza,1898, fq.10.

[7]

Në 6 janar 1834 hartoi me mend idilin *"Ish e diela me natë"*.[8] Vargjet shqip rrodhën natyrshëm në metrat e folklorit arbëresh, madje, s'është mbase e rastit që, në këtë sprovë të parë poetike, vargjet nuk u shkruan, siç e kishte bërë zakon poeti, po u hartuan me mend e u përsëritën me gojë, përafërsisht ashtu siç kishte vepruar shekuj me radhë rapsodi popullor.

Shkruan dhe boton poemat e rëndësishme, "*Këngë të Milosaos bir i sundimtarit të Shkodrës", "Këngë historike shqiptare të Serafina Topisë, grua e princit Nikollë Dukagjini",* të cilat dëshmojnë se në poetikën e tij romantike kanë depërtuar komponentët e krijimtarisë popullore, si gjuha, ritmi, figura, lloji etj. Lidhjet e imagjinatës së tij me imagjinatën e krijuesit popullor do të jenë gjithnjë e më krijuese.

Kaq afër poezisë popullore është De Rada në këto këngë të para të artikuluara shqip, saqë studiues me përvojë të letërsisë dhe folklorit arbëresh si Ferrari e Shuteriqi i morën për krijime popullore të 14 strofat e shkruara nga poeti i Makit dhe të shënuara bashkë me 28 strofat popullore në radhuan e Frashinetës, radhua ku me sa duket poeti i ri shënoi këngë popullore që nisi t'i mblidhte më 1833 e midis tyre shkroi edhe vjershat e para shqip, që krijoi vetë, duke imituar këngët popullore.[9] / [10]

Prof. F. Altimari me veprën e tij "*I canti premilosaici"* botuar më 1998, në Catanzaro ka sjellë një kontribut vendimtar, duke treguar në mënyrë të detajuar fillesën folklorike të rrugës krijuese të De Radës.

Përbën dëshmi të një talenti të madh, të një force jo të zakonshme asimiluese e krijuese, fakti që gjatë 2-3 vjetëve, prej fillimeve poetike në shqip gjer te botimi i *Milosaos*, De Rada ia doli mbanë të shkëputej pothuajse plotësisht nga imitimi i poezisë popullore arbëreshe dhe ta shfrytëzonte përvojën folklorike në mënyrë krijuese.

Së pari, De Rada do të kujdeset që edhe me kompozicionin e këngëve, të dëshmojë se këngët e veçanta të poemave të veçanta, në të cilat këndohet jeta e disa personazheve të shquara, janë rapsodi të ripërtëritura shqiptare të shekullit XV. Për këtë arsye këngët e poemave të tij, të shkruara në gjuhën shqipe, në tërësi imitojnë formën e rapsodive popullore. Në mbështetje të këtij mendimi shërben edhe parathënia e poemës "*Skanderbeku i pafan",* ku De Rada pohon: *"Formën e këngëve unë e mora prej rapsodive që sollën me vete prej atdheut, Shqipërisë, që, në vetvete, janë pjesë të fondit të përbashkët popullor, prej të cilit ka lindur çdo poezi heroike e vetvetishme e*

---

[8] Po aty, fq. 11

[9] Shuteriqi, Dh. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Akademia e Shkencave e RPS të SHqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë. Tiranë, 1976. F. 203.

[10] Haxhihasani, Q. *Rreth dorëshkrimit të Mikel Belushit dhe disa çështje të folklorit arbëresh.* Studime filologjike. Nr. 2. F. 174.

kombeve evropiane. Për sa i takon përmbajtjes, desha, në trajtën që më dhe atdheu im, të përfytyroja jetën ashtu si bëhet e si duhet në shtëpinë e tij".[11]

Së dyti, poezia e De Radës e përngjason poezinë popullore shqipe edhe në ndërtimin e saj kohor. Ashtu si rapsoditë popullore edhe poezitë e tij nuk janë poezi për të sotmen, por poezi për të kaluarën e largët apo më të largët. P.sh. në të gjithë veprën *"Këngët e Milosaos"* ndihet tingulli i veçorive imtësore të jetës shqiptare që e rrethon; loja e diskut dhe e unazës, vallja rrethore tipike tradicionale, kremtimet karakteristike të Pashkëve ortodokse, supersticionet. Ndihet aroma e zakoneve të lashta shqiptare, fryma e një jete që zhvillohet përqark hijes së ikonostaseve dhe ritmit të traditave të paepura etnike, të cilat i zbulon në përditshmërinë e një jete të zakonshme.

Së treti, De Rada do të kujdeset që edhe vargun e tij ta ndërtojë të ngjashëm me vargun e këngëve popullore, si në strukturën metriko-ritmike dhe figurative. Eqrem Çabej, në punimin e tij, "*Vatra dhe bota në poezinë e De Radës",* shkruan se masa e vargut të De Radës nuk është numerike, si në poezinë italiane; ajo është thjesht shqiptare, ritmike, determinuar nga mëshimi i aksentit e nga alternimi i gjatësive me shkurtësitë.[12] Pra, si në poezinë popullore, e cila këndohet, edhe në poezinë e De Radës masën e vargut, strukturën metriko-ritmike të vargut, nuk e caktojnë rrokjet, por theksi, gjatësia dhe shkurtësia e tyre.

Për sa i përket strukturës metriko-ritmike të vargjeve të tij, De Rada do të mbështetet në vargjet e rapsodive dhe mungesa e rimës është dëshmi e bindjeve se poezia e lashtë popullore nuk kishte rimë. Të tilla janë edhe rapsoditë që mbledh dhe boton në përmbledhjen *Rapsodi të një poeme shqipe*. Të qëndruarit larg rimës dhe afrimi me vargun popullor, zakonisht trokaik, flet për një prirje të poetit drejt formave më të lashta. Kjo mënyrë i shkon, ndoshta, arkaizmit të gjuhës së tij dhe e bën të rrjedhë muzikalisht poezinë, përmes një ritmi të natyrshëm dhe të lirë, në rregullsinë e tij.[13]

Në vargjet e Milosaos nuk gjendet asnjë lloj intonacioni sado i vogël retorik, asnjë gjurmë të njohur reminishencash libreske; ato janë vetëm një regëtimë e kthjellët jete shqiptare që shndërrohet vetvetiu në poezi. Mjafton të përmendim vargjet:

Vajzë, a m'ep ti një pikë ujë?

Sa të duash ti, bir zoti.

- Kuja bijë je ti vashë?

Mos më je nga dheu i huaj'....

Jam e bijë e Kollogresë,

---

[11] Girolamo de Rada. *Poesie albanesi. Vol. v. Scanderbeccu i pafaan. Storie del secolo XV*. Taluni bravi schiarimenti. Tip. F. Mormile, Napoli 1877; Jup Kastrati. *Jeronim de Rada. Jeta dhe veprat*. Tiranë 1977. F. 141-142.

[12] Çabej, E. *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës.* Ξερονιμ δε Ραδα. Τιρανë 1965. φ;. 52.

[13] Shapllo, D. *Poezia nëpër kohë*. Tiranë 1990. f. 62.

ngriti ballët e zbuluar….[14]

Së katërti, poezia e De Radës i ngjan poezisë popullore edhe në një sërë përbërësish stilistikë siç janë krahasimet, epitetet, simbolet, apostrofat, personifikimet, hiperbolat, metaforat dhe simbolet e shumta.

Dhe pse s'më foli kurrë prej syve unë ia vodha
zemrën, e s'di në i lumë u bëra apo i mjerë…[15]

Në vizatimin e peizazhit autori përdor një pasuri ngjyrash me shije dhe siguri prej piktori: e bardhë, e kaltër, gështenjë, e zezë, e kuqe, e artë, e verdhë.

Kaltëronte n'ditn' e re…[16]

Tek e bardha shpia ime…[17]

Vreshtat ishin verdhullore..[18]

Në të veshura të zeza…[19]

Lule të bardha, lule të verdha,[20]

Këto ngjyra kanë një funksion të caktuar emocional, në mënyrë të veçantë e bardha dhe e kaltra, ngjyra që ai i ka gjetur në peizazhin e vendlindjes dhe që simbolizojnë pastërtinë dhe delikatesën. Antitezat dhe simbolet janë të shpeshta dhe kanë rëndësi të veçantë shprehëse. Pranë simboleve që De Rada i ka të përbashkëta me romantizmin evropian, ndeshim edhe simbole shqiptare që poeti i ka thithur përmes limfës së këngës popullore siç janë mali, lisi dhe rrushi, të cilët mishërojnë qëndresën, forcën, rreptësinë dhe vitalitetin e popullit tonë; imazhi i luleve, bukurinë, hijeshinë; imazhi i rrushit pjellorinë dhe gëzimin. Këto imazhe rikthehen jo rrallë në funksione të ndryshme:

Rrusht', pak aguridhe,

dheut tonë i kishin hie….

Vreshtat ishin verdhëllore…

O e bukura motra ime,

mos ka rrush te varri yt?[21]

Poeti popullor i zgjidhte simbolet në mbështetje me natyrën shqiptare dhe janë të afërta e të kuptueshme për psikikën e popullit tonë. Dhe pikërisht të tilla simbole takohen dendur në një vepër thellësisht popullore si *"Këngët e Milosaos".* Me imazhin e lisit hapet kjo poemë, "*Lis jeta kishte ndrruar"* dhe po me këtë imazh mbyllet, "*Fryn er e malit, Dhe rrëzoi hijen e lisit."* Poeti merr për bazë dy tipare të ndryshme të lisit, jetëgjatësinë dhe

---

[14] Rada, d, J. *Këngët e Milosaos.* Vepra letrare I. Tiranë 1987. fq. 67-68.
[15]*Serafina Topia*. Vepra letrare 1. Tiranë, 1987. F. 235.
[16]*Milosao*…F. 65.
[17] Po aty, F. 65.
[18] Po aty, F. 67.
[19] Po aty, F. 91.
[20] Po aty, F. 126.
[21] Po aty, f. 65- 67- 116.

qëndresën.Edhe figura e malit përdoret me nuanca të ndryshme si simbol i krenarisë *(kënga e VIII e "Milosaos")* ose i qëndresës *(kënga XI e "Milosaos").*

Së pesti, lidhjen krijuese të poezisë së De radës me poezinë popullore, e dëshmojnë edhe këngët e valleve, domethënë koret që ai fut në poemat e tij, duke filluar prej poemës, "*Këngët e Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës".*

Në fillimet poetike të tij në gjuhën shqipe, këngët e valleve, pra koret, janë më të rralla. Në versionin e parë të botuar të poemës "*Këngët e Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës"* janë vetëm dy këngë kori, kurse në poemat e mëvonshme dhe në versionet e mëvonshme të poemave këto këngë të rralla shtohen.

Po të kihet parasysh se De Rada është poet që kujdeset ta ripërtërijë përvojën poetike popullore me të gjithë përbërësit e saj kompozicionalë, metrikë, ritmikë dhe figuracion,po të kihet parasysh se ai është poet që kujdeset ta ripërtërijë traditën kulturore popullore si përbërës funksional të programit të tij kulturor dhe historik patriotik, atëherë do të jetë e qartë se vallet e tij, dëshmojnë se janë krijuar para së gjithash nën ndikimin e traditës popullore shqiptare. Kënga e valles, në traditën popullore shqiptare, por edhe në traditën e popujve të tjerë, është formë e ruajtur artistike e ritualit, në të cilin loja dhe kënga ende qëndrojnë bashkë. Komponenti i valles, mund të çmohet si njëri prej komponentëve më nxitës të traditës popullore në krijimtarinë e Jeronim de Radës.

Kështu u krijua arti deradian që njohim, me vlerat e mëdha poetike të tij, një art sintetik, shumë evokues, i ngjeshur në maksimium në përmbajtjen e pasur.

Literatura:

Xhiku, A. *Disa tipare të stilit në poezinë arbëreshe.* Romantizmi arbëresh. Tiranë, 1980.

Çabej, E. *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës.* Jeronim de Rada. Tiranë 1965.

Çabej E. *Për gjenezën e literaturës shqipe*. Studime gjuhësore V. Prishtinë 1975.

Çabej, E. *Studime gjuhësore*. V. Prishtinë, 1975.

Shuteriqi, Dh. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850.* Akademia e Shkencave e RPS të SHqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë. Tiranë, 1976.

Shapllo, D. *Poezia nëpër kohë*. Tiranë 1990.

Rada, d, J. *Këngët e Milosaos.* Vepra letrare I. Tiranë 1987.

Rada, d, J. *Serafina Topia*. Vepra letrare 1. Tiranë, 1987.

FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES NË TË FOLMET E NDRYSHME TË TREVAVE SHQIPTARE DHE NË TREVAT SHQIPFOLËSE

Mimoza Zekaj
Departamenti i Gjuhës Shqipe, Universiteti "Eqrem Çabej"
mimoza_zekaj@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtojmë gjendjen e sotme të formave të pashtjelluara të foljes në të folmet e ndryshme të trevave shqiptare, si dhe në trevat shqipfolëse, të paraqitura në Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe, vëllimi I. Në Atlasin dialektologjik vëmë re se foljet në pjesore nuk kanë të njëjtën formë. Në pjesën më të madhe të të folmeve të Jugut, pjesorja e pjesës më të madhe të foljeve del e pareduktuar. Në të folmet e Veriut, si pasojë e zhvillimeve fonetike që kanë ndodhur te trajta e pjesores, ky grup i foljeve del pa mbaresë. Në dialektet e shqipes përcjellorja ka forma që ndërtohen duke u shtuar formave të pjesores pjesëzat përkatëse, të cilat dalin me larmi fonetike si në dialektin e toskërishtes dhe në gegërishte. Paskajorja, si formë foljore perifrastike e krijuar Brenda shqipes gjatë zhvillimit të saj historik, ekziston në të dy dialektet e shqipes. Dallimet themelore shihen në mënyrat e ndryshme të ndërtimit të saj dhe në masat e ndryshme të përdorimit të këtyre varianteve nëpër dialekte. Duke vëzhguar hartat e Atlasit dialektologjik dhe duke u mbështetur në përfundimet e disa studiuesve, vëmë re se klasifikimi i dallimeve morfologjike, duke u nisur nga kriteri strukturor dhe funksioni i formave dhe mjeteve gramatikore, nxjerr më mirë në dukje shkallën e dallimeve të dialekteve.

***Fjalët kyçe**: Atlas Dialektologjik, pjesore, përcjellore, paskajore, këndvështrim.*

Abstract

This study is focused on the current characteristics of non-finite forms of the verbs in the vernacular languages in Albania as well as Albanian language speaking regions, as they are introduced in the Dialectology Atlas of Albanian Language, Volume I. In this atlas, we observe that verbs in their Past participle do not keep the same form. In the majority of cases in the south dialect, the past participle of most verbs has unreduced forms. In the north dialect, due to the phonetic development affecting the past participle form, this verb group does not appear to have any ending. In the Albanian dialects, the non-finite form of gerund is structured by adding to the past participle form the related particles, which display a phonetic variety in both dialects of Tosk and Gheg. The infinitive as periphrastic verb form, which

has evolved within the Albanian language as a product of historical development, exists in both dialects. The main differences are noticed in the different structural ways and the amount of variants use in the dialects. By observing the maps of the Dialectological Atlas and being based on the conclusions of some scholars, we come up with the idea that the classification of morphological distinctions by taking into consideration the structural criterion and the function of grammatical means and forms clearly highlights the degree of differences in these dialects.

Key words: *Dialectological Atlas, participle, gerund, infinitive, viewpoint.*

Në këtë punim do të trajtojmë gjendjen e sotme të formave të pashtjelluara të foljes, si: pjesoren, përcjelloren, paskajoren si në të folmet e ndryshme të trevave shqiptare, ashtu edhe në trevat shqipfolëse, të cilat janë paraqitur në Atlasin Dialektologjik të gjuhës shqipe, vëll. I. Materiali dialektor mbi të cilin jemi mbështetur, është i paraqitur në hartat nr. 128, 129 a b. c. ç, 130 të këtij Atlasi.

Pjesorja shpreh një veprim jo si proces, por si tipar. Ajo është një formë foljore e ngurosur që kthehet në mbiemër me ndihmën e nyjës së përparme. Përgjithësisht, është e kohës së tashme në pësore, por e përdorur në funksion mbiemri ka kuptim vepror[1]. Pjesorja përdoret me vlerë foljore pas foljeve modale *do, duhet*, si edhe shërben si pjesë përbërëse e një vargu formash foljore analitike e sintetike[2].

Pjesorja është një trajtë foljore e pashtjelluar, që merr pjesë në formimin e trajtave foljore të përbëra dhe ka variantet dialektore nëpër të folmet e shqipes[3]. Duke kundruar Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe vëmë re se foljet në pjesore nuk kanë të njëjtën formë. Kjo vjen si rezultat i larmisë së mbaresave me të cilat dalin kategori të ndryshme foljesh.

Në pjesën më të madhe të të folmeve të Jugut, pjesorja e pjesës më të madhe të foljeve del e pareduktuar. Më konkretisht:

Të gjitha foljet që u mbaron tema me **bashkëtingëllore** në dëftoren e tashme (me përjashtim të atyre që u mbaron tema me **l, ll, r**) dhe e formojnë të kryerën e thjeshtë me fundoret ***–a*** ose me ***–ta, -jta,*** e formojnë pjesoren me fundoren ***–ur***: *veshur, goditur, shitur* etj. Kjo vihet re në pjesën më të madhe të të folmeve të toskërishtes jugore e veriore, në pjesën më të madhe të të folmeve kalimtare, por në Belsh, Gjinar të Elbasanit, si pasojë e dukurisë së rotacizmit që ka ndodhur në dialektin e toskërishtes (n/r), mbaresa e pjesores së këtij grupi foljor del me dy trajta: me **–ur** dhe me **–un**. Po kështu paraqitet edhe në të folmen e Spolatë –Lushnje, në të folmet e Çamërisë, si: në Filat, Karbunarë-Pramithi, Apricë-Pargë, Muzhakat etj. Del me këtë formë në

[1] F. Agalliu, "Pjesorja në gjuhën shqipe". SF, 2, 1972, f. 57.
[2] Xh. Gostrurani, "Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e gegërishtes verilindore". SF, 1-4,1994, f. 131.
[3] J. Gjinari, Gj, Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2003, f. 241.

pjesën më të madhe të të folmeve të Arbëreshëve të Italisë, si: në Portokanone -Molize, në Greci, Lungro – Kalabri, Plataçi, S. Benedeto, Maki, Falkonara, Carafa- Ktanxaro –Klabri. Ndeshet dhe në të folmen aravanitase në Salaminë të Greqisë, Kështu paraqitet edhe në Ohër, Resnjë, Manastir – Maqedoni.

Me mbaresën **–un** (**-ur**, si pasojë e dukurisë së rotacizmit që ka ndodhur në dialektin jugor), pjesorja del në Gurë –Lurë -Peshkopi, Tanushaj-Dibër - Maqedoni. Me këtë trajtë del edhe në Xërxe – Drenicë, në Korishtë – Prizëren Kosovë, si edhe në Preshevë –Serbi.

Në pjesën më të madhe të të folmeve të Veriut, si pasojë e zhvillimeve fonetike që kanë ndodhur te trajta e pjesores, ky grup i foljeve del pa mbaresë, pothuajse, në të folmet e gegërishtes, Kosovë, Shkup, në Muriq-Ulqin, Tivar, në Arbnesh- Ulqin, në Pikal – Podgoricë, në Baçicë – Peshter – Serbi, te arbneshët e Dalmacisë.

Pak trajta pa mbaresë për pak folje të këtij grupi i ndeshim edhe në ndonjë të folme jugore, si në Sheper – Zagori, ku vihet re trajta *ardhë* për *ardhur*, apo në Delvinë vihen re trajtat *vjedh* dhe *vel* për trajtat *vjedhur* dhe *vjelur*. Në Pandelejmon – Vurg, Sarandë vihet re trajta *prish* për *prishur*.

Të gjitha foljet me bashkëtingëllore, tema e të cilave mbaron në dëftoren e tashme me: **l,ll, rr** dhe e formojnë të kryerën e thjeshtë me apofoni, dalin me mbaresën **–ë**: *dalë / dal, da:l;vjellë / vjell, vje:ll; marrë / marr, ma:rr*, formë që mbizotëron në toskërishte dhe në gegërishte, por në të folmet veriore, për shkak të veçorive fonetike që kanë të folmet, mbaresa **–ë,** nuk del në asnjë vend: *vjel, mjell, marr*[4].

Edhe një grup foljesh të parregullta ose gjysmë të rregullta, si: *them, jap, vë, lë, zë*, dalin me mbaresën **–n(ë):***dhënë, dha:n.* Me mbaresën **-ë** e formojnë pjesoren kjo kategori e foljeve në Filat, Karbunarë – Paramithi, Apricë, Muzhakat – Prevezë, në Çamëri, si edhe në Karfici –Kalabri, Itali; në Salaminë – Greqi. Variantet pa **ë-në** fundore dalin edhe në disa treva shqipfolëse, si: Baçicë –Peshter, Serbi; në Arbnesh –Zara, Dalmaci.

Me mbaresë të dyfishuar duke marrë edhe **–ur (-un / -ën)** si mbaresë të dytë (*dalur, dhënur / dhanun, thënur/ thanun, vjellur / vjellun, lënur / lanun, zënur/ zanun* etj.), ndeshen në disa treva shqiptare dhe shqipfolëse. Trajtat *dalur, dhënur, thënur, vjellur, lënur, zënur, marrur*, dalin në të folmet e Labërisë, në Lukovë – Bregdeti i Poshtëm, si dhe në të folmen e Piana deli Albanezi – Sicili. Në Progonat, në Sheper, në Pandelejmon –Sarandë, në Resnjë – Prespë, me mbaresë të dytë del vetëm folja *vjelur*, ndërsa në Korçë del vetëm folja *tjerur "tjerrë*". Format me mbaresën **–un**: *dalun, dhanun, thanun, vjellun, lanun, zanun*, i ndeshim në Gur – Lurë –Peshkopi, në Resnjë – Prespë-Maqedoni, në pak të folme në gegërishten verilindore, si: Xërxe-Drenicë, Korishtë-Prizëren, në Preshevë.

---

[4] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2003, f. 242.

Mbaresa e pjesores për disa folje që u mbaron tema **me zanore,** në dëftoren e tashme dhe që e bëjnë të kryerën e thjeshtë me **–va** ose me **–ra**, del me **r(ë), (-n)**:*larë* dhe *pa mbaresë: la:* etj. Në të folmet e toskërishtes pjesoret e këtyre foljeve kanë mbaresën **–r(ë)**; *larë, punuar, bërë, pirë, vrarë* etj. Edhe në pjesën më të madhe të të folmeve kalimtare, si në ato të krahut lindor dhe ato perëndimor, mbaresa e pjesores së kësaj kategoria të foljeve del me këtë mbaresë. Mbaresa e pjesores del me këtë trajtë edhe në Salaminë, në Portokanone-Molize, në Greçi-Kampania, Karfici-Kalabri, Carafa-Kalabri, në Piana d' Albanezi-Palermo. Në të folmet veriore foljet e kësaj kategorie dalin pa mbaresë në pjesore, si: *la, ba, pi, vra, punu/punue, punua/punuo*. Kjo ka ndodhur nga zhvillimet fonetike që kanë ndodhur te trajta e pjesores në Veri[5]. Edhe në Arbnesh – Zarë, Dalamci, në pak pika në të folmet kalimtare, si: në Gjinar-Shpat, Belsh pjesorja e këtyre fojeve del pa mbaresë. Në Elbasan mbaresa e pjesores del edhe me mbaresën **–m**: *la:m*. Në Magurë-Prishtinë del varianti *la:n*. Në Tanushaj-Dibër, Maqedoni për foljen *bëj* ka dalë varianti me mbaresën **–t***ba:t*. Në disa të folme të gegërishtes veriore dhe herë-herë edhe në gegërishten verilindore, si në Xërxe-Drenicë, në Korishtë-Prizëren, Nishor-Prizëren, dalin trajtat me mbaresë të dyfishuar, si: *banën/bamun, thanën/ thanun* etj.

Pjesorja e foljes ***bie*** në dialektet e shqipes ka disa forma. Me mbaresën **–në** (*rënë/ranë*) del në toskërishte. Kjo formë del edhe në Salaminë-Greqi, te disa të folme arbëreshe, si: Piana d' Albanezi –Palermo, në Karfici –Kalabri. Trajta ***ran***, del në Rosek –Mirditë. Trajta pa mbaresë **(ra:)** mbizotëron thuajse në tërë gegërishten. Del edhe në Baçicë – Peshter, Serbi.

Me mbaresën **–r(ë)** dhe me zanoren **a** në temë (***rarë / rar***) del në ndonjë të folme të toskërishtes jugore, si: Progonat – Tepelenë, në Fterrë –Sarandë, në ndonjë të folme kalimtare, si në Belsh-Dumre, Gjinar-Shpat, në disa të folme të arbërshëve të Italisë, si: Greçi – Avellino –Kampania, në Karfici –Kalabri, në Piana d'Albanezi-Palermo.

Me mbaresë të dyfishuar, duke marrë dhe **–ur (-un/-ënë**) (*ranun/ranun/ranën*) del në ndonjë të folme të gegërishtes veriore, si në Pikal –Podgoricë, në Tuz-Hot, në Vermosh-Malësi e Madhe, por edhe në disa të folme të gegërishtes verilindore, si në Xërxe-Drenicë, Nishor-Prizëren, Korishtë –Prizëren.

Me mbaresën **–t** (**rat/ra:t**) del në zonën e Konispolit-Çamëri, në disa të folme të diasporës arbëreshe. Sipas prof. Gj. Shkurtaj, në jo pak raste, sidomos në brezin e vjetër, deri vonë ka pasur gjurmë edhe në gegërishten veriore, p.sh. *jam çuo e rat s'kam të:j* (Malësi e Madhe)[6].

Përcjellorja shpreh një veprim suplementar dytësor të lidhur zakonisht me një veprim tjetër e që ka karakteristika të foljes e të ndajfoljes[7]. Sipas prof.

---

[5] Po aty.
[6] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes*. Tiranë, 2012, f. 102.
[7] M. Çeliku, "Kategorizimi i formave të pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe (gerund)". SF, 1, 1984, f. 140.

Sh. Demiraj elementi i dytë i përcjellores ka qenë një emër prejpjesor i paranyjëzuar, ndërsa elementi i parë në zanafillë ka qenë një parafjalë, mbase me origjinë ndajfoljore[8]. Në dialektet e shqipes përcjellorja ka forma që ndërtohen duke u shtuar formave të pjesores pjesëzat përkatëse, të cilat dalin me larmi fonetike si në dialektin e toskërishtes dhe në gegërishte. Forma **duke + pjesoren** e toskërishtes del në gjithë toskërishten, por mbisundon në toskërishten veriore. Kjo formë del edhe në Karbunarë-Çamëri, në Tushemisht –Pogradec, në Resnjë-Prespë.

Forma **dyke + pjesoren** e toskërishtes mbizotëron në toskërishten veriore të anës lindore, si: Slabinjë-Pogradec, Korçë, në Taçi i Madh-Ersekë, në Leskovik. Forma **tuke / tukë + pjesoren** e toskërishtes del në toskërishten jugore. Kjo formë del edhe në Nikollarë-Korçë, në Apricë -Çamëri, në Salaminë-Athinë, në San Benedeto-Kozenca, Kalabri. Forma **tyke + pjesoren** del në disa të folme të ndërmjetme midis gegërishtes jugore dhe toskërishtes veriore edhe në disa të folme kalimtare, si: në Radolishtë – Strugë, në Elbasan, në Gjinar-Elbasan, në Poshjne- Berat, në Spolatë – Lushjne, në Seman –Myzeqe.

Forma **dikue + pjesoren** del kryesisht në disa të folme të Çamërishtes, si: Filat, në Konispol, në Muzhakat. Në një zonë të kufizuar, konkretisht në të folmen e Matogjinit –Vlorë, ka dalë edhe forma **tu + pjesoren** e foljes.

Në të folmet e gegërishtes, por edhe në ndonjë të folme të toskërishtes dalin kryesisht këto forma: forma **tue + pjesoren** del në gegërishte gjerësisht e përdorur, del edhe në Arbnesh –Zara, Dalmaci. Kjo trajtë ndeshet edhe në ndonjë të folme të toskërishtes, si në Dukat –Vlorë, por edhe në disa të folme te arbëreshët e Italisë, si: Portokanone –Molize, në Plataçi – Kozenca, në Maki –Kozenca, në Carafa-Kalabri. Kjo formë del edhe në Mollas –Elbasan, në Rreth-Greth-Kavajë. Forma **tuo + pjesoren** del në pak të folme si në Vrith –Malësi e Madhe, në Gërdovc –Podujevë. Forma **tu + pjesoren** mbisundon në gegërishten veriore e verilindore. Kjo formë del edhe në disa të folme të gegërishtes si në Petrelë, në Tiranë, Kavajë, në Prosek –Mirditë, në Gërman –Mat, në Tërbaç –Dibër, në Tanushaj- Dibër, në Zhitoshë – Prilep, në Ravenë –Gostivar, në Zajas –Kërçovë.

Forma **tuj + pjesoren** del në disa të folme të gegërishtes verilindore, si: Korisht –Prizëren, në Berishë –Drenicë, në Xërxe –Drenicë, në Gjakovë, por edhe në Odër –Tetovë. Kjo formë del edhe në dy pika të tjera në gegërishte, si në Martinaj –Plavë-Mali i Zi, në Prosek – Mirditë. Forma **tye + pjesore** del në disa të folme të gegërishtes, si në Pikal –Hot, në Tuz –Hot, në Vllane –Podgoricë, në Drelaj –Pejë, në Pejë, në Junik –Gjakovë, në Tërstenë – Mitrovicë, në Velegllavë –Kosovë. Kjo trajtë del edhe në Dorëz, Bërzeshtë – Librazhd dhe në Belsh Elbasan. Forma **tyj + pjesoren** del në pak të folme, kryesisht të gegërishtes, si: Arbnesh –Ulqin, në Ulqin, si dhe në Peqin, Dorëz të Elbasanit.

---

[8] Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986, f. 974.

Paskajorja, si formë foljore perifraztike e krijuar brenda shqipes gjatë zhvillimit historik të saj, ekziston në të dy dialektet e shqipes. Dallimet themelore shihen në mënyrat e ndryshme të ndërtimit të saj dhe në masat e ndryshme të përdorimit të këtyre varianteve nëpër dialekte[9]. Tipi i paskajores së gjuhës letrare i përbërë nga pjesëza parafjalore ***për*** dhe ***emri foljor asnjanës*** i pashquar, del në mbarë toskërishten, në të folmet kalimtare, por më së shumti në krahun lindor dhe më pak në krahun perëndimor, si në Spolatë –Lushnje, Rreth –Greth –Kavajë. Këtë formë rrallë e ndeshim edhe në ndonjë të folme të gegërishtes, si në Macukull –Mat, në Kaçanik –Kosovë, në Arbënesh –Zara-Kroaci.

Për të folmet e gegërishtes, sidomos në të folmet e gegërishtes veriore dhe qendrore dhe në të folmet perëndimore të Shqipërisë së Mesme, përdoret gjerësisht paskajorja e formuar nga pjesëza përemërore **me** dhe nga **pjesorja e foljes**. Në anët e Elbasanit dhe në të folmet kalimtare është pak e përdorshme. Që në librin e parë të shqipes, paskajorja e tipit **me punue** paraqitet si një formë foljore e ngulitur mirë në dialektin verior me të gjitha tiparet morfologjike dhe në pjesën më të madhe të rasteve dhe me funksionet sintaksore që ka edhe sot kjo formë në këtë dialekt[10].

Në gegërishten veriore, sidomos në atë verilindore, del e përdorur gjerësisht edhe forma **për + me + pjesore**, si fomë e dytë, krahas paskajores së tipit **me + pjesore**. Sipas prof. S. Mansakut: [...] *se shqipja e veriut për të dalluar më mirë ndonjë funksion sintaksor të paskajores, merr ndonjëherë para pjesëzës **me** parafjalën **për**, duke krijuar kështu një formë të re të tipit **përme punue**. Kjo formë, që nuk takohet në letërsinë e vjetër shqipe, është një krijim i mëvonshëm dhe përdoret kryesisht në funksion qëllimor*[11]. Krahas disa të folmeve të gegërishtes verilindore që e gjejmë të përdorur gjerësisht këtë formë, del edhe në Shëngjin i Madh-Tiranë, por edhe në Arbënesh–Zarë-Kroaci. Te kjo e folme dalin të përdorura të tria trajtat e paskajores (*për të punuar; me punue; për me punue*).

Gjatë kundrimit të Atlasit Dialektologjik, vëmë re se ka edhe areale ku mungon plotësisht forma e paskajores dhe në vend të saj përdoret **lidhorja**. Ka disa të folme që lidhorja përdoret bashkë me formën **për + të + pjesore,** apo në ndonjë të folme të gegërishtes, bashkë me formën **me + pjesore**. Kjo vihet re në disa të folme të toskërishtes jugore, si në Dukat –Vlorë, në Gjirokastër. Vihet re mungesa e paskajores dhe përdorimi i lidhores edhe në disa të folme të Çamërisë, si: Karbunarë, Apricë, Muzhakat. Mungon tërësisht forma e paskajores dhe në vend të saj përdoret lidhorja edhe në disa të folme të Arbëreshëve të Italisë, si: Portokanone, Greci –Kampania, S. Benedeto, Karfici, Carafa –Kalabri. Lidhorja përdoret në vend të paskajores edhe në Dibër, si dhe përdoret bashkë me paskajoren në Tërbaç –Dibër.

---

[9] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2003, f. 240.
[10] S. Mansaku, "Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj". SF, 1, 1982, f. 139.
[11] Po aty, f. 140.

Sipas disa studiuesve, në gegërishten veriore është mjaft e përdorshme edhe një formë e kohës së shkuar të paskajores, e cila haset vetëm me një funksion sintaksor të caktuar, përdoret si folje-kallëzues e një fjalie kushtore në një periudhë hipotetike: *me pa kana j/kesh ngre vij (*me pas qenë*); mos me pa dit/kishe nejt (*me pasë ditë*);…as me m pa majt para duersh (*me pasë mbajtë*)* etj[12].

Duke vëzhguar hartat e Atlasit Dialektologjik dhe duke u mbështetur në përfundimet e disa studiuesve shqiptarë, themi se klasifikimi i dallimeve morfologjike, në përgjithësi, dhe i formave të pashtjelluara të foljes, në veçanti, duke u nisur nga kriteri strukturor dhe funksioni i formave dhe mjeteve gramatikore, nxjerr më mirë në dukje shkallën e dallimeve të të folmeve dhe dialekteve të gjuhës shqipe.

Shkalla e dallimit të dialekteve të shqipes dhe e sistemeve më të vogla brenda tyre nuk është e madhe. Dallimet e krijuara në të folmet e gjuhës shqipe në sistemin foljor janë kryer mbi një bazë të përbashkët strukturore, e cila shquan gjithandej më tepër sesa dallimet[13].

Bibliografia

Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe, vëll. I, Napoli, 2007.

Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë, 2002.

Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes*. Tiranë, 2012.

J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologji*. Tiranë, 2003.

F. Agalliu, "Pjesorja në gjuhën shqipe". SF, 2, 1972.

M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë, 2000.

M. Çeliku, "Kategorizimi i formave të pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe (gjerundi)". SF, 1, 1984.

S. Mansaku, "Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj", SF, 1, 1982.

Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986.

Xh. Gosturani, "Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e gegërishtes verilindore". SF, 1-4, 1994.

[12] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*. Tiranë, 2003, f. 241.
[13] Gj. Shkurtaj, *Dialektet e shqipes*. Tiranë, 2012, f. 89.

AROMANIAN IN "GRAMATICĀ AROMĀNĀ ICĀ MACEDONOVLAHĀ" BY MIHAIL G. BOIAGI

Spiridhulla Poçi
Departamenti i Gjuhës Shqipe, Universiteti "Eqrem Çabej",
spiridhulla_poci@yahoo.com

Abstrakt

Vepra "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā" e Mihail G. Boiagiut (1813) është vepra e parë në të cilën gjuha aromane ose vllahe është shkruar me alfabet latin. Ajo vjen pas shumë botimeve të tjera për aromanishten, veçanërisht fjalorët shumëgjuhësh të autorëve voskopojarë, shumë prej të cilëve janë shkruar me alfabetin grek.

Duke ndjekur modelin e gramatikës së gjuhëve të tjera, Boiagiu mundi të japë një pasqyrë të plotë të sistemit morfologjik të aromanishtes që flitej në Voskopojë dhe rrethinat e saj në shekullin e 18-të, me të gjitha karakteristikat e saj, si: lakimi i emrave, mbiemrave, përemrave; lidhja e foljeve në mënyra dhe kohë të caktuara, rregulla drejtshkrimore etj.

Gramatika e tij edhe sot ruan vlerën e saj si një metodë që ndihmon në përvetësimin e aromanishtes, e cila si gjuhë e zemrës dhe jo e bukës po asimilohet dalëngadalë në gjuhët e tjera të Ballkanit që kanë statusin e gjuhës zyrtare.

***Fjalët kyçe**: aromane, gramatikë, morfologjike, tekste, ballkanike*

Abstract

The work "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā" by Mihail G. Boiagi (1813) is the first work in which Aromanian or Vlach language was written in the Latin alphabet. It comes after many other publications on Aromanian, especially the multilingual dictionaries of Voskopoja authors, many of which are written in the Greek alphabet.

Following the pattern of grammars of other languages, Boiagi was able to give a complete picture of the morphological system of Aromanian spoken in Voskopoja and its surroundings in the 18th century, with all its characteristics, such as: inflection of nouns, adjectives, pronouns; conjugation of verbs in certain moods and tenses, orthographic rules, etc.

His grammar even today retains its value as a method helping in the acquisition of Aromanian, which being the language of the heart and not that of bread is slowly being assimilated into the other languages of the Balkan which have official language status.

***Key words:** aromanian, grammar, morphological, texts, balkan*

Voskopoja mbahej si qendra më e madhe tregtare në Shqipërinë Qendrore dhe Maqedoninë e Sipërme. Falë zhvillimit të tij ekonomik dhe kulturor, në shek. XVIII konsiderohej si qyteti i dytë i Ballkanit pas Stambollit [1] (Kostandinopojës). N. Hammond e quan atë "më të pasurën dhe qendrën më të rëndësishme të trevës[2]„. W. M. Leake e quan atë "vendbanimin vllah më të populluar dhe më të lulëzuar[3]„. Kjo qendër e rëndësishme e vllehve dallohej për një jetë të gjallë kulturore e fetare ku spikatnin 24 kishat e saj, një shtypshkronjë, një bibliotekë dhe më e rëndësishmja Akademia e Re (*Nea Akadhimia*), e cila pati një rol të rëndësishëm në arsimimin e të rinjve sipas kërkesave të kohës.

Për kohën kur është themeluar Voskopoja (Moskopolea, Moskopoli), ka mjaft diskutime. Studiuesit e sjellin krijimin e saj nga shek. XI deri në shek XIV. Poukouevilli përmend se Voskopoja u themelua nga vllehtë dasaretë në shek. XI në vendin ku më parë ka ekzistuar një venbanim më i lashtë[4]. Sipas një mbishkrimi në një prej kodikëve të gjetur në manastirin e Ioan Prodromit në Voskopojë[5], ku thuhet se ky manastir është ndërtuar në vitin 1630 dhe se përkon me 250-300 vjet pas krijimit të qytetit, duhet që Voskopoja të jetë themeluar në periudhën mes viteve 1330-1380.

Ekzistojnë të dhëna se në krahinat përreth Voskopojës ka pasur një popullsi vllahe në vazhdimësi që çoi në krijimin më pas prej saj të një qendre banimi në përmasat e një qyteti modern. Po të kemi parasysh se informacionet e drejtpërdrejta të asaj kohe për themelimin e Voskopojës dhe të qendrave të tjera rreth saj mungojnë, atëherë mund ta përforcojmë mendimin tonë të mësipërm qoftë edhe me një informacion indirekt. Në vitin 1020, me riorganizimin e kishës bullgare të Ohrit prezantohet dhe një *peshkopatë vllahe* që kishte nën juridiksionin e saj administrativ gjithë popullsinë vllahe të territorit të Arqipeshkopatës së Ohrit[6]. Qendra e kësaj *peshkopate vllahe* që njihej me emrin «*Βρεανύτης ήτοι βλάχων Επισκοπή*», nuk përmendet. Për herë të parë kjo *"επισκοπή βλάχων"* (peshkopatë vllahe) përmendet në katalogun e hierarkisë fetare të Aleks Komnenit në shek. XI. Në dokumentet e njohura deri tani "*episkopin"* e vllehve e gjejmë edhe në shek. XIII me emrin *"Βρεανόγου ήτοι βλάχων",* kurse pas shek. XV nuk përmendet më[7].

---

[1] K. Kallamata, Arti ikonografik në Shqipëri, në: www.korcavizion.com

[2] *N. Hammond*, A history of Macedonia, I, Oxford, 1972, fq. 232.

[3] W.M. Leake, Researches in Greece, London, 1814, fq.258, cituar sipas K. Kyçyku, Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik, fq.180-187.

[4] F. Pouqoueville, Ταξιδι στην ελλαδα, në Γ. Εξαρχος "ΞένοιπεριηγητέςγιατουςΒλάχους",Θεσσαλονίκη, 2004, fq.119; A. Koukoudis, Οιμητροπόλεις *και η διασπορά των βλάχων,* Thessaloniki, 2000, fq. 324.

[5] A. Koukoudis, po aty, fq. 327.

[6] T. Winnifrith, *The vlachs. The Histori of a Balkan people,* Duckwoerth, London 1987, fq.100-101

[7] A. Koukoudis, Οιμητροπόλεις *και η διασπορά των βλάχων,* Thessaloniki, 2000, fq. 324.

Fatkeqësisht nuk trashëgojmë asnjë informacion konkret për qendrën e kësaj diogjeze vllaho-orthodhokse që ishte nën juridiksionin e Arqipeshkopit të Ohrit. Që vllehtë të meritonin një *peshkopatë* të veçantë duhet, që në shekujt X-XIII, të kenë qenë një popullsi e konsiderueshme dhe e rëndësishme në krahinat përreth Ohrit ku, përveç Manastirit dhe zonës së Prespës, duhet të ketë qenë seriozisht e rëndësishme dhe potenciale zona e Voskopojës. Historikisht zona e Voskopojës ka qenë nën juridiksionin e kishës së Ohrit[8], madje, edhe si njësi administrative, deri në vitin 1912, ajo bënte pjesë në Vilajetin e Manastirit. Duhet të ndodhin ngjarje të veçanta që kanë lidhje me këto qendra apo banorët e tyre që historia të ketë pasur mundësinë për t'i "arshivuar" ato. Voskopoja u bë e njohur nga shek. XVII e në vazhdim sepse ajo, nga një vendbanim i thjeshtë i vllehve blegtorë arriti të bëhet qendra më e rëndësishme politike, ekonomike, kulturore, strategjike, madje, edhe numerike e Ballkanit, përkundër Perandorisë Osmane dhe kryeqendrës së saj, Kostandinopojës. G. Weigand në qoftë se do të kishte njohje për informacionet e mësipërme, nuk do ta sillte themelimin e Voskopojës në fillimet e shek. XVI[9].

Vendbanimet e sotme vllahe të Nikolicës, Linotopit dhe Gramostas trajtohen si një grupim i veçantë, si grupi vllaho-gramosten, por, është e sigurt se para djegies së Voskopojës (1769) ato bënin pjesë në të njëjtin grupim të të gjithë zonës përreth Voskopojës, me tipare të përbashkëta dhe me pasoja të njëjta në zhvillimin e ngjarjeve të kohës[10]. Xh. Lloshi thekson "…në shekullin XVIII do të vëmë re se gjendja historike, demografike, fetare, kulturore e gjuhësore në Shqipërinë Jugore ishte mjaft e ndërlikuar, për shkak të sundimit tashmë të gjatë të Perandorisë Osmane, e cila ngrihej mbi një bazë shumetnike dhe nuk përfillte kombësinë në ndarjet administrative. ..... Voskopoja u shfaq si përjashtim me një shumicë arumunësh të ngulur dhe ky përjashtim prandaj edhe nuk pati të gjatë jetën, por për aq kohë sa jetoi, qe një qendër me forcë tërheqëse të madhe, pothuaj si "toka e premtuar"[11]. Perëndimi i një metropoli të tillë kulturor e ekonomik, siç ishte Voskopoja, Moskopoli i vllehve, filloi me plaçkitjen dhe djegien e tij për herë të parë më 1769[12].

Në arsimimin dhe jetën kulturore të popullsisë së Voskopojës dhe më gjerë një rol të rëndësishëm ka luajtur Akademia e Re, në të cilën kanë punuar

---

[8]Gj. Muzaka, Memorje, Tiranë, 1996, fq. 38.

[9]G. Weigand, *ΟιΑρωμούνοι (Die Aromunen), A, Trikala, 2001, fq. 142.*

[10] A. Koukoudis, Οιμητροπόλεις *και η διασπορά των βλάχων,* Thessaloniki, 2000,fq.321.

[11]W. M.-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi, Tiranë, 2006, fq.65.

[12] F. Pouqoueville, Ταξιδιστηνελλαδα, në Γ. Εξαρχος "Ξένοι περιηγητές για τους Βλάχους", Θεσσαλονίκη, 2004, fq. 119: «Nga ana e tyre, bejlerët turq të Myzeqesë, me pretekstin se donin të merrnin në mbrojtje qytetarët e persekutuar të Sulltanit, vendosën garnizonin në qytet dhe mbas dhjetë vjetëve plaçkitje, grabitje e lufte, Voskopoja u zhduk (1769) nga faqja e tokës shqiptare...»

dhe studiuar shumë personalitete të komunitetit vllah. Në veprat e tyre, krahas greqishtes, do të gjejmë dëshmitë e para për shkrimin e aromanishtes (vllahçes), e cila në veprat e para u shkrua me alfabetin e gjuhës greke.

Dëshmitë e hershme të shkrimit të aromanishtes

Më 1731, Nektar Terpoja, me origjinë vllahe, në një gravurë të kishës së Ardenicës ku paraqitet Shën Maria me Krishtin e vogël, na përcjell një fjali të shkruar me alfabetin e gjuhës greke në greqisht-latinisht-arumanisht-shqip[13]. Afërsisht pas 4 dekadash, më 1770, Teodor Anastasie Kavalioti me ndihmën e Antonio Bartolit boton në Venecia fjalorin trigjuhësh, greqisht-vllahisht-shqip, shkruar me alfabetin e gjuhës greke, ku aromanishtja (vllahishtja) është e pranishme, e përfaqësuar nga një material leksikor i pasur. Fjalori është i përfshirë në botimin "Protopeiria" dhe përmban 1170 fjalë. Vllahishtja (aromanishtja), gjuha amtare e Kavaliotit dhe e pjesës më të madhe të popullsisë së Voskopojës, është gjuha e dytë e fjalorit. Xh. Loshi thekson se pjesa arumune natyrisht është e të folurit popullor, sepse përgjithësisht ky është fjalori i parë i asaj gjuhe[14]. Ribotohet nga Johann Thunmann më 1774 dhe nga Gustav Meyer më 1897.

Për aromanishten vepra merr rëndësi të veçantë duke qenë fjalori i parë i saj. E vetmja kopje ndodhet ne Bibliotekën e Akademisë në Rumani[15]. (Nikolae Saramandu thekson se nga punimi i Kavaliotit nuk njihet tashmë asnjë ekzemplar, na është përcjellë nga ribotime të mëvonshme, nga të cilat më të vjetrën ia detyrojmë Johan Thunmannit[16]).

Daniil Voskopojari, vllah nga Voskopoja, vazhdoi përpjekjen e Teodor Kavaliotit duke botuar veprën " "Hyrje në mësimdhënie" më 1802, në të cilën bën pjesë dhe "Fjalori katërgjuhësh". Ky fjalor përmban material gjuhësor në dialektet popullore të greqishtes, të vllahishtes, të bullgarishtes dhe të shqipes, të shkruara me alfabetin e gjuhës greke. Fjalori është botuar në Venedik, më 1802 dhe përmban 1070 fjalë[17]. Mendohet të jetë hartuar më 1793-1794 dhe kopje të tij gjenden në Londër, Vjenë, Sofje, Athinë dhe Shkup[18]. I pari studiues që ka nxjerrë në dritë punën e Daniilit është William

---

[13] W. M.-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe gjuhën shqipe, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi, Tiranë, 2006, fq. 67; DH. Shuteriqi, Shkrime shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976, fq. 107.

[14] W. M.-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi, Tiranë, fq.64.

[15] W. M.-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, Tiranë, fq. 64, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi; DH. Shuteriqi, Shkrime shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976, fq. 127.

[16] N. Saramandu, Momenti "Voskopojë" në historinë e marrëdhënieve gjuhësore rumuno-shqiptare, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore "Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune", Korçë, mars. 2013. Botuar në përmbledhjen me të njëjtin titull, ISBN: 9789928146144, Korçë, 2014, fq. 26, "PROMOPRINT".

[17] J. Kastrati, Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000, fq. 486-493.

[18] W. M.-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, Tiranë, fq. 88, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi.

Martin Leake, i cili e ribotoi më 1814 duke i shtuar dhe gjuhën e pestë, anglishten, të traskriptuar me shkronja latine. Që atëherë fjalorin e gjejmë të botuar pjesërisht ose të plotë në botimet e shumë studiuesve të huaj, si Papahagit, Kristofsonit, Ničevit[19] etj. Ilo Mitkë Qafëzezi më 1936 i shtoi dhe latinishten. Së fundmi, gjejmë të plotë botimin e këtij fjalori në veprën e Niko Stilos " Fjalori katërgjuhësh i Daniil Voskopojarit", Tiranë, 2011. Fjalori jepet në formën e një teksti bashkëbisedimi, me fraza të lidhura mirë dhe të përkthyera lirshëm nga njëra gjuhë në tjetrën[20]. Por ajo që ne na intereson është fakti që ky fjalor ka pasur rëndësi të veçantë dhe është vlerësuar nga shumë studiues për rolin e tij në periudhën e zanafillës së studimeve ballkanike. Kjo vepër bashkë me fjalorin e Teodor Kavaliotit dhe shkrime të tjera shumëgjuhëshe, përveçse janë dëshmi të shkrimit të aromanishtes (vllahçes), janë konsideruar si monumente të rëndësishme mbi të cilat janë mbështetur studimet e para për gjuhësinë e krahasuar ballkanike.

Në idiomën aromane nuk mungojnë dhe shkrimet e kodikëve. Prof. Sh. Sinani në veprën "Kodikët kronografikë të Shqipërisë"[21] sjell të dhëna për një dorëshkrim të quajtur "Codex Dimonie" ose "Meshari arumanisht", "Liturghier aromanesca", i cili mund të jetë shkruar nga fillimi i shekullit XIX. Sipas tij, është një tekst voluminoz, më i hershmi dorëshkrim që e bën të njohur me shkrim aromanishten, me përmbajtje fetare, shkruar me alfabetin grek. Ruhej në familjen Dimonie, prej së cilës mori dhe emrin. U gjend në Ohër dhe u përshkrua për herë të parë prej G. Weigand më 1894. Gjithashtu, si botime të Shtypshkronjës së Voskopojës përmenden dhe dy tiposhkrime të rralla në aromanisht që gjenden në bibliotekën e Patriakanës së Aleksandrisë[22].

Vepër tjetër e shkrimit të aromanishtes është "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā" e vllahut Mihail Boiagiut, i cili ishte profesor i gjuhës greke në një gjimnaz në Vjenë. Ishte një njeri i ditur, njohës i disa gjuhëve evropiane, gjë që e bëri atë të njohur në rrethin e studiuesve të kohës. Kopitar, një nga themeluesit e gjuhësisë ballkanike, e përmend si përkthyes edhe të ndonjë teksti në gjuhën shqipe[23].

Vepra është gramatika e parë shkencore e gjuhës aromane, gjuha e vllehve, e shkruar me alfabetin latin, botuar për herë të parë në Vjenë. Është ribotuar disa herë: më 1863 ribotohet për herë të dytë nga D. Bolintineanu; më 1915 ribotohet për herë të tretë nga P. Papahagi dhe më 1988, sipas botimit të Papahagit, ribotohet nga V. Barba në Freiburg të Gjermanisë[24]. Të tri

---

[19] Po aty, fq. 96.
[20] J. Kastrati, Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000, fq. 486.
[21] Sh. Sinani, Kodikët kronografikë të Shqipërisë, Tiranë, 2014, fq. 136-138.
[22] Po aty, fq. 101.
[23] Xh. Lloshi, Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit 1819- 1827, Tiranë, 2012, fq. 54.
[24] Pas tekstit të Boiagiut, botuesi V. Barba ka shtuar dhe materiale të tjera.

botimet e mëparshme sipas V. Barba[25] nuk mundën ta kryejnë funksionin për të cilin Boiagi e shkruajti veprën, pra, të ndihmonte vllehtë të mësonin të shkruanin gjuhën e tyre. Bilinguizmi i tyre, përhapja dhe përdorimi i greqishtes, fillimi i Luftës së Parë Botërore, pas së cilës vllehtë mbetën të shpërndarë në 4 shtete, Shqipëri, Greqi, Serbi, Bullgari, mund t'i përmendim si shkaqet kryesore që nuk lejuan që vepra e botuar dhe e ribotuar të përdorej nga vllehtë për të mësuar shkrimin e gjuhës së tyre.

Rëndësia e botimit të kësaj vepre.

Së pari, Gramatika e Boiagiut u drejtohet vllehve (aromanëve), të cilët banonin në Gadishullin Ballkanik, në jug të Danubit. Ai përdori 24 shkronja të alfabetit latin dhe disa kombinime shkronjash, duke hapur kështu një faze të re të shkrimit të aromanishtes (vllahishtes), shkrimit të saj me alfabetin latin. Prandaj, vepra e tij, në fillim të shekullit XIX, merr vlera dokumentare dhe identifikuese për vllehtë, kulturën dhe gjuhën e tyre, aromanishten.

Së dyti, gjuha e Boiagiut, gjatë gjithë veprës, sidomos gjuha e teksteve, është një vllahishte e pastër. M. Karaxhiu[26] thekson se aromanishtja e Boiagiut është gjuha që e flisnin prindërit e tij rreth viteve 1750 në anët e Voskopojës , gjuha e shkrimit të Nektar Terpos(1731), gjuha e Teodor Kavaliotit, Daniil Voskopojarit dhe e Kostandin Ukutës. Rregullat morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore kanë të njëjtën vlerë edhe sot, pas 204 vitesh, që nga koha e botimit të parë të saj.

Së treti, duke e titulluar veprën e tij "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", autori e ka të qartë se aromanishtja (vllahishtja) në Jug të Danubit është një idiomë romane që dallohet nga idioma që flitet në veri të Danubit, pra, rumanishtes. Në hyrje të botimit autori thekson: "Ma s-mi tornu la carta a mea, cari easte gramatica di fatsā a limbiljei macedonormane, ashi cum u zburāscu Aromānjlji dit sudlu a Dunāriljei, shi cari, comparatā cu idiomulu zburāt la nordulu a Dunāriljei, nu va hibā fārā interes ahāt trā atselj di idghia originā, cāt sh-trā xenj shi nvitsats"[27] (Por të kthehem te puna ime, sepse kjo gramatikë e bërë për gjuhën maqedonoromane, ashtu si e flasin aromanët nga jugu i Danubit, dhe krahasimi me idiomën e folur në veri të Danubit, nuk duhet të jetë pa interest për ata të së njëjtës origjinë dhe për të huajt e ditur).

Së katërti, duke qenë se materiali i aromanishtes shoqërohet me shpjegime në greqisht dhe gjermanisht, ajo, së bashku me fjalorët e përmendur më lart, shërbejnë si një bazë e fortë për studimet e mëvonshme të gjuhësisë së krahasuar evropiane dhe ballkanike. John Nandris thekson: "Pak popuj ballkanikë patën fatin të njohin aq gjuhë sa vllehtë, dhe që mund të

---

[25] V. Barba, në "Zbor nâinte" në "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", Freiburg,1988.

[26] M. Caragiu, "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā shi importantsa a ljei", botuar në "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", Freiburg,1988, Anexa I/1.

[27] M. Boiagi, Zbor nâinte në "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", II/10, Freiburg,1988.

barazojnë historinë e tyre, kujtimet në botime. Ata themeluan më shumë shtypshkronja në qendrat e kulturës vllahe, siç qenë Voskopoja, Bitola ose Vjena, produktet e të cilave nuk qenë vetëm në gjuhën e tyre[28].

Përshkrimi shkurt i përmbajtjes së veprës

Gramatika prihet nga një hyrje e përgatitur nga autori dhe botuesi. Në pjesën e parë A' autori paraqet alfabetin e përdorur, bashkëtingëllorët, zanoret, bashkimet e ndryshme për të realizuar në shkrim shumë tinguj dhe rregullat e përdorimit të tyre.

Në pjesën e dytë B'autori jep pjesët e ligjëratës. Ai dallon në aromanisht këto klasa fjalësh: nyja, emri, mbiemri, përemri, folja, pjesorja, parafjala, ndajfolja, lidhëza, pasthirrma.

Më poshtë përmbledhtas po japim disa veçori të trajtimit të këtyre pjesëve të ligjëratës në vepër.

Nyja

Autori dallon: nyjet shquese të pasvendosura për gjinën mashkullore njëjës (em/kall. –lu/-le, gj./dh. –lui), mashkullore shumës (em./kall. –lji, gj./dh. –lor); femërore njëjës (em/kall.a/ea, gj./dh. –lji), femërore shumës (em./kall.-le, gj./dh.- lor); nyjen joshquese të gjinisë mashkullore e femërore unu/unâ të numrit njëjës dhe format rasore të tyre. Për çdo formë rasore të nyjes jep dhe rregullat përkatëse të përdorimit të tyre me emra të gjinive të ndryshme.

Në qoftë se do të bënim një krahasim me nyjet shquese dhe joshquese të së folmes aromane në Jug të Shqipërisë do të vërenim pak ndryshime, ndoshta, të krijuara nga ndikimi i gjuhës shqipe. Krahasimi dëshmon një thjeshtim të formave rasore të nyjeve shquese, p.sh: (nyjet shquese, numri njëjës, gjinia mashkullore, em.kall. –u,-l'i; gj./dh. –u, -l'i)[29].

Emri

Duke e krahasuar me lakimin në latinisht, autori i grupon emrat në 5 lakime, sipas tingullit fundor të temës në rasën emërore ose thirrore. Në tri lakimet e para grupon emra femërorë që mbarojnë më temë me tinguj të ndryshëm dhe në lakimin e katërt dhe të pestë përmbledh emrat mashkullore, sipas karakteristikave përkatëse. Edhe për nyjen edhe për emrin autori i jep të qarta tabelat e lakimit, duke i shoqëruar me sqarime në gjuhën greke e gjermane, por pa i emërtuar rasat.

Lakimi i parë përfshinë emrat femërorë më -â dhe -e, por shembujt në rasën emërore mbarojnë me -a dhe në thirrore me -â, ndoshta këto janë mbaresat e lakimit të parë. Lakimi i dytë përfshinë emrat femërorë më e. Lakimi i tretë përfshinë të gjithë emrat e tjerë femërorë. Lakimi i katërt përfshinë emrat mashkullorë më -u ose -â dhe lakimi i pestë emrat mashkullorë më -e.

---

[28] Shih J. Nandris, në "Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", Freiburg,1988, Anexa I/6.

[29] S. Poçi, Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre, Tiranë, 2009, fq. 112.

Sot, në aromanishte[30] vërejmë një thjeshtim të lakimit të emrit. Së pari, raportet sintaksore të fjalëve në fjali shprehen nëpërmjet lakimit të emrave me anën e nyjeve shquese të prapme dhe, së dyti, me ndihmën e parafjalëve. Thjeshtim i formave rasore të nyjeve shquese ka sjellë dhe thjeshtimin e lakimit të emrave. Karakteristikë e mënyrës së parë është lakimi i emrit të gjinisë mashkullore dhe femërore në trajtën e shquar me anën e nyjes shquese të pasvendosur si në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Nyja shquese i pasvendoset emrit ose është bërë një me temën e tij, p.sh: kásă-kása (shtëpi-shtëpia), nviástă-nviásta (nuse-nusja) etj. Në trajtën e pashquar lakimi i emrit bëhet me anën e përemrave të pacaktuar un/únă, që luajnë rolin e nyjes joshquese. Karakteristikë e mënyrës së dytë është shprehja e raporteve sintaksore me ndihmën e parafjalëve të ndryshme. Në këtë rast nuk mund të flasim për rasa. Emri në formën përfaqësuese, i shquar ose i pashquar përdoret pa ndryshuar temën e tij në të gjitha rastet. Parafjalët më të përdorshme janë: la (te, tek); di, diá (nga, prej); ti (për). Kjo mënyrë e afron aromanishten me gjuhët e tjera neolatine perëndimore. Dallimi midis dy mënyrave shfaqet në emrat e gjinisë femërore, në numrin njëjës, trajta e shquar dhe e pashquar si dhe te të gjithë emrat e tjerë në numrin shumës, trajta e shquar dhe e pashquar, në rasat gjinore e dhanore. Mënyra e parë, që është dhe më e vjetër, gjendet edhe te shkrimet e para aromane[31].

Autori thekson praninë e dy gjinive të emrit, mashkullore, femërore dhe mohon praninë e gjinisë asnjanëse.

Mbiemri

Në tekst gjejmë lakimin e mbiemrit të paravendosur dhe të pasvendosur emrit, lakimin në bashkëvajtje me emra të shquar dhe të pashquar. Kur është i paravendosur ai merr treguesit e "shquarsisë" dhe emri del pa tregues gramatikorë, i pandryshueshëm. Lakimi i mbiemrit realizohet edhe duke i paravendosur format rasore të përemrit dëftor sipas gjinisë përkatëse, mashkullore, femërore. Lakimi i mbiemrit, me pak ndryshime fonetike, është i njëjtë dhe në të folmen e sotme aromane. Në klasën e mbiemrave ai përfshin dhe disa përemra të pacaktuar, si: *carecido, tuci, tute* (*kushdo, i gjithë, e gjithë*). Për sa i përket shkallës së mbiemrit, autori bën fjalë vetëm për shkallën krahasore të ndërtuar me fjalët *ma dhe cama* (shqip *më*).

Numërori

Edhe numërorët jepen me të gjitha karakteristikat e tyre. Përshkruan numërorët nga 1-19, jep modele të tilla, si: 20, 30,...,100, 200,...,1000,...,10000,..., 100000,..., 1000000 etj, të shoqëruara dhe me

---

[30] Po, aty, fq. 115.

[31] Shih N. Κατσάνης-K. Ντίνας, Γραμματική της κοινής Κουτςοβλαχικής, Thessaloniki, 1990, fq. 46.

shkrim. Lakimi i numërorit të emërzuar bëhet me anë të nyjes shquese të prapme ose duke paravendosur format rasore të përemrit dëftor *acelji (ata).*

Përemrat

Në klasën e përemrave autori dallon përemrin vetor, vetvetor , pronor, dëftor, pyetës. Në qoftë se do të krahasonim format përemërore në këtë gramatikë me format e sotme do të vërenim se ato janë të njëjta, me dallime të vogla, kryesisht fonetike. Përemri vetor i vetës së parë njëjës *eu* dhe i vetës së dytë *tu* në të folmen aromane në Jug të Shqipërisë del me formën e rasës kallëzore *mini* dhe *tini(unë, ti).* Forma e përemrit vetvetor *shâ* mungon në të folmen tonë.

Përemrat pronorë të vetës së tretë, njëjës, pasngjitur emrit *–su* (në shqip i përgjigjet nyja me vlerë pronori, p.sh, *i biri*, për gjininë mashkullore) dhe *–sa (e bija*), për gjininë femërore, që autori i jep me forma të ndryshme rasore, sot dalin të pandryshueshëm. Gjithashtu, sot, dallojmë dhe format e vetës së parë e të dytë, njëjës, të pasvendosura, si: *-ñu/-mia,* (në shqip, *im/ime* të paravendosura) dhe *-tu/-ta* (në shqip *yt / jot* të paravendosura).

Folja

Një vend të rëndësishëm në vepër zë kapitulli për foljen. Autori trajton foljet ndihmëse *amu (kam)* dhe *escu (jam),* foljet e parregullta dhe folje të tjera në mënyrën dëftore, lidhore, kushtore, urdhërore. Foljet i grupon në katër zgjedhime, por nuk përcakton kriteret e klasifikimit. Në qoftë se do t'i referoheshim paskajores(infinitivit), në zgjedhimin e parë janë grupuar foljet me temë më *–are*; në zgjedhimin e dytë janë grupuar foljet me temë më *–ere*, në zgjedhimin e tretë janë grupuar foljet me temë më *–ere*; në zgjedhimin e katërt janë grupuar foljet më *–ire*. Siç shihet, foljet e zgjedhimit të dytë dhe të tretë në infinitiv dalin me të njëjtën temë, por nuk jepen kriteret dalluese midis tyre.

Për sa i përket paradigmës së zgjedhimit të foljes vërejmë praninë e infinitivit *(calcare, batere, arupere, avzire etj)* dhe të formave të tjera të pashtjelluara si përcjellorja *(batundalui).* Nga krahasimi me të folmen aromane të sotme në Jug të Shqipërisë vërejmë se infinitivi sintetik nuk dëshmohet. Si forma të pashtjelluara në këtë të folme dallojmë paskajoren, pjesoren (*lată*) dhe formën *únă fitséri(një të bërë*). Paskajorja del e paraprirë nga pjesëza parafjalore *ti*: *ti măkári* (*për të ngrënë), ti lukrári (për të punuar), ti fudzéri (për të ikur), ti tărtséri (për të kaluar).* Kjo formë foljore është ndërtuar me anën e paravendosjes së pjesëzës me vlerë parafjale *ti(për)* para emrit prejfoljor, si: *măkári, lukrári, vinéri* etj. Forma e pashtjelluar, shqip përcjellore, që dëshmohet në vepër, në këtë të folme nuk del .

Klasa të tjera fjalësh

Parafjalët në aromanisht janë të pakta në numër. Në vepër gjejmë rreth 10 të tilla: in, di, eu, la pre, sub, de etj. Në mënyrë më të hollësishme autori analizon ndajfoljet duke i grupuar sipas nuancave kuptimore, si: ndajfolje të krahasimit, shpjeguese, kohore, vërtetuese, pyetëse, mohore, penguese, dëftore etj. Si pjesë ligjërate dëshmohen dhe pasthirrmat me nuancat kuptimore përkatëse.

Një vend të rëndësishëm zë kapitulli ku trajtohen rregullat sintaksorë të përdorimit të pjesëve të ligjëratës, duke i emërtuar si: Sintaksa e nyjes; Sintaksa e emrit; Sintaksa e mbiemrit; Sintaksa e foljes; Sintaksa e pjesores; Sintaksa e parafjalës; Sintaksa e ndajfoljes. Vepra mbyllet me disa tekste aromane në prozë e në formë dialogu.

Gjendja e aromanishtes sot në Jug të Shqipërisë

Aromanishtja e folur në Jug të Shqipërisë, pavarësisht se nuk shkruhej, ruhej në një nivel të

kënaqshëm deri në vitet 1990. Pas viteve 1990, marrëdhëniet e reja ekonomike dhe shoqërore që u krijuan kanë bërë që aromanishtja, si një gjuhë e toleruar nga shteti, por e papërkrahur[32], si një gjuhë që ka filluar të humbasë funksionin e saj komunikues edhe brenda familjes, të humbasë shumë përballë shqipes. (Para viteve 90 martesat brendapërbrenda komunitetit ruheshin me fanatizëm. Vitet e fundit janë shtuar shumë martesat jashtë këtij komunitetit, duke prishur kështu bazën më të rëndësishme të konservimit të gjuhës). Gjithashtu, si pasojë e mospraktikimit nga mbartësit e saj, sidomos, nga brezi i ri e i mesëm, i shumë profesioneve, si: profesionin e blegtorit, të përpunimin të leshit, të thurjes së veshmbathjeve, të endjes etj, aromanishtja humbet fondin leksikor përkatës. Për më tepër, vllehtë përballë shqipfolësve ndihen të asimiluar gjuhësisht[33], sepse gjuha shqipe për ta është gjuha e bukës, e shtypit, e arsimimit të brezit të ri. Si rrjedhojë, mund të flasim për huazime të shumta shqipe (edhe shqipja mund t'i ketë të huazuara nga gjuhë të tjera) në të folmen aromane të brezit të tretë dhe të dytë. Ata huazojnë, duke i përshtatur fonetikisht dhe morfologjikisht, ato fjalë që nuk i gjejnë dhe që nuk kanë mundësi t'i krijojnë në aromanisht, për shkak të mundësive të pakta që u ofron kjo gjuhë, si një gjuhë që tashmë është futur në rrugën e asimilimit të pashmangshëm nga gjuha shqipe, p.sh: lavatriçe, frigorifer, dush, aspirator, petrogaz, celular, kalorifer, televizor, shkollë, libër, fletore, stilolaps, çantë, kompast, vizore, shkumës, gazetë, provim, gjimnaz, universitet, gjyq, avokat, burg, ligj, dënoj, prokuror, tharëse, floktore, ushtar, oficer, komandat, pallat etj.

Për sa i përket gjuhës së brezit të ri vllah në Shqipëri, pavarësisht se ai është ende i vetëdijshëm se i përket një grupi etno-kulturor të ndryshëm nga shqiptarët, nuk mund të flasim më për numër huazimesh, por vërejmë se te ky brez aromanishtja po zëvendësohet me shpejtësi nga gjuha shqipe. Në

---

[32] V. Bici, Çështje të dy gjuhësisë në shkollat e pakicave, Tiranë, 2001, fq.16.

[33] Sh. Demiraj, Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët,Tiranë, 2008, fq 105-108.

përgjithësi, pas arsimit parashkollor, fëmijët vlleh shkojnë në klasën e parë si dygjuhësh me mbizotërim të gjuhës shqipe ose si monoling, vetëm me gjuhën shqipe. Kjo vërehet dhe në rezultatet shkollore të tyre. Ata jo vetëm që s'dallohen nga fëmijët e tjerë shqipfolës, por, në mjaft raste, niveli i tyre shkencor është më i lartë, gjë që ka sjellë, në rrjedhë të kohës, integrimin e këtij grupi etno-kulturor në jetën shoqërore, politike, kulturore shqiptare në një shkallë të tillë, që është vështirë të dallosh elementin vllah nga ai shqiptar.

Siç shohim, kjo etni ndodhet përpara rrezikut të asimilimit gjuhësor e kulturor, ndaj ajo kërkon të ndihmohet nga shteti dhe nga organizmat ndërkombëtarë me mjete dhe mënyra të ndryshme për të ruajtur gjuhën, kulturën, zakonet, traditën, të cilat paraqiten si fenomen historik, gjuhësor e kulturor i veçantë në përbërjen e mozaikut kulturor evropian.

Bibliografia

M. G. Boiagi, Gramaticā aromānā icā macedonovlahā", Freiburg,1988.

K. Kallamata, Arti ikonografik në Shqipëri, në: www.korcavizion.com

N. Hammond, A history of Macedonia, I, Oxford, 1972.

K.. Kyçyku, Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik, Bukuresht, 1999.

Γ. Εξαρχος "Ξένοι περιηγητές για τους Βλάχους", Θεσσαλονίκη, 2004.

A. Koukoudis, Οι μητροπόλεις και η διασπορά των βλάχων, Thessaloniki, 2000.

T. Winnifrith, The vlachs. The Histori of a Balkan people, Duckwoerth, London, 1987.

Gj. Muzaka, Memorje, Tiranë, 1996.

G. Weigand, Οι Αρωμούνοι (Die Aromunen*), A, Trikala, 2001*.

W. Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, përkthyer dhe paraqitur nga Xh. Lloshi, Tiranë, 2006.

Sh. Sinani, Kodikët kronografikë të Shqipërisë, Tiranë, 2014.

DH. Shuteriqi, Shkrime shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976.

J. Kastrati, Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000.

Xh. Lloshi, Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit 1819- 1827, Tiranë, 2012.

S. Poçi, Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre, Tiranë, 2009.

N. Κατσάνης-Κ. Ντίνας, Γραμματική της κοινής Κουτζοβλαχικής, Thessaloniki, 1990.

V. Bici, Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave, Tiranë, 2001.

Sh. Demiraj, Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët,Tiranë, 2008.

FJALORËT E GJUHËS GREKE ME TË FOLMEN E ARVANITASVE

Kostando Ksera[1], Eljana Kokalari[2], Evanthia Baruta[3]

[1] Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Universiteti "Eqrem Çabej"

kostandoksera@yahoo.gr

[2]Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti "Eqrem Çabej"

emosko@uogj.edu.al

[3]Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek,Universiteti "Eqrem Çabej"

evanthiajovani@yahoo.gr

Abstrakt

Fusha e leksikografisë dygjuhëshe greqisht - shqip dhe shqip - greqisht nuk karaktrizohet nga prurje të mëdha por nga elemente shumë karakteristike që ndikojnë në pasurimin jo vetëm të fushës së leksikografisë por edhe të gjuhësisë së zbatuar dhe historike në lëmën e të dyja gjuhëve si të greqishtes ashtu edhe të shqipes. Në kuadër të këtij punimi dë të shqyrtojmë fjalorët dygjuhësh të greqishtes në lidhje me të folmen e arvanitasve, e cila përbën idiomë të Toskërishtes, dhe flitet nga Arvanitët në vise të ndryshme të Greqisë. Konkretisht do të paraqiten dy vepra leksikografike të cilat janë hartuar njëra në fillim dhe tjetra në fund të shek. XIX. ***Fjalori greqisht – arvanitshe e thjeshtë i Marko Boçarit (1809)*** *si dhe* ***Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit (1882)***

Fjalë kyçe: *leksikografia dygjuhëshe, e folmja arvanitase, fjalorë dygjuhësh greqisht – shqip*

Abstract

*The field of bilingual Greek-Albanian and Albanian-Greek lexicography is not characterized by large inflows but by specific characteristic features that affect the enrichment not only of the field of lexicography but also of applied and historical linguistics in the field of both Greek and Albanian languages.In the framework of this paper we will examine the bilingual dictionaries of Greek in relation to the idiom of the Arvanites, which is a part of Albanian Tosk dialect, and it is spoken by the Arvanites in different parts of Greece. Specifically, two lexicographical works will be presented which were compiled one at the beginning and the other at the end of the XIX century;****the Greek-simple Arvanite Dictionary by Marko Bocari (1809) and the Greek-Albanian Dictionary by Panajot Kupitori (1882).***

1. Hyrje

Në lemën e fjalorëve dygjuhësh greqisht – shqip dhe shqip – greqisht që janë identifikuar dhe regjistruar deri tani[1] konstatojmë që përveç fjalorëve të greqishtes me gjuhën standarte shqipe(ose dhe atyre ku greqishtja është përdorur si metagjuhë[2] siç janë Fjalori i Kristoforidhit[3] dhe Fjalori i Mitkos[4]), ekzistojnë edhe fjalorë të greqishtes me të folmen e arvanitasve, e cila është gjuha që flitet nga Arvanitët në vende të ndryshme të Greqisë. Kjo e folme, siç do të shohim më poshtë, është idiomë e dialektit jugor të gjuhës shqipe, Toskërishtes.

Fjalorët e greqishtes me të folmen e arvanitasve janë kryesisht një përpjekje nga vetë Arvanitët për të regjistruar të folmen karakteristike që përdorin ata vetë, por edhe të parët e tyre, në mënyrë që të ruajnë dhe promovojnë pasurinë e tyre leksikore dhe karakteristikat bazë të të folmes së tyre.

Bëhet fjalë për ***Fjalorin greqisht – arvanitshe e thjeshtë i Marko Boçarit (1809)*** *si dhe* ***Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit (1882).***

Fakti që veprat të cilat disponojmë janë të pakta në numër dhe vet natyra dhe cilësia e tyre nuk na japin mundësinë të flasim për leksikografi të mirëfilltë dygjuhëshe greko – arvanitase, por për përpjekje spontane/personale për hartim fjalorësh të veçantë. Secila nga këto vepra ka specifikën e saj si nga ana gjuhësore ashtu edhe nga këndvështrimi historik. Materiali që ofrojnë këta fjalorë përbën një korpus për studime si linguistike ashtu edhe historiko - shoqërore në lidhje me gjuhën, kulturën dhe historinë e arvanitasve të Greqisë.

2. Arvanitët dhe e folmja arvanite

Arvanitët janë një grup kulturoro-gjuhësor i veçantë i popullsisë greke. Nga të dhënat historike që disponojmë arvanitët u shkëputën nga trungu i tyre qëndror, Shqipërinë e sotme, në grupe, në periudha të ndryshme kohore rreth shekullit të XIV dhe u vendosën në territore të ndryshme të Greqisë në formë ishujsh gjuhësore.[5]

---

[1]Për më shumë shih: K. Ksera, *Rreth leksikografisë dygjuhëshe greqisht – shqip dhe shqip – greqisht*, doktoraturë, Universiteti i Tiranës, 2015 http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/05/Kostando-KSERA-RRETH-LEKSIKOGRAFIS%C3%8B-DYGJUH%C3%8BSHE-GREQISHT-%E2%80%93-SHQIP-DHE-SHQIP-GREQISHT.pdf

[2] Metagjuha (metaglossa) është gjuha e përdorur për të folur rreth gjuhës. Në fjalorët e poshtëshënuar gjuha greke është përdorur si metagjuhë për të interpretuar lemat e gjuhës shqipe.

[3]K. Χριστοφορίδης, *Λεξικόν της Αλβανικής γλώσσης*, εν Αθήναις 1904

[4] Th. Mitko, *Fjalëtor e shqip-gërqisht e gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike*, përgatitur nga Dhori Qiriazi, Tiranë 2014

[5]Δ. Κυριαζής file:///C:/Users/dell/Downloads/2595-4455-1-PB%20(3).pdf1 f. 166

Sipas Gjinarit dhe Shkurtaj[6] «Dëshmitë më të vjetra të shkruara, që na flasin për shtegtime arbëreshësh në viset e Greqisë, janë së pari një letër e kronistit venedikas Marin Sanudo, qysh më 1325, pastaj dëshmia e perandorit bizantin Johan Kantakuzeni, i cili rrëfen se arbëreshët e parë zbritën në masë nga pjesa veriore drejt Greqisë jugore dhe u ngulën sidomos në Peloponez aty nga viti 1513.»

Ndihmesë të madhe në fushën e hulumtimeve rreth gjuhës dhe historisë së arvanitëve të Greqisë ka dhënë albanologu i njohur prof. Titos Johallas i cili ka studiuar në mënyrë sistematike të folmen dhe kulturën e tyre dhe ka publikuar artikuj dhe botime shkencore të shumta.[7]

Sipas Johallas: «Është gjithashtu e mundur që shqiptarët kishin filluar të përhapeshin paqësisht drejt jugut në gjysmën e dytë të shekullit të 13-të, duke përfituar nga rivaliteti midis despotit të Epirit, Mihail II, dhe dinastive perandorake të Nikesë dhe Konstandinopojës. Përhapja drejt jugut e shqiptarëve, siç vuri në dukje Dionysios Zakythinos, u lehtësua gjithashtu nga Kryqëzata e Katërt që mbolli trazira në Shqipëri dhe gjetkë në Perandorinë Bizantine.»[8]

"Dyndja e popullsisë ndodhi në përmasa të mëdha gjatë sundimit të Stefan Dushanit, i cili i lejoi dhe i nxiti të vendosen në tokat e shpopulluara të Greqisë. [...] Dalëngadalë ata arritën deri në Atikë e More, duke u hedhur edhe në disa ishuj të detit Egje, si në Eube, Hydra, Speces, Poros etj. Pjesa më e madhe e tyre u vendos në tokat e feudalëve greke e frëngj. [...] Qysh nga shek.XIV ata ende vazhdojnë të banojnë në ato vende. Por, nën trysninë e gjatë të helenizimit, shumica e tyre e ka humbur gjuhën shqipe."[9]

3. E folmia e arvanitëve

Të dhënat e para rreth gjuhës së arvanitëve të Greqisë i gjejmë në veprën e mirënjohur «*Netë pellazgjike*» (1855) të Rajnholdit, mjek gjerman i marinës

---

[6] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, shblu, Tiranë 2003, f. 347

[7] Shih më poshtë veprën e prof. Titos Johallas në lidhje me Albanologjinë: *ΤοΕλληνο-ΑλβανικόνΛεξικόντουΜάρκουΜπότσαρη, Φιλολογικήέκδοσιςεκτουαυτογράφου*, εν Αθήναις 1980 (ΠραγματείαιτηςΑκαδημίαςΑθηνών, τόμ. 46); *Στοιχείαελληνο-αλβανικήςΓραμματικήςκαιελληνο-αλβανικοίδιάλογοι. Ανέκδοτο έργο του Ιωάννη Βηλαρά. Φιλολογική έκδοση από τον αυτόγραφο κώδικα της Εθνικής Βιβλιοθήκης των Παρισίων,* Θεσσαλονίκη 1985; *Αλβανολογία και ερασιτεχνισμός. Αποκατάσταση αρβανίτικων κειμένων*, Αθήνα 1988; *Αρβανίτικα παραμύθια και δοξασίες. Νεράιδες, δαίμονες, ξόρκια, ψυχιάσματα,* Αθήνα 1997; *Άνδρος, Αρβανίτες και Αρβανίτικα*, Αθήνα 2000; *Εύβοια, τα Αρβανίτικα*, Αθήνα 2002; *Ύδρα, λησμονημένη γλώσσα*, τόμ. Α΄-Β΄, Αθήνα 2006; *Η αρβανιτιά στο Μοριά, χρονικά πορείας*, τόμ. Α΄-Β΄, Αθήνα 2011; *Τα αλβανόφωνα χωριά της Θράκης. Ιστορία και Γλώσσα*, Αθήνα 2011;

[8] T. Jochalas "*Über die Einwanderung der Albaner in Griecenland, eine zusammenfassende Betrachtung*", në vol: Dissertationes Albanicae, München 1971, σ. 89-106 (Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahes Orients, Band XIII).

[9] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, shblu, Tiranë 2003, f. 363-64

greke, ku përveç këngëve popullore ai mblodhi edhe një numër fjalësh të folmes arvanite, kryesisht leksik bujqësor.[10]

Kjo e folme konsiderohet si forma më arkaike e dialektit jugor të gjuhës shqipe, të Toskërishtes. Falë ngulmimit të mbartësve të saj për ta ruajtur dhe për ta trashëguar atë tek brezat e ardhshme, arriti të mbijetojë për 7-8 shekuj dhe të arrijë deri në ditët tona. Me kalimin e shekujve kjo e folme adoptoi elemente të gjuhës greke, por njëkohësisht ruajti me fanatizëm shumë elemente të tjera, kështu që nuk e humbi karakterin e saj.

Sipas Liosis: «Shkëputja e të folmes arvanite nga trungu qëndror i dialektit tosk në shek. XIV dhe ruajtja tek ajo e disa veçorive arkaike çoi në përfundimin e gabuar se karakteri i saj është krejtësisht arkaik. Më kalimin e shekujve dhe për shkak të kontakteve të saj me greqishten e folur, e folmja arvanite humbi karakterin e saj arkaik dhe fitoi tipare moderne që kanë të bëjnë jo vetëm me rrafshin morfologjik por edhe sintaksor dhe semasiologjik. Gjithashtu futja në të e një numri të madh huazimesh leksikore kryesisht nga gjuha greke është një tjetër element i modernitetit.»[11]

E folmia e arvanitëve flitet akoma edhe sot në vende të ndryshme të Greqisë kryesisht nga moshat e mëdha. Ajo humbet terren dita ditës nën trysninë e gjuhës greke.Sipas Βελιώτη – Γεωργοπούλου[12]: «*Akoma edhe sot e folmja Arvanite funksionon si një "kod solidariteti" duke krijuar një lloj afrimiteti gjuhësor midis atyre që e njohin ose më mirë simpati mes atyre që njihen se janë Arvanitas, një simpati që shtrihet edhe tek jo-vendasit që nuk kanë prejardhje nga zona*.»

4. Fjalori greqisht – arvanitshe e thjeshtë i Marko Boçarit (1809)

Një nga fjalorët më të njohur të greqishtes me të folmen arvanitase është ai i luftëtarit të shquar suliot, Marko Boçarit, i njohur si ***Λεξικόν τής Ρομαϊκοίς καί Αρβανητηκοίς Απλής*(*Fjalor greqisht – arvanitshe e thjeshtë*).**

Dorëshkrimi i fjalorit gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, në degën e dorëshkrimeve greke. Çdo faqe është e ndarë në dy pjesë me vijë vertikale. Në anën e majtë të çdo faqeje janë të shënuara fjalët greke, jo me renditje alfabetike, në anën e djathtë janë shkruar fjalët shqip me shkronja greke. Në fillim të çdo faqeje të dorëshkrimit, përveç faqes së parë, është e shkruar nga

[10] J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Po aty, f. 351

[11] Ν. Λιόσης, *Μερικά βασικά χαρακτηριστικά του αρβανίτικου ιδιώματος της Λακωνίας. Συγκριτική εξέταση με άλλα αρβανίτικα ιδιώματα και τα νότια τόσκικα*, Albanohellenika No 3, 2008, faq. 8

[12] Μ. Βελιώτη – Γεωργοπούλου, *Γλωσσική ιδαιτερότητα και εθνική ταυτότητα, Αρβανίτες και αρβανίτικα*», Μνήμη Τασούλας Οικονόμου, edu2009, έκδ. Παν/μιο Θεσσαλίας. Τμήμα Ιστορίας, Αρχαιολογίας και Κοινωνικής Ανθρωπολογίας-Δημοτική Επιχείρηση Πολιτισμού Άργους-Δήμος Μυκηναίων, σελ. 21-35.

vetë Boçari, Λεξικόν ose ΛεξικόνΔίγλωσσον(fjalor ose fjalor dygjuhësh) me kombinimet më të çuditshme anortografike.[13]

Numri i lemave të greqishtes janë 1701, kurse të shqipes 1494. Për këtë prof. Johallas shprehet se «kjo diferencë fjalësh ka të bëjë me faktin që Markoja për fjalët greke shkruante shpesh herë edhe sinonime, ose e përdorte një fjalë në vende të ndryshme të fjalorit në formë tjetër, të gjuhës popullore ose edhe të katharevusas dhe e shpjegonte me të njëjtën fjalë në shqip. P.sh. ελαία, ελιά – ulli; έμορφος, όμορφος, ωραίος – i bukur.»[14]

I pari që solli në dritë ekzistencën e fjalorit të Boçarit ishte doktoranti Nikollaos Dhosios, i cili botoi një artikull në gazetën e Athinës "Epitheorisis Politiqi kai Filologiki", të datës 25 Prill 1881, nr 15, faq. 256. Siç duket nga të dhënat e mëvonshme ky botim ka kaluar pa u vënë re dhe të gjithë i referohen artikullit të Spiro Llambros, "*Marko Bocari leksikograf*" që u botua, 14 vjet më vonë, në gazetën e Athinës "Estia", më 25 dhjetor 1895.[15] Në vazhdim Fjalori u bë i njohur për publikun me botime të ndryshme.[16]

Dorëshkrimin e Fjalorit e dhuroi Pukëvilli, në Maj të 1819, në Bibliotekën Kombëtare të Parisit, siç e vërteton një shkrim i tij në faqen e tretë të kodikut: *Offert a la Bibliotheque du Roi par Pouqueville ancien consulgeneral de France a Janina. Mai 1819.* Në faqen e parë të dorëshkrimit vetë Marko Boçari ka shënuar titullin e veprës së tij, të cilën e ka emëruar ***— Λεξικόν τής Ρομαϊκοίς καί Αρβανητηκοίς Απλής***. Mbi titullin e faqes së parë ekziston shënimi i Pukëvillit në të cilin shkruan «*Ce lexique est ecrit de la main de Marc Botyari a Corfou 1809 devant moi. Pouqueville*.» (*Fjalori u shkrua nga dora e Marko Boçarit në Korfuz 1809 në praninë time*).[17]

Fjalori është shkruar në faza të ndryshme, këtë e dëshmojnë përsëritjet e ndryshme të fjalëve në fjalësin greqisht, siç duket, ai harronte që një fjalë e kishte shpjeguar një herë.

Pouqueville na pohon që autori është Marko Boçari por sipas Johallës «...ai shkruante vet fjalësin në greqisht kurse përkthimin në shqip nuk e bënte vet por me ndihmën e të atit të tij Kiço, të xhaxhait Notis dhe të vjerit Kristaqis Kalogjiru, një herë i jepte njëri të dhëna, një herë tjetri, sepse në disa raste kemi përkthime të ndryshme për një fjalë të vetme. Këto të dhëna rezultojnë

---

[13] Τ. Γιοχάλας, *Τοελληνο – αλβανικόνλεξικόντουΜάρκουΜπότσαρη*, ΠραγματείαιτηςΑκαδημίαςΑθηνών, τόμος 46, Αθήναι 1980, f. 37. si dhe Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 165

[14]Τ. Γιοχάλας, po aty, faq. 37-38.

[15] Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 165

[16]Më 1926 fjalori botohet në Tiranë nga Lumo Skendo; Më 1980 Akademia e Athinës boton Fjalorin nën kujdesin filologjik dhe me një studim të detajuar të akademikut Titos Johallas me titullin, *Τοελληνο – αλβανικόνλεξικόντουΜάρκουΜπότσαρη*, ΠραγματείαιτηςΑκαδημίαςΑθηνών, τόμος 46, Αθήναι 1980; Në janar të 2008-s fjalori botohet për lexuesit shqiptar nga shtëpia botuese "Arbëria", i përgatitur për botim nga Niko Styllos.

[17]Τ. Γιοχάλας, po aty.f. 38

nga një shënim në frëngjisht, i Puquevillit, në dorëshkrim.Informacioni që na jep Puquevilli është i rëndësishëm për të përcaktuar se lema shqip nuk përbën "idiolekt" dmth nuk i përket një njeriu por nga ana tjetër mund të themi se materiali është i mjaftueshëm për të thënë se i përket të njëjtit dialekt të shqipes.[18]

Këto të dhëna na vërtetojnë autorin, vendin dhe kohën e shkrimit të fjalorit. Na ngelet të konstatojmë arsyen që e shtyu luftëtarin e madh të ndërmarrë një nismë të tillë dhe të ngelet në histori jo vetëm si një luftëtar i shquar, por edhe si leksikograf i një fjalori dygjuhësh.

Nga studiues të ndryshëm fjalori është konsideruar si një metodë që do të ndihmonte Sulotët në mësimin e gjuhës greke[19], ide për të cilën Johallas[20] shprehet se kjo duket shumë pak e mundur për disa arsye:

- Sulotët sipas të dhënave të ndrysme përdornin edhe greqishten.
- Materiali i fjalorit u referohet shumë pak fushave të fjalorit të përditshëm.
- Mungojnë fare nga dorëshkrimi dialogje të thjeshtë të përditshëm, të cilët autori duhet të kujdesej që të gjendeshin në të.
- Fjalori nuk ka asnjë renditje alfabetike që të ishte i përdorshëm lehtësisht.

Për të gjitha sa u përmendën mund të themi me siguri që as për të kundërtën nuk mund të jetë hartuar fjalori domethënë që të mësonin grekët elemente të gjuhës shqipe.

Sipas Johallës nisma për hartimin e fjalorit i përket Puquevilit i cili në atë periudhë tregonte interes për gjuhën shqipe dhe gjeti rastin të "shfrytëzonte" praninë e suliotëve biling në Korfuz dhe dashamirësinë dhe durimin e të riut Marko me të cilin bënte shoqëri. Në këto konkluzione arrijmë nga fakti që në të njëjtin kodik që është i përfshirë edhe fjalori, gjendet një fjalorth frangjisht – shqip i cili është hartuar në bazë të transkriptimit të fjalorit greqisht – shqip të Boçarit.[21]

I të njëjtit mendim është dhe prof. Xh. Lloshi, i cili thekson: "*Ky nuk ishte asnjë lloj fjalori, as nuk ka renditje fjalori e qoftë edhe emrat e ditëve të javëve nuk i ka të plota. Ishte lëndë gjuhësore për shqipen, që i nevojitet Pukëvillit për punën e vet të mëtejshme. Me termat e sotëm, ishte material*

---

[18]Τ. Γιοχάλας, po aty.f. 39-41

[19] Sipas L. Skendos:«*Boçari me hartimin e fjalorit deshi t'u vinte në ndihmë bashkatdhetarëve të vetë shqipfolës, që gjendeshin në Korfuz, të mund të komunikonin me grekët, gjuhën e të cilëve nuk e njihnin*.» (L Skendo, "Mark Mboçari", "Hylli i dritës", Shkodër 1939, tefhos 8 -10 faq. 388); Në botimin e 2008 tëN. Stillos, B. Kuçuku shkruan në hyrje: «*ky i ashtuquajtur fjalor është më tepër një lloj metode e thjeshtëpër t'u mësuarbashkëvendasve të tij, të strehuar në Korfuz, greqishten që nuk e dinin, por që edhe vetë mësuesi i tyre nuk e zotëronte mirë, bënte gabimetë cilat studiuesi i gjen në tekstin e tij*.»

[20]Τ. Γιοχάλας, *Το ελληνο – αλβανικόν λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη*, Αθήναι 1980, faq.40

[21]Τ. Γιοχάλας, po aty, faq 41

ekspedite gjuhësore, të cilin Pukëvilli nuk ishte në gjendje ta regjistronte vetë me shkrim. ... Ndonëse që më 1991 e kam vërtetuar se ky nuk është fjalor i Marko Boçarit, në studimet tona ai vijon pa të drejtë të quhet i tillë, duke mos marrë parasysh qoftë edhe faktin e thjeshtë se i ashtuquajturi autor ishte në atë kohë vetëm 18 vjeç.»[22]

Sipas Memishaj[23]: "Tek fjalori i M. Boçarit e vecanta është se fjalët janë marrë rastësisht dhe janë të shkëputura nga bota kishtare. Fjalori jep mundësi edhe për analiza dhe ftillime etnolinguistike, sepse këto elemente janë më të dalluara se në fjalorët ku fjalët janë grumbulluar me kritere shkencore."

- Ofron material të rëndësishëm për dialektologjinë shqiptare.
- I shkruar në fillim të shek. XIX na ndihmon të ndjekim disa dukuri gjuhësore interesante si psh. strukturën e gjuhës së folur greko – shqiptare të zonës së Fanarit të Prevezës në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX, larminë tipologjike në të folurën e përditshme, ndikimin e greqishtes dhe turqishtes mbi të folmen e kësaj zone, etj.
- Ofron material për fusha të ndryshme për filologjinë, sociologjinë akoma edhe për historinë.[24]
- Tek fjalësi shqip gjejmë fjalë që janë *të shqipes*, gjejmë shumë fjalë *të huazuara nga greqishtja*, ashtu siç gjejmë edhe *fjalë nga turqishtja*.[25]

5. Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit

Një tjetër vepër shumë e rëndësishme, që u hartua nga fundi i shekullit të XIX, por që vonoi shumë të shohë dritën e botimit, është «Fjalori Greqisht – Shqip» i Panajot Kupitorit[26]. Fjalori, një vepër shumë e rëndësishme që përshkruan gjuhën e arvanitasve të Hidrës në fund të shekullit XIX, mbeti dorëshkrim për rreth një shekull dhe vetëm në fillim të shek. XXI arriti të botohet falë kujdesit të prof. Titos Johallas.

---

[22] Xh. Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes: 100 – vjetori i Kongresit të Manastirit*, Tiranë, 2008, f. 107 – 108

[23] V. Memishaj, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë 2011, faq. 168

[24] Τ. Γιοχάλας, *Το ελληνο – αλβανικόν λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη*, Αθήναι 1980faq. 29

[25] V.Memishaj, *Studimepërfjalënshqipe*, Tiranë 2011, faq 167 - 168

[26] P. Kupitorikalindurmë 1821 në ishullineHidrës. Ai është injohurpërstudimetetijnë fushënealbanologjisë sidomosrrethgjuhësdhekulturënsë arvanitëve. Në vitin 1860 botoi "Abetaretë gjuhësshqipe". Dizertacioniqë mbrojtinë marstë 1879 kishtetitullin: «*Rrethpëremritvetortë vetëssë tretë të gjuhësshqipenë dialektineshqiptarëvetë Greqisë dhekryesishttë Hidrës.*» Duhettë shënojmë sefilologungaHidraishtenjohësshumë imirë i çdogjëjeqë është shkruarngaautorë të mesjetësdhebashkëkohës, grekë dhetë huaj, që kishtelidhjemeshqiptarëtdheShqipërinë. Libriitijmepakfaqe "*Studimeshqiptare*" (*Αλβανικαίμελέται, πραγματείαιστορικήκαιφιλολογικήπερίτηςγλώσσηςκαιτουέθνουςτωνΑλβανών*, Αθήνα 1879.)mundtë bëhetnjë fonddijeshdhetë shërbejë edhesotsithemelpërstudimetë mëtejshmealbanologjike. http://hydraspoliteia.blogspot.com.

5.1. Botimi i fjalorit

Siç u përmend më lart, nuk dihen arsyet përse autori nuk e botoi veprën e vet kur ishte gjallë. Një vit pas vdekjes së Kupitorit, më 1882, motrat e tij e shitën dorëshkrimin tek konsulli i Francës në qytetin e Janinës August Dozon. Edhe për këtë Stillos shprehet se nuk dihen arsyet përse Dozoni e bleu dorëshkrimin nga motrat e Kupitorit dhe jo nga e shoqja e tij Anna Gazis, e cila ka punuar edhe vetë mbi fjalor gjë që e dëshmon sigla e saj që vendoste mbi fjalët e korrigjuara.[27]

Në vitin 1925, Shoqata e Historisë dhe Etnologjisë së Greqisë bleu Fjalorin dhe ia besoi botimin e tij Qendrës së Hartimit të Fjalorit Historik të Akademisë së Athinës me udhëheqës prof. Tito Johallën. Për herë të parë Fjalorin e solli në dritë për publikun Titos Johallas në pjesën e dytë të veprës së tij, "Ydra ΛησμονημένηΓλώσσα" (Ydhra gjuhë e harruar) që u botua në Athinë më 2006.[28]

Në vitin 2011 Nikos Stillos botoi Fjalorin e Kupitorit për lexuesit shqiptarë të pajisur me parathënie në greqisht dhe shqip. Në këtë botim Stillos ka përshtatur pjesën shqipe me alfabetin e sotëm, të cilën e paraqet në gjysmën e faqes, kurse në gjysmën e parë na jep fjalorin sipas dorëshkrimit të Kupitorit. Vepra e Stillos ka gjithsej 655 faqe dhe fjalori përmbahet në faqet 39 – 655.

Studiuesi V. Memisha shkruan se: «… *ndryshe nga botimi i studiuesit T. Johallas, ku fjalët e të dyja gjuhëve janë përgjithësisht në greqisht, prurja shkencore e N. Stylos del më në pah, sepse jo vetëm e adreson Fjalorin te përdoruesi shqipfolës, por ka bërë një punë të vlerësueshme për të transkriptuar me alfabet latin a, më saktë, me alfabetin e shqipes së sotme, fjalësin shqip të fjalorit*.»[29]

Titulli i plotë i fjalorit të cilin e ka vënë vetë Kupitori është: «*Fjalor Greqisht – Shqip i shkurtër, nga greqishtja e re në dialektin shqip të arvanitasve të Greqisë, me përqasjen e fjalëve themelore dhe të dialekteve të tjera, domethënë të toskërishtes, gegërishtes dhe të arbëreshëve të Italisë.*»[30]

Dorëshkrimi i Fjalorit gjendet në arkivën e Shoqatës së Historisë dhe Etnologjisë së Greqisë me numër inventari 369, përpunuar dhe plotësuar nga albanologu pedagog në Shkollën e Gjuhëve të Lindjes të Francës A. Dozon.

Sipas N. Stillos, që erdhi në kontakt me fotokopje të dorëshkrimit të Fjalorit, për herë të parë në tetor të 2003, kur u gjend në Athinë, një fotokopje të kësaj kopjeje e ka dorëzuar ai vetë në Arkivin Kombëtar në Tiranë.[31]Dorëshkrimi

---

[27] N. Stillos, *Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit*, botimet Apeirotan, Tiranë 2011, f. 26.

[28] N. Stillos, *Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit*, Tiranë, 2011. f. 25.

[29] V. Memisha, *Qasje për disa riardhje të ditëve të sotme në leksikografinë shqiptare*, në Seminari ndërkombëtar..., Prishtinë, 2011

[30] «*Λεξικό ελληναλβανικόν επίτομον, εκ της νεοελληνικής εις την αλβανικήν διάλεκτον των εν Ελλάδι Αλβανών, μετά παραθέσεων των κυριωτέρων λέξεων και των άλλων διαλέκτων, οίον της τοσκικής, γκεγκικής και της των εν Ιταλία Αλβανών*»

[31] N. Stillos, *Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit*, Tiranë, 2011. f. 26.

përbëhet nga 1226 faqe. Shpjegimi i fjalëve në shqip është bërë duke përdorur alfabetin grek. Sipas Xh. Lloshit: "Autori ka përshtatur alfabetin e greqishtes, duke përfshirë edhe disa shkronja latine: b, d, (për ta dalluar nga [dh] që e jep me gërmën përkatëse greke δ), «e» për (ë) (kurse ε për e), g, gj, h, j; ka përdorur dyshkronjësha λj(l), μπ (mb), γγ (ng), νj(nj), σς (sh), τσς (q)."[32]

5.2. Shqyrtimi i lëmave të fjalorit

Fjalësi në gjuhën greke përmban një numër të konsideruar fjalësh, të cilat autori është munduar t'i përkthejë ose të gjejë një fjalë analoge në gjuhën shqipe. Sipas mendimit tonë, fjalësi greqisht duhet të jetë kopjuar në tërësi nga një fjalor tjetër njëgjuhësh ose dhe dygjuhësh, që autori kishte në dispozicion, me greqishten si gjuhë burim. Në vazhdim autori është përpjekur të gjejë fjalën analoge në gjuhën shqipe. Në këtë rezultat arrijmë nga fakti se në fjalor ka fjalë greke të shënuara në rendin e lëmave për të cilat nuk është dhënë fjala analoge shqipe, e cila ose nuk ekzistonte, ose nuk e ka gjetur apo e ka krijuar autori. Fjalësi në greqisht nuk paraqet ndonjë interes të veçantë, ajo që na intereson më shumë në këtë vepër është pjesa shqip e lëmave.

Në shumicën e rasteve autori jep më shumë se një fjalë shqipe ose forma të ndryshme të së njëjtës fjalë për çdo fjalë greke. p.sh.: απάντημα, το, përpjekësi-a, përpjekësim-y, të përpjekurë-itë, të-përzierë-itë, të-dallë-të përpara, përgjegjësim-y, të përgjegjurë-itë, të paguajturë-itë kshivë. Në fjalor gjejmë të përcaktuara me shkurtesën përkatëse fjalë edhe nga gegërishtja edhe nga toskërishtja (γ. γκεκ., γκεγκ., g. – gegërisht; τ., τοσκ. - toskërisht). Sipas prof. Xh. Lloshi: "Shqyrtimi i leksikut shqip në Fjalorin e Kupitorit e vërteton më së miri, se ai punonte për shqipen përgjithësisht dhe jo për të folmen e arvanitëve. Me njohuritë që ka pasur, ka përfshirë edhe trajta të gegërishtes, të cilave u ka vënë shënimin përkatës; p.sh. *allonari, bredhësi*, g. *qershuri; lëmë*, g. *lanjmëma*.»[33]

Në fjalor në përgjithësi nuk ka një tregues që të bëhet dallimi midis kuptimeve të fjalëve polisemike. Në disa raste për dhënien sa më të plotë të kuptimit të fjalës autori përdor ilustrime, ku është përfshirë fjala në mini tekst/shprehje p.sh.: βραχύς, -εία, -ύ, shkurt, i-shkurtërë, shkurtës, shkurtak; i-pakë; i-vogëll; i-poshtërë. ο βίοςβραχύς, ηδετέχνημακρά, jeta isht eshkurtërë e mnjeshtria e-gjatë. ενβραχείχρόνο, për pak kohë. διαβραχέων, me të-shkurtërë kshile, me pak fjallë.

Gjatë shpjegimit të fjalëve të greqishtes, autori shpesh herë përdor përsëri fjalë greke p.sh.:σελίς, η, katevato-j, selidhë-a; σημάδι, το, simath-dhy. Kjo mund të ndodhë për dy arsye: ose fjala greke përdoret në masë të gjerë nga arvanitët, ose është krijim i autorit. Në lidhje me këtë duhet bërë krahasimi me fjalorë të tjerë të arvanitishtes.

---

[32] Xh. Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes: me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit.* 2008, f. 171-172

[33] Xh. Lloshi, *Po aty*, f.171-172.

Në shumë raste autori në pamundësi për të gjetur fjalën analoge e ndërton vetë. Prof. Xh. Lloshi thekson se: "Përballë një fjalësi shumë të gjerë të greqishtes ka qenë i detyruar të ndërtojë shumë neologjizma vetjake; po sjell si shembull vetëm disa me parashtesën pa-: *i pabëfadisurë, i padritësuarë, i padritësuam, i padhembshurë, i padhembshëm, i padhemburë, i pahelmuarë, i pahelmuam, i pahidhëhurë, i palerë, i palejturë, i paliturgjisurë, i pamëndusuarë, i panëmëruarë, ...*Kjo lëndë shërben për të njohur përpjekjet vetjake të autorit, por nuk e ka vlerën e leksikut të mbledhur nga përdorimi i gjallë, si në rastin e Kristoforidhit. Me keqardhje më duhet të shtoj, se nuk mbetet vend për vlerësimin e studiuesit të shquar të të folmeve të arvanitëve, drejtorit të Insitutit të Gjuhësisë ne Universitetin e Këlnit, Hans -Jürgen Sasse, se ky dorëshkrim: ―Pavarësisht nga disa vështirësi në transkriptim dhe nga mungesa e shënimeve për vendin e prejardhjes së disa fjalëve, nuk mund t'i mohohet kësaj vepre rëndësia si burimi leksikografik më i rëndësishëm për arvanitishten e shekullit të kaluar.»[34]

6. Konkluzione

Përveç fjalorëve të lartpërmendur prof. Johallas në parathënien e fjalorit të Boçarit na informon se «*Në këto (Fjalorë) e drejtë është të shtohen edhe glosarët e shkurtër shqip – greqisht të Lluka Bellos (1848- 1913),*[35] *nga Thiba ... si dhe glosarët shqip – greqisht, të cilat përmbajnë elemente të së folmes shqipe të Attikës, të Petro Furiqit (1878 – 1936)*[36]*dhe të Kr. N. Petru Mesogjitu(1909 – 1944).*[37]»[38]

Forca shtytëse për hartimin e Fjalorit të Boçarit është e qartë se vinte nga një i huaj europianë, i cili në atë periudhë ishte i interesuar të mësonte për Shqipërinë dhe gjuhën shqipe, interes që shfaqej në kuardin e një lëvizjeje të përgjithshme europiane me qendër gjuhët dhe kulturën e popujve më pak të njohur. I njëjti interesim i të huajve që u prmend më lart, solli në dritë edhe fjalorin e Kupitorit, i cili është blerë nga familjarët e autorit nga konsulli Duzon.

Të dy fjalorët janë hartuar njëri në fillim dhe tjetri në fund të shekullin XIX.Fjalorët e Boçarit dhe Kupitorit janë shkruar tërësisht në gjuhën greke, si lëmat në greqisht ashtu edhe ato në shqip. Kjo ndodh për arsye se shqipja deri atëhere ishte e pakodifikuar.Secili nga autorët ka përdorur një alfabet të vetin për të përmbushur nevojat e fonetikës së gjuhës shqipe.

---

[34]Xh. Lloshi, poaty, 2008, f.171-172.

[35] Λ. Μπέλου, *Αλβανικά ή αι τρεις ζώσαι διάλεκτοι της ελληνικής γλώσσης*, εν Αθήναις, 1903 (Υπουργείο Εσωτερικών, Δημοσιεύματα του Τμήματος της Δημόσιας Οικονομίας αριθμ. 6), σ.76 – 112.

[36]Π. Φουρίκη, «*Η εν Αττική ελληνοαλβανική διάλεκτος*», Αθήνα 44(1933), σ. 59-72 και 45(1933), σ. 166-169.

[37]Χρ. Πέτρου – Μεσογείτου, «*Ελληνικές λέξεις εν τω ιδιώματι των αλβανοφώνων της Αττικής*», εις:Αφιαίρωμα εις Κ. Ι. ¨Αμαντον, Αθήναι 1940, σ. 225-244.

[38]Γιοχάλας .Po aty, f. 34.

Të dy fjalorët janë hartuar në Greqi nga autorë me origjinë arvanitase.Me studimin shkencor të tyre si dhe me përgatitjen e tyre për botim për publikun u angazhua albanologu i njohur akademiku Titos Johallas. Këto studime ofrojnë material të vlefshëm si për dialektologjinë shqiptare dhe historinë e gjuhës shqipe ashtu edhe për kulturën dhe identitetin e ngulimeve arvanitase në Greqi.

7. Literatura

Botime

Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976

J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, shblu, Tiranë 2003

N. Stillos, *Fjalori greqisht – shqip i Panajot Kupitorit*, botimet Apeirotan, Tiranë 2011

N. Stylos, *Fjalori i Marko Boçarit*, Tiranë, 2008

Th. Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht e gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike*, përgatitur nga Dhori Qiriazi, Tiranë 2014

V. Memishaj, *Studime per fjalen shqipe*, Tirane 2011

Xh. Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes: me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit*. 2008

K. Χριστοφορίδου, *Λεξικόν της Αλβανικής γλώσσης*, Αθήναις 1904

Τ. Γιοχάλας, το ελληνο-αλβανικόν λεξικόν του Μάρκου Μπότσαρη, Πραγματείαι της Ακαδημίας Αθηνών, τόμος 46, Αθήναι 1980

Artikuj shkencor

G. Meyer, Albanesische Studien V. Beitrage rur Kenntnis der in Griechenland gesprochenen albanesischen Mundarten, Wien 1896, Sitzungsberichte der kais. Akademie der Wissenschaften in Wien. Philosophisch-Historische Classe, Band CXXXIV, 6.5

http://hydraspoliteia.blogspot.com.

K. Ksera, *Rreth leksikografisë dygjuhëshe greqisht – shqip dhe shqip – greqisht*, doktoraturë, Universiteti i Tiranës, 2015http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/05/Kostando-KSERA-RRETH-LEKSIKOGRAFIS%C3%8B-DYGJUH%C3%8BSHE-GREQISHT-%E2%80%93-SHQIP-DHE-SHQIP-GREQISHT.pdf

V. Memisha, *Qasje për disa riardhje të ditëve të sotme në leksikografinë shqiptare*, në Seminari ndërkombëtar..., Prishtinë, 2011

Κυριαζής file:///C:/Users/dell/Downloads/2595-4455-1-PB%20(3).pdf1_f. 166

Λ. Μπέλου, Αλβανικά ή αι τρεις ζώσαι διάλεκτοι της ελληνικής γλώσσης, εν Αθήναις, 1903 (Υπουργείο Εσωτερικών, Δημοσιεύματα του Τμήματος της Δημόσιας Οικονομίας αριθμ. 6), σ.76 – 112.

https://anemi.lib.uoc.gr/php/pdf_pager.php?rec=/metadata/1/3/b/metadata-01-0000670.tkl&do=100783.pdf&lang=el&pageno=1&pagestart=1&width=454.08%20pts&height=671.52%20pts&maxpage=512

Μ. Βελιώτη – Γεωργοπούλου, *Γλωσσική ιδαιτερότητα και εθνική ταυτότητα, Αρβανίτες και αρβανίτικα*», Μνήμη Τασούλας Οικονόμου, edu2009, έκδ. Παν/μιο Θεσσαλίας. Τμήμα Ιστορίας, Αρχαιολογίας και Κοινωνικής Ανθρωπολογίας-Δημοτική Επιχείρηση Πολιτισμού Άργους-Δήμος Μυκηναίων, σελ. 21-35.

Ν. Λιόσης, *Μερικά βασικά χαρακτηριστικά του αρβανίτικου ιδιώματος της Λακωνίας. Συγκριτική εξέταση με άλλα αρβανίτικα ιδιώματα και τα νότια τόσκικα*, AlbanohellenikaNo 3, 2008, σελ.8

Π. Κουπητώρη, *Αλβανικαί μελέται, πραγματεία ιστορική και φιλολογική περί της γλώσσης και του έθνους των Αλβανών, εν Αθήναις, εκ του τυπογραφείου του μέλλοντος*, 1879.

Π. Φουρίκη, «*Η εν Αττική ελληνοαλβανική διάλεκτος*», Αθήνα 44(1933), σ. 59-72 και 45(1933), σ. 166-169.

Χρ. Πέτρου – Μεσογείτου, «*Ελληνικές λέξεις εν τω ιδιώματι των αλβανοφώνων της Αττικής*», εις:Αφιαίρωμα εις Κ. Ι. ¨Αμαντον, Αθήναι 1940, σ. 225-244.

PEMA NË ORGANIZIMIN E STRUKTURËS TRADICIONALE SHOQËRORE TË SHQIPËRISË SË JUGUT, NJË KOMUNIKIM DIAKRONIK ME ORAKULLIN E DODONËS

Panajot Barka
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë & Qytetërimit Grek
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
panajotbarka@yahoo.gr

Abstrakt

Pema dhe roli i saj në organizimet (strukturat) tradicionale shoqërore (mjedise urbane apo fshatra) në Jugun e Shqipërisë na çon në marrëdhëniet e lashta të njeriut me natyrën, të mishëruara tek Orakulli i Dodonës. Kjo përqasje përbën qëllimin bazë të këtij artikulli. Në strukturën e kësaj qëndre tradicionale kanë zenë vend të gërshetuara elementë natyrorë dhe shoqërorë me vlerë kulturore dhe funksion të caktuar shoqëror. Elementë të strukturës me origjinë shoqërore kanë si pikë referimi një elementë natyrorë – pemë, kryesisht rrap, por edhe prar apo lis, dushk. Origjinën e këtij fenomeni dhe rezistencën në kohë duhet kërkuar te roli dhefunksioni i Orakullit të Dodonës. Konkluzionet që mund të tërhiqen kanë të bëjnë me përcaktimet e rolit të natyrës në jetën e banorëve të këtushëm, me rolin në formësimin e identitetit të tyre kulturor dhe jo vetëm.

***Fjalë kyç**: struktura tradicionale, pema, kisha, Orakulli i Dodonës*

Abstract:

The Tree and its role in traditional social organizations (structures), (urban or rural communities), in southern Albania leads us to ancient human relations with nature incorporated in the oracle of Dodona. This approach constitutes the basic purpose of this paper. In the structure of this traditional center have already taken place the interwoven natural and social elements of cultural value and assigned social functions. Elements of the structure of social origin have as a reference point, a natural element - the tree, mostly plane, but also prar or oak. The origin of this phenomenon and its resistance in time should be traced back to the role and function of the oracle of Dodona. Conclusions that can be reached regard the definitions of the role of nature in the lives of residents thereof, its role in shaping their cultural identity and not only that.

***Keywords**: traditional structure, tree, church, oracle Dodona*

Hyrje

Veçoritë e Orakullit të Dodonës dhe natyra e civilizimit të tij.

Organizimi i strukturave tradicionale shoqërore dhe kulturore në Jugun e Shqipërisë dhe më gjerë në Epir na çon në marrëdhëniet e stërlashta të njeriut të këtushëm me natyrën, të kodifikuara tek Orakulli i Dodonës. Artikulli ynë kërkon të sjell argumente që vërtetojnë këtë risi kryesisht në raport me pemën.

Orakulli i Dodonës jetoi në funksionin e tij profetik prej prehistorisë deri ne disa shekuj të krishtërimit. Zëmrën e tij e përbën një pemë. Lisi apo Valanidhja e Shënjtë. Qe i pari orakull dhe për një kohë të gjatë i vetmi në kozmosin e lashtësisë greke. Paralelisht, tek ai u mishërua gjithë spektri fontamental kulturor, i cili njihet ndryshe si civilizimi dodonas.

Sistemi i miteve në lidhje me themelimin e Orakullit dhe peshën e tij të papërseritshme në jetën shoqërore, kulturore, politike, etnike, apo edhe individuale, jo vetëm të Epirit dhe Maqedonisë së Lashtë, por dhe më gjerë se bota greke, ngërthen në vetvete dy linja bazë që i shërbëjnë botëkuptimit të njeriut të kësaj hapësire për natyrën.

E para. Orakulli i Dodonës përbën një zhvillim të sistemit egzistues hyjnor parahistorik të identifikuar në kulturën e Egjeut, Kretës apo të Lindjes së Mesme, i mishëruar në kushtet konkrete të Epirit.

E dyta. Ka të bëjë me thelbin e kozmosit antropologjik të njeriut të këtushëm.

Në bazë të tij qëndron fakti se përenditë nuk përbejnë një realitet që ndodhet jashtë njeriut dhe me pushtet mbi të. Përenditë e Dodonës përbëjnë kodifikim të ndërgjegjës së njeriut të këtushëm, në aspektin social, në marrëdhëniet e tij me natyrën. Këtë kodifikim e realizon nëpërmjet shndërrimit të objekteve natyrorë (natyrës) në mite dhe simbole, që funksionojnë me mekanizma institucionesh hyjnorë dhe njërëzorë. Ky lloj komunikimi përvijohet si identitet kolektiv i përcaktuar si marrëdhënie të vlerave të tij në harmoni dhe në ekuilibër me vlerat e natyrës. Si i tillë përcakton orientimin e kulturës së kësaj treve deri në ditët tona.[1]

Natyra e kronotoposit te civilizimi i Dodonas.

Kozmosi i njeriut të Epirit në raport me Dodonën ka dy drejtime në thelb të kundërta dhe në unitet. E para, centripete, që do të thotë se sistemi i vlerave krijuar prej tij në raporte harmonie me natyrën, çoi në krijimin dhe në institucionalizimin e Orakullit të Dodonës. Këtu duhet marrë në konsideratë edhe ndikimi mbi të, ose adoptimi prej tij i eksperiencave të ngjashme në hapësirën, apo gjeografinë e botës së njohur në atë kohë.

---

[1]Kapsomenos E, (2002), Anazitontas to hameno evropaiko politismo, v.I, Pataki, Athinë, fq.17-22,44.

E dyta, centrifugale. Me qendër Orakullin e Dodonës u strukturua kosmogonia dhe teogonia lashtësisë greke. Mbi bazën e saj mori jetë brezi i parë i sistemit politeist grek (me Zeusin Dodonas dhe Gjean), për të fituar një status të dytë, atë të perëndive të Olimpit. Po ashtu, brenda logjikës së këtij centrifugaliteti nisen prej Dodonës, në hapësirë e kohë, "udhëtimet" e tyre (shpesh me vajtje ardhje), heronj mitikë dhe njerëzorë, përendi dhe gjysëmpërendi, orakuj të tjerë me pak të rendësishëm dhe të karakterit lokal. Të dy këto kahje nuk veprojnë me mevetësi dhe të pavarurë por gjithmonë në marrëdhënie dialektike.

Koha më intensive për këtë realitet ndodh me pikë referimi Luftën e Trojës, para e pas saj. Kështu, të gjithë heronjtë grekë e trojanë para kësaj lufte vizitojnë Orakullin. Pas fundit të saj, heronj trojanë të mbëtur gjallë u rikthyen në Dodonë, "morrën" profecinë për të ardhmën e tyre dhe u angazhuan për ta realizuar atë. Ndërmorën ndërtimin e qytetëve të tyre dhe një rol të rendësishëm politik e shoqëror.

Tek Zeusi Dodonas, mbrojtës i Orakullit falej Ahileas (Akili), por edhe Odhiseas. Iraklis (Herkuli) realizoi këtu dy nga dymbëdhjetë fitorët e tij mitike. Neoptolemos, i biri i Ahileas, mori peng Andromakën, të venë e Hektorit dhe nga bashkimi i tyre u lind Mollossos, mbreti i ardhshëm i Epirit.

Heleni, i biri i mbretit të Trojës, Priamit, u bë mbret i Epirit dhe frymëzoi Eniean të themelojë Butrintin. Po ashtu profecia e Drurit të Shënjtë, sipas Virgjilit, i hapi Enieas rrugën me destinacion themelimin e Romës.[2]

Perëndi të ndryshme të botës greke që i përkasin brezit të dytë, të Olimpit, rikthehen në mënyrë diakronike në Epir dhe te Orakulli i Dodonës. Përmendim Athinanë, e cila konsiderohet perëndeshë e mirifilltë Epirotase, por edhe Apollonin dhe motrën e tij Artemis, Afrodhitin (Afërditen), Themidhen, Estian etj.[3]

Për shkak të numrit të madh dalin jasht kuadrit të këtij shkrimi emrat e mbretërve të lashtësisë greke që vizitonin Orakullin për të dëgjuar profecinë për jetën personale, familjare dhe të mbretërisë, për fatin e luftrave që do të ndërmirrnin etj. Por kuptohet se nuk mund të lihen pa përmendur emrat e Aleksandrit të madh dhe të Pirros së Epirit, që nën drejtimin e tyre, Orakulli i Dodonës fitoi fizionominë arkitekturore që njohim edhe sot.

Në këtë kendvështrim prania e Dodonës dhe roli i saj nuk lidhet thjesht me "toposi-in", hapësirën gjegorafike, por edhe me "hronos-in"- kohën. Këtë rrugëtim të ndryshueshëm në hapësirë, (gjeografi), por jo në hrono, kozmosi i Dodonës vazhdon ende edhe sot në formën e mesazheve të kodifikuara, praktikave dhe dokëve e zakoneve të trashëgimisë kulturore popullore, të

---

[2]Barka P., 2016, Ta taksidhja tis Figou, v.I, Elikranon, Athinë, fq. 33-38,77-79

[3]Tzovara-Souli Hr., 1979, I latria tvn gynekion theotiton is tin arheon ipiron, punim doktorature, Un.
Janinës, fq.11-13,45,47.

cilat përcaktojnë në kronotoposin e tyre kulturën dhe sjelljen kolektive të njeriut të këtushëm në raport me natyrën dhe shoqërinë.[4]

Organizimi arkitektonik i Orakullit të Dodonës

Orakulli i Dodonës që nga koha kur mitet nuk ishin takuar me historinë funksionoi vetëm përmes një peme:- Lisit, Valanidhes së Shënjtë-Figosë. Ndërtimet e godinave të para filluan nga fundi i shek. IV p.Kr me tembullin e Zeusit, mbrojtes i Orakullit. Aleksandri i Madh, në kuadrin e vizionit të tij të panhelenizmit dhe me pas Pirroja ndërtuan rreth pemës orakull, kompleksin arkitekturor të ndenjë për botën e atëhershme greke por edhe të veçantë.

Për ne ka rendësi të theksojmë se në krahë të Pemës Orakull, zunë vend tempujt kushtuar përendive të tjera dodonase. Pak me tutje dhe pas gati dy shekujsh, u vendosen godinat e karakterit publik, pritanio, vouleftirio, teatri antik, stadiumi etj. Më tutje dhe në varësi të terrenit ishin banesat popullore.

Dallimi midis Figosë dhe rolit të pemës në kulturën e popujve të ndryshëm.

Është e vërtetë se tradita mitologjike dhe popullore në shumë popuj të botës e trajtojnë pemën si boshtin e gjithësisë dhe shprehje të përjetësisë, të ripërteritjës së tokës në zhvillim. Shpesh përzgjedhin një lloj peme për t'i atribuar gjithë simbolikën. P.sh vallanidhjaja ishte për Keltët pemë e shënjtë, për gjermanët bliri, për indianët fiku.

Janë gjithashtu të njohura nëpër mitologjitë e popujve të ndryshëm paralelizmat midis perendive dhe pemëve të veçanta. Kështu përendia Atti paralelizohet me bredhin, Osiri me kedrin, Zeusi me lisin, Apoloni me dafinën etj.

Rasti i Figos së Shënjtë (Valanidhes, Lisit) në Dodonë ka një destinacion tjetër. Së pari bëhet fjalë për një pemë konkrete, Valanidhen, (Lisin) konkrete dhe jo për të gjitha lisat. Nuk përbën një simbol abstrakt i ndërtuar mbi bazën e një miti inegzistent.

Te Lisi, Figo-ja,"në aksin e vet të tokës" mbështetet Gjithësia e terë. Krijon shtratin për konceptimin e teogonisë dhe kosmogonisë, për jetesën e perëndive dhe të sistemeve hyjnore, për veprimin e heronjve mitikë dhe historikë. Me një fjalë ngërthen një civilizim unik, në të cilin, profecitë si të tilla njohin realitetin e tyre të provuar në aksin kohor të së ardhmës.

Në këtë kendvështrim, Figoja e Shënjtë përbën një përjashtim karakteristik për teoritë moderne lidhur me antropologjinë sociale dhe ekologjike. Këto teori konkludojnë se "Veprimtaritë kulturore zhvillohen në hapësirë (natyrë)

[4]Barka P, (2003), Llaografika,Shblu, Tiranë, fq. 292.

dhe fiksohen diakronikisht duke ndjekur ndryshimin e sistemeve shoqërore" [5] dhe se "natyra në shekuj nuk paraqet një materie të pandryshueshme jashtë shoqërisë njerëzore dhe kulturës së saj..."[6]

Në rastin tonë, veçantia qëndron tek fakti se arketipi strukturor i organizimit shoqëror të Orakullit të Dodonës, si institucion me aks qëndror Valanidhjan e Shënjtë, përbën realitetin e pandryshueshëm në hapësirë e kohë (kronotopos), pavarësisht ndryshimeve historike shoqërore, politike apo dhe ekonomike dhe se tek ky organizim të pandryshuar tradicionalisht zhvillon jetësën dhe kulturën e vet, në aspektin shoqëror, njeriu i këtushëm. Ai jeton në kronotopsin e këtushëm në një përjetim harmonik dhe organik me vlerat natyrore, etike dhe estetike. Pra, në lidhje me sa më sipër, kemi nga njëra anë një antinomi, në raport me rregullin e përgjithshëm dhe njëkohësisht kapërcimin e saj. Komuniteti shoqëror në raport me Dodonën, pavarësisht zhvillimit të pandërprerë të sistemeve shoqërore, politike dhe ekonomike, ruan të pandryshueshëm mënyrën e organizimit të strukturave shoqërore që burojnë nga arketipi i Dodonës duke respektuar me rigorozitet riprodhimin e strukturave të këtij organizimi. Në hapësirë, në gjeografinë e pranisë së civilizimit Dodonas, Epirit dhe në kohë, me praninë e civilizimit Dodonas në çdo të tashme si mundësi të garantura zhvilimi drejt së ardhmës.

Po ashtu, me pikënisje Orakullin e Shënjtë, mund të ndiqet ecuria e rolit të pemës në organizimin e strukturave tradicionale shoqërore në hapësirë, tradicionalisht në Epir dhe në kohë deri në ditët tona.

Mbartja e traditës së Orakullit në organizimet e sotme të strukturave shoqërore.

Ende dhe sot e kësaj dite pema është mjeti dallues për identifikimin e një qendre urbane apo rurale, tradicionale apo bashkëkohëse në Epir dhe në pjesën e saj në Shqipërinë e Jugut. Pra, pema është e para dhe boshti kryesor përcaktues për organizimin e një qendre të një mjedisi të banuar këtu. Rreth pemës janë vendosur, sipas etapave të zhvillimit, objekte të tjera për veprimtari të përbashkët: fetare, prodhuese, artizanale, arsimore etj. Rreth kësaj qendre, vendosen, në formë rrathesh të çrregullta koncetrikë apo gjysëmrrathesh, banesat private.

Lëhtësisht konstatohet se struktura e këtyre qendrave përbën një mikrografi të strukturës arkitektonike të Orakullit të Dodonës. Në organizimet tradicionale shoqërore të kësaj treve, zgjedhja e pemës është një valanidhe, dushk, lis, rrap, ose prar. Kryesisht një pemë e fortë, hijerendë dhe jetegjatë. Pranë kësaj peme është vendosur kisha, objekt që lidhet me përhapjen e kristianizmit dhe përfaqëson vullnetin e perëndishëm në Tokë.

Pra, ndodh një diferencim që nuk është shënuar në Dodonë. Pema humbet atributet hyjnore dhe profetike, por kurrsesi jo, ato kulturore dhe shoqërore.

---

[5]Nıtsiakos V., 1991, Paradhosiakes kinonikes dhomes, Athinë, fq. 17
[6]Eder K., 1996, The social construction of nature, London , fq. 38-47

Vetitë hyjnore dhe mbrojtëse nga e keqja iu atribuan objektëve kishtare rreth saj.

Pema, si pikënisje e organizimit të qendrës së një strukture tradicionale shoqërore dhe në jugun e sotëm të Shqipërisë, ruajti integritetin e vet edhe në ato raste kur komuniteti ndërroi fenë dhe kishat u prishen. (Pema mbëti pjesë dhe e organizimit të teqeve tek bektashinjtë)

Më vonë, kur organizimi shoqëror i prodhimit u mbështet te diferencimi i aftësive prodhuese, pranë pemës dhe formacionit fetar u vendosen zejet e përbashkëta, ose në shërbim të të gjithë komunitetit.[7]

Shumë me vonë, pranë tyre (pemës, kishës, objekteve artizanale), u vendosen shkollat, apo dhe institucione të tjera. Karakteristikë e përbashkët e tyre ishte bashkegzistenca në tolerancë dhe harmoni midis tyre. Kjo vlerë u cenua në periudhën e sistemit totalitar komunist. Në këtë periudhë të vonët, ose të re u shtua një element i ri,-shtëpitë dhe vatrat e kulturës. Ky element i ri social e kulturor i imponuar nga politika, nuk do të përbënte një risi negative në rast se në vijim të traditës shekullore do të vendoste raporte tolerance, kohëzioni dhe komplementare me objektet e kultit, siç bëri p.sh me shkollat. Fatkeqësisht, midis tyre u imponua një antagonizëm ideologjik asimetrik në dëm të traditës shekullore në lidhje me objektet e kultit. Vatrat apo shtëpitë e kulturës, ose u ngriten duke adoptuar objektet e kultit, ose në pozicione të tilla që të mënjanonin sa më shumë objektet fetare nga qendrat tradicionale. Në shumë raste objektet fetare u shkatërruan.

Në vijim, thellimi i kolektizimit socialist dhe qëllimi i partisë shtet për krijimin e një fizionomie "socialiste" dhe në organizimin e strukturave tradicionale shoqërore, çveshen qendrat tradicionale nga objektet artizanale.

Mëgjithatë, krahasimisht me traditën mijravjeçare, rasti i mësipërm përbën një incident, që po rikorrigjohet pas rreniës së sistemit komunist.

Ndërkohë mendojmë se duhet vemë re një risi me shumë interes. Faktin që në këtë proces të gjatë historik, elementet e karakterit shoqëror në organizimin e qendrës tradicionale urbane, fituan terren në aspektin e funksionit praktik. Objektet e kultit shtuan së tëprmi peshën dhe rolin e tyres, hkollat forcuan poziten shoqërore, zejet u perfeksionuan. Por pavarësisht këtyre transformimeve pema rezistoi dhe roli i saj nuk u cenua.

Rezistenca e pemës, si objekt natyror me vlerë kulturore funksionale dhe estetike, në organizimin e strukturës shoqërore tradicionale, dhe lidhja e saj në mënyrë të pazgjidhshme me identitetin kulturor të këtij rajoni, i dedikohet komunikimit shpirteror, metafizik e praktik të njeriut të këtushëm me pemën orakull të Dodonës.[8]

---

[7]Vernikos N, Daskallopullu S.1999, Stis aparhes tis neoellinikis idheollojias,kronika e Dropullit,
Athinë, fq. 90-91.

[8]Nitsiakos V, 1997, Llaografika eteroklita, Athinë, fq.74.

Aq i rendësishëm dhe përfaqësues është pema e Dodonës saqë, Piroja, apo Aleksandri i Madh e përdoren gjerësisht në sistemin emblematik e simbolik të tyre. Edhe Gjergj Kastrioti si princ i Epirit përdori frytin valanidhës si mjet zbukurimi në pelerinën e tij zyrtare.[9]

Një tregues tjetër që flet për vendin e vëçantë që zë pema në kulturën tradicionale dhe identitetin e kësaj treve përbën fakti që nga 308 biomonumente natyrore të Shqipërisë me element kryesor pemen, 141 gjenden në qarqet Fier, Vlorë, Korçë e Gjirokastër. Vendin e parë e zë qarku i Gjirokastrës me 48 biomonumente dhe rrethi i Gjirokastrës me 25 të tilla.[10]Karakteristikë tjetër përbën fakti që shumica e këtyre biomonumenteve në Jug të vendit janë pemë të vëçanta që lidhen me emra qendrash të banuara, ose me vende e ngjarje historike (Rrapi në Mashkullor, në Hekal etj), ndërkohë që krejt e kundërta ndodh me biomonumentet në pjesën tjetër të territorit të vendit.

Marrëdhëniet harmonisë së njeriut me natyrën dhe identiteti kulturor

«Një kulturë është para së të gjithash një mjedis natyror», na thotë antropologu i njohur francez Fernand Braudel. Rasti i Dodonës na lëjon të themi se një mjedis është mbi të gjitha një kulturë, me kuptimin se në të është fiksuar në mënyrë diakronike vet mënyra e organizimit të jetës së komunitetit, dmth vetë kultura dhe identiteti i tij.

Për të pasur një ide më të qartë në lidhje me formësimin e këtij identiteti në shekuj huazojmë sistemin e Claude Lévi-Strausstë përdorur si istrument studimi në fushën e etnologjisë dhe mbështetet te raportet *natyrë-kulturë, individ-shoqëri, liri-robëri* dhe *jetë-vdekje*. [11]

Një vështrim i shkurtër, qoftë edhe përshkrues na lëjon të vemë re se në rastin tonë këto çifte jetojnë dhe veprojnë në harmoni, janë komplementare dhe në unitet. Këto vlera i garanton dhe i rrezaton realiteti kulturor-estetik i Orakullit të Dodonës. Sipas mitologjisë në themelet e Orakullit qendron pema dhe zogu. Në vijim këto dy elementë përbejnë edhe thelbin e mitit poetik të këngës popullore dhe të letërsisë së trevës përreth (çifti natyrë-kulturë).

Për I.Kadarenë [12] rrapi është elementi natyror përmes së cilit mund të simbolizohet qendresa dhe vitaliteti i një populli të terë (çifti liri-robëri).

Në krijimtarinë popullore pema është lidhur me vendpushimin e luftetarit i cili kur plagët i kërcenojnë jetën kërkon të prehet përjetësisht nën hijen e saj dhe zhurma e armeve të varura në degët e saj të kodifikohet si mesazhe drejt jetës mbitokësore (çifti jetë-vdekje).

Në të tri rastet përvijohet lehtësisht dhe çifti individ shoqëri.

---

[9]Zeqo M, 2005, Gravura më e hershme e Skënderbeut, gaz. Korrieri 26.08. 11.
[10]Qiriazi P, Sala S. 2006, Monumentet e Natyrës Shqiptare, Tiranë, fq.23-141.
[11]Strauss L Cl, 1949, Les structurale élémentaires de la parenté, Paris, fq. 9.
[12]Kadare I, 1980, Autobiografia e popullit në vargje, Tiranë.

Në një kendvështrim tjetër, zogu është protagonist i metaforizuar apo i personifikuar që shpalos koshiencën dhe subkoshiencën e dëshirave dhe aspiratave të njeriut të këtushëm. Ndërsa pema ka një funksion statik vertikal nga qielli në drejtim të tokës, zogu, me veçori më të theksuara personifikimi, zotëron një dinamikë horizontale dhe vertikale drejt qiellit, për të kontrolluar, apo komunikuar me ato vende, ngjarje apo aspirata që njeriu nuk i arrin dot.

Produkt i qendrimit dhe i vlerësimit të raportit harmonik të njeriut me natyrën është fillimisht perceptimi estetik i natyrës nga njeriu.

Në këtë kendvështrim, pema si e tillë fitoi vlera estetike edhe në funksionet e saj praktike në shërbim të njeriut. Vëçanërisht ato me kurrorë të madhe e me gjelbërim të përhershëm, shërbëjnë si mjete shumë të përshtatshme për t'i ardhur në ndihmë bujkut e blegtorit kryesisht në ditët e nxëhta të verës.

Në traditën popullore, pema është lidhur me burimin e ujit dhe udhëtarin.

Nga ana tjetër Dodona është djepi i universit brilant të mitologjisë së lashtë greke. Mbi këtë realitet dhe me një komunikim apo mbartje të drejtpërdrejtë artistike e estetike të kësaj mitologjie hodhi shtat eposi dhe letërsia e lashtë greke.

Mund të vemë re se strukturat krijuese dhe kodet e vlerave estetike në mitet poetike të letërsisë popullore e të kultivuar të kësaj treve, burojnë tek natyra me një komunikim aktiv me eposin mitologjik.[13]

Në periudhën e Mesjetës dhe më vonë, paralelisht me eposin heroik (si karakteristikë e përgjithshme evropiane e frymëzuar, siç thotë Çabej, nga eposi i Dh. Akritës[14]) dhe baladat (si aktualizim i arketipit të dramave njerëzore të mishëruara në mitologji dhe në letërsinë klasike), u mbart gjallë dhe u mbrujt një gjërdan mitesh në formën e legjendave e tregimeve popullore si aktualizim i fragmentarizuar i mitologjisë klasike me elementë që i shërbënin vlerave etike e estetike të kohës, por më shumë shërbenin si kode diakronike përcaktuese të sjelljes kolektive të komunitetit në kushte të caktuara.

Përfundime:

Prej këtyre fakteve mund të kuptohet lehtësisht lidhja e Orakullit të Dodonës dhe simbolit të tij, pemës, me konstitucionin shpirtëror dhe identitetin kulturor të banoreve të kësaj treve

Rasti i Orakullit të Dodonës vërteton përfeksionin e lartë të harmonisë në raportet që njeriu i kësaj treve ka vendosur diakronikisht me natyrën. Nga ana e vet harmonia e këtyre marrëdhënieve përcaktoi orientimin e kulturës së kësaj treve.

---

[13]Kadare,I. 2004, rev. Bota e Rrethuar ,13.04.2004.
[14]Çabej E, 1994), Shqipëtarët midis Perëndimit dhe Lindjes,Tiranë, fq.39.

I rëndësishëm mbetet fakti që sa më e fortë dhe më e qendrueshme është kjo marrëdhënie, aq më rezistent mbëtet identiteti kulturor i komunitetit-treves, mbartëse të tij, ndaj çdo lloj presioni të identetiteve të tjera të karakterit politik, etnik-kombëtar, apo shtetëror.

Kjo strukturë tradicionale organizimi shoqëror të qendrave urbane, pavarësisht nga zhvillimet aktuale, diakronia shekullore dhe kontradiktat që mbart, vazhdon t'i rezistojë kohës edhe në ditët tona.

Bibliografia:

Barka P., 2003, Llaografika, Shblu, Tiranë.

Barka P., 2016, Ta taksidhja tis Figou, v.I, Elikranon, Athinë.

Çabej E., 1994, Shqipëtarët midis Perëndimit dhe Lindjes,Tiranë.

Eder K., 1996, The social construction of nature, London.

Kadare I., 1980, Autobiografia e popullit në vargje, Tiranë.

KadareI., 2004, rev. Bota e Rrethuar,13.04.2004.

Kapsomenos E., 2002, Anazitontas to hameno evropaiko politismo, v.I, Pataki, Athinë.

Vernikos N, Daskallopullu S,1999, Stis aparhes tis neoellinikis idheollojias, kronika e Dropullit,Athinë.

Nitsiakos V.,1997, Llaografika eteroklita, Athinë.

Nıtsiakos V., 1991, Paradhosiakes kinonikes dhomes, Athinë.

Qiriazi P, Sala S., 2006, Monumentet e Natyrës Shqiptare, Tiranë.

Zeqo M., 2005, Gravura më e hershme e Skënderbeut Korrieri 26.08.2011.

Strauss L Cl., 1949, Les structurale élémentaires de la parenté, Paris.

Tzovara-Souli Hr., 1979, I latria tvn gynekion theotiton is tin arheon ipiron, punim doktorature, Un. Janinës.

KARAKTERISTIKAT E NJË MËSIMDHËNIEJE PRODUKTIVE

Zeqir Zeqirllari[1], Hristina Mallanezo[2]

[1]Student, Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës
zeqirzeqirllari18@gmail.com

[2]Departamenti Gjuhëve të Huaja, Universiteti "Eqrem Çabej
hristinamallanezo@gmail.com

Abstrakt
Për të plotësuar tablonë e një mësuesi të suksesshëm, është e nevojshme që të përshtaten disa karakteristika kryesore në klasë nga mësuesit. Midis shumë karakteristikave ndihmëse, më të rëndësishme janë përdorimi i ideve të nxënësit, strukturimi, arti i të pyeturit, shqyrtimi, ndikimi i mësuesit. Përdorimi i ideve dhe kontributeve është një sjellje e cila përmbledh marrjen në konsideratë, modifikimin, zbatimin, krahasimin dhe përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve në funksion të qëllimeve të mësimit dhe nxitjes së pjesëmarrjes së nxënësve në mësim. Komentet e mësuesit të bëra për qëllimin e organizimit të përmbajtjes që do të mësohet apo përmbledhje e asaj që është zhvilluar quhet strukturim. Strukturimi i përdorur para një veprimtarie apo situate i shërben përgatitjes për të nxënë dhe plotëson boshllëkun që ekziston midis asaj që nxënësi është në gjendje të bëjë vetë pa ndihmën e mësuesit dhe asaj për kryerjen e së cilës kërkohet ndihma e mësuesit. Studimet e ndryshme i kanë klasifikuar pyetjet në dy grupe, duke evidentuar pyetjet që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe ato që përmbajnë një proces.
***Fjalët çelës**: mësues, strukturim, arti i të pyeturit, ndikimi i mësuesit, nxënës.*

Abstract:
To achieve the image of a successful teacher, it's necessary to adapt some key characteristics and methods in the classroom. Among the many characteristics, the most important include using the students' ideas, structuring, the art of asking questions and the teacher's influence. The use of ideas and contributions is a behavior that summarizes the consideration, modification, comparison and summarization of the students' answers in function of the learning goals and encouraging student engaging in learning. Teacher comments made for the purpose of organizing the content to be learned or summarizing what has been taught is called structuring. The structuring used before an activity or situation serves the preparation to learn and fills the gap that exists between what the student is able to do on his own without the help of the teacher and what requires the help of the

teacher. Various studies have classified the questions into two groups, highlighting content-related questions and process-related questions.
***Key words**: teacher, structuring, the art of asking questions, a teacher's influence, students*

Vështrim teorik

Për të plotësuar tablonë e një mësuesi të suksesshëm është e nevojshme që të përshtaten disa karakteristika kryesore në klasë nga mësuesit. Midis shumë karakteristikave ndihmëse, këto janë më të rëndësishme:

-përdorimi i ideve të nxënësit;
-strukturimi;
-arti i të pyeturit;
-shqyrtimi;
-ndikimi i mësuesit.

Përdorimi i ideve dhe kontributeve është një sjellje e cila përmbledh marrjen në konsideratë, modifikimin, zbatimin, krahasimin dhe përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve në funksion të qëllimeve të mësimit dhe nxitjes së pjesëmarrjes së nxënësve në mësim.

Strukturimi. Komentet e mësuesit të bëra për qëllimin e organizimit të përmbajtjes që do të mësohet apo përmbledhje e asaj që është zhvilluar quhet strukturim. Strukturimi i përdorur para një veprimtarie apo situate, i shërben përgatitjes për të nxënë dhe plotëson boshllëkun që ekziston midis asaj që nxënësi është në gjendje të bëjë vetë pa ndihmën e mësuesit dhe asaj për kryerjen e së cilës kërkohet ndihma e mësuesit

Arti i të pyeturit. Të pyeturit është një sjellje ndihmëse e mësuesit. "Të pyesësh mirë do të thotë të japësh mirë mësim. Në përdorimin me zotësi të të pyeturit, më shumë se çdo gjë tjetër, qëndron arti i bukur i të mësuarit." [1] Studimet e ndryshme i kanë klasifikuar pyetjet në dy grupe, duke evidentuar pyetjet që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe ato që përmbajnë një proces.

Janë përcaktuar afërsisht mbi dhjetë karakteristika që tregojnë lidhjen midis rezultateve të dëshirueshme të nxënësve, të përcaktuara përmes testeve dhe instrumenteve të tjera të vlerësimit. Nga këto, pesë janë përcaktuar si karakteristika kryesore. Pesë të tjerat janë quajtur ndihmëse, por edhe ato, të lidhura në mënyrë logjike me mësimdhënien produktive. Pesë të parat do t'i quajmë kryesore, pasi me të vërtetë janë konsideruar të tilla dhe të dytat do t'i quajmë ndihmëse.

Pesë karakteristikat kryesore janë:

-qartësia në mësimdhënie;
-llojshmëria në mësimdhënie;
-orientimi në detyrë;
-përfshirja në procesin e të nxënit;
-shkalla e suksesit të nxënësve.

Qartësia ne mësimdhënie.

Kjo karakteristikë kryesore ka të bëjë me qartësinë e paraqitjes së mësimit në klasë, e treguar përmes karakteristikave të mëposhtme të

mësuesit të suksesshëm. Ata, mësuesit, i paraqesin dhe i bëjnë çështjet mësimore të kuptueshme. Përshkruajnë dhe u shpjegojnë qartë konceptet nxënësve dhe janë në gjendje të ndjekin një linjë logjike të rregullt, hap pas hapi. Të folurit e tyre është i qartë, i pranueshëm për nxënësit dhe i çliruar nga fjalët e panevojshme e të pakuptimta.
Sjelljet e mësuesit varen, në mënyrë të konsiderueshme, nga qartësia. Jo të gjithë mësuesit janë në gjendje të komunikojnë qartë dhe drejtpërdrejt me nxënësit e tyre, pa shmangur mëdyshjet, kapërcimin përtej nivelit të të kuptuarit të nxënësve etj.
Qartësia është një sjellje komplekse e mësuesit dhe është e lidhur me të ashtuquajturat sjellje kognitive, si organizimi i përmbajtjes, familjarizimi me përmbajtjen dhe mënyrat e mësimdhënies. Por që të dyja, qartësia kognitive dhe ajo gojore e paraqitjes, ndryshojnë shumë nga një mësues te një tjetër.
Llojshmëria në mësimdhënie.
Kjo sjellje kryesore ka të bëjë me llojshmërinë apo mënyrën e dhënies së mësimit. Një nga mënyrat më të efektshme të krijimit të llojshmërisë në mësimdhënie është të pyeturit. Në mësim mund të bëhen pyetje të shumta dhe kur ato integrohen natyrshëm, krijojnë një variacion të këndshëm dhe të kuptueshëm. Kështu, mësuesit e suksesshëm e kanë të nevojshme të zotërojnë artin e të pyeturit, procesin e pyetjeve, pyetjet konvergjente dhe divergjente.
Orientimi në detyrë.
Orientimi në detyrë është një element tjetër kryesor që ka të bëjë shumë me kohën që i kushtojnë mësuesit detyrës për mësimdhënien e temës apo të çështjeve të reja të mësimit. Sa më shumë kohë t'i kushtohet detyrës për mësimdhënien e një teme të caktuar, aq më shumë mundësi do të kenë nxënësit për të nxënë. Një pyetje e mundshme, e lidhur me orientimin e detyrës mund të jetë: sa kohë më duhet për përdorimin e metodave për dhënien e mësimit të ri? Pyetje të tilla janë të lidhura me materialet që paraqiten, mësohen dhe vlerësohen dhe po ashtu të lidhura me kohën tjetër të nevojshme për çështje proceduriale dhe organizative. Të gjithë mësuesit duhet t'i përgatisin nxënësit për të nxënë dhe për më tepër ky proces t'u japë edhe kënaqësi atyre.
Një tjetër aspekt i llojshmërisë në mësimdhënie, ndoshta edhe më i rëndësishmi, është *përdorimi i materialeve për të nxënët*, i pajisjeve, vendosja e punimeve të nxënësve në mure apo rafte, përdorimi i mirë dhe me kujdes i hapësirës në klasë. Mjedisi fizik dhe pamja e klasës ndihmojnë në llojshmërinë e mësimdhënies. Kjo ndikon, më pas, në rezultatet e nxënësve, përfshirjen e tyre në procesin e të nxënit etj.

2. Struktura e një ore mësimore

Të mishëruara të gjitha këto karakteristika në një prej fazave në të cilat kalojnë nxënësit gjatë procesit të të nxënit (PNP)[1], përgjatë zbatimit të metodave mësimore në mësimdhënien me në qendër nxënësin, në lëndën e gjuhës dhe, pikërisht, për strukturën mësimore të temës *"Fjala*

dhe pjesët përbërëse të saj", po e paraqesim në formë tabele (vijon në faqen tjetër):
(PNP) Parashikim/ Ndërtimi i njohurive/ Përforcim-është një prej stadeve psiko-pedagogjike në të cilat kalojnë nxënësit gjatë procesit të të nxënit.

Fusha: Gjuha e komunikimi	**Lënda: Gjuhë shqipe**	**Shkalla: IV**	**Klasa: VIII**
Rubrika: Njohuri gjuhësore në fjalëformim **Tema mësimore:** Fjala dhe pjesët përbërëse të saj		**Situata e të nxënit:** Lojë: "Dhe në gjuhë përdoren pluset" Nxënësit zbërthejnë fjalët e dhëna: Zbukurojmë Fluturoj Përmirësoj Shkollar etj. Z+bukur+O+jmë Kështu veprojmë dhe me fjalët e tjera	
Rezultatet e të nxënit sipas kompentencave kyçe - Kompentenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompentenca e të menduarit. - Kompentenca personale. - Kompentenca qytetare.			
Rezultatet e të nxënit të kompentencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • Dallon përbërësit e fjalës rrënjë, temë, mbaresë, parashtesë dhe prapashtesë. • Identifikon lehtësisht pjesët përbërëse të secilës fjalë të paragrafit të parë të pjesës me titull: "I forti", por jo vetëm.		Fjalët kyçe: Përbërësit e fjalës Rrënjë Temë Mbaresë Prapashtesë, Parashtesë	
Burimet: Teksti mësimor		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** letërsi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: DDM, stuhi mendimi, punë dyshe, shkrim i lirë.
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: DDM

Di	***Dua të di***	***Mësova***
Fjalët e prejardhura dhe të përbëra ndahen në pjesë.		
Njësia më e vogël kuptimore është morfema.		
Parashtesat dhe prapashtesat janë morfema fjalëformuese, ndërsa mbaresat janë morfema tratëformuese.		

Ndërtimi i njohurive të reja: DDM
Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet, për të plotësuar përgjigjet e pyetjeve të bëra prej tyre.

Di	***Dua të di***	***Mësova***
Fjalët e prejardhura dhe të përbëra ndahen në pjesë.	Çfarë tregojnë morfemat fjalëformuese? Po ato trajtëformuese?	Mbaresa quhen ato morfema trajtëformuese që qëndrojnë në fund të fjalës. Ato tregojnë kuptimet gramatikore të fjalës: gjininë, numrin, rasën dhe trajtën tek emri; gjininë dhe numrin te mbiemri; kohën mënyrën dhe vetën te folja
Njësia më e vogël kuptimore është morfema.	Nëse do të hiqni morfemat trajtëformuese të fjalës *alpinistët,* cila është pjesa që mbetet?	Tema e fjalës është pjesa e fjalës që mbetet, pasi asaj i hiqen të gjitha morfemat trajtëformuese. Kështu tema e fjalës *malin* është *mal* (pa -*in* që është morfemë trajtëformuese e rasës kallëzore në trajtë të shquar.)
Parashtesat dhe prapashtesat janë morfema fjalëformuese, ndërsa mbaresat janë morfema trajtëformuese.	A mund të ndahet fjala *gur*? Po *gurore*? Pse?	Rrënja e fjalës Rrënja është pjesa e fjalës që mbetet, pasi i hiqen të gjitha morfemat ndajshtesore (parashtesa, prapashtesa, mbaresa, nyje). Rrënja është bartësja e kuptimit themelor leksikor të fjalës.

Tabela plotësohet nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi/ja ndërhyn vetëm në rastet kur ka paqartësi. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: shkrim i lirë, punë dyshe.**

1. Nënvizoni mbaresat e fjalëve të mëposhtme. Për secilën fjalë gjeni temën dhe rrënjën e saj: *shkoj, duroj, lotët, përkulte, degët, përkëdheli, flokët, vështrimi, vajzat, luanin, vrapoj, shkeli, gishtat, endacakët, lulishtare, brohoritje, shkop, bashkëmoshatarët, mbishkruanin.*

Fjala	Rrënja	Tema	Mbaresa
vrapoi	*vrap*	*vrapo*	*i*
shkeli	*shkel*	*shkel*	*i*
vajzat	*vajz(ë)*	*vajz(ë)*	*at*

2. Identifikoni pjesët prëbërëse të secilës fjalë të paragrafit të parë të pjesës me titull"I forti".

3. Gjeni në fjalët me shkronja të zeza mbaresat, temën, parashtesat, prapashtesat dhe rrënjën. *Aeroplani merr **lartësinë** me shpejtësi. Zemra më rreh me forcë. Përpara meje një mori **instrumentesh**.*

*Disa lëvizin si të gjalla, disa **vështrojnë** të palëvizshme numrat, **shigjetat** dhe akrepat e tyre. Ja, me këto instrumente piloti bën **vazhdimisht** një dialog të gjatë, këtu, lart në qiell. **Gjuha** e tyre është e saktë, e përpiktë. Mos u beso **syve**, thonë **ata**, kur përreth është errësirë, na beso neve, tani je në këtë lartësi. Po mua, më duket se jam më ulët? Jo, të **gënjejnë dritat** e tokës. Më duket sikur **motori** po pakëson xhirot. S'është e vërtetë. Të gënjejnë veshët. Motori punon në rregull. Instrumentet luftojnë vazhdimisht me **iluzionet** që mund t'i **lindin** pilotit në fluturim, sidomos në **fluturimet** e natës. Piloti duhet t'u besojë gjithmonë instrumenteve. Kur humbet **besimin** në to, atëherë rrezikun e ke mbi kokë, ai fluturon bashkë me ty.*

Fjala	Tema	Parashtesa	Prapashtesa	Rrënja	Mbaresa
lartësinë	*Lartësi*	---	*ë/si*	*lart*	*në*
instrumentesh	*instrument*	---	---	*instrument*	*(e)sh*
vështrojnë	*Vështro*	---			*jnë*
gjuha	*Gjuhë*	---	---	*gjuhë*	*a*
syve	*Sy*	---	---	*sy*	*ve*
ata	*Ata*	---	---	*ata*	
beso	*bes(ë)*	---	*o*	*bes(ë)*	
shigjetat	*shigjet(ë)*	---	---	*shigjet(ë)*	*at*
vazhdimisht	*Vazhdimish*	---	*im/ isht*	*vazhd(o)*	
dritat	*drit(ë)*	---		*drit(ë)*	*at*
motori	*motor*	---		*motor*	*i*
besimin	*besim*	---	*im*	*bes(ë)*	*in*
fluturimet	*fluturim*	---	*im*	*flutur*	*(e)t*
lindin	*lind*	---	---	*lind*	*in*

Gjeni parashtesat në fjalët e grupit të parë dhe prapashtesat në ato të grupit të dytë.

Fjala	Parashtesa	Fjala	Prapashtesa
përmbledh	*për-*	*urdhëroj*	*-o*
nënkryetar	*nën-*	*tregtar*	*-tar*
zbardh	*z-*	*vendos*	*-os*
skuq	*s-*	*traktorist*	*-ist*
i paplotë	*Pa-*	*lumturi*	*-i*
rindërtoj	*ri-*	*hyrje*	*-je*
mbingarkoj	*mbi-*	*shtëpizë*	*-zë*

Formo fjalë të reja me temat e dhëna, përdori ato në një tekst dhe më pas bëj analizën e tyre: dorë, gjumë, udhë, zemër, besë, vend, luftë.
Nxënësit punojnë dhe më pas lexojnë punët e tyre duke i vlerësuar.
Vlerësimi: *Vlerësohen nxënësit për dallimin e saktë të përbërësve të fjalës, rrënjës, temës, mbaresës etj.*
Për të transmetuar njohuritë për të zhvilluar aftësitë, për të kultivuar vlerat dhe qëndrimet e nxënësve, gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e gjuhës, përdoren një numër i madh teknikash dhe metodash në bashkëpunim me nxënësit, të cilat janë procedura standarde që përdoren për paraqitjen dhe për zhvillimin e veprimtarive mësimore, për të arritur qëllimet dhe objektivat mësimore të kësaj lënde.

Referenca

Sadker, Myra&David, *Mësuesit, shkollat dhe shoqëria,*T. Eureka, 1995, f. 33.

Myrtaj, L., Pema, E., *Gjuha shqipe: libër për mësuesin,* T., Pegi, 2017.

Myrtaj, L., Pema, E., *Gjuha shqipe: libër për mësuesin,* T., Pegi, 2017.

Musai, Bardhyl, *Metodologji e mësimdhënies,* T., Pegi, 2003.

Gjokutaj, Mimoza, *Didaktika e gjuhës shqipe*, T., SHBLU, 2009.

HAPJA TREGTARE DHE RRITJA EKONOMIKE: ANALIZË E SERIVE KOHORE PËR SHQIPËRINË

Arjola Mitaj
Departamenti i Administrimit Publik, Universiteti "Eqrem Çabej"
a_mitaj@uogj.edu.al

Abstrakt

Bota është bërë gjithnjë e më shumë e integruar përsa i përket tregtisë dhe financave që prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, si rezultat i kostove më të ulëta të transportit dhe komunikimit, dhe barrierave kufizuese në rënie. Sipas statistikave të OBT-së, vlera e eksporteve të mallrave botërore u rrit nga 2.03 trilion dollarë në 1980 në 18.26 trilion dollarë në vitin 2011, e cila është e barabartë me 7.3 përqind rritje vjetore mesatare në terma të dollarit aktual. Ndërsa në terma të volumit tregtar (duke marrë parasysh ndryshimet e çmimeve dhe normat e këmbimit), tregtia e mallrave në botë më shumë se u katërfishua gjatë 1980-2011. Rezultatet e shpjegimit të rritjes ekonomike të Shqipërisë nga variabla që masin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo liberalizimin tregtar, janë arritur përmes përdorimit të modeleve njëfaktoriale. Në lidhje me shpjegimin e rritjes ekonomike të Shqipërisë nga volumi i tregtisë mund të thuhet se u provua një lidhje pozitive dhe deri diku e kënaqshme, duke qenë se rreth 24.7% e PBB-së së Shqipërisë i dedikohet ndryshimeve në volumin tregtar në kushtet kur faktorë të tjerë janë jashtë analizës.

***Fjalët çelës**: hapje tregtare, rritje ekonomike, Shqipëri, GDP, volumi tregtar*

Abstract

The world has become increasingly integrated in terms of trade and finance since the end of World War II, as a result of lower transportation and communication costs, and declining barriers. According to WTO statistics, the value of world commodity exports increased from $ 2.03 trillion in 1980 to $ 18.26 trillion in 2011 which equates to an average annual growth of 7.3 percent in current dollar terms. While in terms of trade volume (taking into account price changes and exchange rates), world commodity trade more than quadrupled during 1980-2011. Many factors have contributed to this tremendous expansion of trade, but it is undeniable that this coincided with a significant reduction of trade barriers. The results of Albania's economic growth explanation by the variable that directly or indirectly measures trade liberalization have been achieved through the use of one-factor models. Regarding the explanation of Albania's economic growth by trade volume, it can be said that a positive and somewhat satisfactory relationship was proven, given that about 24.7% of Albania's GDP is dedicated to changes in trade volume in conditions when other factors are out of analysis.

***Key words**: trade opening, economic growth, Albania, GDP, trade volume*

1. Hyrje

Që prej fillimit të reformave ekonomike liberale dhe adoptimit të politikës së dyerve të hapura me fillesë në vitin 1992, tregtia e jashtme e Shqipërisë ka përjetuar një rritje të konsiderueshme shoqëruar me ndryshime të ndjeshme në strukturën e saj. Po ashtu edhe rritja ekonomike e vendit tonë, e identifikuar me ndryshimin vjetor në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto, ka qenë pozitive që prej këtij viti. Sigurisht që në ekuacionin e rritjes së një vendi bëjnë pjesë shumë variabla, përveç liberalizimit tregtar dhe ky i fundit nuk mjafton për të shpjeguar i vetëm rritjen ekonomike. Në literaturën e tregtisë ndërkombëtare theksi vihet tek eksportet; rritja e tyre konsiderohet si një prej kontribuesve kryesorë për një performancë ekonomike pozitive të një vendi. Problemi në rastin e Shqipërisë shtrohet ndryshe po të kemi parasysh faktin se përgjatë 25 viteve të fundit balanca tregtare e Shqipërisë ka qenë negative, sepse importet tejkalojnë eksportet disa herë, duke qenë se vendi jonë ka një bazë eksporti shumë të vogël dhe një shportë eksportesh pak të diversifikuar. Prandaj një vëmendje e veçantë në këtë analizë i kushtohet importit të mallrave kapitale dhe mallrave të ndërmjetëm, sepse këto të fundit janë të lidhura me investimet e kryera në vend dhe për pasojë edhe me rritjen ekonomike. Importi i kësaj kategorie produktesh ka stimuluar ose nxitur edhe zhvillimin e kapitalit human, nëpërmjet *learning by doing* apo *learning through exporting*, si një nevojë dhe gjithashtu për të bërë të mundur operimin dhe menaxhimin e kapaciteteve të reja prodhuese-shërbyese të ndërtuara në vend me mjete ose lëndë të para të importuara.

Sipas teorive të tregtisë ndërkombëtare, nga Modelet e Rikardos dhe Hecksher-Ohlin dihet se vendet janë me mirë me tregti të lirë sesa në *autarki*. Në sajë të regjimeve tregtare liberale vendet rialokojnë burimet për të prodhuar mallra për të cilat ata zotërojnë një avantazh krahasues dhe importojnë mallra të cilat janë më të lira se sa mund të prodhohen në vend. Teorema H-O thekson se ajo që ka rëndësi nuk është sasia e faktorëve të zotëruar, por raporti ndërmjet kapitalit dhe punës. Në këtë kuptim, një vend specializohet në prodhimin e atyre produkteve që kërkojnë për t'u prodhuar faktorin që vendi zotëron me shumicë. Këto parashikime janë të rëndësishme në rastin e Shqipërisë, sepse ne duam të përcaktojmë nëse liberalizimi ka stimuluar prodhimin e atyre produkteve të eksportit në të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues duke rritur kështu prodhimin e brendshëm bruto. Për këtë arsye, pritet një marrëdhënie pozitive midis rritjes së PBB-së dhe eksporteve e tregtisë totale.

Por të bazohesh vetëm tek eksportet apo tregtia për të identifikuar masën me të cilën Shqipëria është e integruar në tregjet ndërkombëtare, për të parë sesi kjo ndikon pastaj në rritjen ekonomike të saj, është e pamjaftueshme.

Kjo është arsyeja që ky punim përfshin dy kategori indikatorësh për matjen e liberalizimit tregtar. E para përfshin ata indikatorë që kanë lidhje me flukset

tregtare. Klasifikimi i dytë përfshin indikatorë që në mënyrë të drejtpërdrejtë matin nivelin e kufizimeve tregtare. Kështu, tregues apo indekse në lidhje me barrierat tarifore, jotarifore apo indekse të përbërë nga një ndërthurje e të dy treguesve, reflektojnë shkallën me të cilën kufizimet e politikës tregtare pengojnë apo ndihmojnë integrimin tregtar dhe benefitet që vijnë prej tij.

Grafiku nr. 1 paraqet ecurinë e Produktit të Brendshëm Bruto, eksporteve dhe importeve në %.

Grafik 1: Rritja vjetore në % e eksporteve, importeve dhe PBB-së, 1991-2014



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e Bankës Botërore.

Ajo çfarë mund të dallohet është se rritja e PBB-së ka qenë e qëndrueshme, por normat e rritjes pas vitit 2009 duket se janë vështirë të shkojnë në nivelin e parakrizës. Ndërkohë që përgjatë 1991-2014, eksportet sikundër dhe importet shënojnë rritjen më të lartë të tyre, në vitin 1993. Kjo si rrjedhojë e politikës liberalizuese të tregtisë së jashtme shoqëruar edhe me liberalizimin e çmimeve që zuri fill në vitin 1992. Është evështirë të dalloshnjë model tëndikimit të rritjes së PBB-sëngaeksportet. Kjo ngrenjëdyshim në lidhjeme rëndësinë eeksporteve nëzhvillimin ekonomik tëShqipërisë apo e thënë ndryshe: eksportetkanë qenëshumë të kufizuara nëndikimin e tyre nërritjen ekonomikenë Shqipërinë periudhën afatgjatë.

2. Kuadri analitik dhe metodologjia

Në këtë punim përdoret analiza ekonometrike për të provuar ose edhe për të matur efektet e hapjes tregtare në rritjen ekonomike. Modelet ekonometrike njefaktoriale do të përdoren edhe për të analizuar raportet shkakësore (shkak-pasojë) midis hapjes tregtare dhe rritjes ekonomike. Analiza e thjeshtë e regresionit që trajton varësinë e një variabli nga një apo më shumë variabla të tjerë shpjegues, nuk provon ekzistencën e shkakësisë apo më saktë drejtimin e ndikimit. Në ekonomi nëse një ngjarje A ndodh përpara ngjarjes B, atëherë ekziston mundësia që A-ja të shkaktojë ndodhjen e B-së.

Pra,me fjalë të tjera, ngjarjet e së kaluarës mund të shkaktojnë ndodhjen e ngjarjeve në të tashmen. Të dhënat në formën e serive kohore në lidhje me variablat e mësipërm do të bëjnë të mundur aplikimin e testit *GRANGER* të shkakësisë dhe përdorimi i analizës VAR- vektori autoregresiv për të parë drejtimin e shkakësisë midis hapjes dhe rritjes.

Literatura që merret me studimin e lidhjes midis liberalizimit tregtar dhe rritjes ekonomike është e pasur, por mbetet ende e pazgjidhur çështja nëse është liberalizimi që i paraprin rritjes apo e anasjella. Për këtë arsye testi i shkakësisë Granger është përdorur në këtë studim si një mjet suplementar për të parë natyrën e drejtimit të lidhjes liberalizim-rritje, nëse ekziston një e tillë. Kjo teknikë nuk nënkupton një matës të saktë të shkakësisë, por një vëzhgim për të parë nëse të dhënat e viteve të kaluara të variableve të pavarur x, ndihmojnë apo përmirësojnë parashikimin e y-nit. Në gjuhën statistikore, kjo teknikë synon të matë nëse përfshirja e informacionit të kaluar në lidhje me x-in redukton gabimin mesatar kuadratik të ekuacionit. Bazuar te Richards (2001), ekuacioni i Grangerit ka trajtën e mëposhtme:

$$PBB_t = a + \sum_{i=1}^{M} \alpha_i PBB_{t-i} + \sum_{i=1}^{N} \beta_i EX_{t-i} + \mu_t \qquad (1)$$

$$EX_t = b + \sum_{i=1}^{K} \gamma_i EX_{t-i} + \sum_{i=1}^{L} \lambda_i PBB_{t-1} + \mu_t \qquad (2)$$

Ku PBB-ja tregon rritjen ekonomike, e matur në mënyrë alternative nga norma e rritjes së PBB-së dhe norma e rritjes së PBB-së për frymë; dhe EX-i tregon eksportet, të matura sipas rastit nga eksportet apo volumi tregtar.

Përveç indikatorëve tradicionalë të tillë si raporti i eksportit/PBB-ja, importit/PBB-së dhe indeksit të hapjes tregtare, i matur si raport i volumit tregtar me PBB-në e vendit, një vëmendje i kushtohet importit të mallrave kapitale dhe importit të makinerive dhe mjeteve të transportit si pjesë e mallrave kapitale. Praktikisht, mekanizmi më bindës që lidh tregtinë me rritjen ekonomike në vendet në zhvillim, është importi i kësaj kategorie mallrash, duke qenë se mund të importohen më lirë sesa mund të prodhohen në vend, sepse vendet në zhvillim janë punë-intensive dhe të kufizuar në burimet kapitale. Ky konstatim është i vlefshëm edhe për Shqipërinë. Për vendin tonë ekspozimi më i lartë ndaj tregtisë ndërkombëtare është rezultat më tepër i importeve. Një pjesë e konsiderueshme e tyre përbëhet nga importi i mallrave kapitale, një mënyrë kjo për të siguruar stokun e munguar të kapitalit. Së fundmi, në listën e variableve potenciale të matjes së liberalizimit tregtar në Shqipëri shtojmë disa indekse të llogaritura nga organizata ndërkombëtare të tilla si Heritage Foundation, e cili publikon një Indeks të Lirisë Tregtare si edhe Indeksi i Liberalizimit të Çmimeve, Indeksi i Këmbimit Valutor dhe Tregtar publikuar nga Banka Europiane për Rikonstruksion dhe Zhvillim.

3. Analiza empirike dhe rezultatet

Modeli i regresionit në këtë analizë ka formën e mëposhtme:

$Y_{t=}\beta_0+\beta_1 X_t$ (3)

Ku me Y_t është identifikuar sipas rastit PBB-ja në milion dollarë, rritja vjetore e PBB-së në %, PBB-ja për frymë apo rritja vjetore e PBB-së/frymë dhe me X_t secili prej variableve përfaqësues të liberalizimit tregtar të shpjeguar më lart.

Në vijim jepen rezultatet e gjeneruara nga programi Eviews dhe Gretl për modelimin e rritjes ekonomike të Shqipërisë në varësi të volumit tregtar, importit të mallrave kapitale, importit të makinerive dhe mjeteve të transportit dhe indeksit të hapjes tregtare. Rezultatet janë arritur bazuar në modelet e formës logaritmike të cilat shprehin masën e ndryshimit në % të variablit të varur (rritjes ekonomike në këtë rast), për 1% ndryshim të variablit të pavarur. Siç vihet re, volumi tregtar dhe, në veçanti, importi i mallrave kapitale dhe importi i makinerive dhe mjeteve të transportit kanë rezultuar të rëndësishëm. Bazuar në rezultatet e gjeneruara nga programi, ndërtojmë modelet njëfaktoriale si më poshtë:

$Log(D(Y1)) = 8.656 + 0.224*Log(D(X1))$ (4)

$Log(D(Y1)) = 6.16 + 0.43*Log(D(X3))$ (5)

$Log(D(Y1)) = 6.22 + 0.42*Log(D(X2))$ (6)

Modeli 1: PBB në varësi të volumit tregtar, forma logaritmike

Dependent Variable: LOG(D(Y1))				
Method: Least Squares				
Sample(adjusted): 1992 2014				
Included observations: 18				
Excluded observations: 3 after adjusting endpoints				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	8.656954	0.882336	9.811400	0.0000
LOG(D(X1))	0.223981	0.084453	2.652143	0.0174
R-squared	0.305370	Mean dependent var		10.98350
Adjusted R-squared	0.261956	S.D. dependent var		0.468059
S.E. of regression	0.402107	Akaike info criterion		1.120244
Sum squared resid	2.587046	Schwarz criterion		1.219174
Log likelihood	-8.082197	F-statistic		7.033862
Durbin-Watson stat	2.315892	Prob(F-statistic)		0.017393

Modeli 2: PBB-ja në varësi të importit të mallrave kapitale, forma logaritmike

Dependent Variable: LOG(D(Y1))				
Method: Least Squares				
Sample(adjusted): 1998 2013				
Included observations: 10				
Excluded observations: 5 after adjusting endpoints				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	6.162255	1.224899	5.030825	0.0010
LOG(D(X3))	0.432898	0.109562	3.951151	0.0042
R-squared	0.661183	Mean dependent var		10.98786
Adjusted R-squared	0.618831	S.D. dependent var		0.479606

S.E. of regression	0.296103	Akaike info criterion	0.580639
Sum squared resid	0.701417	Schwarz criterion	0.641156
Log likelihood	-0.903194	F-statistic	15.61159
Durbin-Watson stat	2.036887	Prob(F-statistic)	0.004229

Modeli 3: PBB-ja në varësi të importit të makinerive dhe mjeteve të transportit, forma logaritmike

Dependent Variable: LOG(D(Y1))				
Method: Least Squares				
Sample(adjusted): 1995 2013				
Included observations: 11				
Excluded observations: 6 after adjusting endpoints				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	6.220247	1.482585	4.195542	0.0023
LOG(D(X2))	0.424973	0.130013	3.268703	0.0097
R-squared	0.542786	Mean dependent var		11.05341
Adjusted R-squared	0.491984	S.D. dependent var		0.504275
S.E. of regression	0.359423	Akaike info criterion		0.954332
Sum squared resid	1.162664	Schwarz criterion		1.026677
Log likelihood	-3.248827	F-statistic		10.68442
Durbin-Watson stat	0.738618	Prob(F-statistic)		0.009703

Sipas ekuacioneve të mësipërme, rezulton se, nëse volumi tregtar rritet me 1%, PBB-ja pritet të shtohet me 0.22% (po ashtu edhe PBB-ja/frymë). Nëse importi i mallrave kapitale rritet me 1%, PBB-ja pritet të shtohet me 0.43% (PBB-ja/frymë pritet të shtohet me 0.44%). Dhe së fundmi, nëse importi i makinerive dhe mjeteve të transportit rritet me 1%, PBB-ja pritet të shtohet me 0.42% (PBB-ja/frymë me 0.43%).

Midis 2 variableve të përdorur si tregues të akumulimit të kapitalit, ai i Formimit të Kapitalit Fiks Bruto rezultoi i parëndësishëm. Së fundmi, në objektivin e studimit ishte verifikimi i drejtimit të lidhjes liberalizim-rritje ekonomike, pra, nëse eksportet apo tregtia apo ndonjë variabël tjetër i lidhur me liberalizimin, i paraprin rritjes ekonomike në Shqipëri apo është e anasjella. Prandaj ndërtojmë modele që japin mundësi të testohen efektet shtesë të disa vlerave të kaluara të variableve të liberalizimit, pasi janë përfshirë edhe vlerat e kaluara që identifikojnë rritjen ekonomike në Shqipëri. Për të testuar këtë përdorim metodën autoregressive për PBB-së dhe PBB-ja/frymë me eksportet dhe tregtinë. Sipas rastit, hipoteza zero do të ishte:

H0: Eksportet nuk shkaktojnë Granger PBB; tregtia nuk shkakton Granger PBB; tregtia nuk shkakton Granger PBB/frymë.

Tabelat në vazhdim tregojnë rezultatet në lidhje me testin e shkakësisë Granger. Theksojmë se variablet e varura dhe të pavarura janë regresuar me vonesë kohore. 2. Janë bërë teste edhe duke përdorur vlerën e diferencës nga njëri vit në vitin tjetër të variablit të varur dhe atij të pavarur, edhe vlerat vjetore të tyre.

Modeli 4: Testi Granger midis PBB-së dhe tregtisë totale

Pairwise Granger Causality Tests			
Sample: 1994 2014			
Lags: 2			
Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Probability
D(X1) does not Granger Cause D(Y1)	19	1.13960	0.34791
D(Y1) does not Granger Cause D(X1)		1.18231	0.33539

Modeli 5: Testi Granger midis PBB-së/frymë dhe tregtisë totale

Pairwise Granger Causality Tests			
Sample: 1994 2014			
Lags: 2			
Null Hypothesis:	Obs	F-Statistic	Probability
D(X1) does not Granger Cause D(Y3)	19	1.06229	0.37194
D(Y3) does not Granger Cause D(X1)		2.08914	0.16070

Këto rezultate tregojnë se nuk mund të refuzojmë asnjërën nga hipotezat 0 të ngritura më lart. Kjo do të thotë se nuk provohet asnjë evidencë në lidhje me volumin tregtar dhe PBB-në apo PBB/frymë si në rastin kur marrim në konsideratë diferencat vjetore ashtu dhe vlerat vjetore të tyre. Në përfundim do të thonim se PBB-ja ose shtesa e PBB-së në vitet e ardhshme nuk mund të parashikohet nga PBB-ja ose shtesa e PBB-së dhe e volumit tregtar dhe as nga shtesa e volumit tregtar në vitet e shkuara.

4. Përfundime

Ky punim kishte si objektiv kryesor të tij matjen e impaktit që liberalizimi tregtar ka mbi rritjen ekonomike në Shqipëri. Për këtë, gjatë analizës u përdorën disa tregues potencialë të liberalizimit tregtar duke qenë se nuk ka një tregues të vetëm që të konsiderohet si matësi më i mirë i këtij të fundit. Në lidhje me shpjegimin e rritjes ekonomike së Shqipërisë nga volumi i tregtisë mund të themi se u provua një lidhje pozitive dhe deri diku e kënaqshme, duke qenë se rreth 24.7% e PBB-së së Shqipërisë i dedikohet ndryshimeve në volumin tregtar në kushtet kur faktorë të tjerë janë jashtë analizës. Ashtu siç nuk pritej, indeksi i hapjes tregtare rezultoi i parëndësishëm në shpjegimin e PBB-së apo PBB/frymë.

5. Referenca

ACIT Trade Report 2014

ACIT Trade Report 2002

Baldwin, Richard E. (1994). Towards an integrated Europe. Graduate Institute of International Studies.

Baldwin. E. R. and Seghezza. E. (1998). Regional Integration and Growth in Developing Nations. Journal of Economic Integration 13(3), pages 367-399.

Barro, J. R. (1991). Economic Growth in a Cross Section of Countries. The Quarterly Journal of Economics, Vol. 106, No. 2, pages 407-443

Bank of Albania, November 2010. Economic Policies in SEE: Design, Performance and Challenges.

Bhagwati, J.N. 1991. The World Trading System at Risk, Harvester Wheatsheaf, Hemel Hempstead.

Blomstrom, M., Kokko, A. (1997). The Impact of Foreign Investment on Host Countries: A Review of the Empirical Evidence. RePEc

Chang, R.; Kaltani, L.; Loayza, V.N. (2009). Openness can be good for growth: The role of Policy Complementarities. Journal of Development Economics 90, 33-49.

Damijan, J.; de Sousa, J.; Lamotte, O. (2006). The effect of trade liberalization in South-Eastern European countries. The wiiw Balkan Observatory, Working Papers 070

Dean, M. J.; Desai, S. and Riedel, J. (1994). Trade Policy Reform in Developing Countries since 1985. World Bank Discussion Papers 267

Deardorff, V. A. (1980). The General Validity of the Law of Comparative Advantage. The Journal of Political Economy, Vol. 88, No. 5. Pages 941-957.

Helpman, E. (1987). Imperfect Competition and International Trade: Evidence from Fourteen

Industrial Countries. Journal of the Japanese and International Economies 1(1): 62-81.

Helpman, E. and Krugman, P. R. (1985), Market Structure and Foreign Trade: Increasing Returns, Imperfect Competition, and the International Economy,Cambridge: MIT Press

Kaminski, B (1999). The EU factor in the Trade Policies of Central European Countries. World Bank, Policy Research Paper 2239

Kaminski, B, and de la Rocha, M. (2001). Policy-Induced Integration in Balkans: Policy Options and their Assessment", World Bank

Krugman, Paul, 1991, "The Move toward Free Trade Zones," in Policy Implications of Trade and Currency Zones: A Symposium Sponsored by the Federal Reserve Bank of Kansas City (KansasCity: Federal Reserve Bank of Kansas City) 5-25.

Linder, S. B. (1961), An Essay on Trade and Transformation. New York: John Wiley and Sons.

Linnemann, H. (1966). An econometric study of international trade flows. Amsterdam: North-Holland Pub. Co.

Lee J.W. (1994), Capital goods import and long-run growth, NBER Working Paper, No 4725

Michalopolous Constantine, "The Western Balkans in the World Trade – An Essay in Memoriam of Bela Balasa", World Banks 2001

Osmani, M. (2013). Metodat e ekonometrisë, me Eviews.

Romalis, J. (2004), "Factor proportions and the structure of commodity trade," American Economic Review 94(1): 67-97.

Sachs, J. and Warner, A. (1995). Economic Reform and the Process of Global Integration. Brookings Papers on Economic Activity No.1.

WIDER (1991), Economic Liberalization: No Panacea. The Experiences of Latin America and Asia, Edited by Tariq Banuri

Wolf, C.H., (1994). Trade Orientation Measurement and Consequences. Working Paper, New York University

KORELACION MIDIS TE DHËNAVE EPIDEMIOLOGJIKE DHE KLINIKE I RASTEVE ME BRUCELOZË NË QARKUN E GJIROKASTRËS GJATË PERIUDHËS 2017-2019.

Dritan Rami[1], Arjan Harxhi[2], Pëllumb Pipero[3]
[1]Departamenti i Infermierisë, Universiteti "Eqrem Çabej"
ramidritan@gmail.com
[2]Mjek infeksionist, QSUT "Nënë Tereza" Tiranë
haxhiarjan@yahoo.com
[3] Mjek infeksionist, QSUT "Nënë Tereza" Tiranë
piperop@gmail.com

Abstrakt
Sëmundja e brucelozës në bazë të studimeve të bëra rezulton të jetë e përhapur kudo në zonën e Mesdheut, por edhe në botë pavarësisht diferencave numerike midis vendeve të pazhvilluara dhe atyre të zhvilluara. Meqenëse Shqipëria është pjesë e Ballkanit që njihet si një nga zonat me përhapjen më të gjerë të kësaj sëmundjeje, studimet kanë qenë të vazhdueshme si në aspektin epidemiologjik dhe në atë klinik. Duke marrë për bazë faktorët klimaterikë, kushtet sociale dhe zhvillimin ekonomik, qarku i Gjirokastrës ngelet një ndër qarqet me numrin më të lartë të individëve të prekur nga sëmundja e brucelozës. Kjo bën që studimi të jetë periodik dhe të përfshijë aspekte të ndryshme, siç është shtrirja gjeografike, periudha kohore, ndarja sipas grupmoshave dhe seksit, shkalla e hospitalizimit të këtyre pacientëve si dhe shfaqja e ndërlikimeve të sëmundjes. Konfirmimi i rasteve të dyshuara klinikisht nëpërmjet laboratorit ndikon në vendosjen e saktë të diagnozës dhe i hap rrugë trajtimit terapeutik të shpejtë dhe efikas. Studimi i rasteve sipas të gjitha elementeve të sipërpërmendura bën që edhe konkluzionet e nxjerra në lidhje me brucelozën të vlejnë jo vetëm si të dhëna statistikore, por njëkohësisht edhe si elemente praktike të aplikueshme me sukses në trajtimin e sëmundshmërisë. Lidhja midis ekzaminimit laboratorik dhe klinikës së sëmundshmërisë sjell diagnostikim dhe trajtim të rasteve të cilat janë të dyshuara për brucelozë.
Fjalët kyç: *Studimi i rasteve me bruceloze; Qarku i Gjirokastrës; ecuria klinike.*

Abstract
According to the studies, the brucellosis disease results being widespread all over the Mediterranean area, but even in the other parts of the world despite the numeric differences between the developed and undeveloped states. Since Albania is a part of the Ballkans known as one of the areas with the widest spread of this disease, studies have been going on not only in the

epidemiological aspect but also in the clinical aspect. Based on climatic factors, social conditions and economic development, Gjirokastra remains one of the regions with the highest number of individuals affected by brucellosis. This causes the study being periodic and including different aspects such as geographical extent, period of time, division by groups of age and sex, the rate of hospitalization of these patients and the occurrence of complications of the disease. Confirmation of clinically suspected cases through the lab affects the precision of the diagnose and paves the way for a fast and efficient therapeutic treatment. The study of the cases according to all the elements mentioned above makes the extracted conclusions about brucellosis worth not only as statistical data but also simultaneously as succesfully applicable practical elements in the morbidity treatment. The connection between the laboratoric examination and the clinic of morbidity brings diagnostics and treatment of the suspected brucellosis cases.
***Key word**: The study of brucellosis cases, The Region of Gjirokastra, Clinic progress*

Hyrje

Bruceloza është një zoonozë dhe infeksioni në njerëz vjen direkt ose indirekt nga ekspozimi me kafshët e infektuara. Sëmundja është mjaftë e përhapur veçanërisht në vendet Mesdhetare si në Portugali, Spanjë, pjesa jugore e Italisë dhe Francës, Greqi, Turqi, Afrikën Veriore, të cilat kanë një incidencë 1-78 raste për 100.000 banorë (11). Në botë numërohen çdo vit 500.000 raste të brucelozës në njerëz dhe 10.000-20.000 raste janë në Evropë (11, 12). Në vendin tonë sipas ISHP-së incidenca ka ardhur duke rënë nga viti në vit. Kështu, në vitin 2003 incidenca ka qenë 31,6 raste për 100.000 banorë, ndërsa në vitin 2013 incidenca ka qenë 13 raste për 100.000 banorë (1). Në vitin 2019 incidenca ka qenë 3,5 raste në 100.000 banorë për herë të parë që nga viti 1980.

Brucellosis, Gastric intermittent fever, Febris undulans, Malta fever, Mediterran fever, Neapolitan fever, Melitococcosis, Texas fever, Rio grande fever, Bang's disease, Febris melitensis janë të gjitha emërtime të kësaj sëmundjeje, e cila është një infeksion zoonotik tipik i kafshëve shtëpiake dhe të egra, e shkaktuar nga organizma të gjinisë Brucella. Shkaktari i saj është brucela që është një kokobacil gram negativ i palëvizshëm, aerob i detyruar pa kapsulë, që nuk formon spore. Gjinia brucela përfshin 6 lloje të ndryshme që janë: brucela melitensis, brucela abortus, brucela suis, brucela canis, brucela ovis, brucela neotomae, brucela maris. Nga këto vetëm 4 të parat mund të infektojnë njeriun. Brucela melitensis prek dhentë dhe dhitë, brucela abortus prek lopët, brucela suis prek derrat, brucela canis prek qentë. Brucela është një bakter që ka aftësi të mëdha mbijetuese më shumë se bakteret e tjera josporiluese. Në kushte të pështatshme të temperaturës dhe mbrojtjes nga dielli brucelat mund të mbijetojnë për një kohë të gjatë edhe pse nuk ka prova që mikroorganizmat të replikohen në këto kushte në tokë, ujë ose esterokol. Brucelat jetojnë në tokë për 3-4 muaj, në ujin e liqenit më shumë se 57 ditë, në lesh 110 ditë, në qumësht 8-10 ditë, në gjalpë dhe salcë kosi 30

ditë, në djathë të butë 35 ditë, ndërsa djathi i fortë i stazhionuar për 2 muaj nuk është infektues. (1, 2) Periudha e inkubacionit zgjat 2-4 javë, por në disa raste mund të ketë variabilitet dhe mund të shkojë edhe deri në 8 javë. Sëmundja mund të paraqitet në formë akute subakute dhe kronike dhe zakonisht shkakton dobësi, dhimbje koke, letargji, humbje në peshë, ethe dhe djersitje. Ethet zakonisht janë remitente dhe kjo është arsyeja që një nga emërtimet e sëmundjes është "ethet ondulante" (3, 4).
Në kafshë bruceloza është një infeksion që mund të persistojë gjithë jetën, ndonjëherë edhe pa shenja klinike,por, duke shërbyer si burim infeksioni për kafshët dhe njerëzit. Lokalizimi i brucelave në organet e riprodhimit shpjegon abortin dhe sterilitetin. Brucelat nuk përhapen nga njeriu te njeriu, por vetëm nga kafsha te njeriu. Sëmundja transmetohet te njerëzit nëpërmjet kontaktit direkt me kafshën e infektuar ose produktet e saj (veterinerët, barinjtë, kasapët janë më të predispozuar). Mënyrë tjetër është transmetimi indirekt nga konsumimi i qumështit të papasterizuar ose djathit të njomë të pastazhonuar (5, 8). Produktet e mishit rrallë shërbejnë si burim për sëmundjen, pasi ato përgjithësisht, nuk përdoren të paziera dhe numri i brucelave në muskuj është i vogël (6).
Sëmundja mund të transmetohet edhe nëpërmjet aerosolëve apo nëpërmjetkonjunktivave (mjaftojnë 10-100 bakterie për t'u infektuar) sidomos te personat që punojnë për diagnozën mikrobiologjike të brucelozës (1). Rastet e transmetimit seksual janë hipotetike, por potenciali ekziston pasi brucelat janë izoluar nga spermatozoidet njerëzore (7). Vetë inokulimi i vaksinës së gjallë është një tjetër mënyrë infektimi për veterinerët (1, 2). Sëmundja ka sezonalitet (pranverë -verë) që lidhet me periudhën e lindjeve, dështimeve dhe të laktacionit të bagëtive. Seksi mashkull rezulton më i prekur (9) si pasojë e ekspozimit më të madh me burimin e infeksionit, sidomos ata që kujdesen për kafshët.
Qarku i Gjirokastrës duke qenë i klasifikuar si një qark blegtoral gjithmonë ka pasur prezencë të sëmundshmërisë. Të dhënat e mbledhura kanë shërbyer për qëllime studimore për të nxjerrë në pah format, mënyrën e prekjes, përhapjes dhe ecurisë së kësaj sëmundjeje.

Materiali dhe metodat

Është marrë në studim qarku i Gjirokastrës në periudhën kohore 2017-2019. Janë analizuar të dhënat e Drejtorisë së Higjienës dhe Epidemiologjisë në Gjirokastër në lidhje me ekzaminimet laboratorike për brucelozë, të dhënat e kartotekës së spitalit rajonal "Omer Nishani", Gjirokastër për individët e hospitalizuar me ketë diagnozë si dhe të dhëna nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në lidhje me numrin e bagëtive dhe vaksinimin e tyre gjatë kësaj periudhe.
Rastet e studiuara kanë qenë raste ambulatore të dyshuara për brucelozë duke u nisur nga të dhënat klinike, si dhe raste spitalore, nga pacientë të shtruar në pavijonin e sëmundjeve infektive ose në pavijonet e tjera për sëmundshmëri të tjera ku klinika e tyre konvergonte edhe me klinikën e brucelozës. Përsa i përket të dhënave të mbledhura nga Drejtoria e Higjienës

dhe Epidemiologjisë, studimi ka përfshirë ndarjen sipas vendbanimeve, grupmoshave, gjinisë si dhe titrit të koagulimit të provës Wright. Ndërmjet provave serologjike për zbulimin e brucelozës është pikërisht kjo provë që është më klasikja. Wright është një test aglutinacioni që zhvillohet në dy faza. Parimi i provës bazohet në përcaktimin e aglutinimit të brucelave në prani të serumit të individit të dyshuar ose të sëmurë. Kjo provë përcakton IgM dhe në sasi të vogël IgG2, ndërsa IgG1 nuk ka veti aglutinuese. Ky test ka sensitivitet të mirë në fazat fillestare të infeksionit. Për diagnozë positive pranohen titrat më të mëdhenj sesa 1:160. Gjatë fazës akute antitrupat janë të klasës IgM dhe pastaj të klasës IgG. (10) Ky reaksion ngelet pozitiv për disa muaj pas shërimit. Në format kronike ky test mund të jetë pozitiv në titra të ulët ose mund të jetë negativ. Ulja e titrit të IgG-së me kalimin e kohës është një tregues prognostik i përgjigjes së mirë ndaj mjekimit, kurse një ringritje e titrit flet për relaps. Mund të ndodhë që gjatë fazës akute rezultatet e këtij testi të dalin negative, kjo si pasojë e antitrupave bllokantë (klasa IgA ose IgG) që në hollime të caktuara induktojnë fenomenin e prozonës. Bruceloza është një sëmundje sistemike. Ajo pozicionohet në gjendrat limfatike dhe mandej nëpërmjet gjakut prek organe dhe sisteme. Hemokultura, sternokultura dhe adenokultura mund të vlerësohen si ekzaminime komplementare për diagnozë të rasteve ku klinika flet qartë për bruzelozë ndërsa titri i aglutinimit del negativ që në fillimet e sëmundjes. Studimi i rasteve të hospitalizuara është bërë në mënyrë të datajuar për të gjitha rastet që i përkasin kësaj periudhe, sipas një kartele tip që merr në studim moshën, gjininë, vendbanimin dhe shtrirjen gjeografike. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë nëpërmjet tabelave dhe grafikëve në Excel Software.

Rezultate dhe diskutime

Zona e studiuar përfshin të gjithë qarkun e Gjirokastrës. Studimi ka nisur me të gjitha rastet e dyshuara që janë paraqitur për ekzaminim pranë laboratorit qendror në Drejtorinë e Higjienës dhe Epidemiologjisë në Gjirokastër, ku aplikohet metoda Wright që përcakton titrin e aglutinimit. Të dhënat e mbledhura janë referuar në tabelën e mëposhtme.

Viti	analiza në total	analiza pozitive për brucelozën në shifra	analiza pozitive për brucelozën në %
2017	855	131	15,3 %
2018	879	126	14,3 %
2019	653	68	10,4 %

Tabela tregon se kemi një trend në ulje të rasteve pozitive me brucelozë nga viti në vit, sidomos në vitin e fundit.

Më poshtë po japim disa të dhëna në lidhje me ndarjen sipas seksit dhe grupmoshave:

Viti	meshkuj	femra	0-18	18-40	40-60	60+
2017	99	32	10	29	67	25
2018	84	42	8	42	43	33
2019	47	21	0	26	25	17

Tabela e mësipërme tregon se seksi mashkull dhe grupmosha 40-60 vjeç janë shumë më të prekur, lidhur kjo me profesionin, aktivitetin social dhe ushqyerjen.
Me tabelën e mëposhtme po japim shpërndarjen edhe sipas muajve.

viti	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor
2017	6	7	15	6	19	10	16	15	16	4	8	9
2018	7	13	5	19	15	17	12	12	14	7	5	0
2019	4	5	4	14	10	4	3	6	5	6	3	4

Të dhënat e mësipërme tregojnë se stina pranverë-verë ka frekuencat më të larta të rasteve të konstatuara.
Sipas shtrirjes gjeografike rezulton se përhapja gjatë kësaj periudhe është si më poshtë:

Viti	Gjirokastër		Tepelenë		Përmet	
	qytet	fshat	qytet	Fshat	qytet	Fshat
2017	56	46	14	8	2	3
2018	38	63	14	7	4	0
2019	23	29	10	5	1	0

Nga tabela rezulton se rrethi i Gjirokastrës ka numrin më të madh të të prekurve me brucelozë në këtë qark. Po kështu fshati dominon mbi qytetin. Këto rezultate janë në trendin e rezultateve të studimeve të bëra në periudhën 2002-2004.
Nga rastet e pasqyruara më lart janë marë në studim rastet të cilat janë hospitalizuar gjatë periudhës kohore 2017-2019. Të dhënat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	Raste të shtruara me brucelozë
2017	27
2018	15
2019	15



Grafiku tregon se në vitin 2018 fillon një rënie si e numrit të rasteve ashtu dhe e numrit të hospitalizimeve të individëve të prekur nga bruceloza.

Më poshtë po japim disa të dhëna në lidhje me ndarjen sipas seksit dhe grupmoshave të personave të hospitalizuar:

Viti	meshkuj	femra	0-18	18-40	40-60	60+
2017	22	5	3	9	10	5
2018	10	5	2	4	7	2
2019	11	4	0	4	6	5

Siç shihet edhe nga rastet e hospitalizuara, numrin më të madh e zënë meshkujt dhe grupmoshat 40-60 vjeç
Sipas shtrirjes gjeografike rezulton se rastet e hospitalizuara gjatë kësaj periudhe janë si më poshtë:

Viti	Gjirokastër		Tepelenë		Përmet	
	qytet	fshat	Qytet	fshat	qytet	Fshat
2017	2	11	1	10	0	3
2018	3	7	0	4	0	1
2019	2	8	2	3	0	0

Sipas kësaj tabele, rezulton se shtrimet më të shumta i përkasin rrethit të Gjirokastrës me dominim të zonës rurale.
Është studiuar dhe numri i krerëve të bagëtive gjatë këtyre viteve. Nga ky studim rezulton se kemi:

Specia	2017	2018	2019
Të leshta	295310	271871	262850
Të dhira	134580	122649	121800
Gjedhë	25200	19667	18830

Qartazi duket se nga viti ne vit kemi një ulje drastike edhe të numrit të bagëtive që shërbejnë si rezervuar të brucelës. Për sa i përket vaksinimit ai ka qenë në shifrat 30%.

Përfundime

Në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë periudhës 2017-2019 nxirren disa konkluzione të cilat shërbejnë si përfundime.

- Në qarkun e Gjirokastrës për periudhën 2017-2019 janë analizuar 2387 raste nga të cilat 325 raste kanë rezultuar pozitive me brucelozë.
- Shkaktari kryesor i brucelozës është brucela melitensis.
- Nga rastet pozitive rezulton se 57 prej tyre janë hospitalizuar.
- Numri i rasteve është më i madh në zonën rurale.
- Sëmundja ka prekur më tepër meshkujt se femrat.
- Mosha më e prekur është 40-60 vjeç.
- Gjirokastra predominon kundrejt Tepelenës dhe Përmetit.
- Trendi i prekjes dhe i shtrimeve në spital është drejt uljes, e lidhur kjo me disa faktorë, siç është ulja e numrit të krerëve, rritja e masave veterinare nëpërmjet trajtimit të dështimeve si dhe nëpërmjet vaksinimit, migrimi i popullsisë.
- Gama e ndryshimeve epidemiologjike nga viti në vit brenda këtij 10-vjeçari, pavarësisht se ekziston, është e vogël.
- Testi kryesor që aplikohet për vendosjen e diagnozës vazhdon të ngelet reaksioni Wright, i cili jo gjithmonë paraqet koherencë midis klinikës dhe epidemiologjisë.

Referenca

Muhedin P, G. Moka- M.R.& M.A.F. Study of epidemiological situation of brucellosis and the strategy of control in livestock. Scopie/ Macedonia 14- 18 April, 2003; abstract book 7-15.

Kuka A. Bruceloza e kafsheve bujqesore; botim ILB Tirane 1969.

Sakran W, Chazan B, Koren A. Brucellosis: clinical presentation, diagnosis, complications and therapeutic options. Harefuah 2006; 145: 836-40.

Brucellosis in humans and animals. World Health Organization. 2006. Guideline

Castell Monsalve J, Rullan JV, Peiro Callizo EF et al. Epidemic outbreak of 81 cases of brucellosis following the consumption of fresh cheese without pasteurization. Rev Esp Salud Publca 1996, May- Jun; 70 (3): 303-11.

Mandell, Douglas and Bennett's Principles and Practice of Infectious Diseases,4-th edition Churchill Livingstone 1995, Brucella species 2053-2060.

Vandercam B, Zech F, de Cooman S et al. Isolation of Brucella melitensis from human sperm. Eur J Clin Microbiol Infect Dis. 1990; 9: 303-4.

Chomel BB, Debess EE, Mangiamele DM et al. Changing trends in the epidemiology of human brucellosis in California from 1973 to 1992: a shift towards foodborn transmission. J Infect Dis 170: 1216, 1994.

Harxhi A, Shkurti K, Pano K. Brucellosis and the genitourinary system. 5-th European congress of chemotherapy and infection, 17-20 oct 2003, Rhodos-Greece, absract book.

WHO Collaborating Centre for Research and Training in Mediterranean Zoonoses; Training course on diagnosis of Brucellosis, Dec 2002, 32.

Sherwood L. Gorbach, John G. Barlett, Neil R. Blacklow; Infectious Diseases, Philadelphia-London- Toronto 1998, 2-nd edition; Brucella, 1837-1843.

Sirmatel F, Turker M, Bozkurt AI. Evaluation of the methods used for the serologic diagnosis of brucellosis. Mikrobiology Bul 2002 Apr; 36(2): 161-7.

STUDIM KLINIKO-STATISTIKOR I VARIKOCELËS, NË SPITALIN "OMER NISHANI" GJIROKASTËR, NË PERIUDHËN 2009-2013

Igli Kokalari
Reparti i Kirurgjisë, Spitali "Omer Nishani" Gjirokastër
kokalarii@yahoo.com

Abstrakt
Infertiliteti mashkullor i lidhur me varikocelën është menaxhuar në mënyrë klasike duke përdorur kirurgji ose teknika riprodhuese të asistuara. Praktika kirurgjikale mbi mjekësinë riprodhuese të meshkujve po zgjerohet vazhdimisht, veçanërisht në lidhje me diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të infertilitetit për shkak të varikocelës dhe pasojave të saj si astenospermisë dhe azoospermisë jo-obstruktive. Përveç kësaj, studime të shumta mbi azoosperminë jo-obstruktive kanë raportuar se varikocelektomia jo vetëm që mund të nxisë spermatogjenezën, por gjithashtu mund të rrisë shkallën e marrjes së spermës; megjithatë, vlera e varikocelektomisë në pacientët me azoospermi jo-obstruktive mbetet një nga metodat kirurgjikale shpresëdhënëse. Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë një pasqyrë të statusit aktual të trajtimit kirurgjikal të varikocelës tek meshkujt me azoospermi jo-obstruktive.

Fjalët kyç: *Varikocelë, infertiliteti, venat varikoze, ndërhyrje kirurgjikale*

Abstract
Male infertility associated with varicocele is classically managed using surgery or assisted reproductive techniques. The surgical practice of male reproductive medicine is constantly expanding, especially in relation to the diagnosis and early treatment of infertility due to varicocele and its consequences such as asthenospermia and non-obstructive azoospermia. In addition, numerous studies on non-obstructive azoospermia have reported that varicocelectomy can not only promote spermatogenesis but also increase the sperm retrieval rate; however, the value of varicocelectomy in patients with non-obstructive azoospermia remains one of the promising surgical methods. The aim of this study is to present an overview of the current status of surgical treatment of varicocele in men with non-obstructive azoospermia.

Key words*:varicocele, infertitity, varicose, veins, intervention.*

1. Hyrje

Me termin varikocelë kuptojmë një zgjerim varikozë të venave në skrotum. Gjaku venoz nuk mund të rikthehet nga testikujt normalisht për shkak të këtyre venave, të cilat pasi zgjerohen kthehen në vena varikoza. Pikërisht ky çrregullim, që krijohet në testikuj nga pellgëzimi i gjakut, krijon këtë patologji që quhet varikocelë.

Njohja e kësaj sëmundjeje ka rëndësi pasi diagnostikimi i hershëm i saj rrit mundësinë e shërimit në mënyrë të ndjeshme. E kundërta ndodh nëse rasti zbulohet me vonesë, ku ndryshimet që kjo patologji shkakton mund të jenë edhe të parikthyeshme.

Varikocelat janë shumë të zakonshme dhe nuk janë të rrezikshme. Në fakt, 15% e të gjithë meshkujve të rritur kanë varikocelë. Për shumë meshkuj, varikocela e tyre do të kalojë pa u vënë re gjatë gjithë jetës së tyre, ose nuk do të shkaktojë fare probleme. Rreth 20% e adoleshentëve kanë varikocela, kështu që një pjesë e tyre ka të ngjarë të zgjidhet spontanisht *(Johns Hopkins Medicine, 2022).*

Për të kuptuar më mirë veçoritë dhe karakteristikat e kësaj sëmundjeje nevojitet një përshkrim i shkurtër i anatomisë së sistemit venoz testikular, si dhe i shenjave klinike, komplikacioneve, mjekimit dhe trajtimit kirurgjikal.

Fillesat e sistemit venoz testikular janë në pleksusin pampiniform, i cili vazhdon me venën spermatika interna. Kjo e fundit derdhet në venën suprarenale të majtë ose të djathtë. Vena spermatika interna e majtë në vendin e derdhjes në venën suprarenale formon një kënd gati të drejtë dhe ky është një nga variacionet anatomike që shkakton që kjo sëmundje të shfaqet më shumë në anën e majtë. Ndërsa në anën e djathtë përqindja është tepër e vogël dhe kjo lidhet me faktin se vena spermatika interna e djathtë e cila derdhet po në venën suprarenale të djathtë nuk e ka këtë lloj pengese.

Kjo sëmundje në rreth 90% të rasteve lokalizohet në anën e majtë, për arsyet që u përshkruajtën më lart. 8% në të dyja anët dhe vetëm 2% në anën e djathtë.

Etiologjia e varikocelës është akoma e papërcaktuar me saktësi. Mendohet se ajo formohet si rezultat i mungesës së disa valvulave në brendësi të venave testikulare të cilat bëjnë që gjaku të mos rrjedhë në mënyrë të përshtatshme duke shkaktuar zgjerimin e tyre. *(Arafa 2019).*

Predispozicioni mund të jetë edhe gjenetik me karakter hereditar familjar. *(Raman 2005).* Studimet e bëra prej Raman et.al. nxorrën përfundimin se 56% e të afërmve të shkallës së parë të pacientëve me varikocele kishin një varikocele të dukshme, e cila ishte 8 herë më e lartë se grupi i tyre i kontrollit (burrat që paraqiteshin për të zhbërë një vazektomi). *(Raman 2005).* Mokhtari et.al. gjithashtu tregoi një prevalencë 45% të varikocelës midis të afërmve të shkallës së parë, krahasuar me 11% në grupin e tyre të kontrollit (popullsia e meshkujve të shëndetshëm që shërbejnë si donatorë të veshkave). *(Mokhtari 2008).* Këto studime sugjerojnë fuqishëm se prevalenca e varikocelës mund të ndikohet nga faktorë trashëgues. Faktorët specifikë gjenetikë që lidhen me prevalencën e shtuar të varikocelës tek anëtarët e familjes mbeten për t'u qartësuar.

Dëmtimi ose mungesa e sistemit valvular të venës spermatika interna bëjnë që gjaku të kthehet mbrapsht në drejtim të kundërt, pra të testikulit duke realizuar zgjerimin e venave të skrotumit dhe të pleksit pampiniform.
Hulumtimet teorizojnë se spermatozoidi mund të dëmtohet për shkak të nxehtësisë së tepërt. Kjo e shkaktuar nga rritja e stresit oksidativ në spermë prej grumbullimit të gjakut që shkakton oksigjenim të reduktuar, efekte të drejtpërdrejta të dëmtimit të presionit hidrostatik në testikul, formim të toksinave, hipoksisë etj. *(Vaganée 2018).* Teoria më e pranuar është se zgjerimi i venave rreth testikujve për pasojë sjell rritjen e temperaturës lokale mbi 32°C, që duhet të jetë temperatura normale në këtë zonë, ndryshim ky që influencon në mundësinë e testikujve për të prodhuar një numër më të vogël spermatozoidesh si dhe me lëvizshmëri më të dobët, për pasojë sterilitet mashkullor. Përveç kësaj, kjo mund të dëmtojë testikulin dhe ta atrofizojë atë.
Ekziston një korrelacion statistikisht i pranueshëm ndërmjet varikocelës dhe uljes së aftësisë riprodhuese ose infertilitetit sekondar mashkullor. Diagnostikimi i hershëm i kësaj sëmundjeje nëpërmjet depsistimimit në fëmijët e seksit mashkull ndihmon për të evidentuar në kohë këtë patologji në dukje të thjeshtë, por që mund t'u shkaktojë atyre sterilitet në moshën adulte.
Varikocela në gradat e para mund të jetë pa simptoma evidente, por me kalimin e viteve, ajo mund të shkaktojë ënjtje dhe dhimbje në testikuj, për shkak të progresit të zgjerimit të venave. Këto shenja e rrisin intesitetin e tyre gjatë qëndrimit gjatë në këmbë, nga ushtrime fizike për një kohë të gjatë dhe lehtësohen gjatë qëndrimit shtrirë në shpinë. Me kalimin e kohës, venat mund të zgjerohen akoma më tepër duke u bërë të dukshme. Në këto raste ato i ngjajnë një qeseje të mbushur me krimba, *(Leslie 2021),* mund të shkaktojnë ënjtjë të indeve mbi testikul dhe në raste akoma më të avancuara, testikujt mund të zbuten dhe të atrofizohen.
Një varikocelë konstatohetnga ekzaminimi fizik ndërsa mashkulli është në këmbë. Varikocela është shumë më pak e theksuar dhe mund të zhduket gjatë shtrirjes. Një varikocelë që tregohet në ultratinguj por nuk mund të ndihet në fizik ekzaminimi quhet varikocele subklinike. *(American Society for Reproductive Medicine 2014).* Nëse ekzaminimi fizik nuk është i mjaftueshëm, rekomandohet një ekzaminim ekografik i skrotumit ku në disa raste këshillohet edhe një ekzaminim më i gjerë i abdomenit për të përjashtuar praninë e një mase që komprimon venën spermatike. Imazheria termike është një tjetër teknikë joinvazive, pa dhimbje dhe pa kontakt për vlerësimin dhe konfirmimin e një varikocele të mundshme. *(Hannick 2019), (Shakeri 2018), (Rocher 2019).*
Të tjera ekzaminime që mund të ndihmojnë janë ekot vaskulare dopler, imazheria CT *(Leslie 2021).* Përveç këtyre është e nevojshme që në këtë moment të kryhet edhe një spermogram për të verifikuar cilësinë e spermës para fillimit të trajtimit.
Hidrocela është një patologji tjetër që mund të shkaktohet si ndërlikim i një varikocele. Ajo është një grumbullim jonormal i lëngjeve në qesen e

membranës seroze që mbulon testikujt. *(Nesbit 2004).* Kjo ndodh zakonisht në moshat mbi 40 vjeçare duke shkaktuar përveç grumbullimit të likidit në skrotum dhe për pasojë zgjerimin e tij, ndonjëherë edhe zvogëlim të testit. Por ndërlikimi më i madh që ndodh për pasojë të varikocelës gjithmonë mbetet infertiliteti dhe steriliteti mashkullor.

Te të gjitha çiftet që kanë marrdhënie seksuale të rregullta dhe pa mbrojtje, që nuk kanë asnjë shtatzani brenda një viti, bashkëshorti mashkull duhet detyrimisht të ekzaminohet për praninë e mundshme të varikocelës.

Trajtimi i varikocelës mund të mos jetë gjithmonë i domosdoshëm. Trajtimi i varikocelës klinike duhet t'i ofrohet partnerit mashkull të një çifti që tenton të mbetet shtatzënë kur janë të pranishme: 1) varikocela është e prekshme; 2) çifti ka infertilitet të dokumentuar; 3) femra ka fertilitet normal ose infertilitet potencialisht të korrigjueshëm; dhe 4) partneri mashkull ka një ose më shumë parametra jonormalë të spermës ose rezultate të testit të funksionit të spermës. (Sharlip 2002).

Pacientët që nuk kanë shqetësime madhore, zakonisht nuk kanë nevojë për trajtim. Në këto raste ata monitorohen dhe ndiqen në dinamikë për të parandaluar që sëmundja të kalojë në stade të avancuara. Trajtimi kirurgjikal rekomandohet në raste kur varikocela shkakton dhimbje, atrofi të testit ose infertilitet. Qëllimi i saj konsiston në mbylljen e venës së dëmtuar në mënyrë që gjaku të rrjedhë nëpër venat normale. Metodat kirurgjikale për trajtimin e kësaj patologjie janë:

- Kirurgjia e hapur – Mund të kryhet me anestezi të përgjithshme ose lokale. Bëhet një incizion i lëkurës në bark ose në rrëzë të kofshës, pasi zbulohet vena, ajo lidhet dhe pritet ndërmjet dy ligaturave. Pas dy ditësh, pacienti rikthehet në jetë normale pa sforcim fizik.*(Silber 1979).*
- Kirurgjia laparoskopike – Kjo procedurë kryhet me anestezi të përgjithshme dhe konsiston në mbylljen e venës me anën e laparoskopit. *(Hagood 1992).*
- Embolizimi perkutan – Është një procedurë që kryhet në bashkëpunim me imazherinë ku nën ekzaminimin eko futet një kaniulë nën kontrollin e monitorit dhe injektohet substancë që bën sklerotizimin e venës. *(Goldstein 2011).*

Varikocelektomia është një procedurë ambulatore. Pacienti mund të kthehet në punë pas dy-tre ditësh. Duke u rekomanduar të evitohet aktiviteti fizik deri në dy-tre javë, si dhe aktiviteti seksual tre-katër javë. Rikuperimi i spermatogjenezës kërkon disa muaj. Kjo për arsye se spermatozoidet e reja duan tre muaj që të zhvillohen.

1. Metodologjia studimore

Ka pasur si qëllim primar studimin e rasteve te të sëmurët me varikocelë gjatë përiudhës kohore 2009 – 2013 të trajtuar nga ana jonë.

Objektivat e këtij punimi janë fokusuar në prezantimin jo vetëm të analizës e të gjitha rasteve me varikocelë që mund të çojnë në infertilitet, por jemi përpjekur të vëmë në dukje një nga shkaqet, fatkeqësisht jo të rralla, e cila

mund të parandalohet që në moshë të hershme, kur nuk ka dhënë akoma ndryshime të parikthyeshme, si infertiliteti mashkullor.

1.1. Të dhëna demografike dhe epidemologjike

Sëmundja e varikocelës në Gjirokastër, e hasur në popullatën mashkullore 15 – 30 vjeç (rreth 4000 banorë), në vitet 2009 – 2013 ka një frekuencë që llogaritet me një prevalencë prej 32 rastesh për 10'000 banorë, ose 0.32% dhe incidenca komulative e kësaj sëmundjeje është 0.61%. Niveli i pjesshëm i infertilitetit në rastet e shqyrtuar llogaritet mbi 80%.

1.2. Instrumentat e përdorur

- Kartelat klinike dhe numrin e personave të shtruar në repartin e kirurgjisë me këtë diagnozë gjatë periudhës kohore 2009 – 2013;
- Ekzaminimet dhe analizat e përdorura për vendosjen e diagnozës;
- Vlerësimi nga ana jonë të dëmtimeve patologjike në tërësi dhe komplikacionet shoqëruese, veçanërisht niveli i fertilitetit te pacientët e prekur nga varikocela;
- Menaxhimi kliniko-mjekësor të rasteve dhe teknikat kirurgjikale të përdorura, trajtimi medikamentoz dhe ditë-qëndrimi mesatar në spital;
- Vlerësimi i kontrolleve periodike të pacientit pas trajtimit në një periudhë kohore prej dy vjetësh (follow up);
- Grumbullimi, përpunimi dhe analizat e të dhënave si dhe nxjerrja e e rezultateve dhe konkluzioneve konkrete, për pacientet e trajtuar si dhe në shkallën e përmirësimit të tyre përsa i përket fertilitetit.

Në praktikën tonë klinike është vënë re se pacientët që janë paraqitur për vizitë dhe më pas për trajtim, kanë qenë të martuar dhe nuk kanë patur fëmijë.

1.3. Periudha studimore përfshin vitet 2009 – 2013

Gjatë kësaj periudhe në repartin e kirurgjisë janë paraqitur 32 pacientë, raste të operuara. Mosha e tyre varion nga 15 deri në 30 vjeç.
U diagnostikuan për shqetësime klinike 70% e pacientëve që u paraqitën te mjeku kirurg.
U diagnostikuan në mënyrë të rastësishme 30% e pacientëve që u paraqitën për shqetësime të tjera, por që gjatë vizitës mjekësore që u krye nga mjeku kirurg u diagnostikuan edhe me varikocelë.

Sipas viteve shpërndarja e rasteve ka qenë:

- Viti 2009 7 raste
- Viti 2010 11 raste
- Viti 2011 5 raste
- Viti 2012 4 raste
- Viti 2013 5 raste

1.4. Ankesat e pacientëve dhe kuadri klinik

Pacientët e paraqitur te ne kishin larmi simptomash, por për lehtësi studimore i kemi grupuar ato në disa kategori. Ankesat kryesore ishin:

- Dhimbje dhe rëndesë në testin respektiv, e cila mund të iradiojë deri në regjionin lumbar;
- Disfunksion erektil;
- Ejakulacion i parakohshëm dhe i pakët;
- Pamundësi për të konceptuar një shtatzani në vitin e parë të martesës tek ata meshkuj që kryejnë marrëdhënie seksuale të rregullta dhe bashkëjetojnë në çift.

1.5. Kriteret ekzaminuese dhe diagnostike të përdorura

- Historia e sëmundjes dhe intervista me pacientin;
- Vlerësimi i simptomave dhe shqetësimeve klinike;
- Ekzaminimi manual i testeve;
- Eko e skrotumit dhe e enëve të gjakut;
- Kryerja e analizës së spermogramës.

Në pjesën më të madhe të rasteve të diagnostikuara gjatë ekzaminimit klinik me sy dhe me prekje dallohet pleksusi pampiniform i dilatuar në formën e një grushti krimbash që me provën e valsavës dilatohet së tepërmi. Staza venoze e krijuar në sistemin vazal krijon një shtrat të nxehtë përreth testit dhe gradualisht fillon e dëmton atë.

2. Rezultate

2.1. Nga pikpamja patologjike sipas të dhënave klinike të marra nga rastet studimore u evidentuan:

- Në 97.5% të rasteve dominon varikocela sinistra;
- 2% e rasteve janë varikocelë dextra;
- 0.5% e rasteve janë varikocelë bilateriale;
- Në 80% të rasteve u vu re atrofi e testit sinistra;
- 5% e rasteve janë hidrocelë;
- 75% e rasteve u vu re astenospermi;
- 25% e rasteve u vu re oligospermi.

2.2. Ndërlikimet e konstatuara të varikocelës

Një nga shkaqet e sterilitetit në çift është steriliteti mashkullor i shkaktuar nga varikocela e avancuar. Në kushtet tona është bërë ekzaminimi mikroskopik i kampionit të sperrmës (spermograma) e cila merret nga meshkujt me probleme infetiliteti.

2.3. Në 90% të rasteve me varikocele është konstatuar:

- Hidrocelë dhe atrofi e testkulit;

- Oligospermi me forma nga më të lehtat deri tek ato më të vështirat, përkatësisht gjetjet variojnë nga 5 – 20 milion të numrit të përgjithshëm të spermatozoidëve;
- Defekti i dytë ka qenë astenospermia.
- Gjithashtu është konstatuar edhe leukospermia, e cila është konfirmuar nëpërmjet spermokulturës;
- Po kështu është konstatuar teratospermia;
- Raste me asospermi dhe nekrospermi nuk kemi pasur.

3. Diskutime

3.1. Infertiliteti mashkullor dhe varikocela

Në rastet e çifteve infertile, që paraqesin infertilitet mashkullor një ndër shkaqet kryesore mund të jetë varikocela.Pra nga ana jonë u vërtetua prezenca domethënësee infertilitetit sekondar të pjesshëm në 75% të rasteve të diagnostikuara te burrat që kishin lidhje në çift. Të gjithë këta burra, mund të jenë prej kohësh infertilë, pa qenë konshientë për këtë fakt, gjë që e kuptuan vetëm pas fillimit te jetës bashkëshortore, kryerjes së marrëdhënieve të rregullta dhe të pa mbrojtuara seksuale dhe mos konceptimit të shtatzanisë te partnerja e tyre. Gjatë ekzaminimeve të sferës seksuale dhe riprodhuese në çift rezulton se të gjitha gratë e këtyre burrave, janë të shëndetshme përsa i përket mirëqënies gjinekologjike të shëndetit seksual dhe riprodhues.
Ngapraktika jonë klinike në trajtimin e rasteve me varikocelë sipas statistikave, rezulton se në një çift steril 50 – 75% të rasteve, defekti duhet kërkuar te seksi mashkull dhe në 25 – 50 % të rasteve, defekti duhet kërkuar te seksi femër.

3.2. Kritere të diagnozës diferenciale

Nga ana jonë u bë diagnoza diferenciale me sëmundje të tilla si orkioepidimitet, hidrocelat traumatike, seminomat dhe kriptotokiditet.

3.3. Aspekte antropologjike dhe problematikat psikologjike

Nga ana jonë janë evidentuar problematika të karaterit antropologjik dhe psikologjik të personave që vuajnë nga varikocela të cilët nuk kanë ardhur në kohën e duhur tek mjeku për t'u vizituar. Kjo ka ardhur si pasojë e ndjenjës së turpit, stigmës dhepsikologjisë patriakale mbizotëruese te meshkujt.
Në rastet e çifteve të martuar infertil gruaja është detyruar të kryejë kontrolle të vazhdueshme mjekësore gjinekologjike, ndërsa burri nuk ka shkuar në kohë për kontroll mjekësor te mjeku kirurg ose nuk i ka frekuentuar ato rregullisht. Si rezultat duke mos pasur dëshirën dhe informacionin e duhur, një pjesë e varikocelave të avancuara të pa diagnostikuara kanë përbërë shkakun e panjohur të sterilitetit në çift.

3.4. Menaxhimi i sëmundjes

Në rastet tona të operuara diagnoza është konfirmuar nga ankesat e pacientit, kuadri klinik i sëmundjes dhe ekzaminimet imazherike me ultrasound ECHO dopler të venave.

Krahas kësaj diagnoza mund të vihet edhe me anën e ekografisë (ultrasonografinë) që quhet "Color Doppler USG of the scrotum". Për të kuptuar gjendjen e spermës së mashkullit në atë moment dhe për të ndjekur avantazhin në kurim, testi "spermogram" është i domosdoshëm.

3.5. Trajtimi kirurgjikal i varikocelësdhe rezultatet e teknikes operatore

Në të gjitha rastet, prej nesh u përdor teknika e kirugjisë e hapur, teknika kirurgjikale e ligaturës së venës spermatike interne me incizion MAC bynay të majtë ose të djathtë. Në katër raste është bërë heqja e pleksusit pampiniform krahas ligaturës së venës spermatike interna. Ndërhyrja operatore është kryer me anestezi spinale.

3.6. Rezultuatet konkrete

- Shumica e pacientëve patën një përmirësim të theksuar ose shërim të plotë;
- Periudha post operatore ka kaluar shumë mirë;
- Nuk kemi pasur asnjë rast me infeksione post operatore;
- Ditë-qëndrimi mesatar ka qenë 2 ditë. Trajtimi medikamentoz ka qenë vetëm me analgjezikë;
- Në rastet e infertilitetit, numri i spermatozoideve dhe lëvizshmëria e tyre u përmirësua pas ndërhyrjes kirurgjikale;
- Pas operacionit, periudha e pritjes për rritjen e numrit të spermatozoidëve u përmiresua pas 3-6 muajsh;
- Ky përmirësim u vërejt në afërsisht 70% të meshkujve të trajtuar me metodën kirurgjikale;
- Shkalla e pritur e shtatzanisë brenda një viti u evidentua në rreth 50% të rasteve;
- Rreth 20 prej rasteve janë ndjekur në dinamikë për 2 vjet dhe në të gjithë këta person, spermograma është normalizuar dhe kanë lindur fëmijë;
- Rastet e tjera kanë qenë të pamartuar, prandaj përveç spermogramës që është normalizuar nuk kemi të dhëna të tjera;
- Megjithatë tek disa meshkuj të operuar nuk u vërejt ndonjë përmirësim në numërimin dhe cilësinë e spermës.

Gjithsesi edhe studimet tregojnë që çiftet pas kirurgjisë kanë një mundësi për të bërë fëmijë nga 30% deri në 50% më shumë sesa ata që nuk i janë nënshshtruar ndërhyrjes.

4. Përfundime

Këshillojmë të gjithë personat e seksit mashkull të grup-moshës 15 – 30 vjeçe të kryejnë kontrolle periodike te mjeku kirug për të zbuluar sëmundjen e varikocelës dhe për të parandaluar ndërlikimet serioze të kësaj sëmundjeje siç është infertiliteti mashkullor.

Këshillojmë të gjitha çiftet e sapomartuar, të cilët përreth 2 vitesh nuk kanë lindur fëmijë, të kontrollohen te mjeku, sidomos mashkulli, në mënyrë që të

evidentohet një varikocelë e mundshme, me qëllim që të bëhet ndërhyrja në kohë për trajtimin e kësaj sëmundjeje dhe eliminimin e sterilitetit në çift.

Referenca

American Society for Reproductive Medicine. (2014). Varicocele; marrë nga: https://www.reproductivefacts.org/globalassets/rf/news-and-publications/bookletsfact-sheets/english-fact-sheets-and-info-booklets/varicocele_factsheet.pdf

Arafa M, Henkel R, Agarwal A, Majzoub A, Elbardisi H. (2019). Correlation of oxidation-reduction potential with hormones, semen parameters and testicular volume. *Andrologia*. Jun;51(5):e13258. doi: 10.1111/and.13258. Epub Feb 26. PMID: 30809834.

Goldstein M. Wein A, Kavoussi LR, Novick AC, Partin AW, Peters C. (2011). Surgical management of male infertility. *Campbell's urology*.. Vol 1:10th ed. Philadelphia: WB Saunders, Co;648–687.

Hagood PG, Mehan DJ, Worischeck JH, Andrus CH, Parra RO. (1992). Laparoscopic varicocelectomy: preliminary report of a new technique. *J Urol*. Jan; 147(1):73-6. doi: 10.1016/s0022-5347(17)37137-9. PMID: 1530871.

Hannick JH, Blais AS, Kim JK, Traubici J, Shiff M, Book R, Lorenzo AJ. (2019). Prevalence, Doppler Ultrasound Findings, and Clinical Implications of the Nutcracker Phenomenon in Pediatric Varicoceles. *Urology*. Jun; 128:78-83. doi: 10.1016/j.urology.2019.03.001. Epub Mar 16. PMID: 30885542.

Johns Hopkins Medicine, (2022) Varicocele, marrë nga: (https://www.hopkinsmedicine.org/health/conditions-and-diseases/varicocele)

Leslie SW, Sajjad H, Siref LE. (2021). Varicocele. In: StatPearls. StatPearls Publishing, Treasure Island (FL);. PMID: 28846314.

Mokhtari G, Pourreza F, Falahatkar S, Kamran AN, Jamali M. (2008). Comparison of prevalence of varicocele in first-degree relatives of patients with varicocele and male kidney donors. *Urology*. Apr; 71(4):666-8. doi: 10.1016/j.urology.2007.11.116. Epub Feb 15. PMID: 18279919.

Nesbit JA. (2004), Hydrocele and Spermatocele. In Graham SD, Keane TE, Glenn JF eds, *Glenn's Urologic Surgery*. Philadelphia: Lippincott Williams & Wilkins: 598– 602

Raman JD, Walmsley K, Goldstein M. Inheritance of varicoceles. (2005) *Urology*. Jun; 65(6):1186-1189. doi: 10.1016/j.urology.2004.12.057. PMID: 15913726

Rocher L, Gennisson JL, Baranger J, Rachas A, Criton A, Izard V, Bertolloto M, Bellin MF, Correas JM. (2019). Ultrasensitive Doppler as a tool for the diagnosis of testicular ischemia during the Valsalva maneuver: a new way to explore varicoceles? *Acta Radiol.* Aug; 60(8):1048-1056. doi: 10.1177/0284185118810981. Epub 2018 Nov 5. Erratum in: Acta Radiol. 2021 Jun;62(6):848. PMID: 30396287.

Silber SJ. (1979). Microsurgical aspects of varicocele. *Fertil Steril*. 31(2):230–232. doi: 10.1016/S0015-0282(16)43830-6

Shakeri S., Malekmakan L., Manaheji F., Tadayon T., (2018). Inter-observer agreement on varicoceles diagnosis among patients referred to Shiraz Namazi Hospital. *International Journal of Reproductive BioMedicine*. (16). 649-652. doi:10.29252/ijrm.16.10.649.

Sharlip ID, Jarow JP, Belker AM, Lipshultz LI, Sigman M, Thomas AJ, Schlegel PN, Howards SS, Nehra A, Damewood MD, Overstreet JW, Sadovsky R. (2002). Best practice policies for male infertility. *Fertil Steril*. May; 77(5):873-82. doi: 10.1016/s0015-0282(02)03105-9. PMID: 12009338.

Vaganée D, Daems F, Aerts W, Dewaide R, van den Keybus T, De Baets K, De Wachter S, De Win G. (2018) Testicular asymmetry in healthy adolescent boys. *BJU Int.* Oct; 122(4):654-666. doi: 10.1111/bju.14174. Epub 2018 Mar 23. PMID: 29461677.